FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 4

Tiranë – E martë, 12 janar 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 158/2020, datë 17.12.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integrimit Evropian, dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal i Zi–Shqipëri, 2014–2020, alokimet për vitin 2019.....	447
Dekret i Presidentit nr. 11896, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	532
Ligj nr. 159/2020, datë 17.12.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane, dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut–Shqipëri ,2014–2020, alokimet për vitin 2019.....	532
Dekret i Presidentit nr. 11897, datë 5.1.2021	Për shpallje ligji.....	598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1122, datë 30.12.2020	Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.....	598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.12.2020	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet, 2021–2026, dhe të planit të veprimit 2021–2023.....	618
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020	Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022.....	664
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1143, datë 9.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 750, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit".....	692

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1147, datë 9.12.2020	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Portali unik qeveritar *e-Albania*" dhe për miratimin e rregullave "Për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit".....	709
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 527, datë 30.12.2020	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 24, datë 30.1.2013, "Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve".....	716
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave nr. 5, datë 24.12.2020	Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror".....	722
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 1, datë 5.1.2021	Për delegimin e kompetencave.....	722
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 195, datë 7.1.2021	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	723

LIGJ
Nr. 158/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, MALIT TË ZI, PËRFAQËSUAR NGA ZYRA E INTEGRIMIT EUROPIAN, DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MAL I ZI-SHQIPËRI 2014-2020, ALOKIMET PËR VITIN 2019

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integrimit Europian, dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mal i Zi-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11896, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJA E FINACIMIT
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

Mali i Zi i përfaqësuar nga Qeveria e Malit të Zi - Zyra e Integrimit Evropian dhe Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që në vijim referohen bashkërisht si "Përfituesit e IPA II" ose veçmas si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin për alokimet e vitit 2019 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

Programi i Veprimit të Bashkëpunimi Ndërkufitar Mali i Zi për vitet 2018 – 2020. (Numri i angazhimit (CRIS): 2019 / 041-470)

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)[1].

2. Kostoja e totale e llogaritur për fondet e vitit 2019 është 2,000,000 EURO dhe kontributi maksimal i Bashkimit në këtë Program të Veprimit është 1,700,000 EURO

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e vendeve IPA II.

Neni 2
Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje

[1] Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3
Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar, duke iu referuar shprehimisht Programit të Veprimit, siç identifikohet në nenin 1 (1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

për Komisionin
Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtoria D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe Fqinjësinë, Komisioni Europian
15, Rue de la Loi, B – 1049 Bruksel, Belgjikë
E-mail: NEAR-D1@ec.europa.eu

Për përfituesit e IPA II

Për Malin e Zi:
Z. Aleksandar Drljević Krye-Negociator dhe Koordinator Kombëtar i IPA-s
Qeveria e Malit të Zi
Zyra e Integrimit Evropian
Bulevar Revolucije 15
81000, Podgoricë, Mali i Zi
E-mail: aleksandar.drlievic@,gsv.gov.me

Për Republikën e Shqipërisë::
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial
Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 6

Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@mfa.gov.al

Neni 4
Pikat e kontaktit të OLAF-it

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operacionale të OLAF-it do të jenë:

Për Malin e Zi:
AFCOS pikë kontakti / zyra e AFCOS
Znj. Natasa Kovacevic
Ministria e Financave e Malit të Zi
Stanka Dragojevića 2, 81000, Podgoricë, Mali i Zi
Natasa.kovacevic@mif.gov.me

Për Shqipërinë::
Z. Bejko Late
Drejtor i Sektorit të Inspektimit Financiar
Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri
Bejko.late@financa.gov.al

Neni 5
Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Malit të Zi mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit për Malin e Zi nën Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 4 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015, (e referuar në vijim si "Marrëveshja Kuadër (et)").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 6
Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
a) këto Kushte të Veçanta;
b) Shtojca I: Programi i Veprimit CBC Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2018 - 2020;
c) Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 ndërmjet Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë;

d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;

e) Shtojca III: Model i Raportit Vjetor BNK për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;

f) Shtojca IIIA: Modeli i Raportit Vjetor për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 58 dhe 59 (1) të Marrëveshjes Kuadër;

g) Shtojca IV: Modeli i Raportit Financiar sipas nenit 59 (2) të Marrëveshjes Kuadër;

h) Shtojca V: Specifikimet Minimale të Sistemit të Kontabilitetit me Bazë Akruale;

2) Në rast të një konflikti, nga njëra anë e dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër e dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA dhe e dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës I, nga njëra anë, dhe dispozitave të Shtojcës IA nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën kur Komisioni merr njoftim nga vendi i fundit përfitues i IPA II, i cili konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi. Komisioni duhet të informojë përfituesit IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Nëse Komisioni nuk merr njoftim deri më 31 dhjetor 2020, Marrëveshja e Financimit nuk hyn në fuqi.

Kjo Marrëveshje është hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat një do i dorëzohet Komisionit dhe dy të tjerat përfituesve IPA II.

Për përfituesin IPA II:
Për Malin e Zi:
Z. Aleksandar Drljević
Krye-Negociator
dhe Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Qeveria e Malit të Zi
Zyra e Integrimit Evropian
Podgoricë, datë 25 gusht 2020

Për Republikën e Shqipërisë:
Z. Zef Mazi
Koordinator Kombëtar i IPA-s
Tiranë, datë 9 nëntor 2020

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtore D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe Fqinjësinë
Komisoni Evropian

Bruksel, datë 22 qershor 2020

SHTOJCË
E VENDIMIT ZBATUES TË KOMISIONIT QË MIRATON PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI - REPUBLIKA E SHQIPËRISË PËR VITET 2018-2020[2]

Programi shumëvjeçar i punës
Ky dokument përbën programin shumëvjeçar të punës në kuptimin e nenit 110 (2) të Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046

1. IDENTIFIKIMI

Përfituesit	Mali i Zi, Republika e Shqipërisë
Referencat e angazhimit të CRIS / ABAC Kontributi i Unionit Linja e buxhetit	2018/ 041-468 EURO 1,700,000 22.020401 2019/ 041-470 EURO 1,700,000 22.020401 2020/ 041-175 EURO 1,530,000 22.020401
Mënyra e menaxhimit **Strukturat përgjegjëse**	Menaxhimi i tërthortë nga Mali i Zi Struktura Operuese përgjegjëse për zbatimin e projekteve është: Zyra e Integrimit Evropian Autoriteti Kontraktues është Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Ndihmës së BE-së (CFCU) në Ministrinë e Financave Struktura Operuese partnere në Shqipëri është: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Data përfundimtare për	Për angazhimin buxhetor të vitit 2018

[2] Kjo është për programet e viteve 2018, 2019 dhe 2020. Në këtë dokument Republika e Shqipërisë përdoret si emri i vendit.

miratimin e Marrëveshjes/ve Financiare me vendet përfituese të IPA II (tripalëshe)	maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2019 Për angazhimin buxhetor të vitit 2019 maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2020 Për angazhimin buxhetor të vitit 2020 maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2021
Data përfundimtare për mbylljen e kontratave të granteve, duke përfshirë përfundimin e marrëveshjeve të kontributit/delegimit	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 189 (2) të Rregullores Financiare
Data përfundimtare për zbatimin e projekteve	6 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (datë në të cilën ky program duhet të jetë mbyllur dhe të jetë përfunduar angazhimi i fondeve) pas pranimit të shpenzimeve	12 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit

2. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË VEPRIMIT

2.1 PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR 2014-2020

Programi i BNK-së (Bashkëpunimi Ndërkufitar) Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020 është miratuar me Vendimin Zbatues të Komisionit C (2014) 9352 të datës 10 dhjetor 2014.[3] Programi i miratuar 2014-2020 përbën strategjinë e bashkëpunimit të BNK për rajonin e kufitar, duke përcaktuar ndër të tjera edhe listën e zonave gjeografike të pranueshme, kontekstin e zonës, programin tematik prioritar dhe ndarjet orientuese buxhetore për periudhën 7 vjeçare.

Programi BNK 2014-2020 shërben gjithashtu si referencë për miratimin e programeve të veprimit BNK. Programi i veprimit BNK 2018-2020 synon sigurimin e asistencës për bashkëpunim ndërkufitar në fushat tematike, të parashikuar në programin 2014-2020 (siç tregohet në seksionin 2.2).

Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi Komunikatën me temë "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhim të zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor"[4]. Kjo komunikatë synon të avancojë më tej reformën në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojë një angazhim të dukshëm për zgjerimin e BE-së për të mbështetur më mirë përgatitjet e tyre në rrugën evropiane. Komunikata përcakton orientimet e reja strategjike, veçanërisht në lidhje me zbatimin e gjashtë iniciativave kryesore.

Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kyç për nxitjen e pajtimit dhe trajtimin e trashëgimisë së të kaluarës në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me iniciativën kyçe 6 (mbështetje për pajtimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë) dhe për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në përputhje me iniciativën kyçe 3 (mbështetje e zhvillimit socio-ekonomik).

Lista e zonave gjeografike të pranueshme

Në Malin e Zi zonat e lejueshme janë: Andrijevica, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin. Në Republikën e Shqipërisë zonat e lejueshme janë: Shkodra, Lezha dhe Rrethi i Tropojës

Bashkëpunimi ndërkufitar (BNK) në kontekstin e zonës përfituese

Zona e Programit është e ndryshme, por ka disa karakteristika të përbashkëta të lidhura për shembull me natyrën, pozitën gjeografike, tendencat demografike, ekonominë dhe kapitalin njerëzor që mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të BNK-së.

Gjithashtu, Programi duhet të ndërtohet mbi karakteristikat dhe veprimet e sakta, të përcaktuara në kuadër të Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) COM (2014) 357, në të cilën marrin pjesë të dyja vendet përfituese.

Analiza e situatës së bërë për përgatitjen e programit tregoi disa sfida dhe mundësi kryesore për tu trajtuar dhe mbështetur përmes bashkëpunimit ndërkufitar.

–*Karakteristika ekonomike të të dy vendeve tregojnë*

[3] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/albania/ipa/2015/2014_-_2020_ipa_cbc_montenegro_albania_action.pdf

[4] https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

tendenca të ngjashme: të dy vendet janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mesatare-të larta nga Banka Botërore. Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dy anët e kufirit.

-Konkurrenca është e ulët në të dyja anët e kufirit. Produktivitet më i lartë, investime të mëtejshme në njohuritë teknike dhe përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe dixhitale janë një parakusht për t'u bërë më konkurruese në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

-Forcimi i rrjeteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe lidhjeve të shërbimit (përfshirë dixhitalizimin dhe zgjerimin e aksesit) që ekziston në zonat kufitare, është një potencial që përdoret pak. Mbi 97% e NVM të regjistruara kanë më pak se katër persona të punësuar. Niveli i bashkëpunimit përtej kufirit është minimal.

-Të dyja anët e zonës së programit po bëhen gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj, por kushtet nga të dyja anët duhet të përmirësohen dhe veçanërisht ato të infrastrukturës, për të bërë biznes.

-Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por e nënvlerësuar. Papunësia mbetet një problem madhor për popullatën e zonës së programit, veçanërisht për grupet sensitive sociale siç janë të rinjtë, popullsia rurale, si dhe gratë.

-Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshme të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit duke u mbështetur kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve janë vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

-Infrastruktura e dobët është një sfidë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së programit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe rritjen e përgjithshme të pasurisë në zonën e programit.

-Zona e programit ka potencial të lartë turistik. Megjithatë, këto mundësi turistike shfrytëzohen kryesisht në anën malazeze, ndërsa turizmi në anën shqiptare ka zhvillim të dobët, pavarësisht potencialit të madh. Gjithashtu, trashëgimia e pasur historike-kulturore-artistike në zonën kufitare duhet të ruhet.

-Përmirësimi i cilësisë së sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një sfidë dhe prioritet për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale.

-Sektori i shëndetësisë është i dobët dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Gjithashtu, mungesa e një kuadri të duhur ligjor në anën shqiptare të kufirit për sigurim shëndetësor në zonat rurale është ende pengesë në zhvillimin e saj.

-Ekziston nevoja për inkurajimin e *rrjeteve rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC)*.

-Hulumtimi, zhvillimi dhe depërtimi i Teknologjisë Informative dhe Komunikacionit (TIK) është në disproporcion të lartë midis vendeve dhe në veçanti në nivel lokal në zonën e programit.

-Qeveritë lokale dhe rajonale janë përgjithësisht të dobëta financiarisht dhe nuk mund ta nxisin zhvillimin lokal.

Përmbledhje e përvojave të kaluara dhe atyre në vazhdim të BNK-së, duke përfshirë mësimet e nxjerra

Në zhvillimin e këtij programi janë marrë parasysh rekomandimet kryesore nga vlerësimet e përkohshme dhe auditimet e programeve të BNK-së në periudhën 2007-2013. Kështu, programet e BNK 2014-2020 janë më të fokusuara për sa i përket numrit të prioriteteve tematike të trajtuara dhe shtrirjes gjeografike, e cila do të ndihmojë për të arritur rezultate më të mira dhe ndikim më të lartë. Përveç kësaj, zbatimi i programeve të BNK-së është thjeshtuar kryesisht duke pasur një autoritet të vetëm kontraktues dhe një alokim të vetëm financiar për programin.

Mësimet kryesore të nxjerra u identifikuan edhe nga vlerësimi përfundimtar i Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) Programet BNK 2007-2013 që u realizua midis viteve 2016 dhe 2017. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet u diskutuan me palët e interesuara të BNK-së në Ballkanin Perëndimor dhe masat për ndjekje u identifikuan për një afat të shkurtër dhe të mesëm, si për programet BNK 2014-2020 në vijim, ashtu edhe për programet e ardhshme BNK 2021-2027. Rekomandimet kryesore në lidhje me të gjitha programet BNK në nivelin e Ballkanit Perëndimor përfshijnë:

-Objektivi kryesor për të promovuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duhet të reflektohet qartë në projektet e BNK-së.

-Thirrjet për propozime duhet të përqendrohen më shumë në pak çështje prioritare që kanë interes të lartë ndërkufitar.

-Logjika e ndërhyrjes së programeve dhe sistemet e raportimit dhe monitorimit duhet të përmirësohen pasi nuk janë të strukturuara për të

vendosur një bazë të qartë për matjen e rezultateve në nivelin rajonal.

-Ekziston nevoja për vazhdimin e aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve për strukturat operuese dhe sekretaritet e përbashkëta teknike / antenat.

-Ekziston nevoja për përmirësimin e sinergjive me politikat dhe donatorët e tjerë, kapitalizimin dhe shkëmbimin e përvojave me instrumentet e tjera të BNK-së (si p.sh. INTERREG (Programi i Bashkëpunimit Ndër-rajonal) dhe Instrumenti Evropian për fshinjësinë (ENI) Programet BNK.

Për sa i përket këtij programi, bashkëpunimi i ngushtë midis dy vendeve përfituese gjatë secilit hap të zbatimit të programit ka qenë thelbësor dhe do të duhet të sigurohet edhe në periudhën 2018-2020.

Duke ndjekur përvojën e fituar në periudhën prej vitit 2007 deri 2013, Komiteti i Përbashkët i Monitorimit (KPM) do të veprojë si organ vendim-marrës i programit ndërkufitar, për të mbikëqyrur efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit. Roli i KPM-së i referohet programimit të përgjithshëm dhe monitorimit të programit të BNK-së, ndërsa përzgjedhja e projekteve do të jetë nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues.

Përvoja e viteve të mëparshme ka treguar që nga njëra anë numri i aplikantëve të interesuar është në rritje të vazhdueshme, duke arritur kështu një larmi të gjerë të palëve të interesuara, si edhe njësi të vogla - dhe nga ana tjetër që pjesëmarrësit ende kërkojnë mbështetje intensive për ndërtimin e kapaciteteve, në mënyrë që aplikantët e ardhshëm të mundshëm mund të përfshijnë më mirë elemente të praktikës më të mirë dhe veçori të tjera në veprimet e tyre. Më tej, programet e mëparshme promovuan krijimin e partneriteteve ndërkufitare, bashkëpunimi afatgjatë i të cilave duhet të inkurajohet me qëllim nxitjen e zhvillimit lokal. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar kanë treguar se janë një instrument i fuqishëm për proceset e zhvillimit lokal, duke bashkuar njerëzit dhe institucionet, duke trajtuar nevoja tepër konkrete dhe lokale të zhvillimit.

Strukturat përgjegjëse në nivel kombëtar për zbatimin e këtij programi bashkëpunimi ndërkufitar nën modalitetin e menaxhimit të tërthortë t kanë fituar përvojë gjatë ekzekutimit të katër viteve të para të periudhës aktuale financiare nga viti 2014 deri në 2020. Pritet që ky proces të vazhdojë me rritjen e efikasitetit në menaxhimin e thirrjeve përkatëse për propozime dhe kontratave të granteve nën menaxhim të tërthortët. Gjithashtu, kjo mënyrë e tërthortë e e menaxhimit nën drejtimin e Malit të Zi dhe në partneritet të ngushtë me Republikën e Shqipërisë ka një stimul të fuqishëm për forcimin e bashkëpunimit dhe besimit rajonal.

2.2 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I PROJEKTEVE

Veprimi 1	**Projektet e Bashkëpunimit Ndërkufitar**	**4,930,000 EURO**

Ndihma e parashikuar për Malin e Zi dhe Republikën e Shqipërisë do të ndjekë kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në bazë të nenit 215 TFEU[5].

(1) Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme

Përshkrimi i veprimit: Projektet e Bashkëpunimit Ndërkufitar në rajonin kufitar, në fushën e punësimit, lëvizshmërisë për punë dhe përfshirjes sociale e kulturore, mjedisit, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe zbutjes, parandalimit të rrezikut dhe menaxhimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Objektivi: Zhvillimi socio-ekonomik dhe forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë në zonën ndërkufitare përmes zbatimit të projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar që synojnë:

a) promovimin e punësimit, lëvizjen e fuqisë punëtore dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përtej kufijve, midis të tjerash: integrimin e tregjeve ndërkufitare të punës, duke përfshirë edhe lëvizshmërinë ndërkufitare; iniciativa të përbashkëta të punësimit lokal; informacion dhe shërbime këshilluese dhe trajnime të përbashkëta (duke përfshirë projekte që trajtojnë mungesën e literaturës dixhitale); barazinë gjinore; mundësi të barabarta; integrimin e komuniteteve të emigrantëve dhe grupeve të cenueshme; investimin në shërbimin e punësimit publik; dhe mbështetjen e investimeve në shëndetin publik dhe shërbimet sociale;

b) mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut përmes, ndër të tjera: veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; promovimin e përdorimit të

[5] https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en

qëndrueshëm të burimeve natyrore, efiçencën e burimeve, burimet e rinovueshme të energjisë dhe ndryshim drejt një ekonomie të ulët të karbonit, të qëndrueshme dhe të sigurt; promovimin e investimeve për rreziqet specifike, duke siguruar aftësinë e përballimit të katastrofave dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive dhe gatishmërisë për emergjenca;

c) inkurajimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ndër të tjera përmes: mbështetjes për shkëmbimet sociale dhe kulturore; promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore të zonës, duke përfshirë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, krijimin e rrjeteve dhe partneriteteve ndërmjet pushtetit vendor dhe palëve të interesuara lokale për të promovuar faqet e përbashkëta turistike; ruajtjen e trashëgimisë kulturore; rritjen e shkëmbimeve kulturore, vlerave historike dhe diversitetit kulturor.

Kur është e mundur, veprimet që lidhen me objektivat e lartpërmendura, siç janë zhvilluar në Planin e Veprimit të strategjisë makro-rajonale të Adriatikut dhe Jonit, ku marrin pjesë të dyja vendet, duhet të merren parasysh.

Rezultatet e pritshme:

-Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe produkteve të turizmit.

-Bashkëpunimi në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore është rritur.

-Ndërgjegjësimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve mjedisore në liqen dhe zonat alpine ka avancuar.

-Qasja në tregun e punës është përmirësuar, veçanërisht për grupet e cenueshme.

Objektivat dhe rezultatet e pritshme do të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Programi i Veprimit BNK 2018-2020 do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe rezultatet e pritshme të përcaktuara në programin BNK 2014-2020. Për detaje të mëtejshme shihni seksionin 3.2 të programit BNK 2014-2020 (Aneksi 2 i Komisionit zbatues - Vendimi C (2014) 9352 të 10 dhjetor 2014). [6]

2) Supozimet dhe kushtet

Si kusht i nevojshëm për menaxhimin efektiv të programit, vendet pjesëmarrëse do të ngrenë një Komitet të Përbashkët Monitorues dhe do të sigurojnë zyrat dhe stafin e duhur për Sekretariatin e Përbashkët Teknik (që do të ngrihet me një vendim të veçantë financimi) dhe antenën në funksion, në rast se kjo e fundit do të ngrihet.

Nën menaxhimin e tërthortë, vendet pjesëmarrëse do të nënshkruajnë një marrëveshjeje dypalëshe për të gjithë kohëzgjatjen e programit, e cila të përcaktojë përgjegjësitë e tyre përkatëse për zbatimin e programit. Kjo marrëveshje bilaterale është lidhur midis dy vendeve pjesëmarrëse dhe do të mbetet e vlefshme për të gjithë zbatimin e programit.

Deri më tani, përfituesit janë pajtuar me supozimet dhe kushtet e mësipërme, duke përfshirë krijimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Podgoricë dhe Zyrën e Antenës në Shkodër. Këto struktura financohen plotësisht nga Masa Mbështetëse për Asistencë Teknike për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA II në kuadër të Instrumentit për Asistencëm e Para-Aderimit (IPA II) për vitin 2014 C (2014) 37629[7].

Mbështetja e mëtejshme financiare do të programohet nga Komisioni Evropian për vazhdimin e ofrimit të mbështetjes për Sekretariatin e Përbashkët Teknik dhe Zyrën e Antenës nga viti 2020 e në vazhdim.

Mosrespektimi i kërkesave të lartpërmendura mund të çojë në kthimin mbrapsht të fondeve në kuadër të këtij programi dhe /ose ri-alokimin e fondeve të ardhshme.

3). Modalitetet e zbatimit

3) (a) Menaxhimi i tërthortë me Malin e Zi

Përshkrimi i shkurtër i detyrave të besuara

Strukturat operuese të Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë kanë përgatitur bashkarisht programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020 dhe kanë rënë dakord mbi masat e nevojshme për menaxhimin dhe zbatimin e programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi për monitorimin e zbatimit.

Struktura operuese e Malit të Zi do të

[6] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/albania/ipa/2015/2014_-_2020_ipa_cbc_montenegro_albania_action.pdf

[7] http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/3/2014/EN/3-2014-9421-EN-F1-1-ANNEX-1.PDF

organizojë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit me prioritetet e përzgjedhura tematike të programit. Për sa i përket thirrjes për propozime, detyrat e besuara përfshijnë hartimin e udhëzimeve për aplikantët, nisjen e aplikimeve, përzgjedhjen e përfituesve të granteve dhe nënshkrimin e kontratave të granteve. Detyrat e besuara përfshijnë edhe aktivitete të lidhura me menaxhimin financiar dhe zbatimin e programit si monitorimi, vlerësimi, pagesat, kthimi i fondeve, verifikimi i shpenzimeve, duke siguruar auditim të brendshëm, raportimi i parregullsive dhe krijimi i masave të duhura kundër mashtrimit.

Elementët thelbësorë të veprimit

Granti – Thirrja për propozim/e: 4,930,000 EURO

a) Kriteret thelbësore të pranueshmërisë:

Lista e aktiviteteve e pranueshme është përcaktuar në nenin 3.2 të aneksit 2 të Vendimit Zbatues të Komisionit C (2014) 9352, datë 10 dhjetor 2014. Lista e mëposhtme është një përmbledhje që tregon aktivitetet/projektet kryesore të pranueshme:

inkurajimi i sipërmarrjes dhe aftësisë konkurruese në sektorin e turizmit; trajnimi i përbashkët profesional lidhur me aftësitë që synohen, lidhur me një ofertë konkurruese turistike dhe kërkesat e tregut; aktivitetet për të promovuar potencialin kulturor dhe natyror turistik të zonës së programit; aktivitete të përbashkëta për të nxitur, por edhe përtërirë vlerat kulturore dhe trashëgiminë natyrore përmes festivaleve, panaireve, konkurseve; projekte të konceptuara për të parandaluar dhe menaxhuar fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet mjedisore të shkaktuara nga njeriu, të cilat ndikojnë në zonën e programit; projekte që synojnë krijimin e mundësive të punësimit dhe aftësive për grupet e disavantazhuara të shoqërisë; partneriteti pushtet vendor–OSHC në përfshirjen sociale.

Gjithashtu, në kontekstin e zbatimit të programit, përparësi mund t'i jepet projekteve që lidhen me Strategjinë Makro-Rajonale të BE-së për Adriatikun dhe Jonin COM (2014) 357, ku marrin pjesë të dy vendet.

Përfituesit duhet të jenë persona juridikë dhe të vendosur në një vend përfitues të IPA II që marrin pjesë në programin BNK.

Përfitues potencialë mund të jenë autoritetet vendore, personat juridikë që menaxhohen nga autoritetet vendore, shoqatat e bashkive, agjencitë e zhvillimit, organizatat mbështetëse të biznesit lokal, faktorët ekonomikë si NVM-të, organizatat turistike dhe kulturore, OJQ-të, dhe organet publike dhe private në mbështetje të fuqisë punëtore, institucionet e formimit profesional dhe teknik, organet dhe organizatat për mbrojtjen e natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e emergjencës/zjarrit, shkollat, kolegjet, universitetet dhe qendrat kërkimore, duke përfshirë edhe institucionet e trajnimit profesional dhe teknik.

Institucione të tjera mund të shtohen nëse janë në përputhje me programin.

b) Kriteret kyçe të përzgjedhjes janë kapaciteti financiar dhe operacional i aplikuesit.

c) Kriteret thelbësore të dhënies së grantit janë relevanca, efektiviteti, fizibilitetit, qëndrueshmëria dhe kostoja e efektivitetit të veprimit.

d) Shkalla maksimale e bashkë-financimit të BE-së për grante në bazë të kërkesave është 85% e kostos së pranueshme të projektit.

e) Shuma indikative e thirrjes/ve: 4.930.000 EURO

f) Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të publikojnë më shumë se një thirrje për propozime. Çdo kërkesë për propozime do të ketë të njëjtat objektiva, rezultate dhe përshtatshmëri, përzgjedhje dhe dhënie kriteresh thelbësore, siç përshkruhet më sipër. Çdo kontratë granti do të financohet nga një angazhim buxhetor. Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të bashkojnë alokimet e 2018, 2019 dhe 2020 me alokimet e mëvonshme të buxhetit.

g) Datë indikative për fillimin e thirrjes/ për propozime: gjashtëmujori i dytë i vitit 2020 për alokimet e viteve 2018, 2019 dhe 2020 për tu shpallur në një thirrje për propozime.

3. BUXHETI

2018				2019				2020				Vendimi i përgjithshëm i financimit
	Kontributi i Unionit*	Bashkëfinancimi i përfituesit/ve të Granteve**	**Totali i shpenzimeve**		Kontributi i Unionit	Bashkëfinancimi i përfituesit/ve të Granteve	**Totali i shpenzimeve**		Kontributi i Unionit	Bashkëfinancimi i përfituesit / ve të Granteve	**Totali i shpenzimeve**	
Projektet BNK	1,700,000	300,000	2,000,000	Projektet BNK	1,700,000	300,000	2,000,000	Projektet BNK	1,530,000	270,000	1,800,000	4,930,000
në %	85	15	100		85	15	100		85	15	100	
TOTALI 2018	**1,700,000**	**300,000**	**2,000,000**	**TOTALI 2019**	**1,700,000**	**300,000**	**2,000,000**	**TOTALI 2020**	**1,530,000**	**270,000**	**1,800,000**	**4,930,000**

Kontributi i Unionit është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, që janë bazuar në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë-financimit të Unionit në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

*** Bashkë-financimi i prioriteteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një nivel minimal prej 15% të kostos totale të pranueshme të projektit.*

4. MARRËVESHJET E MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

Si pjesë e kuadrit të matjes së performancës së tij, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuara në Rregulloren e IPA II në bazë të treguesve të paracaktuar qartë, të matshëm dhe transparentë. Raportet e progresit të përmendura në nenin 4 të Rregullores së IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të asistencës IPA II.

Komisioni do të mbledhë të dhënat të performancës (treguesit e procesit, treguesit e rezultave dhe produkteve) nga të gjitha burimet, të cilat do të mblidhen dhe analizohen në aspektin e ndjekjes së progresit kundrejt objektivave dhe synimeve të përcaktuara për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe Dokumenteve Strategjike Indikative.

Koordinatorët Kombëtarë të IPA-s do të mbledhin informacion mbi perfomancën e projekteve dhe programit (treguesit e procesit, treguesit e rezultave dhe produkteve) dhe do të koordinojnë mbledhjen dhe paraqitjen e treguesve që vijnë nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme: a) Sistemi i monitorimit të Orientuar drejt Rezultateve (ROM); b) Vetë-monitorimi i përfituesit të IPA II; c) Vetë-monitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; d) Monitorimi i përbashkët nga DG Fqinje dhe Negociatat e Zgjerimit (DG-NEAR) dhe përfituesit e IPA II, ku përputhshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi për zbatimin e asistencës financiare do të monitorohet rregullisht nga një Komiteti i Monitorimit të IPA II, i mbështetur nga Komiteti Përbashkët i Monitorimit, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel programi.

Progresi i përgjithshëm do të jetë objekt i vlerësimit, i cili do të kryhet pas zbatimit të aktiviteteve.

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA-ANËTARËSIMIT 2014-2020
PROGRAMI IPA BNK
MAL I ZI – SHQIPËRI
MIRATUAR MË 10/12/2014

TABELA E PËRMBAJTJES

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA-ANËTARËSIMIT 1
2014-2020
Përmbledhje
Seksioni 1: Përmbledhje e Programit
1.1 Përmbledhje e Programit
1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve
Seksioni 2: Zona e Programit
2.1 Analiza e Situatës
Gjeografia
Demografia
Varfëria
Ekonomia
Sektori Privat
Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
Turizmi
Infrastruktura
Sociale
Tregu i punës
Arsimi
Shëndetësia
Kultura
Shoqëria Civile
Mjedisi dhe Natyra
2.2 Gjetjet Kryesore
Seksioni 3: Strategjia e Programit
3.1 Arsyetim - Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes
3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit
3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura
Seksioni 4: Plani Financiar
Seksioni 5: Dispozitat Zbatuese
1. HYRJE
2. ANALIZA PESTLE
2.1 Reformat politike dhe procesi i integrimit në BE
Konteksti Ekonomik i Vendit
2.2 KARAKTERISTIKAT EKONOMI-KE TË ZONËS SË PROGRAMIT
2.2.1 Sektori Privat
2.2.2 Tregu i punës

2.2.3 Bujqësia dhe Zhvillimi rural
2.2.4 Turizmi
2.3 SOCIALE
2.3.1 Demografia
Dendësia
Minoritetet
Varfëria
2.3.2 Arsimi
2.3.3 Shëndetësia
2.3.4 Kultura
2.3.5 Shoqëria Civile
2.4 INFRASTRUKTURA
2.5 MJEDISI
2.6 MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
3.7. KONKLUZIONE
4. ANALIZA SWOT

Përmbledhje

Titulli i programit	Programi BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020
Zona e programit	Mal i Zi: -Andrijevica, Beranë, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinjë, Danilovgrad, Budva, Tivar dhe Ulqin Shqipëri: -Rajoni i Shkodrës -Rajoni i Lezhës * Rrethi i Tropojës
Objektivi i përgjithshëm i programit	Të promovojë/ forcojë marrëdhënie të mira fqinjësore dhe zhvillimin social- ekonomik të rajoneve kufitare, nëpërmjet vlerësimit të potencialeve të tyre turistike, zhvillimit ekonomik ekologjikisht të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, me respektin për trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe natyrore.
Prioritetet tematike të programit	**PT1**: Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore; **PT2**: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut; **PT3:** Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit; **PT4:** Asistenca teknike.
Objektivat Specifike të Programit	-Konkurrenca e sektorit të turizmit rritet nga vlerësimi ekonomik i trashëgimisë kulturore dhe natyrore -Avancimi i mbrojtjes së burimeve mjedisore tek liqeni dhe zonat alpine -Nxitja e punësimit dhe përfshirjes sociale -Garantimi i zbatimi efektiv, efikas, transparent dhe në kohë i programit, si dhe rritja e ndërgjegjësimit
Alokimi financiar 2014-2020	11,900,000.00 EURO
Metoda e Zbatimit	Menaxhim indirekt (në bazë të besimit tek detyrat e zbatimit të buxhetit)
Autoriteti Kontraktues	**Mal i Zi**: Ministria e Financave Njësia Qendrore e Financave dhe Kontraktimit (CFCU) Jola Piletica bb, 81 000 Podgoricë Tel: + 382 (0) 20 230 630 Faks: + 382 (0) 20 230 657

Autoritetet përkatëse nga pjesëmarrësit, përfitues të IPA II [Strukturat Operative]	**Mal i Zi**: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integrimit Europian Stanka Dragojevića 2 81000 Podgoricë Tel: (+382 20) 224 439 Faks:(+382 20) - 224 449 **Shqipëri:** Ministria e Integrimit Evropian Rr. "Papa Gjon Pali II", Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 22 286 45 Faks: + 355 4 22 562 67
SPT/Antena	SPT do të jetë e vendosur në Podgoricë, Mali i Zi. Antena do të jetë e vendosur në Shkodër, Shqipëri.

**Kudo që është përmendur termi "Qarku i Tropojës" në tekst, ai i referohet ndarjes territoriale të mëparshme në Shqipëri, e cila përfshin Bashkinë Bajram Curri, Komunën Margegaj, Komunën Tropojë, Komunën Bujan, Komunën Bytyç, Komunën Fierzë, Komunën Lekbibaj, dhe Komunën Lugajë.*

Seksioni 1: Përmbledhje e Programit

Programi për bashkëpunim ndërkufitar mes Malit të Zi (MZ) dhe Shqipërisë (AL) do të zbatohet në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integrimit në Bashkimin Evropian dhe promovimin e zhvillimit social ekonomik. Dispozitat ligjore për zbatimin e tij janë të përcaktuara në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

-Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, për themelimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)

-Rregullorja (BE) Nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve te Bashkimit Evropian për financimin e veprimit të jashtëm

-Rregullorja Zbatuese e Komisionit të BE-së Nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e rregullores IPA II

1.1 Përmbledhje e Programit

Programi mbulon një territor prej 11,970 km^2 me një popullsi prej rreth 749.257 banorë. Territori në Mal të Zi që përbën 52.1% të sipërfaqes së programit, mbulon 12 komuna të shtrira në tre rajone gjeografike. Pjesa shqiptare është e përbërë nga tri njësi administrative, rajonet e Lezhës dhe Shkodrës dhe rrethi i Tropojës, duke zënë 47.9% të sipërfaqes së programit. Gjatësia e vijës kufitare është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufi ujor. Gjithsej, zona e programit ka 23 komuna dhe një total prej 1,144 vendbanimeve - qytete dhe fshatra. Zona e programit karakterizohet nga një profil i ndryshëm gjeografik dhe klimatik. Ajo paraqet kontraste të mprehta, pasi në të alternohen malet, kodrat, lumenjtë, liqenet dhe bregu i detit shumë afër me njëri-tjetrin. Zona e programit ka disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që pasqyrojnë biodiversitetin e pasur dhe dallimet mjedisore. Popullsia që jeton në zonën e programit llogaritet të përbëjë rreth 61% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, dhe 13.5% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia në zonën e programit është e balancuar, e përbërë nga popullsi e Malit të Zi rreth 50.63%, dhe popullsi shqiptare me rreth 49.37%. Përbërja e popullsisë në zonën e programit tregon se 50% e popullsisë i takon segmentit moshor 15-49 vjeç.

Gjetjet kryesore

Gjetjet kryesore të analizës, të pasqyruara në përgatitjen e dokumentit, janë përmbledhur më poshtë:

Zona e programit **përmban pabarazi rajonale** në aspektin e zhvillimeve social-ekonomike dhe struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dy anët e kufirit. Ndërkohë që rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje me shumicë dhe pakicë, rajonet malazeze shfaqin një industri më të zhvilluar,

si dhe niveli i turizmit është shumë më i zhvilluar. Të dy rajone janë nën potencialin e tyre të zhvillimit, pasi ata ende duhet të gjejnë mënyra

dhe mundësi për të përfituar nga avantazhet e tyre krahasuese.

Konkurrenca e biznesit është e ulët në të dyja anët e kufirit. Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programit është e dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Produktiviteti më i lartë dhe investimet e mëtejshme në ekspertizën dhe përdorimin e teknologjive të inovacionit, janë një parakusht për t'u bërë më konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në të dyja anët operojnë në sektorin e shërbimeve. Forcimi i mekanizmave mbështetëse të biznesit mbetet një sfidë.

Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në të dy vendet, por vazhdon të jetë e pashfrytëzuar, me **produktivitet dhe konkurrencë të ulët**. Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit. Por, pronarët e vegjël bujqësorë përballen me vështirësinë për të hyrë në tregjet e vendit dhe ato rajonale. Përmirësimi i aksesit në treg dhe forcimi i sistemit ushqimor dhe organeve përkatës të inspektimit do të jenë të rëndësishëm për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë.

Turizmi është një potencial i madh për të dy vendet, por është i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Mali i Zi është tashmë një destinacion turistik i admiruar, ndërsa Shqipëria ka ende punë për tu bërë i tillë, pasi sektori i turizmit në pjesën shqiptare të zonës së programit është zhvilluar pak, pavarësisht potencialit të madh që ekziston. Sinergji të dukshme, me mundësi që të mbështeten nga bashkëpunimi ndërkufitar (programi BNK), mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi. Ekziston një **trashëgimi e pasur historike-kulturore** në zonën kufitare, e cila duhet të ruhet. Vleftësimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës, por edhe si një pasuri për zhvillimin ekonomik të saj.

Papunësia është relativisht e lartë si në Mal të Zi ashtu edhe Shqipëri, dhe vazhdon të jetë një problem i madh ekonomik. Papunësia mbetet një problem i mprehtë veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale siç janë të rinjtë, gratë dhe popullsia rurale. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërkohë që ripërtëritja e potencialit urban tashmë të përdorur është bërë e domosdoshme për të udhëhequr rritjen ekonomike. Niveli i pabarabartë **arsimor** është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për tu larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit. Depërtimi i **kërkimit shkencor & zhvillimit** dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është në një nivel të ulët në Shqipëri, ndërsa në Mal të Zi ndjek trendin e rritjes së vazhdueshme dhe aktualisht është në nivel të mjaftueshëm. Në zonën e programit investimet janë të pamjaftueshme, si dhe mungojnë aktiviteteve mbështetëse në nivel qeveritar, rajonal ose lokal për kërkimin shkencor dhe zhvillimin. Në përgjithësi, shërbimet **shëndetësore** në zonën e programit janë duke u përmirësuar, por duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar akses universal në shërbime të tilla edhe nga familjet e varfra.

Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshëm të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit që mbështetet kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja dhe ruajtja mjedisore e tyre është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, i kontrollit të ndotjes, dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës.

Fushat kryesore të ndërhyrjeve

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi ndërkufitar është të promovojë/ forcojë marrëdhënie të mira fqinjësore dhe zhvillimin social-ekonomik të rajoneve kufitare, nëpërmjet vlerësimit të potencialeve të tyre turistike, zhvillimit ekonomik ekologjikisht të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, me respektin

për trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe natyrore.

Bazuar në analizën e situatës, analizën e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, ligjorë, dhe Mjedisor (PESTLE), dhe analizën e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT), prioritetet e mëposhtme tematike dhe objektivat specifike janë cilësuar si të rëndësishëm për tu mbështetur nëpërmjet iniciativave të bashkëpunimit ndërkufitar (BNK):

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore:

-Konkurrenca e sektorit të turizmit rritet nga vlerësimi ekonomik i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut:

- Mbrojtja e burimeve mjedisore tek liqeni dhe zonat alpine, çohet më tej

3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit:

- Punësimi dhe përfshirja sociale nxitet

Përveç tre prioriteteve tematike të përmendura më lart, programet do të përfshijnë një prioritet specifik, **Asistencë Teknike**, i cili ndër të tjera, synon sigurimin e menaxhimit dhe administrimit efektiv të programit ndërkufitar.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Programi IPA BNK 2014-2020 midis Malit të Zi dhe Shqipërisë është rezultat i një pune të përbashkët programuese, e realizuar nga përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse, duke përfshirë palët e interesuara nga institucionet qendrore, institucionet e nivelit lokal të zonës së programit, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë , sipërmarrësit, dhe organizatat lokale. Një Task Forcë e Përbashkët është krijuar për të përgatitur dhe zbatuar dokumentin e programit nën udhëheqjen e Strukturave Operative (SO). Kështu, programi menaxhohet nga Strukturat Operative - për Malin e Zi në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integrimit Evropian, dhe për Shqipërinë, në Ministrinë e Integrimit Evropian.

Procesi i programimit ka filluar në fillim të muajit Korrik të vitit 2013 dhe vazhdoi deri në fund të muajit Maj 2014. Programi është hartuar nëpërmjet një procesi konsultimi, duke përfshirë palët e interesuara lokale dhe përfituesit potencialë nga të dyja anët e kufirit. Pyetësorë janë hartuar nga CBIB+ dhe shpërndarë nga SO me mbështetjen e SPT, tek institucionet në nivel qendror dhe lokal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), për të mbështetur analizat PESTLE dhe SWOT për programin dhe për të siguruar një nga treguesit për identifikimin e prioriteteve të përbashkëta për zonën ndërkufitare. Nga 140 pyetësorë të dërguar (70 në Shqipëri dhe 70 në Mal të Zi), 91 u kthyen të plotësuar. Shkalla e përgjithshme e përgjigjeve në anketë ishte rreth 65%. Gjithashtu, janë zhvilluar edhe intervista - 34 në Shqipëri dhe 9 në Mal të Zi. Drafti i parë i Dokumentit të Programit u dorëzua tek Komisioni më datë 15 nëntor 2013.

Gjatë muajit dhjetor 2013, janë mbajtur dy takime prezantuese me përfaqësuesit e pushtetit vendor në kuadër të procesit të konsultimit publik nga pala shqiptare, në Shkodër dhe Lezhë, me 15 pjesëmarrës. Nga ana tjetër, konsultimet publike janë mbajtur në tetor 2013, në Bijelo Polje me rreth 15 pjesëmarrës të pranishëm.

Gjatë periudhës mars-prill 2014, një proces i dytë konsultimi publik me një rreth më të gjerë u organizua nga OS shqiptar në koordinim me Projektin e Ndërtimit të Institucioneve Ndërkufitare (CBIB +) për të prezantuar tek organizatat e shoqërisë civile, universitetet, aktivistët qytetarë, draft dokumentin e dytë të programit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në rajonet e pranueshme nga Shqipëria. Aktorët e shoqërisë civile dhe përfaqësues të pushtetit vendor mbështetën fuqimisht prioritetet tematike të përzgjedhura për këtë program, dhe gjithashtu dhanë detaje për sa i përket nevojave që lidhen me rajonet e tyre përkatëse, të cilat janë pasqyruar në mënyrën e duhur në dokumentin e programit.

Përveç kësaj, për të koordinuar procesin në nivel kombëtar, një takim konsultativ u organizua edhe me përfaqësues nga ministritë e linjës në Shqipëri, mbi prioritetet tematike dhe aktivitetet e propozuara në program.

Tabela në vijim përmbledh procesin e përgatitjes së këtij programi.

Tabela 1 –Takimet dhe konsultimet

Koha dhe Vendi	Aktivitetet dhe Qëllimi
20-21 Qershor 2013, Becici, Budva, në Mal të Zi	Takim programues për 2014-20 për Ballkanin Perëndimor.
9 korrik 2013, Podgoricë	Hapat e programimit dhe kërkesat për analizat SWOT dhe PESTLE me SO të Malit të Zi.
gusht – mes shtatori 2013	Shpërndarja e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave.
16 shtator 2013, Tiranë	Takimi i parë me ekipin dhe Koordinimin e CBIB+ për përgatitjen e Programit IPA BNK 2014-2020.
25 shtator 2013, Podgoricë	Trajnim i CBIB+ mbi Zhvillimin dhe Formulimin e Strategjisë (SO, DEU, SPT/A).
27 shtator 2013, Tiranë	Trajnim i CBIB+ mbi Zhvillimin dhe Formulimin e Strategjisë (SO, DEU, SPT/A).
2 tetor 2013, Podgoricë	Takim me Strukturën Operative të Malit të Zi - Koordinimi për realizimin e programit IPA BNK 2014 - 2020, marrëveshja për kalendarin e programit.
8 tetor 2013, Podgoricë	Takim me autoritetet e ndryshme të Malit të Zi (ministritë e linjës) - diskutim mbi gjendjen dhe perspektivat zhvillimore strategjike.
14 tetor 2013, Tiranë	Takim me Strukturën Operative të Shqipërisë - Koordinimi për realizimin e programit IPA BNK 2014 - 2020, marrëveshja për kalendarin e programit, diskutim mbi gjendjen dhe perspektivat zhvillimore strategjike.
17 shtator – 24 tetor 2013, Tiranë, Podgoricë	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, përgatitja e PESTLE, finalizimi i Analizës së Situatës dhe Analizës SWOT.
25 tetor 2013, Tiranë	Takimi i Task Forcës së Parë të Përbashkët, prezantimi i Analizës së Situatës dhe Analizës SWOT.
30 tetor 2013, Bijelo Polje, Mal i Zi	Takim konsultativ publik me më shumë se 15 pjesëmarrës nga zona e programit.
15 nëntor 2013	Dorëzimi i draftit të parë të Dokumentit të Programit tek DG ELARG.
21-22 nëntor 2013 , Beograd, Serbi	Forumi Rajonal Konsultativ BNK.
12 dhjetor 2013 , Tiranë, Shqipëri	Takim teknik i procesit të programimit midis SO, Komisionit, Delegacionit të BE dhe CBIB +; U bë diskutimi mbi strategjitë programore për tri programet. U dhanë disa sugjerime nga KE në lidhje me formulimin e objektivave, indikatorëve dhe zonave përfituese.
19 dhjetor 2013, Konsultimi Publik Paraprak, Lezhë, Shkodër, Shqipëri	U prezantua dokumenti i programit, si dhe procesi i programimit dhe arsyetimi për zgjedhjen e strategjisë së ndërhyrjes, me 15 përfaqësues nga qeverisja lokale. Strategjia e ndërhyrjes dhe prioritetet tematike të përzgjedhura rezultuan të jenë në përputhje me pikëpamjen e tyre ndaj nevojave të BNK.
janar 2014	Rishikimi i Dokumentit të Programit bazuar në rekomandimet e Komisionit.
7 shkurt 2014	Dorëzimi tek Komisioni i draftit të dytë të dokumentit të programit.

27 mars 2014, rajoni Lezhë, AL Takim Konsultues me Publikun e gjerë, shoqërinë civile dhe aktorët lokal, me 27 pjesëmarrës	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit u prezantuan tek 27 organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të qeverisjes vendore në qarkun e Lezhës, duke u ndjekur nga diskutime aktive me rekomandime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit. Prioritetet rezultuan të jenë në përputhje me pikëpamjen e tyre ndaj nevojave të BNK.
28 mars 2014, rajoni Shkodër, AL, Takim Konsultues me Publikun e gjerë, shoqërinë civile dhe aktorët	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit u prezantuan tek më shumë se 32 organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të qeverisjes vendore në qarkun e Shkodrës, duke u
lokal	ndjekur nga diskutime aktive me rekomandime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit. Prioritetet rezultuan të jenë në përputhje me pikëpamjen e tyre ndaj nevojave të BNK.
30 mars 2014	Komisioni komenton mbi draftin e dytë të dokumentit.
16 Prill 2014, Tiranë, AL, Takim Konsultues me Ministritë e Linjës	Procesi i programimit dhe prioritetet e programit për të 3 kufijtë, AL-KSV, MZ-AL, MK-AL u prezantuan në ministritë e linjës që mbulojnë prioritetet dhe aktivitetet në dokumente. Qëllimi ishte konsultimi me programet aktuale kombëtare në fushat përkatëse të veprimit dhe shmangia e mbivendosjeve, përfshirë sinergjitë e mundshme. Draft-dokumentet rezultuan të jenë në përputhje edhe me strategjitë kombëtare dhe u konceptuan nga pjesëmarrësit si shumë të rëndësishme për zhvillimin e rajoneve.
17 prill – 1 maj 2014	Reflektimi mbi komentet e marra nga Komisioni dhe nga takimet e konsultimeve publike.
30 maj 2014	Dorëzimi i versionin përfundimtar të dokumentit të Programit tek Komisioni.

Seksioni 2: Zona e Programit[8]

2.1 Analiza e Situatës

Zona e programit për Programin Ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë mbulon një territor prej 11,970 km^2 me një popullsi prej rreth 749.257 banorë. Territori në Mal të Zi përbën 52.1% kundrejt 47.9% në Shqipëri. Vija kufitare është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufi ujor. Ka tre pika funksionale të kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi përgjatë kësaj vije kufitare. Zona e Programi në Mal të Zi mbulon komunat: Andrijevica, Berane, Plavë, Guci[9], Petnjica[10] dhe Rozaje; Podgorica, kryeqyteti i Malit të Zi dhe Cetinjë, Danilovgrad, Budva, Tivar dhe Ulqin. Zona e Programit në Shqipëri përfshin rajonet e Shkodrës dhe të Lezhës, dhe rrethin e Tropojës[11]. Në përgjithësi, zona e programit përfshin 23 komuna dhe një total prej 1,144 vendbanimeve - qytete dhe fshatra.

[8] Ky seksion jep një përmbledhje të të dhënave kryesore nga analiza e situatës, Analiza SËOT dhe PESTLE. Versioni i plotë i analizës është shtojcë në dokumentin e programit.

[9] Gucia është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Plavës; ajo është në fazat e hershme të organizimit.

[10] Petnjica është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Berane-s; ajo është në fazat e hershme të organizimit; Edhe Gucia është një komunë e themeluar rishtazi.

[11] Rrethi i Tropojës ka 1 Bashki, atë të Bajram Currit, dhe 7 komuna - Bujan, Bytyç, Fierzë, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj dhe Tropoja



Gjeografia

Zona e programit përmban disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që pasqyrojnë biodiversitet të pasur dhe dallimet mjedisore. Territori në Mal të Zi është i karakterizuar nga një profil gjeografik dhe klimatik i ndryshëm, i mbushur me vargje malore, fusha, lugina, lumenj, laguna dhe liqene. Pjesa kontinentale ose veriore e rajonit është një zonë malore. Majat malore arrijnë deri në 2.500 m lartësi, dhe territori përshkohet nga lumenj, si lumi Lim, Morava dhe Tara, duke formuar kanione dhe lugina mbresëlënëse. Territori në **Shqipëri** paraqet kontraste të mprehta, pasi alternon male, kodra, lumenj, liqene dhe bregdet, shumë afër me njëri-tjetrin. Në këtë zonë ka lumenj të shumtë që kalojnë nëpër territor, të cilët shpesh shkaktojnë përmbytje gjatë stinëve me reshje. Zona shtrihet nga malet e larta (Alpet Shqiptare) në pjesën veriore të saj në kufi me Malin e Zi, deri në bregdet (Velipojë dhe Shëngjin), në pjesën veri-perëndimore të Shqipërisë. Maja më e lartë është Jezerca me 2,694 m lartësi, në rajonin e Shkodrës, dhe ajo më e ulëta (-6m) ndodhet në rajonin e Lezhës. Zona e Programit ka klimë mesdhetare në zonën e saj bregdetare, me verë dhe vjeshtë të nxehtë dhe të thatë, dhe klimë kontinentale në zonën veriore malore të Shkodrës dhe Tropojës, me dimër relativisht të ftohtë dhe me reshje dëbore të rënda në brendësi. Elemente të tilla gjeografike me kontrast të lartë pasurojë mjedisin, florën dhe faunën e zonës së programit. Burimet e saj natyrore janë stimuluese për zhvillimin e turizmit dhe agrobiznesit, si stimujt kryesorë ekonomikë për të rritur mundësitë për mirëqenien dhe prosperitetin e banorëve në zonën e programit.

Demografia

Popullsia që jeton në zonën e programit llogaritet të përbëjë rreth 61% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, dhe 13.2% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia në zonën e programit është e balancuar, e përbërë nga popullsi e Malit të Zi prej rreth 379,366 banorësh, duke zënë 50.63% të popullsisë totale në zonën e

programit, dhe popullsi shqiptare prej rreth 369,891 banorësh, duke zënë 49.37% të popullsisë totale në zonë. Në pjesën malazeze dendësia e popullsisë me 65.7 banorë/ km^2 është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 45 banorë/ km^2, ndërsa në Shqipëri është 59 banorë/ km^2, më e ulët në krahasim me mesataren kombëtare prej 97 banorë/ km^2. Zona e programit ka një normë natyrore rritje prej 1.87%, që është nën mesataren kombëtare prej 2.2%; Shkalla e vdekshmërisë qëndron në 9.4% e barabartë me mesataren kombëtare. Zona e programit në **Mal të Zi** ka një popullsi kryesisht urbane, duke zënë rreth 52% të popullsisë së saj, e cila është më e ulët, në krahasim me 62% që jetojnë në zonat urbane në nivel kombëtar. Rreth 49% e popullsisë në zonën e programit është e përqendruar në Podgoricë. Në **Shqipëri** numri i përgjithshëm i popullsisë që jeton në zonën e programit është 369,891[12] banorë, ose rreth 13.2% e popullsisë së përgjithshme të vendit. Rajoni i Shkodrës është rajoni i gjashtë më i madh i vendit me një popullsi prej 215,347 banorë, ose rreth 7.6% e popullsisë së përgjithshme, e ndjekur nga Lezha e cila renditet e dhjeta mes rajoneve të vendit, që numëron një total prej 134,027 banorë apo 4.7% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Rrethi i Tropojës regjistron një popullsi totale prej 20,517 banorë, e cila përbën 0.07% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia është kryesisht rurale, me një mesatare prej 53.2%. Këtë mesatare e përcakton rajoni i Shkodrës, pasi popullsia rurale është 55.6% e 119,794 banorëve të tij. Në të kundërt, rajoni i Lezhës ka një dominim të popullsisë urbane, me rreth 53.8% të popullsisë. Rrethi i Tropojës ka një popullsi kryesisht rurale, e cila përbën rreth 74% të popullsisë së tij. Përbërja e popullsisë në zonën e programimit të të dyja vendeve tregon se 50% e popullsisë i takon segmentit moshor 15-49 vjeç.

Varfëria

Vulnerabiliteti i popullsisë së **Malit të Zi** është rritur kohët e fundit, pasi numri i personave nën vijën e varfërisë ka pësuar një rritje nga 6.6% e popullsisë, deri në rreth 9.3% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, në vitin 2011. Rritja e shkallës së varfërisë është shumë më e theksuar në zonat rurale, mesatarisht 18.4%, ndryshe nga zonat urbane ku arrinte mesatarisht 4.4% në vitin 2011. Pabarazia është rritur në Mal të Zi, pasi koeficienti Gini u rrit nga 24.3% në vitin 2010, në 25.9% në vitin 2011[13]. Vulnerabiliteti i popullsisë së **Shqipërisë** u rrit në vitin 2012; numri i regjistruar i personave nën vijën e varfërisë u rrit me 8.4%. Varfëria ekstreme ka arritur në 2.2% në vitin 2012, kundrejt 1.2% të regjistruar në vitin 2008. Rajonet në zonën e programit janë më të varfër në krahasim me mesataren kombëtare të shkallës së varfërisë prej 14.3%. Qarku i Lezhës regjistron një normë varfërie 17.5%, ndërsa qarku i Shkodrës është pak më mirë, me një normë varfërie 15.7%. Rrethi i Tropojës i përket rajonit më të varfër të Shqipërisë, Kukësit, me një normë varfërie 21.8%. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërsa ripërtëritja e potencialit urban tashmë të ezauruar, është bërë e domosdoshme për të sjellë rritjen ekonomike.

Ekonomia

Zona e programit përmban të gjitha pabarazitë rajonale të hasura në **Mal të Zi**, në aspektin e zhvillimeve social-ekonomike. Ashtu si në nivel kombëtar, ajo është e dominuar nga Podgorica, e cila është motori ekonomik i vendit. Çdo bashki e zonës së programit është nën mesataren kombëtare, me bashkinë e Plavës në krye, e cila është më pak e zhvilluara në vend. Ndryshe nga Budva, e cila ka indeksin më të lartë të zhvillimit në Mal të Zi me 362.4, dy bashkitë e tjera bregdetare të zonës së programit Tivari dhe Ulqini, janë nën mesataren kombëtare.

Edhe në **Shqipëri**, pabarazitë rajonale janë shumë të dukshme. Zhvillimi social-ekonomik i vendit anon rëndë në favor të rajonit qendror. Shkodra është rajoni më i zhvilluar në zonën e programit të Shqipërisë. Kontributi i Qarkut të Shkodrës në GDP arriti në 555 milion Euro në vitin 2011[7], e barabartë me 6.1% të GDP totale të shtetit, duke u radhitur e shtata ndër 12 qarqet e Shqipërisë. Kontribuuesi kryesor në aktivitetin ekonomik të rajonit është bujqësia, e cila përbën rreth 26% të kontributit të GDP- së, e pasuar nga tregtia, hotelet, transporti dhe komunikacioni me 23%, sektori financiar dhe ai i pasurive të patundshme me 19%, industria me 11%, dhe ndërtimi me 8%. GDP e rajonit të Lezhës për vitin

[12] INSTAT Census 2011

[13] Banka Botërore, fotografim i programit të Shtetit

2011 arrin 3.7% të GDP-së së vendit[14]. Kontribuuesit kryesorë në GDP-në e rajonit të Lezhës janë tregtia, hotelet, transporti dhe komunikacioni me 26%, sektori i bujqësisë me 25%, sektorët financiarë dhe të pasurive të patundshme me 19%, ndërtimi me 10%, ndërkohë që industria është kontribuuesi më i vogël me 8%. Kontributi i rajonit të Kukësit në GDP-në e Shqipërisë, ku Tropoja përbën rreth 24% të popullsisë, është më i ulëti në vend, me vetëm 2.4%; sektorët më të rëndësishëm janë bujqësia, e cila është përgjegjëse për 34%, dhe tregtia, hotelet dhe turizmi me 20%.

Sektori Privat

Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programimit është e dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). NVM-të në Mal të Zi përbëjnë 98.6% të numrit të përgjithshëm të operatorëve ekonomikë, ndërsa në Shqipëri ato përbëjnë 95.4% të totalit. Shumica e NVM-ve në të dyja anët e kufirit operojnë në sektorin e shërbimeve. Shumica e operatorëve ekonomik të **Malit të Zi** janë të përqendruar në zonën e programit, duke përbërë 67.3% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në nivel kombëtar. Rreth 49.2% e këtyre NVM-ve janë të vendosura në Podgoricë, duke treguar kështu pabarazitë e zhvillimit rajonal.

Grafiku 1. NVM-të sipas sektorëve kryesorë ekonomikë në zonën e programit



[14] INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013

Në **Shqipëri,** zona e programit regjistron një total prej 10,174 ndërmarrjesh[15] në fund të vitit 2012, ose rreth 9.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të vendit. Ajo ka një shkallë lindje[16] prej 13%, më e lartë në krahasim me mesataren kombëtare prej 12.2%, ndikuar kryesisht nga Shkodra, e cila me 14.4% tregon një zhvillim relativisht më të lartë të aktivitetit ekonomik, në të kundërt me rajonin e Lezhës dhe rrethin e Tropojës me 10.8%. Struktura e ndërmarrjeve është e dominuar nga ndërmarrjet shumë të vogla, me 1-4 persona të punësuar, të cilat përbëjnë 85.7% të totalit të ndërmarrjeve në fushën e programit. Përveç madhësisë së vogël të ndërmarrjeve, një faktor i rëndësishëm, i cili është një pengesë për zhvillimin ekonomik në zonën e programit në të dy anët e kufirit, është mungesa e njohurive teknologjike dhe aftësive të punës. Kjo mbetet një sfidë kryesore, pasi kërkesave të tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë, nuk mund t'iu përgjigjen aftësitë joadekuate të punës. Një tjetër sfidë kryesore është aksesi i ulët i NVM-ve në financim; politikat tepër të kujdesshme të kreditimit të miratuara nga institucionet financiare në të dyja vendet, janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve në fushën e programit.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Pjesa Malazeze e zonës së programit është më e pasur në burime bujqësore dhe ka më shumë potencial në këtë sektor në krahasim me pjesën e Shqipërisë. Megjithatë, sektori i bujqësisë dhe zhvillimi i tij është po aq i rëndësishëm për të gjithë zonën e programit, veçanërisht për shkak të pjesës së madhe të popullsisë që jeton në zonën rurale, ku bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik. Një tipar i përbashkët në zonën e programit është produktiviteti dhe konkurrenca e ulët në fushën e bujqësisë. Ai vjen si pasojë e: fermave të vogla të cilat kanë prodhim dhe fitim të kufizuar; prodhimit kryesisht për të mbuluar nevojat e jetesës, sesa për shitje direkte në tregjet e gjelbra; nivelit të ulët të finalizimit të produkteve bujqësore dhe industrisë ushqimore të pazhvilluar.

Zona e programit mbulon rreth 38% të totalit të tokës bujqësore të **Malit të Zi.** Punësimi në bujqësi është raportuar të jetë rreth 2.5% e totalit të të punësuarve[17], Podgorica është rajoni kryesor fushor në Mal të Zi - vetëm ajo zë rreth 31.5% të tokës bujqësore në zonën e programit. Ajo ofron kushte optimale për prodhim të larmishëm: perime, prodhimin e drithërave, blegtori, fruta dhe verë. Vera, e cila është produkti kryesor Malazez i orientuar drejt eksportit, prodhohet në Podgoricë - rreth 80% e prodhimit të përgjithshëm të verës në vend.

Zona e programit në **Shqipëri** mbulon rreth 13.3% të totalit të tokës bujqësore të vendit[18]. Shumica e territorit të saj është e dominuar nga pyjet, kullotat (85.2%), ndërsa pjesa e tokës në shfrytëzim për qëllime bujqësore është vetëm 14.8% ose 92,748 ha. Terreni është kryesisht malor dhe i thyer, i cili kufizon në mënyrë të konsiderueshme zonat ku potenciali bujqësor mund të mbajë disa domethënie krahasuese. Zona të tilla janë të vendosura kryesisht në rrethinat e liqenit të Shkodrës, ku terreni dhe kushtet klimatike janë të favorshme për bujqësinë e perimeve. Qarku i Lezhës ka një traditë për blegtorinë e derrave, pasi ajo ka 91.7% të inventarit total të shtetit, ndërsa bujqësia në rrethin e Tropojës është e orientuar kryesisht drejt prodhimit të thekrës. Bujqësia në zonën e programit është një aktivitet familjar, i orientuar drejt nevojave për jetesë, me toka shumë të fragmentuara - madhësia e fermës është 1.1 ha në Shkodër; 0.89 ha në Lezhë, dhe 0.60 ha në Tropojë, madhësi të cilat janë sa gjysma e mesatares Shqiptare, prej 1.20 ha.

Turizmi

Rëndësia e turizmit është e ndryshme për ekonomitë e Malit të Zi dhe Shqipërisë. Mali i Zi është tashmë një destinacion i popullarizuar turistik, ndërsa Shqipëria ka ende shumë për të bërë, për tu bërë një destinacion i tillë. Në **Mal të Zi**, turizmi është një sektor kryesor i ekonomisë, i cili përbën rreth 9.9% të GDP-së së vendit në vitin 2012, ose rreth 336 milion Euro, që është 20.7% më i lartë se në vitin 2011[19]. Rajoni

[15] INSTAT, Regjistri Statistikor i Biznesit të Ndërmarrjeve 2012

[16] Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara për një vit të caktuar e shprehur në % mbi numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve

[17] Industria dhe okupacioni i popullsisë në Malin e Zi-Census i vitit 2011, publikimi 197 i MONSTAT

[18] Libri statistikor, Ministria e Bujqësisë

[19] Këshilli i Udhëtimeve nëpër Botë dhe Turizmit - Mars 2013

bregdetar në zonën e programit përbën më shumë se 69% të totalit të qëndrimeve me fjetje në vend në vitin 2012[20], kryesisht në periudhën e pushimeve Korrik-Gusht. Bregdeti i zonës së programit tërhoqi rreth 67.5% të totalit prej 1,44 milionë turistë që hynë në Malin e Zi në vitin 2012. 160 objekte akomoduese bregdetare që gjenden në zonën e programit përbëjnë rreth 49% të totalit të mjediseve akomoduese në Mal të Zi, ndërsa në zonën e programit ndodhen edhe rreth 30% e objekteve akomoduese të zonave jo-bregdetare të vendit. Pavarësisht nivelit aktual të ulët të vizitave turistike, rajoni kontinental ka përparësi të shumta për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit të lidhura me sportet malore (ski, ecje, çiklizëm, rafting etj.), duke përmendur natyrën e paprekur dhe biodiversitetin e pasur (dy parqe kombëtare, liqene, kanione, etj.), jetën autentike rurale, dhe prodhimin tradicional dhe cilësor të ushqimit.

Sektori i turizmit është më pak i rëndësishëm në pjesën shqiptare të zonës së programit (edhe pse ai ka një potencial të madh), në krahasim me anën malazeze. Specifikisht, rajonet e Shkodrës dhe Lezhës dhe rrethi i Tropojës kanë potencial të lartë individual për zhvillimin e një turizmi përgjatë gjithë vitit. Natyra atraktive dhe panoramat e natyrës malore dhe kodrinore, si dhe liqeni i Shkodrës, lugina e Valbonës në Tropojë dhe parqet e tjera kombëtare, dhe zonat e mbrojtura; vizitat turistike (peizazhet natyrore, speciet e rralla, etj.); agro-turizmi, vendet me interes historik dhe kulturor, të tilla si vendet parahistorike

të banuara, qendrat arkeologjike, objektet e kultit, duhet të promovohen më mirë për një zhvillim më të shpejtë të turizmit në bregdetin e Shkodrës (Velipojë), dhe kryesisht në Lezhë (Shëngjin).

Infrastruktura

Mali i Zi dhe Shqipëria janë pjesë e SEETO[21] – Rrjeti kryesor. Pozicioni i zonës së programit thekson rëndësinë e një infrastrukture të mirë transporti në zhvillimin e ardhshëm të turizmit, tregtisë, shkëmbimeve kulturore dhe në rritjen e konkurrencës. **Infrastruktura rrugore** që lidh Malin e Zi dhe Shqipërinë, në veçanti përmes akseve Sukobine - Muriqan dhe Bozaj -Hani i Hotit është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Edhe infrastruktura e shërbimeve nga këto pika të kalimit kufitar është përmirësuar, duke lejuar komunikimin më të shpejtë midis dy zonave, duke lehtësuar kështu transportin, tregtinë dhe turizmin. Pika e tretë kufitare në Gjercan - Plavë është më pak e zhvilluar. Një pikë e katërt e kalimit kufitar në Cijevna Zatrijebačka -Triesh, do të krijohet pas përfundimit të ndërtimit të rreth 23 km rrugë brenda territorit shqiptar, e cila është në ndërtim e sipër me financim të BERZH. Ajo do të shkurtojë ndjeshëm kohën e udhëtimit nga Plava në Podgoricë (koha e udhëtimit e pritur nëpër territorin shqiptar do të jetë rreth gjysmë ore). Mali i Zi dhe Shqipëria kanë rënë dakord për të integruar procedurat e organizimit të transportit hekurudhor midis dy vendeve. Një hekurudhë kalon përmes zonës së programit nga Podgorica në Shkodër, me një gjatësi prej rreth 63.5 km; ajo është përdorur vetëm për transportin e mallrave, pasi linja nuk është e elektrizuar. E njëjta hekurudhë lidh Tiranën me Shkodrën, nëpërmjet Lezhës. Planet e ardhshme përfshijnë elektrifikimin e saj, të paktën në anën e Malit të Zi, si dhe përdorimin e kësaj hekurudhe edhe për transportin e udhëtarëve, duke miratuar komunën urbane të Tuz-it, një nënndarje të Komunës së Podgoricës, si stacion të përbashkët kufitar.

Telekomunikacioni në zonën e programit përfiton si nga telefonia fikse, ashtu edhe nga ajo celulare. Telefonia fikse në Mal të Zi është plotësisht e dixhitalizuar. Numri i abonentëve korrespondon me një normë prej 27,55%. Tregu i telefonisë celulare ka tre operatorë telekomunikacioni. Në vitin 2012, tre kompanitë celulare raportuan një total prej 990,868 përdoruesish, që korrespondon me një normë prej 159%. Në Shqipëri, niveli i depërtimit të telefonisë fikse dhe celulare në zonën e programit qëndron në 88.15%[22], pak nën mesataren kombëtare prej 89.47%. Megjithatë, me përjashtim të qyteteve kryesore, depërtimi i

[20] MONSTAT – Mbërritjet turistike dhe qëndrimet me fjetje sipas qyteteve 2012

[21] Observatori i Transportit Jug-Lindor. Korridoret e rrugëve & Lidhjet që përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjen, Kroacinë, Kosovën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë, Malin e Zi

[22] Shqipëri, Census 2011

telefonisë fikse në zonat rurale është i ulët; komunikimi është i bazuar kryesisht në telefonat celularë. Niveli i depërtimit të telefonisë celulare në Shqipëri është mbi 130%.

Njohuritë kompjuterike në Mal të Zi[23] i përkasin mesatarisht 35% të popullsisë nga 15 vjeç e lart. Rreth 16% e popullsisë ka njohuri të pjesshme mbi kompjuterin. Në Shqipëri, niveli i përdorimit të internetit (që do të thotë se ka një kompjuter që përdoret për të hyrë në internet) në familjet në zonën e programit qëndron në 9.97%, i cili është nën mesataren kombëtare prej 12.35%.

Energjia është e disponueshme për të gjitha komunat në zonën e programit. Shumica e nevojave energjetike në të dyja anët janë plotësuar nëpërmjet importeve. Përfundimi i linjës ndërlidhëse 400 kv midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (Elbasan-Podgoricë), rrit kapacitetet e shkëmbimeve të energjisë midis dy vendeve, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend. Edhe pse ka burime të mëdha, por ende të pashfrytëzuara hidrocentrale (veçanërisht në Shqipëri), zona karakterizohet nga një efikasitet i ulët në përdorimin e energjisë elektrike. Përdorimi i energjisë për qëllime ngrohje është i përhapur në shkallë të gjerë.

Shumica e familjeve (247,354) në Mal të Zi përdorin **ujin** nga sistemi publik i ujit, edhe pse sistemi publik i ujit mund të jetë i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe gjatë kohës së verës. Nga numri i përgjithshëm i banesave[24], 92% prej tyre kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë brenda shtëpive të tyre, dhe po i njëjti numër banesash është i lidhur me sistemin e kanalizimit brenda shtëpisë. Në zonën e programit në Shqipëri, furnizimi me ujë dhe sistemet e kanalizimit dhe ujitjes mbeten problematike. Aksesi në ujë brenda banesave në zonën e programit është i siguruar për rreth 55% të tyre; rreth 40% e banesave kanë pjesërisht akses në sistemet e furnizimit me ujë, ndërsa 4.6% e familjeve në zonën e programit nuk kanë akses në sistemin e ujësjellësit.

Sociale

Tregu i punës

Si në Mal të Zi ashtu edhe në Shqipëri, papunësia është relativisht e lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Ajo është ende një problem i madh ekonomik në të dyja anët e zonës së programit, dhe karakterizohet nga dallime të mëdha rajonale. Në Mal të Zi tregu i punës ka pësuar krizë, duke regjistruar një rritje të papunësisë që arriti në 20.45% në vitin 2011[25], duke u ulur në 19.6% në vitin 2012. Zona e programit ka rreth 93.4% të forcës aktive të punës të vendit; rajoni bregdetar dhe rajoni qendror janë më mirë se rajonet më të varfra dhe më pak të zhvilluara pa dalje në det në zonën veriore. Shumica e fuqisë punëtore është e punësuar në sektorin e shërbimeve (76.2%), pasuar nga industria me 18.1%, dhe bujqësia me 5.6% të totalit të punësuar. Punëdhënësi më i madh në program është sektori i tregtisë me 20.5%, i ndjekur nga administrata publike me 12.5%. Femrat përbëjnë 44.1% të totalit të të punësuarve.

Fuqia e përgjithshme punëtore në **Shqipëri** arrin në 1,117,082 persona në fund të muajit dhjetor 2012[26]. Ajo nuk ka pasur ndryshime të mëdha, pavarësisht nga ngadalësimi ekonomik gjatë 2-3 viteve të fundit. Shkalla e përgjithshme e papunësisë[27] ka ngelur në 13.9%, njëlloj si në vitin 2011. Në ndryshim nga Tropoja, papunësia në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës pasqyron të njëjtën normë mesatare të papunësisë si në nivel kombëtar, ndërsa që të tre rajonet ruajnë të njëjtën strukturë të punësimit. Në fund të vitit 2012, numri i të papunëve në Shkodër qëndron në 19,417 persona, duke përbërë 13.6% të totalit të të papunëve, kurse Lezha me 15,021 persona të papunë përbën 10.6% të totalit. Ndërsa Tropoja regjistron 2,368 të papunë, ose rreth 36% të forcave të përgjithshme të punës që i përkasin grup-moshës 15-64 vjeç në rrethin e Tropojës. Papunësia është më e pranishme në zonat urbane, pasi ata që jetojnë në zonat rurale janë konsideruar si të vetë-punësuar.

[23] MONSTAT, Popullsia sipas njohurive kompjuterike për bashkitë në Mal të Zi 2011, Publikimi Nr. 156

[24] MONSTAT. Banesat, lidhur me pajisjen me instalime, Publikimi Nr. 280

[25] Census Mal i Zi, 2011

[26] INSTAT, Buletini Statistikor Tremujor, Nr. 2, 2013

[27] Norma e papunësisë përfaqëson përqindjen e personave të papunësuar në popullsinë e përgjithshme aktive.

Arsimi

Niveli i pabarabartë arsimor është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për tu larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit. Shkollat private dhe Formimi Profesional janë të pranishme, por nuk janë në gjendje që të përputhen me kërkesat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar dhe të aftë, duke përbërë kështu një pengesë për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Dispozitat arsimore në të gjitha nivelet kërkojnë përmirësim, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tregut të punës. Sistemi arsimor në zonën e programit në të dyja vendet kërkon reforma, veçanërisht përvoja praktike mësimore dhe lidhje me sektorin e biznesit. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore është një përparësi e madhe për të dyja qeveritë, në nivel qendror dhe lokal. Përmirësimi i sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një prioritet i madh për zonën e programit. Programi BNK do të ketë një rol të kufizuar në adresimin e këtyre çështjeve, por mund të mbështesë shkëmbimet midis shkollave dhe qendrave të formimit profesional në zonat kufitare. Prezenca e universiteteve dhe qendrave kërkimore në të dyja anët e zonës së programit është një pasuri për programin BNK dhe një mundësi jo vetëm për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit akademik, por edhe për inicimin e programeve kërkimore në zonën kufitare në sektorë të ndryshëm, të tillë si bujqësia apo turizmi.

Kërkimi shkencor & Zhvillimi është i pazhvilluar. Pavarësisht faktit se në zonën e programit janë të pranishëm 4 universitete, investimet dhe aktivitetet mbështetëse qeveritare, rajonale ose lokale për Kërkimin shkencor dhe Zhvillimin janë të pamjaftueshme. Nuk ka të dhëna specifike mbi kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin. Megjithatë nuk ka pothuajse asnjë bashkëpunim midis institucioneve të arsimit në të dy vendet, dhe fusha e kërkimit shkencor, zhvillimit dhe inovacionit nuk është eksploruar. Mali i Zi shpenzon rreth 0.41% të GDP-së në Kërkim shkencor dhe Zhvillim[28], ndërkohë që Shqipëria shpenzon rreth 0.02% të GDP-së së saj[29]. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nënshkruar një marrëveshje në lidhje me lëvizjen e studiuesve dhe ekspertëve teknik midis universiteteve partnere; ngritjen e qendrave të përbashkëta kërkimore për të studiuar burimet hidrike të lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës; dhe një qendër të përbashkët për studimet e avancuara për rreziqet sizmike në Ballkanin Perëndimor.

Shëndetësia

Organizimi i sistemit shëndetësor në Mal të Zi dhe Shqipëri është i ngjashëm; ai është kryesisht publik me një prani modeste (por në rritje) private, dhe mbulimi territorial është i pajisur siç duhet me shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Në përgjithësi, shërbimet shëndetësore në zonën e programit janë duke u përmirësuar, por duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar akses universal në shërbime të tilla edhe nga familjet e varfra. Sfida kryesore e radhës për të garantuar që të gjithë qytetarët janë të pajisur me shërbimet e duhura shëndetësore është heqja e pengesës ekonomike për të pasur akses në shërbimet cilësore, e cila është e rënduar nga mungesa totale e sigurimit shëndetësor.

Kultura

Në përgjithësi, në zonën e programit kultura karakterizohet nga elemente të ndryshme të traditave individuale dhe të përbashkëta. Qendrat turistike dhe qytetet e mëdha janë të pasura me trashëgimi kulturore që përfshijnë monumente dhe vende fetare (kisha, manastire dhe xhami), qytete të vjetra, vende arkeologjike dhe muzeume të ndryshme. Zona e programit është gjithashtu e pasur në traditën e kuzhinës dhe artizanatit, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit. Bashkëpunimi ndërkufitar mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie, si dhe në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të bashkëpunimit rajonal midis dy vendeve. Investimet dhe subvencionet e kufizuara publike kanë mbajtur një nivel të ulët të aktiviteteve

[28] S & Zh në 2011, Zyra Statistikore e Malit të Zi, publikimi Nr. 24

[29] Shqipëri, Buxheti i Shtetit 2012

kulturore në zonën e programit, pavarësisht trashëgimisë së saj të pasur. Megjithatë, aktivitetet kulturore dhe kontaktet mund të intensifikohen, duke krijuar kështu një bazë për një bashkëpunim ndërkufitar më aktiv. Kjo krijon kushte të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të nismave të përbashkëta që synojnë shtimin e vlerës në trashëgiminë e përbashkët në të dyja anët e zonave kufitare.

Shoqëria Civile

Në **Mal të Zi** janë 5,843[30] Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) të regjistruara. Pjesa më e madhe e tyre janë shoqata qytetare (5665), dhe 175 janë fondacione. OSHC-të me më shumë ndikim dhe përvojë janë të vendosura në Podgoricë, aktive në sektorë të ndryshëm (të drejtat e njeriut, politikat publike, mjedisi dhe zhvillimi rural, ngritja e kapaciteteve, aftësitë e kufizuara, etj.). Shumica e tyre kanë një përvojë në përcaktimin e projekteve BNK. Kapacitetet njerëzore dhe kapacitetet e financimit janë përgjithësisht të pamjaftueshme; partneriteti me autoritetet lokale, si dhe krijimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve janë ende të dobëta. Megjithatë, rrjeti lokal i organizatave komunitare është i shumëllojshëm dhe i pasur. Disa prej tyre, të tilla si shoqatat e malësorëve, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e nismave BNK.

Sektori i OSHC-ve në **Shqipëri** është i vogël dhe relativisht i pazhvilluar. Zyrtarisht ekzistojnë 2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra të regjistruara[31]. Shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në kryeqytet (Tiranë), ose në rajonin qendror (i cili përfshin Tiranën dhe qytetet e mëdha të tilla si Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça). Shoqëria civile është e përfaqësuar dobët në të gjitha zonat rurale. Sektori i Shoqërisë Civile në Shqipëri, si një i tërë, është pak i integruar dhe përfaqësuar. Nuk ka asnjë forum të sektorëve të gjerë ose rrjet që i dedikohet koordinimit të përpjekjeve të OShC-ve.

Mjedisi dhe Natyra

Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit janë të rëndësishme për një zhvillim të qëndrueshëm të zonës së programit, e cila është mjaft e pasur në burime mjedisore dhe biodiversitet në të dyja anët e kufirit. Megjithatë ka disa faktorë që kërcënojnë burimet mjedisore në zonën e programit, të tillë si; shpyllëzimi për shkak të rënies së pakontrolluar të pemëve; menaxhimi i varfër i ujit dhe i ujërave të zeza; largimi i pakontrolluar i mbeturinave; urbanizimi i parregulluar; ndotja industriale në disa zona; vend-groposjet e paligjshme, të cilat rrezikojnë ndotjen e lumenjve dhe liqeneve; përdorimi intensiv i pesticideve, i cili po

dëmton bujqësinë; peshkimi i tepruar dhe gjuetia e jashtëligjshme, të cilat kërcënojnë faunën në liqene dhe lumenj. Degradimi i tokës është i pranishëm në të dyja anët e kufirit. Bashkëpunimi midis dy vendeve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit të Shkodrës është rritur në dekadën e fundit.

Mali i Zi ka një diversitet të lartë biologjik, për shkak të sfondit të tij gjeologjik, klimës dhe pozicionit në afërsi të detit dhe maleve. Mali i Zi ka dy vende të Trashëgimisë Botërore, një rezervë të biosferës dhe pesë parqet kombëtare. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit është një shtyllë e të gjitha strategjive të zhvillimit të vendit. Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura të Malit të Zi mbulon 108,866 ha[32] ose 7.88% të territorit të përgjithshëm. Ajo përbëhet nga 5 parqe kombëtare - Liqeni i Shkodrës, Durmitor, Lovćen, Biogradska Gora, dhe Prokletije.

Në Shqipëri, zona e programit ofron një biodiversitet dhe klimë të pasur, pasi ajo përfshin malet, kodrat, fushat, liqenin, lumenjtë dhe bregdetin. Ajo ka 8 parqe kombëtare[33], rezerva natyrore dhe peizazhe të mbrojtura, të cilat mbulojnë mbi 13% të territorit të përgjithshëm. Parku më i rëndësishëm natyror në zonën e programit është Liqeni i Shkodrës.

Ndryshimet sociale dhe ekonomike të viteve të fundit si dhe ndryshimet demografike në Shqipëri dhe Mal të Zi, kanë ushtruar presion mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe

[30] Raporti i Vlerësimit të Nevojave në Mal të Zi nga TACSO. Nuk dihet se sa prej tyre janë active.

[31] Vlerësimet e fundit të shoqërisë civile dhe vëzhgimet intensive nga Zyra e Projektit TACSO në Shqipëri vlerësojnë se numri i përgjithshëm i OSHC-ve aktive nuk i kalon 450

[32] MONSTAT, Libri statistikor 2012

[33] Shqipëria, Ministria e Mjedisit, Rrjeti i zonave të mbrojtura në Shqipëri, Shtator 2013

biodiversitetit në zonën e programit. Dëmet e dekadës së kaluar janë të dukshme në zonën e pyjeve, për shkak të ndërhyrjeve të popullsisë lokale. Shumica e dëmit ka ardhur për shkak të prerjeve abuzive dhe mbi-kullotjes. Mbrojtja e burimeve natyrore me fokus tek pyjet, zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i burimeve ujore përfaqësojnë vlerat ekonomike dhe mjedisore për këtë zonë. Megjithëse ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit është rritur, një shkallë më e lartë e zbatimit të standardeve për mbrojtjen e mjedisit është e nevojshme për të siguruar zhvillimin e duhur urban dhe zgjerimin e turizmit. Reduktimi i ndotjes ekzistuese, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimit të një mjedisi të pastër, i lidhur me masat për të mbrojtur tokën nga shkatërrimi natyror dhe artificial si dhe zbatimi i një procesi strategjik të planifikimit urban, janë sfidat kryesore për tu përballuar në zonën e programit.

Gjetjet Kryesore

Zona e programit është e ndryshme, e megjithatë, disa tipare të përbashkëta në lidhje me natyrën, pozicionin gjeografik, tendencat demografike, ekonominë, kapitalin njerëzor etj., mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave BNK.

Karakteristikat ekonomike të të dy vendeve tregojnë tendenca të ngjashme. Të dy vendet janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesatare nga Banka Botërore. Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje shumice dhe pakice, rajonet malazeze shfaqin industri më të zhvilluar, dhe një niveli shumë më të zhvilluar të turizmit. Përgjithësisht, bujqësia është e rëndësishme për të dyja palët. Sfidat kryesore përfshijnë: adresimin e pabarazive ekonomike rajonale; nivelin e ulët të prodhimtarisë si pasojë e mungesës së njohurive teknologjike dhe aftësive të punës, si dhe për shkak të mospërputhjes së kërkesës së tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë me aftësitë joadekuate të punës.

Konkurrenca është e ulët në të dyja anët e kufirit. Produktivitet më i lartë dhe investime të mëtejshme në njohuritë mbi përdorimin e teknologjive të inovacionit është një parakusht për t'u bërë më konkurrues si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Zakonisht, bizneset në zonat kufitare shfrytëzojnë mundësitë për tregti përtej kufirit dhe në arenën ndërkombëtare, por tregtia ndërmjet dy vendeve dhe palëve të treta është ende e kufizuar nga barrierat e shumta administrative.

Forcimi i rrjeteve të NVM-ve dhe lidhjet e shërbimeve ekzistuese në zonat kufitare janë një potencial që përdoret shumë pak. Mbi 97% e NVM-ve të regjistruara punësojnë më pak se 4 persona. Niveli i bashkëpunimit përtej kufirit është minimal. Një sfidë kryesore është aksesi i varfër i NVM-ve në burimet financiare. Politikat tepër të kujdesshme në kredi-dhënie të miratuara nga institucionet financiare në të dyja vendet, janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve të vogla në zonën e programit. Promovimi i *biznesit virtual* është një sfidë. Me pak fjalë, në aspektin e zhvillimit të sektorit privat ka sinergji të qarta për t'u zhvilluar brenda zonës së programit, të cilat duhen mbështetur nga programi BNK.

Të dyja anët e zonës së programit janë duke u bërë gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj, por tek të dyja anët ka nevojë për përmirësimin e kushteve, veçanërisht të infrastrukturës, për të bërë biznes. Investimet në turizëm, në energjinë e rinovueshme dhe në bujqësi mund ti bëjnë këto të fundit sektorët potencialë për tërheqjen e më shumë IHD-ve (Investime të Huaja Direkte). Industritë e përpunimit të dritës dhe ushqimit janë konsideruar gjithashtu si një potencial për rritjen e përshpejtuar ekonomike të zonës së programit.

Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por përdoret pak. Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit, dhe pronat e vogla bujqësore kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese. Sfidat kryesore përfshijnë: përmirësimin e aksesit në treg; forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe organeve inspektues; dhe në përgjithësi rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë. Ndërhyrja

e ardhshme duhet të synojë përmirësimin e efikasitetit në bujqësi dhe pylltari, si dhe të zhvillojë burime shtesë të të ardhurave nga ruajtja e pasurive natyrore dhe turizmit.

Papunësia mbetet një problem i mprehtë për popullsinë e zonës së programit, veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale siç janë të rinjtë, popullsia rurale, dhe gratë. Pasiguria e punësimit konsiderohet si arsyeja kryesore për shkallën e lartë të migracionit, veçanërisht në zonat rurale ose më pak të zhvilluara, ku niveli i papunësisë është i lartë si rezultat i mjeteve të jetesës dhe prodhimeve bujqësore të një niveli të ulët që ofrojnë një formë të sigurimit shoqëror për pjesën më të madhe të popullsisë rurale dhe të punës, si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshëm të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit mbështetur kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Sfidat në këtë fushë përfshijnë: nevojën për të rritur zbatimin e rregullave dhe standardeve për mjedisin, për të siguruar menaxhim më të mirë të pyjeve dhe zonave të mbrojtura, në mënyrë që të parandalohet degradimi i mjedisit; parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore në zonën e programit; rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë për përdorim më të mirë të burimeve natyrore. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, kontrolli i ndotjes, dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar nga planet zhvillimore qeveritare dhe lokale. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës, veçanërisht në anën shqiptare të kufirit.

Infrastruktura e varfër është një sfidë kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së programit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në një rritje të përgjithshme të pasurisë në zonën e programit. Zhvillimi i infrastrukturës që lehtëson biznesin dhe përhapjen e rrjeteve dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin dhe inovacionin e biznesit, mund të kontribuojë në një rritje të përgjithshme të pasurisë dhe ekonomisë në zonë.

Zona e programit ka potencial të lartë turistik, por këto mundësi janë përdorur kryesisht në anën e Malit të Zi, ndërsa turizmi në anën e Shqipërisë është zhvilluar pak, pavarësisht potencialit të madh që ka. Iniciativa BNK me qëllim për të prodhuar një ofertë të përbashkët turistike, duhet të konsiderohet. Sfidat kryesore mbeten: zhvillimi i pa balancuar i turizmit, me mbizotërimin e turizmit bregdetar dhe nevojën për të zhvilluar lloje të ndryshme të turizmit (malor, kulinar dhe agro-turizëm) në të gjithë zonën e programit; infrastruktura e dobët e turizmit (veçanërisht në anën shqiptare); vizibiliteti i ulët i trashëgimisë së pasur historike dhe kulturore dhe i veçorive tradicionale; nevoja për të rritur të ardhurat në zonën e programit, duke nxitur aktivitetet për të ruajtur traditën, dhe trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Sinergji të dukshme, me mundësi që të mbështeten nga bashkëpunimi ndërkufitar (programi BNK), mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi, por edhe me "zonat më pak turistike" në veri-lindje të Malit të Zi, të cilat kanë karakteristika të ngjashme me veriun e Shqipërisë, në aspektin e mjedisit, natyrës së egër dhe maleve.

Ekziston një trashëgimi e pasur historike-kulturore-artistike në zonën në kufi, e cila duhet të ruhet. Vleftësimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Bashkëpunimi midis institucioneve kulturore është i pranishëm, por ai mund të intensifikohet akoma më tej.

Përmirësimi i cilësisë së sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një sfidë dhe prioritet për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale. Prezenca e universiteteve të rëndësishme private dhe publike si dhe e qendrave kërkimore të biznesit në zonën e programit është një pasuri për programin BNK. Veprime të mëtejshme të përbashkëta do të mund të ndërmerren për të krijuar rrjetin e qendrave të formimit profesional si dhe të

institucioneve të larta, agjencive dhe organizatave kërkimore.

Në përgjithësi, **sektori i shëndetësisë** është i dobët dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Mungesa e një kuadri të duhur ligjor për sigurimin shëndetësor në zonat rurale (në anën shqiptare të kufirit), vazhdon të pengojë zhvillimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh se sektori i shëndetësisë menaxhohet në nivel qendror, ndoshta nuk mund të bëhet shumë në kuadrin e programeve BNK, por sigurisht që ka vend për aktivitete të mundshme të përbashkëta që lidhen me fushatat parandaluese dhe edukimin shëndetësor.

Inkurajimi i rrjeteve rajonale të OShC-ve (duke përfshirë organizatat e sportit, rinisë dhe ato kulturore) mund të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e kufirit në këtë zonë të programit shumë-etnik.

Depërtimi i kërkimit shkencor & zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është në disproporcion të dukshëm midis vendeve të programit, dhe mbetet në nivel të ulët. Investimet e pamjaftueshme, mungesa e aktiviteteve mbështetëse në nivel qendror, rajonal ose lokal për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, janë të pranishme, pavarësisht faktit që në zonën e programit ka 4 Universitete. Nuk ka të dhëna specifike mbi kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin, por praktikisht mungon bashkëpunimi midis institucioneve edukuese në të dy vendet, dhe kjo fushë është e pa eksploruar.

Në përgjithësi, qeveritë lokale dhe rajonale janë të dobëta financiarisht dhe nuk mund të nxisin zhvillimin lokal. Ndryshe nga Shqipëria, Mali i Zi nuk ka qeverisje lokale. Sfidat përfshijnë: mungesën e aftësive në menaxhim, kontroll financiar dhe buxhetim, si dhe qasjet demokratike në proceset vendim-marrëse. Absorbimi i fondeve të BE-së është i ulët. Bashkëpunimi midis qeverive lokale ndërmjet dy vendeve mund të përmirësohet. Procesi i decentralizimit është duke vazhduar në të dy vendet.

Bazuar në analizën e situatës dhe në analizat PESTLE ose SWOT, ndërhyrjet e mëposhtme të mundshme konsiderohen si thelbësore për zhvillimin e rajonit kufitar:

1. Turizmi dhe trashëgimia kulturore;
2. Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi klimatik dhe parandalimi i riskut;
3 Punësimi, lëvizja gjeografike e punonjësve dhe përfshirja sociale;
4. Asistenca teknike.

Seksioni 3: Strategjia e Programit

3.1 Arsyetim - Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes

Programi BNK do të synojë të promovojë iniciativa të përbashkëta ndërkufitare dhe veprime që synojnë të përmirësojnë ekonominë e zonave kufitare në mënyrë të qëndrueshme sociale dhe mjedisore. Në kuadër të këtij programi janë zgjedhur tre prioritete tematike, të cilat përfshijnë:

PRIORITETI TEMATIK 1: Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Prioriteti i parë do të promovojë iniciativa të përbashkëta ndërkufitare dhe veprime që synojnë të mbështesin zhvillimin ekonomik me fokus turizmin (por jo ekskluzivisht), pasi ai konsiderohet të ketë një potencial të madh për të gjithë zonën e programit si një e tërë. Përveç kësaj, do të mbështeten shkëmbime kulturore dhe sociale. Ky prioritet i programit do të kontribuojë në përmirësimin dhe rritjen e standardeve të jetesës, duke ofruar mundësi për partneritete më të gjera dhe shkëmbime të interesit të përbashkët përtej kufirit, për të zhvilluar turizmin dhe për të vlerësuar trashëgiminë kulturore të zonës. Aktivitetet që do të zbatohen, pritet të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, krijimin e rrjeteve dhe partneriteteve ndërmjet pushtetit vendor dhe palëve të interesuara në nivel lokal për të promovuar vendet e përbashkëta turistike, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, inkurajimin e sipërmarrjes dhe konkurrencës në sektorin e turizmit, promovimin e ofertave të përbashkëta turistike, zhvillimin dhe promovimin e markave të reja të produkteve vendase, promovimin e imazhit të zonës për investitorët dhe vizitorët potencial, etj. Rezultatet e pritshme do të kenë një ndikim në promovimin e aktiviteteve sipërmarrëse turistike përtej kufirit dhe rritjen e shkëmbimeve të diversitetit kulturor, vlerave historike dhe kulturore, si një tipar unik i përbashkët i zonave në secilën anë të kufirit.

PRIORITETI TEMATIK 2: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut

Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit duke u mbështetur kryesisht tek burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e burimeve natyrore janë vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm. Aktivitetet në kuadër të këtij prioriteti do të mbështesin bashkëpunimin për mbrojtjen e mjedisit, si për shembull Shkodra/Liqeni i Shkodrës dhe rrethinat e saj, duke krijuar sinergji ndër-kufitare për menaxhimin e zonave të mbrojtura që ndodhen në zonën kufitare, do të mbështesin reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e integruar, menaxhimin e ekosistemeve të ndjeshme dhe përdorimin e mirë të ujërave sipërfaqësore, sistemet e integruara të monitorimit të mjedisit dhe bazat e të dhënave, veprime të përcaktuara për të inkurajuar aktivitetet ekonomike ekologjikisht-miqësore, etj., me qëllim vlerësimin e mëtejshëm të burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik.

PRIORITETI TEMATIK 3: Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit

Ky prioritet do të synojë të adresojë çështjet që lidhen me normat e larta të papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë, integrimin e ulët të tregjeve të punës ndërkufitare, dhe lëvizjen gjeografike të punonjësve. Aktivitetet në kuadër të këtij prioriteti do të synojnë të promovojnë lidhjen më të mirë të formimit profesional me kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të rriten aftësitë e fuqisë punëtore dhe mundësitë për punësim, iniciativat ekonomike të punës intensive me një shtrirje ndërkufitare, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit dhe sektorit privat për të përmirësuar përputhjen e kurrikulave të trajnimit me kërkesat e tregut të punës, zhvillimin e *mësimit virtual* të vazhdueshëm për të përmirësuar aftësitë e personave të punësuar si dhe atyre të papunë, për të rritur mundësitë e tyre në tregun e punës, mbështetjen e shfrytëzimit të teknologjive TIK për krijimin e rrjeteve dhe lëvizjet ndërkufitare të fuqisë punëtore.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të kontekstit dhe arsyetimet që çojnë në zgjedhjen e këtyre prioriteteve.

Tabela 1: Pasqyrë sintetike e justifikimit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike

Prioritetet tematike të zgjedhur	Justifikimi për përzgjedhjen
Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	▪ Turizmi është sektori ekonomik më premtues në Mal të Zi, ndërkohë që edhe në zonën e programit në Shqipëri ka një potencial të lartë për zhvillim; ▪ Nevoja për të nxitur zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (malor, kulinar, dhe agro-turizmi) në të gjithë zonën e programit, pasi ka një zhvillim të çekuilibruar të turizmit, me mbizotërimin e turizmit bregdetar; ▪ Nevoja për të rritur vizibilitetin e trashëgimisë së pasur historike dhe kulturore, si dhe të veçorive tradicionale, me qëllim rritjen e të ardhurave në zonën e programit, duke nxitur aktivitetet për të ruajtur traditën dhe trashëgiminë kulturore dhe natyrore; ▪ Nevoja për të rritur nivelin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në fushën e zhvillimit të turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.	▪ Biodiversiteti i pasur natyror dhe ekzistenca e disa zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare në zonën e programit, si dhe cënueshmëria e lartë e rajonit nga përmbytjet; ▪ Nevoja për të promovuar dhe për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe standardeve mbi mjedisin, për të siguruar menaxhim më të mirë të pyjeve dhe zonave të mbrojtura, në mënyrë që të parandalohet degradimi i mjedisit; ▪ Nevoja për të nxitur përpjekjet e përbashkëta në menaxhimin dhe kontrollin për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore në zonën e programit; ▪ Nevoja për të nxitur rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë për një përdorimin më të mirë të burimeve natyrore, për potencialin e lartë ekzistues në pyje, si dhe për promovimin e ekoturizmit.
Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale.	▪ Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë, reduktimi i popullsisë dhe largimi i personave të aftë dhe të arsimuar nga pjesa rurale e zonës së programit, integrimi shumë i ulët i tregjeve të punës ndërkufitare, dhe lëvizja e ulët ndërkufitare e punonjësve; ▪ Nevoja për të rritur aksesin në tregun e punës, veçanërisht të popullsisë rurale, duke nxitur zhvillimin e programeve të punësimit për integrimin social të grupeve të margjinalizuara, në mënyrë që të zbutet rreziku i normave të larta të migrimit; ▪ Nevoja për të nxitur lidhjen më të mirë të formimit profesional me kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të rriten aftësitë e fuqisë punëtore dhe si rrjedhojë të rriten mundësitë për punësim; ▪ Nevoja për të promovuar kthimin e multietnicitetit në zonën e programit si një avantazh për përfshirjen ekonomike, sociale dhe kulturore që rrit nivelin e integrimit të tregjeve të punës ndërkufitar, si dhe lëvizjen gjeografike të punonjësve; ▪ Nevoja për të promovuar aktivitetet e kërkimit shkencor dhe zhvillimit duke përdorur institucionet ekzistuese kërkimore dhe ato të arsimit të lartë në fushat me interes të përbashkët, të cilët rrisin përfitimet që rrjedhin nga të tilla bashkëpunime ndërkufitare.

3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit

Tabelat e mëposhtme paraqesin një përshkrim të çdo prioriteti, të mbështetur nga objektivat specifikë, rezultatet, aktivitetet dhe treguesit e suksesit:

PRIORITETI 1 – NXITJA E TURIZMIT DHE E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE				
Objektivi specifik	**Rezultatet**	**Treguesit***	**Burimet e verifikimit**	**Llojet e aktiviteteve**
<u>Objektivi Specifik 1</u> **Konkurrenca e sektorit të turizmit rritet nga vlerësimi ekonomik i**	**<u>Rezultati 1.1</u>** **Cilësia e shërbimeve dhe produkteve të turizmit është**	- 1.1.1 Kontributi i turizmit në GDP-të rajonale për çdo anë të programit, rritur me 20% *(standardi bazë 2013, Mali i Zi 9.9% të GDP, Shqipëria 6.4% të GDP)*	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritetet përkatëse kombëtare	▪ Inkurajimi i sipërmarrjes dhe konkurrencës në sektorin e turizmit ▪ Diversifikimi i ofertës turistike, përmirësimi i saj dhe promovimi i atraksioneve turistike më pak të njohura në zonën e

trashëgimisë kulturore dhe natyrore	**përmirësuar**	- 1.1.2 Të paktën 5 oferta të reja turistike të përbashkëta, të zhvilluara për zonën e programit *(standardi bazë 2013 = 2)* - 1.1.3 Ofertat turistike të krijuara nga iniciativat BNK, të miratuara dhe pranuara nga të paktën 40% e operatorëve turistikë aktivë në zonë - 1.1.4 Dy harta turistike dhe oferta të integruara turistike të prezantuara për zonat malore (më pak të favorshme) në të dyja anët e kufirit	Raportet e organizatave kombëtare dhe lokale të turizmit Raportet e monitorimit / projektit	programit ▪ Rritja e kapaciteteve dhe futja e teknikave dhe qasjeve të reja për promovimin, duke përfshirë hartat, përdorimin e TIK, multi-median, hulumtimin, etj. ▪ Iniciativa të përbashkëta lidhur me trajnimin profesional, të cilat synojnë aftësitë që lidhen me një ofertë konkurruese turistike dhe kërkesat e tregut ▪ Vepra të vogla infrastrukturore dhe sigurimi i pajisjeve për të përmirësuar standardet e ofertës turistike dhe restaurimi ose ruajtja e trashëgimisë historike
	<u>Rezultati 1.2</u> Bashkëpunim i në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore është rritur (p.sh. rreth zonës së Shkodrës / Liqenit të Shkodrës)	- 1.2.1 Nr. i turistëve (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) që vizitojnë zona të tilla si Shkodra / Liqeni i Shkodrës, i rritur me 30% - 1.2.2 2000 pjesëmarrës (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) në eventet e reja kulturore - 1.2.3 Nr. i vizitorëve (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) në vendet kulturore dhe natyrore ku janë bërë ndërhyrjet e vogla, i	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritetet përkatëse kombëtare Raportet e organizatave kombëtare dhe lokale të turizmit Raportet e monitorimit / projektit	▪ Fushata ndërgjegjësimi dhe programe dhe kurrikula edukative lidhur me turizmin dhe shfrytëzimin më të mirë të potencialeve të tij në zonë ▪ Aktivitete për të promovuar potencialin turistik kulturor dhe natyror të zonës së programit ▪ Aktivitete të përbashkëta për të nxitur, por edhe për të përtërirë vlerat kulturore dhe trashëgiminë natyrore nëpërmjet festivaleve, panaireve, konkurseve ▪ Trajnime për të rritur cilësinë e shërbimeve në vendet kulturore dhe
		rritur me 20%		natyrore ▪ Aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore,

*Bazuar në aktivitetet mbështetëse të programit deri në 2022.

*- Shumica e treguesve kanë si bazë "0". Përkatësisht, disponueshmëria e kufizuar e informacionit statistikor dhe burimeve nuk lejon përcaktimin e saktë të treguesve në nivelin bazë. E njëjta qasje vlen për të tri prioritetet tematike. Ju lutem kini parasysh se kudo ka synime, ato janë thjesht tentativë, pasi shumat e alokimeve të programit janë ende të panjohura.

PRIORITETI 2 – MBROJTJA E MJEDISIT, NXITJA E PËRSHTATJES DHE LEHTËSIMIT NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RREZIKUT				
Objektivi specifik	**Rezultatet**	**Treguesit***	**Burimet e verifikimit**	**Llojet e aktiviteteve**
<u>Objektivi Specifik 2</u> **Mbrojtja e burimeve mjedisore tek liqeni dhe zonat alpine, çohet më tej**	**<u>Rezultati 2.1</u>** Ndërgjegjësimi mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore në zonën e liqenit dhe zonat alpine, ka avancuar	- 2.1.1 Të paktën 40% e popullsisë (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) në zonën e programit ka qenë subjekt i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi mjedisin. - 2.1.2 Kontrolli i niveleve të ndotjes në zonën e Shkodrës / Liqenin e Shkodrës është bërë më i saktë dhe më i rregullt teknikisht - 2.1.3 Shkodra / Baseni i Liqenit të Shkodrës plotëson kushtet për t'u bërë pjesë e zonave të mbrojtura në Listën e Rezervës së Biosferës të UNESCO-s	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritetet përkatëse kombëtare Raportet e bashkive/ institucioneve lokale Raportet e monitorimit / projektit	▪ Aktivitete të projektuara për të trajtuar së bashku mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit në zonën e programit ▪ Mbështetje për mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të ekosistemeve të ndjeshme duke i dhënë përparësi zonave të mbrojtura dhe mbrojtjes së zonës së programit ▪ Aktivitete të projektuara për të inkurajuar aktivitetet ekonomike ekologjikisht miqësore në zonën e programit ▪ Aktivitete të projektuara për të parandaluar dhe për të menaxhuar fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet mjedisore të bëra nga njeriu, të cilat ndikojnë në zonën e programit ▪ Mbështetje për
		harmonizuar mbi edukimin mjedisor dhe / ose një program ekstra- kurrikular, i futur në arsimin e mesëm në të dyja anët e kufirit		ndërgjegjësimin e popullsisë lidhur me rëndësinë, mbrojtjen dhe promovimin e burimeve mjedisore të zonës së programit

* Bazuar në aktivitetet mbështetëse të programit deri në 2022.

PRIORITETI 3 – NXITJA E PUNËSIMIT, LËVIZJES GJEOGRAFIKE TË PUNONJËSVE, DHE PËRFSHIRJES SOCIALE				
Objektivi specifik	**Rezultatet**	**Treguesit***	**Burimet e verifikimit**	**Llojet e aktiviteteve**
Objektivi Specifik 3 **Punësimi dhe përfshirja sociale nxitet**	**Rezultati 3.1** Aksesi në tregun e punës i përmirësuar, veçanërisht për grupet vulnerabël	- 3.1.1. Të paktën 5 iniciativa të reja të biznesit që nxisin lëvizjen e fuqisë punëtore përtej kufirit - 3.1.2. Të paktën 20% e të papunëve (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) pjesëmarrës në iniciativat BNK, ia dalin për të gjetur një punë - 3.1.3. Të paktën 300 të rinj (të ndarë sipas gjinisë) të trajnuar nëpërmjet shërbimeve të reja të të mësuarit gjatë gjithë jetës - 3.1.4. Të paktën 10% e NVM-ve të reja të krijuara në zonat ndërkufitare	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritete t përkatëse kombëtare Regjistrat e agjencive të punësimit Regjistrat e Dhomave të tregtisë Raportet e monitorimit / projektit	▪ Mbështetja e bashkëpunimit midis dhe ndërmjet institucioneve të arsimit (profesional) dhe sektorit privat për të përmirësuar përputhjen e kurrikulave të trajnimit për grupet në nevojë, me kërkesën e tregut të punës, duke përfshirë programet e mësimit virtual dhe përdorimin e TIK ▪ Iniciativa mbështetëse dhe fushata për vetë-punësim, veçanërisht në zonat rurale, duke përfshirë mbështetjen e grupeve vulnerabël për të nisur një biznes ▪ Mbështetja e forcimit të kapaciteteve të institucioneve të promovimit të punës, shkëmbimi i eksperiencave dhe modeleve më të mira për të rritur punësimin (veçanërisht të grupet vulnerabël) brenda dhe përtej kufijve ▪ Aktivitete që synojnë krijimin
		janë në pronësi të të rinjve dhe anëtarëve të grupeve të margjinalizuara (të ndarë sipas gjinisë dhe grupit vulnerabël)		e mundësive dhe aftësive për punë për grupet në nevojë të shoqërisë ▪ Punë kërkimore për të nxitur punësimin, lëvizjen e fuqisë punëtore dhe përfshirjen sociale ▪ Inkurajimi i partneritet pushtet lokal - OSHC mbi përfshirjen sociale (plane veprimi në nivel lokal për grupet në nevojë, rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për të menaxhuar programet sociale dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e aksioneve të ndërmarra) ▪ Organizimi i programeve të shkëmbimit të të rinjve, për shembull, nëpërmjet programeve të shkëmbimit shkollor ose iniciativave të tjera të OJQ-ve

*Bazuar në aktivitetet mbështetëse të programit deri në 2022.

Në rastet kur është e mundur, zbatimi i prioriteteve tematike dhe objektivave specifike të programit duhet të bëhet në përputhje me objektivat e vendosura nga Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jonian "COM (2014) 357".

PRIORITETI 4 – ASISTENCA TEKNIKE

Objektivi specifik:

Objektivi specifik i asistencës teknike është të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dy vendet përfitues të IPA II. Për më tepër, siç ka treguar përvoja në ciklin e programit 2007-2013, ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.

Alokimi për asistencën teknike do të përdoret për të mbështetur punën e Strukturave Kombëtare Operative (SO) dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (KPM), në sigurimin e fillimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit efikas të programeve, si dhe për një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Sekretariati të Përbashkët Teknik (SPT) me bazë në territorin e Malit të Zi dhe një Zyrë Antena në Shqipëri. SPT do të jetë në krye të menaxhimit të përditshëm të programit dhe do ti raportojë mbi ecurinë e tij SO-ve dhe KPM-së.

Rezultatet e synuar:

1. Mbështetja administrative për Strukturat Operative (SO) dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM) të programit është rritur

Ky prioritet do të sigurojë një zbatim normal të programit gjatë të gjitha fazave të tij. Ai përfshin disponueshmërinë e mjeteve financiare dhe vendosjen e personelit të kualifikuar përgjegjës për të ndihmuar Strukturat Operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, si dhe krijimin dhe zbatimin e mekanizmave dhe procedurave të menaxhimit, monitorimit dhe kontrollit. Nëse kërkohet, ai gjithashtu do të kontribuojë në përgatitjen e ciklit pasardhës financiar (2021-2027).

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	***Njësia***	***Baza***	***Synimi deri në 2022***
Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar[34]**	Përqindje	Nuk ka të dhëna	80%

2. Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur

Ky prioritet do të ofrojë mundësi për përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të strukturave menaxhuese të programeve, si dhe të aplikantëve të mundshëm dhe përfituesve të granteve. Aktivitete specifike për ngritjen e kapaciteteve do të planifikohen dhe zbatohen në bazë të nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të programit. Si pjesë e mësimeve të nxjerra nga cikli i programit 2007-2013,

(i) do të pritet një pjesëmarrje në rritje e anëtarëve të KPM në detyrat e përcaktuara nën kuadrin ligjor të IPA II; (ii) kapaciteti i aplikantëve të mundshëm për zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare do të rritet; dhe (iii) kapaciteti i përfituesve të granteve për të përmbushur detyrimet e kontratave të tyre në **mënyrë të kënaqshme, të do të përforcohet.**

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022
Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme*	Përqindje	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna*
Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm	Përqindje	0	10%

[*]Ju lutemi të vini re se në perspektivën financiare 2014-2020, thirrjet e mundshme të përshtatura/ strategjike për propozime janë parashikuar me fokus të qartë dhe / ose kërkesa të caktuara në lidhje me përfituesit e mundshëm. Gjithashtu, Thirrjet për Projekt Propozime mund të përdorin parimin e rotacionit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike (PT) dhe objektivave të tyre specifike, dhe në këtë aspekt numri i propozimeve jo domosdoshmërisht mund të rritet. Për këto arsye, rritja e pritshme e numrit të aplikimeve të marra mund të llogaritet për çdo thirrje të njëpasnjëshme në mënyrë individuale, dhe do të ndikohet nga një faktor që mund të llogaritet në bazë të: 1) Buxheti i përgjithshëm në dispozicion, 2) Prioritetet tematike, objektivat specifike dhe rezultatet e përfshira në Thirrjen për Projekt Propozime, 3) Shumat minimale dhe maksimale të lejuara të granteve, 4) Numri i aplikimeve dhe granteve të lejuara

[34] Kërkon një studim të rregullt dhe të thjeshtë duke përdorur një pyetësor standard me pyetje të mbyllura

për aplikues / bashkë-aplikues / entet e lidhur dhe 5) Çdo dispozitë tjetër e veçantë që ndikon në kritere të ndryshme të pranueshmërisë, të zbatueshme për një thirrje specifike për projekt propozime.

4.1.3 Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet**.**

Programet BNK kanë qenë shumë të famshëm në zonat përfituese, përveç të tjerave, falë veprimeve të vizibilitetit të ndërmarra gjatë ciklit të programit 2007-2013. Duke parë numrin e aplikuesve në thirrjet pasuese, është vënë re se ka një interes në rritje për iniciativat e bashkëpunimit. Këto arritje duhet të ruhen dhe të përmirësohen edhe gjatë zbatimit të perspektivës financiare 2014-2020. Një shumëllojshmëri e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve të publicitetit duhet të zhvillohet për të siguruar informacion të rregullt midis palëve të interesuara të programit dhe një audience më të gjerë, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në evente që lidhen me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022
Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në eventet promocionale	Përqindje	1,682	20%
Vizita në faqen e internetit të programit	Numër	3,244	50,000

Lloji i aktiviteteve:

Një listë jo shteruese e aktiviteteve të mundshme të mbuluara nga alokimi i asistencës teknike do të përfshijë:

-Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij.

-Organizimi i eventeve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial.

-Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE- së.

-Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm.

-Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve, etj.).

-Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit.

-Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës.

-Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve.

-Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promocionale dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit, etj.

-Mbështetje për punën e Task Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026.

-Pjesëmarrja në forume vjetore dhe aktivitete të tjera që lidhen me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë (listë jo shteruese):

-Strukturat e menaxhimit të programit, duke përfshirë autoritetet kontraktuese

-Aplikuesit e mundshëm

-Përfituesit e granteve

-Përfituesit përfundimtarë të projektit

-Publiku i gjerë

3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura

Çështjet e ndërthurura përcaktohen në një sërë konventash, deklaratash dhe traktatesh ndërkombëtare mbi zhvillimin, dhe janë të detyrueshme për vendet e BE-së dhe shumicën e vendeve përfituese. Ato duhet të merren në konsideratë në të gjitha fazat e ciklit të financimit.

Prandaj, në përputhje me objektivat dhe politikat e BE-së, programi do të përfshijë parimet horizontale të partneritetit ndërkufitar, pronësinë lokale dhe mundësitë e barabarta, dhe do të sigurojë që çështjet e ndërthurura, siç janë: mos-diskriminimi i minoriteteve dhe grupeve vulnerabël, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile,

mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore, dhe qeverisja e mirë, respektohen dhe nxiten në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Të gjitha çështjet e mësipërme synohen nëpërmjet 3 prioriteteve kryesore të programit.

Kuadri aktual i Politikës së Kohezionit të BE-së e bën zhvillimin mjedisor dhe të qëndrueshëm një nga temat horizontale që duhet të integrohet në të gjitha prioritetet, masat dhe projektet. Programi synon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e mjedisit si një nga çështjet kryesore me interes për zonat ndërkufitare të synuara nëpërmjet prioritetit 2: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut. Projektet që rrjedhin në kuadër të këtij prioriteti duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë që mjedisi nuk dëmtohet, por shndërrohet në një mundësi për zhvillimin rajonal.

BE-ja ka pranuar në mënyrë të përsëritur se barazia gjinore është çelësi për arritjen e objektivave të zhvillimit. Për më tepër barazia gjinore është një prioritet për BE-në. Programi synon në mënyrë të drejtpërdrejtë promovimin e punësimit dhe mundësive në bazë të perspektivës gjinore nëpërmjet prioritet 3 "promovimi i punësimit, lëvizja e fuqisë punëtore dhe përfshirja sociale", por perspektiva dhe barazia gjinore duhet të trajtohen edhe nëpërmjet 2 prioriteteve të tjera të programit, në aspektin e pjesëmarrjes dhe kontributit të balancuar.

Projektet e përgatitur në bazë të qasjes së Zhvillimit të Bazuar në Zonë (ZhBZ) për të lehtësuar rritjen e qëndrueshme në zonat gjeografike të përcaktuara në rajonet ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor, në zona të veçanta rurale që karakterizohen nga probleme të veçanta zhvillimore komplekse, mund të konsiderohen për financim sipas këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar. Puna përgatitore për qasjen ZhBZ tashmë e kryer në rajonin ndërkufitar që mbulon Malin e Zi dhe Shqipërinë, do të merret në konsideratë.

Financimi i dyfishtë duhet të shmanget dhe duhet të sigurohet plotësimi i aktiviteteve me programet e tjera.

Seksioni 4: Plani Financiar

Tabela 1 tregon sasinë indikative vjetore të kontributit të Bashkimit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar për periudhën 2014-2020. Tabela 2 ofron një shpërndarje indikative për alokimet për secilin prioritet tematik si dhe një indikacion mbi shumën maksimale të bashkë-financimit të Bashkimit Evropian.

Tabela 1 Alokimet indikative financiare në vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020

Viti	PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II_MAL I ZI - SHQIPËRI							Totali (EURO)
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Operacionet BNK (*të gjitha prioritetet tematike*)	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 530 000	10 710 000
Asistenca Teknike	510 000	0	0	510 000	0	0	170 000	1 190 000
Totali (EURO)	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	11 900 000

Tabela 2: Alokimet indikative financiare për prioritet gjatë periudhës 2014-2020 dhe shkalla e kontributit të BE-së

PRIORITETET	PROGRAMI IPA BNK MAL I ZI - SHQIPËRI 2014-2020			
	Kontributi i BE	Bashkë-financimi i përfituesve	Financimi total	Shkalla e kontributit të BE
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore	4 165 000.00	735	4 900 000.00	85%
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	3 570 000.00	630 000.00	4 200 000.00	85%
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit	2 975 000.00	525 000.00	2 800 000.00	85%
4. Asistenca Teknike	1 190 000.00	0	1 190 000.00	100 %
GRANTI TOTAL (EURO)	**11 900 000.00**	**1 890 000.00**	**13 790 000.00**	

Kontributi i BE-së është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë- financimit të BE në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

Bashkë-financimi i prioriteteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

Shuma e dedikuar për asistencën teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të caktuar për programin. Shkalla e bashkë-financimit të BE-së do të jetë 100%.

Fondet për prioritetet tematike do të jepen nëpërmjet Vendimeve të Komisionit Zbatues, duke mbuluar alokime një deri në tre vjeçare, sipas nevojës. Fondet për asistencën teknike do të jepen nëpërmjet një Vendimi të veçantë të Komisionit Zbatues.

Seksioni 5: Dispozitat Zbatuese

Thirrje për projekt-propozime:

Si rregull i përgjithshëm, ky program do të zbatohet nëpërmjet nisjes së thirrjeve për propozime (ThpP), të cilat mbulojnë një ose më shumë prioritete tematike apo objektiva specifike të programit BNK. Komiteti i Përbashkët i Monitorimit do të jetë përgjegjës për identifikimin e prioriteteve tematike, objektivave specifike, përfituesve të synuar dhe të fokusit të veçantë të secilës thirrje për propozime, e cila duhet të miratohen nga Komisioni Evropian.

Autoritetet përgjegjëse në vendet pjesëmarrëse janë duke planifikuar zbatimin e pjesës më të madhe të ndërhyrjeve nëpërmjet skemave të granteve të bazuara në thirrjet publike për propozime. Ato do të sigurojnë transparencë të plotë në procesin dhe aksesin në një gamë të gjerë të subjekteve publike dhe jo-publike.

Dinamikat e publikimit të thirrjeve për propozime varen nga një numër faktorësh, duke përfshirë faktorët logjistikë, kohën e vlerësimit dhe nivelin e interesit nga aplikuesit e mundshëm. Pra, nuk mund të përcaktohet në këtë fazë se sa thirrje për propozime do të publikohen gjatë periudhës së programit. Gjithsesi, autoritetet përgjegjëse janë të angazhuara ti publikojnë thirrjet për propozime në mënyrë të tillë që të shmangin mbivendosjen e prioriteteve tematike midis programeve të ndryshme BNK. Thirrjet për propozime do të realizohen duke përdorur parimin e rotacionit për zgjedhjen e prioriteteve tematike dhe objektivat e tyre specifike.

Projektet strategjike:

Gjatë përgatitjes së programit, nuk është identifikuar asnjë projekt strategjik që do të financohet jashtë një thirrje për propozime. Megjithatë, gjatë periudhës së zbatimit të programit, autoritetet përgjegjëse mund të konsiderojnë të ndajnë një pjesë të alokimit financiar të programit për një ose më shumë projekte strategjike. Identifikimi i projekteve të tilla do të varet nga fakti nëse të dy vendet kanë treguar interes specifik për adresimin e prioriteteve strategjike specifike.

Projektet strategjike mund të zgjidhen nëpërmjet thirrjeve për projekte strategjike ose thirrjeve të jashtme për propozime. Në rastin e dytë, partnerët e programit do të identifikojnë së bashku dhe të bien dakord për çdo projekt strategjik që do të miratohet nga KPM në momentin e duhur përgjatë zbatimit të programit. Në këtë rast, pas propozimit dhe aprovimit nga KPM dhe miratimit nga Komisioni, programi BNK duhet të ndryshohet për të përfshirë një projekt të tillë strategjik.

Projektet strategjike janë përcaktuar si ndërhyrje që kanë një ndikim të rëndësishëm ndërkufitar në të gjithë zonën e programit, i cili në mënyrë të pavarur ose në kombinim me projekte të tjera strategjike, kontribuon në një masë të madhe në arritjen e objektivave madhore në nivel prioritar. Disa kritere të përgjithshme për përzgjedhjen e projekteve strategjike do të jenë: ndikimi në të dyja anët e zonës së programit; lidhja me strategjitë rajonale për zhvillimin e zonave kufitare; niveli i kontributit dhe bashkë- financimit nga autoritetet rajonale; numri i popullsisë që përfiton nga ndërhyrja; efektiviteti i kostove të ndërhyrjes; plotësimi i veprimeve paralele, dhe qëndrueshmëria. Për më tepër, këto projekte duhet të kenë një dokumentacion të plotë të tenderit, dhe në rast të investimeve në infrastrukturë, përveç vlerësimeve të nevojshme të ndikimit në mjedis, duhet të kenë edhe të gjitha lejet e nevojshme për vendin dhe ndërtimin.

Strategjitë makro-rajonale:

Duke qenë se të dy vendet po marrin pjesë në Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe

Jonit "COM (2014) 357", përkufizimi dhe zhvillimi i projekteve strategjike mund të bëhet në kuadër të fushave prioritare apo temave të identifikuara si në planin e komunikimit, ashtu edhe në planin e veprimit të këtyre strategjive. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjen për propozime që mund të dalë në lidhje me fushat prioritare ose temat e strategjisë makro-rajonale ku bën pjesë programi.

ANEKS 1 – Analizat e Situatës
Analiza e Situatës
Programi IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri
2014 – 2020
Draft i versionit përfundimtar 20 maj 2014

Përmbajtja

1. HYRJE
2. ANALIZA PESTLE
2.1 Reformat politike dhe procesi i integrimit në BE
Konteksti Ekonomik i Vendit
2.2 KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË ZONËS SË PROGRAMIT
2.2.1 Sektori Privat
2.2.2 Tregu i punës
2.2.3 Bujqësia dhe Zhvillimi rural
2.2.4 Turizmi
2.3 SOCIALE
2.3.1 Demografia
Dendësia
Minoritetet
Varfëria
2.3.2 Arsimi
2.3.3 Shëndetësia
2.3.4 Kultura
2.3.5 Shoqëria Civile
2.4 INFRASTRUKTURA
2.5 MJEDISI
2.6 MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
2.7 KONKLUZIONE
3. ANALIZA SWOT

1. HYRJE

Zona e programit për Programin Ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë mbulon një territor prej 11,970 km^2 me një popullsi prej rreth 749.257 banorë. Territori i zonës së programit është disi më i madh në Shqipëri, duke zënë rreth 52.1% kundrejt 47.9 % në Mal të Zi. Gjatësia e vijës kufitare ndërmjet dy vendeve është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufi ujor i përbërë nga liqeni i Shkodrës, deti Adriatik dhe lumenj. Ka tre pika funksionale të kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi përgjatë kësaj vije kufitare, të quajtura Murriqan -Sukobinë, Hani i Hotit -Božaj, dhe Vermosh -Gjercan.

Zona e programit në **Mal të Zi** mbulon një territor prej 5,745 km^2. Ajo përbëhet nga 12 bashki dhe 615 vendbanime - qytete dhe fshatra - me një popullsi të përgjithshme prej 379,366 banorë. Ajo kufizohet me Shqipërinë në lindje, dhe Kosovën dhe Serbinë në veri-lindje. Mali i Zi ka vendosur ndarjen në rajone që i korrespondojnë klasifikimit NUTS, i cili është miratuar nga EUROSTAT, dhe sipas ndarjes së lartpërmendur, Mali i Zi është një rajon në të tre nivelet e NUTS. Për qëllime të planifikimit strategjik, vendi është i ndarë në tri rajone gjeografike, veriore, qendrore dhe jugore. Bashkitë nga zona e programimit:

Andrijevica, Berane, Plavë, Guci[35], Petnjica[36] dhe Rožaje;

-Podgorica, kryeqyteti i Malit të Zi, Cetinje dhe Danilovgrad, dhe**;**

-Budva, Ulqin dhe Tivar**.**

Zona e programit në **Shqipëri** përfshin rajonet e Lezhës dhe Shkodrës dhe rrethin e Tropojës, me një territor të përgjithshëm prej 6,225 km^2 dhe një popullsi prej 369,891 banorë. Rajoni i Shkodrës ka popullsinë më të madh të përbërë prej 215,347 banorëve, të ndjekur nga Lezha me 134,027 banorë dhe rrethi i Tropojës me vetëm 20.517 banorë. Shqipëria ka një ndarje administrative ekuivalente me NUTS II [37], por akoma nuk është zbatuar.

Tabela 1 – Zona e mbuluar nga zona e programit

Shteti	Zona në km^2	% e territorit të përgjithshëm
Mali i Zi	**13,812**	**100**
Rozaje	432	3.12
Berane*	544	3.94
Petnjica	173	1.25
Andrijevica	283	2.04
Plava	329	2.38
Gucia**	157	1.13
Danilovgrad	501	3.62
Podgorica	1,441	10.43
Tivar	598	4.32
Ulqin	255	1.84
Cetinja	910	6.58
Budva	122	0.88
Gjithsej Mali i Zi	**5,745**	**41.59**
Shqipëria	**28,748**	**100**
Shkodra	3,562	12.39
Lezha	1,620	5.63
Tropoja	1,043	3.62
Gjithsej Shqipëria	**6,225**	**21.6**
Zona e përgjithshme e programit	**11,970**	**MNE: 47.9 % AL: 52.1 %**

***Të dhëna nga http://www.trpezi.eu/BIHOR%20I%20STUDIJA.html

**Të dhëna nga http://www.plav.me/uploads/dokumenta/odluke/GUSINJE%20-%20studija.pdf

[35] Gucia është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Plavës; ajo është në fazat e hershme të organizimit

[36]Petnjica është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Berane-s; ajo është në fazat e hershme të organizimit; Edhe Gucia është një komunë e themeluar rishtazi.

[37] [31]Shqipëria ka 12 rajone të cilat përfshijnë 36 rrethe, 64 bashki dhe 309 komuna, të cilat përmbajnë një numër të përgjithshëm prej 74 qytetesh dhe 2980 fshatrash. Rajonet e kësaj zone të programit janë të ndarë në 7 rrethe të përbërë nga 11 bashki, 54 komuna, të cilat përmbajnë 16 qytete dhe 484 fshatra

Në përgjithësi, zona e programit ka 23 komuna dhe një total prej 1.114 vendbanimeve - qytete dhe fshatra. Shtatë komuna ndodhen direkt në kufi: Plavë, Andrijevica, Podgoricë, Gucia dhe Ulqini në Mal të Zi, dhe Shkodër dhe Koplik në Shqipëri. Vija kufitare kalon nëpër vargjet malore të lartë të Prokletije / Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare) dhe liqenin e Shkodrës, për të përfunduar në detin Adriatik. Pikat e kalimit kufitar, veçanërisht ato të Sukobinë -Muriqan dhe Bozaj -Hani i Hotit, janë lehtësisht të arritshme gjatë gjithë vitit, ndërsa në pikën e kalimit kufitar Vermosh-Gercan janë duke u bërë përmirësime në infrastrukturën rrugore të saj, pasi ndodhet në lartësi të madhe, duke e bërë të vështirë kalimin e saj gjatë dimrit.

Zona e programit në **Mal të Zi** karakterizohet nga një profil gjeografik dhe klimatik i ndryshëm, i mbushur me vargje malore, fusha, lugina, lumenj, laguna dhe liqene. Zona e programit përmban disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që pasqyrojnë biodiversitet të pasur dhe dallimet mjedisore. Pjesa kontinentale ose veriore e rajonit është një zonë malore. Majat malore arrijnë deri në 2.500 m lartësi, dhe territori përshkohet nga lumenj, si lumi Lim, Morava dhe Tara, duke formuar kanione dhe lugina mbresëlënëse. Në lindje rajoni është i dominuar nga malet Prokletije dhe Hajla, ngjitur me Shqipërinë. Prokletije është shënuar si një Park Kombëtar që nga viti 2009. Komunat bregdetare të Tivarit dhe Ulqinit ndjekin traditën e kultivimit të agrumeve dhe ullinjve, si dhe atë të prodhimit të vajit të ullirit.

Zona e programit në **Shqipëri** paraqet kontraste të mprehta, pasi alternon male, kodra, lumenj, liqene dhe bregdet, shumë afër me njëri-tjetrin. Në këtë zonë ka

lumenj të shumtë që kalojnë nëpër territor, të cilët shpesh shkaktojnë përmbytje gjatë stinëve me reshje. Zona shtrihet nga malet e larta (Alpet Shqiptare) në pjesën veriore të saj në kufi me Malin e Zi, deri në bregdet (Velipojë dhe Shëngjin), në pjesën veri-perëndimore të Shqipërisë. Maja më e lartë është Jezerca me 2,694 m lartësi, në rajonin e Shkodrës, dhe ajo më e ulëta (-6m) ndodhet në rajonin e Lezhës. Në territorin e rajonit të Shkodrës mbizotërojnë malet, duke zënë 80% të sipërfaqes; dhe pyjet përbëjnë rreth 30% të saj.

Rajoni i Shkodrës është gjithashtu i pasur me burime ujore. Drini, Buna, Shala, Cemi, Kiri janë lumenjtë kryesorë që rrjedhin në këtë zonë, me Drinin, i cili është lumi më i rëndësishëm i Shqipërisë - hidrocentralet e ndërtuar në të prodhojnë mbi 60% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Shqipëri. Lezha ka pjesën e saj të maleve të larta dhe kodrave, të cilat mbulojnë rreth 65% të territorit të saj, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga fushat. Lumenjtë Mat dhe Ishëm, të cilët derdhen në detin Adriatik, së bashku me disa fusha lagunore, e bëjnë rajonin e Lezhës të pasur me burime ujore. Lezha ka një vijë bregdetare 38 km të gjatë, e cila fillon tek Kepi i Rodonit në jug dhe kufizohet me Velipojën-Shkodër në veri. Rrethi i Tropojës dominohet nga malet, me pyje që zënë 62% të territorit të tij të përgjithshëm; duke qenë se përmban liqenin e Fierzës dhe përshkohet nga lumenjtë Drini dhe Valbona, kjo zonë është e pasur me burime ujore.

Zona e Programit ka klimë mesdhetare në zonën e saj bregdetare, me verë dhe vjeshtë të nxehtë dhe të thatë, dhe klimë kontinentale në zonën veriore malore, me dimër relativisht të ftohtë dhe me reshje dëbore të rënda në brendësi. Elemente të tilla gjeografike me kontrast të lartë pasurojë mjedisin, florën dhe faunën e zonës së programit. Burimet e saj natyrore janë stimuluese për zhvillimin e turizmit dhe agrobiznesit, si stimujt kryesorë ekonomikë për të rritur mundësitë për mirëqenien dhe prosperitetin e banorëve në zonën e programit.

Liqeni i Shkodrës

Tipari më dallues gjeografik dhe mjedisor i zonës së programit është Liqeni i Shkodrës. Ai është liqeni më i madh në Ballkan, me një sipërfaqe prej 384 km², të shtrirë në Mal të Zi (2/3) dhe Shqipëri (1/3); të dy vendet e kanë listuar atë si një Park Kombëtar - liqeni është i shënuar edhe si një vend Ramsar. Liqeni është pjesërisht nën nivelin e detit, i cili mbushet nga lumi Moraça dhe derdhet në Adriatik nëpërmjet lumit 41 km të gjatë (Buna), e cila formon kufirin ndërkombëtar në gjysmën e poshtme të gjatësisë së saj. Liqeni përmban një nga rezervatet më të mëdhenj në Evropë, duke pasur 270 specie zogjsh, pjesë e të cilëve janë disa nga pelikanët e fundit në Evropë. Gjithashtu liqeni përmban habitate të pulëbardhave dhe çafkave, si dhe është i bollshëm në peshk, veçanërisht në krap, gjuhëz dhe ngjala. Ba shkëpunimi mes dy vendeve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit të Shkodrës është rritur në dekadën e fundit.¶

2. ANALIZA PESTLE

2.1 Reformat politike dhe procesi i integrimit në BE

Si Mali i Zi ashtu edhe Shqipëria janë të angazhuar për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian. Mali i Zi e ka marrë tashmë statusin e vendit kandidat, ndërsa Shqipëria pret ta marrë atë në qershor të vitit 2014.

Transformimi në demokraci funksionale dhe ekonomi tregu ka qenë baza logjike e proceseve të thella të reformave kombëtare institucionale dhe ristrukturuese në Mal të Zi dhe Shqipëri.

Mali i Zi ka bërë progres për sa i përket përmirësimit të legjislacionit në vend, kuadrit institucional dhe politik, forcimit të funksionimit të parlamentit, sistemit gjyqësor, politikave anti-korrupsion, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve[38]. Reformat e vazhdueshme në administratën kushtetuese dhe atë publike duhet të përparojnë akoma më tej. Stabiliteti makroekonomik është ruajtur gjerësisht. Përmirësime të mëtejshme janë bërë në procedurat për hyrjen në treg dhe rimëkëmbjen nga falimentimi, së bashku me reformat e liberalizimit të tregut. Është bërë progres i mirë edhe në fushat e prokurimit publik, politikave të transportit, statistikave, dhe të shkencës dhe kërkimit.

Ristrukturimi i ekonomisë për të siguruar një alokim efikas të burimeve mbetet një sfidë kryesore, së bashku me luftimin e një sektor të madh informal, i cili vazhdon të pengojë mjedisin e biznesit; këto janë rreziqe të mëdha për aftësinë për të ndjekur politikat e duhura makroekonomike për të siguruar se stabiliteti makro-financiar është ruajtur.

Marrëdhëniet me Bashkimin Evropian kanë parë përparim të konsiderueshëm që kur është nënshkruar Partneriteti Evropian për Malin e Zi nga Këshilli i Evropës, më 22 janar 2007. Një vit më pas, më 15 tetor 2007 Mali i Zi nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe një Marrëveshje të Përkohshme mbi tregtinë dhe çështjet e lidhura me të. Kjo e fundit hyri në fuqi në 1 janar 2008, ndërsa MSA hyri në fuqi në 1 maj 2010. Të bindur në përparimin e reformave të tij, Mali i Zi aplikoi për anëtarësim në BE më 15 dhjetor 2008. Pas një viti, në 19 dhjetor 2008, BE-ja hoqi kërkesën e vizave për malazezët që vizitonin shtetet anëtare të saj. Që nga data 17 dhjetor 2010, Mali i Zi ka marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE. Bisedimet për negociatat mbi pranimin në BE kanë filluar më 29 qershor 2012 pasi Këshilli miratoi vlerësimin e Komisionit, i cili pranon se Mali i Zi është në përputhje me kriteret për anëtarësim në BE.

Në përgjithësi, Mali i Zi vazhdon të zbatojë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit (MSA) me një ecuri të mirë.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2007 (SKZhQ) e Malit të Zi[39] është një nga dokumentet kryesore të zhvillimit të politikave të vendit. Ajo përcakton pesë qëllimet afatgjata për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm:

-Përshpejtimi i rritjes dhe zhvillimit ekonomik dhe reduktimi i pabarazive të zhvillimit rajonal;

-Reduktimi i varfërisë; sigurimi i aksesit të barabartë në shërbime dhe burime;

-Sigurimi i kontrollit efikas të ndotjes dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore;

Përmirësimi i sistemit të qeverisjes dhe pjesëmarrjes publike; mobilizimi i të gjitha palëve të interesuara dhe ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet;

Ruajtja e diversitetit dhe identiteteve kulturore.

Duke njohur progresin e **Shqipërisë** me reformat politike dhe ekonomike, Bashkimi Evropian nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Shqipërinë në qershor të vitit 2006, e cila hyri në fuqi në prill 2009. Shqipëria iu bashkua NATO-s në prill 2009. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Shqipërisë për të hyjnë në shtetet e Shengenit hyri në fuqi më 15 dhjetor 2010.

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit shënoi një etapë cilësisht të re në marrëdhëniet dypalëshe, duke sjellë detyrime dhe angazhime të reja të rëndësishme për vendin në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, lëvizjes së lirë të punonjësve, të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve, si dhe për transportin, fushën audio-vizuale dhe telekomunikacionit. Në përgjithësi, zbatimi i MSA-së ka vazhduar pa probleme, dhe Shqipëria ka vazhduar përafrimin e legjislacionit të saj me kërkesat e legjislacionit të BE-së në një sërë

[38] Strategjia e zgjerimit të BE-së dhe Sfidat kryesore 2012-2013 (faqe 12

[39] Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Malit të Zi 2007

fushash dhe rritjen e aftësive të saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Përmirësime thelbësore janë bërë në fusha të tilla si reformat e brendshme dhe ekonomike të tregut, rendi publik dhe menaxhimi i kufijve, reformat ligjore dhe administrata publike, prokurimi publik, statistikat, drejtësia, liria dhe siguria, dhe doganat.

Duke parë që Shqipëria arriti përparimin e nevojshëm, *Komisioni Evropian rekomandoi në tetor të vitit 2013 që Këshilli Evropian t'i japë Shqipërisë statusin e Vendit Kandidat për në BE*[40]

Megjithatë, sfidat kryesore mbesin në përfundimin e reformave në administratën publike dhe sistemin gjyqësor, në mënyrë që të forcohen institucionet e vendit. Zbatimi i reformës së pronës dhe reformës së administratës publike janë gjithashtu të rëndësishme, pasi njëra do ti hapë rrugën krijimit të tregut të tokës dhe të tjera do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Përfundimi i ristrukturimit ekonomik - privatizimi në shkallë të gjerë dhe ruajtja e stabilitetit makroekonomik, dhe përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit për të tërhequr investimet private të drejtpërdrejta, janë prioritete kyçe për të ardhmen, së bashku me luftën ndaj ekonomisë së madhe informale. Është thelbësore të ruhet vrulli i reformave, veçanërisht duke u përqendruar në zbatimin e legjislacionit të miratuar dhe sigurimin e sundimit të ligjit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të Shqipërisë 2014-2020 (SKZHI), konsiderohet si kuadri i politikave gjithëpërfshirëse për vendin në kontekstin e integrimit në BE. Ajo përcakton katër shtyllat e politikës strategjike që përcaktojnë themelet për ndërhyrjet sektoriale dhe të bazuara në vend[41]:

-Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës që adreson aspekte si: sistemi zgjedhor, drejtësia dhe punët e brendshme, të drejtat e njeriut dhe media, qeverisja efektive dhe politikat e jashtme dhe të mbrojtjes;

-Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik konkurrues dhe të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit efikas të burimeve që mbulojnë: stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makroekonomike, ekonominë konkurruese të tregut, përdorimin efikas të burimeve, zhvillimin e integruar rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

-Nxitja e përfshirjes sociale, mirëqenies dhe zhvillimit të tregut të punës, të cilat synojnë të promovojnë: politikat e punësimit dhe përfshirjes sociale, politikat sociale;

-Zhvillimi i një shoqërie të bazuar në dituri, inovacion dhe teknologji dixhitale, që përfshin ndërhyrjet në fushat në vijim: arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal të Shqipërisë dallon zonat kufitare si subjekt të planifikimit të politikave ndërsektoriale dhe i bën çështjet ndërkufitare pjesë të planifikimit të politikave të zhvillimit në nivel qarku.

Konteksti Ekonomik i Vendit

Mali i Zi po përpiqet të sigurojë forcimin ekonomik dhe stabilitetin financiar nëpërmjet konsolidimit fiskal dhe reformave strukturore. Reformat strukturore të Malit të Zi në sektorin publik, sektorin financiar, si dhe në klimën e investimeve, kanë bërë të mundur që vendi të bëjë progres në vitet e fundit në rritjen e të ardhurave për frymë dhe reduktimin e varfërisë, avancimin e reformave strukturore, dhe përgatitjen për anëtarësim në BE. GDP për frymë është 5.063 Euro në vitin 2012[42], pak më e ulët në krahasim me 5.211 Euro e regjistruar në vitin 2011, por më e lartë se në gjashtë vendet e tjerë të rajonit.

Ekonomia e Malit të Zi ka hyrë në recesion në vitin 2008, dhe ka filluar të ngrihet pjesërisht në vitin 2010 dhe 2011 me një mesatare prej 2.9%. Megjithatë, rritja ka ndaluar përsëri pasi GDP ka regjistruar një rritje negative prej 2.5%[43], ndërsa papunësia ka arritur në rreth 19.7% në vitin 2012 nga 16.5% që ishte në vitin 2010[44]. Shtyllat kryesore ekonomike të vendit mbeten turizmi, i ndjekur nga prodhimi, ndërsa sektorë të tjerë si ndërtimi dhe industria janë kontraktuar gjatë vitit 2012. Inflamacioni është rritur nga 0.5% në vitin 2010, në rreth 3.6% në vitin 2012 dhe borxhi publik është rritur nga nën 30% e GDP-së në vitin 2007 në mbi 54% të GDP-së në vitin 2012.

[40] Një vendim që pritej të merrej në Qershor të vitit 2014

[41] Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZhI)

[42] 36MONSTAT, GDP e Malit të Zi, Publikimi Nr. 246, Shtator 2013

[43] MONSTAT, GDP e Malit të Zi, Publikimi Nr. 246, Shtator 2013

[44] MONSTAT, Sondazhi I Fuqisë Punëtore 2012

Nga ana tjetër, kredia për ekonominë vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulëta, ndërkohë që disa banka kanë ndaluar së dhëni hua për sektorin privat.

Sfida kryesore në të ardhmen mbetet fuqizimi i konkurrencës së ekonomisë së Malit të Zi, duke përmirësuar produktivitetin dhe duke tërhequr IHD të tjera në më shumë sektorë sesa vetëm turizmi dhe pasuritë e patundshme. Mjedisi i biznesit do të përmirësohet më tej duke vazhduar luftën ndaj korrupsionit dhe fuqizimin e shtetit ligjor. Hendeku midis ofertës dhe kërkesës së aftësive të punës duhet të tejkalohet duke lejuar vendosjen më të pavarur të pagave në nivel kompanie. Forcimi i financave publike së bashku me reduktimin e ekonomisë informale janë gjithashtu sfida të rëndësishme që duhet përballuar.

Mali i Zi u bë anëtar i plotë i Organizatës Botërore të Tregtisë në prill të vitit 2012. Si vend anëtar i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL) që nga data 11 maj 2007, Mali i Zi e ka nënshkruar anëtarësimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) më 26 korrik 2007, dhe gjithashtu ka nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me vendet pjesë të Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2012.

Shqipëria ka bërë ecje relativisht të mirë gjatë dekadës së fundit. Vendi ka qëndruar larg recesionit, duke ruajtur ritmet pozitive të rritjes, pavarësisht ekspozimit të saj ndaj krizës së vështirë ekonomike, e

cila ka goditur Greqinë dhe Italinë, si dhe rrethimit nga ekonomitë rajonale kontraktuese. Rritja e GDP-së së saj është ngadalësuar nga një kulm i normës së rritjes prej 7.5% në vitin 2008, në një normë më të ulët të rritjes prej 1.6% në vitin 2012[45]. Sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në GDP, duke përbërë më shumë se gjysmën e GDP-së së vendit. Shqipëria cilësohet si një vend me të ardhura të ulëta deri në mesatare me një GDP për frymë, e cila në vitin 2012 qëndron në 3.415 Euro[46]. Shkalla e papunësisë me një mesatare prej 13% është ndër më të ulëtat në rajon. Borxhi publik i përgjithshëm i Shqipërisë ka arritur në 60.6% të GDP-së deri në fund të vitit 2012[47]. Ekonomia mbetet e brishtë për shkak të dobësive të brendshme strukturore dhe paqëndrueshmërisë ekonomike globale.

Sfida kryesore në të ardhmen mbetet sigurimi i rritjes së qëndrueshme afatgjatë, duke ndjekur politika të matura fiskale dhe monetare dhe reformat strukturore. Shqipëria duhet të punojë për reduktimin e niveleve të larta të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Ajo duhet të përmirësojë parashikimin fiskal duke hequr dorë nga mbivlerësimi i të ardhurave dhe duke përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme përputhjen e taksave. Përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit të biznesit dhe investimeve është thelbësor për diversifikimin e ekonomisë dhe nxitjen e potencialit të saj të rritjes afatgjatë. Përforcimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit dhe adresimi i detyrimeve të pashlyera, si dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor, janë fushat kryesore ku duhet të përqendrohen shumë përpjekje. Reduktimi i ekonomisë gri mbetet një sfidë e rëndësishme.

Shqipëria ka Marrëveshje për Tregti të Lirë me të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë Malin e Zi, dhe është anëtare e CEFTA-s që nga viti 2006.

2.2 KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË ZONËS SË PROGRAMIT

Zona e programit përmban të gjitha pabarazitë rajonale të hasura në **Mal të Zi** në drejtim të zhvillimeve social-ekonomike. Ashtu si në nivel kombëtar, ajo është e dominuar nga Podgorica, e cili është motori ekonomik i vendit. Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Malit të Zi 2010-2014 ofron një pasqyrë të qartë të situatës social-ekonomike në zonën e programit nëpërmjet indeksit të saj të zhvillimit, e cila veçon vetëm bashkitë e Budvës dhe Podgoricës me një nivel zhvillimi mbi mesataren kombëtare. Çdo bashki e zonës së programit është nën mesataren kombëtare, me bashkinë e Plavës në krye që është më pak e zhvilluara në vend. Ndryshe nga Budva, e cila ka indeksin më të lartë të zhvillimit në Mal të Zi, përkatësisht 362.4, dy

[45] INSTAT, GDP tremujore 2012

[46] Banka Botërore, Të dhënat e shtetit 2008 - 2012

[47] Ministria e Financave, 2012

bashkitë e tjera bregdetare të zonës së programit, Tivari dhe Ulqini, janë nën mesataren kombëtare.

Grafiku 1. Indeksi i Zhvillimit Rajonale, Mal i Zi



Rajoni verior, relativisht i industrializuar në kohën e Jugosllavisë, është përballur me një rënie të madhe ekonomike. I gjithë rajoni verior kontribuon në GDP-në kombëtare me vetëm 18%[48], ndërsa papunësia mesatare dhe niveli i varfërisë janë dukshëm më të larta sesa në rajonet qendrore dhe bregdetare. Kjo situatë mund të çojë në një rrallim të vazhdueshëm të popullsisë së këtij rajoni, i cili mund të pengojë planet e mëtejshme të zhvillimit. Megjithatë, rajoni ka burime të vlefshme, të cilat janë të lidhura kryesisht me mjedisin e tij unik. Veçanërisht, ky është rasti për sektorët e bujqësisë dhe pyjeve, për prodhimin e energjisë së rinovueshme, dhe për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit malor dhe ekoturizmit. Veprimtaritë e vogla prodhuese, kryesisht të lidhura me përpunimin e ushqimit (mish, fruta dhe perime) dhe përpunimin e drurit po rimarrin zhvillim, dhe shumë përpjekje i janë kushtuar zhvillimit të produkteve të reja të turizmit.

Duke pasur një pozitë qendrore, bashkia e Podgoricës është e përqendruar në ofrimin e shërbimeve dhe industritë. Gjithashtu, ajo përfiton edhe nga toka dhe kushtet e favorshme klimatike për zhvillimin e bujqësisë intensive. Pavarësisht nga aktivitetet që lidhen me portin e Tivarit, rajoni bregdetar është shumë i varur nga turizmi dhe aktivitetet përkatëse. Në aspektin e infrastrukturës së turizmit, Ulqini dhe Tivari janë ende larg nga të qenit në nivel të bashkive të tjera të bregdetit Adriatik të Malit të Zi.

Në **Shqipëri** pabarazitë rajonale janë gjithashtu të dukshme. Zhvillimi social-ekonomik i vendit anon shumë në favor të rajonit qendror. Rajoni i Tiranës kontribuon me më shumë se një të tretën e GDP-së së vendit, dhe është deri tani rajoni më i zhvilluar në krahasim me të gjitha rajonet e tjera të Shqipërisë. Kjo tregon qartë se të gjitha rajonet e tjera janë nën potencialin e tyre të zhvillimit, pasi i duhet të gjejnë rrugë dhe mundësi për të përfituar nga avantazhet e tyre krahasuese. Rajonet Shkodër dhe Lezhë pasqyrojnë gjerësisht këto pengesa për sa i përket zhvillimit social-ekonomik.

Shkodra është rajoni më i zhvilluar në zonën e programit të Shqipërisë. Kontributi i Qarkut të Shkodrës NË GDP- në e vitit 2011[49] arriti në 555 milion Euro, pra 6.1% të GDP-së së përgjithshme të vendit, duke u renditur e shtata ndër 12 qarqet e Shqipërisë. Kontribuesi kryesor në aktivitetin ekonomik në rajonin e Shkodrës është sektori i bujqësisë, kontributi i të cilit llogaritet të jetë rreth 26% në GDP-në e rajonit, pasuar nga kontributi i përbashkët i të cilave në vitin 2011 është 23% në GDP-në e rajonit. Kontributi i sektorit financiar dhe i pasurive të patundshme arrin në 19%, pasuar nga shërbimet e tjera që llogaritet të kontribuojnë me 13% të GDP-së rajonale. Kontributi i industrisë në ekonominë e rajonit është 11%, e ngjashme me mesataren kombëtare, e cila vlerësohet të jetë 11.2%. Sektori me nivelin më të ulët të kontributit në ekonominë e rajonit të Shkodrës është ndërtimi, i cili përbën 8% të GDP-së së rajonit.

Grafiku 2. Kontributi rajonal në GDP në %, Shqipëria



[48] Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Malit të Zi

[49] INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013

GDP e qarkut të Lezhës për vitin 2011 llogaritet me 334 milionë Euro ose rreth 3.7% të GDP-së së vendit[50]. Kontribuuesit kryesorë në GDP-në e qarkut të Lezhës janë tregtia, hotelet, transporti dhe komunikimi, që kontribuojnë me 26%, dhe sektori i bujqësisë që kontribuon me 25%. Kontributi i sektorit financiar dhe i pasurive të patundshme arrin në 19%, pasuar nga shërbimet e tjera që kontribuojnë me 13% të GDP-së rajonit. Kontributi i sektorit të ndërtimit është vlerësuar me 10%, nën mesataren kombëtare të vlerësuar me 12.8%, ndërkohë që industria është kontribuuesi më i vogël për ekonominë e qarkut të Lezhës , duke zënë 8% të GDP-së në vitin 2011.

Kontributi i qarkut të Kukësit në GDP-në e Shqipërisë, ku Tropoja përbën 24% të popullsisë, është më i ulëti në vend me vetëm 2.4%; sektorët më të rëndësishëm janë bujqësia, e cila është përgjegjëse për 34%, dhe tregtia, hotelet dhe turizmi me 20%.

Përveç sektorit të shërbimeve, i cili është kontribuuesi kryesor në GDP-në e vendit, sektori i bujqësisë ka një rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në zonën e programit, pasi pavarësisht lëvizjeve të mëdha drejt zonave urbane të regjistruara nga Censusi i fundit në vitit 2011, një pjesë e madhe e popullsisë ende jeton në zonat rurale.

2.2.1 Sektori Privat

Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programit mbizotërohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. NVM-të në Mal të Zi përbëjnë 98.6% të numrit të përgjithshëm të operatorëve ekonomikë, ndërsa në Shqipëri ato përbëjnë 95.4% të totalit. Shumica e NVM-ve në të dyja anët e kufirit punojnë në sektorin e shërbimeve.

Pjesa më e madhe e operatorëve ekonomikë të **Malit të Zi** janë të përqendruar në zonën e programit, e cila ka një total prej 14,215 ndërmarrjesh[51], që përbëjnë 67.3% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në nivel kombëtar. Rreth 49.2% e këtyre NVM-ve janë të vendosura në Podgoricë, duke treguar pabarazitë e zhvillimit rajonal. Komuna të tjera të rëndësishme në zonën e programit janë Budva me 16% dhe Tivari me 14.5% të NVM-ve të zonës së programit. Andrijevica dhe Plava janë dy komunat me numrin më të vogël të ndërmarrjeve me më pak se 1% të numrit të përgjithshëm. Rreth 83% e totalit të 34 ndërmarrjeve që kanë më shumë se 250 punonjës janë të vendosura në Podgoricë. Niveli i femrave që zotërojnë një biznes në zonën e programit është mjaft modest, më i ulët se 9.5%; ai është pak më i ulët se 9.6% që është mesatarja kombëtare.

Forcimi i mekanizmave mbështetëse të biznesit mbetet një sfidë. Dhomat e Tregtisë së Malit të Zi kanë ende një aktivitet të kufizuar në ofrimin e mbështetjes dhe këshillave për sipërmarrësit. Ekzistojnë 2 inkubatorë biznesi në zonën e programit, një në Podgoricë nën mbikëqyrjen e Drejtorisë për Zhvillimin e NVM-ve (SMEDA) që mbulon Podgoricën dhe Tivarin, dhe një tjetër në Berane.

Grafiku 3. NVM-të sipas sektorëve kryesorë ekonomikë në zonën e programit



Në **Shqipëri** zona e programit regjistron një total prej 10,174 ndërmarrjesh[52] në fund të vitit 2012, ose rreth 9.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të vendit. Ajo ka një shkallë lindje prej 13%[53], më e lartë në krahasim me mesataren kombëtare prej 12.2%, e ndikuar kryesisht nga Shkodra, e cila me 14.1% tregon një zhvillim relativisht më të lartë të aktivitetit ekonomik, në të kundërt me rajonin e Lezhës dhe rrethin e Tropojës, të cilat kanë një përqindje më të ulët krahasuar me mesataren në nivel kombëtar, vetëm 10.8%.

Operatorët ekonomikë në rajonet e Shkodrës, Lezhës si dhe në rrethin e Tropojës, janë

[50] INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013

[51] MONSTAT, Regjistri i Bizneseve, Numri dhe struktura e subjekteve të biznesit 2011

[52] INSTAT, Regjistri Statistikor i Biznesit të Ndërmarrjeve 2012

[53] Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara për një vit të caktuar e shprehur në % mbi numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve.

jashtëzakonisht shumë të fragmentuar dhe të vegjël në madhësi, duke pasqyruar strukturën e ndërmarrjeve në nivel kombëtar, dhe duke treguar se biznesi është kryesisht familjar dhe mbizotëron vetëpunësimi. Struktura e ndërmarrjeve është e dominuar nga ndërmarrje shumë të vogla, me 1-4 persona të punësuar, të cilat përbëjnë 85.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në zonën e programit. Megjithatë, kjo vlerë është nën mesataren kombëtare, e cila i përllogarit NVM-të me 1-4 persona të punësuar në rreth 90.2% në vitin 2012. Aktiviteti ekonomik menaxhohet kryesisht nga meshkujt, dhe numri i femrave menaxhuese në zonat përfituese është nën mesataren kombëtare prej 27.4% - më e larta në Shkodër në vlerën 25.1%, e ndjekur nga Lezha me 24.7%, dhe më pas nga Tropoja që regjistron nivelin më të ulët në Shqipëri me 14.2%.

Përveç përmasave të vogla të ndërmarrjeve, një faktor i rëndësishëm që përbën pengesë për zhvillimin ekonomik në zonën e programit në të dyja anët e kufirit është mungesa e njohurive teknologjike dhe aftësive të punës. Kjo mbetet një sfidë themelore, sepse kërkesa e tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë nuk përputhet me aftësitë e papërshtatshme të punonjësve. Ekonomitë më pak të zhvilluara të zonave rurale dhe të largëta nuk janë në gjendje të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga qytetet më të zhvilluara bregdetare dhe qendrat e mëdha urbane të zonës së programit. Një tjetër sfidë kryesore është aksesi i dobët i NVM-ve në financim; politikat tepër të kujdesshme të kredi-dhënies të miratuara nga institucionet financiare në të dyja vendet janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve në zonën e programit. Dhomat e Tregtisë, organizatat e biznesit dhe Agjencitë për Zhvillim Rajonal të pranishme në zonën e programit duhet të marrin një rol më proaktiv në promovimin e zhvillimit të bizneseve dhe të bashkëpunimit.

2.2.2 Tregu i punës

Si në Mal të Zi ashtu edhe në Shqipëri, papunësia është relativisht e lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Ajo është ende një problem i madh ekonomik në të dyja anët e zonës së programit, dhe karakterizohet nga dallime të mëdha rajonale.

Në **Mal të Zi** tregu i punës ka pësuar krizë, duke regjistruar një rritje të papunësisë që arriti në 20.45% nëvitin 2011[54] duke u ulur në 19.6% në vitin 2012. Zona e programit ka rreth 93.4% të forcës aktive të punës në vend. Të dhënat e censusit tregojnë pabarazitë e zhvillimit rajonal në Mal të Zi me rajonin bregdetar dhe atë qendror duke përparuar më shumë se rajonet më të varfra dhe më pak të zhvilluara pa dalje në det, të cilat ndodhen në veri të vendit. Budva ka nivelin më të ulët të papunësisë me 13.2%, e ndjekur nga të gjitha bashkitë bregdetare dhe ato të rajonit qendror. Nga ana tjetër, bashkitë pa dalje në det të Rozhajës dhe Plavës janë bashkitë më pak të zhvilluara në zonën e programit me një shkallë të lartë papunësie deri në 58.5% dhe 50.4% respektivisht.

Pjesa më e madhe e fuqisë punëtore është e punësuar në sektorin e shërbimeve (76.2%), pasuar nga industria me 18.1%, dhe bujqësia me 5.6% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në nivel kombëtar. Pjesa veriore e Malit të Zi regjistron një shkallë më të lartë të punësimit në bujqësi, me rreth 14.9%, dhe në industri me rreth 21.7%, ndërkohë që punësimi në shërbime llogaritet në 63.3%. Punësimi në shërbime në rajonin bregdetar është rreth 83%, i ndjekur nga industria me 15.1% dhe bujqësia me vetëm 1.9%. Rajoni qendror është më i balancuar dhe më afër normave kombëtare. Deri tani, Podgorica përbën motorin kryesor ekonomik dhe të punësimit të rajonit qendror. Punëdhënësi më i madh në program është sektori i tregtisë me 20.5%, i ndjekur nga administrata publike me 12.5%. Rreth 55.9% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve janë meshkuj, ndërkohë që femrat përbëjnë pjesën e mbetur prej 44.1 %.

Fuqia e përgjithshme punëtore në Shqipëri arrin në 1,117,082 persona në fund të muajit dhjetor 2012[55]. Ajo nuk ka pasur ndryshime të mëdha, pavarësisht nga ngadalësimi ekonomik gjatë 2-3 viteve të fundit. Shkalla e përgjithshme e punësimit[56] në Shqipëri gjatë vitit 2012 arriti në 56.4 %, ndërkohë që shkalla e përgjithshme e

[54] Census i Malit të Zi 2011

[55] INSTAT, Buletini Tremujor i Statistikave, Nr. 2, 2013

[56] Shkalla e punësimit përfaqëson përqindjen e personave të punësuar në raport me popullsinë e përgjithshme aktive të moshës 15 vjeç e lart.

papunësisë[57] ka mbetur në 13.9%, njëlloj si në vitin 2011. Papunësia në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës pasqyron të njëjtën normë mesatare të papunësisë si në nivel kombëtar, dhe gjithashtu të njëjtën strukturë punësimi. Rrethi i Tropojës ruan të njëjtën strukturë të punësimit duke regjistruar nivele të larta të papunësisë. Në fund të vitit 2012, numri i të papunëve në Shkodër qëndron në 19,417 persona, duke përbërë 13.6% të totalit të të papunëve; Lezha me 15,021 persona të papunë përbën 10.6% të totalit; ndërsa Tropoja regjistron 2,368 të papunë, ose rreth 36% të forcave të përgjithshme të punës që i përkasin grup-moshës 15-64 vjeç në rrethin e Tropojës. Papunësia është më e pranishme në zonat urbane, pasi ata që jetojnë në zonat rurale janë konsideruar si të vetë-punësuar.

Fuqia punëtore në Shqipëri dhe në zonën e programit është e dominuar nga grup-mosha 25-54 vjeç, e cila përbën 66.5% të fuqisë së përgjithshme punëtore. Më shumë se 54% e punësimit të përgjithshëm është në sektorin e bujqësisë, ndërsa punësimi në sektorin privat jo-bujqësor qëndron në 28.7%.

Punësimi në sektorin privat jo-bujqësor dominohet nga sektori i shërbimeve (tregti, hotele, transport), e cila përbën 55.6% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin privat, e ndjekur nga punësimi në sektorin e ndërtimit, i cili përbën 22.2%. Punësimi në prodhim qëndron në 17.2%, ndërsa në sektorin e energjisë shkon deri në 5% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin privat.

Duhet të theksohet se në të dy vendet, një numër i konsiderueshëm personash punojnë jashtë vendit dhe janë shumë aktivë në ofrimin e ndihmës për familjet e tyre. Pra, dërgesat e emigrantëve luajnë një rol të rëndësishëm në subvencionimin e të ardhurave dhe konsumin vendor.

2.2.3 Bujqësia dhe Zhvillimi rural

Pjesa Malazeze e zonës së programit është më e pasur në burime bujqësore dhe ka më shumë potencial në këtë sektor në krahasim me pjesën e Shqipërisë. Megjithatë, sektori i bujqësisë dhe zhvillimi i tij është po aq i rëndësishëm për të gjithë zonën e programit, veçanërisht për shkak të pjesës së madhe të popullsisë që jeton në zonën rurale, ku bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik. Një tipar i përbashkët në zonën e programit është produktiviteti dhe konkurrenca e ulët në fushën e bujqësisë. Ai vjen si pasojë e: fermave të vogla të cilat kanë prodhim dhe fitim të kufizuar; prodhimit kryesisht për të mbuluar nevojat e jetesës, sesa për shitje direkte në tregjet e gjelbra; dhe nivelit të ulët të finalizimit të produkteve bujqësore dhe industrisë ushqimore të pazhvilluar.

Zona e programit mbulon rreth 38% të totalit të tokës bujqësore të **Malit të Zi**. Punësimi në bujqësi është raportuar të jetë rreth 2.5% e totalit të të punësuarve[58], Podgorica është rajoni kryesor fushor në Mal të Zi - vetëm ajo zë rreth 31.5% të tokës bujqësore në zonën e programit. Ajo ofron kushte optimale për prodhim të larmishëm: perime, prodhimin e drithërave, blegtori, fruta dhe verë. Vera, e cila është produkti kryesor Malazez i orientuar drejt eksportit, prodhohet në Podgoricë - rreth 80% e prodhimit të përgjithshëm të verës në vend. Bashkitë e tjera të ndodhura në zonën qendrore, si Berane dhe Danilovgrad janë prodhuesit kryesorë të mollëve, kumbullave dhe dardhave. Bashkitë në zonën bregdetare të cilat kanë aktivitet të veçantë bujqësor janë të Ulqini dhe Tivari. Rajoni bregdetar është veçanërisht i përshtatshëm për frutat subtropikale dhe prodhimin e ullirit. Më shumë se 80% e pemëve agrume në Mal të Zi janë në Ulqin (65%) dhe Tivar. Këto dy bashki (Tivar dhe Ulqin) janë edhe prodhuesit më të mëdhenj të vajit të ullirit - me 47% të prodhimit të përgjithshëm të vajit të ullirit në Mal të Zi. Ndërkohë që prodhimi i vajit të ullirit mban një potencial të madh për zhvillim, relievi kodrinor i zonës bregdetare dhe rajonit përreth liqenit të Shkodrës është gjithashtu i pasur me bimë mjalti dhe bimë mjekësore, dhe është i përshtatshëm për blegtori.

Zona e programit në **Shqipëri** mbulon rreth 3.2% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së vendit[59]. Pjesa më e madhe e territorit të saj është e dominuar nga pyjet, kullotat (80%), ndërsa

[57] Norma e papunësisë përfaqëson përqindjen e personave të pa-punësuar nw raport me popullsinë e përgjithshme aktive.

[58] Industria dhe punësimi i popullsisë në Mal të Zi -Census 2011 MONSTAT, publikimi nr. 197

[59] Libri statistikor, Ministria e Bujqësisë

pjesa e tokës në shfrytëzim për qëllime bujqësore është vetëm 14.8% ose 92,748 ha. Terreni është kryesisht malor dhe i thyer, i cili kufizon në mënyrë të konsiderueshme zonat ku potenciali bujqësor mund të mbajë disa domethënie krahasuese. Zona të tilla janë të vendosura kryesisht në rrethinat e liqenit të Shkodrës, ku terreni dhe kushtet klimatike janë të favorshme për bujqësinë e perimeve. Qarku i Lezhës ka një traditë për blegtorinë e derrave, pasi ajo ka 91.7% të inventarit total të shtetit. Prodhimi bujqësor në rrethin e

Tropojës është i orientuar kryesisht drejt prodhimit të thekrës, dhe zona është e famshme për pyjet me gështenja.

Pavarësisht se zona e programit është e pasur me burime ujore, vetëm 32% e tokës bujqësore në zonë ujitet, duke treguar nivelin e ulët të zhvillimit në sektorin e bujqësisë. Bujqësia në zonën e programit është një aktivitet familjar, i orientuar drejt nevojave për jetesë, me toka shumë të fragmentuara - madhësia e fermës është 1.1 ha në Shkodër; 0.89 ha në Lezhë, dhe 0.60 ha në Tropojë, madhësi të cilat janë sa gjysma e mesatares Shqiptare, prej 1.20 ha.

Përmirësimi i mëtejshëm i aksesit në treg, infrastruktura rurale, dhe menaxhimi më i mirë i burimeve ujore mund të jenë prioritetet e ardhshme në zonën e programit. Modernizimi i bujqësisë, përmirësimi i proceseve të prodhimit dhe vendosja e standardeve të sigurisë ushqimore në përputhje me standardet e BE-së, si dhe rritja e prodhimit tradicional bujqësor, janë sfida për tu përballuar në zonën e programit. Iniciativat ndërkufitare mund të mbështesin dhe promovojnë: i) diversifikimin e aktiviteteve rurale (p.sh. akomodimi i turistëve në ferma); ii) aksesin në tregje dhe zhvillimin e prodhimit dhe marketingut të produkteve ushqimore organike; iii) mbrojtjen (p.sh. mbrojtja e emërtimit të origjinës) dhe tregtimin e produkteve tradicionale bujqësore dhe agro-ushqimore; dhe iv) bashkëpunimin midis prodhuesve. Mund të konsiderohet përkrahja e përpjekjeve që janë duke u bërë në të dy vendet për të ndjekur një qasje të integruar që synon promovimin dhe lidhjen e bujqësisë me aktivitete të tjera turistike dhe ekonomike në një paketë, si forma më e përshtatshme e zhvillimit të bujqësisë në zonën e programit.

2.2.4 Turizmi

Rëndësia e turizmit është e ndryshme për ekonomitë e Malit të Zi dhe Shqipërisë. Mali i Zi është tashmë një destinacion i popullarizuar turistik, ndërsa Shqipëria ka ende shumë për të bërë, për tu bërë një destinacion i tillë.

Në **Mal të Zi**, turizmi është një sektor kryesor i ekonomisë, i cili përbën rreth 9.9% të GDP-së së vendit në vitin 2012, ose rreth 336 milion Euro, që është 20.7% më i lartë se në vitin 2011[60]. Turizmi punëson rreth 12.000 persona, ose 6.9% të punësimit të përgjithshëm në vitin 2012. Ai është sektori më premtues ekonomik në Mal të Zi, dhe pritet që të përbëjë rreth 14.8% të GDP-së së vendit në vitin 2021, veçanërisht në qoftë se përpjekjet për "integrimin e të gjitha rajoneve në një destinacion të vetëm me cilësi të lartë" nën markën "Mali i Zi-Bukuria e Egër"[61] dalin me sukses. Një objektivi i tillë politik synon të sigurojë një zhvillim të përgjithshëm më të ekuilibruar të rajoneve të Malit të Zi, në veçanti në sektorin e turizmit, i cili mbështetet kryesisht në turizmin bregdetar gjatë kohës së verës.

Zona e programit në kufi me Shqipërinë, ofron një shumëllojshmëri të destinacioneve turistike, duke ofruar aktivitete të turizmit bregdetar dhe malor të tilla si noti, ecja në natyrë, çiklizmi, si dhe shijimi i pijes së verës. Rajoni bregdetar në zonën e programit përbën më shumë se 69% të totalit të qëndrimeve me fjetje në vend në vitin 2012[62], kryesisht në periudhën e pushimeve Korrik-Gusht. Bregdeti i zonës së programit tërhoqi rreth 67.5% të totalit prej 1,44 milionë turistë që hynë në Malin e Zi në vitin 2012. 160 objekte akomoduese bregdetare që gjenden në zonën e programit përbëjnë rreth 49% të totalit të mjediseve akomoduese në Mal të Zi, ndërsa në zonën e programit ndodhen edhe rreth 30% e objekteve akomoduese të zonave jo-bregdetare të vendit. Ture të verës organizohen në Podgoricë dhe vreshtat e bashkive jugore. Pavarësisht nivelit të ulët aktual të vizitave turistike, rajoni kontinental ka përparësi të shumta për zhvillimin e të gjitha

[60] Këshilli i Udhëtimeve nëpër Botë dhe Turizmit - Mars 2013

[61] Mali i Zi, Strategjia për Zhvillimin e Turizmit deri në 2020

[62] MONSTAT – Mbërritjet Turistike dhe Qëndrimet me fjetje sipas Qyteteve 2012

llojeve të turizmit të lidhura me sportet malore (ski, ecje, çiklizëm, rafting, etj.), duke përmendur natyrën e paprekur dhe biodiversitetin e pasur (dy parqe kombëtare, liqene, kanione, etj.), jetën autentike rurale, dhe prodhimin tradicional dhe cilësor të ushqimit.

Bashkitë bregdetare në zonën e programit janë gjithashtu të pasura me monumente arkitekturore dhe kulturore nga kohët antike, të cilat i bëjnë këto zona shumë tërheqëse për turistët. Tivari është një qytet-port i njohur edhe për shumë monumente të rëndësishme historike dhe kulturore.

Sektori i turizmit është më pak i rëndësishëm në pjesën **shqiptare** të zonës së programit, në krahasim me anën malazeze. Zona e programit ka një natyrë të gjerë, me potencial për turizëm kulturor dhe historik, për mbetet e pashfrytëzuar në një masë të madhe. Ajo ka një vijë bregdetare 50 km të gjatë (12 km Velipojë-Shkodër dhe 38 km Lezha), e përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit bregdetar. Përmirësimet e kohëve të fundit në infrastrukturën rrugore e kanë bërë këtë bregdet lehtësisht të arritshëm, veçanërisht nga turistët nga Kosova dhe Maqedonia. Strukturat ekzistuese pritëse, kryesisht në pronësi private, kanë vështirësi për të përballuar numrin në rritje të turistëve, veçanërisht në Shëngjin-Lezhë. Rrethi i Tropojës, edhe pse ka potencial të konsiderueshëm për turizmin malor dhe sportet (ski, ecje, çiklizëm, etj.), natyrë të paprekur dhe biodiversitet të pasur (të parkut kombëtar të Luginës së Valbonës, "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Bjeshkët e Doberdolit, të cilat kanë liqene akullnajore"), dhe jetë autentike rurale, ofron shumë pak në drejtim të strukturave pritëse. Pavarësisht përmirësimeve gjatë viteve të fundit, infrastruktura e turizmit mbetet e pazhvilluar sa duhet, dhe potenciali ekzistues i pasur me burime natyrore dhe kulturore ende duhet të shpaloset.

Rajonet e Shkodrës dhe Lezhës, si dhe rrethi i Tropojës kanë potencial të lartë individual për zhvillimin e një turizmi përgjatë gjithë vitit. Natyra atraktive dhe panoramat e natyrës malore dhe kodrinore, si dhe liqeni i Shkodrës, lugina e Valbonës në Tropojë dhe parqet e tjera kombëtare, dhe zonat e mbrojtura; vizitat turistike (peizazhet natyrore, speciet e rralla, etj.); agro-turizmi, vendet me interes historik dhe kulturor, të tilla si vendbanimet parahistorike, qendrat arkeologjike, objektet e kultit, duhet të promovohen më mirë për një zhvillim më të shpejtë të turizmit në bregdetin e Shkodrës (Velipojë), dhe kryesisht në Lezhë (Shëngjin).

2.3 SOCIALE

2.3.1 Demografia

Si në Shqipëri, ashtu edhe në Malin e Zi, gjatë vitit 2011 u realizua një census. Ndërkohë që popullsia e regjistruar në Malin e Zi tregoi ndryshime të papërfillshme, popullsia e regjistruar në Shqipëri ka rënë me 8.8% në vitin 2011 krahasuar me Censusin e vitit 2001.

Tabela 2. Popullsia dhe dendësia në zonën e programit

	Banorë	Dendësia banorë/km^2
Mali i Zi	**620,029**	**44.89**
Zona e përgjithshme e programit	**379,366**	**65.69**
Rozaje, Berane, Andrijevica, Plavë, Danilovgrad, Podgoricë, Bar, Ulqin, Cetinje, Budva, Petnjica, Guci	**379,366**	**65.69**
Shqipëria	**2,800,18**	**97.40**
Zona e përgjithshme e programit	**369,891**	**59.4**
Rajoni Shkodër	215,347	60.46
Rajoni Lezhë	134,027	82.70
Qarku Tropojë	20,517	19

Popullsia që jeton në zonën e programit llogaritet të përbëjë rreth 61% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, dhe 13.2% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia në zonën e programit është e balancuar, e përbërë nga popullsi e Malit të Zi prej rreth 379,366 banorësh, duke zënë 50.63% të popullsisë totale në zonën e programit, dhe popullsi shqiptare prej rreth 369,891 banorësh, duke zënë 49.37% të popullsisë totale në zonë. Në pjesën malazeze dendësia e popullsisë me 65.7 banorë/ km2 është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 45 banorë/$km^{2,}$ ndërsa në Shqipëri është 59 banorë/ km2, më e ulët në krahasim me mesataren kombëtare prej 97 banorë/ km^2. Podgorica, Berane, Petnjica Tivari dhe Rozaja janë qytetet kryesore në Mal të Zi, ndërsa Shkodra dhe Lezha janë qendrat më të rëndësishme urbane në zonën e programit në Shqipëri.

Popullsia e përgjithshme në zonën e programit në **Mal të Zi** është 379,366[63] banorë. Zona e programit ka një normë rritje natyrore prej 1.87%, që është nën mesataren kombëtare prej 2.2%; shkalla e vdekshmërisë qëndron në 9.4% e barabartë me mesataren kombëtare. Në **Shqipëri**, numri i përgjithshëm i popullsisë që jeton në zonën e programit është 369,891[64] banorë, ose rreth 13.2% e popullsisë së përgjithshme të vendit. Rajoni i Shkodrës është rajoni i gjashtë më i madh i vendit me një popullsi prej 215,347 banorë, ose rreth 7.6% e popullsisë së përgjithshme, e ndjekur nga Lezha e cila renditet e dhjeta mes rajoneve të vendit, që numëron një total prej 134,027 banorë apo 4.7% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë.

Rrethi i Tropojës regjistron një popullsi totale prej 20,517 banorë, e cila përbën 0.07% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë.

Zona e programit në Mal të Zi ka një popullsi kryesisht urbane, duke zënë rreth 52% të popullsisë së saj, e cila është më e ulët, në krahasim me 62% që jetojnë në zonat urbane në nivel kombëtar. Rreth 49% e popullsisë në zonën e programit është e përqendruar në Podgoricë. Nga ana tjetër, Andrijevica ka përqendrimin më të madh të popullsisë rurale, e cila përbëhet nga 79.3%, e pasuar nga Berane dhe Danilovgrad me përkatësisht 67.4% dhe 62%. Gjithashtu, bashkitë Plav dhe Tivar dominohen nga popullsia rurale me 59%, ndërsa të gjitha bashkitë e tjera në zonën e programit janë të dominuara nga popullsi urbane, e cila varion nga 53.7% në Ulqin deri në 84.6% në Cetinjë, e cila shënon përqendrimin më të lartë të popullsisë urbane. Në **Shqipëri** situata është ndryshe, pasi popullsia është kryesisht rurale, me një mesatare prej 53.2%. Këtë mesatare e përcakton rajoni i Shkodrës, pasi popullsia rurale është 55.6% e 119,794 banorëve të tij. Në të kundërt, rajoni i Lezhës ka një dominim të popullsisë urbane, me rreth 53.8% të popullsisë. Ndërsa rrethi i Tropojës ka një popullsi kryesisht rurale, e cila përbën rreth 74% të popullsisë së tij.

Përbërja e popullsisë në zonën e programimit të të dyja vendeve tregon se 50% e popullsisë i takon segmentit moshor 15-49 vjeç.

[63] Monstat Census 2011
[64] INSTAT Census 2011

Grafiku 4. Përbërja e popullsisë sipas grupmoshave në zonën e programit_Census i vitit 2011



Zona e programit në të dy vendet ka përjetuar flukse të **migrimit të brendshëm**. Lëvizja e popullsisë drejt rajoneve qendrore dhe bregdetare, të cilat janë gjerësisht më të zhvilluara dhe ofrojnë më shumë mundësi, është e pranishme në zonën e programit. Në **Mal të Zi**, këto modele të migrimit të brendshëm, por edhe të jashtëm, kanë ndikuar në disa prej bashkive në zonën e programit, të cilat regjistrojnë një rritje negative të popullsisë, si Andrijevica me -5.5%, e ndjekur nga Danilovgrad me -1.4% dhe Cetinje me -1.2%[65]. Në zonën e programit në **Shqipëri**, edhe pse pjesa më e madhe e popullsisë banon në zonat rurale, përsëri ka ndryshime të dallueshme të popullsisë. Popullsia rurale në Shkodër dhe Lezhë ka rënë respektivisht me 25.3% dhe 42.67%. Nga ana tjetër, popullsia urbane në Shkodër është tkurrur me 0.28% në vitin 2011, ndërkohë që popullsia urbane në Lezhë është rritur me një normë mbresëlënëse prej 49.4%[66], ndërsa në rrethin e Tropojës ka ruajtur një profil të thellë rural.

Dendësia

Dendësia e popullsisë e regjistruar në zonën e programit në **Mal të Zi** gjithashtu tregon flukset e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm nga zonat më pak të zhvilluara apo zonat rurale, drejt zonave urbane dhe më tërheqëse ekonomikisht. Dendësia e popullsisë së Andrijevicës dhe Cetinjës është shumë e ulët, me 18 banorë për km^2, e ndjekur nga Plava me 27 dhe Danilovgrad me 37 banorë për km^2. Nga ana tjetër, bashkia turistike e Budvës ka dendësinë më të lartë të popullsisë me 157 banorë, e ndjekur nga Podgorica me 129 banorë për km^2. Qytetet bregdetare të Ulqinit dhe Tivarit kanë gjithashtu një dendësi të lartë të popullsisë, me përkatësisht 78 dhe 70 banorë për km^2, duke qenë mbi mesataren prej 45 banorë për km^2 në Mal të Zi. Në zonën **Shqiptare** të programit, dendësia mesatare e popullsisë është 71 banorë për km^2. Dendësia më e lartë e popullsisë vërehet në rajonin e Lezhës, i cili me 83 banorë për km^2 është më afër me mesataren kombëtare prej 97 banorë për km^2, e ndjekur nga Shkodra me një dendësi të popullsisë prej 60 banorë për km^2, ndërsa rrethi i Tropojës regjistron një dendësi shumë të ulët me 19 banorë për km^2. Është njëlloj e rëndësishme si për Malin e Zi ashtu edhe për Shqipërinë që të ndryshojnë ose të frenojnë disi tendencat e migrimit, pasi ato përfaqësojnë një shqetësim dhe një sfidë, veçanërisht kur politikat e zhvillimit mbështeten në turizëm dhe agro-biznes.

Minoritetet

Struktura etnike e zonës së programit ndryshon shumë. Në **Mal të Zi** ka diversitet të madh në popullsi, pasi shumica e saj është e përbërë nga malazezët dhe serbët, e ndjekur nga boshnjakët dhe shqiptarët. Grupet më të mëdha etnike në zonën e programit në Mal të Zi[67] janë Serbët, të cilët përbëjnë 24.8% të popullsisë. Grupi i dytë më i madh minoritar përbëhet nga boshnjakët me 16.3%, dhe grupi i tretë me përqindje më të lartë i përket shqiptarëve me 10.7 %. Në bashkitë bregdetare dhe në bashkinë e Plavës, shqiptarët përbëjnë një minoritet të fortë, ndërsa në bashkinë e Ulqinit ata përbëjnë një shumicë prej 70%. Në **Shqipëri**, prania e grupeve etnike në zonën e programit është e papërfillshme. Shqiptarët etnikë përbëjnë shumicën absolute të popullsisë. Ka

[65] Mal i Zi, Census 2011 60
[66] Shqipëri, Census 2011
[67] MONSTAT, Census 2011

vetëm një komunitet shumë të vogël të malazezëve etnikë në Shkodër, duke zënë rreth 0.13%[68] të popullsisë së përgjithshme të rajonit të Shkodrës.

Varfëria

Kufiri absolut i varfërisë në **Mal të Zi** në vitin 2011 ishte 175,25 Euro për të rritur, duke regjistruar një rritje prej 5 Euro në krahasim me vitin e kaluar 2010[69]. Vulnerabiliteti i popullsisë së Malit të Zi është rritur kohët e fundit, pasi numri i personave nën vijën e varfërisë ka pësuar një rritje nga 6.6% e popullsisë, deri në rreth 9.3% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, në vitin 2011. Rritja e shkallës së varfërisë është shumë më e theksuar në zonat rurale, mesatarisht 18.4%, ndryshe nga zonat urbane ku arrinte mesatarisht 4.4% në vitin 2011. Pabarazia është rritur në Mal të Zi, pasi koeficienti Gini u rrit nga 24.3% në vitin 2010, në 25.9% në vitin 2011[70].

Pabarazitë rajonale janë të dukshme - varfëria është e përhapur në rajonet veriore (mbi 50% e njerëzve të varfër të vendit jetojnë atje) dhe zvogëlohet ndjeshëm në jug, në rajonet qendrore dhe bregdetare.

Kufiri absolut i varfërisë në **Shqipëri** në vitin 2012 ishte 35.2 Euro për të rritur[71]. Varfëria është rritur në Shqipëri, pasi norma e varfërisë në vitin 2012 arriti në 14.3% kundrejt 12.4% të regjistruar në vitin 2008. Vulnerabiliteti i popullsisë së Shqipërisë u rrit në vitin 2012; numri i regjistruar i personave nën vijën e varfërisë u rrit me 8.4%. Varfëria ekstreme ka arritur në 2.2% në vitin 2012, kundrejt 1.2% të regjistruar në vitin 2008.

Gjatë vitit 2012, rritjet në normat e varfërisë në zonat urbane kanë qenë më të shpejta në krahasim me normën e varfërisë në zonat rurale. Numri i personave të varfër në zonat rurale ka rënë me 11.8%, ndërsa numri i personave të varfër në zonat urbane është rritur ndjeshëm me 36.8% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2008. Kjo tregon se popullsia e zonave rurale dhe rajoneve veriore të Shqipërisë ka lëvizur drejt zonave urbane, kryesisht kryeqytetit - Tiranës, dhe në zonat bregdetare - këto të fundit regjistrojnë normën më të lartë të varfërisë në vitin 2012, me një mesatare prej 17.6%.

Rajonet në zonën e programit janë më të varfër në krahasim me mesataren kombëtare të shkallës së varfërisë prej 14.3%. Rajoni i Lezhës regjistron një normë varfërie 17.5%, ndërsa rajoni i Shkodrës është pak më mirë, me një normë varfërie 15.7%. Qarku i Tropojës i përket rajonit më të varfër të Shqipërisë, Kukësit, me një normë varfërie 21.8%. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërsa ripërtëritja e potencialit urban tashmë të përdorur, është bërë e domosdoshme për të sjellë rritjen ekonomike.

2.3.2 Arsimi

Sistemi arsimor në Mal të Zi ka menaxhim të centralizuar, ndërsa në Shqipëri është i decentralizuar me përgjegjësi të përbashkët ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal.

Niveli i pabarabartë arsimor është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për tu larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit. Shkollat private dhe Formimi Profesional janë të pranishme, por nuk janë në gjendje që të përputhen me kërkesat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar dhe të aftë, duke përbërë kështu një pengesë për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Dispozitat arsimore në të gjitha nivelet kërkojnë përmirësim, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tregut të punës. Sistemi arsimor në zonën e programit në të dyja vendet kërkon reforma, veçanërisht përvoja praktike mësimore dhe lidhje me sektorin e biznesit. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore është një përparësi e madhe për të dyja qeveritë, në nivel qendror dhe lokal.

Nevojat për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm janë gjerësisht të mbuluara në zonën e programit të **Malit të Zi**. Mali i Zi ka një mbulim të mirë të territorit me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, duke përfshirë zonat rurale. Zona e programit ka 213 shkolla 9-vjeçare[72] për rreth 44,047 nxënës, dhe 29 shkolla të mesme, të cilat ofrojnë arsimim për rreth 19,881 nxënës. Arsimimi ofrohet në gjuhën

[68] INSTAT, Census 2011

[69] MONSTAT, Analiza e varfërisë në Mal të Zi, në vitin 2011, Publikimi Nr. 329

[70] Banka Botërore, fotografim i programit të vendit

[71] Shqipëria, trended e varfërisë, Shtator 2013, INSTAT-Banka Botërore

[72] MONSTAT, Libri statistikor 2012

malazeze dhe gjithashtu në gjuhën shqipe (në komunat e populluara me shqiptarë etnikë). Numri mesatar i nxënësve për klasë në shkollat 9-vjeçare qëndron në 22.4, ndërsa mesatarja e nxënësve për klasë në shkollat e mesme është 27.7, duke treguar një raport të mirë mësues / nxënës, duke lejuar kështu një proces cilësor të mësimdhënies.

Ekzistojnë 3 Universitete në zonën e programit[73]: Universiteti publik i Malit të Zi me bazë në Podgoricë, i cili ka 20 fakultete dhe 3 institute kërkimore - me degë në Budva dhe Cetinjë; Universiteti Mesdhetar me bazë në Podgoricë; dhe Universiteti Donja Gorica (në periferi të Podgoricës). Të tre Universitetet kanë pasur një numër të përgjithshëm prej 21,134 studentësh gjatë vitit akademik 2012 - 2013, ku 86.4% i përkasin Universitetit publik të Malit të Zi.

Problemet kryesore të sektorit të arsimit në Mal të Zi përfshijnë: nevojën për të përmirësuar infrastrukturën e shkollave; integrimin e pamjaftueshëm të Romëve dhe grupeve të tjera të margjinalizuara në sistemin arsimor; përfshirjen e pamjaftueshme të fëmijëve me nevoja të veçanta; nevojën për të përputhur më mirë kurrikulat me kërkesat e tregut të punës dhe sipërmarrjes; mungesën e burimeve financiare për kërkime shkencore dhe zhvillim.

Mali i Zi shpenzon rreth 0.41% të GDP-së në **Kërkim shkencor dhe Zhvillim**[74]; 58% i përkasin sektorit publik; 27% burojnë nga bizneset private dhe rreth 15% financohen nga projektet e BE dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. 59.4% e studiuesve është e punësuar në arsimin e lartë - pasuar nga sektori i Qeverisë me 32% dhe bizneset me 8%. Kërkimi shkencor dhe Zhvillimi në sektorin jo-fitimprurës llogaritet për vetëm 0.6%.

Zona e programit në **Shqipëri** ka një mbulim të mirë me institucione të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm. Ajo ka një total prej 300 shkolla 9-vjeçare, nga të cilat 222 ndodhen në zonat rurale, duke i shërbyer 54,274 nxënësve, ose 62% të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Gjithashtu ka 72 shkolla të mesme për 16,974 nxënës, nga të cilat rreth 33% ndodhen në zonat rurale.

Ekzistojnë 3 shkolla profesionale në Lezhë dhe 9 në Shkodër, të cilat i shërbejnë një numri të përgjithshëm prej 3,330 nxënësh; vetëm 10.5% e këtyre nxënësve vijnë nga zonat rurale. Ekziston një Universitet në Shkodër, i cili përfaqëson ndoshta qendrën më të rëndësishme të zhvillimit intelektual, social dhe kulturor në zonën e programit - Universiteti "Luigj Gurakuqi", i cili ka 6 fakultete. Janë 14,538 studentë[75] të regjistruar në Universitetin e Shkodrës për vitin akademik 2011 - 2012. Ai ka një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Podgoricës që nga viti 2004. Universiteti ka një Qendër Kërkimore të Ujit [76].

Shqipëria shpenzon rreth 0.02% të GDP-së së saj[77] për **Kërkimin shkencor dhe Zhvillimin**, një shifër tepër modeste e cila është përdorur tërësisht në sistemin publik. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nënshkruar një marrëveshje në lidhje me lëvizjen e studiuesve dhe ekspertëve teknik midis universiteteve partnere; ngritjen e qendrave të përbashkëta kërkimore për të studiuar burimet hidrike të lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës; dhe ngritjen e një qendre të përbashkët për studimet e avancuara për rreziqet sizmike në Ballkanin Perëndimor.

Si përfundim, përmirësimi i sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një prioritet i madh për zonën e programit. Programi BNK do të ketë një rol të kufizuar në adresimin e këtyre çështjeve, por mund të mbështesë shkëmbimet midis shkollave dhe qendrave të formimit profesional në zonat kufitare. Prezenca e universiteteve dhe qendrave kërkimore në të dyja anët e zonës së programit është një pasuri për programin BNK dhe një mundësi jo vetëm për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit akademik, por edhe për inicimin e programeve kërkimore në zonën kufitare në sektorë të ndryshëm, të tillë si bujqësia apo turizmi.

2.3.3 Shëndetësia

Organizimi i sistemit shëndetësor në Mal të Zi dhe Shqipëri është i ngjashëm; ai është kryesisht publik me një prani modeste (por në rritje) private, dhe mbulimi territorial është i pajisur siç duhet me shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të **Malit të Zi** shpreh keqardhjen

[73] MONSTAT, Deklaratat e Arsimit të Lartë 2012

[74] K&Zh në 2011, Zyra Statistikore e Malit të Zi, publikimi Nr. 24

[75] INSTAT, Studentët e regjistruar për secilin universitet 2012

[76] Ajo ka një lidhje direkte me Universitetin e Podgoricës

[77] Shqipëri, Buxheti i Shtetit 2012

për faktin se "sistemi i kujdesit shëndetësor është përshtatur në një masë të madhe vetëm për ofrimin e shërbimeve kurative" dhe përcakton si prioritet forcimin dhe sistemimin e programeve të parandalimit dhe promovimit të shëndetit. Disa tregues të shëndetit (p.sh. norma e vdekshmërisë foshnjore, shkalla e vdekshmërisë së nënave), tregojnë një përmirësim të rregullt në shëndetin publik në Mal të Zi.

Kujdesi shëndetësor parësor në Mal të Zi ofrohet në nivel bashkie dhe të gjitha bashkitë kanë nga një qendër shëndetësore për kujdesin primar. Që nga miratimi i "modelit të mjekut të zgjedhur" numri i personave të siguruar të regjistruar arrin në 83%. Kujdesi shëndetësor dytësor është gjithashtu mjaft i pranishëm në territorin e zonës së programit. Qendra Klinike në Podgoricë shërben si spital i përgjithshëm për Podgoricën, Danilovgradin dhe Kolashinin, duke ofruar edhe kujdesin shëndetësor terciar për të gjithë Malin e Zi. Përveç kësaj, zona e programit ka edhe 3 spitale të tjerë të përgjithshëm (në Tivar, Beranë, dhe Cetinjë) si dhe 2 qendra shëndetësore në Plavë dhe Rozhajë.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në zonën e programit arrin në 3,331 persona[78], ose rreth 61.9% të fuqisë punëtore të përgjithshme të punësuar në sektorin e shëndetësisë në Mal të Zi.

Ngjashëm me Malin e Zi, kujdesi shëndetësor parësor në **Shqipëri** ofrohet në nivel komune dhe bashkie, ndërsa kujdesi shëndetësor dytësor është i vendosur kryesisht në qendrat më të mëdha urbane. Zona e programit ka një rrjet prej 421 institucionesh shëndetësore[79] në sektorin e kujdesit shëndetësor parësor – 46% prej të cilave ofrojnë shërbime në rajonin e Shkodrës, 37% në rajonin e Lezhës dhe 17% në qarkun e Tropojës. Në zonë gjenden 10 spitale; 6 në Shkodër, 3 në rajonin e Lezhës dhe 1 në qarkun e Tropojës.

Kujdesi shëndetësor dytësor është mjaft i pranishëm në rajonin e zonës së programit me një total prej 10 spitalesh. Rajoni i Shkodrës ka 6 spitale: 1 në bashkinë Pukë me 11 mjekë, dhe 5 spitale në Shkodër – duke përfshirë spitalin rajonal të Shkodrës – me 85 mjekë dhe 262 infermierë, ndërsa shërbimet shëndetësore në Malësi të Madhe ofrohen nga 19 mjekë dhe 92 infermierë.

Rajoni i Lezhës ka 3 spitale: 1 në bashkinë Lezhë, 1 në bashkinë Rrëshen dhe 1 në bashkinë Laç. Numri i përgjithshëm i mjekëve në rajonin e Lezhës shkon në 83, të mbështetur nga 341 infermierë.

Qarku i Tropojës ka 1 spital në bashkinë Bajram Curri; spitali ka 13 mjekë të mbështetur nga 134 infermierë.

Në përgjithësi, shërbimet shëndetësore në Shqipëri janë duke u përmirësuar, por duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar akses universal në shërbime të tilla edhe nga familjet e varfra. Sfida kryesore e radhës për të garantuar që të gjithë qytetarët janë të pajisur me shërbimet e duhura shëndetësore është heqja e pengesës ekonomike për të pasur akses në shërbimet cilësore, e cila është e rënduar nga mungesa totale e sigurimit shëndetësor.

2.3.4 Kultura

Në përgjithësi, në zonën e programit kultura karakterizohet nga elemente të ndryshme të traditave individuale dhe të përbashkëta. Qendrat turistike dhe qytetet e mëdha janë të pasura me trashëgimi kulturore që përfshijnë monumente dhe vende fetare (kisha, manastire dhe xhami), qytete të vjetra, vende arkeologjike dhe muzeume të ndryshme. Zona e programit është gjithashtu e pasur në traditën e kuzhinës dhe artizanatit, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit. Bashkëpunimi ndërkufitar mund të luajë rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie, si dhe në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të bashkëpunimit rajonal midis dy vendeve. Investimet dhe subvencionet e kufizuara publike kanë mbajtur një nivel të ulët të aktiviteteve kulturore në zonën e programit, pavarësisht trashëgimisë së saj të pasur. Megjithatë, aktivitetet kulturore dhe kontaktet mund të intensifikohen, duke krijuar kështu një bazë për një bashkëpunim ndërkufitar më aktiv. Kjo krijon kushte të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të nismave të përbashkëta që synojnë shtimin e vlerës në trashëgiminë e përbashkët në të dyja anët e zonave kufitare.

Zona e programit në **Mal të Zi** përmban një shumëllojshmëri të besimeve fetare, traditave, dhe kulturave. Zona përmban popullsi me kombësi të

[78] Instituti i Shëndetit Publik i Malit të Zi 2011

[79] Rajonet Shkodër dhe Lezhë, Buletini Statistikor 2012

përzier (malazezët, serbët, shqiptarët, boshnjakët), me një histori të gjatë të të qenurit të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Një histori dhe traditë e tillë krijon një terren të mirë për iniciativat ndërkufitare, pasi marrëdhëniet ndërkufitare dhe lidhjet kulturore janë të rrënjosura thellë në mendësinë e popullsisë në zonën e programit.

Në Shqipëri, zona e programit është e pasur në trashëgimi kulturore. Përveç kalasë së famshme të Rozafës, në Shkodër ka disa muzeume, një numër të konsiderueshëm të vendeve arkeologjike dhe atraksione turistike të lidhura me trashëgiminë kulturore të rajonit dhe qytetit. Lezha, një park arkeologjik që prej vitit 2005, ka gjithashtu rrënojat e kalasë së saj, të cilat dominojnë qytetin, së bashku me atraksione të tjera si muzetë dhe kishat, të cilat mund të gjenden në rajon. Monumenti më i rëndësishëm në rajonin e Lezhës është memoriali i heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriot Skënderbeu, i vendosur mbi rrënojat e kishës së lashtë ku u themelua Lidhja Shqiptare për të luftuar otomanët në vitin 1444 në qytetin e Lezhës.

2.3.5 Shoqëria Civile

Në **Mal të Zi** janë 5,843[80] Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) të regjistruara. Pjesa më e madhe e tyre janë shoqata qytetare (5665), dhe 175 janë fondacione. OSHC-të me më shumë ndikim dhe përvojë janë të vendosura në Podgoricë, aktive në sektorë të ndryshëm (të drejtat e njeriut, politikat publike, mjedisi dhe zhvillimi rural, ngritja e kapaciteteve, aftësitë e kufizuara, etj.). Shumica e tyre kanë një përvojë në përcaktimin e projekteve BNK. Në rajone të tjera dhe veçanërisht në rajonin verior, situata e OSHC-ve është më e pasigurt. Kapacitetet njerëzore dhe kapacitetet e financimit janë përgjithësisht të pamjaftueshme; partneriteti me autoritetet lokale, si dhe krijimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve janë ende të dobëta. Megjithatë, rrjeti lokal i organizatave komunitare është i shumëllojshëm dhe i pasur. Disa prej tyre, të tilla si shoqatat e malësorëve, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e nismave BNK.

Sektori i OSHC-ve në **Shqipëri** është i vogël dhe relativisht i pazhvilluar. Zyrtarisht ekzistojnë 2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra të regjistruara[81]. Pjesa më e madhe e OSHC-ve janë të përqendruara në kryeqytet (Tiranë), ose në rajonin qendror (i cili përfshin Tiranën dhe qytetet e mëdha të tilla si Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça). Shoqëria civile është e përfaqësuar dobët në të gjitha zonat rurale. Aktivitetet kryesore të OSHC-ve bazohen tek advokimi dhe kërkimi në fushat e promovimit të të drejtave të njeriut, mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve, demokracisë dhe qeverisjes së mirë, si dhe kërkimeve dhe advokimit mbi politikat, dhe zhvillimit ekonomik. Aksesi në financimet qeveritare dhe private është i kufizuar. Sektori i Shoqërisë Civile në Shqipëri, si një i tërë, është pak i integruar dhe përfaqësuar. Nuk ka asnjë forum të sektorëve të gjerë ose rrjet që i dedikohet koordinimit të përpjekjeve të OShC-ve.

2.4 INFRASTRUKTURA

Mali i Zi dhe Shqipëria janë pjesë e SEETO[82] – Rrjeti kryesor. Linja më e rëndësishme në këtë zonë është rruga që lidh Podgoricën me Shkodrën nëpërmjet Bozaj -Hani Hotit, e cila është pjesë e Rrjetit Evropian të Rrugëve thelbësore.

Pozicioni i zonës së programit thekson rëndësinë e një infrastrukture të mirë transporti në zhvillimin e ardhshëm të turizmit, tregtisë, shkëmbimeve kulturore dhe në rritjen e konkurrencës. Infrastruktura rrugore që lidh Malin e Zi dhe Shqipërinë, në veçanti përmes akseve Sukobinë - Muriqan dhe Bozaj - Hani i Hotit është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Edhe infrastruktura e shërbimeve nga këto pika të kalimit kufitar është përmirësuar, duke lejuar komunikimin më të shpejtë midis dy zonave, duke lehtësuar kështu transportin, tregtinë dhe turizmin. Pika e tretë kufitare në Gjercan - Plavë është më pak e zhvilluar. Një pikë e katërt e kalimit kufitar në Cijevna Zatrijebačka -Triesh, do të krijohet pas përfundimit të ndërtimit të rreth 23 km rrugë brenda territorit shqiptar, e cila është në ndërtim e sipër me financim të BERZH. Ajo do të shkurtojë ndjeshëm kohën e udhëtimit nga Plava në Podgoricë (koha e udhëtimit e pritur nëpër territorin shqiptar do të jetë rreth gjysmë ore).

Rrugët

[80] Raporti i vlerësimit të nevojave për Malin e Zi nga TACSO. Nuk dihet se sa prej tyre janë aktive

[81] Vlerësimet e fundit të shoqërisë civile dhe vëzhgimet intensive nga Zyra e Projektit TACSO në Shqipëri vlerësojnë se numri i përgjithshëm i OSHC-ve aktive nuk i kalon 450

[82] Observatori i Transportit Jug-Lindor. Korridoret e rrugëve & Lidhjet përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjen, Kroacinë, Kosovën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë, Malin e Zi

Në **Mal të Zi** nuk ka autostrada; rrugët kryesore të vendit janë rrugë të tipit me një karrexhatë. Lidhjet midis Podgoricës dhe qyteteve bregdetare janë përmirësuar ndjeshëm, kohët e udhëtimit janë bërë më të shkurtra dhe rrugët janë bërë më të sigurta me përfundimin e tunelit Sozina (koha e udhëtimit nga Podgorica në Tivar, gjysmë ore) dhe përmirësimet e shumta të rrugëve në drejtim të Cetinjës dhe Tivarit. Megjithatë, rrjeti i rrugëve sekondare dhe rurale, i menaxhuar nga bashkitë, kërkon përmirësime pasi shpesh është në gjendje të keqe.

Në zonën **shqiptare** të programit, infrastruktura e rrugëve është përmirësuar ndjeshëm në 5 vitet e fundit, edhe pse Tropoja ka ende nevojë për përmirësime në rrjetin e saj rrugor. Transporti i mallrave dhe i njerëzve tani është më i lehtë dhe më i shpejtë. Të udhëtosh nga Tirana për në Lezhë dhe Shkodër nuk merr më shumë se 120 minuta; një pjesë e kësaj rruge i përket autostradës Durrës-Kukës - "Rruga e Kombit", e cila lidh Shqipërinë me Kosovën.

Transporti Hekurudhor

Mali i Zi dhe Shqipëria kanë rënë dakord për të integruar procedurat e organizimit të **transportit hekurudhor** midis dy vendeve. Një hekurudhë kalon përmes zonës së programit nga Podgorica në Shkodër, me një gjatësi prej rreth 63.5 km; ajo është përdorur vetëm për transportin e mallrave, pasi linja nuk është e elektrizuar. E njëjta hekurudhë lidh Tiranën me Shkodrën, nëpërmjet Lezhës. Duke qenë se zhvillimi i infrastrukturës është fokusuar kryesisht në rrjetin rrugor, rrjeti hekurudhor ka marrë pak vëmendje nga qeveritë përkatëse, duke çuar në përkeqësimin e kushteve fizike të kësaj hekurudhe ndër vite. Planet e ardhshme përfshijnë elektrifikimin e saj, të paktën në anën e Malit të Zi, si dhe përdorimin e kësaj hekurudhe edhe për transportin e udhëtarëve, duke miratuar komunën urbane të Tuz-it, një nënndarje të Komunës së Podgoricës, si stacion të përbashkët kufitar.

Transporti Ajror dhe Detar

Aeroporti i Podgoricës në Mal të Zi është i vetmi aeroport në zonën e programit. Në zonën e programit në **Mal të Zi** gjendet **porti** i Tivarit, më i madhi në Mal të Zi, si dhe molet në Budva dhe porti i vogël i Ulqinit.

Në zonën e programit në **Shqipëri** është porti i Shëngjinit (qarku i Lezhës), i cili i shërben nevojave të pjesës veriore të Shqipërisë për transportin detar.

Telekomunikacioni

Telekomunikacioni në zonën e programit përfiton si nga telefonia fikse, ashtu edhe nga ajo celulare. Telefonia fikse në **Mal të Zi** është plotësisht e dixhitalizuar. Numri i abonentëve është rreth 1.700.856[83] duke korresponduar me një normë prej 27,55%. Tregu i telefonisë celulare ka tre operatorë telekomunikacioni. Në vitin 2012, tre kompanitë celulare raportuan një total prej 990,868 përdoruesish, që korrespondon me një normë prej 159%.

Në **Shqipëri**, niveli i depërtimit të telefonisë fikse dhe celulare në zonën e programit qëndron në 88.15%[84], pak nën mesataren kombëtare prej 89.47%. Megjithatë, me përjashtim të qyteteve kryesore, depërtimi i telefonisë fikse në zonat rurale është i ulët; komunikimi është i bazuar kryesisht në telefonat celularë. Ekziston një ofrues kombëtar i telefonisë fikse, ndërkohë që ka 4 operatorë celularë. Niveli i depërtimit të telefonisë celulare në Shqipëri është mbi 130%.

Teknologjitë e Informacionit

Njohuritë kompjuterike në **Mal të Zi**[85] i përkasin mesatarisht 35% të popullsisë nga 15 vjeç e lart. Rreth 16% e popullsisë ka njohuri të pjesshme mbi kompjuterin. Përqindja më e madhe e njohjes së kompjuterit në zonën e programit është hasur në Budva me 46%, në Podgoricë 41%, ndërsa më e ulëta është në Andrijevica me rreth 18%. Njohuritë kompjuterike janë më të larta midis popullsisë më të re, dhe ato bien me rritjen e moshës.

Në **Shqipëri**, niveli i përdorimit të internetit (që do të thotë se ka një kompjuter që përdoret për të hyrë në internet) në familjet në zonën e programit qëndron në 9.97%, i cili është nën mesataren kombëtare prej 12.35%.

Energjia

Energjia është e disponueshme në të gjitha bashkitë në zonën e programit në **Mal të Zi**. Shumica e nevojave energjetike plotësohen nëpërmjet importeve – e gjithë nafta dhe derivatet

[83] Agjencia për Komunikimet Elektronike dhe Shërbimet Postare, Raporti Vjetor 2011

[84] Shqipëria, Census 2011

[85] MONSTAT, Popullsia sipas njohjes kompjuterike për bashkitë në Mal të Zi në vitin 2011, publikimi Nr. 156

importohen, ashtu si dhe një e treta e konsumimit të elektricitetit. Madhësia e tregut të energjisë elektrike është rreth 3.720G Wh/ vit, nga të cilat 28.2% janë të importuara, duke treguar një nivel të moderuar të shfrytëzimit të potencialit të vet hidroenergjetik.

Kapaciteti aktual i instaluar në **Shqipëri** është 1,726 MW[86], një normë shfrytëzimi e vetëm 35% të potencialit të saj hidroenergjetik. Pjesa më e madhe e energjisë hidrike të vendit, rreth 52.3%, gjenerohet në zonën e programit, i cili ka tre hidrocentralet më të mëdha të Shqipërisë: Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës me kapacitet prej 1,350 MW në total. Impianti i Hidrocentralit të Ashtës me kapacitet të instaluar prej 53 MW u vu në punë në shtator 2012. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike në vitin 2012 në Shqipëri arriti në 4,288GWh, duke mbuluar vetëm 57% të konsumit të saj vjetor, dhe duke e bërë kështu Shqipërinë një rrjet importues të energjisë. Përfundimi i linjës ndërlidhëse 400 kv midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (Elbasan-Podgoricë), rrit kapacitetet e shkëmbimeve të energjisë midis dy vendeve dhe lidh Shqipërinë me rrjetet rajonale dhe Evropiane, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend. Edhe pse ka burime të mëdha, por ende të pashfrytëzuara hidrocentrale, Shqipëria karakterizohet nga një efikasitet i ulët në përdorimin e energjisë elektrike. Përdorimi i energjisë për qëllime ngrohje është i përhapur në shkallë të gjerë.

Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimet

Shumica e familjeve (247,354) në **Mal të Zi** përdorin ujin nga sistemi publik i ujit, edhe pse sistemi publik i ujit mund të jetë i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe gjatë kohës së verës. Nga numri i përgjithshëm i banesave[87], 92% prej tyre kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë brenda shtëpive të tyre, dhe po i njëjti numër banesash është i lidhur me sistemin e kanalizimit brenda shtëpisë. Në zonën e programit, Budva ka shkallën më të lartë të aksesit në sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, me një mesatare prej 99%, ndërsa Andrijevica ka normën më të ulët të aksesit në këto dy shërbime, mesatarisht 76%.

Në zonën e programit në **Shqipëri**, furnizimi me ujë dhe sistemet e kanalizimit dhe ujitjes mbeten problematike. Aksesi në ujë brenda banesave për rreth 106,094 familje[88] në zonën e programit është i siguruar për vetëm rreth 55.4% të tyre; rreth 39.5% e banesave kanë akses të pjesshëm në sistemet e furnizimit me ujë, ndërsa 5.1% e familjeve në zonën e programit nuk kanë akses në sistemin e ujësjellësit. Numri i familjeve pa akses në sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve është më i lartë në Shkodër me 1.13%, e pasuar nga Lezha me vetëm 0.98%, ndërsa rrethi i Tropojës regjistron 0.75% - duke qenë më mirë se mesatarja kombëtare me 1.12%. Përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë janë të nevojshme për të ruajtur dhe për të nxitur nivele të qëndrueshme të turizmit, si dhe për të zvogëluar pabarazitë rajonale.

2.5 MJEDISI

Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit janë të rëndësishme për një zhvillim të qëndrueshëm të zonës së programit, e cila është mjaft e pasur në burime mjedisore dhe biodiversitet në të dyja anët e kufirit. Zona e programit është shumë e pasur në burime natyrore dhe biodiversitet. Megjithatë ka disa faktorë që kërcënojnë burimet mjedisore në zonën e programit, të tillë si; shpyllëzimi për shkak të rënies së pakontrolluar të pemëve; menaxhimi i varfër i ujit dhe i ujërave të zeza; largimi i pakontrolluar i mbeturinave; urbanizimi i parregulluar; ndotja industriale në disa zona; vend-groposjet e paligjshme, të cilat rrezikojnë ndotjen e lumenjve dhe liqeneve; përdorimi intensiv i pesticideve, i cili po dëmton bujqësinë; peshkimi i tepruar dhe gjuetia e jashtëligjshme, të cilat kërcënojnë faunën në liqene dhe lumenj. Degradimi i tokës është i pranishëm në të dyja anët e kufirit.

Mali i Zi ka një diversitet të lartë biologjik, për shkak të sfondit të tij gjeologjik, klimës dhe pozicionit në afërsi të detit dhe maleve. Mali i Zi ka dy vende të Trashëgimisë Botërore, një rezervë të biosferës dhe pesë parqet kombëtare. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit është një shtyllë e të gjitha strategjive të zhvillimit të vendit. Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura të Malit të Zi mbulon 108,866 ha[89] ose 7.88% të territorit të përgjithshëm. Ajo

[86] ERE – Raporti Vjetor 2012

[87] MONSTAT. Banesat sipas pajisjes me instalime, Publikimi Nr. 280

[88] Census 2011, INSTAT Treguesit e ndërtesave dhe banesave sipas prefekturave

[89] MONSTAT, Libri statistikor 2012

përbëhet nga 5 parqe kombëtare - Liqeni i Shkodrës, Durmitor, Lovćen, Biogradska Gora, dhe Prokletije. Zona e programit është e pasur në burime natyrore dhe përmban katër parqe kombëtare në zonën e programit të Malit të Zi:

Liqeni i Shkodrës ndodhet në bashkitë e Podgoricës dhe Tivarit. Një e treta e liqenit i përket Shqipërisë. Pjesa e Malit të Zi (rreth 40.000 hektarë) është renditur si një Park Kombëtar në vitin 1983. Si liqeni më i madh në Ballkan, ai është jashtëzakonisht i pasur me zogj dhe peshq, si dhe me bimësi kënete. Liqeni i Shkodrës është në listën e zonave lagunore të rëndësishme në nivel ndërkombëtar, si habitat ujor dhe i zogjve migratorë (Konventa e Ramsarit).

Biogradska Gora është i rrethuar nga bashkitë Andrijevice, Berane, Kolashin, dhe Mojkovac. Parku Kombëtar u shpall në vitin 1952 dhe mbulon 54 km^2. Ai është i njohur për pyjet e tij të paprekur (midis pyjeve të fundit primarë në Evropë), diversitetin e madh të florës dhe faunës dhe për gjashtë liqenet e tij akullnajore, duke përfshirë Liqenin e famshëm Biogradsko.

Lovćen është një park kombëtar në zonë malore që gjendet në bashkitë Budva dhe Cetinje, dhe mbulon një sipërfaqe prej 6220 hektarësh.

Prokletije është një varg malor që shtrihet nga Shqipëria veriore, në Kosovën jug-perëndimore dhe në zonën lindore të Malit të Zi. Si një vend natyror i paprekur dhe i jashtëzakonshëm, ai u shpall një Park Kombëtar në Mal të Zi në vitin 2009 (Parku mbulon rreth 210 km^2, kryesisht në bashkitë Plavë dhe Guci). Ai është Parku i fundit Kombëtar i listuar në Mal të Zi. Për këtë arsye, njësia e menaxhimit të parkut nuk është themeluar ende.

Industria dhe bujqësia nuk janë ndotës të mëdhenj në zonën e programit, edhe pse nivelet e fluorit në Podgoricë tejkalojnë kufijtë e lejuar 3-6 herë gjatë vitit. Ndërkohë ekziston një nevojë e përgjithshme për rinovimin teknologjik. Kërcënimet kryesore për mjedisin janë të lidhura me mungesën e sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura (Podgorica është pjesërisht e pajisur me impiante të trajtimit të ujërave të zeza) dhe vend-groposjeve të përshtatshme për mbetjet e ngurta. Disa projekte investimi të bashkë- financuar nga BE-ja ose të mbështetur nga bankat evropiane janë planifikuar dhe duhet të përmirësojnë këtë situatë.

Në **Shqipëri**, zona e programit ofron një biodiversitet dhe klimë të pasur, pasi ajo përfshin malet, kodrat, fushat, liqenin, lumenjtë dhe bregdetin. Ajo ka 8 parqe kombëtare[90], rezerva natyrore dhe peizazhe të mbrojtura, të cilat mbulojnë mbi 13% të territorit të përgjithshëm. Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë të pranishme në të dy rajonet e zonës shqiptare të programimit. Qarku Tropojë mbulohet nga

Agjencia Rajonale e Mjedisit e Rajonit të Kukësit.

Në qarkun e Shkodrës ndodhen tre parqe kombëtare - Parku kombëtar i Thethit, i cili ndodhet në zonën malore në kufi me Malin e Zi; Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna, të cilat janë cilësuar si vende Ramsar. Parku më i rëndësishëm natyror në zonën e programit është Liqeni i Shkodrës. Bashkëpunimi midis dy vendeve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit të Shkodrës është rritur në dekadën e fundit. Zonat e mbrojtura në qarkun e Lezhës përfshijnë Berzanën, Kune-Vain-Tale, dhe Patok-Fushëkuqe- Ishëm, të cilat janë të gjitha Burime Natyrore të Menaxhuara. Qarku i Lezhës gjithashtu përfshin 4.745 ha peizazhe të mbrojtura. Zona e mbrojtur më e rëndësishme në qarkun e Lezhës është Kune-Vain-Tale, një kompleks lagunash me ishullin e rërës së Kunes prej 125 ha në të djathtë të deltës së lumit Drin. Kjo zonë ka një florë të pasur dhe përmban rreth 70 lloje shpendësh, 22 lloje zvarranikësh (nga 33 që janë në nivel kombëtar) dhe gjithashtu 6 lloje amfibësh nga një total prej 15 në nivel kombëtar.

Qarkut i Tropojës ka një Park Kombëtar që nga viti 1996, dhe 29 zona të mbrojtura që nga viti 2002. Parku Natyror i Luginës së Valbonës është zona më e rëndësishme e qarkut, pasi ajo përfshin një sipërfaqe prej 8000 ha.

Ndryshimet sociale dhe ekonomike të viteve të fundit si dhe ndryshimet demografike në Shqipëri dhe Mal të Zi, kanë ushtruar presion mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit në zonën e programit. Dëmet e dekadës së kaluar janë të dukshme në zonën e pyjeve, për shkak të ndërhyrjeve të popullsisë lokale. Shumica e dëmit ka ardhur për shkak të prerjeve abuzive dhe mbi-kullotjes. Mbrojtja e burimeve natyrore me fokus tek pyjet, zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i

[90]Shqipëria, Ministria e Mjedisit, Rrjeti i zonave të mbrojtura në Shqipëri, Shtator 2013

burimeve ujore përfaqësojnë vlerat ekonomike dhe mjedisore për këtë zonë. Megjithëse ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit është rritur, një shkallë më e lartë e zbatimit të standardeve për mbrojtjen e mjedisit është e nevojshme për të siguruar zhvillimin e duhur urban dhe zgjerimin e turizmit. Reduktimi i ndotjes ekzistuese, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimit të një mjedisi të pastër, i lidhur me masat për të mbrojtur tokën nga shkatërrimi natyror dhe artificial si dhe zbatimi i një procesi strategjik të planifikimit urban, janë sfidat kryesore për tu përballuar në zonën e programit.

2.6 MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Mali i Zi është i ndarë në 23 bashki, si njësi bazë të qeverisjes vendore.

Objektivat e vendit përfshihen në një numër të strategjive, të cilat vënë në dukje prioritetet zhvillimore që mund të shërbejnë si fushat e ndërhyrjes për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar. Strategjitë më të lidhura me qëllimet e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar janë:

-Drejtimet e zhvillimit të Malit të Zi 2013 – 2016;

-Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Malit të Zi (2007);

-Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2010 – 2014;

-Strategjia për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 2011-2015;

-Strategjia për Bujqësinë (2014-2020);

-Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore 2012-2015;

-Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Profesional në Mal të Zi 2010-2014.

Pushteti lokal në **Shqipëri** përbëhet nga dy nivele: niveli i parë përbëhet nga 374 njësi të qeverisjes vendore (NjQV) të ndara në 65 bashki në zonat urbane dhe 309 komuna në zonat rurale, të cilat mund të ndahen më tej në fshatra (3020); niveli i dytë përbëhet nga 12 rajone (*qarku*). Strategjitë më të lidhura me qëllimet e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar janë:

-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

-Strategjia Kombëtare ndër-sektoriale për Zhvillimin Rajonal 2007;

-Kuadri Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Shkodrës 2010 – 2016;

-Kuadri Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Lezhës 2010 – 2016.

1	Konkurrenca, zhvillimi i biznesit dhe NVM- ve, tregtia dhe investimet	-
2	Punësimi, Lëvizja gjeografike e punonjësve, dhe Përfshirja sociale	- "Konkluzionet e Malit të Zi" dokument i nënshkruar gjatë Forumeve të Konferencës së tretë Ministrore mbi Punësimin dhe Politikat Sociale në Evropën Juglindore, në 26.10.2007.
3	Kërkimi shkencor, Zhvillimi dhe Inovacioni Teknologjik dhe TIK	- Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Malit të Zi për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik, nënshkruar më 16.12.2008.
4	Mbrojtja e Mjedisit, Ndryshimet Klimatike dhe Parandalimi i rrezikut	- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Malit të Zi mbi problemet e ujit. Statuti i Komisionit të përbashkët ndër-qeveritar Shqiptaro-Malazez në trajtimin e kufijve ujor dhe Protokolli i mbledhjes së këtij Komisioni nënshkruar më 31.10.2001, hyrë në fuqi më 13 Shkurt 2003. - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për shfrytëzimin e LTL 400 KV, nënshkruar më 02.07.2004. - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi zhvillimin ndërkufitar të liqenit të Shkodrës, nënshkruar më 26.05.2006. - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Malit të Zi, nënshkruar më 14.12.2010, hyrë në fuqi në të njëjtën ditë.

5	Transporti dhe Infrastrukturat publike	- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi mbi vendosjen e qarkullimit të përhershme ndërkombëtar nëpërmjet pikës kufitare Han i Hotit-Bozhaj, nënshkruar më 24.01.2000. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, nënshkruar më 02.07.2000 dhe hyrë në fuqi më 11.11.2004. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për krijimin e linjës ndërkombëtare të liqenit për udhëtarët, Shkodër-Virpazar, nënshkruar në Podgoricë më 02.07.2004. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për marrëdhëniet reciproke për çështjet doganore, nënshkruar më 23.12.2005, hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2007. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi organizimin e trafikut hekurudhor ndërmjet dy vendeve, nënshkruar më 16.05.2006. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Murriqan-Sukobinë, e nënshkruar më 17 janar 2007. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit kufitar hekurudhor ndërmjet dy vendeve, të nënshkruar në Podgoricë, më 03.08.2012.
6	Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore	- Marrëveshja mbi bashkëpunimin kulturor ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Sporteve dhe Medias të Malit të Zi, nënshkruar më 28.02.2001, dhe hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit. - Marrëveshja për bashkëpunimin kulturor ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Sporteve dhe Medias të Malit të Zi, nënshkruar më 10.11.2009, dhe hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit.
7	Rinia dhe arsimi	-
8	Qeverisja Lokale dhe Rajonale, Planifikimi dhe Administrimi i Ngritjes së Kapaciteteve	-

3.7. KONKLUZIONE

Zona e programit është e ndryshme, e megjithatë, disa tipare të përbashkëta në lidhje me natyrën, pozicionin gjeografik, tendencat demografike, ekonominë, kapitalin njerëzor etj., mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave BNK.

Karakteristikat ekonomike të të dy vendeve tregojnë tendenca të ngjashme. Të dy vendet janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesatare nga Banka Botërore. Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje shumice dhe pakice, rajonet malazeze shfaqin industri më të zhvilluar, dhe një niveli shumë më të zhvilluar të turizmit. Përgjithësisht, bujqësia është e rëndësishme për të dyja palët.

Konkurrenca është e ulët në të dyja anët e kufirit. Produktivitet më i lartë dhe investime të mëtejshme në njohuritë mbi përdorimin e teknologjive të inovacionit është një parakusht për t'u bërë më konkurrues si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Zakonisht, bizneset në zonat kufitare shfrytëzojnë mundësitë për tregti përtej kufirit dhe në arenën ndërkombëtare, por tregtia ndërmjet dy vendeve dhe palëve të treta është ende e kufizuar nga barrierat e shumta administrative.

Forcimi i rrjeteve të NVM-ve dhe lidhjet e shërbimeve ekzistuese në zonat kufitare janë një potencial që përdoret shumë pak. Mbi 97% e NVM-ve të regjistruara punësojnë më pak se 4 persona. Niveli i bashkëpunimit përtej kufirit është minimal. Promovimi i biznesit virtual do të jetë i rëndësishëm. Me pak fjalë, në aspektin e zhvillimit të sektorit privat ka sinergji të qarta për t'u zhvilluar brenda zonës së programit, të cilat duhen mbështetur nga programi i bashkëpunimit ndërkufitar.

Të dyja anët e zonës së programit janë duke u bërë gjithnjë e më tërheqëse për investitorët

e huaj, por tek të dyja anët ka nevojë për përmirësimin e kushteve, veçanërisht të infrastrukturës, për të bërë biznes. Investimet në turizëm, në energjinë e rinovueshme dhe në bujqësi mund ti bëjnë këto të fundit sektorët potencialë për tërheqjen e më shumë IHD-ve (Investime të Huaja Direkte). Industritë e përpunimit të dritës dhe ushqimit janë konsideruar gjithashtu si një potencial për rritjen e përshpejtuar ekonomike të zonës së programit.

Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por përdoret pak. Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit, dhe pronat e vogla bujqësore kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese. Përmirësimi i aksesit në treg dhe forcimi i sistemit të sigurisë ushqimore dhe organeve inspektues do të jenë të rëndësishme për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë. Ndërhyrja e ardhshme duhet të synojë përmirësimin e efikasitetit në bujqësi dhe pylltari, si dhe të zhvillojë burime shtesë të të ardhurave nga ruajtja e pasurive natyrore dhe turizmit.

Papunësia mbetet një problem i mprehtë për popullsinë e zonës së programit, veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale siç janë të rinjtë, popullsia rurale, dhe gratë. Pasiguria e punësimit konsiderohet si arsyeja kryesore për shkallën e lartë të migracionit, veçanërisht në zonat rurale ose më pak të zhvilluara, ku niveli i papunësisë është i lartë si rezultat i mjeteve të jetesës dhe prodhimeve bujqësore të një niveli të ulët që ofrojnë një formë të sigurimit shoqëror për pjesën më të madhe të popullsisë rurale dhe të punës, si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshëm të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit mbështetur kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, kontrolli i ndotjes, dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar nga planet zhvillimore qeveritare dhe lokale. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës, veçanërisht në anën shqiptare të kufirit.

Infrastruktura e varfër është një sfidë kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së programit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në një rritje të përgjithshme të pasurisë në zonën e programit. Zhvillimi i infrastrukturës që lehtëson biznesin dhe përhapjen e rrjeteve dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin dhe inovacionin e biznesit, mund të kontribuojë në një rritje të përgjithshme të pasurisë dhe ekonomisë në zonë.

Zona e programit ka potencial të lartë turistik, por këto mundësi janë përdorur kryesisht në anën e Malit të Zi, ndërsa turizmi në anën e Shqipërisë është zhvilluar pak, pavarësisht potencialit të madh që ka. Iniciativa BNK me qëllim për të prodhuar një ofertë të përbashkët turistike, duhet të konsiderohet. Sinergji të dukshme, me mundësi që të mbështeten nga bashkëpunimi ndërkufitar (programi BNK), mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi, por edhe me "zonat më pak turistike" në veri-lindje të Malit të Zi, të cilat kanë karakteristika të ngjashme me veriun e Shqipërisë, në aspektin e mjedisit, natyrës së egër dhe maleve.

Ekziston një trashëgimi e pasur historike-kulturore-artistike në zonën në kufi, e cila duhet të ruhet. Vleftësimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Bashkëpunimi midis institucioneve kulturore është i pranishëm, por ai mund të intensifikohet akoma më tej.

Përmirësimi i cilësisë së sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një sfidë dhe prioritet për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale. Prezenca e universiteteve të rëndësishme private dhe publike si dhe e qendrave kërkimore të biznesit në zonën e programit është një pasuri për programin BNK. Veprime të mëtejshme të përbashkëta do të mund të ndërmerren për të krijuar rrjetin e qendrave të

formimit profesional si dhe të institucioneve të larta, agjencive dhe organizatave kërkimore.

Në përgjithësi, **sektori i shëndetësisë** është i dobët dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Mungesa e një kuadri të duhur ligjor për sigurimin shëndetësor në zonat rurale (në anën shqiptare të kufirit), vazhdon të pengojë zhvillimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh se sektori i shëndetësisë menaxhohet në nivel qendror, ndoshta nuk mund të bëhet shumë në kuadrin e programeve BNK, por sigurisht që ka vend për aktivitete të mundshme të përbashkëta që lidhen me fushatat parandaluese dhe edukimin shëndetësor.

Inkurajimi i rrjeteve rajonale të OShC-ve (duke përfshirë organizatat e sportit, rinisë dhe ato kulturore) mund të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e kufirit në këtë zonë të programit shumë-etnik.

Depërtimi i kërkimit shkencor & zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është në disproporcion të dukshëm midis vendeve të programit, dhe mbetet në nivel të ulët. Investimet e pamjaftueshme, mungesa e aktiviteteve mbështetëse në nivel qendror, rajonal ose lokal për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, janë të pranishme, pavarësisht faktit që në zonën e programit ka 4 Universitete. Nuk ka të dhëna specifike mbi kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin, por praktikisht mungon bashkëpunimi midis institucioneve edukuese në të dy vendet, dhe kjo fushë është e pa eksploruar.

Në përgjithësi, qeveritë lokale dhe rajonale janë të dobëta financiarisht dhe nuk mund të nxisin zhvillimin lokal. Ndryshe nga Shqipëria, Mali i Zi nuk ka qeverisje lokale. Atyre iu mungojnë aftësitë menaxhuese, të kontrollit financiar dhe buxhetimit, si dhe qasjet demokratike në proceset vendim-marrëse. Absorbimi i fondeve të BE-së është i ulët. Bashkëpunimi midis qeverive lokale ndërmjet dy vendeve mund të përmirësohet. Procesi i decentralizimit është duke vazhduar në të dy vendet.

4. ANALIZA SWOT

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
RRITJA E KONKURRENCËS, ZHVILLIMI I BIZNESIT DHE NVM-ve, TREGËTIA DHE INVESTIMET	•Marrëveshja e tregtisë së lirë midis dy vendeve. Të dy vendet marrin pjesë në CEFTA; •Klima e favorshme e biznesit dhe taksat e korporatave. Kuadri i përgjithshëm ligjor dhe institucional, i cili favorizon tërheqjen e investimeve të Huaja Direkte; •Protokolli ekzistues i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ekzistenca e Forumit Ekonomik Rajonal ndërmjet Rajonit të Shkodrës dhe Malit të Zi •Një numër i madhe dhe në rritje i NVM-ve në të gjithë rajonin me aktivitete të shumëllojshme; •Burimet natyrore, Liqeni i Shkodrës, si dhe trashëgimia kulturore si potencial për zhvillimin e turizmit; •Mbulimi relativisht i mirë i zonës së programit me universitete dhe qendra të formimit profesional; •Ekzistenca e inkubatorëve të biznesit (Mal i Zi) dhe agjencive rajonale të zhvillimit (Shqipëri); •Rritja e investimeve në infrastrukturë me qëllim për të mbështetur zhvillimin e industrisë së turizmit në zonat përreth Liqenit të Shkodrës.	•Konkurrenca e ulët e bizneseve , produktiviteti i ulët dhe njohuri të pamjaftueshme; •Migrimi dhe largimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore të kualifikuar; •Ekspozimi i kufizuar në tregjet ndërkombëtare; •Organizimi në shkallë të ulët i bujqësisë dhe produktiviteti i ulët i aktiviteteve të agrobiznesit; •Kultura e kufizuar e sipërmarrjes, e dominuar nga tregtia afatshkurtër dhe aktivitetet e shërbimit më shumë sesa nga investimet kapitale afatgjata; •Pabarazia e lartë në zhvillimin urban dhe rural; • Niveli i ulët i teknologjisë; •Disponueshmëria e kufizuar e skemave të mikro-kredive.	•Mundësia për të zhvilluar mekanizma dhe instrumente të ndryshme duke synuar lehtësimin në vendosjen e partneritetit të biznesit në iniciativat ndërkufitare; •Specializimi i NVM-ve dhe forcimi i tyre nëpërmjet rritjes së vlerës së produkteve të tyre; •Krijimi i produktit të integruar të turizmit , duke përfshirë të dy zonat e liqenit, bregun dhe zonën malore ; •Identifikimi i disa produkteve të veçanta të zonës që mund të njihen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; •Zhvillimi i mëtejshëm i produkteve të agrikulturës dhe industrisë së agro – përpunimit; •Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional me qëllim që ti shërbejë më mirë kërkesave të tregut të punës; •Rritja e partneritetit privat/ publik për ndërtimin e infrastrukturës adekuate rrugore; • Përparësitë që rrjedhin nga niveli relativisht i ulët i kostove të punës (veçanërisht në veri të Shqipërisë).	•Aksesi i kufizuar në sistemin e kredive për fermat dhe NVM- të mund të ngadalësojë zhvillimin ekonomik; •Administratat e vetë - qeverisjes lokale të pazhvilluara dhe të pa pajisura; •Relievi malor dominues mund të ketë një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik lokal; •Ekonomia informale konkurron padrejtësisht me sektorin formal; •Niveli i konsiderueshëm i korrupsionit; • Largimi i njerëzve të arsimuar në drejtim të zonave më të zhvilluara.

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
NXITJA E PUNËSIMIT, LËVIZJA E PUNONJËSVE, DHE PËRFSHIRJA SOCIALE DHE KULTURORE PËRMES KUFIRIT	•Fuqia punëtore me kosto relativisht të ulët; •Popullsia relativisht e re dhe normë rritje pozitive; •Prania e shkollave të arsimit profesional; •Prania e degëve universitare, me qëllim për të mbështetur dhe për tu përqendruar më shumë në nevojat lokale për njohuri dhe aftësi; •Multi-etniciteti si një avantazh për përfshirje ekonomike, sociale dhe kulturore.	•Reduktimi dhe largimi i popullsisë së aftë dhe të arsimuar nga pjesët rurale të zonës së programit; •Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht ndër popullsinë e re dhe femrat; •Kurrikula nuk i përshtatet plotësisht tregut të punës - trajnimi i orientuar profesional; •Numri i madh i familjeve që varen nga paratë e dërguara nga jashtë; •Niveli i ulët i arsimit të popullsisë rurale dhe grupeve shoqërore të margjinalizuara, të tilla si Romët, etj.; •Institucione të dobëta të promovimit të punës në nivel lokal.	•Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional në funksion të përshtatjes më të mirë me kërkesat e tregut të punës për punonjësit më të aftë; •Zhvillimi i aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, duke përdorur kërkimet ekzistuese dhe qendrat e arsimit të lartë; •Programet për rritjen e aksesit në tregun e punës të popullsisë rurale, veçanërisht të grave dhe grupeve të margjinalizuara; •Zhvillimi i programeve të punësimit për integrimin social të grupeve shoqërore të margjinalizuara; •Përmirësimi i lëvizjes së punonjësve në zonën e bashkëpunimit ndërkufitar.	•Mungesa e mundësive të punësimit që çojnë në migrim më të lartë në drejtim të zonave të zhvilluara të vendit ose jashtë vendit , veçanërisht të personave të rinj dhe të kualifikuar; •Kriza e zgjatur ekonomike e cila rrit papunësinë, me efekte më të mëdha të përhapura mbi grupet më pak të arsimuar dhe ato vulnerabël; •Aksesi i dobët i popullsisë rurale në sistemin arsimor për shkak të varfërisë apo infrastrukturës arsimore të papërshtatshme.
MBROJTJA E MJEDISIT , PROMOVIMI I PËRSHTATJES DHE LEHTËSIMIT TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RREZIKUT	•Biodiversiteti i pasur natyror, mjedisi i paprekur dhe tërheqës, diversiteti i peizazheve natyrore; •Ekzistenca e disa zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare të përshtatshme për zhvillimin e eko-turizmit; •Zonat e gjera pyjore dhe cilësia e pyjeve; •Potenciali i lartë për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (energjisë së ujit, energjisë së erës, energjisë diellore dhe biomasës); •Zona e pastër, pa ndotje industriale, veçanërisht në breg dhe në zonat malore.	•Zbatimi i dobët i rregulloreve dhe standardeve mjedisore; •Menaxhimi dhe mekanizmi i dobët i kontrollit për mbrojtjen e burimeve natyrore; •Menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ngurta dhe mungesa e sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza; •Menaxhimi i papërshtatshëm i tokës; •Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore; •Ndërgjegjësimi i ulët për çështjet mjedisore.	•Menaxhimi më i mirë i zonave pyjore dhe të mbrojtura; •Zhvillimi i programeve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve; •Rritja e programeve dhe projekteve për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, bujqësisë së qëndrueshme, mbeturinave të ngurta dhe ujërave të zeza, etj.; •Interesi lokal për prodhimin e energjisë së gjelbër; •Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi masat për mbrojtjen e mjedisit nën trysninë e kërkesave eko-turistike; •Zona përreth liqenit të Shkodrës, bëhet pjesë e zonave të mbrojtura në "listën e Rezervës së Biosferës" të UNESCO-s.	•Ndotja e tokës dhe burimeve ujore për shkak të ekzistencës ose mungesës së një sistemi jo të përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza; •Procesi i urbanizimit i pakontrolluar dhe jashtë standardeve; •Shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore (druri, zhavorri, frutat e pyllit), kryesisht shpyllëzimi; •Presionet në mjedisin rreth bregut për shkak të frekuentimit të lartë turistik; •Zgjerimi i industrisë së çimentos në rajonin e Lezhës, e cila paraqet një rrezik në rritje për natyrën përreth.

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
PROMOVIMI I TRANSPORTIT TË QËNDRUESHËM DHE PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE	•Pozicioni gjeografik strategjik në rajonin më të gjerë dhe pjesëmarrja në Rrjetet e Transportit Evropian; •Lidhjet e lehta duke përmirësuar infrastrukturën rrugore; •Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të kalimit të kufirit; • Lidhjet hekurudhore; •Afërsia dhe aksesi i lehtë në të gjithë zonën e programit nga aeroportet në Podgoricë dhe Tiranë; •Portet e Tivarit dhe Shëngjinit, si një pasuri e rëndësishme ekonomike për rajonin.	•Infrastruktura në kushte të këqija e rrjetit të rrugëve rurale dhe dytësore, si dhe e hekurudhave; •Kosto e lartë e mirëmbajtjes dhe buxhetet e kufizuara në dispozicion; •Besueshmëria e ulët dhe mungesa e furnizimit me energji elektrike, të cilat varen shumë nga burimet hidrike (AL); •Infrastruktura e varfër dhe kapacitete të pamjaftueshme për trajtimin e ujit, ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta, veçanërisht në zonat rurale; •Aplikimet e pasaktë të standardeve të planifikimit urban; • Aksesi i kufizuar në internet.	•Programet për përmirësimin e rrjeteve rrugore dhe hekurudhore që lidhin Malin e Zi dhe Shqipërinë; •Menaxhimi i planeve dhe fondeve ekzistuese (BE, bankat evropiane, etj.) dhe sistemet e ujërave të zeza; •Lëvizja më e lehtë e njerëzve dhe e mallrave nëpërmjet rrugëve të përmirësuara (duke përfshirë edhe ato të rihapurat) dhe pikave të reja ndërkufitare; •Rritja e investimeve në furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimeve dhe trajtimin e mbeturinave për përmirësimin e mbetjeve të ngurta; •Potenciali për rritjen e transportit detar; •Zhvillimi i prodhimit të energjisë alternative; •Përmirësimi i aksesit në internet.	•Burimet e kufizuara financiare vonojnë investimet në infrastrukturën publike dhe veçanërisht në mirëmbajtje; •Burimet financiare të pamjaftueshme për ri-ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së përkeqësuar lokale; •Ndërtimet e paligjshme, që ushtrojnë presion shtesë mbi zhvillimin e infrastrukturës në zonën e programit; •Çështjet e pazgjidhura të pronësisë që pengojnë investimet në infrastrukturë; •Planifikimi urban i pazhvilluar, duke përfshirë planifikimin e qëndrueshëm të mjeteve të transportit publik dhe privat.

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
INKURAJIMI I TURIZMIT DHE TRASHËGIMIA KULTURORE & NATYRORE	•Klima e këndshme mesdhetare dhe klima kontinentale japin mundësinë për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në të gjithë zonën e programit; •Natyra e pasur dhe e shumëllojshme, shumë e përshtatshme për aktivitete në natyrë; •Trashëgimia e pasur kulturore dhe historike; •Shoqatat e shumta komunitare të përfshira në aktivitete për të ruajtur kulturën dhe natyrën; •Diversiteti multikulturor dhe traditat në shkëmbimet kulturore; •Traditat e pasura të kulinarisë të përshtatshme për agroturizmin; •Eksperienca relativisht e gjatë në bregun e Malit të Zi me turizmin masiv.	•Infrastruktura e pazhvilluar e turizmit në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare; •Zhvillimi i pabalancuar me mbizotërimin e turizmit bregdetar përkundrejt atij malor dhe agroturizmit; •Përpjekjet dhe financimi i pamjaftueshëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe të trashëgimisë historike dhe arkeologjike; •Njohja e kufizuar e potencialit të trashëgimisë historike dhe kulturore , si një burim i të ardhurave nëpërmjet aktiviteteve turistike dhe kulturore; •Aftësitë e kufizuara dhe niveli i dobët i shërbimeve në anën shqiptare; •Njohja e kufizuar në rang ndërkombëtar e rajonit si një destinacion turistik tërheqës.	•Nxitja e iniciativave për përfshirjen e mëtejshme të trashëgimisë kulturore në ofertën turistike; •Promovimi i traditës së veçantë të kulinarisë dhe produkteve agro-ushqimore për forcimin e identitetit dhe përvojën turistike të rajonit; •Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale vendore që lidhen me promovimin e turizmit, kulturës dhe aseteve tradicionale; •Zhvillimi i eko- turizmit të lidhur me eksperiencat në natyrë si pjesë e një pakete të integruar (p.sh. alpinizëm, rafting, ecj , çiklizëm); •Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive turistike për të ofruar paketa të integruara turistike përtej kufirit.	•Promovimi i pamjaftueshëm i turizmit, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal, për shkak të mungesës së financimit; •Ndotja e mjedisit në zonat me potencial të lartë për eko-turizëm; •Mungesa e të kuptuarit të potencialit të trashëgimisë kulturore dhe historike të zonës së programit; •Mungesa e mbrojtjes së duhur të monumenteve dhe vendeve kulturore dhe historike; •Ndërtimet e paligjshme në afërsi të bregut të detit, parqeve natyrore dhe vendeve të trashëgimisë kulturore.
INVESTIME PËR TË RINJTË, ARSIMIN DHE AFTËSITË	•Popullsia relativisht e re dhe shkalla e lartë e lindjeve; •Prania e lartë e universiteteve publike dhe private; •Multi-etniciteti si një avantazh për zhvillimin social dhe kulturor; •Ekzistenca e ofruesve të trajnimeve profesionale dhe jo- formale; • Mjedisi shumëgjuhësh; •Një brez i ri entuziast i etur për të mësuar dhe për tu zhvilluar.	•Kurrikula jo në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe orientimi profesional në drejtim të punësimit jo efikas; •Sistemi i pazhvilluar i arsimit gjatë gjithë jetës; •Niveli i ulët i arsimit të popullsisë rurale dhe grupeve të margjinalizuara të shoqërisë, siç janë komuniteti Rom, Ashkali, etj.; •Niveli i braktisjes shkollore gjatë arsimit fillor dhe të mesëm, si rezultat i arsimit të dobët të ofruar, veçanërisht në disa zona rurale.	•Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional për ti shërbyer më mirë nevojave të tregut të punës me aftësitë e nevojshme; •Zhvillimi i aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, duke përdorur kërkimet ekzistuese dhe qendrat e arsimit të lartë; •Përdorimi i internetit në mënyrë që të përmirësojë aksesin në arsim në zonat rurale dhe rritjen e kontakteve dhe bashkëpunimit ndërkufitar virtual.	•Aksesi i kufizuar i popullsisë rurale në sistemin arsimor për shkak të varfërisë; •Infrastruktura e dobët ose inekzistente e TIK në zonat rurale, e cila rrit pabarazitë rajonale; •Migrimi i të rinjve për shkak të mungesës së mundësive.

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
PROMOVIMI I QEVERISJES LOKALE DHE RAJONALE, PLANIFIKIMI & NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE	•Dalja e protokollit të bashkëpunimit midis vendeve; •Ekzistenca e strategjisë së zhvillimit rajonal; •Ekzistenca e planit të zhvillimit rajonal; •Procesi i decentralizimit në vazhdim e sipër.	•Kapacitetet e kufizuara të njësive të qeverisjes vendore për zbatimin e politikave të zhvillimit; •Burimet e pamjaftueshme financiare për të financuar objektivat e zhvillimit; •Mungesa e njohurive të duhura nga ana e administratës lokale për të përfituar dhe zbatuar fondet e BE.	•Pjesëmarrja e njësive të qeverisjes vendore në nismat apo programet për rritjen e kapaciteteve të përbashkëta institucionale.	•Njësitë e qeverisjes vendore financiarisht të dobëta; •Mungesa e financimit për trajnimin e administratës së Pushtetit Lokal për të rritur mundësinë e politikë-bërjes dhe kapacitetet zbatuese; •Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave rajonale përkatëse.
FORCIMI I KËRKIMIT SHKENCOR, ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK, INOVACIONI DHE TIK	•Prania e universiteteve publike dhe private në zonën e programit; •Rritja e përqindjes së popullsisë që përdor në mënyrë aktive teknologjinë TIK.	•Kërkimet dhe praktikat novatore të universiteteve dhe operatorëve të tjerë në zonën e programit, të varfra; •Depërtimi modest në internet; • Arsimimi i dobët kompjuterik; •Teknologjia e informacionit dhe komunikimit e përdorur nga ana e universiteteve, shkollave dhe bizneseve, e dobët.	•Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve ndërkufitare të TIK; •Investimet në TIK dhe programet e kërkimit dhe zhvillimit që do të përshtaten me nevojat e zhvillimit të sektorit privat; •Forcimi i kërkimit shkencor, teknologjik dhe novatore në zonën e programit; •Programet e shkëmbimit të studentëve.	•Mungesa e strategjive kombëtare për promovimin e TIK, kërkimin shkencor & zhvillimin; •Burime financiare të kufizuara për kërkimin shkencor dhe zhvillimin; •Interesi i pamjaftueshëm i sektorit privat për zhvillimin teknologjik dhe modernizimin e proceseve të prodhimit.

Marrëveshja e Financimit IPA II, Programet Vjetore të Veprimit BNK – Shtojca II- Kushtet e Përgjithshme v. 3.1 shtator 2018

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITH-SHME

Pjesa e parë: Dispozita të përgjithshme

Neni 1 - Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

Neni 2 - Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

Neni 3 - Kërkesat e raportimit

Neni 4 – Vizibiliteti dhe Komunikimi

Neni 5 – Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 6 - Pranueshmëria e shpenzimeve

Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme të menaxhimit të tërthortë nga përfituesi i IPA-s II

Neni 7 – Parime të përgjithshme

Neni 8 - Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

Neni 8 – Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

Neni 9 – Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni

Neni 10 - Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura

Neni 11 - Dispozita për pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

Neni 12 - Ndërprerja e pagesave

Neni 13 – Kthimi i fondeve

Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare

Neni 14 - Konsultimi ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit .

Neni 15 - Amendimi i kësaj marrëveshjeje financimi

Neni 16 - Pezullimi i kësaj marrëveshjeje financimi

Neni 17 - Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financimi …

Neni 18 – Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën operative të zbatimit, si dhe një fazë të mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit është e përcaktuar në nenin 2 (1) të Kushteve të Veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha në të cilën kanë përfunduar të gjitha aktivitetet operative të mbuluara nga prokurimi dhe kontratat e grantit të Programit të Veprimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2 (2) për Kushtet e Veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

3. Periudha operacionale e zbatimit dhe ekzekutimit duhet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues në mbyllje dhe zbatim të prokurimit dhe kontratave të granteve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare.

4. Kostot që lidhen me projektet e këtij Programi Veprimi do të jenë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë kryer gjatë periudhës së zbatimit operativ.

5. Prokurimet, kontratat e grantit dhe marrëveshjet e kontributit do të përfundojnë maksimumi brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare, përveç:

a) në ndryshimet në kontratat tashmë të lidhura;

b) kur kontratat individuale të prokurimit përfundojnë pas një ndërprerjeje të parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të jenë të nënshkruara pas zbatimit operacional;

d) ndryshimi i subjektit të ngarkuar me detyra të besuara.

6. Kur një kontratë granti ose prokurimi nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, do të ndërpritet automatikisht dhe fondet e saj do të bllokohen, me përjashtim të çështjeve gjyqësore pranë gjykatave ose në organet e arbitrazhit.

Neni 2
Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76 (3) të kuadrit të marrëveshjeve përkatëse, përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë ngushtë dhe duhet të përmbushin bashkërisht në veçanti funksionet e mëposhtme dhe të marrin përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar në përputhje me nenin 68 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse ose rishikimet e tyre;

b) sigurojnë pjesëmarrjen në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM), mbledhje dhe takime të tjera dypalëshe;

c) emërojnë përfaqësuesin e tyre në KPM;

d) krijojnë Sekretariatin e Përbashkët Teknik (SPT) dhe sigurohen që ajo të ketë stafin e duhur;

e) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike të KPM;

f) mbështesin punën e KPM-së dhe sigurojnë informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, në veçanti të dhënat që lidhen me ecurinë e programit operativ në arritjen e objektivave specifike dhe synimeve për prioritet tematike si ngritja e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

g) krijojnë një sistem për të mbledhur informacion të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

h) hartojnë raportet vjetore dhe finale të zbatimit siç janë përmendur në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në përputhje me nenin 3;

i) të përgatisin dhe të zbatojnë një plan koherent për komunikim dhe vizibilitet;

j) të hartojnë një plan vjetor të punës për Sekretariatin e Përbashkët Teknik, të miratuar nga KPM-ja.

2. Me qëllim zbatimin e nenit 25 të Marrëveshjes Kuadër mbi Mbrojtjen e të Dhënave, të dhënat personale do të jenë:

-përpunuar në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;

-të mbledhura për qëllime të specifikuara, të qarta dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen më tej në atë mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime;

-të mjaftueshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në çka është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat përpunohen;

-të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara;

-përpunuar në atë mënyrë që garantojnë sigurinë e duhur të të dhënave personale dhe

-të mbajtura në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë sesa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale të përfshira në dokumente që duhen mbajtur nga përfituesi i IPA II, në përputhje me nenin 8.5, duhet të fshihen pasi të kenë përfunduar afatet e përcaktuara në nenin 8.5.

Neni 3
Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenin 80 (1) të Marrëveshjeve përkatëse Kuadër, strukturat operuese do të përdorin modelin e parashikuar në Shtojcën III të kësaj marrëveshjeje financimi.

2. Për qëllim të kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuara në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit nën menaxhimin e tërthortë të përcaktuara në nenin 59 (1) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në raportin vjetor për zbatimin e asistencës IPA II, NIPAC do të përdorë modelin e dhënë në Shtojcën IIIA të kësaj marrëveshjeje financimi.

3. Për qëllim të kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në pikën (a) të nenit 59 (2) të Marrëveshjes Kuadër mbi raportin vjetor financiar apo deklaratat, NAO si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përdorë modelin e parashikuar në Shtojcën IV të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Për qëllim të nenit 59 (4) të Marrëveshjes Kuadër, NIPAC (KKIPA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i paraqesë Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e asistencës së IPA II të Programit të Veprimit jo më vonë se katër muaj pas disbursimit (pagesës) të fundit për kontraktuesit e saj ose përfituesit e granteve.

5. Për qëllim të nenit 59 (6) të Marrëveshjes Kuadër, ZKA si përfitues i IPA II ku është

Autoriteti Kontraktues, do të sigurojë deri në datën 15 janar të vitit financiar vijues, në format elektronik, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit, të krijuar sipas nenit 10(5). Kjo duhet të mbështetet nga një raport i nënshkruar i paaudituar përmbledhës financiar, në përputhje me pikën (c) të Shtojcën IV.

Neni 4
Vizibiliteti dhe Komunikimi

1. Siç parashikohet në dispozitat e nenit 24 (1), 76 (3) (k), dhe nenit 78 (8) (f) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II duhet të përgatisin një plan koherent të aktiviteteve të vizibilitetit dhe të komunikimit, të cilat do t'i paraqiten Komisionit për një marrëveshje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete të vizibilitetit dhe komunikimit duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimeve dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5
Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara sipas kësaj marrëveshjeje financiare, duhet të garantojnë që përfituesit e IPA II të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti kontraktues, do të garantojë që Komisioni ose dikush apo personi i autorizuar nga Komisioni dhe përfituesit e të tjerë të IPA II, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do ta përdorë një material të tillë vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6
Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj marrëveshjeje financiare:

a) borxhet dhe pagesat e shërbimit të borxhit (interesi);

b) dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;

c) Kostoja e deklaruar nga përfituesi dhe e financuar nga një veprim apo program pune që merr një grant nga Unioni;

d) humbjet e këmbimit valutor;

e) kreditë për palët e treta;

f) gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor.

2. Blerja e tokës që nuk është e ndërtuar dhe e tokës me ndërtim në shumën deri 10% të totalit të shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë, do të jetë e ligjshme/e pranueshmepër financim sipas asistencës për bashkëpunim ndërkufitar IPA II, nëse është e justifikuar nga natyra e veprimit dhe të dhënat në Shtojcën I.

PJESA E DYTË
DISPOZITAT E ZBATUESHME TË MENAXHIMIT TË TËRTHORTË NGA PËRFITUESI IPA II

Neni 7
Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është të vendosë rregullat për zbatimin e Programit të Veprimit nën menaxhimin e tërthortë dhe në veçanti rregullat që lidhen me detyrat që i janë besuar zbatimit të buxhetit, siç përshkruhet në Shtojcën I dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni në kryerjen e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76 (3) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II, bashkërisht, duhet të përgatisin një marrëveshje dypalëshe dhe të sigurojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoritet Kontraktues, do të bashkëpunojë me përfituesin e IPA II që është Autoritet Kontraktues, për të siguruar se detyrat në vijim janë plotësuar:

a) të kryejë ndjekjen operative dhe menaxhimin e operacioneve, siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76 (4) të Marrëveshjes Kuadër;

b) të kryejë verifikime në përputhje me nenin 76 (5) të Marrëveshjes Kuadër;

c) të mbrojë interesin financiar të Unionit, siç parashikohet në nenin 51 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8

Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

1. Detyrat e përmendura në nenin 7 (3) duhet të kryhen nga përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratave të granteve, në veprimet e jashtme, në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara të Vizibilitetit dhe Komunikimit, të përmendura në Nenin 4 (2).

2. Në përputhje me nenin 18 (2) të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni do të pajisë përfituesin e IPA-II që është Autoritet Kontraktues, me udhëzime të mëtejshme për përshtatjen e procedurave dhe dokumenteve standarde, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në veprimet e jashtme, në rastin specifik të bashkëpunimit ndërkufitar.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të kryejë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, të lidhë kontratat që pasojnë dhe të sigurojë që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmët e auditimit janë në gjuhën e kësaj marrëveshjeje të financimit. Në zbatim të pjesës së dytë të kësaj Marrëveshjeje Financiare, çdo referencë për dhënien e kontratave duhet të përfshijë gjithashtu kontratën e kontributit dhe çdo referencë për përfituesit e granteve do të përfshijë edhe organizatat që kanë nënshkruar marrëveshje kontributi.

4. Përfituesit e vendeve IPA II do të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e komisioneve të vlerësimit, siç parashikohet në pikën (a) të nenit 76 (4) i Marrëveshjes përkatëse Kuadër.

5. Përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të mbajë të gjitha dokumentet ndihmëse financiare dhe kontraktuale përkatëse, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare ose nga një datë më e hershme, në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime, ose procedurat e dhënies së granteve të drejtpërdrejta, kanë filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të Financimit:

a. Për procedurat e prokurimit në veçanti:

a) Njoftim i mëparshëm me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe të çdo korrigjimi;

b) Caktimi i panelit të zgjedhur;

c) Raporti i listës së të përzgjedhurve (duke përfshirë anekset) dhe aplikimet;

d) Dëshmi e publikimit të njoftimit të listës së përzgjedhurve

e) Letra e kandidatëve jo-të përzgjedhur;

f) Ftesë për tender ose ekuivalente e saj;

g) Dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarime, procesverbalet e mbledhjeve, dëshmitë e publikimit;

h) Caktimi i komisionit të vlerësimit;

i) Raporti për hapjen e tenderave, duke përfshirë anekset;

j) Raporti i vlerësimit/negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuara;[91]

k) Letra e njoftimit;

l) Shkresë për dorëzimin e kontratës;

m) Letrat për kandidatët e pasuksesshëm;

n) Dhënia /njoftimi i anulimit, përfshirë dëshminë e publikimit;

o) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë, raportet e zbatimit, dhe korrespondenca përkatëse.

b. Për thirrjet për propozime dhe dhënien e drejtpërdrejtë të granteve në veçanti:

a) Emërimi i komisionit të vlerësimit;

b) Raporti i hapjes dhe raporti administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e marra;[92]

c) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, pas vlerësimit të hartimit të notës;

d) Raporti i vlerësimit të hartimit të notës;

e) Raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë ose raporti i negocimit me shtojcat përkatëse;

[91] Eliminimi i ofertave të pa-suksesshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

[92] Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit

f) Kontrolli i pranueshmërisë dhe dokumentet e tjera shoqëruese;

g) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm me listën e miratuar rezervë, pas vlerësimit të plotë të aplikimit;

h) Shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) Dhënia/njoftimi i anulimit, me dëshmi të publikimit;

j) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë dhe korrespondencat përkatëse.

Përveç kësaj, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 6 (a) dhe (b) të këtij neni, do të plotësohen nga të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese përkatëse, siç kërkohen nga procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimin dhe shpenzimet operative, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontrolleve të vendeve, pranimi i furnizimeve dhe punëve, sigurimet dhe garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes.

Të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale do të mbahen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8a

Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe grantit, përfituesi i IPA II do të sigurojë që asnjë kontratë e prokurimit ose grantit të financuar nga BE nuk i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti për grante, nëse operatori ekonomik ose kërkuesi i grantit, nëse ai personalisht ose një person me kompetenca të përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit mbi të, ndodhet në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të informojë Komisionin, kur një kandidat, ofertues ose aplikant ndodhet në një situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies së prokurimit dhe grantit, ka kryer parregullsi dhe mashtrime ose është konstatuar në shkelje të rëndë të detyrimeve të tij kontraktuale.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të marrë parasysh informacionin përfshirë në Sistemin e Zbulimit të Parakohshëm dhe të Përjashtimit (EDES), gjatë dhënies së kontratave të prokurimit dhe granteve. Aksesi në informacione mund të sigurohet përmes pikës(ve) së ndërlidhjes ose nëpërmjet konsultimeve me mënyrat e mëposhtme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, nëpunësi i kontabilitetit të Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe me email: BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu bashkë me adresën e Komisionit, të identifikuar në nenin 3 të Kushteve të veçanta).

4. Kur përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është në dijeni për një situatë përjashtimi në zbatimin e detyrave të përshkruara në Shtojcën I, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do ti vendosë një operatori ekonomik ose aplikuesi granti përjashtim nga prokurimet e saj të ardhshme ose procedurat e dhënies së granteve. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, gjithashtu mund të vendosë një penalitet financiar proporcional me vlerën e kontratës në fjalë. Përjashtimet dhe/ose penalitetet financiare do të vendosen pas një procedure për gjetjen dhe paraqitje e provave që siguron të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, njofton Komisionin në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.

5. Në lidhje me paragrafin 4 të këtij neni, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, merr përsipër mosveprimin, nëse nuk vendos përjashtim dhe/ose një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit.

6. Në rastin e mosveprimit, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të njoftojë Komisionin për të shpjeguar arsyet për mosveprimin e tij. Komisioni rezervon të drejtën për të përjashtuar një operator ekonomik ose një aplikues granti nga procedurat e ardhshme të financimit të BE-së dhe/ose të vendosë një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit ndërmjet 2% dhe 10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

Neni 9

Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle paraprake (ex ante) për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat e mëposhtme të prokurimit ose dhënies së granteve:

a) për miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tij;

b) për miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;

c) për miratimin e përbërjes së komisioneve të vlerësimit;

d) për miratimin e raporteve të vlerësimit dhe vendimet e dhënies së kontratës[93];

e) për miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtesën e kontratës.

2. Lidhur me kontrollin paraprak, komisioni duhet të vendosë:

a) të kryejë kontrolle paraprake për të gjitha dosjet ose

b) të kryejë kontrolle paraprake në përzgjedhjen e këtyre dosjeve ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet paraprake.

3. Nëse Komisioni vendos për të kryer kontrolle paraprake në përputhje me paragrafin 2, shkronjat (a) ose (b) të këtij neni, ai duhet të informojë përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues i dosjeve të përzgjedhura, në lidhje me kontrollet paraprake. Ky përfitues i IPA II do të japë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll paraprak maksimumi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë për të kryer kontrolle të mëpasshme (ex-post), duke përfshirë auditimet dhe kontrollet në vend, në çdo kohë, për ndonjë kontratë ose grantet e dhëna nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues që rrjedhin nga kjo marrëveshje financimi. Ky përfitues i IPA II do të të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se kjo dosje është përzgjedhur për kontroll të mëpasshëm (ex post). Komisioni mund të autorizojë një person ose njësi ekonomike për të kryer kontrolle ex post në emër të tij.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostoja e njohur

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operative e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues për Programin e Veprimit, duhet të hapë të paktën një llogari bankare në Euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit do të jetë shuma e bilanceve në të gjitha llogaritë bankare të Programit të Veprimit, të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat pjesëmarrëse që operojnë tek përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

2. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përgatisë dhe dorëzojë në Komision planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 3 (2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet do të bazohen në një analizë të dokumentuar dhe të detajuar (duke përfshirë edhe kontraktimin e planifikuar dhe orarin e pagesave sipas kontratës për dymbëdhjetë muajt në vijim), të cilat do të jenë në dispozicion të Komisionit në bazë të kërkesës.

3. Plani fillestar i parashikimit të disbursimit duhet të përmbajë përmbledhjen e parashikimit vjetorë të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të Programit të Veprimit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhjen vjetore të parashikimeve të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të kontabilitetit në përputhje me pikën 2 (3) (b) të Shtojcës A të Marrëveshjes

[93] Për kontratat e shërbimit këto hapa përfshijnë kontrollet paraprake në lidhje me miratimin e listës së përzgjedhur.

Kuadër, i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat që menaxhohen nën Programin e Veprimit të treguar në Shtojcën V.

5. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit e mbajtur nën seksionin 4 të këtij neni, duhet të jetë kryer, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojë me kostot aktuale të provuara nga dokumentet mbështetëse dhe të përdoret kur është e përshtatshme, për të nisur para-financimin e paguar nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues sipas kontratave lokale.

6. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit do të shfrytëzohet nga Komisioni për njohjen e përkohshme të kostos së saj, gjatë zbatimit të Programit të Veprimit (duke përfshirë autorizimin e para-financimit që i paguhet përfituesit të IPA II, i cili është Autoriteti Kontraktues) për procesin e miratimit për pagesat, autorizimin përfundimtar të procedurës së llogarive në fund të Programit të Veprimit, praktikat vjetore të ndërprera dhe çdo zbatim tjetër të menaxhimit dhe të shqyrtimeve të performancës.

7. Përfituesi i IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

a) Raportin Përmbledhës - siç është përcaktuar në nenin 3 (5);

b) Raportet vjetore siç janë përcaktuar në paragrafët (2) deri (4) të nenit 3;

c) Kërkesa për raportet e fondeve, siç përmenden në nenin 11.

Neni 11

Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

1. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të paraqesë parashikimin e tij fillestar të disbursimit (pagesës) për Programin e Veprimit, të përgatitur në përputhje me nenin 10 (2), me kërkesën e parë për pagesë të para-financuar. Pagesa e parë e para-financimit do të bëhet për 100% të pagesës së parashikuar për vitin e parë të planit të parashikuar për disbursim.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të paraqesë kërkesa të vazhdueshme të pagesës së para-financimit kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit përfshihet nën pagesën e parashikuar për pesë muajt në vazhdim të Programit të Veprimit.

3. Çdo kërkesë për para-financim shtesë do të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

a) Një deklaratë përmbledhëse të të gjitha pagesave të kryera për Programin e Veprimit;

b) Balancat bankare për Programin e Veprimit në datën e përcaktuar të kërkesës;

c) Një parashikim të pagesave për Programin e Veprimit për katërmbëdhjetë muajt në vazhdim në datën e përcaktuar të kërkesës.

4. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, mund të kërkojë për çdo para-financim pasues, shumën e totalit të disbursimeve të parashikimit për katërmbëdhjetë muaj, pas datës së përcaktuar të kërkesës, pa balancat e referuara në nenin 3 (b) të këtij neni në datën e përcaktuar të kërkesës për fondet e rritura nga ndonjë shumë e financuar nga përfituesi IPA II sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni gëzon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë pasuese të para-financimit, nëse tepricat totale bankare të mbajtura nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues në bazë të këtij programi dhe në të gjitha programet e tjera të IPA I apo IPA II që menaxhohen nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, tejkalon parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Në rastet kur pagesa është reduktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet ta financojë programin nga burimet e veta, deri në shumën e reduktimit. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti kontraktues, më pas mund të kërkojë rimbursimin e këtij financimi, si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë për të rikuperuar balancat e tepërta bankare, të cilat kanë mbetur të papërdorura për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para se të ushtrojë këtë të drejtë, Komisioni e fton përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, për të dhënë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën për to në vazhdim gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Interesi i gjeneruar nga llogaritë bankare të përdorura për këtë Program nuk njihet nga Komisioni.

8. Sipas Nenit 33 (4) të Marrëveshjes Kuadër, kur ndërprerja e afatit për kërkesën për pagesë tejkalon dy muaj, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë një vendim nga Komisioni, nëse ndërprerja e afatit duhet vazhdojë.

9. Pasqyra financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37 (2) të Marrëveshjes Kuadër do të dorëzohet nga ZKA jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 12
Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje financimi sipas përkatësisht neneve 16 dhe 17 dhe përveç nenit 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, në qoftë se:

a) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, pasi përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka bërë gabime të konsiderueshme, ka parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve në fjalë, në implementimin e Programit të Veprimit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje financiare;

b) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, nëse përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka kryer gabime sistemike ose të përsëritura, ose ka parregullsi, mashtrime apo shkelje të detyrimeve në këtë ose në të tjera marrëveshje financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrime, ose shkelje të detyrimeve të kenë ndikim material në zbatimin e kësaj marrëveshjeje financiare apo vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve bazë;

Neni 13
Kthimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rimarrë fondet nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet në rregulloren financiare, veçanërisht në rast se:

a) Komisioni vendos se objektivat e Programit të Veprimit të përcaktuara në Shtojcën I nuk janë arritur;

b) shpenzimet janë të papërshtatshme;

c) shpenzimet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve apo shkeljeve të detyrimeve në zbatimin e Programit të Veprimit, në veçanti në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

2. Në përputhje me ligjin kombëtar, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të rimarrë kontributin e Unionit që i paguhet përfituesit të IPA II, i cili është Autoriteti Kontraktues nga marrësit të cilët ndodhen në një prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1 pika b) ose c) të këtij neni ose të referuara në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti se përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk ka sukses në kthimin e të gjithë ose një pjese të fondeve nuk do ta pengojë Komisionin për rikuperimin e fondeve nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin e IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, në rimëkëmbjen e saj, kur përfituesi vendoset në territorin e tij. Marrëveshja për rikuperimin do të parashikohet në një marrëveshje dypalëshe që do të lidhet në përputhje me nenin 69 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse.

4. Shumat e paguara padrejtësisht apo të mbuluara nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, shumat e garancive financiare, performancës dhe para-financimit, të paraqitura në bazë të prokurimit dhe dhënies së procedurave të granteve, shumat nga gjobat e vendosura nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve, të paguara për përfituesit e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, ose do të ri-përdoren për Programin e Veprimit, ose do t'i kthehen Komisionit.

PJESA E TRETË
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Konsultime ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesit e IPA II dhe Komisioni do të konsultohen me njëri tjetrin para se të krijojnë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në përputhje me nenin 18 të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

2. Kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshje Financimi, ai duhet të krijojë të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA II për të korrigjuar situatën dhe ndërmarrë hapat e nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, në pezullimin ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Komisioni do të informojë rregullisht përfituesit e IPA II për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në Shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në Pjesën e Dytë të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

Neni 15
Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje financiare duhet të bëhet me shkrim, duke përfshirë dhe shkëmbimin e shkresave.

2. Nëse përfituesit e IPA II, kërkojnë një amendament, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi që kërkohet të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të amendojë *Dokumentet Model* në Shtojcën III, IIIA, IV dhe V, pa nevojën e një amendamenti të kësaj marrëveshjeje financiare. Përfituesit e IPA II do të informohen me shkrim për çdo amendament të tillë dhe për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 16
Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Nëse ndonjë përfitues IPA II shkel një detyrim sipas kësaj marrëveshjeje financiare.

b) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në bazë të procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18 (2) të Marrëveshjes përkatëse Kuadër, pa cenuar dispozitat në nenin 8 (2).

c) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, nuk i plotëson kërkesat për zbatimin e detyrave të besuara të buxhetit.

d) Nëse përfituesit e IPA II nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në Nenin 2 (1) dhe kur është e mundur edhe menaxhimin e tërthortë sipas Nenit 7(3).

e) Nëse ndonjë përfitues i IPA II vendos të pezullojë ose ndërpresë procesin e pranimit të anëtarësimit në BE.

f) Nëse ndonjë përfitues i IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit, si dhe në raste të rënda të korrupsionit ose nëse përfituesi IPA II është fajtor për sjellje të rëndë profesionale të provuar me ndonjë mënyrë të justifikuar. Shkelje e rëndë profesionale nënkupton një nga sa më poshtë:

-shkelje e ligjeve ose rregulloreve në fuqi ose e standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt, ose

-çdo sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ka ndikim në kredibilitetin e tij profesional, kur sjellja e tillë nënkupton qëllimin e gabuar ose neglizhencën e rëndë.

g) Në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë Madhore" do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon secilën prej tyre në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre, gjë që nuk i atribuohet gabimit ose neglizhencës nga ana e tyre (ose pjesës së kontraktuesve të tyre, agjentëve ose të punësuarve) dhe vërteton pakapërcyeshmërinë e situatës, pavarësisht se janë bërë përpjekjet e duhura. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat e tyre të mundshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk duhet të konsiderohet si shkelëse e detyrimeve të saj, nëse është penguar nga përmbushja e tyre për shkak të një force

madhore për të cilën pala tjetër është informuar siç duhet. Një palë që përballet me një forcë madhore duhet ta informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

Asnjëra prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, nëse është penguar nga përmbushja e tyre nga forca madhore, me kusht që ajo palë të marrë masa për të minimizuar dëmtimet e mundshme.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë masat e duhura parandaluese para se të bëhet pezullimi.

4. Kur pezullimi është njoftuar, duhet të tregohen pasojat e prokurimit dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe marrëveshjet e delegacionit për këto kontrata, si dhe marrëveshjet që duhen nënshkruar për këto kontrata.

5. Pezullimi i kësaj marrëveshjeje financimi nuk e cenon ndërprerjen e kësaj marrëveshjeje financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 17.

6. Palët do të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes Financiare sapo kushtet ta lejojnë, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo nuk cenon asnjë amendim të kësaj marrëveshjeje financiare që mund të jenë të nevojshme për të përshtatur Programin e Veprimit me kushtet e reja zbatuese, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së zbatimit ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financiare në përputhje me nenin 17.

Neni 17
Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financimi

1. Nëse çështjet të cilat çuan në pezullimin e Marrëveshjes së Financimit nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale 180 ditore, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen Financiare me njoftim 30 ditë para.

2. Kur ndërprerja është njoftuar, duhet të tregohen pasoja e prokurimeve dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe kontratat ose grantet e tilla që duhen nënshkruar.

3. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare nuk do të përjashtojë mundësinë e Komisionit që të kryejë korrigjime financiare në përputhje me nenet 43 dhe 44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 18
Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, të parashikuar në nenin 14, mund të zgjidhet nga arbitrazhi me kërkesën e njërës prej palëve.

2. Secila palë do të caktojë një gjyqtar brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar të dytë. Të dy gjyqtarët, nga ana e tyre, caktojnë një gjyqtar të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë.

3. Përveç kur arbitrat vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, rregullat opsionale për Arbitrazhin që përfshijnë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve.

Shtojca III A Modeli i Raportimit Vjetor
Periudha e mbuluar nga raporti:
01/01/20XX-31/12/20XX
Raport i lëshuar më XX/XX/20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhim e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vendi] të paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referencë e objektivave të Dokumenteve Strategjikë të Vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve

2. Përfshirja në programim

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-s dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.

6. Përfshirja në veprimet shumë-vendëshe dhe çdo çështje që ka lidhje me to.

7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.

8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

9. Koordinimi i donatorëve

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjithashtu:

10. Zbatimin gjithëpërfshirës të asistencës së IPA-s nën menaxhim e tërthortë (maksimumi një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-s dhe masat përkatëse të marra /planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).

13. Auditimet - gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

II. Informacion sipas Sektorëve

Titulli i sektorit[94]: [*Transporti*]

Pjesa përshkruese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim

2. Përmbledhje e rezultateve të arritura drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritura sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të Sektorit).

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe / ose donatorë / IFI-të brenda sektorit.

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim e tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me to, nëse ka: [*Ministria e Transportit]*

6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor.

7. Arritjet kryesore në atë sektor.

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat e marra / planifikuara në vijim.

9. Rekomandime për veprime të mëtejshme.

10. Aktivitetet monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet - gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndërkufitar[95]

1. Përfshirja në programim, sipas rastit.

2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.

4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave dhe kur është e zbatueshme, dhe aktivitete vlerësimi.

5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe svizibilitetin.

6. Koordinimi me vendin partner.

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operuese ekzistuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me të, nëse ka.

2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra/ planifikuara.

3. Rekomandime për veprime të mëtejshme

4. Auditimet e kryera - gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

[94] Sipas sektorëve në Dokumentet tregues të Strategjisë.

[95] Për Bashkëpunimin Ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

II a. Treguesit e performancës në sektorin [*p.sh. transporti*] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[3] për program

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit[5]	**Treguesi për sektor [*Transporti*]**	**Burimi**	**Baza**	**Komponentët kryesorë (2017)**	**Objektivi (2020)**	**Vlera (2014[4])**
2014 Programi i vendit	*Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit*					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	*Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti*					

[3] Këto duhet të jenë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit

[4] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

5 Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumë vjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit	**Projekti**	**Situata/Progresi për projekte të veçanta (p.sh. Termat e Referencës në përgatitjen për shpalljen e tenderit, kontraktimin, zbatimin, përfundimin)**	**Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre**	**Probleme kryesore të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre**	**Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen**	**Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese**
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*P.sh., Kontratë Shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*P.sh., Kontrata e Shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe duhet të ri-shpallet*	*P.sh., ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja me dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim e tërthortë duhet të sigurohen dhe Shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1

Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me MK (maksimumi një faqe)

Shtojca 2

Histori suksesi (Shënim. ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare, i cili përgatitet nga Komisioni Evropian).

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Shtojca e mëposhtme duhet të sigurohet si për menaxhimin e drejtpërdrejtë, ashtu dhe për atë të tërthortë:

Shtojca 4

Udhërrëfyesi i qasjes sektoriale – arritjet (duke theksuar nëse objektivat e planifikuara janë përmbushur ose jo).

Shtojca III A Modeli i Raportimit Vjetor
Periudha e mbuluar nga raporti:
01/01/20XX-31/12/20XX
Raport i lëshuar më XX/XX/20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhim e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vendi] të paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referencë e objektivave të Dokumenteve Strategjikë të Vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve

2. Përfshirja në programim

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-s dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.

6. Përfshirja në veprimet shumë-vendëshe dhe çdo çështje që ka lidhje me to.

7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.

8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

9. Koordinimi i donatorëve

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjithashtu:

10. Zbatimin gjithëpërfshirës të asistencës së IPA-s nën menaxhim e tërthortë (maksimumi një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-s dhe masat përkatëse të marra /planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).

13. Auditimet - gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

II. Informacion sipas Sektorëve

Titulli i sektorit[96]: [*Transporti*]

Pjesa përshkruese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim

2. Përmbledhje e rezultateve të arritura drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritura sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të Sektorit).

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe / ose donatorë / IFI-të brenda sektorit.

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim e tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me to, nëse ka: [*Ministria e Transportit]*

6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor.

7. Arritjet kryesore në atë sektor.

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara, p.sh. vonesat në

[96] Sipas sektorëve në Dokumentet tregues të Strategjisë.

kontraktim dhe masat e marra / planifikuara në vijim.

9. Rekomandime për veprime të mëtejshme.

10. Aktivitetet monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet - gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndërkufitar[97]

1. Përfshirja në programim, sipas rastit.

2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.

4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave dhe kur është e zbatueshme, dhe aktivitete vlerësimi.

5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe svizibilitetin.

6. Koordinimi me vendin partner.

Shtojca V e kësaj Marrëveshjeje Financiare

Specifikimi minimal i Sistemit të Kontabilitetit Akrual

Sistemi i kontabilitetit të përfituesit të IPA II duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të reflektojë strukturën organizative të caktuar për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatur për kryerjen e detyrave. Në mënyrë të veçantë, para se të autorizohet një veprim, duhet të verifikohen të gjitha aspektet (si operative dhe financiare) e veprimit nga anëtarët e tjerë të stafit, përveç atij që e ka nisur veprimin. Personi që merret me verifikimin nuk mund të jetë në varësi të atij që e ka nisur transaksionin.

2. Të përfshijë një gjurmë auditimi për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet.

3. Të ketë siguri të mjaftueshme fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet e rikuperimit dhe të ruajtjes së një kopje rezervë/mbështetjes.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm për kontratat lokale që menaxhohen nën secilin program:

a) Referencën e Kontratës;

b) Vlerën e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

c) Datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);

d) Datën e fillimit të zbatimit të kontratës;

Kjo është përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të jetë e ndryshme nga ajo, si në rastet kur data e fillimit të punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës nëpërmjet një Urdhri Administrativ.

e) Datën e përfundimit të zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

Kjo është data e fundit kur mund të këtë kosto të pranueshme. Kjo nuk përfshin asnjë periudhë garancie ose kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi.

f) Totali i paguar (me lekë në dorë) nga kontrata;

g) Parafinancimi i paguar me kontratë;

Njohje e hollësishme dhe regjistrim në bilancin e kërkuar sipas kontratës së para-financimit.

h) Kosto e njohur - e drejtpërdrejtë (me kontratë);

Njohje e hollësishme e kostos si një detyrim për shpenzimet e vitit. Disa pagesa do të mbulojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shpenzimet e kryera. Nuk përfshihet ndonjë para-financim. Këto mund të jenë pagesa përfundimtare kur para-financimi është hequr tashmë ose pagesa të ndërmjetme kur para-financimi është hequr ose kur kontrata nuk përfshin sigurimin e para-financimit.

i) Kosto e njohur – e tërthortë (me kontratë);

Njohje e hollësishme e kostos si një detyrim për shpenzimet e vitit. Disa fatura apo detyrime kostoje, të paraqitura nga një përfitues i grantit ose kontraktues, do të lidhen me kostot që mbulohen nga para-financimi i paguar më herët gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes ose kontratës së grantit. Në këto raste, pagesa e bërë do të jetë më e vogël sesa kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë dhe zero, nëse e gjithë kostoja është e mbuluar me para-financim (sigurisht do të jetë zero në qoftë se kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të thithur para-financimin dhe lëshohet një urdhër rivlerësimi për bilancin e papërdorur të para-financimit.). Në të gjitha këto raste, sistemi gjatë përcaktimit të shumës për t'u paguar, duhet të

[97] Për Bashkëpunimin Ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

regjistrojë vlerën e plotë të kostos së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë nga bilanci i para-financimit koston e kompensuar nga para-financimi.

j) Kthimi i fondeve të papërdorura për të ulur para-financimin (me kontratë);

Njohja e reduktimit të fondeve të para-financimit në bilanc pas kthimit të një para-financimi të papërdorur.

k) Kthimi i fondeve të papërdorura për të ulur koston (sipas kontratës);

Kur një kthim fondesh bëhet kundrejt një kostoje të pranuar më parë - ndoshta pas një hetimi për mashtrim. Në raste të tilla, shpenzimet e regjistruara për vitin duhet të reduktohen në qoftë se kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperimi pasues; ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar, në një vit para tij të kthimit të fondeve.

l) Data e faturës së furnizuesit për çdo faturë, ose dokument tjetër i shoqëruar nga një raport financiar që paraqet shpenzimet e njohura;

m) Informacion mbi kontekstin e kthimit të fondeve të kostove të papranueshme dhe kthimeve të fondeve.

Annex IV (d) - Parashikimi i pagesave

Referenca e Programit	Parashikimi i disbursimeve të planifikuara (Shtoni vite sipas nevojës)																
	Parashikimi I disbursimeve mujore (12 muaj për para-financimin/14 muaj për pagesat e mëvonshme)														**Totali Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**
	1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**			
NP2010															0		
CBC AA/BB 2010															0		

Shtojca IV (c) Raporti Vjetor i Financimit - kontributi i thjeshtuar i konsoliduar i BE-së

Raporti Financiar i vendit përfitues IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i kontributit të BE-së për Programin	Aktivitetet e kontratave lokale					
			Totali i shumës së kontraktuar	Shuma totale të fondeve të papërdorura në mbyllje	Totali i fondeve të disbursuara	Shuma e kostove të njohura	Shuma e para-financimit	Totali
1	2	3	4	5	6	7	8	9
NP2010	**2010/123-456**							

(*) 15 Janar

Shtojca IV(b): Raportimi Vjetor Financiar – kontributi i BE për programin

Raporti Financiar i vendit përfitues IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i kontributit të BE për Programin	Aktivitetet e kontratave lokale										
			Totali I shumës së kontraktuar	Kontraktimi në %	Shuma totale të fondeve të papërdorura në mbyllje	Fondet e papërdorura %	Totali I fondeve të disbursuara	Disbursimet %	Shuma e kostove të njohura	Kostot %	Shuma e para-financimit	Para-financimi %
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
				4/3*100%		6/4*100%		8/4*100%		10/4*100%		12/4*100%
NP2010	**2010/123-456**											
Nën- programi												
Projekti												

(*) 15 Shkurt



Shtojca IV(a): IV(a): Raporti Financiar Vjetor - Buxheti Total

Raporti Financiar I përfituesit IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i Programit			Shuma totale e kontraktuar			Kontraktuar X			Shuma totale e likuiduar në përfundim të Programit			Të likuara X			Shuma totale e disbursuar			Disbursuar X			Kostot totale të ajudues			Kostot X			Totali i Para-financimit			Para-financimi X			Aktivitetet e kontraktës totale				Balanca Bankare (Kontributi i BE)			Parashikimi i disbursimeve (BE)	
																																		Gabimet	Parregullsitë	Humbjet	Pa kushtet	Totali	Totali i kushtëzuar	Totali i parashikimeve të disbursimit mujor	12 muajt e ardhshëm	X kushtëzuar
1	2	3			4			5			6			7			8			9			10			11			12			13			14	15	16	17	18	19	20	21	22
		3a	3b	3c	4a	4b	4c	5a	5b	5c	6a	6b	6c	7a	7b	7c	8a	8b	8c	9a	9b	9c	10a	10b	10c	11a	11b	11c	12a	12b	12c	13a	13b	13c									
								4a/3a*100 XX	4b/3b*100 XX	4c/3a*100XX				6a/4a*100 XX	6b/4b*100 XX	6c/4a*100 XX				8a/4a*100 XX	8b/4b*100 XX	8c/4a*100XX				10a/4a*100 XX	10b/4b*100 XX	10c/4a*100XX				12a/4a*100 XX	12b/4b*100 XX	12c/4a*100XX						19/3a*100XX			21/3a*100XX
		Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi i BE	Kontributi i Kombëtar	Burime të tjera									
IPA2018	2018/039-456																																									
IPA 2019/039 2018																																										

(*) 15 Shkurt

Nën menaxhim e tërthortë duhet të sigurohen dhe Shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1

Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me MK (maksimumi një faqe)

Shtojca 2

Histori suksesi (Shënim. ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare, i cili përgatitet nga Komisioni Evropian).

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Shtojca e mëposhtme duhet të sigurohet si për menaxhimin e drejtpërdrejtë, ashtu dhe për atë të tërthortë:

Shtojca 4

Udhërrëfyesi i qasjes sektoriale – arritjet (duke theksuar nëse objektivat e planifikuara janë përmbushur ose jo).

II a. Treguesit e performancës në sektorin [*p.sh. transporti*] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[3] për program

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit[5]	**Treguesi për sektor [*Transporti*]**	**Burimi**	**Baza**	**Komponentët kryesorë (2017)**	**Objektivi (2020)**	**Vlera (2014[4])**
2014 Programi i vendit	*Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit*					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	*Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti*					

[3] Këto duhet të jenë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit

[4] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

5 Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumë vjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit	**Projekti**	**Situata/Progresi për projekte të veçanta (p.sh. Termat e Referencës në përgatitjen për shpalljen e tenderit, kontraktimin, zbatimin, përfundimin)**	**Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre**	**Probleme kryesore të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre**	**Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen**	**Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese**
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*P.sh., Kontratë Shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*P.sh., Kontrata e Shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe duhet të ri-shpallet*	*P.sh., ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja me dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operuese ekzistuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me të, nëse ka.
2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra/planifikuara.
3. Rekomandime për veprime të mëtejshme
4. Auditimet e kryera - gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

Shtojca III A Modeli i Raportimit Vjetor
Periudha e mbuluar nga raporti:
01/01/20XX-31/12/20XX
Raport i lëshuar më XX/XX/20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhim e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vendi] të paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referencë e objektivave të Dokumenteve Strategjikë të Vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve
2. Përfshirja në programim
3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.
4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.
5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-s dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.
6. Përfshirja në veprimet shumë-vendëshe dhe çdo çështje që ka lidhje me to.
7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.
8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.
9. Koordinimi i donatorëve

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjithashtu:

10. Zbatimin gjithëpërfshirës të asistencës së IPA-s nën menaxhim e tërthortë (maksimumi një faqe).
11. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-s dhe masat përkatëse të marra /planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).
12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).
13. Auditimet - gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

II. Informacion sipas Sektorëve

Titulli i sektorit[98]: [*Transporti*]

Pjesa përshkruese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim
2. Përmbledhje e rezultateve të arritura drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritura sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të Sektorit).
3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe / ose donatorë / IFI-të brenda sektorit.
4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim e tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me to, nëse ka: [*Ministria e Transportit]*
6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor.
7. Arritjet kryesore në atë sektor.
8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat e marra / planifikuara në vijim.
9. Rekomandime për veprime të mëtejshme.
10. Aktivitetet monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet - gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndërkufitar[99]

1. Përfshirja në programim, sipas rastit.
2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë

[98] Sipas sektorëve në Dokumentet tregues të Strategjisë.
[99] Për Bashkëpunimin Ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.

4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave dhe kur është e zbatueshme, dhe aktivitete vlerësimi.

5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe svizibilitetin.

6. Koordinimi me vendin partner.

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

Shtojca 1

Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me MK (maksimumi një faqe)

Shtojca 2

Histori suksesi (Shënim. ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare, i cili përgatitet nga Komisioni Evropian).

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Shtojca e mëposhtme duhet të sigurohet si për menaxhimin e drejtpërdrejtë, ashtu dhe për atë të tërthortë:

Shtojca 4

Udhërrëfyesi i qasjes sektoriale – arritjet (duke theksuar nëse objektivat e planifikuara janë përmbushur ose jo).

II a. Treguesit e performancës në sektorin [*p.sh. transporti*] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[3] për program

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit[5]	**Treguesi për sektor [*Transporti*]**	**Burimi**	**Baza**	**Komponentët kryesorë (2017)**	**Objektivi (2020)**	**Vlera (2014[4])**
2014 Programi i vendit	*Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit*					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	*Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti*					

[3] Këto duhet të jenë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit

[4] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

5 Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumë vjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit	**Projekti**	**Situata/Progresi për projekte të veçanta (p.sh. Termat e Referencës në përgatitjen për shpalljen e tenderit, kontraktimin, zbatimin, përfundimin)**	**Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre**	**Probleme kryesore të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre**	**Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen**	**Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese**
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*P.sh., Kontratë Shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*P.sh., Kontrata e Shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe duhet të ri-shpallet*	*P.sh., ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja me dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operuese ekzistuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me të, nëse ka.
2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra/ planifikuara.
3. Rekomandime për veprime të mëtejshme
4. Auditimet e kryera - gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

DEKRET
Nr. 11896, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 158/2020, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integrimit Evropian dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi–Shqipëri, 2014–2020, alokimet për vitin 2019".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 159/2020

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI PËR ÇËSHTJET EUROPIANE, DHE KOMISIONIT EUROPIAN PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MAQEDONI E VERIUT-SHQIPËRI 2014-2020, ALOKIMET PËR VITIN 2019

Në mbështetje të neneve, 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Europiane, dhe Komisionit Europian për

programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11897, datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE FINANCIMI
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane dhe Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, në vijim të referuar bashkërisht si "Përfituesit e IPA II" ose individualisht si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

ndërsa,

Çdo referim i përfshirë në këtë marrëveshje dhe anekset e tij në "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" duhet të lexohet "Republika e Maqedonisë së Veriut"

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin e lëvrimit për vitin 2019 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

"Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë për vitet 2018-2020"[100],

Numri global i angazhimit (CRIS): 2019/041-371

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)[101].

2. Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e lëvrimit për vitin 2019 të këtij Program Veprimi është 2 000 000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është caktuar në 1 700 000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e IPA II.

Neni 2
Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3
Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar dhe do t'i referohet shprehimisht Programit të Veprimit siç identifikohet në nenin 1 (1), dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin

Znj. Genoveva Ruiz Calavera

Drejtoria D, Ballkani Perëndimor

Drejtoria e Përgjithshme e Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit,

15, Rue de la Loi, B – 1049

Brussels, Belgium (Belgjikë)

E-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

[100] C(2018)8152 i Dt. 29.11.2018

[101] Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Ndihmën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

b) për përfituesit e IPA II

Sekretariati për Çështjet Evropiane,
Quai Dimitar Vlahov No.4,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,
Tel: +389 (0)2 3200 105, Faks: +389(0)2 3114 569,
E-mail: cabinet@sep.gov.mk

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Drejtoria e Fondeve të BE-së
Bulevardi "Gjergj Fishta" No. 6
Tiranë, Republika e Shqipërisë
E-mail: info@mfa.gov.al

Neni 4
Pikat e kontaktit të Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF)

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të OLAF-it, do të jenë:

-Z. Fatmir Ademi, Shefi i Departamentit për Inspektimin Financiar të Sektorit Publik dhe Koordinimin për Luftimin e Mashtrimit kundër Fondeve të BE-së, Quai Dimitar Vlahov Nr.4, kati 4, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e-mail: fatmir.ademi@finance.gov.mk

dhe,

- Z. Bejko Late, Drejtor i Njësisë së Inspektimit Financiar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bulevardi "Dëshmoret e Kombit" Nr.3, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

e-mail: Bejko.late@financa.gov.al

Neni 5
Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 24 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA II) që ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015 (referuar në vijim si "Marrëveshja/jet Kuadër").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 6
Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

a) këto Kushte të Veçanta;

b) Shtojca I: "Programi i Veprimit të BNK-së, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë për vitet 2018 – 2020"

c) Shtojca IA: "IPA II CBC 2014-2020 Programi ndërmjet ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë";

d) Shtojca II: "Kushtet e Përgjithshme";

e) Shtojca III: Raporti Vjetor i CBC Tip për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;

f) Shtojca IIIA: Raporti Vjetor Tip për zbatimin e ndihmës IPA II në përputhje me nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;

2. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër, të dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA dhe dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës I, nga njëra anë dhe dispozitave të Shtojcës IA nga ana tjetër, të parat do të kenë përparësi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi në datën kur Komisioni merr një njoftim nga përfituesi i fundit IPA II (Republika e Shqipërisë), duke konfirmuar përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA II, të nevojshme për këtë hyrje në fuqi. Komisioni informon përfituesit e IPA II për datën e marrjes së këtij

njoftimi. Kjo Marrëveshje e Financimit nuk do të hyjë në fuqi nëse një njoftim i tillë nuk është marrë nga Komisioni deri më 31 dhjetor 2020.

Kjo marrëveshje është hartuar në tre kopje në gjuhën angleze, një i dorëzohet Komisionit dhe një secilit prej përfituesve të IPA II.

Për përfituesit e IPA II:
Për Republikën e Maqedonisë së Veriut

Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Shkup datë 26 nëntor 2020:

Për Republikën e Shqipërisë:
Z. Zef Mazi
Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Kryenegociator

Tiranë

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtore pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit, Drejtoria D, Ballkani Perëndimor

Bruksel datë: 10 qershor 2020

SHTOJCA 1

PROGRAMI I VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR NDËRMJET ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR VITET 2018-2020

I. Identifikimi

Përfituesit	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë Republika e Shqipërisë
CRIS/ABAC, Referencat e angazhimit **Kontributi i Bashkimit** **Buxheti**	EURO 1,700,000 22.020401 2018/041-370 EURO 1,700,000 22.020401 2019/041-371 EURO 1,190,000 22.020401 2020/041-372
Mënyra e menaxhimit **Strukturat përgjegjëse**	Menaxhim i drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Ministria e Vetëqeverisjes Vendore Në Republikën e Shqipërisë: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Data përfundimtare për mbylljen e <u>Marrëveshjes/ve të Financimit</u> me vendet përfituese (trepalëshe) të IPA II	Për angazhimin buxhetor të vitit 2018: Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2019 Për angazhimin buxhetor të vitit 2019: Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2020 Për angazhimin buxhetor të vitit 2020: Në rastin më të vonë deri më 31 dhjetor 2021
Data përfundimtare për mbylljen e <u>kontratave të prokurimit dhe granteve</u>	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit) me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 114 (2) të Rregullores Financiare
Data përfundimtare për zbatimin operacional	6 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit).
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes Financiare (data nga e cila ky program duhet të tërhiqet nga detyrimi dhe të mbyllet), pas pranimit të llogarive	12 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit (nga nënshkrimi i palës së fundit).
Njësia e Programimit	DG NEAR Njësia D3, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova
Njësia Zbatuese / Delegacioni i BE-së	Delegacioni i Bashkimit Evropian për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

2. PËRSHKRIM I PROGRAMIT TË VEPRIMIT

2.1 PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR 2014-2020 DHE PROGRAMI I VEPRIMIT TË BNK-SË 2018-2020

Programi i BNK-së 2014-2020 i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë - Republika e Shqipërisë (Vendimi Zbatues i Komisionit C(2014) 9674 i datës 11 dhjetor 2014). Programi i miratuar 2014-2020 përbën strategjinë e bashkëpunimit ndërkufitar për rajonin kufitar, duke përcaktuar, ndër të tjera, listën e zonave gjeografike të pranueshme, kontekstin e zonës, prioritetet e programit dhe ndarjen e buxhetit për periudhën 7 vjeçare.

Programet BNK 2014-2020, shërbejnë gjithashtu si referencë për miratimin e programeve të veprimit të BNK-së. Programi i veprimit 2018-2020 i BNK-së synon sigurimin e ndihmës për bashkëpunim ndërkufitar në fushat tematike të parashikuara në programin 2014-2020 (siç tregohet në seksionin 2.2).

Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi një Komunikim[102], i cili synon të gjenerojë një vrull të reformave të rinovuar në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojnë angazhim të zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme në BE për të mbështetur më mirë përgatitjet e tyre në rrugën evropiane. Komunikimi përcakton orientimet e reja strategjike, veçanërisht në lidhje me zbatimin e 6 nismave kryesore. Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kryesor për nxitjen e rivendosjes së marrëdhënieve miqësore dhe trajtimi i trashëgimisë së kaluar në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me nismën e 6-të (mbështesin pajtimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë) dhe për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në përputhje me nismën e 3-të (mbështetje e zhvillimit socio-ekonomik).

Lista e zonave gjeografike të pranueshme

në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë zona e pranueshme janë:

-Rajoni i Pelagonias: bashkitë e Bitolas, Demir Hisarit, Dolnenit, Krivogastanit, Krusevos, Mogilas, Novacit, Prilepit, dhe Resenit;

-Rajoni i Pologut: bashkitë e Bogovinjes, Brvenicas, Gostivarit, Jegunovces, Mavrovës dhe Rostusas, Tearces, Tetovës, Vrapcistes dhe Zelinës;

-Rajoni Jugperëndimor: bashkitë e Centar Zupas, Debarit, Debarcas, Kicevos, Makedonski Brod, Ohrit, Plasnicas, Strugës dhe Vevcanit.

Në Republikën e Shqipërisë zonat e pranueshme janë:

-Rajoni i Dibrës: rrethet e Bulqizës, Burrelit dhe Dibrës;

-Rajoni e Elbasanit: rrethet e Cërrikut, Elbasanit, Gramshit, Librazhdit dhe Peqinit;

-Rajoni i Korçës: rrethet e Devollit, Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit.

Bashkëpunimi ndërkufitar (BNK), konteksti i zonave përfituese

Në bazë të analizës së situatës së bërë për përgatitjen e Programit dolën në pah disa sfida dhe mundësi kryesore për t'u adresuar dhe mbështetur përmes bashkëpunimit ndërkufitar. Në veçanti, Programi parashikon adresimin e prioriteteve vijuese tematike si :

1. Inkurajimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;
2. Rritjen e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutja, parandalimi dhe menaxhimi i riskut

Prioriteti numër 1, bazohet në mundësitë e identifikuara strategjike në lidhje me rëndësinë në rritje të turizmit si një mundësi ekonomike ndërkohë që nxitet shkëmbimi kulturor dhe, promovimi i trashëgimisë natyrore do të ruajë dialogun mes njerëzve dhe dialogun e shoqërisë civile me institucionet.

Prioritet numër 2, nxitet nga nevoja dhe mundësitë dhe kërkon të zgjidhë nivelin e ulët të punësimit në zonën e Programit.

Prioriteti numër 3 synon t'u përgjigjet nevojave specifike të një prej sektorëve të politikave më të neglizhuara; të mjedisit dhe ndryshimit klimatik. Në kontekstin e BNK-së, kjo do të zgjidhë çështjen e nxitjes së ekonomisë së pastër dhe të gjelbër, përdorimin më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore, elasticitetin e klimës në infrastrukturën e një shkalle të vogël mbështetëse (kundër përmbytjeve dhe zjarreve) dhe erozionit të tokës në zonën kufitare malore.

[102] Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi një Komunikim me temë "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe angazhim i zgjeruar i BE me Ballkanin Perëndimor".

Përmbledhje e përvojës së kaluar dhe asaj në vazhdim të BNK-së, përfshirë mësimet e nxjerra

Rekomandimet kryesore nga vlerësimet e ndërmjetme dhe auditimet e programeve të BNK-së 2007-2013 janë marrë parasysh në zhvillimin e këtij programi. Kështu që, programet e BNK-së 2014-2020 janë më të fokusuar për sa i përket numrit të prioriteteve dhe zonave gjeografike të përfshira, gjë që do të ndihmojë në arritjen e rezultateve më të mira dhe rritjen e ndikimit. Përveç kësaj, zbatimi i programeve të BNK-së është thjeshtuar kryesisht nëpërmjet pasjes së një autoriteti të vetëm kontraktues dhe një zarfi të vetëm financiar për program.

Mësimet kryesore të nxjerra u identifikuan gjithashtu nga vlerësimi përfundimtar i Programit CBC të Asistencës Para-Anëtarësimit (IPA) CBC 2007-2013, që u realizua ndërmjet viteve 2016 dhe 2017. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet u diskutuan me palët e interesuara të CBC në Ballkanin Perëndimor, gjithashtu dhe masat për ndjekje që u identifikuan për një afat të shkurtër dhe të mesëm, si për programet në vazhdim CBC 2014-2020, ashtu edhe për programet e ardhshme 2021-2027 CBC. Rekomandimet kryesore në lidhje me të gjitha programet CBC në nivelin e Ballkanit Perëndimor përfshijnë:

-Qëllimi kryesor i promovimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë duhet të reflektohet qartë në projektet e BNK-së.

-Thirrjet për propozim duhet të përqendrohen më shumë në disa çështje prioritare që kanë përmbajtje të lartë ndërkufitare.

-Logjika e ndërhyrjes së programeve dhe sistemet e raportimit dhe monitorimit duhet të përmirësohen pasi ato nuk janë të strukturuara për të vendosur një bazë të qartë për matjen e rezultateve në nivelin rajonal.

Ekziston nevoja për të vazhduar me aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për Strukturat Operuese dhe Sekretaritë Përbashkëta Teknike/Antenat.

Ekziston nevoja për përmirësimin e sinergjive me politikat dhe donatorët e tjerë, kapitalizimin dhe shkëmbimin e përvojave me mjediset e tjera të BNK-së (p.sh. programet INTERREG dhe ENI CBC).

2.2 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I VEPRIMEVE

Veprimi 1	**Operacionet e Bashkëpunimit Ndërkufitar**	**4,930,000 EURO**

Ndihma e parashikuar për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë konsiderohet se ndjek kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në bazë të nenit 215 TFEU[103].

1. Përshkrimi i veprimit, objektivat, rezultatet e pritshme

Përshkrimi i veprimit: Operacionet e Bashkëpunimit Ndërkufitar në rajonin kufitar në fushën e mjedisit; përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut; turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore; konkurrencës; zhvillimit të biznesit dhe NVM-ve, tregtisë dhe investimeve.

Objektivat: Zhvillimi socio-ekonomik dhe forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë në zonën ndërkufitare përmes implementimit të operacioneve të bashkëpunimit ndërkufitar me qëllim:

a) Mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut, ndër të tjera, përmes,: veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; nxitjes së përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efiçencës së burimeve, burimeve të energjisë së rinovueshme dhe ndryshimin drejt një ekonomie të sigurt dhe të qëndrueshme me shkallë ndotjeje sa më të ulët; promovimit të investimeve për shmangien e rreziqeve specifike, duke siguruar elasticitet në raste katastrofash dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive, si dhe gatishmërinë në rastet emergjente;

b) Inkurajimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

c) Rritjen e konkurrencës; rritjen e mjedisit të biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; rritjen e tregtisë dhe investimeve, ndër të tjera, përmes, promovimit dhe mbështetjes së sipërmarrjes, në veçanti ndërmarrjeve të vogla dhe

[103] https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en

të mesme; zhvillimin e tregjeve ndërkufitare dhe ndërkombëtarizimin;

Rezultatet e pritshme:

a) Nxitja e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit;

b) Nxit bashkëpunimin, kuptimin dhe respektimin e ndërsjelltë i vlerave dhe trashëgimisë kulturore;

c) Rritjen e mundësive të biznesit dhe ofruesve të shërbimeve dhe operatorët lokale në fushën e turizmit;

d) Rritja e ndërgjegjësimit dhe kapacitetit të NVM-ve dhe sipërmarrjeve fillestarëve për të hyrë në tregje të reja dhe rritja e gamës së vlerave.

Objektivat dhe rezultatet e pritshme do të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Programi i Veprimit i BNK 2018-2020 do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të rezultateve të pritshme, të përcaktuara në programin e BNK-së 2014-2020. Për hollësi të mëtejshme shihni seksionin 3.2 të programit BNK 2014-2020 (Shtojca 2 e Vendimit Zbatues të Komisionit C (2014) 9674, i datës 11 dhjetor 2014).

2. Supozime dhe kushte

Si një kusht i nevojshëm për menaxhimin efektiv të programit, vendet pjesëmarrëse do të krijojnë një Komitet të Përbashkët Monitorimi dhe të sigurojnë zyrat dhe personelin e përshtatshëm për Sekretariatin e Përbashkët Teknik (që do të krijohet me një Vendim Financimi të veçantë) dhe Antenës, në rast se kjo e fundit do të ngrihet.

Dështimi për të përmbushur kërkesat e përcaktuara më sipër mund të çojë në tërheqjen e fondeve të këtij programi dhe / ose ri-alokimin e fondeve në të ardhmen.

Deri më tani, përfituesit janë pajtuar me këtë gjendje duke siguruar mbarëvajtjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Strugë (përfitues Ministria e Vetëqeverisjes Lokale) dhe Zyrës së Antenës në Elbasan. Këto struktura janë financuar plotësisht nga Masa Mbështetëse për Ndihmën Teknike për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA II në kuadër të Instrumentit për ndihmë para-anëtarësimi (IPA II) për vitin 2014[104].

Komisioni Evropian ka programuar mbështetje e mëtejshme financiare për vazhdimin e ofrimit të mbështetjes për Sekretariatin e Përbashkët Teknik dhe Zyrën e Antenës nga viti 2019 e tutje. Prandaj me përfituesit do të vendosin rregullime të reja që duhet të sigurojnë që kushtet e këtij paragrafi të respektohen më tej.

3. Elementet thelbësore të veprimit

Thirrje për propozime - Grante: 4,930,000 EURO

a) Kriteret thelbësore të pranimit:

Aktivitetet e pranueshme janë përcaktuar në nenin 3.2 i Programit të BNK-së 2014-2020, dhe në Shtojcës 2 të Vendimit të Komisionit C (2014) 9674, të datës 11 dhjetor 2014. Lista e mëposhtme është një përmbledhje që tregon veprimet /operacionet kryesore të pranueshme:

-Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve të përbashkëta turistike dhe shërbimeve, si dhe investimet e vogla në infrastrukturën publike të turizmit.

-Trajnimet për nxitjen e aftësive në industrinë e mikpritjes/turizmit.

-Restaurimi/rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike si dhe mjedisit rrethues.

-Mbështetja për aktivitete të përbashkëta kulturore.

-Ndihma për NVM-të dhe sipërmarrjeve fillestare në gjetjen e partnerëve të biznesit dhe ndërkombëtarizimit i tyre.

-Investimet në tregun e vogël ndërkufitar dhe lehtësirat në tregti.

-Nxitja dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit.

-Nxitja e investimeve në infrastrukturën e vogël për përballimin në rast fatkeqësish dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përfituesit duhet të jenë persona juridikë dhe të vendosur në një vend përfitues të IPA II, pjesëmarrës në programin e BNK-së.

Përfitues potencialë mund të jenë autoritetet vendore, njësitë ligjore të menaxhuara nga qeveritë vendore, shoqata të komunave, agjencitë e zhvillimit, organizatat e mbështetjes së bizneseve vendore, faktorët ekonomikë si, NVM-të, organizatat kulturore dhe të turizmit, OJQ-të, organet publike dhe private në mbështetje të fuqisë punëtore, institucionet e trajnimit profesional dhe teknik, organet dhe organizatat për mbrojtjen e

[104] C(2014) 37629

natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e zjarrit/emergjencës, shkollat, kolegjet, universitetet dhe institucionet kërkimore, duke përfshirë institucionet e trajnimit teknik dhe profesional, dhomat e tregtisë, shoqatat e banorëve të vendeve të BNK-së, organizatat e fermerëve, ndërmarrjet publike.

b) Kriteri kryesor i përzgjedhjes është kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit.

b) Kriteret kryesore për dhënien e mbështetjes financiare janë rëndësia, efektiviteti dhe fizibiliteti, qëndrueshmëria dhe efektiviteti i kostos së veprimit.

d) Shkalla maksimale e bashkë-financimit nga BE-ja për grante në bazë të thirrjeve është 85% e kostos së veprimit.

e) Shuma treguese e thirrjes/ve: 4,930,000 EURO

Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të publikojnë më shumë se një thirrje për propozime. Çdo thirrje për propozime duhet të ketë të njëjtat objektiva, rezultate, kriteret thelbësore mbi pranueshmërinë, kritere përzgjedhjeje dhe dhënieje, siç përshkruhet më sipër. Secila kontratë granti do të financohet nga një urdhër buxhetor.

Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të fillojnë një thirrje për propozime të cilat do të bashkojnë alokimet e vitit 2018 me alokimet e mëvonshme të buxhetit.

f) Datë treguese për publikimin e thirrjes/ve për propozime: Q2 2020 për urdhrin buxhetor të viteve 2018 – 2020.

3. BUXHETI

2018				2019				2020				Vendimi i Financimit Total
	Kontributi i Bashkimit*	Bashkëfinancimi i Përfituesit / ve të grantit**	Totali i shpenzimeve		Kontributi i Bashkimit	Bashkëfinancimi i Përfituesit / ve të grantit	Totali i shpenzimeve		Kontributi i Bashkimit	Bashkëfinancimi i Përfituesit / ve të grantit	Totali i shpenzimeve	
Operacionet e BNK-së	1.700.000	300.000	2.000.000	Operacionet e BNK-së	1.700.000	300.000	2.000.000	Operacionet e BNK-së	1.530.000	270.000	1.800.000	4.930.000
në %	85	15	100	**në %**	85	15	100	**në %**	85	15	100	
TOTALI 2018	1.700.000	300.000	2.000.000	**TOTALI 2019**	1.700.000	300.000	2.000.000	**TOTALI 2020**	1.530.000	270.000	1.800.000	**5.800.000**

/

* Kontributi i Bashkimit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë-financimit të Bashkimit për çdo prioritet nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të lejueshme.

**Bashkë-financimi i prioriteteve do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të kostos totale të lejueshme të projektit.

4. ZBATIMI

4.1 MËNYRA E ZBATIMIT DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT DHE DHËNIES SË GRANTIT

MENAXHIMI I DREJTPËRDREJTË:

Ky program do të zbatohet me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni / nga delegacionet e Bashkimit në përputhje me nenin 62 (1)(a) të Rregullores Financiare.

5. MARRËVESHJET E MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

Si pjesë e kornizës së tij të matjes së performancës, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifike të përcaktuara në Rregulloren e IPA II në bazë të treguesve të paracaktuar, të qartë, të matshëm e transparente. Progres raportet e përmendura në nenin 4 të Rregullores së IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të ndihmës IPA II.

Komisioni do të mbledhë nga të gjitha burimet e të dhënave mbi performancën (procesin, treguesit e produkteve dhe rezultateve), të dhëna që do të mblidhen dhe të analizohen në aspektin e matjes së progresit kundrejt objektivave dhe synimeve të përcaktuara për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe në Dokumentin Strategjik Indikativ.

Koordinatorët Kombëtarë të IPA-s (KKIPA-t) do të mbledhin informacion mbi performancën e veprimeve dhe programeve (procesin, treguesit e produkteve dhe rezultateve) dhe të koordinojë grumbullimin dhe prodhimin e treguesve që vijnë nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme: a) Sistemi Monitorim i Orientuar në Rezultate (MOR); b) Monitorimi i vetë përfituesve të IPA II; c) Vetë-monitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; d) Monitorimi i përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Negociatave të Fqinjësisë dhe Zgjerimit (NEAR) dhe Përfituesit të IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi në zbatimin e ndihmës financiare do të monitorohet rregullisht nga një komision Monitorimi i IPA II, i mbështetur nga Komisioni i Përbashkët i Monitorimit, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel programi.

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA-ANËTARËSIMIT
2014-2020
PROGRAMI IPA CBC
ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË – REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MIRATUAR MË 11/12/2014

Tabela e Përmbajtjes

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA-ANËTARËSIMIT1
2014-2020
AKRONIME
PËRMBLEDHJE
SEKSIONI 1
PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT
1.1 Përmbledhje e Programit
1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve
SEKSIONI 2
ZONA E PROGRAMIT
2.1 Analiza e Situatës – Përmbledhje
2.2 Gjetjet kryesore
SEKSIONI 3
STRATEGJIA E PROGRAMIT
3.1 Arsyetimi - Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes
3.2 Përshkrimi i Prioriteteve Tematike të Programit
3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura
SEKSIONI 4
PLANI FINANCIAR
SEKSIONI 5
DISPOZITAT ZBATUESE
LISTA E SHTOJCAVE
SHTOJCA 1
Analiza e Situatës dhe Analiza SWOT
Analiza e Situatës së Zonës së Programit
Analiza SWOT

AKRONIME

CBC	Bashkëpunimi Ndër-Kufitar
CfP	Thirrje për Propozime
CSO	Organizatë në Mbështetje të Komunitetit
DG	Drejtoria e Përgjithshme
ERE	Autoriteti Kombëtar Rregullator i Energjisë Elektrike (Republika e Shqipërisë)
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
GBER	Rregullorja e Përgjithshme e Bllokimit dhe Përjashtimeve (BE)
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GfA	Udhëzimet për Aplikantët
GVA	Vlera e Shtuar Bruto
HR	Burimet Njerëzore
ICT	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
INSTAT	Instituti Statistikor i Republikës së Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit
JTF	Task Forca e Përbashkët
JTS	Sekretariati i Përbashkët Teknik
KPI	Treguesit Kryesorë të Performancës
LFS	Anketim mbi Fuqinë Punëtore
LP	Partneri Udhëheqës (Parimi i Partnerit Udhëheqës)
LSMS	Studimi për Matjen e Standardeve të Jetesës (Banka Botërore)
MIS	Sistemi i Menaxhimit te Informacionit
MoU	Memorandum Mirëkuptimi
NACE	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NGO	Organizatë Jo-Qeveritare
NIPAC	Koordinatori Kombëtar i IPA-s
NSDI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Republika e Shqipërisë)
NUTS	Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat
OS	Struktura Operative
PRAG	Udhëzime Praktike të Procedurave të Kontraktimit për Veprimet e Jashtme të KE
RDI	Kërkimi shkencor, Zhvillimi dhe Inovacioni
SBA	Akti për Biznesin e Vogël (EU)
SME	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, duke përfshirë Firmat e Vogla
OMC	Metoda e Hapur e Koordinimit për Mbrojtjen Sociale dhe Përfshirjen Sociale (BE)
SWOT	Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve
TP	Prioritet Tematik



PËRMBLEDHJE

Titulli i programit	Programi BNK: ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë
Zona e programit	ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Pellagoni, Pollog, Jug-perëndimi Republika e Shqipërisë: Dibër, Elbasan, Korçë
Objektivi i përgjithshëm i programit	Të stimulojë një zhvillim më të ekuilibruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në aspektin social-ekonomik, në zonën kufitare
Prioritetet tematike të programit	1.Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4) 2.Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7) 3.Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2) 4.Asistenca teknike
Objektivat Specifike të Programit	TP 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore OS 1: Potenciali i turizmit është zhvilluar nga promovimi i trashëgimisë dhe vlerave kulturore TP 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve OS 2: Kapaciteti produktiv i NVM-ve dhe aksesi i tyre në tregje janë forcuar TP 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut OS 3: Ndërgjegjësimi për një ekonomi të gjelbër, mjedis të pastër dhe ndryshimet klimatike është rritur Asistenca teknike Zbatimi efektiv, efikas, transparent dhe në kohë i programit, dhe rritja e ndërgjegjësimit
Alokimi financiar 2014-2020	11 900 000.00 EURO

Metoda e Zbatimit	Menaxhim i drejtpërdrejtë
Autoriteti Kontraktues	Delegacioni i Bashkimit Evropian në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
Autoritetet përkatëse nga pjesëmarrësit, përfitues të IPA II	Ministria e Vetë-Qeverisjes Lokale (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) Ministria e Integrimit Evropian (Republika e Shqipërisë)
JTS/Antena	JTS në Strugë, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë Antena në Elbasan, Republika e Shqipërisë

SEKSIONI 1
PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi (MZ) dhe Shqipërisë (AL) do të zbatohet në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar me qëllim promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integrimit në Bashkimin Evropian dhe promovimin e zhvillimit social ekonomik. Dispozitat ligjore për zbatimin e tij janë të përcaktuara në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

-Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II);

-Rregullorja (BE) Nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve te Bashkimit Evropian për financimin e veprimit të jashtëm;

-Rregullorja Zbatuese e Komisionit të BE-së Nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e rregullores IPA II.

1.1 Përmbledhje e Programit

Ky Program Bashkëpunimi Ndërkufitar mbulon periudhën 2014-2020 dhe lidhet me Perspektivën e Re Financiare të Komunitetit Evropian. Ai është hartuar mbi bazën e një analize të hollësishme të situatës në zonën e programit

Zona kufitare e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë - Republikës së Shqipërisë përbën një nga zonat më të varfra dhe me më pak mundësi dhe kushte të favorshme për zhvillim social-ekonomik në të gjithë kontinentin evropian, për shkak të karakterit rural, malor dhe të largët të Zonës BNK. Përveç kësaj, situata aktuale e zhvillimit të Zonës së Programit është rrjedhojë e një sërë faktorësh historikë, demografikë, politikë, gjeografikë dhe ekonomikë, të cilët nuk mund të kapërcehen në një periudhë kohore të shkurtër.

Ndërhyrja dhe aktivitetet e propozuara rrjedhin nga 'grupi i problemeve' e kombinuar me analizën strategjike të bilancit dhe burimet e kufizuara të Programit. Ajo synon të trajtojë nyjat problematike më të rëndësishme dhe mundësitë strategjike të identifikuara nëpërmjet analizës social-ekonomike dhe SWOT, përkatësisht:

1. nivelet e ulëta të aktivitetit ekonomik së bashku me mospërputhjen e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës,
2. infrastrukturën e pazhvilluar dhe të vjetërsuar, dhe
3. potencialet në zhvillimin e turizmit dhe shkëmbimin kulturor.

Realisht nuk pritet që **Zona e Programit** të rritet shpejt, edhe pse **po shkon drejt një zhvillimi social-ekonomik më të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm** përmes testimit të instrumenteve dhe zgjidhjeve reja, duke mësuar nga rajone të tjera dhe duke mobilizuar dhe shfrytëzuar potencialin e brendshëm. Kjo mund të çojë në standarde më të larta të jetesës, vetë-besim dhe siguri sociale.

Programi përqendrohet në tri prioritete tematike të Rregullores IPA II që rrjedhin nga analiza e nevojave-mundësive. Përkatësisht, këto janë:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (i nxitur nga mundësitë);
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (i nxitur nga nevojat dhe mundësitë);
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (i nxitur nga nevojat).

Programi BNK përfshin e një prioritet mbi Asistencën Teknike.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Procesi i programimit të këtij Programi IPA II BNK për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë filloi në korrik të vitit 2013. E gjithë rrjedha e programimit u bazua në

përvojën e përbashkët të procesit që ishte zhvilluar në periudhën 2007-2013.

Zhvillimi i këtij dokumenti të Programit u drejtua nga Task Forca e përbashkët e përbërë nga përfaqësues të dy Strukturave Operative, delegatët e zyrës së NIPAC në të dy vendet, përfaqësues të rajoneve të Zonës së Programit NUTS-3 dhe disa njësi vetë-qeverisëse. Puna e JTF u lehtësua dhe mbështet nëpërmjet Projektit të Asistencës Teknike CBIB+, financuar nga BE, i cili solli praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë proces.

Sesionet e punës së SO dhe JTF u realizuan në të gjithë fazën e programimit, në mënyrë që të siguronin komunikim efektiv për të identifikuar prioritetet tematike për tu trajtuar në strategjinë e zhvillimit të Zonës së Programit dhe për ngritjen e strukturave të përshtatshme të zbatimit dhe monitorimit. Përveç konsultimeve midis dy OS-ve, në kuadër të lehtësimit të të mësuarit dhe rrjetëzimit nën Projektin CBIB+, u zhvilluan:

Data/Vendi	Aktiviteti
18/07/2013, Strugë	Takim i Strukturave Operative: identifikimi i sfidave dhe çështjeve kryesore; shkurtimi fillestar i listës së Prioriteteve Tematike dhe marrëveshja për analizën SWOT.
23/09/2013, Shkup	Takimi i parë me Ministrinë e Vetë-qeverisjes Lokale, Delegacionin e Bashkimit Evropian, ekipin e programimit dhe pikën e kontaktit kombëtare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.
27/09/2013, Tiranë	Trajnim mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë: 14 pjesëmarrës (OSs, JTF, JTS, CBIB+): shpjegimi i procesit të programimit të IPA II CBC, diskutimi i mësimeve të nxjerra nga programi/et aktual/e, planifikimi hap pas hapi (analiza e situatës, gjetjet kryesore (SWOT, nevojat), bërja e zgjedhjeve strategjike – zgjedhja e prioriteteve, përcaktimi i prioriteteve, treguesit dhe objektivat), kontrolli i logjikës së ndërhyrjes, çështjet horizontale dhe ndërsektoriale.
30/09/2013, Shkup	Trajnim mbi zhvillimin dhe formulimin e strategjisë: 21 pjesëmarrës (OSs, JTF, JTS, CBIB+): shpjegimi i procesit të programimit të IPA II CBC, diskutimi i mësimeve të nxjerra nga programi/et aktual/e, planifikimi hap pas hapi (analiza e situatës, gjetjet kryesore (SWOT, nevojat), bërja e zgjedhjeve strategjike – zgjedhja e prioriteteve, përcaktimi i prioriteteve, treguesit dhe objektivat), kontrolli i logjikës së ndërhyrjes, çështjet horizontale dhe ndërsektoriale.
04/10/2013, Shkup	Takim i Task Forcës së përbashkët: reagime nga analiza SWOT fillestare, takimi me ekipin e Asistencës Teknike, diskutim mbi prioritetet tematike dhe logjikën e ndërhyrjes, hapat për të përfunduar dokumentin e Programit (14 pjesëmarrës).
24/10/2013, Strugë	Takim i Task Forcës së përbashkët: situata përfshirëse dhe analiza SWOT, konfirmimi i prioriteteve tematike dhe përzgjedhja fillestare e aktiviteteve dhe aksioneve; diskutimi mbi treguesit; alokimet financiare.
07/11/2013, Tiranë	Takim i Task Forcës së përbashkët: Diskutimi mbi Strategjinë e Ndërhyrjes së Programit dhe Aktivitetet.
21-22/11/2013, Beograd	Forumi Rajonal Konsultativ CBC
06/12/2013, Elbasan	Konsultim publik: U prezantua Dokumenti i Programit, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (14 pjesëmarrës).
11/12/2013, Tiranë	Takimi i Komitetit Monitorues të përbashkët: një temë e veçantë e rendit të ditës ishte prezantimi i procesit të programimit 2014-2020 midis ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë-Republikës së Shqipërisë para përfaqësuesve të JMC nga ministritë e linjës së të dy vendeve, përfaqësuesve të pushtetit vendor, EUD dhe OS-ve (36 përfaqësues).
12/12/2013, Tiranë	Takim teknik me OS-në, DG ENLARG, EUD dhe CBIB +: u zhvillua diskutim mbi Strategjinë e Programit dhe programe të tjera CBC në zhvillim e sipër.
12/12/2013, Pogradec	Seminar i konsultimit publik paraprak: U prezantua Dokumenti i Programit tek palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (11 pjesëmarrës).
13/12/2013, Korçë	Seminar i konsultimit publik paraprak: U prezantua Dokumenti i Programit tek palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (13 pjesëmarrës).

16/12/2013, Dibër	Seminar i konsultimit publik paraprak: U prezantua Dokumenti i Programit tek palët e interesuara, si dhe procesi i zhvillimit të tij, zgjedhja e prioriteteve tematike dhe hapat e ardhshme. Zgjedhja e prioriteteve tematike u konfirmua nga palët e interesuara (15 pjesëmarrës).
14/03/2014, Strugë	Konferenca e konsultimit publik me pjesëmarrjen e palëve të interesuara nga të dy vendet: Komenti mbi përmbajtjen teknike të ndërhyrjes së Programit dhe propozimi për ri-formulimin e aktiviteteve të Programit (54 pjesëmarrës).
31/03/2014, Strugë	Takimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik: Diskutim mbi përmbajtjen e Programit (drafti i dytë), konsensus për ndërhyrjen, aksionet dhe aktivitetet që kanë vijuar nga aktivitetet e konsultimit publik, të mbajtura deri në këtë moment (20 pjesëmarrës).
Maj 2014	Dorëzimi i draftit final të programit tek Komisioni Evropian.

Gjithashtu, partnerë të tjerë të rëndësishëm socialë dhe ekonomikë u ftuan të marrin pjesë aktivisht në

procesin e programimit për Programin IPA CBC II për periudhën 2014-2020 midis ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i kësaj ishte i trefishtë:

1. Të informojë publikun e gjerë mbi gjendjen e përgatitjes së programit për bashkëpunimin ndërkufitar, duke përfshirë fushat orientuese të aktiviteteve të pranueshme për tu mbështetur në kuadrin e këtij programi;
2. Të kontribuojë për analizën SWOT dhe identifikimin e nevojave dhe mundësive prioritare për ndërhyrjet CBC; dhe
3. Ti ofrojë publikut të gjerë një mundësi për të shprehur mendimet e tyre dhe për të dhënë kontribut të vlefshëm në procesin e programimit. Konsultimi publik është organizuar para finalizimit të dokumentit të Programit.

Krahas atyre, parimi i partneritetit është zbatuar nëpërmjet konsultimeve individuale të koordinuara me mbi 80 organizata të shoqërisë civile, kryesisht për analizën SWOT dhe caktimin e prioriteteve tematike, si edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së palëve kryesore të interesuara rajonale dhe lokale në seminaret konsultative.

SEKSIONI 2
ZONA E PROGRAMIT

Mbulimi gjeografik dhe madhësia e zonës përfituese të Programit rrjedh nga asistenca e mëparshme IPA CBC për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë, dhe mbulon tre rajone NUTS-3 në secilin nga vendet. Këto rajone janë të shënuara më poshtë.

Rajonet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë	Madhësia e Zonës së Programit (km^2)	Zona e Programit si % e madhësisë së shtetit
Pellagonia	4,717	18.3
Jug-Perëndimi	3,340	13.0
Pollogu	2,416	9.4
TOTAL	**10,473**	**40.7**

Rajonet e Republikës së Shqipërisë	Madhësia e Zonës së Programit (km^2)	Zona e Programit si % e madhësisë së shtetit
Korça	3,711	12.9
Dibra	2,586	9.0
Elbasani	3,199	11.1
TOTAL	**9,496**	**33.0**

Burimi: Zyra e Statistikave, INSTAT

Madhësia e përgjithshme e Zonës Ndërkufitare në të dy vendet është 19,969 km^2. Rajonet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë përbëjnë 52,5% dhe rajonet e Republikës së Shqipërisë përbëjnë 47.5% të madhësisë së zonës së bashkëpunimit ndërkufitar.

Gjatësia e kufirit midis të dy vendeve që përfaqësojnë zonën e Programit është 191 km. Vija kufitare është e shumëllojshme: 151 km është kufi tokësor, 12 km është kufi në lumin Drin dhe 28 km i kufirit përshkon liqenin e Ohrit dhe Prespës.

Ka 4 pika të vendkalimeve kufitare ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë:

1. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Qafë Thanës, duke çuar në Pogradec, Librazhd dhe Elbasan;
2. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Tushemishtit, në skajin juglindor të liqenit të Ohrit, duke çuar në Pogradec;
3. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Bllatës, duke çuar në Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel;
4. Nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, përmes Goricës, duke çuar në brigjet veriore të Liqenit të Prespës.

Gjashtë rajonet që përbëjnë zonën e Programit kanë një popullsi prej 1,427,675 banorë, nga të cilët ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë përmban 54% të këtij numri, dhe Republika e Shqipërisë përmban 46% të tyre.[105]

Rajonet e pranueshme në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë përfshijnë 27 komuna, ndërsa në territorin e Republikës së Shqipërisë janë 12 rrethe (me 17 komuna) që hyjnë në zonën e Programit. Këto janë të shënuara më poshtë.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë:

-Rajoni i Pellagonisë përfshin 9 komuna: Manastir, Demir Hisar, Dollnen, Krivogashtan, Krushevë, Mogilla, Novac, Prilep, dhe Resnjë;

-Rajoni i Pollogut përfshin 9 komuna: Bogovinjë, Bërvenicë, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë dhe Rostushë, Tearcë, Tetovë, Vrapçisht dhe Zhelinë;

-Rajoni Jugperëndimor mbulon 9 komuna: Qendër Zhupë, Dibër, Debarcë, Kërçovë, Brod, Ohër, Plasnicë, Strugë dhe Vevçan.

Në Republikën e Shqipërisë:

-Qarku i Dibrës përfshin rrethet: Bulqizë, Burrel dhe Dibër;

-Qarku Elbasan përfshin rrethet Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd dhe Peqin;

-Qarku Korçë përfshin rrethet Devoll, Korçë, Kolonjë dhe Pogradec.

[105]Deri në fund të vitit 2012; burimi: INSTAT dhe Zyra Shtetërore e Statistikave



2.1 Analiza e Situatës – Përmbledhje

Zona e Programit karakterizohet nga burime të pasura natyrore, diversitet etnik dhe kulturë e ngjashme, por me gjuhë të ndryshme të folura. Megjithatë, më e rëndësishmja është se zonat kufitare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë shfaqin trashëgimi të ndryshme ekonomike, që përcakton arsyetimin dhe potencialin për bashkëpunim ndërmjet njerëzve dhe institucioneve përtej kufirit për integrim dhe kohezion social dhe ekonomik më të mirë të rajonit.

Kjo përmbledhje bën dallimin ndërmjet aspekteve të përgjithshme dhe demografike, ekonomike dhe sociale të kohezionit, që frymëzojnë Strategjinë për ndërhyrjen e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020, ndërsa një situatë më e hollësishme dhe analiza SWOT janë bashkëlidhur si shtojca në dokumentin e Programit.

Aspektet e Përgjithshme dhe Demografike

1. Natyra dhe mjedisi janë të pasura me male, fusha kodrinore të kryqëzuara me lumenj, lugina dhe liqene. Kjo zonë përmban tre rezervuare të mëdha të ujit në rajon: Liqenin e Ohrit, Prespës dhe Dibrës, të rrethuar nga një Park Kombëtar duke krijuar kështu **kushte të favorshme për zhvillimin e energjisë hidrike**, në të cilën të dy vendet kanë investuar tashmë. Zonat ekologjikisht të ndjeshme janë të pajisura me mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe **rajoni përmban gati gjysmën e pyjeve të të dy vendeve**.

2. Zona e Programit përmban dy korridore të transportit Pan-Evropian: Korridori VIII dhe Dega D e Korridorit X, të cilat hapin mundësi ekonomike përgjatë dy rrugëve të transportit, por gjithashtu krijojnë sfida në aspektin e mirëmbajtjes së mjedisit dhe infrastrukturës.

3. Të dy vendet shfaqin një nivel pothuajse të barabartë të zhvillimit ekonomik dhe gëzojnë përmirësimin e vazhdueshëm në marrëdhëniet dypalëshe, si dhe rritje në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka marrë statusin e vendit kandidat në

BE, ndërsa aplikimi i Republikës së Shqipërisë varet nga progresi i mëtejshëm i reformës së administratës publike dhe rishikimi i rregullave dhe procedurave parlamentare.

4. Të dy vendet gëzojnë norma pozitive të rritjes natyrore, por numri i popullsisë po rritet më shpejt në Republikën e Shqipërisë se sa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. **Megjithatë, me përjashtim të rajonit të Pollogut dhe atij Jugperëndimor, zona e programit po përjeton tendenca negative.** Të dy vendet vuajnë nga **migrimet e jashtme, të cilët mund të kontribuojnë në shpopullim.** Indeksi mesatar i dendësisë së popullsisë është i ngjashëm në të dyja anët e kufirit, por **shifra shumë të ulëta të dendësisë së popullsisë janë regjistruar në rrethet (prefekturat) e Dibrës dhe Korçës, të cilat tregojnë karakterin e tyre rural dhe periferik.**

5. Popullsia në zonën e programit është relativisht e re (36 vjeç), por **Pellagonia me një moshë mesatare të popullsie prej 40 vjeç, përbën dallim** nga pjesa tjetër e rajonit.

Kohezioni Ekonomik

6. Pabarazitë rajonale në të dy vendet në aspektin e GDP-së për frymë, në përgjithësi konsiderohen të moderuara, por zona e programit përmban rajone që në mënyrë të qartë mbeten prapa; këto janë: Pollogu në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Dibra në Republikën e Shqipërisë (përkatësisht 47% dhe 62% e shifrave kombëtare).

7. Struktura e ekonomisë e përcaktuar nga GVA është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet e Republikës së Shqipërisë mbështeten në bujqësi, pylltari, peshkim dhe tregjet me shumicë dhe pakicë, rajonet në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbështeten në industri, e cila është më e zhvilluar se në Shqipëri, ndërtim dhe tregjet e shërbimeve. Megjithatë, këto nuk përkthehen në GDP shumë më të lartë për shifrat kapitale, dhe tregojnë nivele të ulëta të konkurrencës së këtyre sektorëve dhe industrive.

8. Konkurrenca e ulët është reflektuar në nivelet e ulëta të ndërkombëtarizimit të ekonomisë së zonës së Programit. Vetëm Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Elbasani në Republikën e Shqipërisë, dëshmojnë një pozicion të shquar në tregun e jashtëm, kryesisht për shkak të industrisë minerare, ndërsa rajonet e tjera luajnë rol të parëndësishëm.

9. Sipërmarrja e dëshmuar nga dendësia e SME-ve në raport me dendësinë e popullsisë është në nivele shumë të ulëta, e cila është një çështje e shqetësimit të lartë. Rregullat administrative të komplikuar dhe afatgjatë për tregtinë e jashtme konsiderohen si burokraci, duke penguar mundësitë e tregtisë.

10. Shkalla e punësimit është e ulët në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në mënyrë të konsiderueshme më e lartë në Republikën e Shqipërisë, por për këtë të fundit shkalla e punësimit të lartë rezulton nga niveli minimal i jetesës dhe nga prodhimi bujqësor në shkallë të ulët, i cili siguron një formë të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe të popullsisë rurale, dhe shërben si amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

11. Zona e programit ka potencial të lartë turistik, por këto mundësi janë përqendruar kryesisht në anën e kufirit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

12. Ekonomia rurale është e fragmentuar, por në një shkallë më të lartë në zonën e programit në Republikën e Shqipërisë dhe pronarët e vegjël bujqësorë kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese.

13. Infrastruktura e transportit është e pazhvilluar dhe kjo lidhet si me rrugët lokale, edhe me rrugët kryesore të Korridorit VIII.

Kohezioni Social

14. Zona e programit përmban pakica etnike të konsiderueshme: shqiptarë, romë, turq dhe të tjerë.

15. Nivelet e papunësisë janë shumë të larta për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe relativisht të ulëta në Republikën e Shqipërisë. Për këtë të fundit, kjo dukuri është shkaktuar nga punësimi i lartë (kryesisht informal) në pronat bujqësore.

16. Pagat neto të punonjësve janë në nivele të ngjashme.

17. Zona e Programit në Republikën e Shqipërisë përjeton përjashtim dixhital. Përdorimi i kompjuterëve dhe i Internetit është në nivele të ulëta të papranueshme.

18. Aksesi në arsimin fillor është i balancuar, por ka një sforcim të dëshmuar në arsimin e mesëm në rajonin e Dibrës. Kjo prefekturë gjithashtu pëson shkallën më të lartë të largimit të popullsisë me arsim të lartë në të gjithë zonën e Programit.

19. Nuk ka të dhëna specifike mbi RDI, por praktikisht mungon bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit në të dy vendet dhe fusha e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit nuk është eksploruar.

20. Niveli i ulët i menaxhimit të mbetjeve, i çiftëzuar me intensitetin e lartë të minierave, janë një shqetësim i madh mjedisor. Kjo lidhet me përdorimin e mbetjeve të ngurta dhe mungesën e trajtimit të ujërave të zeza në pjesën më të madhe të zonës së programit.

21. Organizatat e shoqërisë civile janë të pranishme në zonën e programit, megjithatë pozita e tyre financiare është e dobët. Përveç kësaj, OJQ-të në Republikën e Shqipërisë hasin vështirësi me procedurën e regjistrimit, dhe si pasojë legjitimiteti i tyre është penguar.

22. Infrastruktura e kujdesit shëndetësor është e pazhvilluar dhe veçanërisht në zonën e programit të Republikës së Shqipërisë, është e vështirë për të përfituar nga ky shërbim.

2.2 Gjetjet kryesore

Analiza social-ekonomike e kombinuar me vlerësimin e analizës SWOT identifikoi nyjat kyçe problematike për zonën e programit**. Këto janë:**

-Nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik (performancës dhe produktivitetit);

-Lidhur me këtë ka mospërputhje të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës;

-Qasje e pa strukturuar në investimet publike dhe aktivitetet e përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin.

Tre nyjat kryesore problematike janë ndarë më tej në nën-nyja për të reflektuar rrjedhën e marrëdhënies shkak-pasojë që ofron një kontekst strategjik dhe arsyetimin për zonat e ndërhyrjes CBC. Grupi logjik i problemit (ose vendimit) është përshkruar më poshtë.

Përveç këtyre nyjave strategjike, **kapaciteti i ulët institucional i njësive të vetë-qeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile paraqitet si një problem thelbësor ndërsektorial** dhe çështje shumë problematike, e cila manifestohet në planifikimin e mangët dhe alokimin e burimeve të kufizuara.



Shkaqet (ose problemet rrënjësore) në tabelën e mësipërme janë identifikuar përmes analizës së situatës dhe analizës SWOT. Ato njihen si pikat që kanë karakter ndër-sektorial apo ndër-tematik, dhe kështu lidhen me tre prioritetet tematike për ndihmë për bashkëpunimin territorial siç janë identifikuar në Aneksin III të Rregullores së IPA II:

1. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve;[106]

2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;

Përveç problemeve, turizmi dhe trashëgimia kulturore janë identifikuar si një mundësi e rëndësishme ekonomike dhe një mjet për të rritur më tej kontaktet dhe shkëmbimin njerëz-për-njerëz. Kjo lidhet me një tjetër prioritet tematik për asistencën për bashkëpunim territorial në Shtojcën III të Rregullores së IPA II, që është inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Të gjitha prioritetet tematike janë renditur në mënyrë individuale nga palët e interesuara në procesin e programimit CBC (bashkitë, OJQ-të, ministritë e linjës, shoqëritë e shërbimeve publike dhe subjektet e tjera publike, etj.) sipas rëndësisë së perceptuar të tematikave dhe çështjeve.[107] Renditja paraqet një reagim të rëndësishëm të programimit që pasqyrohet në qasjen nga poshtë-lart dhe është ndërtuar mbi parimin e **partneritetit**. Megjithatë, kjo nuk i merr në konsideratë kufijtë e politikave dhe burimeve, të cilët janë aplikuar vetëm nëpërmjet mekanizmit dhe parimit të **koordinimit** (pjesa 3).

SEKSIONI 3
STRATEGJIA E PROGRAMIT

Strategjia njeh prioritetet e komunikuar nga palët e interesuara të programit (seksioni 2.2) të cilat më pas janë përpunuar dhe paraqitur nga Strukturat Operative CBC dhe Task Forca e Përbashkët në krye të përpjekjeve të programimit duke aplikuar parimin e **koordinimit**. Zgjedhjet strategjike janë bërë duke marrë parasysh parimet e mëposhtme mbizotëruese:

Koherenca - Prioritetet tematike nuk u ndryshuan dhe janë të njëjtët që janë komunikuar në Shtojcën III të Rregullores IPA II, dhe përkatësisht në Dokumentin e Strategjisë Shumë-kombëshe;

Partneriteti - Prioritetet e përshtatshme janë zgjedhur bazuar në reagimet e marra nga organizatat që përfaqësojnë autoritetet rajonale, lokale, urbane dhe autoritetet e tjera publike, partnerët shoqërorë dhe ekonomikë, si dhe shoqërinë civile, partnerët mjedisorë, organizatat jo-qeveritare dhe organizatat përgjegjëse për promovimin e barazisë;

Përqendrimi - Strategjia ofron një fokus të rëndësishëm dhe efikas të **burimeve të kufizuara** dhe të ndërhyrjes bazuar në specifikat sociale dhe ekonomike të zonës së programit që fokusohet në temat e përzgjedhura, dhe mbi objektivat dhe masat me një rëndësi të veçantë nga kohezioni social-ekonomik dhe perspektiva e dëshiruar e zhvillimit.

Plotësueshmëria me Programin Kombëtar – programi plotëson dhe përforcon strategjitë kombëtare, ashtu siç janë përcaktuar në Dokumentet e Strategjisë së Vendit, duke mbështetur bashkëpunimin rajonal dhe territorial.

3.1 Arsyetim - Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes

Përmbajtja e Strategjisë së propozuar rjedh nga:

1. Analiza e situatës dhe analiza SWOT;

2. Nyjat problematike të identifikuara dhe mundësitë strategjike; dhe

3. Renditja e prioriteteve tematike sipas rëndësisë së tyre për zonën e programit: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore, Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve, dhe Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.

Një zhvillim social-ekonomik më i balancuar, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në zonën kufitare stimulohet. Ky është titulli dhe objektivi i përgjithshëm i programit, duke pasur parasysh perspektivën afatmesme në ndërhyrjen e propozuar.

Programi synon të ketë sinergji me **objektivat specifike të IPA II** dhe **Dokumentet e Strategjisë së Vendit** në lidhje me: përkrahjen për zhvillimin e shoqërisë civile dhe dialogut social, nxitjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit

[106] Të lidhura me punësimin (TP1) i cili do të konsiderohet si një çështje ndërsektoriale.

[107] Renditja u krye nëpërmjet pyetësorit individual SWOT që u plotësua nga aktorët kryesorë.

njerëzor, përfshirjen sociale dhe ekonomike, dhe bashkëpunimin territorial.

Tabela 1: Pasqyrë sintetike e justifikimit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike

Prioritetet tematike të zgjedhur	Justifikimi për zgjedhjen
Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4, Rregullorja IPA II)	Bazohet në mundësitë strategjike të identifikuara që lidhen me rëndësinë në rritje të turizmit si një mundësi ekonomike, ndërsa nxitja e shkëmbimit kulturor dhe promovimi i trashëgimisë natyrore do të mbështesë nismat njerëzit për njerëz dhe dialogun ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve.
Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7, Rregullorja IPA II)	Synon të trajtojë nivelet e ulëta të punësimit në zonën e programit. Kjo do të trajtohet nëpërmjet përmirësimit të aksesit në tregje, rritjes së përdorimit të instrumenteve të TIK, duke përfshirë tregtinë elektronike dhe shfrytëzimin më efikas të mundësive të zinxhirit të vlerave në zonën kufitare.
Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2, Rregullorja IPA II)	Synon ti përgjigjet nevojave specifike të një prej sektorëve më të neglizhuar të politikave. Në kontekstin CBC ky prioritet do të trajtojë çështjet e promovimit të ekonomisë së pastër dhe të gjelbër, përdorimit më të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbështetjen e infrastrukturës së elasticitetit klimatik në shkallë të vogël (kundër përmbytjeve dhe zjarreve) dhe erozionin e tokës në zonën kufitare malore.

Asistenca Teknike do të sigurojë një menaxhim efikas të programit gjatë gjithë ciklit të jetës dhe zhvillimin e kapaciteteve të palëve të interesuara të programit. Alokimi financiar ndaj këtij prioriteti është 10% e buxhetit të programit.

Alokimi i buxhetit indikativ nëpër prioritetet tematike është një konsensus ndërmjet parimit të përqendrimit kombinuar me shpërndarjen e balancuar të fondeve. Rëndësi e veçantë i është dhënë edhe intensitetit të kapitalit të projekteve të mundshme dhe renditjes aktuale të prioriteteve tematike, ku turizmi, trashëgimia kulturore dhe natyrore janë temat më të preferuara për mbështetje.

Prioriteti Tematik	Shpërndarja e buxhetit të fondeve të BE (%)
1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)	31.5
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)	31.5
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)	27.0
4. Asistenca Teknike	10.0
TOTAL	**100**

Parimi i **rritjes së mençur, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse është i njohur si një çështje ndërsektoriale** dhe është aplikuar në të gjitha prioritetet tematike të programit dhe në objektivat e tyre.

Gjithashtu, strategjia e propozuar bazohet në gjetjet kryesore dhe rekomandimet e raportit të vlerësimit të draftit CBC ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë për vitet 2007-2013. Prandaj, çështjet e mëposhtme merren në konsideratë:

-Mbështetja për projekte të vogla infrastrukturore të përbashkëta që nuk kërkojnë studime dhe projektime të sofistikuara dhe komplekse;

Asistenca ndaj projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e studimeve dhe projektimeve për financim nga burime të brendshme dhe donatorë të tjerë;

-Fokus strategjik për veprime më të fuqishme, të cilët synojnë të sjellin ndikim më të prekshëm;

-Përmirësimi dhe orientimi më strategjik i JTS nën Asistencën Teknike, veçanërisht në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis përfituesve të mundshëm të ndodhur në zonën e programit dhe jo jashtë saj, për të siguruar gatishmërinë e tyre për të aplikuar nën parimin e Partnerit Kryesor;

-Forcimi i rolit të koordinimit strategjik të SO-ve;

-Orientimi i JTS-ve drejt rrjeteve dhe ndarjes së përvojës së projektit ndërmjet organizatave nga zona e programit;

-Nxitja e një roli më aktiv të JTS-ve në monitorimin e programit dhe zhvillimin e mjeteve dhe manualeve të brendshme dhe për përdoruesit e jashtëm;

-Përmirësimi i planifikimit dhe zbatimit të operacioneve nga SPT.

Rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga dy vlerësimet e ndërmjetme mbi programet CBC të fokusuara në strukturat qeverisëse dhe në ecurinë e ndihmës, janë marrë në konsideratë[108]:

Dokumenti i programimit duhet të jetë subjekt i:

1. konsultimeve publike dhe të pasqyrojë në mënyrë të qartë procesin e konsultimeve, duke përfshirë një pasqyrë të personave që morën pjesë dhe rezultatet e procesit të konsultimit;

2. të përfshijë çështjet e ndërlidhura në të gjitha dokumentet e programimit dhe

3. të kryejë një vlerësim të bazuar në parashikime (që do të përfshihet në dokument).

Në lidhje me çështjet organizative, strukturat e programimit duhet të:

1. kryejnë një auditim të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe vlerësimin e nevojave për trajnim;

2. transferojnë detyrat tek JTS-të, duke përfshirë edhe përgatitjen për grantet e asistencës teknike;

3. mbështesin zbatimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit.

3.2 Përshkrimi i Prioriteteve Tematike të Programit

Përshkrimi i secilit prioritet tematik (TP) është organizuar në formën e Fletës me të dhëna për Prioritet me përmbajtje dhe strukturë të njëjtë për secilin prioritet, ndërsa prioriteti i Asistencës Teknike ka një përbërje të veçantë.

Numërimi i prioritetit tematik të programit është radhitur sipas radhës së rëndësisë së TP, e llogaritur gjatë ushtrimeve të programimit duke iu referuar regjistrimit të caktuar të TP të identifikuar në Rregulloren e IPA II.

Figura e mëposhtme përshkruan logjikën e ndërhyrjes së programit dhe kryqëzimin e prioriteteve individuale me çështjet e ndërthurura dhe horizontale.

[108] Vlerësimi i Ndërmjetëm i Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar midis vendeve kandidatë / kandidatë të mundshëm (kufijtë e Ballkanit Intra-perëndimor) nën Komponentin e Bashkëpunimit Ndërkufitar të IPA; Raporti II - Performanca e ndihmës.



Meqë perspektiva e programimit për vitet 2014-2020 është më e orientuar drejt rezultateve se sa kuadri i IPA 2007-2013, të gjithë treguesit e rezultateve të paraqitur në fletët e të dhënave më poshtë synojnë që të informojnë mbi përzgjedhjen e operacioneve dhe projekteve që do të mbështeten. Këto do të kontribuojnë drejtpërdrejt në përcaktimin e treguesve për Programin.

Përmbajtja e ndërhyrjes e përshkruar më poshtë ka marrë në konsideratë vërejtjet dhe komentet konstruktive të prodhuara gjatë aktiviteteve të konsultimeve publike të zhvilluara në zonën e programit në periudhën dhjetor 2013 - mars 2014.

Prioriteti Tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore (TP4)

Përmbledhje e Prioritetit Tematik dhe Referenca Strategjike

Evropa është destinacioni nr. 1 i turizmit në botë, me turizmin kulturor dhe një numër të madh të vendeve turistike, si dhe me një rrjedhë të fortë të vizitorëve ndërkombëtarë dhe vendas. Politikat e turizmit duhet të përshtaten me këto tendenca dhe të zhvillojnë një ofertë cilësore, duke promovuar kulturat dhe traditat lokale dhe duke i kushtuar vëmendje aspekteve të qëndrueshëm: ruajtja e trashëgimisë, e peizazhit dhe e kulturës lokale. Zona e programit synon të shfrytëzojë mundësitë strategjike që dalin nga potenciali më i gjerë i të gjithë kontinentit, i cili është në përputhje me konceptin e turizmit të qëndrueshëm dhe kulturor të promovuar nga DG Sipërmarrje dhe Industri.

Turizmi ka qenë i njohur si një nga mundësitë ekonomike prioritare që janë me interes për popullsinë në zonën CBC. Edhe pse industria e mikpritjes është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në zonën e programit, në të dyja vendet industria po rritet. Aktualisht, aktivitetet e lidhura me turizmin janë burimi kryesor i të ardhurave për popullsinë në rajonet e Ohrit dhe Prespës në muajt e verës, por ka shumë potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm kulturor dhe zbavitës në të gjithë rajonin CBC.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave të ndryshme në rajonin CBC është në rritje, por ende ekziston një mungesë praktike e iniciativave të qëndrueshme të përbashkëta në një shkallë më të gjerë. Aktivitetet e përfshira në këtë prioritet tematik do të mbështesin bashkëpunimin midis institucioneve, bazuar në vlerësimin e ofertës heterogjene dhe potencialin e kulturave dhe traditave të ndryshme të pranishme në zonë, si dhe aksionet njerëzit-për-njerëzit. Këto duhet të kontribuojnë për trajtimin e sfidave të tilla si ruajtja e burimeve natyrore dhe kulturore, nxitja e mirëqenies së komuniteteve lokale, përmirësimi i

cilësisë së vendeve të punës në fushën e turizmit, kufizimi i ndikimit mjedisor të transportit që lidhet me turizmin, etj.

Objektivi Specifik

Objektivi Specifik i këtij Prioriteti Tematik synon **të zhvillojë potencialin e turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore** (SO 1.1).

Prioriteti Tematik do të inkurajojë shumëllojshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve turistike. Duke mbështetur projekte që promovojnë produkte tematike turistike të qëndrueshme, programi do të forcojë bashkëpunimin trans-nacional në lidhje me turizmin e qëndrueshëm, do të inkurajojë një përfshirje më të madhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të autoriteteve lokale, dhe do të stimulojë konkurrencën e industrisë së turizmit me anë të një fokusimi të përmirësuar mbi shumëllojshmërinë e produkteve tematike të qëndrueshme dhe të turizmit kulturor. Gjithashtu, prioriteti tematik synon të rrisë aftësitë e stafit të angazhuar në industrinë e mikpritjes, duke përfshirë trajnimin profesional për të eliminuar mangësitë në aftësitë për të prezantuar një ofertë të larmishme turistike, p.sh. për guidat turistike dhe trajnerët e specializuar në sportet e dimrit, sportet malore, turizmin rural dhe aventurën, personelet e shërbimit të hoteleve, etj.

Rezultatet e Pritshme

Ky prioritet tematik synon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

1.1.1 Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur;

1.1.2 Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej.

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë organizuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e synuara të përfituesve
1.1.1.1 Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve të përbashkëta turistike dhe i investimeve në shkallë të vogël në infrastrukturën publike të turizmit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Ofruesit e shërbimeve turistike –OJQ-të, OSHC-të –Parqet kombëtare –Dhomat e tregtisë –Rrjetet / grupet e NVM-ve
1.1.1.2 Trajnim për rritjen e aftësive në industrinë e mikpritjes	–Institucionet arsimore e AAP –Institucionet e arsimit të lartë –Institucione të tjera formale dhe jo-formale arsimore dhe trajnuese –OJQ-të, OSHC-të –Rrjetet / grupet e NVM-ve
1.1.2.1 Restaurimi / rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, dhe e mjedisit të lidhur me këto objekte	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Ofruesit e shërbimeve turistike –OJQ-të –Institucionet kulturore (muzetë, bibliotekat, orkestrat, etj.) –Operatorët në industrinë e mikpritjes (NVM)
1.1.2.2 Mbështetje për aktivitete të përbashkëta kulturore	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –OJQ-të –Institucionet e arsimit (në të gjitha nivelet) –Institucionet kulturore (muzetë, bibliotekat, orkestrat, etj.) –Banorët dhe organizatat e tyre

Treguesit e Performancës së Zbatimi të Prioritetit Tematik

Rezultati 1.1.1 i Objektivit Specifik: Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i shërbimeve/ produkteve të reja/përmirësuara	Shërbimet/ produktet e reja të përmirësuara	0	4	10	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Nr. i personave të trajnuar	Trajnimi i njerëzve në industrinë e mikpritjes	0	50	500	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i turistëve që përdorin shërbimet e reja/ përmirësuar	Turistët përdorin shërbimet e reja/ përmirësuara	0	2,000	5,000	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë*	Vlera e synuar (2020)**	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të turistëve (me fjetje)	Numri mesatar i qëndrimeve me fjetje për turistët e regjistruar	2,8 netë qëndrim me fjetje (të dhënat e 2013, duke përfshirë edhe statistikat nga të dy vendet në zonat përfituese)	I rritur me 1 natë	Zyra Statistikore Shtetërore dhe INSTAT	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Burimi: Zyra Statistikore Shtetërore, http://www.stat.gov.mk/prikaziPublikacija_1.aspx?rbr=483. Të dhënat janë marrë nga Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve në Shqipëri, 2013

** Grumbullues

Rezultati 1.1.2 i Objektivit Specifik: Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i vendeve të trashëgimisë kulturore të përmirësuar	Përmirësimi i vendeve të trashëgimisë kulturore	0	2	4	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Nr. i aktiviteteve të organizuara	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta kulturore	0	10	20	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit
Financimet e reja për librarinë e dixhitalizuara	Financime të reja për koleksione / librari kulturore të krijuar	0	2	5	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Grumbullues

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i vizitorëve në vendet e trashëgimisë kulturore	Njerëzit vizitojnë vendet e trashëgimisë kulturore	PËR TU VENDOSUR*	I rritur me 7% për vendet dhe subjektet e ndërhyrjes së programit	I rritur me 15% për vendet dhe subjektet e ndërhyrjes së programit	Sistemi i monitorimit Zyra Statistikore Shtetërore dhe INSTAT	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
% e palëve të treta të përfshira në aktivitete	Raporti i palëve të interesuara që u angazhuan në aktivitetet kulturore në kuadër të programit	1465*	E rritur me 10% në krahasim me 2007-2013	Sistemi i monitorimit	Çdo vit, nga data e zbatimit

* Raporti Vjetor i Zbatimit (AIR) 2013

Modalitetet e zbatimit[109]

Aktivitetet e parashikuara nën këtë prioritet tematik do të zbatohen nëpërmjet modaliteteve të skemës së granteve në bazë të metodologjisë së thirrjeve për projekt propozime brenda regjimit të PRAG.

Aktiviteti që synon përmirësimin e aftësive të personelit të industrisë së mikpritjes duhet të përfshijë përfaqësuesit e industrisë si aktorët kryesorë në secilin projekt propozim.

Në kuadër të këtij prioriteti tematik është parashikuar një gamë e gjerë e përfituesve të mundshëm. Vetëm për Aktivitetin 1.1.2.2 pritet një numër i konsiderueshëm i projekteve të vogla që do të nxisin bashkëpunimin njerëz-për-njerëz dhe institucion-për-institucion.

Aktivitetet 1.1.1.1 dhe 1.1.2.1 do të zbatojnë projekte me ndikim më të rëndësishëm afatgjatë, të tilla si infrastruktura e turizmit në shkallë të vogël dhe renovimi i monumenteve historike dhe kulturore.

Qëllimi i ndërhyrjes në këtë prioritet tematik mund të kryqëzohet pjesërisht me mbështetjen e dhënë nëpërmjet prioritetit tematik 2, veçanërisht në lidhje me sipërmarrjet private, të cilat do të jenë aplikues dhe përfitues të pranueshëm. Në këtë aspekt, është hartuar linja ndarëse në vijim: palët e interesuara të prioritetit tematik (partnerët ose bashkëpunëtorët sipas modaliteteve PRAG) që bien në kategorinë e SME-ve duhet të përfshihen nën seksionin 1 të NACE: Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit.

Dy skenarë janë parashikuar për të siguruar mbështetje granteve:

1. Aktivitetet 1.1.1.1, 1.1.2.1 do të mbështeten në perspektivën afatmesme pasi kërkojnë një mbështetje më të gjerë për lehtësimin, mobilizimin dhe zhvillimin e projektit se sa aktivitetet e tjera. Kështu, ato do të përfshihen vetëm në raundin e dytë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, ndërsa Aktivitetet 1.1.1.2 dhe 1.1.2.2 do të mbështeten nëpërmjet raundit të parë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime.

2. I gjithë prioriteti tematik do të zbatohet nëpërmjet një thirrje për projekt propozime (përjashtim mund të bëhet për aktivitetin 1.1.2.2 i cili mund të përsëritet në çdo thirrje për projekt

[109] Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

propozime, kur është rasti për të reduktuar barrierat e hyrjes për aplikuesit me kapacitet më të ulët financiar).

Një thirrje e vetme për propozime mund të mbulojë më shumë se një prioritet tematik. Kur është e nevojshme dhe e mundur, thirrja për projekt propozime do të përfshijë ndarjet e buxhetit nga alokimet e ndryshme financiare vjetore, në mënyrë që të promovojë projekte në një shkallë më të madhe.

Prioriteti Tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve (TP7)

Përmbledhje e Prioritetit Tematik dhe Referenca Strategjike

Papunësia e lartë, nivelet e ulëta të punësimit dhe vlerës së shtuar në ekonominë e zonës së programit është një çështje e shqetësimit të lartë. Kështu, nxitja, mbështetja dhe krijimi i vendeve të punës dhe burime alternative të të ardhurave paraqitet si një nga objektivat kryesore të politikës së zhvillimit social-ekonomik të rajonit CBC në këto rrethana.

Prioriteti tematik do të synojë të mbështesë aksesin në tregjet të operatorëve ekonomikë në të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë në zonën e programit, rritjen e përdorimit të instrumenteve të TIK dhe teknologjisë, dhe shfrytëzimin e mundësive të pashfrytëzuara të zinxhirit të vlerave, duke përfshirë ato në ekonominë rurale. Pritet që këto të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës, zhvillimin e tregtisë dhe investimet e reja në zonën e programit.

Aktivitetet e këtij prioriteti tematik kanë si qëllim të trajtojnë një numër të kufizuar të mundësive strategjike që lidhen me konkurrencën, e cila mbetet një nga shtyllat kryesore të Strategjisë së Evropës 2020. Qëllimi i ndërhyrjes së propozuar është plotësisht në përputhje me qasjen e sektorit IPA II: Zona A e Politikës - procesi i tranzicionit dhe ndërtimi i institucioneve, sektori: Zhvillimi i Sektorit Privat, dhe Objektivi tematik 3 i ndërhyrjes së Fondeve Strukturore: Konkurrueshmëria e SME-ve.

Objektivi Specifik

Ky prioritet tematik përqendrohet në **forcimin e kapaciteteve prodhuese të SME-ve dhe aksesit të tyre në tregje** (SO 2.1).

Ndërhyrja do të përqendrohet në përmirësimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi mundësitë që rrjedhin nga hapjet e zinxhirit të vlerave ekonomike ekzistuese, mbështetjen në drejtim të produktit dhe procesit të certifikimit të cilësisë të kërkuar në tregjet ndërkombëtare, dhe në përdorimin e gjerë të teknikave të shitjes moderne, duke përfshirë tregtinë elektronike. Në mënyrë që të rritet ekonomia rurale dhe mundësitë e saj strategjike, do të sigurohet një fushatë për të hapur / zhvilluar tregjet e organizuar të prodhimeve të freskëta.

Rezultatet e pritshme

Rezultati i pritshëm i lidhur me objektivin specifik të prioritetit tematik është:

2.1.1 Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti i SME-ve dhe bizneseve të reja për të hyrë në tregjet e reja dhe zinxhirët e vlerave janë rritur.

Aktivitetet e parashikuara dhe Grupet e Synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe Grupet e Synuara janë grupuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e Synuara të Përfituesve
2.1.1.1 Asistencë për SME-të dhe bizneset e reja për ndërkombëtarizim dhe gjetjen e partnerëve të biznesit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Organizatat anëtare të biznesit (p.sh. dhomat e tregtisë / artizanatit) –Shoqatat e SME-ve, grupimet dhe rrjetet e tyre –Organizatat RDI dhe institucionet e arsimit të lartë
2.1.1.2 Investime në tregun e vogël ndërkufitar dhe në objekte tregtare	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Qendrat për zhvillim të rajoneve planifikuese –Ndërmarrjet publike (në pronësi mbi 50% nga organet publike) - në rast të zhvillimit të tregjeve ndërkufitare dhe objekteve tregtare (përfshirë tregjet e prodhimeve të freskëta) –Shoqatat e SME-ve, grupimet e tyre dhe organizatat anëtare të biznesit (p.sh. dhomat e tregtisë / artizanatit) –Shoqatat e fermerëve

Treguesit e Performancës së Zbatimit të Prioritetit Tematik

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i aktiviteteve të tregtisë së jashtme	Aktivitete që synojnë tregun e jashtëm	0	5	10	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i bizneseve që marrin pjesë në aktivitete të reja të tregtisë së jashtme	Nr. i bizneseve që përfitojnë nga aktivitetet e reja të tregtisë së jashtme	0	30	50	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i SME-ve me certifikata të reja të konformitetit të fituara (ISO, HACCP, etj.)	SME-të që kanë çertifikata të reja të konformitetit	0	8	20	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i tregjeve të reja dhe objekteve tregtare të zhvilluara nëpërmjet marrëveshjeve	Nr. i marrëveshjeve me tregje të reja dhe objekte tregtisë	0	1	3	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbullues

Treguesi i rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Ndarja e vlerës së eksportit të mallrave dhe shërbimeve (%)	Raporti i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në lidhje me tregtinë e përgjithshme	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 2%	Rritje me 5%	Sistemi i monitorimit, Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor
Qarkullimi i bizneseve	Ritja e shitjeve totale të një shoqërie për një periudhë të caktuar	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 3%	Rritje me 8%	Sistemi i monitorimit, Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Vlera bruto e shtuar nga sektori	Përqindje e rritur e vlerës së të mirave dhe shërbimeve të prodhuara në sektorin ekonomik brenda zonës gjeografike	PËR TU VENDOSUR*	Rritje me 2% në krahasim me vitin 2013	Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor

* Të dhënat do të llogariten pasi zyrat e statistikave të sigurojnë informacionin e nevojshëm.

Modalitetet e Zbatimit[110]

Të gjitha aktivitetet e prioritetit tematik 2 do të zbatohen nëpërmjet modaliteteve të skemës së granteve.

Ndihma e dhënë për bizneset individuale duhet të jetë në përputhje me ligjet e BE-së: i) ndihma shtetërore e dhënë nën GBER ose ii) tavani i ndihmës minimale dhe maksimale të jetë deri në 85%, për të siguruar bashkë-financimin minimal të kërkuar për IPA.

Vija ndarëse e kufirit midis aktiviteteve të realizuara në bazë të këtij prioriteti tematik dhe prioritetit tematik 1 është përcaktuar në bazë të pranueshmërisë së aplikantëve: SME-të dhe rrjetet e tyre që përfitojnë nga ndërhyrjet e prioritetit tematik 2 nuk duhet të bien nën seksionin I të NACE: Aktivitetet e akomodimit dhe shërbimeve ushqimore.

Janë parashikuar dy opsione për të ofruar ndërhyrjen në bazë të këtij prioriteti tematik, në varësi të karakteristikave përfundimtare të ofertës financiare:

1. Aktiviteti 2.1.1.1 mund të mbështetet në raundin e parë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, ndërsa Aktiviteti 2.1.1.2 gjatë raundit të dytë ose të tretë të thirrjeve për projekt propozime (për të shmangur përplasje në një thirrje për projekte me Aktivitetin 1.1.2.1 që pritet gjithashtu të konsumojnë pjesë të mëdha të financimit - këto projekte pritet të jenë të konsiderueshme në madhësi dhe me kohëzgjatje më të madhe se çdo iniciativë tjetër).

2. I gjithë prioriteti tematik mund të zbatohet nëpërmjet një thirrje për projekt propozime.

Prioriteti Tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)

Përmbledhje e Prioritetit Tematik dhe Referenca Strategjike

Zona e programit karakterizohet nga një mjedis dhe natyrë e pasur dhe e larmishme, dhe në përgjithësi njihet si një territor i pastër dhe i gjelbër. Megjithatë, në rajon mungon infrastruktura për mbrojtjen e mjedisit, si dhe strategjitë dhe praktikat për njohjen në kohë, parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut. Zona kufitare është e prirur drejt motit të pafavorshëm dhe dukurive klimatike, veçanërisht stuhive të rënda dhe reshjeve që rezultojnë në përmbytje lokale dhe rrëshqitje të tokës, duke dëmtuar rrugët, pronat private dhe tokën bujqësore. Në stinët e thata, zjarret rrezikojnë dhe dëmtojnë ekonominë rurale dhe prodhimin e të korrave. Kështu, rimëkëmbja prej katastrofave klimatike është një nga çështjet që duhet të trajtohen nëpërmjet këtij prioriteti tematik.

Përveç kësaj, përmirësimi i mbledhjes së mbetjeve të ngurta, menaxhimit të mbetjeve dhe praktikat e parandalimit të erozionit të tokës, konsiderohen si fusha prioritare të ndërhyrjes në rajonin CBC.

"Të jetosh mirë, brenda kufijve të planetit tonë" është titulli kryesor i Programit të ri të Veprimit për Mjedisin deri në vitin 2020, i propozuar nga Komisioni Evropian. Ky prioritet tematik i programit CBC bazohet në këtë nismë, dhe është në përputhje me politikat e Zonës B të IPA II: Zhvillimi Rajonal, sektori: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, dhe objektivat tematike 5 dhe 6 të ndërhyrjes së Fondeve Strukturore: Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, parandalim dhe menaxhimi i rrezikut & Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i efikasitetit të burimeve.

Aktivitetet e këtij prioriteti tematik përfshijnë të dy llojet e projekteve: "projektet e butë" me qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit dhe promovimin e përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve, ekonomisë të gjelbër; si dhe mbështetjen e investimeve të vogla në infrastrukturën për mbrojtjen e mjedisit, e cila konsiderohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në rajonin ndërkufitar dhe në prodhimin e efektit të demonstrimit. Gjithashtu, ndërhyrja synon të trajtojë kapacitetet e ulëta financiare dhe institucionale të shoqërive të shërbimeve publike, si dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe metodave të prodhimit bujqësor.

Objektivi Specifik

Kryetitulli i objektivit specifik të këtij prioriteti tematik (SO 3.1) mbetet **rritja e ndërgjegjësimit për një ekonomi më të gjelbër, mjedis më të pastër dhe ndryshimet klimatike.**

Qartësisht, prioriteti tematik ka një dimension hapësinor që kërkon një qasje të bazuar në vend, pasi territore të caktuara kufitare janë të veçantë nga të tjerët. Ky prioritet tematik do të

[110] Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

përqendrohet në ndërtimin e ndërgjegjësimit dhe njohurive, integrimin e komuniteteve dhe grupeve të synuara, dhe në zbatimin e masave reale për të trajtuar çështjet e parashikuara në seksionin e mësipërm. **Fokus i veçantë do të drejtohet ndaj përpunimit të produkteve pyjore drusore dhe furnizimit me ujë**.

Rezultatet e pritshme

Ky prioritet tematik do të arrijë rezultatet e mëposhtme:

3.1.1 Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur;

3.1.2 Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar.

Aktivitetet e parashikuara dhe Grupet e Synuara

Aktivitetet e parashikuara dhe grupet e synuara janë grupuar në tabelën e mëposhtme.

Aktivitetet e parashikuara	Grupet e Synuara të Përfituesve
3.1.1.1 Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Qendrat për zhvillim të rajoneve të planifikuara –Shoqëritë e shërbimeve publike –Parqet kombëtare –OSHC-të, OJQ-të –Dhomat e tregtisë –Organizatat RDI –Shoqatat e banorëve në zonat ndërkufitare, kryesisht në zonat rurale –Shoqatat e fermerëve –Institucionet e arsimit primar, dytësor dhe tretësor, dhe ato të hulumtimit –Rrjetet e SME-ve
3.1.2.1 Promovimi i investimeve të vogla në infrastrukturë për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe mbrojtjen e mjedisit	–Njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale –Qendrat për zhvillim të rajoneve të planifikuara –Qendrat kombëtare dhe rajonale për menaxhimin dhe monitorimin e fatkeqësive –Shoqëritë e shërbimeve publike –Shoqatat e fermerëve –OSHC-të, OJQ-të –Dhomat e tregtisë –Shoqatat e banorëve në zonat ndërkufitare, kryesisht në zonat rurale

Treguesit e Performancës së Zbatimit të Prioritetit Tematik

Rezultati 3.1.1 i Objektivit Specifik: Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të mjedisit	Fushata të reja publike mbi çështjet e mjedisit në nivel projekti	0	5	12	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe	Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe	0	3	6	Sistemi i monitorimit	Vjetor

zinxhirëve të vlerave të përmirësuar brenda zonës	zinxhirëve të vlerave të modernizuar brenda zonës					
Nr. i aksioneve të pastrimit	Nr. i nismave të pastrimit të zbatuara në nivel projekti	0	4	8	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbulluese

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
% e popullsisë në zonën CBC e ndërgjegjësuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit në sektorët kyç	Norma e popullsisë së informuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe çështjet e mjedisit	PËR TU VENDOSUR*	1% (rreth 14,000)	3.5% (rreth 50,000)	Sistemi i monitorimit	Vjetor
% e të gjitha bizneseve dhe organizatave që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve	Raporti ndërmjet atyre që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta dhe të gjithë organeve ekzistuese në zonë	PËR TU VENDOSUR*	5%	10%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Përdorimi i ujit nga familjet dhe bizneset	Përqindja e humbjeve të ujit e reduktuar	PËR TU VENDOSUR*	Rënie e përdorimit të ujit me 10%	Sistemi i monitorimit Zyra Shtetërore e Statistikave, dhe INSTAT	Vjetor
% e mbetjeve të grumbulluara për riciklim	Norma e mbetjeve të ricikluara në raport me sasinë e mbledhur	PËR TU VENDOSUR*	Rritja e mbetjeve të grumbulluara për riciklim me 15%	Sistemi i monitorimit	Vjetor
	Norma e numrit të vend-shkarkimeve të paligjshme të mbyllura në raport me numrin fillestar të vend-shkarkimeve ekzistuese	PËR TU VENDOSUR nga JTS me bashkitë, ministrinë e mjedisit	Ulja e numrit të vendshkarkimeve të paligjshme me 10%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Vlera bazë lidhet me performancën e përfituesve/grupeve të synuara para ndërhyrjes; Shifrat përkatëse për të matur vlerën bazë, duhet të sigurohen nga aplikanti në formularin e aplikimit për grante.

Rezultati 3.1.2 i Objektivit Specifik: Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar

Treguesi i Kontributitit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)*	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Nr. i projekteve të mbështetur	Nr. total i projekteve të reja të mbështetur nën këtë objektiv	0	5	12	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i objekteve të siguruara për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarret	Nr. i objekteve të reja të siguruara për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarri	0	0	2	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit	Nr. i fushatave të reja të ndërgjegjësimit	0	2	5	Sistemi i monitorimit	Vjetor
Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja	Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja	0	100	250	Sistemi i monitorimit	Vjetor

* Grumbulluese

Treguesi i Rezultatit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2017)	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Gjatësia e rrugëve të mbrojtura	Nr. i km të rrugëve të ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore të mbrojtura në raport me nr. e km të rrugëve në nevojë për mbrojtje	0	3%	10% e rrugëve të ekspozuara ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor
Madhësia e sipërfaqes bujqësore të mbrojtur	Norma e sipërfaqes së tokës bujqësore të mbrojtur në raport me sipërfaqen totale të tokës në nevojë për mbrojtje	0	2%	5% e tokës e ekspozuar ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor
Madhësia e zonave pyjore të mbrojtura	Norma e sipërfaqes së zonës pyjore të mbrojtur në raport me sipërfaqen totale të zonës pyjore në nevojë për mbrojtje	0	2%	5% e pyjeve të ekspozuar ndaj rrezikut	Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, Sistemi i monitorimit	Vjetor

Treguesi i Ndikimit	Përshkrimi	Vlera bazë	Vlera e synuar (2020)	Burimi i të dhënave	Intervali i raportimit
Madhësia e zonës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të mbuluar nga aktivitetet	Sipërfaqja e pranueshme e programit CBC është mbuluar nga aktivitetet e projektit	0	3%	Sistemi i monitorimit	Vjetor

Modalitetet e Zbatimit[111]

Aktivitetet do të zbatohen nëpërmjet financimit me grante, duke ndjekur modalitetet e PRAG për dhënien e granteve.

Zbatimi i prioritet tematik do të kërkojë përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të interesit në nivel lokal dhe rajonal. Pritet që me kalimin e kohës të ketë një ndikim më të ndjeshëm nga motivimi i autoriteteve lokale dhe shoqërivepublike komunale në rajonin e Bashkëpunimit Ndërkufitar për të marrë një rol aktiv në zbatimin e programit: investimet e vogla në mjedis do të projektohen në kuadër të mandatit të tyre nëpërmjet procedurave transparente të prokurimit publik, dhe nuk do të kërkohet përgatitja e dokumentacionit të detajuar dhe të shtrenjtë të projektit të financuar nga fondet e programit.

Financimi i granteve mund të ofrohet në bazë të skenarëve të mëposhtëm alternativë:

1. Të dy aktivitetet mund të zbatohen paralelisht.

2. Aktiviteti 3.1.1.1 mund të zbatohet gjatë raundit të parë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, ndërsa aktiviteti 3.1.2.1 - në rrjedhën e raundit të dytë të thirrjeve për projekt propozime.

Asistenca Teknike

Objektivi specifik i asistencës teknike është të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dy vendet përfitues të IPA II.

Për më tepër, siç ka treguar përvoja në ciklin e programit 2007-2013, ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.

Alokimi për asistencën teknike do të përdoret për të mbështetur punën e Strukturave Kombëtare Operative (OS) dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC), në sigurimin e fillimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit efikas të programeve, si dhe për një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Sekretariati të Përbashkët Teknik (JTS) me bazë në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe një Zyrë Antena në Republikën e Shqipërisë. JTS do të jetë në krye të menaxhimit të përditshëm të programit dhe do ti raportojë mbi ecurinë e tij OS-ve dhe JMC-së.

Rezultatet e synuar:

Mbështetja administrative për Strukturat Operative (OS) dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (JMC) të programit është rritur.

Ky prioritet do të sigurojë një zbatim normal të programit gjatë të gjitha fazave të tij. Ai përfshin disponueshmërinë e mjeteve financiare dhe vendosjen e personelit të kualifikuar përgjegjës për të ndihmuar Strukturat Operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, si dhe krijimin dhe zbatimin e mekanizmave dhe procedurave të menaxhimit, monitorimit dhe kontrollit. Nëse kërkohet, ai gjithashtu do të kontribuojë në përgatitjen e ciklit pasardhës financiar (2021-2027).

[111] Këto janë të natyrës parashikuese, bazuar në supozimin që deri në tre CFP do të organizohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit. Modaliteti mund të ndryshojë gjatë zbatimit të programit.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022	Burimi
Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar[112]	Përqindje	0	60 %	Anketë

Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur.

Ky prioritet do të ofrojë mundësi për përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të strukturave menaxhuese të programeve, si dhe të aplikuesve të mundshëm dhe përfituesve të granteve. Aktivitete specifike për ngritjen e kapaciteteve do të planifikohen dhe zbatohen në bazë të nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të programit. Si pjesë e mësimeve të nxjerra nga cikli i programit 2007-2013, (i) do të pritet një pjesëmarrje në rritje e anëtarëve të KPM në detyrat e përcaktuara nën kuadrin ligjor të IPA II; (ii) kapaciteti i aplikuesve të mundshëm për zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare do të rritet; dhe (iii) kapaciteti i përfituesve të granteve për të përmbushur detyrimet e kontratave të tyre në mënyrë të kënaqshme, të do të përforcohet.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022	Burimi
Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme[113]	Përqindje	123 *	+ 45%	AIR
Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm	Përqindje	59	10 %	AIR

Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet.

Programet CBC kanë qenë shumë të famshëm në zonat përfituese, përveç të tjerave, falë veprimeve të vizibilitetit të ndërmarra gjatë ciklit të programit 2007-2013. Duke parë numrin e aplikuesve në thirrjet pasuese, është vënë re se ka një interes në rritje për iniciativat e bashkëpunimit. Këto arritje duhet të ruhen dhe të përmirësohen edhe gjatë zbatimit të perspektivës financiare 2014-2020. Një shumëllojshmëri e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve të publicitetit duhet të zhvillohet për të siguruar informacion të rregullt midis palëve të interesuara të programit dhe një audience më të gjerë.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022	Burimi
Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese	Numër	1398*	2000	AIR
Vizitat në faqen e internetit të programit	Numër	40*	700	AIR

* AIR 2013

[112] Kërkon një studim të rregullt dhe të thjeshtë duke përdorur një pyetësor standard me pyetje të mbyllura.

[113] Ju lutemi të vini re se në perspektivën financiare 2014-2020, thirrjet e mundshme të përshtatura/ strategjike për propozime janë parashikuar me fokus të qartë dhe / ose kërkesa të caktuara në lidhje me përfituesit e mundshëm. Gjithashtu, Thirrjet për Projekt Propozime mund të përdorin parimin e rotacionit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike (TP) dhe objektivave të tyre specifike, dhe në këtë aspekt numri i propozimeve jo domosdoshmërisht mund të rritet. Për këto arsye, rritja e pritshme e numrit të aplikimeve të marra mund të llogaritet për çdo thirrje të njëpasnjëshme në mënyrë individuale, dhe do të ndikohet nga një faktor që mund të llogaritet në bazë të: 1) Buxheti i përgjithshëm në dispozicion, 2) Prioritetet tematike, objektivat specifike dhe rezultatet e përfshira në Thirrjen për Projekt Propozime, 3) Shumat minimale dhe maksimale të lejuara të granteve, 4) Numri i aplikimeve dhe granteve të lejuara për aplikues / bashkë-aplikues / entet e lidhur dhe 5) Çdo dispozitë tjetër e veçantë që ndikon në kritere të ndryshme të pranueshmërisë, të zbatueshme për një thirrje specifike për projekt propozime.

Lloji i aktiviteteve:

Një listë jo shteruese e aktiviteteve të mundshme të mbuluara nga alokimi i asistencës teknike do të përfshijë:

-Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij.

-Organizimi i aktiviteteve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial.

-Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE-së.

-Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm.

-Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve, etj.).

-Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit.

-Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës.

-Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve.

-Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promovuese dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit, etj.

-Mbështetje për punën e Task Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026.

Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë (listë jo shteruese)

-Strukturat e menaxhimit të programit
-Aplikuesit e mundshëm
-Përfituesit e granteve
-Përfituesit përfundimtarë të projektit
-Publiku i gjerë

Modalitetet e zbatimit

Plani i vizibilitetit dhe komunikimit duhet të prodhohet në përputhje me kërkesat e përgjithshme të IPA II dhe praktikat më të mira mbi transparencën dhe trajtimin e barabartë.

Përfituesit duhet të informohen në mënyrë korrekte dhe të plotë mbi rregulloret për publicitetin. Kujdes i veçantë i kushtohet rregullave të vizibilitetit edhe gjatë monitorimit të zbatimit të projektit.

Organet e përfshira në zbatimin e programit janë përgjegjëse për të siguruar që përfituesit përfundimtarë të marrin masat për informimin dhe publicitetin mbi aktivitetet e bashkë-financuara në kuadër të IPA II, në përputhje me udhëzimet e BE-së mbi vizibilitetin.

Tabela 2: Përmbledhje e strategjisë së programit

Prioriteti Tematik (TP)	Objektivat Specifikë	Rezultatet	Treguesit	Llojet e aktiviteteve (shembuj)
Prioriteti Tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore. (TP4)	Objektivi Specifik i këtij Prioriteti Tematik synon të zhvillojë potencialin e turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore	1.1.1 Mundësitë e biznesit për ofruesit lokalë të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit janë rritur; 1.1.2 Bashkëpunimi i ndërsjellë, mirëkuptimi dhe respekti për trashëgiminë dhe vlerat kulturore janë zhvilluar më tej.	1.1.1 Nr. i turistëve që përdorin shërbimet e reja/ përmirësuar. Nr. i shërbimeve/ produkteve të reja/përmirësuara. Nr. i personave të trajnuar. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të turistëve (me fjetje). 1.1.2 Nr. i vizitorëve në vendet e trashëgimisë kulturore. Nr. i vendeve të trashëgimisë kulturore të përmirësuar. Nr. i aktiviteteve të organizuara. Nr. i librarive të reja të dixhitalizuara. % e palëve të interesuara të përfshirë në aktivitete.	1.1.1.1 Projektimi, zhvillimi dhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve të përbashkëta turistike dhe i investimeve në shkallë të vogël në infrastrukturën publike të turizmit. 1.1.1.2 Trajnim për rritjen e aftësive në industrinë e mikpritjes. 1.1.2.1 Restaurimi / rezervimi, ruajtja, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe historike, dhe e mjedisit të lidhur me këto objekte. 1.1.2.2 Mbështetje për aktivitete të përbashkëta kulturore.
Prioriteti Tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve. (TP7)	Forcimi i kapaciteteve prodhuese të SME-ve dhe aksesit të tyre në tregje.	2.1.1 Ndërgjegjësimi dhe kapaciteti i SME-ve dhe bizneseve të reja për të hyrë në tregjet e reja dhe zinxhirët e vlerave janë rritur.	Vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve (%). Qarkullimi i bizneseve GVA. Nr. i aktiviteteve të tregtisë së jashtme. Nr. i bizneseve që marrin pjesë në aktivitete të reja të tregtisë së jashtme. Nr. i SME-ve me certifikata të reja të konformitetit të fituara (ISO, HACCP, etj.). Nr. i tregjeve të reja dhe objekteve tregtare të zhvilluara nëpërmjet marrëveshjeve.	2.1.1.1 Asistencë për SME-të dhe bizneset e reja për ndërkombëtarizim dhe gjetjen e partnerëve të biznesit. 2.1.1.2 Investime në tregun e vogël ndërkufitar dhe në objekte tregtare.
Prioriteti Tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut. (TP2)	Rritja e ndërgjegjësimit për një ekonomi më të gjelbër, mjedis më të pastër dhe ndryshimet klimatike.	3.1.1 Ndërgjegjësimi dhe njohuritë mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit janë rritur; 3.1.2 Infrastruktura publike në rrezik nga përmbytjet, erozioni i dherave dhe zjarret është përmirësuar.	3.1.1 Përdorimi i ujit nga familjet dhe bizneset. % e mbetjeve të grumbulluara për riciklim. Nr. i fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe të mjedisit. Nr. i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe zinxhirëve të vlerave të përmirësuar brenda zonës. Nr. i aksioneve të pastrimit. % e popullsisë në zonën CBC e ndërgjegjësuar mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit në sektorët kyç. % e të gjitha bizneseve dhe organizatave që marrin pjesë në veprimet e përbashkëta për menaxhimin e ujit dhe mbetjeve. 3.1.2 Gjatësia e rrugëve të mbrojtura. Madhësia e sipërfaqes bujqësore të mbrojtur. Madhësia e zonave pyjore të mbrojtura. Nr. i projekteve të mbështetur. Nr. i objekteve të siguruara për mbrojtjen nga përmbytjet dhe zjarret. Nr. i fushatave të ndërgjegjësimit. Numri i familjeve / fermave dhe organizatave të tjera që përfitojnë nga aktivitetet e reja. Madhësia e zonës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të mbuluar nga aktivitetet.	3.1.1.1 Promovimi dhe mbështetja e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit. 3.1.2.1 Promovimi i investimeve të vogla në infrastrukturë për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe mbrojtjen e mjedisit.

Asistenca Teknike	Të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dy vendet përfitues të IPA II. Ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.	Mbështetja administrative për Strukturat Operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit të programit është rritur. Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur. Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet.	Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar. Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme. Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm. Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në aktivitetet promovuese. Vizitat në faqen e internetit të programit.	Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij. Organizimi i aktiviteteve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial. Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE-së. Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm. Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve, etj.). Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit. Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës. Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe / ose studimeve. Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promovuese dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit, etj. Mbështetje për punën e Task Forcës së Përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021-2026. Tjetër.

3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura

Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale kanë të bëjnë me temat e ndërlidhura me modalitetet e zbatimit të prioriteteve tematike të përzgjedhura dhe me politikat e komunitetit të karakterit horizontal.

Programi pranon aksionet **njerëz-për-njerëz** dhe **rrjetet institucionale / të bashkëpunimit për LPP** si modalitete që do të zbatohen në të gjitha prioritetet e zgjedhura tematike.

Përveç kësaj, legjislacioni i BE-së kërkon që çështjet specifike horizontale dhe ndërsektoriale që janë pjesë e politikave të komunitetit, të trajtohen në mënyrën e duhur në të gjitha programet e financuara nga BE. Në këtë kontekst, strategjia ka të bëjë me prioritetet e Evropës 2020 në harmoni me rrethanat rajonale, duke trajtuar një vizion të ekonomisë sociale të tregut në Evropë, duke sjellë kështu nivele të rritura të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit social. Kjo strategji është e bazuar në tri prioritetet e përbashkët përforcues: **Rritje e mençur, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse** për të gjithë. Në këtë kontekst, **qëndrueshmëria sociale** është çështja që integrohet në këtë program të bashkëpunimit ndërkufitar, e cila synon të parandalojë çdo diskriminim në bazë të gjinisë, prejardhjes raciale apo etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Ndërsa **qëndrueshmëria e mjedisit** do të kërkojë kryesisht pajtueshmërinë me Direktivën e Habitateve 92 /43/KE, Direktivën për Zogjtë 79/409 / KE dhe direktivat në lidhje me rrjetin evropian të zonave të mbrojtura NATURA 2000. Në krye të kësaj, çështjet mjedisore do marrin në konsideratë drejtpërdrejt aspekte që, ndër të tjera, lidhen me menaxhimin e mbetjeve, efikasitetin e energjisë dhe aftësinë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike si pjesë e Prioritetit 3.

Çështjet horizontale dhe ndërsektoriale do të trajtohen në mënyrë të dyfishtë:

1. Nëpërmjet operacioneve dhe aktiviteteve të drejtpërdrejta, duke nxitur dhe mbështetur rritjen gjithëpërfshirëse dhe qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore;

2. Nga përfshirja e tyre si çështje të ndërlidhura që kanë ndikim të tërthortë dhe integrohen në operacionet dhe aktivitetet brenda çdo prioriteti tematik.

Rrjedhimisht, Strukturat Operative janë të nevojshme për të futur dispozita të veçanta në dokumentet që shtrojnë bazat për aktivitetet dhe operacionet, p.sh. skemat e granteve, termat e referencës etj., në mënyrë që të sigurohet që:

-Aktivitetet dhe operacionet të mos vendosin pengesa të lidhura me gjininë, pikëpamjet, orientimin seksual, racor apo origjinën etnike, veçanërisht në lidhje me punësimin dhe politikat e HR të ndjekura ndaj personave të cilët do të jenë të punësuar në kuadër të projekteve të zbatuara nën skemat e granteve ose përmes ndërhyrjeve të asistencës teknike;

Përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuara të jetë një nga kriteret që duhet të respektohet për zhvillimin e infrastrukturës;

- Përfituesit e granteve të bashkëpunimit ndërkufitar të sigurojnë që përfituesit përfundimtarë të kenë mundësi të barabarta aksesi në të gjitha shërbimet, trajnimet, asetet ose pajisjet fikse ose jo-materiale të blera nëpërmjet aktiviteteve dhe operacioneve;

Aktivitetet dhe operacionet gjithashtu duhet të hartohen në përputhje me parimet e një mjedisi të qëndrueshëm dhe promovimit të mbrojtjes së mjedisit, dhe të prodhojnë ndikim pozitiv ose të paktën neutral në mjedis. Që aktivitetet dhe operacionet të kenë ndikim pozitiv, duhet të hartohen me qëllim që, ose të marrin në konsideratë të paktën një nga pikat e mëposhtme:

-Përmirësimin e zinxhirit të menaxhimit të mbetjeve (për mbetjet e ngurta dhe/ose të lëngshme);

-Zvogëlimin e vëllimit të mbetjeve tashmë të krijuara, në fazën e planifikimit dhe projektimit të projektit individual;

-Përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore,

-Elasticitetin klimatik;

-Proceset pjesëmarrëse të planifikimit dhe konsultimit publik për proceset e planifikimit të zhvillimit hapësinor dhe të investimeve.

-Projektet të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e vendeve të punës (duke përfshirë dialogun social), nxitjen e punësimit dhe forcimin e kushteve të punës, si dhe të promovojnë sigurimin e barazisë.

Temat horizontale dhe të ndërlidhura të këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar duhet të harmonizohen edhe nëpërmjet prioritetit të Asistencës Teknike që synon forcimin e efikasitetit dhe efektivitetit të ndërhyrjeve të bashkë-financimit

nga fondet e IPA II me cilësi të lartë dhe menaxhim të shëndoshë në nivel kombëtar, dhe me mbështetje gjithëpërfshirëse në nivel lokal.

Projektet e përgatitura në kuadër të qasjes së Zhvillimit të Bazuar në Zonë (ABD) për të lehtësuar rritjen e qëndrueshme në zonat gjeografike të përcaktuara në rajonet ndërkufitare të Ballkanit Perëndimor, në zona të veçanta rurale që karakterizohen nga probleme të veçanta komplekse zhvillimore, mund të konsiderohen për financim në kuadër të këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar. Puna përgatitore për qasjen ABD tashmë të zbatuar në rajonin ndërkufitar që mbulon ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë, do të merret në konsideratë.

SEKSIONI 4
PLANI FINANCIAR

Tabela 1 tregon sasinë vjetore të parashikuar të kontributit të Bashkimit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar për periudhën 2014-2020. Tabela 2 ofron një shpërndarje të parashikuar për alokimet për secilin prioritet tematik si dhe një parashikim mbi shumën maksimale të bashkë-financimit të Bashkimit Evropian.

Tabela 1: Alokimet e parashikuara financiare në vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020

Viti	Programi IPA II CBC Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë							Totali (EUR)
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Operacionet CBC (të gjitha prioritetet tematike)	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 530 000	10 710 000
Asistenca Teknike	510 000	0.00	0.00	510 000	0.00	0.00	170 000	1 190 000
Totali (EURO)	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	1 700 000	11 900 000

Tabela 2: Alokimet e parashikuara financiare për prioritet gjatë periudhës 2014-2020 dhe shkalla e kontributit të BE-së

PRIORITETET	Programi IPA II CBC Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – Republika e Shqipërisë 2014-2020			
	Kontributi i BE-së	Bashkë-financimi i përfituesve	Financimi total	Shkalla e kontributit të BE-së
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
1.Prioriteti Tematik 1: Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore	3 750 000.00	661 764.71	4 411 764.71	85%
2.Prioriteti Tematik 2: Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve	3 750 000.00	661 764.71	4 411 764.71	85%
3.Prioriteti Tematik 3: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	3 210 000.00	566 470.58	3 776 470.58	85%
4.Asistenca Teknike	1 190 000.00	0.00	1 190 000.00	100%
GRANTI TOTAL	11 900 000.00	1 890 000.00	13 790 000.00	

Kontributi i BE-së është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë-financimit të BE në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

Bashkë-financimi i prioriteteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

Shuma e dedikuar për asistencën teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të caktuar për programin. Shkalla e bashkë-financimit të BE-së do të jetë 100%.

Fondet për prioritetet tematike do të jepen nëpërmjet Vendimeve të Komisionit Zbatues, duke mbuluar alokime një deri në tre vjeçare, sipas nevojës. Fondet për asistencën teknike do të jepen nëpërmjet një Vendimi të veçantë të Komisionit Zbatues.

Seksioni 5
Dispozitat Zbatuese

Në kuadër të këtij programi nuk janë parashikuar thirrje për projekte strategjike.

Ashtu siç është parashikuar nën prioritetin e Asistencës Teknike, aplikuesit kanë të drejtë të kenë mbështetje gjatë hartimit dhe zhvillimit të projektit.

Duke pasur parasysh që baza duhet të identifikohet përpara ndërhyrjes së programit, të gjithë aplikuesit duhet të ofrojnë informacionin e kërkuar për të llogaritur vlerën e treguesve bazë. Informacioni duhet të sigurohet për aplikuesin kryesor, të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët.

Për shkak të burimeve të kufizuara financiare, nuk ka asnjë dispozitë për të synuar nën-tema ose aktivitete specifike për thirrje për propozime.

Modalitetet e propozuara të zbatimit janë të detajuara në përshkrimin e çdo prioriteti, të **bazuar në supozimin se gjatë periudhës së zbatimit të programit do të kryhen tre raunde të thirrjeve për projekt propozime** dhe në faktin që nuk është parashikuar asnjë projekt strategjik për zbatim. Tabela e mëposhtme përmbledh këto modalitete bazuar në dy skenarë të hartuar nën paragrafin e modaliteteve të zbatimit të seksionit 3.2. Megjithatë, këta skenarë kanë një natyrë supozuese dhe mund të ndryshojnë në bazë të mundësive të tjera që mund të shqyrtohen gjatë zbatimit të programit dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe rezultateve të prokurimit.

Skenari 1

Ky skenar parashikon organizimin e tre raundeve të thirrjeve për propozime me ndarje të barabartë financiare për çdo prioritet tematik, me afërsisht 1/3 e buxhetit total të programit për prioritet. Të gjitha thirrjet do të synojë secilin prioritet dhe aktivitete të zgjedhura.

Të gjitha grupet e synuara do të kenë akses të barabartë në financimin e ofruar nga programi.

Raundi i Thirrjeve për projekt-propozime	Aktivitetet
I pari	1.1.1.2 1.1.2.2 2.1.1.1 3.1.1.1
I dyti	1.1.1.1 1.1.2.1 2.1.1.2 3.1.2.1
I treti	1.1.1.1 1.1.2.1 1.1.1.2 1.1.2.2 2.1.1.1 2.1.1.2 3.1.1.1

Skenari 2

Sipas këtij skenari çdo thirrje për projekt propozime do të synojë një prioritet të vetëm, përveç raundit të parë ku Aktiviteti 1.1.2.2 është përjashtuar. Ky aktivitet do të përfshihet në raundin e dytë dhe të tretë të thirrjeve për projekt propozime, në mënyrë të përsëritur.

Raundi i Thirrjeve për projekt-propozime	Aktivitetet
I pari	Prioriteti 1, përveç aktivitetit 1.1.2.2 që mund të qarkullojë gjatë gjithë periudhës së zbatimit
I dyti	Prioriteti 2 me aktivitetin 1.1.2.2
I treti	Prioriteti 3 me aktivitetin 1.1.2.2

Të gjithë projektet dhe aksionet do të përzgjidhen për mbështetje duke pasur parasysh çështjet horizontale dhe ndërsektoriale të parashikuara në pikën 3.3.

Projektet duhet të projektohen dhe paketohen në përputhje me parimin e partnerit kryesor.

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1
Analiza e Situatës dhe Analiza SWOT

Analiza e Situatës së Zonës së Programit

Rajoni kufitar midis Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë karakterizohet nga gjuhë të ndryshme të folura dhe larmi etnike, por kulturë, histori dhe vlera tradicionale të ngjashme. Karakteristikat e mëposhtme kryesore hapësinore dhe klimatike dominojnë zonën e programit:

Vargu Jugor i Alpeve Dinarike (Dinariket) me pyje dhe kullota të bollshme, natyrë të pasur dhe mjedis të kombinuar me fusha dhe ultësira, pengon aksesin në të gjithë rajonin: diferenca ndërmjet majës më të lartë (Golem Korabi 2.753 m mbi nivelin e detit) dhe zonave fushore të Pellagonisë (130 m mbi nivelin e detit) është më shumë se 2.600 m.

Liqeni i Ohrit, i Prespës dhe Liqeni artificial i Dibrës, së bashku me Parqet Kombëtare Galiçica dhe Shebenik-Jabllanicë dhe fushat, kanionet dhe livadhet e tyre, sigurojnë kushte të favorshme për faunën dhe florën dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit. Pyjet mbulojnë rreth 44% të zonës së programit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe 37% të zonës së programit të Republikës së Shqipërisë. Liqeni i Ohrit është deklaruar nga UNESCO si vend kulturor dhe natyror i trashëgimisë botërore dhe Liqeni i Prespës është një zonë Ramsar me rëndësi ndërkombëtare;

Dy korridoret kryesore të transportit mbarë-evropian nxjerrin në pah vendndodhjen e rëndësishme gjeostrategjike të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë në Evropën Juglindore. **Korridori VIII** (Durrës-Shkup-Sofje-Varna) dhe **Dega D e Korridorit X** (Igumenicë-Manastir-Prilep-Veles) ndikojnë fuqishëm në dinamikën e zonës së programit, ekonominë, njerëzit dhe mjedisin e saj.[114]

1. **Zona kufitare është e pasur me minerale, p.sh.** krom, qymyr, hekur-nikel, bakër, gëlqere, kuarc, rërë dhe mermer;

2. **Rajoni ndërkufitar karakterizohet nga kushte të ndryshme klimatike:** nga trans – kontinentale në veri, në trans - mesdhetare në jug dhe në pjesët qendrore. Megjithatë, në zonat më

[114]Korridoret e përcaktuara sipas konkluzioneve të Konferencës së Kretës (1994) dhe Konferencës së Helsinkit (1997) mbi korridoret multimodal Pan-Evropian dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar nga vendet e Ballkanit Perëndimor (2004)

malore të këtyre rajoneve dimri është i ftohtë dhe i lagësht, ndërsa vera është e nxehtë dhe e thatë. Temperaturat në zonat malore përgjatë kufirit variojnë prej -16 deri në +36 gradë (minimumi dhe maksimumi). Mesatarja vjetore e reshjeve në anën e Republikës së Shqipërisë (+1.400 mm) është më e lartë se sa në anën e kufirit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (600 mm).[115]

Aspektet Politike

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka qenë identifikuar si një kandidat potencial për anëtarësim në BE që në vitin 2003. Vendi ka aplikuar për anëtarësim në BE në mars të vitit 2004 dhe i është dhënë statusi i kandidatit në vitin 2005.

Në mënyrë të ngjashme me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Republika e Shqipërisë u identifikua si një kandidat potencial për anëtarësim në BE në vitin 2003. Në vitin 2009 Republika e Shqipërisë paraqiti kërkesën zyrtare të saj për anëtarësimin në BE. Në vitin 2010, Komisioni vlerësoi se përpara se negociatat e pranimit të mund të hapen formalisht, Republika e Shqipërisë duhet të punonte akoma për të arritur një shkallë të nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti për të përmbushur 12 prioritetet kyçe të identifikuara nga Opinioni. Më vonë në vitin 2012, Komisioni rekomandoi që Republikës së Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit të BE-së, duke i lënë si detyrë plotësimin e masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe të administratës publike, si dhe rishikimin e rregullave të procedurave parlamentare.

Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë kuadri udhëzues i referencës politike është informuar nga Plani Kombëtar për Miratimin e *Acquis*, i cili informon politikat kombëtare dhe veprimet e qeverisë. Objektivat kryesore strategjike të Programit të Punës së Qeverisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë që kanë të bëjnë me periudhën 2011-2015 përfshijnë:

1. Përshpejtimi i rritjes ekonomike, punësimit dhe standardit të jetesës së qytetarëve, duke përfshirë cilësinë e jetesës;

2. Integrimi i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në BE dhe NATO;

3. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit dhe zbatimi efikas i ligjit duke ndërmarrë reforma të thella në gjyqësor dhe në administratën publike;

4. Mirëmbajtja e marrëdhënieve të mira ndër-etnike bazuar në parimet e tolerancës dhe respektit reciprok dhe zbatimi i Marrëveshjes Kuadër të Ohrit; dhe

5. Mbështetja e investimeve në arsim, shkencë dhe teknologji informacioni, si elementë kryesorë të një shoqërie të bazuar në dije.

Strategjia për Zhvillimin Rajonal 2009-2019 e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë identifikon bashkëpunim ndër-komunal dhe ndërkufitar, si një nga shtyllat dhe objektivat kryesore të zhvillimit të balancuar social-ekonomik rajonal. Rajonet kufitare, së bashku me zonat rurale dhe malore janë përcaktuar si zona me nevoja të veçanta zhvillimi, duke u bërë kështu një prioritet për ndërhyrje social-ekonomike.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim e Republikës së Shqipërisë 2014-2020 (NSDI) konsiderohet si kuadri i politikave gjithëpërfshirëse për vendin në kontekstin e integrimit në BE. Ajo përcakton katër shtyllat e politikës strategjike që përcaktojnë themelet për ndërhyrjet sektoriale dhe të bazuara në vend:

1. Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës që trajton aspekte si: sistemi zgjedhor, drejtësia dhe punët e brendshme, të drejtat e njeriut dhe media, qeverisja efektive dhe politikat e jashtme dhe të mbrojtjes;

2. Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik konkurrues dhe të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit efikas të burimeve që mbulojnë: stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makroekonomike, ekonominë konkurruese të tregut, përdorimin efikas të burimeve, zhvillimin e integruar rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

3. Nxitja e përfshirjes sociale, mirëqenies dhe zhvillimit të tregut të punës, të cilat synojnë të promovojnë: politikat e punësimit dhe përfshirjes sociale, politikat sociale;

4. Zhvillimi i një shoqërie të bazuar në dituri, inovacion dhe teknologji dixhitale, që përfshin ndërhyrjet në fushat në vijim: arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal të Republikës së Shqipërisë dallon **zonat kufitare si subjekt të planifikimit të politikave ndërsektoriale** dhe i bën çështjet ndërkufitare pjesë të planifikimit të politikave të zhvillimit në nivel qarku.

[115] Burimi: Banka Botërore

Raportet e vitit 2012 nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi zbatimin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë theksojnë se marrëdhëniet midis dy vendeve vazhdojnë të përmirësohen dhe ato tregojnë baza të shëndosha për shfrytëzimin e mundësive ekonomike në të dyja anët e kufirit.

Demografia

Dinamikat në demografi janë të ndryshme në të dy vendet. Ndërsa norma e popullsisë së përgjithshme të Republikës së Shqipërisë ka pësuar rritje të ndjeshme dhe është dyfishuar në 50 vitet e fundit, popullsia e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është rritur me mesatarisht 29%.

Në fund të vitit 2012, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë kishin një popullsi prej përkatësisht 2,061,044 dhe 2,815,749 banorë. Zona e programit përfshin 770,802 banorë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (37.4% e popullsisë së përgjithshme të saj) dhe 656,873 banorë në Republikën e Shqipërisë (23.3% e popullsisë së përgjithshme të saj). Një ndarje më e detajuar e nivelit të popullsisë sipas NUTS-3 dhe dendësisë së popullsisë (persona / km^2) është dhënë më poshtë.

Zona e Programit	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë
Pellagonia	232,959	49.4
Pollogu	317,003	131.2
Jug-perëndimi	220,840	66.1
Gjithsej në zonën e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë	**770,802**	**73.6**
Dibra	137,811	37.1
Elbasani	297,476	115.0
Korça	221,586	23.3
Gjithsej në zonën e Republikës së Shqipërisë	**656,873**	**69.2**

Burimi: Zyra e Statistikave e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, INSTAT

Rajoni i Pollogut me kryeqytetin e tij në Tetovë dhe Elbasani me qytetin kryesor të Elbasanit janë njësitë statistikore më të mëdha në zonën e programit në aspektin e popullsisë. Roli i shquar policentrik i qendrave të tyre kryesore urbane është reflektuar në dendësinë e popullsisë së dy rajoneve.

Femrat përbëjnë 49.9% të popullsisë në tre rajonet e pranueshme në territorin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, e cila pasqyron strukturën e popullsisë sipas gjinisë në të gjithë vendin. Në zonën e programit në Republikën e Shqipërisë femrat përbëjnë 49.5% të popullsisë së saj, që është pak nën mesataren e vendit (49,9%).

Përsa i përket rritjes natyrore të popullsisë, zonat e programit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë karakterizohen nga rritje pozitive natyrore në rajonin e Pollogut dhe atë jug-perëndimor, ndërsa të gjitha zonat përfituese në Republikën e Shqipërisë dhe në Pellagonia në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, po përjetojnë tendenca negative.

Megjithatë, vetëm normat e rritjes natyrore të bashkuara me bilancin e migrimit të kohëve të fundit ilustrojnë tendencat aktuale demografike. Brenda zonës së programit, vetëm rajonet e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë gëzojnë bilanc pozitiv të migrimit, ndërsa të gjithë rajonet në Republikën e Shqipërisë vuajnë nga tendencat negative të migrimit, të cilat kontribuojnë në shpopullimin e zonave të tyre. Bilanci negativ i migrimit në rajonet përkatëse të Republikës së Shqipërisë është shkaktuar nga zhvendosja e kontingjentit të punës të grupmoshës 25-40 vjeçare për të kërkuar për mundësi punësimi në rajone të tjera. Ndërsa largimi i meshkujve është më i përhapur në Dibër dhe Elbasan, Korça paraqet migrimin më të shpejtë të femrave drejt zonave të tjera.

Asnjëri nga të dy vendet nuk përjeton plakjen e popullsisë. Përkundrazi, mosha mesatare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë mbetet e njëjtë për dy vitet e fundit (38 vjeç) dhe popullsia në Republikën e Shqipërisë bëhet më e re (me një

mesatare prej 36 dhe 35 vjeç përkatësisht).[116] Brenda zonës së programit, mosha më e lartë mesatare e popullsisë është në Pellagoni (40 vjeç) dhe mbetet e qëndrueshme gjatë viteve të fundit, ndërsa rajoni më i ri është ai i Pollogut (35 vjeç), me tendenca të ngjashme me ato të vëzhguara në Republikën e Shqipërisë.

Popullsia e re (grupmosha 0-14 vjeç) përbën 17.1%, ndërsa popullsia e moshuar (65+ vjeç) përbën 11.9% të popullsisë së përgjithshme të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në Republikën e Shqipërisë, shifrat përkatëse janë: 20.3% dhe 11.6%, dhe nuk ka mospërputhje të mëdha midis rajoneve të vendit. Përkundrazi, Pollogu dhe Pellagonia regjistrojë diferencën më të lartë në lidhje me pjesën e popullsisë së tyre të moshuar: përkatësisht 8.5% dhe 15.0%.[117]

Raporti i moshës së të punësuarve është një çështje shqetësuese në Republikën e Shqipërisë. Edhe pse indeksi pësoi një rënie të ngadaltë dhe arriti në 47 në vitin 2012 ndërsa për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është përcaktuar në 41, rritja natyrore e bashkuar me rritjen e parashikuar të jetëgjatësisë mund të ndikojë negativisht në ekonomi. Në zonën e programit, Pellagonia është rajoni më i prekur nga plakja e popullsisë (shkalla e moshës së të punësuarve është 43) ndërsa në Republikën e Shqipërisë është Korça (mesatarisht 50%).[118]

Kohezioni Ekonomik

Të dy vendet shfaqin nivel të ngjashëm të zhvillimit dhe janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesataren nga Banka Botërore. Megjithatë niveli i Brendshëm i të Ardhurave Bruto i tyre thjesht e kalon vijën ndarëse midis ekonomive të tyre dhe të vendeve me të ardhura të ulëta – të mesme.

Prodhimi i Brendshëm Bruto

Duke pasur parasysh faktin se analizat janë kryer mbi nivelin NUTS-3 dhe GDP-ja për frymë tregon pozitë të shquar të kryeqyteteve të të dy shteteve, si të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe të Republikës së Shqipërisë, në vendet e tjera pasuria është e shpërndarë në mënyrë të moderuar në të dy shtetet, me pabarazi më të larta të vërejtura në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në krahasim me Republikën e Shqipërisë. Në vitin 2011, GDP për frymë arriti në 3,631 € në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 3,214 € në Republikën e Shqipërisë. Tabela e mëposhtme ilustron pabarazitë ndërmjet rajoneve të zonës së programit dhe treguesit e performancës së dy vendeve.

Zona e Programit	GDP për frymë (EURO)	Indeksi (për vend = 100)
Pellagonia	3,702	102
Pollogu	1,719	47
Jug-perëndimi	2,638	73
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	**3,631**	**100**
Dibra	1,999	62
Elbasani	2,796	87
Korça	2,526	79
Republika e Shqipërisë	**3,214**	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT

[116] Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave; llogaritja e bazuar në të dhënat e papërpunuara të INSTAT
[117] Burimi: *si më lart*
[118] Burimi: *si më lart*

Rajoni i Pollogut është më i pazhvilluari në të gjithë zonën e programit dhe Dibra mbetet prapa në zonën e Republikës së Shqipërisë. Në të vërtetë, rajoni i Dibrës është më i varfri në aspektin e performancës ekonomike në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Të dy rajonet janë në kufi me njëri-tjetrin.

Në vitin 2012, GDP-ja e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë u tkurr me 0.2%, ndërsa Republika e Shqipërisë ka shënuar një rritje të ulët prej 0.7%.

Vlera e Shtuar Bruto sipas Sektorëve

GVA ilustron strukturën e ekonomisë së zonës së programit dhe kjo është e qartë nga të dhënat statistikore që tregojnë se struktura e ekonomisë së ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është i ndryshëm nga struktura e ekonomisë së Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë mbështetet në tregjet me shumicë dhe pakicë që përbëjnë 31% të GVA-së së vendit, por ky sektor është i një rëndësie më të vogël në prefekturat e zonave të programit në Republikën e Shqipërisë. Këto janë rajone kryesisht bujqësore me prodhimin bujqësor të Dibrës dhe Korçës që kontribuojnë në 1/3 e GVA-së në këto rajone. Bujqësia në rajonet e zonës së programit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka kontribut më të vogël në GVA-në rajonale, duke pasur si sektorë kryesorë për gjenerimin e vlerës së shtuar në ekonominë e vendit industrinë dhe shërbime të tjera. Miniera dhe industria e Pellagonisë është faktori më i rëndësishëm që kontribuon në pasurinë e këtij rajoni. Në të vërtetë, vlera e saj e shtuar industriale në shifra absolute pothuajse e barazon vlerën e shtuar bruto industriale të të gjitha rajoneve të tjera në zonën e programit të të dy vendeve.

Kontributi në GVA nga sektorë të ndryshëm është përshkruar në figurën më poshtë.



Burimi: llogaritje bazuar në Zyrën Shtetërore të Statistikave; INSTAT

Tregtia e jashtme

Të dhënat mbi tregtinë e jashtme ilustrojnë potencialin ekonomik të çdo territori dhe është e qartë se zona e programit karakterizohet nga nivele të ulëta të aktivitetit ekonomik dhe konkurrencës ndërkombëtare. Në mënyrë të qartë, Pellagonia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Elbasani në Republikën e Shqipërisë luajnë rolin më të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e ekonomisë në zonën e programit (tabela më poshtë).

Zona e Programit	Aksionet në Eksport (%)	Aksionet në Import (%)
Pellagonia	6.4	3.9
Pollogu	2.7	2.9
Jug-perëndimi	1.9	1.8
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	**100**	**100**
Dibra	1.4	0.1
Elbasani	9.9	7.1
Korça	3.2	2.6
Republika e Shqipërisë	**100**	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Republika e Shqipërisë)

Minierat dhe Energjia

Zona kufitare ndërmjet dy vendeve është e pasur me minerale dhe burime natyrore. Ndërsa miniera e qymyrit është më e rëndësishmja për zonën kufitare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në basenet e Kërçovës dhe Pellagonisë, zona kufitare e Republikës së Shqipërisë, përveç qymyrit, shfrytëzon hekurin, bakrin dhe kromin. Brezi ndërmjet Bilishtit dhe Librazhdit ka depozita të konsiderueshme të hekurit dhe nikelit mineral. Prefekturat e Dibrës dhe Elbasanit janë të pasura me krom, me minierën e kromit në Bulqizën veriore që ka një rëndësi strategjike. Qymyri shfrytëzohet në Korçë, megjithatë depozitat e qymyrit në këtë zonë përbëjnë vetëm rreth 10% të të gjitha depozitave të qymyrit në Republikën e Shqipërisë.

Depozitat e qymyrit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikën e Shqipërisë janë linjit me vlerë relativisht të ulët në kalori dhe me përmbajtje të lartë të lagështirës dhe të hirit nga epokat gjeologjike të Pliocenit dhe Miocenit.

Minerale të tjera përfshijnë: titan-magnez, talk, granit, mermer, gurë gëlqerorë, dolomite dhe gurë të tjerë dekorativë karbonatikë.

Rajonet Pollog dhe ai jug-perëndimor në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përmbajnë 9 termocentrale hidroelektrike, ndërsa në Pellagoni ndodhet një impiant i energjisë diellore. Zona kufitare e Republikës së Shqipërisë përmban 41 hidrocentrale, kryesisht në lumenjtë Drin dhe Devoll. Kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit të energjisë elektrike të instaluar ilustron avantazhin e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe pse është Republika e Shqipërisë ajo që prodhon energji elektrike të gjelbër në sajë të impianteve të saj hidroelektrike.

Rajonet në zonën e programit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë prodhojnë 60% të energjisë elektrike të përgjithshme në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa rajonet në Republikën e Shqipërisë përbëjnë 47% të kapacitetit të impianteve të energjisë së vendit.

Zona e Programit	Kapaciteti (MW)
Pellagonia	685
Pollogu	190
Jug-perëndimi	258
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	**1,889**
Dibra	39.7
Elbasani	18.9
Korça	32.0
Republika e Shqipërisë	**195.8**

Burimi: Zyra e Statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (Republika e Shqipërisë), 2012

Sipërmarrja

Zona e programit karakterizohet nga veprimtari ekonomike nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Megjithatë rëndësia e tyre në ekonominë rajonale është më e ulët sesa në rajonet e tjera të të dy vendeve. Vetëm 32% e SME-ve të përgjithshme të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe 17% e SME-ve të përgjithshme të Republikës së Shqipërisë ndodhen në zonën e programit, dhe këto vlera konsiderohen shumë të ulëta në raport me numrin e popullsisë në rajonet kufitare.

Pabarazitë rajonale tashmë të theksuara ndikojnë edhe në disproporcionin e intensitetit të SME-ve në secilin rajon të pranueshëm. Nga e gjithë zona e programit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë më të përhapura në Pellagoni në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Korçë në Republikën e Shqipërisë. Siç përshkruhet në grafikun e mëposhtëm, rrethet e tjera përmbajnë një numër më të ulët të SME-ve.



Burimi: Llogaritje bazuar në Zyrën Shtetërore të Statistikave; INSTAT

Ndërsa minierat dhe industritë e lidhura me to në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë në gjendje të tërheqin bizneset e vogla dhe të krijojnë mundësi për zinxhirin e vlerave, industritë e rënda në Republikën e Shqipërisë prodhojnë pak efekt përhapje dhe shumë pak mundësi ekonomike për bizneset e vogla.

Zakonisht, në zonat kufitare bizneset shfrytëzojnë mundësitë e tregtisë ndërkombëtare, por tregtia midis dy vendeve dhe të tretëve është e kufizuar nga pengesat administrative, kryesisht në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa gëzojnë përparësi të lartë krahasuese të kostove të importit dhe eksportit të mallrave, SME-të në Republikën e Shqipërisë operojnë në një nga kuadret më të pafavorshme administrative në Evropë për ndërkombëtarizimin e biznesit. Aspektet kryesore të këtij problemi janë paraqitur në tabelën e mëposhtme (në bazë të të dhënave të SBA).

Faktori	Republika e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Kostot e kërkuara për të importuar (USD)	1,380	710
Koha e kërkuar për të importuar (ditë)	11	18
Nr. i dokumenteve të kërkuar për të importuar	6	9
Kostot e kërkuara për të eksportuar (USD)	1,376	725
Koha e kërkuar për të eksportuar (ditë)	12	19
Nr. i dokumenteve të kërkuar për të eksportuar	6	7

Burimi: të dhënat e SBA, Ndërmarrja DG

Barra administrative dhe konkurrenca e varfër rezultojnë në deficit të konsiderueshëm të tregtisë së jashtme midis dy vendeve, në disfavor të Republikës së Shqipërisë.

Punësimi

Bazuar në gjetjet e LFS, në fillim të vitit 2012 dhe 2013, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë kishin përkatësisht 56.5% dhe 63.2% popullsi në moshë pune (grupmosha 15-64 vjeç) ekonomikisht aktive, me pabarazi të mëdha nëpër rajonet e të dy vendeve. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përqindja më e lartë (60.9%) ishte regjistruar në rajonin Juglindor, dhe më e ulëta në rajonin e Pollogut (44.3%). Edhe pse shifrat rajonale nuk janë në dispozicion për Republikën e Shqipërisë, vlerësohet se rajoni i Tiranës regjistron normat më të larta të aktivitetit, në krahasim me pjesën tjetër të vendit. Zonat e kufirit të Republikës së Shqipërisë përmbajnë norma të aktivitetit nën mesataren e vendit.

Shkalla e punësimit prej 44% në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është më e ulët se ajo në Republikën e Shqipërisë (50.1%). Në zonën kufitare CBC Pellagonia ka normën më të lartë (46.9%) ndërsa Pollogu dhe jugperëndimi – përkatësisht 29.3% dhe 32.4%. Rajonet e bashkëpunimit ndërkufitar në Republikën e Shqipërisë kanë norma punësimi më të larta, ku të gjithë e kalojnë mesataren e vendit: Dibra 55%, Elbasani 55.7% dhe Korça 53.8%. Këto norma të larta të punësimit rezultojnë nga niveli minimal i jetesës dhe nga prodhimi bujqësor në shkallë të ulët, i cili siguron një formë të sigurimeve shoqërore për pjesën më të madhe të popullsisë rurale, dhe shërben si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

Norma e punësimit	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Meshkuj	52.4	56.6
Femra	35.3	43.7

Burimi: LFS nga Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT

Nivelet e punësimit sipas gjinisë gjithashtu përshkruajnë pabarazi të mëdha midis dy vendeve. Për Republikën e Shqipërisë, si meshkujt ashtu edhe femrat janë më aktivë në tregun e punës dhe gjejnë më shpesh mundësi për të bërë të ardhura se sa homologët e tyre në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Megjithatë, këto pabarazi rezultojnë kryesisht nga pjesa e lartë e punësimit në sektorin e bujqësisë, ku punojnë 40% e meshkujve dhe 60% e femrave ekonomikisht aktivë.

Në bazë të sektorëve, pjesën më të madhe të kontributit në krijimin e punësimit në Republikën e Shqipërisë e ka bujqësia (duke përfshirë peshkimin dhe pyjet), e cila punëson rreth 48.7% të popullsisë ekonomikisht aktive, ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë këtë sektor përbën 17.3% të të gjithë të punësuarve. Prodhimi industrial, industria dhe ndërtimi është punëdhënësi më i madh në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe përbën 29.9% të të gjithë të punësuarve. Në Republikën e Shqipërisë ky sektor kontribuon vetëm në 16% të mundësive për punësim.

Nuk ka të dhëna specifike mbi punësimin sipas sektorëve në nivel rajonal, por vlerësohet se sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe sektori i bujqësisë në Republikën e Shqipërisë.

Turizmi

Natyra, trashëgimia kulturore dhe historike janë themelet kryesore të zhvillimit të turizmit në zonën kufitare. Potenciali turistik është i rëndësishëm në zonën kufitare, por ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë e ka më të zhvilluar industrinë e turizmit dhe i shfrytëzon mundësitë e zinxhirit të vlerave në shkallë shumë më të madhe se Republika e Shqipërisë. Kjo ilustrohet nga numri i qëndrimeve me fjetje në qendra akomoduese: ndërsa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka regjistruar më shumë se 2,1 milionë në vitin 2012, Republika e Shqipërisë regjistroi vetëm 0.8 milion qëndrime turistike me fjetje. Turizmi familjar në Republikën e Shqipërisë përbën 55.6%, ndërsa në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 62.2% të të gjithë industrisë së turizmit. Me më shumë se 26.8 mijë dhoma në qendrat akomoduese, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka kapacitet më

të lartë strehimi se sa Republika e Shqipërisë (me vetëm 18.9 mijë dhoma).

Megjithatë, ka dallime strukturale dhe rajonale midis dy vendeve: ndërsa destinacionet turistike prioritare në Republikën e Shqipërisë janë në bregdetin Adriatik dhe Jon, infrastruktura e turizmit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përqendrohet në rajonin jugperëndimor. Në të vërtetë, trafiku i turizmit në jugperëndim është më i madhi i të gjitha rajoneve të vendit dhe përbën 45.1% të numrit të përgjithshëm të turistëve në vend, me zonat kryesore turistike rreth liqeneve të Ohrit dhe Prespës. Trafiku i turizmit në zonën e programit të Republikës së Shqipërisë është relativisht i parëndësishëm kur krahasohet me zonës ndërkufitare të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, edhe pse për shkak të mungesës së të dhënave specifike rajonale mbi këtë temë nuk mund të nxirren konkluzione të mëtejshëm.

Ekonomia Rurale

Lartësia e tokës në zonën e programit krijon kushte të favorshme për pylltarinë dhe janë pikërisht zona Jugperëndimore dhe Pellagonia në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe të gjitha rajonet CBC në Republikën e Shqipërisë, zonat ku mbulimi i pyjeve është mbi mesataren e të dy vendeve. Në të vërtetë, Republika e Shqipërisë përmban një ndër pjesët më të vogla të tokës së punueshme në të gjitha tokat bujqësore në Evropë. Lartësia e tokës ndikon negativisht në ekonominë rurale të komuniteteve të zonës kufitare dhe zvogëlon mundësitë bazike ekonomike dhe të të ardhurave që rrjedhin nga shfrytëzimi i tokës.

Megjithatë, ekonomia rurale dhe bujqësia është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë në të dy vendet, edhe pse Republika e Shqipërisë mbështetet në prodhimin e ushqimit në shkallë shumë më të madhe se sa ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Tabela e mëposhtme jep faktet thelbësore të potencialit ekonomik rural lidhur me tokën bujqësore (shifrat në '000 ha nëse nuk citohet ndryshe).

Shteti / Rajoni	Tokë e përgjithshme bujqësore	Tokë e punueshme dhe kopshte	Tokë e punueshme si % e tokës bujqësore	Madhësia mesatare e fermës (ha)
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**1,268**	**510**	**40**	**1.60**
Pellagonia	263	112	43	2.90
Pollogu	169	43	25	4.10
Jugperëndimi	136	50	37	3.00
Republika e Shqipërisë	**2,875**	**696**	**24**	**1.20**
Dibra	249	41	16	0.72
Elbasani	327	73	22	1.26
Korça	371	91	25	1.27

Burimi: INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe: llogaritje të bazuara në të dhënat e Bankës Botërore për madhësisë së fermës në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 2012

Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë toka e punueshme përbën 40% të të gjithë tokës bujqësore, ndërsa në Republikën e Shqipërisë ky raport është 24%. Mesatarisht, në zonën e programit të të dy vendeve pjesa e tokës së punueshme në raport me madhësinë e përgjithshme të tokës bujqësore është nën mesataren e vendit, duke sjellë kushte të pafavorshme për ekonominë rurale. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë prodhimi bujqësor ka kushte më të favorshme natyrore për kulturat bujqësore dhe prodhimin blegtoral.

Ekonomia rurale e të dy vendeve është e fragmentuar. Në Republikën e Shqipërisë madhësia mesatare e fermës është 1.2 ha dhe vetëm rajoni i Dibrës është nën mesataren e vendit. Në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë madhësia mesatare e fermës është 1.6 ha, por zona e programit përmban fermat më të mëdha bujqësore në krahasim me çdo zonë tjetër të vendit.

Prodhimet bimore kryesore në zonën e programit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Prodhimet bujqësore janë radhitur në bazë të prodhimit të përgjithshëm për vendin dhe rajonin.

Shteti / Rajoni	Prodhimi kryesor bujqësor
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**Gruri, perimet, patatet, misri, tërfili**
Pellagonia	Gruri, perimet, patatet, frutat, jonxha, duhani
Pollogu	Misri, patatet, perimet, jonxha, tërfili
Jugperëndimi	Patatet, gruri, misri, jonxha, perimet, frutat
Republika e Shqipërisë	**Gruri, misri, perimet, fasulet, patatet, tërshëra**
Dibra	Misri, gruri, perimet
Elbasani	Gruri, misri, perimet, tërshëra, fasulet, patatet, bagëtitë, frutat dhe rrushi
Korça	Gruri, misri, perimet, fasulet, elbi

Burimi: përpunimi në bazë të INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Republika e Shqipërisë) dhe Zyra shtetërore e statistikave (ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë), 2012

Ndërsa zona CBC e Republikës së Shqipërisë është e specializuar në drithëra, perime, fasule dhe prodhimin e tërshërës, ekonomia rurale e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është më e larmishme dhe rajonet janë të specializuar në varietete të kulturave. Rajonet e Jugperëndimit dhe Elbasanit janë shembuj ku të ardhurat janë të larta dhe prodhimi është i larmishëm, ndërsa Korça dhe Pollogu kanë të ardhura më të ulëta në prodhimin bujqësor.

Ekonomia rurale në zonën e programit ndikohet negativisht nga erozioni i tokës. Lartësia e tokës, veçanërisht në zonat ku alternohen malet, kodrat dhe luginat me karakterin e rrëmbyeshëm të reshjeve, kontribuon në humbjet e përshpejtuara të tokave. Nuk ka të dhëna specifike rajonale mbi erozionin e tokës, por në nivel kombëtar Republika e Shqipërisë është vlerësuar të ketë një humbje prej më shumë se 16 t / ha në vit, ndërsa për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kjo shifër është vlerësuar të kalojë 18 t / ha.[119]

Infrastruktura e Transportit

Të dhënat kryesore mbi infrastrukturën dhe transportin janë përshkruar në tabelën e mëposhtme.

Treguesi	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Republika e Shqipërisë
Hekurudha (km)	696	399
Rrugë në total (km)	13,983	18,000
Lokomotiva	52	53
Transport hekurudhor për mallra ('000 t-km)	478,925	8,333
Makina të pasagjerëve	313,084	300,974
Mjete për transportin e mallrave	27,917	71,278
Autobuzë	2,636	6,698

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), INSTAT, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Republika e Shqipërisë), 2012

Nuk ka të dhëna që ilustrojnë ndarjen rajonale të infrastrukturës së transportit, por për të dy vendet rruga e interesit të përbashkët të transportit është Korridori VIII Perëndim-Lindje dhe për zonën kufitare është një seksion i rrugës Elbasan-Kafasan-Shkup. Autostrada Tiranë-Elbasan e përfunduar kohët e fundit është një përmirësim i rëndësishëm në këtë rrugë ndërkombëtare, e cila përmirëson kushtet e sigurisë së transportit rrugor dhe aksesin në të.

Transporti rrugor duket si mënyra më e rëndësishme e transportit, pasi nuk ka asnjë hekurudhë që lidh të dy vendet - linja Shkup-Kërçovë nuk shtrihet më tej në drejtim të Ohrit dhe në kufi.

Kohezioni Social

Ky seksion përshkruan tiparet kryesore të kapacitetit të zonës së programit për të siguruar mirëqenien e popullit të saj duke minimizuar dallimet dhe duke shmangur margjinalizimin.

[119] Burimi: Qendra e përbashkët kërkimore, Komisioni Evropian

Papunësia

Sipas metodologjisë LFS, shkalla e papunësisë përfaqëson pabarazi të mëdha ndërmjet dy vendeve kufitare. Në mënyrë të qartë, papunësia është një çështje shumë shqetësuese dhe problematike në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa në Republikën e Shqipërisë pjesa më e madhe e fuqisë punëtore thithet nga ekonomia e fragmentuar rurale.

Zona e Programit	Papunësia (%)
Pellagonia	25.3
Pollogu	34.2
Jugperëndimi	42.3
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**31.0**
Dibra	8.7
Elbasani	6.0
Korça	10.4
Republika e Shqipërisë	**13.4**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, LFS 2012

Të ardhurat

Pagesa mesatare neto për të punësuarit në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë arrin në 335 € dhe në Republikën e Shqipërisë deri në 356 €. Pra, njerëzit në Republikën e Shqipërisë fitojnë 7% më shumë se sa ata që jetojnë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Pagat neto ndryshojnë në rajone të ndryshme në të dy vendet, por në zonat përfituese të programit nuk ka pabarazi të konsiderueshme në nivelin e të ardhurave neto.

Zona e Programit	Paga neto, Për vend=100
Pellagonia	91.7
Pollogu	95.6
Jugperëndimi	90.8
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**100**
Dibra	97.0
Elbasani	95.7
Korça	100.3
Republika e Shqipërisë	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, llogaritje në bazë të të dhënave të INSTAT

Teknologjia e Informacionit

Zona e programit karakterizohet nga pabarazi të larta në aksesin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit, e cila është një nga forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik bashkëkohor. Pabarazitë lidhen me diferencat ndërmjet dy vendeve dhe midis rajoneve të pranueshëm të Republikës së Shqipërisë.

Zona e Programit	Përdorimi i Kompjuterave	Përdorimi i Internetit
Pellagonia	61.0	55.0
Pollogu	64.0	64.0
Jugperëndimi	64.0	57.0
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**64.0**	**58.0**
Dibra	15.5	6.5
Elbasani	16.8	8.3
Korça	14.5	11.0
Republika e Shqipërisë	**20.2**	**14.1**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave, INSTAT, LSMS 2012

Të dhënat e mësipërme ilustrojnë një ndarje dixhitale ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë, ku familjet dhe bizneset shqiptare janë padyshim të ekspozuar ndaj përjashtimit dixhital. Kjo dukuri përbën një shqetësim kritik, pasi nuk rezulton nga paaftësia apo mosha e njerëzve. Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë normat krahasimore janë të larta, por prapë mbeten më të ulëta se në të gjithë shtetet anëtare të BE-së, me afërsisht 30% nën mesataren.

Arsimi

Në të dy vendet shkalla e arsimimit është konsideruar e lartë: 96% për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 97% për Republikën e Shqipërisë. Nuk ka devijime të mëdha rajonale nga mesatarja kombëtare apo pabarazi ndërmjet rajoneve që përbëjnë zonën e programit.

Edukimi dhe Shkollimi

Shkollimi dhe arsimimi janë strukturat dhe instrumentet qendrore për të zhvilluar dhe për të formësuar kapitalin njerëzor, i cili ka një rol themelor në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme të bazuar në dije, konkurrencës, kohezionit social dhe qëndrueshmërisë.

Ndërsa aksesi në arsimin fillor është relativisht i ekuilibruar dhe shkollat nuk janë të mbipopulluara, arsimi i mesëm është disi më i sforcuar, veçanërisht në Republikën e Shqipërisë, me qarkun e Dibrës të ekspozuar kryesisht ndaj infrastrukturës së pamjaftueshme të shkollave. Në këtë rajon, numri mesatar i nxënësve për mësues është dukshëm më i lartë se mesatarja për vendin (shih tabelën më poshtë).

Zona e programit	Nr. i nxënësve për mësues (arsimi fillor)	Nr. i nxënësve për mësues (arsimi i mesëm)	Nr. i studentëve të diplomuar në 1,000 banorë
Pellagonia	11	14	118
Pollogu	12	13	71
Jugperëndimi	10	13	92
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**12**	**13**	**103**
Dibra	15	21	39
Elbasani	14	16	63
Korça	13	15	77
Republika e Shqipërisë	**16**	**16**	**94**

Burimi: llogaritja e bazuar në të dhënat e papërpunuara nga Zyra Shtetërore e Statistikave dhe INSTAT, 2011

Shekulli i 21[të] karakterizohet nga emigrimi i personave me arsim të lartë, e cila është një dukuri e përhapur me rritjen e rolit të qyteteve dhe qendrave urbane, duke thelluar ndarjen urbane-rurale. Ky fenomen ndikon seriozisht në zonën e programit, me përjashtim të rajonit të Pellagonisë. Në vendet e tjera problemi është i përhapur (më shumë në Republikën e Shqipërisë), me kulmin negativ në Dibër, ku përqindja e njerëzve me arsim universitar është më e ulëta në mbarë territorin e programit CBC.

Furnizimi me ujë dhe Menaxhimi i mbetjeve

Në zonën e programit, rreth 97% e familjeve nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë janë të lidhura me sistemet individuale ose publike të furnizimit me ujë dhe 95% - me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Përkatësisht, në Republikën e Shqipërisë, këto shifra janë: 95% dhe 87%.

Nuk ka statistika mbi vëllimin e trajtimit të ujërave të zeza, por vlerësohet se të paktën deri në 10% të mbetjeve të lëngshme trajtohen. Përveç shfrytëzimit të pakontrolluar të plehrave kimike në bujqësi, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza është arsyeja kryesore për eutrofikimin e përshpejtuar të pjesës më të madhe të ekosistemeve ujore në zonën e programit (liqene dhe lumenj).

Përsa i përket mbetjeve të ngurta, 70% e mbetjeve të gjeneruara në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë është mbledhur, por për Republikën e Shqipërisë kjo pjesë është vlerësuar në nivele të konsiderueshme më të ulëta.

Tabela e mëposhtme përshkruan statistikat mbi mbetjet e ngurta të grumbulluara në zonën e programit.

Zona e programit	Ton ('000)	Ndarja (%), për vend=100
Pellagonia	72	13.0
Pollogu	59	10.6
Jugperëndimi	49	8.8
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**555**	**100**
Dibra	33.1	2.9
Elbasani	81.1	7.1
Korça	62.1	5.4
Republika e Shqipërisë	**1,137**	**100**

Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), Ministria e Mjedisit (Republika e Shqipërisë), 2012

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kapaciteti i vend-grumbullimeve të mbetjeve të ngurta është i shpërndarë në mënyrë të arsyeshme nëpër rajone dhe korrespondon në mënyrë të kënaqshme me vëllimin e mbetjeve të gjeneruara. Ndërsa për Republikën e Shqipërisë nuk disponohen të dhëna lidhur me këtë aspekt.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta është një çështje shqetësuese për shkak të raportit të ulët të mbetjeve të krijuara dhe atyre të mbledhura. Përveç kësaj, ndarja gjatë depozitimit të mbetjeve është pothuajse jo-ekzistuese, e cila rrit koston e menaxhimit të mbetjeve dhe ndikon në mjedis.

Infrastruktura e kujdesit shëndetësor

Infrastruktura e kujdesit shëndetësor përmban pabarazi domethënëse përgjatë kufirit. Mesatarisht, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ofron mundësi më të mira të trajtimit të specializuar mjekësor dhe Pellagonia ka infrastrukturën më konkurruese të kujdesit shëndetësor në të gjithë zonën e programit. Edhe pse territori CBC në anën e Republikës së Shqipërisë mund të ofrojë më shumë shtretër në spitale se mesatarja për të gjithë vendin, Shqipëria ka hyrë në marrëveshje strategjike me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, sipas së cilës qytetarët e Republikës së Shqipërisë me sëmundje kronike mund të përdorin spitalet dhe klinikat në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për një trajtim më të specializuar. Kjo ndodh për shkak të pranisë së kufizuar të pajisjeve moderne apo aksesit të vështirë fizik të infrastrukturës shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, kryesisht në zonat më të largëta.

Zona e programit	Nr. i Spitaleve	Nr. i shtretërve të spitaleve	Nr. i shtretërve të spitaleve për 1,000 banorë
Pellagonia	3	1,419	6,1
Pollogu	7	646	2
Jugperëndimi	5	815	2
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	**73**	**9,076**	**4,4**
Dibra	3	508	3,7
Elbasani	6	1,020	3,4
Korça	4	752	3,4
Republika e Shqipërisë	**44**	**8,410**	**3**

Burimi: Ministria e Shëndetësisë (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Shqipërisë)

Analiza SWOT

Kjo analizë SWOT ndjek logjikën e prioriteteve tematike të asistencës IPA II dhe përshkruan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet duke marrë parasysh karakterin apo efektin e tyre strategjik (cilësia e nevojës ose e mundësisë). Kjo analizë SWOT mbulon vetëm ato tema që janë konsideruar për përfshirjen në ndërhyrjen strategjike dhe shton analizën e grupit të problemeve të përshkruar në seksionin 2.2 të dokumentit të programit.[120]

SWOT është hartuar në bazë të pyetësorëve individualë të plotësuar nga palët e interesuara të programit, reagimet nga Strategjitë ekzistuese të Zhvillimit Rajonal në rajonet e NUTS-3 në zonën kufitare, dhe konkluzionet e ekspertëve mbi profilin social-ekonomik të rajonit.

Analiza më poshtë ndjek rendin sipas rëndësisë së prioriteteve tematike të zgjedhura për Programin IPA II CBC 2014-2020.

Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore (TP4)

Aktualisht, niveli i pabarabartë i zhvillimit të infrastrukturës turistike në rajonin ndërkufitar e bën rajonin e përgjithshëm jo tërheqës për një ofertë gjithëpërfshirëse turistike, veçanërisht në anën e Republikës së Shqipërisë. Kështu, format alternative të turizmit mund të përdoren si bazë për ndërtimin e një imazhi të zonës së programit si një destinacion tërheqës turistik.

Trashëgimia e pasur kulturore nuk është e ruajtur dhe paraqitur mirë. Kështu, iniciativat për rritjen e bashkëpunimin ndërmjet njerëzve dhe institucioneve nga rajoni CBC duhet të intensifikohen në të ardhmen.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Efekt) Ofertë e pasur turistike bazuar në shfrytëzimin e burimeve natyrore, trashëgiminë kulturore, monumentet fetare, ujërat termale, sportin dhe argëtimin	**(Dobësi strategjike)** Nuk ka nivel të balancuar të infrastrukturës së turizmit (akomodim, sporte, terrene) dhe mungesa e strategjisë për ofertë të qëndrueshme turistike të rajonit CBC
(Pikë e fortë strategjike) Eksperienca në pritjen e mysafirëve vendas dhe ndërkombëtarë	**(Efekt)** Mungesa e njohjes ndërkombëtare të të gjithë rajonit CBC si destinacion atraktiv turistik
(Pikë e fortë strategjike) Një pjesë e territorit CBC rrit njohjen e tij si destinacion turistik i rëndësishëm për turizmin familjar	**(Efekt)** Mirëmbajtja e papërshtatshme e monumenteve historike dhe kulturore
Mundësitë	**Kërcënimet**
(Efekt) Ofertë turistike e integruar, e bazuar në kulturë, sport, kohë të lirë, aventurë, turizmin spa (të llixhave)	**(Efekt)** Mungesa e strategjisë së integruar të zhvillimit të turizmit dhe masave të përkushtuara për rajonin CBC
(Mundësi strategjike) Shkëmbim më efikas dhe i integruar i përvojave ndërmjet dy vendeve dhe operatorëve	**(Kërcënim strategjik)** Investime të pa balancuara në infrastrukturën e turizmit
(Mundësi strategjike) Plani i përbashkët për hartëzimin, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve kulturore dhe historike	**(Efekt)** Imazhi i papërshtatshëm i rajonit CBC
(Mundësi strategjike) Aktivitete të përbashkëta kulturore	

Konkurrenca, biznesi, tregtia dhe investimet (TP7)

SME-të, sipërmarrja dhe ekonomia rurale paraqiten si një nga forcat kryesore lëvizëse të zhvillimit ekonomik në zonën e programit. Ato janë të ndjeshme ndaj ndryshimeve të politikës dhe të tregut, kryesisht për shkak të konkurrencës së kufizuar dhe orientimit të tregut të tyre. Kështu, industritë e lehta, sektorët e qëndrueshëm të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit janë konsideruar si një potencial për rritje më të qëndrueshme ekonomike të rajonit CBC në tërësi.

[120]Në korrik 2013 Strukturat Operacionale arritën në përfundimin se lista e TP-ve duhet të ngushtohet para hyrjes në fazën e konsultimeve më të gjera të programimit për shkak të burimeve të kufizuara financiare të programit. Më pas, TP-të janë renditur sipas rëndësisë së tyre dhe janë përfshirë në ndërhyrjen për vitet 2014-2020.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Pikë e fortë strategjike) Baza ekzistuese e SME-ve në rajonin e përgjithshëm me aktivitete të shumëllojshme	**(Dobësi strategjike)** SME-të janë të karakterit mikro dhe jashtëzakonisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve politike, fiskale apo të tregut
(Pikë e fortë strategjike) Prodhimi i larmishëm bujqësor dhe ekonomia rurale në të gjithë rajonin	**(Dobësi strategjike)** Mungesa e specializimit, vlerës së shtuar, hulumtimit dhe orientimit të plotë të tregut
(Efekt) Bizneset e mesme të qëndrueshme dhe konkurruese, veçanërisht në rajonet e Pollogut, Elbasanit dhe Pellagonisë	**(Efekt)** Konkurrenca e kufizuar e produkteve në nivel rajonal dhe kombëtar, nivelet e ulëta të GVA
	(Dobësi strategjike) Bujqësia e karakterizuar nga fragmentim i madh, produktivitet i kufizuar dhe mungesë e orientimit në treg
	(Dobësi strategjike) Burimet natyrore në dispozicion të bujqësisë konkurruese dhe praktikave të prodhimit të ushqimit, të pashfrytëzuara
	(Kërcënim strategjik) Ofertë e kufizuar e produkteve gjysmë-të gatshme me sasi të qëndrueshme
Mundësitë	**Kërcënimet**
(Efekt) Zhvillimi ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve të disponueshme natyrore dhe zinxhirët e vlerave	**(Efekt)** Mospërputhje të mëdha në nivelin e zhvillimit dhe aktivitetet ekonomike midis rajoneve të ndryshme në zonën e bashkëpunimit ndërkufitar
(Mundësi strategjike) Specializimi i SME-ve dhe fuqizimi i tyre përmes shtimit të vlerës së produkteve të tyre	**(Efekt)** Aktivitete të pamjaftueshme të eksportit
(Mundësi strategjike) Identifikimi i produkteve që mund të njihen në nivel ndërkombëtar	**(Efekt)** Mikro-sipërmarrjet jo rezistuese ndaj ndryshimeve të tregut
(Mundësi strategjike) Prodhimi bujqësor dhe përpunimi i ushqimit organik, ose të paktën i qëndrueshëm organik	**(Kërcënim strategjik)** Prodhimi bujqësor i gjerë me tërheqje të kufizuar të tregut
(Mundësi strategjike) Bashkëpunim dhe tregti më të zhvilluara midis shoqërive në rajonin e Bashkëpunimit Ndërkufitar	**(Kërcënim strategjik)** Erozioni i lartë i tokës për shkak të lartësisë së tokës
(Mundësi strategjike) Zhvillimi i infrastrukturës së biznesit dhe rrjeteve të biznesit (inkubatorët, qendrat mbështetëse të biznesit, shoqatat, etj.)	

Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut (TP2)

Pavarësisht minierave intensive në territorin e kufizuar, rajoni i bashkëpunimit ndërkufitar është perceptuar si "zonë e gjelbër" e përshtatshme për zhvillimin ekonomik të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për shkak të pyjeve të bollshme, lumenjve dhe liqeneve. Megjithatë, rajoni nuk ka asnjë sistem për monitorimin e mjedisit apo për parandalimin e rrezikut. Për më tepër, mungesa e infrastrukturës mjedisore minimale të kërkuar (trajtimi i mbetjeve ujore, grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta, etj.) mund të çojë në ndotjen e mëtejshme të pakontrolluar në rajon dhe në rënien e tërheqjes nga aktivitetet e biznesit të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
(Pikë e fortë strategjike) Prania e burimeve të shumëllojshme natyrore (uji, pyjet, flora dhe fauna, klima)	**(Dobësi strategjike)** Mungesa e planeve për mbrojtjen e mjedisit, monitorimin dhe sistemet e parandalimit të rrezikut për çdo lloj të ndotjes në rajon dhe parandalimin e erozionit të tokës
(Efekt) "Zonë e pastër", pa ndotje të mëdha industriale	**(Dobësi strategjike)** Mungesa e kontrollit të shfrytëzimit të burimeve natyrore (minierat, pyjet)
(Pikë e fortë strategjike) Prania e zonave të ndryshme klimatike (malore, kontinentale dhe mesdhetare) mundëson prodhimin më të specializuar të bujqësisë	**(Efekt)** Ndërgjegjësimi i ulët i popullsisë për mbrojtjen e mjedisit

dhe zhvillimin e turizmit alternativ	
Mundësitë	**Kërcënimet**
(Efekt) Zhvillimi i strategjisë së përbashkët për mbrojtjen e mjedisit të rajonit CBC, monitorimin, njohjen e hershme dhe parandalimit e rrezikut	**(Efekt)** Rajonet e vogla me një kërcënim për ndotje që mund të rrezikojë zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekonomike / turistike
(Mundësi strategjike) Zhvillimi i programeve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve	**(Kërcënim strategjik)** Mungesa e stimujve dhe investimeve në mbrojtjen e mjedisit dhe / ose teknologjive më miqësore
(Mundësi strategjike) Hartimi dhe zhvillimi i projekteve, studimeve të fizibilitetit për mbrojtjen e ujërave ndërkombëtare dhe ujërave nëntokësore	**(Kërcënim strategjik)** Ujërat ndërkombëtare me rrezik të lartë të ndotjes

SHTOJCA II
KUSHTET E PËRGJITHSHME

Pjesa e parë: Dispozita të përgjithshme
Neni 1 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues
Neni 2 – Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta
Neni 3 – Kërkesat e raportimit
Neni 4 – Vizibiliteti dhe Komunikimi
Neni 5 – Të drejtat e pronësisë intelektuale
Neni 6 – Pranueshmëria e shpenzimeve
Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme të menaxhimit të tërthortë
nga përfituesi i IPA II
Neni 7 – Parime të përgjithshme
Neni 8 – Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve
Neni 9 – Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni
Neni 10 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura
Neni 11 – Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues
Neni 12 – Ndërprerja e pagesave
Neni 13 – Mbulimi i fondeve
Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare
Neni 14 – Konsultimi mes përfituesve të IPA II dhe Komisionit
Neni 15 – Amendimi i kësaj marrëveshjeje financimi
Neni 16 – Pezullimi i kësaj marrëveshjeje të financimit
Neni 17 – Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare
Neni 18 – Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Pjesa e parë
Dispozita të përgjithshme

Neni 1
Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës Marrëveshja e Financimit është zbatuar dhe përfshin periudhën operative të zbatimit, si dhe një fazë të mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit është përcaktuar në nenin 2 (1) të Kushteve të Veçanta, dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha në të cilën kanë përfunduar të gjitha aktivitetet operative të mbuluara nga prokurimi dhe kontratat e grantit të Programit të Veprimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2 (2) për Kushtet e Veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

3. Periudha operacionale e zbatimit dhe ekzekutimit duhet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues në përmbyllje dhe zbatim të prokurimit dhe kontratave të granteve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare.

4. Kostot që lidhen me operacionet e Programit të Veprimit do të jenë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operativ.

5. Kontratat e grantit dhe të prokurimit do të përfundojnë e shumta brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare, përveç:

a) në ndryshimet në kontratat tashmë të lidhura;

b) kur kontratat individuale të prokurimit përfundojnë pas një ndërprerjeje të parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të jenë të nënshkruara pas zbatimit operacional;

d) kur ndryshimi i entitetit është i ngarkuar me detyra të besuara.

6. Kur një kontratë granti ose prokurimi, nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda dy viteve të nënshkrimit të saj, do të ndërpritet automatikisht dhe fondet e saj do të bllokohen.

Neni 2
Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76 (3) të kuadrit të marrëveshjeve përkatëse, përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë ngushtë dhe duhet të përmbushin bashkërisht në veçanti funksionet e mëposhtme dhe të marrin përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar në përputhje me nenin 68 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse ose rishikimet e tyre;

b) sigurojnë pjesëmarrjen në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM), mbledhje dhe takime të tjera dypalëshe;

c) emërojnë përfaqësuesin e tyre në KPM;

d) krijojnë Sekretariatin e Përbashkët Teknik (SPT) dhe sigurojnë që ka personel të mjaftueshëm;

e) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike te KPM;

f) mbështesin punën e KPM-së dhe sigurojnë informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, në veçanti të dhënat që lidhen me ecurinë e programit operativ në arritjen e objektivave specifike dhe synimeve për prioritet tematike, si ngritja e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

g) krijojnë një sistem për të mbledhur informacion të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

h) hartojnë raportet vjetore dhe finale te zbatimit siç janë përmendur në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në përputhje me nenin 3;

i) të përgatisin dhe të zbatojnë një plan koherent për komunikim dhe vizibilitet;

j) të hartojnë një plan vjetor të punës për Sekretariatin e Përbashkët Teknik, të miratuar nga KPM.

Neni 3
Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenin 80 (1) të marrëveshjeve përkatëse Kuadër, strukturat operuese do të përdorin modelin e parashikuar në Shtojcën III të kësaj marrëveshjeje financimi.

2. Për qëllim të kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuar në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit nën menaxhimin e tërthortë, të përcaktuar në nenin 59 (1) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në raportin vjetor për zbatimin e ndihmës IPA II, NIPAC do të përdorë modelin e dhënë në Shtojcën IIIA të kësaj marrëveshjeje financimi.

3. Për qëllim të kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në pikën (a) të nenit 59 (2) të Marrëveshjes Kuadër mbi raportin vjetor financiar apo deklaratat, NAO si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të përdorë modelin e parashikuar në Shtojcën IV të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Për qëllim të nenit 59 (4) të Marrëveshjes Kuadër, NIPAC (KKIPA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i paraqesë Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e ndihmës së IPA II të Programit të Veprimit, jo më vonë se katër muaj pas disbursimit (pagesës) të fundit për kontraktuesit e saj ose përfituesit e granteve.

5. Për qëllim të nenit 59 (6) të Marrëveshjes Kuadër NOA (ZKA) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të sigurojë deri më datë 15 janar të vitit financiar vijues, në format elektronik, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit, themeluar sipas nenit 10 (5). Kjo duhet të mbështetet nga një raport i nënshkruar i paaudituar përmbledhës financiar, në përputhje me pikën (c) të Shtojcën IV.

Neni 4
Vizibiliteti dhe Komunikimi

1. Siç parashikohet në dispozitat e nenit 24 (1), 76 (3) (k), dhe nenit 78 (8) (f) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II duhet të përgatisin një plan koherent të aktiviteteve të vizibilitetit dhe të komunikimit, të cilat do t'i

paraqiten Komisionit për një marrëveshje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete të vizibilitetit dhe komunikimit duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimeve dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5
Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara sipas kësaj marrëveshjeje financiare duhet të garantojnë që përfituesit e IPA II të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti kontraktues, do të garantojë që Komisioni, ose dikush apo personi i autorizuar nga Komisioni, dhe përfituesit e të tjerë të IPA II, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do ta përdorë një material të tillë vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6
Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj marrëveshjeje financiare:

a) borxhet dhe pagesat e shërbimit të borxhit (interesi);

b) dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;

c) Kostoja e deklaruar nga përfituesi dhe financuar nga një veprim apo program pune, që merr një grant nga Unioni;

d) humbjet e këmbimit të monedhës;

e) kreditë për palët e treta;

f) gjobat, sanksionet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor.

2. Blerja e tokës që nuk është e ndërtuar dhe e tokës me ndërtim në shumën deri në 10% të totalit të shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë, do të jetë e e pranueshme për financim sipas ndihmës për bashkëpunim ndërkufitar IPA II, nëse ajo është e justifikuar nga natyra e veprimit dhe të dhënat në Shtojcën I.

PJESA E DYTË
DISPOZITAT E ZBATUESHME TË MENAXHIMIT TË TËRTHORTË NGA PËRFITUESI IPA II

Neni 7
Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është të vendosë rregullat për zbatimin e Programit të Veprimit nën menaxhimin të tërthortë dhe në veçanti rregullat që lidhen me detyrat që i janë besuar zbatimit të buxhetit, siç përshkruhet në Shtojcën I dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni në kryerjen e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76 (3) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II, bashkërisht, duhet të përgatisin një marrëveshje dypalëshe dhe të sigurojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoritet Kontraktues do të bashkëpunojë me përfituesin e IPA II që është Autoritet Kontraktues, për të siguruar se detyrat në vijim janë plotësuar:

a) të kryejnë ndjekjen operative dhe menaxhimin e operacioneve, siç parashikohet në pikën (b) të nenit 76 (4) të Marrëveshjes Kuadër;

b.) të kryejnë verifikime në përputhje me nenin 76 (5) të Marrëveshjes Kuadër;

c) të mbrojnë interesin financiar të Unionit, siç parashikohet në nenin 51 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8
Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

1. Detyrat e përmendura në nenin 7 (3) duhet të kryhen nga përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratave të granteve, në veprimet e jashtme, në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara të Vizibilitetit dhe Komunikimit, të përmendura në nenin 4 (2).

2. Në përputhje me nenin 18 (2) të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni do të pajisë përfituesin e IPA-II që është Autoritet Kontraktues, me udhëzime të mëtejshme, për përshtatjen e procedurave dhe dokumenteve standard, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në veprimet e jashtme, në rastin specifik të bashkëpunimit ndërkufitar.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues do të kryejë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, të lidhë kontratat që pasojnë dhe të sigurojë që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmët e auditimit janë në gjuhën e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë plotësisht në vendosjen e komisioneve të vlerësimit, siç parashikohet në pikën (a) të nenit 76 (4) të Marrëveshjes përkatëse Kuadër.

5. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të informojë Komisionin, kur një kandidat, ofertues ose aplikant, është në një situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies së prokurimit dhe grantit, ose është konstatuar në shkelje të rëndë të detyrimeve të tij kontraktuale. Në raste të tilla, pa qenë në kundërshtim me fuqinë e Komisionit për të marrë masa kundër një subjekti të tillë në bazë të Rregullores Financiare të zbatueshme, dënimet financiare të përmendura në dispozitat për dënimet administrative dhe financiare të Kushteve të Përgjithshme të prokurimit dhe kontratave të granteve, të lidhura nga përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, mund të vendosen për kontraktuesit dhe përfituesit e granteve nga ky përfitues i IPA II, nëse kjo lejohet nga ligji i tij kombëtar.

Sanksionet e tilla financiare do të informohen pas një procedure oponence, duke siguruar të drejtën e mbrojtjes së kontraktuesit ose përfituesit të grantit. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të marrë parasysh informacionin që përmban Central Exclusion Database (Baza Qendrore e të Dhënave për Përjashtimin), gjatë dhënies së kontratave të prokurimit dhe granteve. Aksesi në informacione mund të sigurohet përmes pikës së ndërlidhjes (s) ose nëpërmjet konsultimeve me *Komisionin*[121] (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, nëpunësi i kontabilitetit të Komisionit, BRE2- 13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe nga email-i: BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu së bashku me adresën e Komisionit, të identifikuar në nenin 3 të Kushteve të Veçanta).

6. Përfituesi i IPA II, që është Autoritet Kontraktues, do të mbajë të gjitha dokumentet ndihmëse financiare dhe kontraktuale përkatëse, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare ose nga një datë më e hershme, në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime ose procedurat e dhënies së granteve të drejtpërdrejta kanë nisur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të Financimit:

a) Për procedurat e prokurimit në veçanti:

Njoftim i mëparshëm me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe të çdo korrigjimi;

a) Caktimi i panelit të zgjedhur;

b) Raporti i listës së të përzgjedhurve (përfshirë anekset) dhe aplikimet;

c) Dëshmi e publikimit të njoftimit të listës së përzgjedhurve

d) Letra e kandidatëve që nuk janë përzgjedhur;

e) Ftesë për tender ose ekuivalentin e saj;

f) Dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshmitë e publikimit;

g) Caktimi i komisionit të vlerësimit;

gj) Raporti për hapjen e tenderave, duke përfshirë anekset;

h) Raporti i vlerësimit / negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuara;2[122]

i) Letra e lajmërimit;

j) Shkresë për dorëzimin e kontratës;

[121] Përfituesi IPA II, do të lejohet që të ketë qasje të drejtpërdrejtë në Bazën Qendrore të të Dhënave të Përjashtimit (Central exclusion database) përmes një pike ndërlidhëse, kur përfituesi i vërteton shërbimit të komisionit përgjegjës se ajo zbaton masat e mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave, siç parashikohet në Rregulloren (KE) Nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 18 dhjetor 2000, mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (OJ L 8, 12.1.2001, fq. 1).

[122] Eliminimi i ofertave të pa-suksesshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

k) Letrat për kandidatët pasuksesshëm;

l) Çmimi /njoftimi i anulimit, duke përfshirë edhe dëshminë e publikimit;

m) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë, raportet e zbatimit, dhe korrespondenca përkatëse.

b) Për thirrjet për propozime dhe dhënien e drejtpërdrejtë të granteve në veçanti:

a) Emërimi i komisionit të vlerësimit;

b) Raporti i hapjes dhe raporti administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e marra;[3][123]

c) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, pas vlerësimit të koncept idesë;

d) Raporti i vlerësimit të hartimit të shënimit;

e) Raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë, ose raporti i negocimit me shtojcat përkatëse;

f) Kontrolli i pranueshmërisë dhe dokumentet e tjera shoqëruese;

g) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm me listën e aprovuar rezervë, pas vlerësimit të plotë të aplikimit;

h) Shkresa për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) Dhënia / njoftimi i anulimit, me dëshmi të publikimit;

j) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë dhe korrespondencat përkatëse.

Përveç kësaj, dokumentet financiare dhe kontraktuale përmendur në paragrafin 6 (a) dhe (b) të këtij neni, do të plotësohet nga të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese përkatëse siç kërkohen nga procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimin dhe shpenzimet operative, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontrolleve të vendeve, pranimi i furnizimeve dhe punëve, sigurimet dhe garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes. Të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale do të mbahen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 9

Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle paraprake (ex ante) për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat e mëposhtme të prokurimit ose dhënies së granteve:

a) për miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tij;

b) për miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;

c) për miratimin e përbërjes së komisioneve të vlerësimit;

d) për miratimin e raporteve të vlerësimit dhe vendimet e dhënies së kontratës[124];

e) për miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtesa e kontratës.

2. Në lidhje me kontrollin paraprak, komisioni duhet të vendosë:

a) të kryejë kontrolle paraprake për të gjitha dosjet, ose

b) të kryejë kontrolle paraprake në një përzgjedhje e këtyre dosjeve, ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet paraprake.

3. Nëse Komisioni vendos për të kryer kontrolle paraprake në përputhje me paragrafin 2, shkronjat (a) ose (b) të këtij neni, ai duhet të informojë përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues i dosjeve të përzgjedhura për kontrollet paraprake. Ky përfitues i IPA II do të japë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll paraprak së fundi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose programit të punës për publikim.

4 Komisioni mund të vendosë për të kryer kontrolle të mëpasshme (ex-post), duke përfshirë auditimet dhe kontrollet e çastit, në çdo kohë, për ndonjë kontratë ose grantet e dhëna nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, që rrjedh

[123] Eliminimi i aplikacioneve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit

[124]Për kontratat e shërbimit këto hapa që përfshijnë kontrollet paraprake, lidhen me miratimin e listës së përzgjedhur.

nga kjo marrëveshje financimi. Ky përfitues i IPA II do të të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin pasi të informohet se kjo dosje është përzgjedhur për kontroll të mëpasshëm (ex post). Komisioni mund të autorizojë një person ose njësi ekonomike për të kryer kontrolle ex post në emër të saj.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit, dhe kostoja e njohur

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operative e përfituesit të IPA II, që është Autoriteti Kontraktues për Programin e Veprimit, duhet të hapë të paktën një llogari bankare në Euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e Veprimit do të jetë shuma e bilanceve në të gjitha llogaritë bankare të Programit të Veprimit, të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat pjesëmarrëse që operojnë tek përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

2. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përgatisë dhe të dorëzojë në Komision planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit. Këto parashikime duhet të përditësohet për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 3 (2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet do të bazohen në një analizë të dokumentuar dhe të detajuar (duke përfshirë edhe kontraktimin e planifikuar dhe orarin e pagesave sipas kontratës për dymbëdhjetë muajt në vijim), të cilat do të jenë në dispozicion të Komisionit në bazë të kërkesës.

3. Plani fillestar i parashikimit të disbursimit duhet të përmbajë përmbledhjen e parashikimit vjetorë të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të Programit të Veprimit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhjen vjetore të parashikimeve të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit dhe parashikimet mujore disbursimit për katërmbëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të kontabilitetit në përputhje me pikën 2 (3) (b) të Shtojca A të Marrëveshjes Kuadër, i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat që menaxhohen nën Programin e Veprimit të përcaktuar në Shtojcën V.

5. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit e mbajtur nën seksionin 4 të këtij neni, duhet të jetë e bëra, e paguar dhe e pranuar dhe të korrespondojë me kostot aktuale të provuara nga dokumentet mbështetëse dhe të përdoret kur është e përshtatshme për të nisur para-financimin e paguar nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues sipas kontratave lokale.

6. Kostoja e njohur në sistemin e kontabilitetit do të shfrytëzohet nga Komisioni për njohjen e të përkohshme të kostos së saj, gjatë zbatimit të Programit të Veprimit (duke përfshirë autorizimin e para-financimit që i paguhet përfituesit të IPA II, që është Autoriteti Kontraktues), për procesin e miratimit për pagesat, për autorizimin përfundimtar të procedurës së llogarive në fund të Programit të Veprimit, për praktikat vjetore të ndërprera dhe çdo zbatim tjetër të menaxhimit dhe të shqyrtimeve të performancës.

7. Përfituesi i IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

a) Raporti Përmbledhës - siç është përcaktuar në nenin 3 (5);

b) Raportet vjetore siç janë përcaktuar në paragrafët (2) deri (4) të nenit 3;

c) Kërkesa për raportet e fondeve, siç përmenden në nenin 11.

Neni 11

Dispozita për pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

1. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të paraqesë parashikimin e tij fillestarë të disbursimit (pagesës) për Programin e Veprimit, të përgatitur në përputhje me nenin 10 (2), me kërkesën e parë për pagesë të para-financuar. Pagesa e parë e para-financimit do të bëhet për 100% të pagesës së parashikuar për vitin e parë të planit të parashikuar për disbursim.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të paraqesë kërkesa të vazhdueshme të pagesës së para-financimit kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin e

Veprimit bie nën pagesën e parashikuar për pesë muajt në vazhdim të Programit të Veprimit.

3. Çdo kërkesë për para-financim shtesë do të mbështetet nga raportet e mëposhtme, në përputhje me pikat (a), (b) dhe (d) të Shtojcës IV:

a) Një deklaratë përmbledhëse e të gjitha pagesave të bëra për Programin e Veprimit;

b) Balancat bankare për Programin e Veprimit në datën e caktuar të kërkesës;

c) Një parashikim i pagesave për Programin e Veprimit për katërmbëdhjetë muajt në vijim në datën e përcaktuar të kërkesës.

4. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë për çdo para-financim pasues shumën e totalit të disbursimeve të parashikimit për katërmbëdhjetë muaj, pas datës së përcaktuar të kërkesës, pa balancat e referuara në nenin 3 (b) të këtij neni në datën e përcaktuar të kërkesës për fondet e rritura nga ndonjë shumë e financuar nga përfituesi IPA II, sipas paragrafit 5 të këtij neni, dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni gëzon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë pasuese të para-financimit, nëse tepricat totale bankare të mbajtura nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues në bazë të këtij programi dhe në të gjitha programet e tjera të IPA I apo të IPA II, të cilat menaxhohen nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, tejkalon parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Në rastet kur pagesa është reduktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues duhet ta financojë programin nga burimet e veta, deri në shumën e reduktimit. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti kontraktues më pas mund të kërkojë rimbursimin e këtij financimi, si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë për të rimarrë balancat e tepërta bankare, të cilat kanë mbetur të papërdorura për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para se të ushtrojë këtë të drejtë, Komisioni e fton përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, për të dhënë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën për to në vazhdim gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Nuk duhet të jetë shkak interesi i gjeneruar nga para-financimi bilanceve bankare të Programit të Veprimit.

8. Sipas nenit 33 (4) të Marrëveshjes Kuadër, kur ndërprerja e afatit për kërkesën për pagesë tejkalon dy muaj, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë një vendim nga Komisioni nëse ndërprerja e afatit duhet vazhdojë.

9. Deklarata financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37 (2) të Marrëveshjes Kuadër do të dorëzohet nga NOA (ZKA) jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operativ.

Neni 12
Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi sipas neneve 16 dhe 17 përkatësisht dhe krahas nenit 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, në qoftë se:

a) Komisioni ka vendosur, ose paraqet shqetësime serioze, pasi përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, ka bërë gabime të konsiderueshme, ka parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve në fjalë, në zbatimin e Programit të Veprimit, ose ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje financiare;

b) Komisioni ka vendosur, ose paraqet shqetësime serioze, nëse përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka kryer gabime sistemike ose të përsëritura, ose ka parregullsi, mashtrime, apo shkelje të detyrimeve, në këtë ose në të tjera marrëveshje financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrime, ose shkelje të detyrimeve të kenë një ndikim material në zbatimin e kësaj marrëveshjeje financiare apo vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA II, ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve bazë;

Neni 13
Mbulimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rimarrë fondet nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet në rregulloren financiare, veçanërisht në rast se:

a) Komisioni vendos se objektivat e Programit të Veprimit të përcaktuara në Shtojcën I nuk janë arritur;

b) shpenzimet janë të papërshtatshme;

c) shpenzimet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve apo shkeljeve të detyrimeve në zbatimin e Programit të Veprimit, në veçanti në procedurën e dhënies së prokurimit dhe granteve.

2. Në përputhje me ligjin kombëtar, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të rimarrë kontributin e Unionit që i paguhet përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues nga marrësit të cilët janë në një prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1 pika b) ose c) të këtij neni ose të referuara në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti se përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk ka sukses në kthimin e të gjithë ose një pjese të fondeve, nuk do ta pengojë Komisionin për rikuperimin e fondeve nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin e IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, në rimëkëmbjen e saj, kur përfituesi vendoset në territorin e tij. Marrëveshja për rikuperimin do të parashikohet në një marrëveshje dypalëshe, e cila do të lidhet në përputhje me nenin 69 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse.

4. Shumat e paguara padrejtësisht apo të mbuluara nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, shumat e garancive financiare, performancës dhe para-financimit, të paraqitura në bazë të prokurimit dhe dhënies së procedurave të granteve, shumat nga gjobat e vendosura nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve, paguar për përfituesit e IPA II që është Autoriteti Kontraktues ose do të ri-përdoren për Programin e Veprimit, ose do t'i kthehen Komisionit.

PJESA E TRETË
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Konsultime ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesit e IPA II dhe Komisioni do të konsultohen me njëri tjetrin para se të krijojnë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi në përputhje me nenin 18 të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

2. Kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai duhet të krijojë të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA II për të korrigjuar situatën dhe të ndërmarrë hapat që janë të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, në pezullimin ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Komisioni do të informojë rregullisht përfituesit e IPA II për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në Shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në Pjesën e Dytë të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

Neni 15
Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo amendament i kësaj marrëveshjeje financiare,duhet të bëhet me shkrim.

2. Nëse përfituesit e IPA II kërkojnë një amendament, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi që kërkohet të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të amendojë *Dokumentet Model* në Shtojcën III, IIIA, IV dhe V, pa nevojën e një amendamenti të kësaj marrëveshjeje financiare. Përfituesit e IPA II do të informohen me shkrim për çdo amendament të tillë dhe për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 16
Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Nëse ndonjë përfitues IPA II shkel një detyrim sipas kësaj marrëveshjeje financiare.

b) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në bazë të procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18 (2) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, pa cenuar dispozitat në nenin 8 (2).

c) Nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk i plotëson kërkesat e për zbatimin e detyrave të buxhetit të besuar.

d) Nëse përfituesit e IPA II nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në nenin 2 (1) dhe kur është e mundur edhe menaxhimin të tërthortë sipas nenit 7 (3).

e) Nëse ndonjë përfitues i IPA II vendos të pezullojë ose të ndërpresë procesin e pranimit të anëtarësimit në BE.

f) Nëse ndonjë përfitues i IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetin ligjor, si dhe në raste të rënda të korrupsionit.

g) Në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë Madhore" do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme, ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon secilën prej tyre në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre, gjë që nuk i atribuohet gabimit ose pakujdesisë nga ana e tyre (ose pjesës së kontraktuesve të tyre, agjentëve ose të punësuarve) dhe vërteton mos-rregullimin e situatës, pavarësisht se janë bërë përpjekjet e duhura. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat e tyre të mundshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare, nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk duhet të konsiderohet si shkelëse e obligimeve të saj nëse ajo është penguar nga përmbushja e tyre për shkak të një force madhore, për cilën pala tjetër është informuar siç duhet. Një palë që përballet me një forcë madhore duhet ta informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, si edhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

Asnjëra prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, nëse është penguar nga përmbushja e tyre nga forca madhore, me kusht që ajo palë të marrë masa për të minimizuar dëmtimet e mundshme.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë masat e duhura parandaluese para se të bëhet pezullimi.

4. Kur pezullimi është njoftuar, duhet të tregohen pasojat e prokurimit dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe marrëveshjet e delegacionit për këto kontrata si dhe marrëveshjet që duhen nënshkruar për këto kontrata.

5. Pezullimi i kësaj marrëveshjeje të financimit nuk e cenon ndërprerjen e kësaj marrëveshjeje financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 17.

6. Palët do të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes Financiare sapo kushtet ta lejojnë, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo nuk cenon asnjë amendim të kësaj marrëveshjeje financiare që mund të jenë të nevojshme për të përshtatur Programin e Veprimit për kushtet e reja zbatuese, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së zbatimit, ose përfundimin e kësaj marrëveshjeje financiare në përputhje me nenin 17.

Neni 17
Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare

1. Nëse çështjet të cilat çuan në pezullimin e Marrëveshjes së Financimit nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditëve, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen Financiare në njoftimin prej 30 ditësh.

2. Kjo Marrëveshje Financimi do të ndërpritet automatikisht, në qoftë se brenda një periudhe prej dy vjet që prej nënshkrimit të saj:

a) nuk është bërë asnjë pagesë;

b) nuk është nënshkruar asnjë kontratë zbatimi apo marrëveshje delegacioni.

3. Kur ndërprerja është njoftuar, duhet të tregohen pasoja e prokurimeve dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe kontratat ose grantet e tilla që duhen nënshkruar.

4. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financiare nuk do të përjashtojë mundësinë e Komisionit që të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenet 43 dhe 44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 18
Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, të parashikuar në nenin 14 mund, të zgjidhet nga arbitrazhi, me kërkesën e njërës prej palëve.

2. Secila palë do të caktojë një gjyqtar brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar të dytë. Të dy gjyqtarët nga ana e tyre caktojnë një gjyqtar të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë.

3. Përveç kur gjyqtarët vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit, rregullat opsionale për Arbitrazhin që përfshijnë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet.

4. Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve.

MODEL
I RAPORTIT VJETOR TË BNK-SË MBI ZBATIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II NDËRMJET PËRFITUESVE TË IPA II
(Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër)

1. Identifikimi

PROGRAMI NDËRKUFITAR	Titulli i Programit: Programi ndërkufitar <vendi A> – < vendi B> <viti>/<viti>
	Përfitimi për vitin 20xx:
	Përfitimi për vitin 20xx:
	Përfitimi për vitin 20xx:
RAPORTI VJETOR MBI ZBATIMIN	Viti i Raportimit (nga 1 janari 20xx deri 31 dhjetor 20xx)
	Përgatitur nga: – <struktura operative, vendi X> – < struktura operative, vendi Y>
	Data e shqyrtimit të raportit vjetor nga Komiteti i Përbashkët Monitorues

Baza ligjore: Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër të IPA II

2. Përmbledhje mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar

2.1 Arritjet dhe analiza e progresit

Përmbledhje mbi zbatimin e programit gjatë periudhës së mbuluar (aktivitetet e kryera, thirrjet e bëra, forumet për të kërkuar partnerë, takimet mbi KGM (Komunikimin me Gazetarët dhe Median) etj).

Nëse duhet, të përfshihet edhe informacion mbi përgatitjen apo rishikimin e programit 2014-2020

2.2 Progresi në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndër-kufitar (Neni 80.1a IPA II FWA)

Progresi i bërë në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike për çdo prioritet tematik (si dhe për prioritetin e Asistencës Teknike), duke përfshirë edhe elementet cilësore dhe sasiorë që tregojnë përparim në lidhje me objektivat.

2.2.1 Analiza sasiore

*Informacion mbi progresin e bërë në zbatimin e programit ndërkufitar, me përcaktimet sasiore kur është e mundur, duke përdorur objektivat dhe treguesit që përfshihen në program (**Plotësoni Shtojcën 1**)*

Analizë e arritjeve sipas matjeve nga treguesit fizikë dhe financiarë. Treguesit do të ndahen sipas gjinisë, kur është e mundur.

Nëse shifrat (të dhënat) nuk janë vënë akoma në dispozicion, duhet të jepet informacion se kur do të vihen në dispozicion dhe kur do të përfshihen në raportin vjetor mbi zbatimin. Gjithashtu, informacioni mund të paraqitet grafikisht.

2.2.2. Analiza cilësore

Analiza cilësore e progresit të bërë në zbatimin e programit ndërkufitar, duke përfshirë një analizë të ndikimit të programit në zonën e programit

2.3Informacione të hollësishme për ekzekutimin financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar (Neni 801 (d) IPAII FWA)[125]

*Informacion mbi kontraktimin dhe ndarja e përfitimeve vjetore **(*** Plotësoni Shtojcën 2**)*

Analiza e faktorëve të mëposhtëm:

Statusi financiar

Informacion mbi bashkë-financimet

Faktorët që kanë penguar dhe /ose vonuar zbatimin financiar

Faktorët që kanë pasur ndikim pozitiv në zbatimin financiar

2.4.Informacion mbi hapat e ndërmarra nga strukturat operuese dhe / ose Komiteti i Përbashkët Monitorues për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit:

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

Masat monitoruese të ndërmarra nga strukturat operuese ose Komiteti i Përbashkët Monitorues përfshijnë marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave.

Në programet e zbatuara me masa të tërthorta të vlerësimit të menaxhimit të ndërmarra nga struktura operuese aty ku ndodhet Autoriteti kontraktues (neni 57 i FWA-së).

2.4.2. Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

Përmbledhje e çdo problemi të rëndësishëm të hasur në zbatimin e programit dhe çdo veprimi korrigjues të ndërmarrë.

Rekomandime për veprime (të mëtejshme) korrigjuese.

2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti

-Masat e marra për të siguruar dukshmërinë dhe reklamimin e programit (planin e vizibilitetit), duke përfshirë shembuj të praktikave më të mira dhe duke theksuar ngjarjet e rëndësishme.

2.6Shfrytëzimi i asistencës teknike

-Shpjegim i detajuar i shfrytëzimit të asistencës teknike

-Përmbledhje e çdo problemi të rëndësishëm të hasur në zbatimin e buxhetit TA

2.7 Ndryshimet në kuadër të zbatimit të programit ndërkufitar (nëse ka)

Përshkrimi i çdo elementi i cili edhe pse nuk rrjedh drejtpërdrejt nga ndihma, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e programit (p.sh. ndryshimet ligjore, ndryshimet socio-ekonomike përkatëse etj.)

*** - përfshini një Aneks 2 - listën e projekteve dhe një përmbledhje të shkurtër

[125] Ky paragraf do të përfshihet në raporte vetëm në rastin e menaxhimit të tërthortë.

Periudha e mbuluar nga raporti:
01/01/20XX-31/12/20XX
Raport i lëshuar më XX/XX/20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e ndihmës IPA II nën menaxhim të tërthortë nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, i paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referencë e objektivave të Dokumenteve Strategjikë të Vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve

2. Përfshirja në programim

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-s dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.

6. Përfshirja në veprimet shumë-vendëshe dhe çdo çështje që lidhet me to.

7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.

8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

9. Koordinimi i donatorëve

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjithashtu:

1. Zbatimin e gjithanshëm të asistencës së IPA-s nën menaxhim të tërthortë (maksimumi një faqe).

2. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-s dhe masat përkatëse të marra/planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).

3. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).

4. Auditimet - gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra

II. Informacion sipas Sektorëve

Titulli i sektorit [126]: [*Transporti*]

Pjesa përshkruese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim

2. Përmbledhje e rezultateve gjatë lëvizjes drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritura sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të Sektorit).

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe /ose donatorë / IFI-të brenda sektorit

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operative dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse ka: [*Ministria e Transportit]*

6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor

7. Arritjet kryesore në atë sektor

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat të marr /planifikuara në vijim.

9. Rekomandime për veprime të mëtejshme

10. Aktivitetit monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet - gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndërkufitar[127]

1. Përfshirja në programim, sipas rastit

2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifike sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat)

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.

4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet e grumbullimit të të dhënave dhe kur është e zbatueshme, edhe aktivitetet e vlerësimit.

5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

6. Koordinimi me vendin partner.

[126] Sipas sektorëve në Dokumentet tregues të Strategjisë.

[127] Për Bashkëpunimin Ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

Nën menaxhim të tërthortë, duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operative ekzistuese dhe ndryshimet që lidhen me të, nëse ka.
2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra /të planifikuara.
3. Rekomandime për veprime të mëtejshme
4. Auditimet e kryera - gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

II a. Treguesit e performancës në sektorin [*p.sh. transporti*] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[3] për program

Marrëveshja e Financimit /Programi referues[4]	**Treguesi për sektor [*Transporti*]**	**Burimi**	**Linja bazë**	**Objektivi (2017)**	**Objektivi (2020)**	**Vlera (2014[5])**
2014 Programi i vendit	*Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit*					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	*Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti*					

[3] Ky duhet të jetë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit
[4] Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumëvjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s
[5] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

Marrëveshja e Financimit /Programi referues	**Veprimi**	**Gjendja / Progresi për një veprim të caktuar (p.sh. po përgatiten Termat e Referencës, tenderi është shpallur, kontraktuar, po zbatohet, është përfunduar)**	**Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre**	**Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra / të planifikuara për kapërcimin e tyre**	**Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen**	**Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese**
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*p.sh. Kontratë shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punëve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*p.sh. Kontrata e shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe u nevojit të ribëhej*	*p.sh. ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim të tërthortë duhet të sigurohen dhe Shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1
Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).
Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me FWA-në (maksimumi një faqe)

Shtojca 2
Historitë e suksesshme (Kujdes! Ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian)

Shtojca 3
Plani vjetor i prokurimit
Si për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe atë të tërthortë, duhet të paraqitet shtojca e mëposhtme:

Shtojca 4
Udhërrëfyes i Qasjes Sektoriale - arritjeve (duke theksuar nëse janë përmbushur apo jo objektivat e planifikuara)

DEKRET
Nr. 11897, datë 5.1.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 159/2020, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Sekretariati për Çështjet Evropiane, dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedoni e Veriut–Shqipëri, 2014–2020, alokimet për vitin 2019".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 1122, datë 30.12.2020

PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE, KUSHTEVE, PROCEDURAVE, FONDEVE TË NEVOJSHME BUXHETORE PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN, MENAXHIMIN DHE PËRDITËSIMIN E KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 88, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar; të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", dhe të nenit 26, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është miratimi i kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administrator", struktura pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), e ngarkuar për administrimin, menaxhimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

b) "Autoritet publik" janë:

i. organet e qeverisjes qendrore dhe vendore apo organet e tjera të administratës publike, përfshirë organizmat këshillues publikë, në nivel kombëtar, rajonal apo vendor;

ii. çdo person, fizik apo juridik, që ushtron funksione administrative publike, përfshirë edhe detyra, veprimtari ose shërbime specifike që kanë të bëjnë me mjedisin;

iii. çdo person juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike apo që siguron shërbime

publike, që kanë të bëjnë me aktivitete ose shërbime, në lidhje me ujërat dhe janë nën kontrollin e një organizmi apo personi që përfshihet në grupimet e përcaktuara në nënndarjet "i" dhe "ii", të kësaj shkronje.

c) "Baza e të dhënave shtetërore", i njëjti kuptim, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

ç) "Dataset", grumbull të dhënash me karakteristika të lidhura logjikisht, duke përfshirë të dhënat e përpunuara.

d) "Dokument", regjistrim i çdo lloji, forme dhe teknike (shkrim, të shtypura, imazhe, tinguj, film ose video, të dhënat elektronike etj., strukturën dhe përmbajtjen e të cilit e bën një entitet i veçantë.

dh) "Dokumentacioni teknik", studim, projekt, plan, hartë, përshkrimi teknik dhe specifikime, udhëzime dhe dokument lidhur me objekte, pajisje, sistemet teknike dhe procedurat.

e) "Dhënësi i informacionit", i njëjti kuptim, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

ë) "Gjenerues privat i të dhënave", subjekte përdoruese të burimeve ujore, të cilët kanë në administrimin e tyre pajisje të matjeve hidrometeorologjike, të dhëna historike apo në kohë reale, të cilat duhet të përfshihen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

f) "Informacion", të dhëna të përpunuara, fotografi, vizatime, film, raporte, akte, tabela, grafikë, skica apo të tjera të përafërta, pavarësisht nëse është i ruajtur në një dokument apo jo, dhe, pavarësisht nga burimi, data e origjinës, vendi i ruajtjes, mënyra e zbulimit me urdhrin e të cilit, në emrin e të cilit, për llogari të të cilit informacioni është i ruajtur.

g) "Informacioni i klasifikuar", të dhëna, që nuk mund të shpërndahen për publikun e gjerë për shkak të kërkesave të konfidencialitetit, të sigurisë kombëtare apo çështje të tjera që kërkohen nga ligji.

gj) "Kapaciteti maksimal gravitacional i derdhjes", sasia maksimale e ujit që derdhet për shkak të gravitacionit dhe jo të pompimit apo të ndonjë forme tjetër.

h) "Kadastra", Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore.

i) "Nyjat hidrografike", nyjë, kryqëzime apo ndarje të rrjedhave ujore, brenda një rrjeti hidrografik.

j) "Pellgu zonal i ujërave nëntokësore/sipërfaqësore", pellgu, i cili përfshin pellgje të tjera më të vogla.

k) "Pellgu natyror i supozuar", pellgu natyror, i cili nuk është saktësisht i gjeometrizuar, por i përafrohet shumë pellgut të vërtetë natyror.

l) "Përrua", ujërat sipërfaqësore natyrore në formën e një rrjedhe ujore natyrore.

ll) "Përrua sekondar", përrua që derdhet në një përrua tjetër, ku ky i fundit derdhet direkt në lumë apo në ndonjë trup tjetër ujor, liqen, det.

m) "Rrjedhë e sipërme lumore", rrjedha e lumit mbi 800 (tetëqind) m nga kuota absolute/niveli i detit.

n) "Rrjedhë e mesme lumore", rrjedha e lumit nga 200 (dyqind)–800 (tetëqind) m nga kuota absolute/niveli i detit.

nj) "Rrjedhë e poshtme lumore", rrjedha e lumit më e vogël se 200 m nga kuota absolute/niveli i detit.

o) "Rrjedhë sekondare", të gjitha rrjedhat që i shmangen drejtimit kryesor të rrjedhës në aksin e lumit ose kanalit.

p) "Sifon", strukturë tubacioni që shërben për të përcjellë lëngje nga një nivel më i lartë në një nivel më të ulët, duke shfrytëzuar presionin diferencial që të detyrojë një kolonë lëngu të një niveli më të lartë para se të derdhet në dalje.

q) "Subjekt i interesuar", i njëjti kuptim, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

r) "Shtresa gjeohapësinore", të dhënat gjeohapësinore të organizuara, sipas tipologjive të caktuara.

rr) "Të dhëna", i njëjti kuptim, sipas përcaktimit të nenit 7, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

s) "Të dhëna gjeohapësinore", të dhëna me një referencë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në një vend të veçantë ose zonë gjeografike.

sh) "Të dhëna gjeohapësinore të përcaktuara" janë një koleksion i identifikueshëm i të dhënave gjeohapësinore.

II. KËRKESAT DHE KUSHTET PËR KRIJIMIN DHE MBAJTJEN E KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

1. Kadastra krijohet e mbahet mbi bazën e të dhënave elektronike për burimet ujore, nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik. Baza e të dhënave, e cila është përcaktuar në pikën 2, të nenit 88, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, strukturohet sipas strukturës së përcaktuar në pikën 2, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Baza e të dhënave shtetërore për burimet ujore ndahet, për:

a) ujërat sipërfaqësore;

b) ujërat nëntokësore;

c) ujërat detare;

ç) strukturat e ujit;

d) përdorimi i ujit;

dh) mbrojtja e ujit;

e) zonat e mbrojtura ujore;

ë) monitorimi i ujit;

f) monitorimi meteorologjik;

g) modele të tjera.

3. Kërkesat për modulin për trupat ujorë sipërfaqësorë, përfshirë ujërat detare, janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Kërkesat për modulin për ujërat nëntokësore janë sipas shtojcës 2, që bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Kërkesat për modulin për strukturat e ujit janë sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Kërkesat për modulin për përdorimin e ujit janë sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Kërkesat për modulin për mbrojtjen e ujit janë sipas shtojcës 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Kërkesat për modulin për zonat e mbrojtura ujore dhe habitatet ujore janë sipas shtojcës 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Kërkesat për modulin për monitorimin e ujit, janë sipas shtojcës 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Kërkesat për modulin për monitorimin meteorologjik janë sipas shtojcës 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Përcaktimet për hedhjen e të dhënave nga burimi i disponimit të tyre në Kadastër janë sipas shtojcës 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Kadastra do të përmbajë të dhëna parësore/dytësore, sipas përcaktimit në nenin 7, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

13. Në shtojcën nr. 9 të këtij vendimi janë përcaktuar institucionet që detyrohen të popullojnë Kadastrën me të dhëna, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të dhëna parësore/dytësore, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

III. PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN DHE PËR PËRDITËSIMIN E KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

1. Kadastra menaxhohet dhe përditësohet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik.

2. Të gjitha të dhënat gjeohapësinore që përmban Kadastra do të vihen në dispozicion të ASIG-ut, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera, publike ose jopublike, që merren me menaxhimin e burimeve ujore, detyrohen të caktojnë një përfaqësues të përhershëm që mban marrëdhënie me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, duke raportuar në mënyrë periodike çdo 3 (tre) muaj mbi ecurinë e përditësimit me të dhënat në Kadastër. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përgatit raportin në nivel kombëtar, të cilin ia paraqet Këshillit Kombëtar të Ujit me sugjerimet përkatëse.

4. Administrimi i Kadastrës kryhet nga Administratori, i cili kryen këto funksione:

a) është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e Kadastrës;

b) mbikëqyr e monitoron veprimet që kryhen në Kadastër në përgjithësi;

c) është përgjegjës për strukturën e bazës së të dhënave dhe administrimin e saj;

ç) ka të drejtë të ndryshojë apo të anulojë nivelin e aksesit të një përdoruesi pa njoftim, kur vëren se ai nuk zbaton rregullat e përdorimit ose dyshohet se po i shkakton dëm sistemit në përgjithësi;

d) harton udhëzime dhe manuale për përdoruesit e sistemit;

dh) bën propozime për avancimin e programeve të përdorura dhe avancimin e sistemit në përgjithësi, në konsultim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;

e) krijon dhe administron nivelet e aksesit në Kadastër;

ë) krijon përdoruesit e të gjitha niveleve me privilegjet përkatëse për të punuar në sistem;

f) shpërndan privilegjet për përdoruesit dhe u heq të drejtën për të punuar në sistem, në rast të largimit të tyre nga funksioni;

g) krijon virtualisht institucionet në sistem, vendos varësitë, ndryshon varësitë e institucionit, fshin institucionin në rastin e mbylljes së tij dhe kalon të dhënat në arkivin historik;

gj) monitoron dhe auditon mbledhjen, sistemimin, organizimin, koordinimin e të dhënave gjeohapësinore, grafike, elektronike, letër dhe të tjera lidhur me sektorin e ujërave, në një trajtë uniforme, efikase dhe të përgjegjshme;

h) arkivon në mënyrë të sigurt dhe me metoda alternative të dhënat, si dhe ruan periodikisht kopje të të dhënave në mjedis rezervë, të shkëputur e të pavarur nga sistemi kryesor; përmbush detyrimet për shkëmbimin dhe hyrjen në informacion;

j) krijon mundësinë e gjenerimit të raporteve nga sistemi në institucionet e administratës publike, sipas nevojave të tyre.

5. Dhënia e informacionit/dhënësit e informacionit për Kadastrën u nënshtrohen këtyre përcaktimeve:

a) të gjitha institucionet shtetërore, autoritetet dhe entet publike, subjektet fizike dhe juridike, vendës e të huaj, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe aktivitetit që ato zhvillojnë në fushën e ujërave, detyrohen të regjistrohen si të tillë në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe të popullojnë e përditësojnë Kadastrën me të dhënat që ata disponojnë në këtë fushë. Të dhënat hidhen në mënyrë periodike, në standardin e kërkuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim;

b) të gjithë përdoruesit e burimeve ujore, subjekte private apo subjekte juridike me kapital shtetëror, të cilët, me financimin dhe infrastrukturën e tyre, disponojnë e përpunojnë të dhëna që janë pjesë e atributeve të Kadastrës, janë të detyruar t'i hedhin këto të dhëna në Kadastër. Ndërveprimi dhe procesi i ndërveprimit ose i shkëmbimit të të dhënave ndërmjet bazave të të dhënave realizohet përmes platformës qeveritare të ndërveprimit;

c) të gjitha hidroelektrocentralet (HEC) e ndërtuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi apo të planifikuar për t'u ndërtuar, duhet që:

i. në secilën nga veprat e marrjes, prurja llogaritëse e të cilave është më e madhe se 150 l/sek, të instalojnë një stacion hidrologjik, automatik, që mat prurjet e nivelet ditore me një frekuencë 2 (dy) herë në ditë;

ii. pranë godinës së centralit, të instalojnë një stacion meteorologjik, automatik, i cili mat të paktën temperaturën, reshjet dhe lagështinë, me frekuencë ditore.

Brenda datës 30.6.2021, subjekti duhet të njoftojë AMBU-në për të verifikuar instalimin e këtyre stacioneve dhe funksionalitetin e tyre në kuptim të gjenerimit e transmetimit të të dhënave, në përputhje me përcaktimet e neneve 53 e 72, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar.

Të dhënat e gjeneruara, sipas nënndarjes "i", të kësaj shkronje, dërgohen në kohë reale në IGJEUM dhe AMBU. Në pamundësi të kësaj mënyre, të dhënat mujore të digjitalizuara dërgohen çdo datë 1 të muajit pasardhës, në formë elektronike, pranë IGJEUM-it dhe AMBU-së;

ç) në rastet kur një subjekt i interesuar ndërron statusin e tij, ai është i detyruar të bëjë çregjistrimin e tij me shkrim pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;

d) lista e dhënësve të informacionit në Kadastër përditësohet në mënyrë ë vazhdueshme nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

dh) detyrimet e dhënësit të informacionit të Kadastrës konsistojnë, në:

i. saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave e informacioneve në fushën e menaxhimit të ujit, me anë të kontrollit të afateve kohore, si dhe për të konfirmuar cilësinë e tyre;

ii. hartimin e zbatimin e procedurave për menaxhimin e të dhënave/informacionit (përgatitjen, inputet, përditësimin, përpunimin, prezantimin, disponueshmërinë);

iii. mundësimin e të dhënave të përputhshmërisë dhe grumbullimin e të dhënave

gjeohapësinore, grafike, elektronike, letër e të tjera dhe shërbimet e informacionit;

iv. detyrimin për hyrjen dhe shkëmbimin e informacionit;

v. respektimin e të gjitha standardeve në fuqi të legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinore;

e) në rastet kur dhënësi i informacionit nuk realizon në kohë kompletimin ose pengon futjen e të dhënave në Kadastër me të dhënat e përshkruara më lart apo të dhëna të tjera lidhur direkt/indirekt me ujin, ai mban përgjegjësi administrative, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Në këto raste, mbi bazën e njoftimit zyrtar të dërguar nga titullari i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, institucioni përkatës nis procesin, ku shqyrtohet përgjegjësia administrative e personit përgjegjës;

ë) mosrespektimi i detyrimeve dhe i afateve të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të kësaj pike, bën pjesë në mospërmbushjen e kushteve të lejes për përdorimin e burimit ujor dhe shoqërohet me masat administrative që përcakton ligji nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar;

f) të drejtën e përdorimit të të dhënave dhe informacioneve lidhur me aktivitetet që nuk kanë përfunduar e kanë:

i. personat përgjegjës të përfshirë në aktivitete të tilla;

ii. personat që mbikëqyrin personin tjetër të autorizuar;

g) nëse të dhënat që disponohen nuk plotësojnë kërkesat për nga përmbajtja dhe standardi, nga institucionet përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, bëhet vlerësimi i nevojave teknike dhe financiare për të plotësuar këto kërkesa, në përputhje me Kadastrën. Këto kërkesa paraqiten si pjesë e kërkesave buxhetore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe një kopje e relacionit përkatës i dërgohet zyrtarisht edhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;

gj) AMBU-ja përgatit programin vjetor të monitorimit, ku adreson të gjitha nevojat e paraqitura nga institucionet monitoruese dhe ato që evidentohen nga raporti vjetor i përditësimit të Kadastrës.

6. Niveli i aksesimit për institucionet, entet publike e private dhe subjektet përdoruese të burimeve ujore, të cilat popullojnë me të dhëna Kadastrën, u nënshtrohet këtyre përcaktimeve:

a) hyrja në të dhëna dhe informacioni për menaxhimin e burimeve ujore është:

i. hyrje e drejtpërdrejtë në burim;

ii. kopjim i të dhënave;

iii. marrja e një informacioni të përpunuar;

b) të dhënat dhe informacionet e hedhura të jenë në formë elektronike;

c) të drejtën për hedhjen e të dhënave dhe informacioneve në Kadastër e kanë punonjësit e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe autoritetet e tjera publike, në përputhje me nivelin e lejuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

ç) dhënësi i informacionit cakton personin përgjegjës, që do të ketë të drejtën e detyrimin e hedhjes së të dhënave në Kadastër. Ky person pajiset me të drejtën e përdoruesit nga administratori i Kadastrës. Autentifikimi në Kadastër do të realizohet ndërmjet integrimit me platformën *Single Sign On* të AKSHI-t;

d) Institucioni që posedon informacionin përkatës, duhet të vërë në dispozicion këtë informacion, në kohën e duhur, në çdo rast të kërkuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

7. Shkëmbimi i informacionit/ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave realizohet sipas këtyre përcaktimeve:

a) kadastra përfshihet në GIS-in kombëtar dhe publikohet në Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga ASIG-u, sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) informacioni nga Kadastra shkëmbehet dhe përdoret pa pagesë ndërmjet institucioneve shtetërore publike;

c) për rastet e paparashikuara në këtë vendim, informacioni nga Kadastra shkëmbehet dhe përdoret ndërmjet institucionit shtetëror dhe enteve ose subjekteve joshtetërore, në përputhje me marrëveshjet e ndërsjella;

ç) informacioni në dispozicion të personave fizikë dhe juridikë, vendës apo të huaj, është i

hapur, i dukshëm, i papërpunueshëm dhe i pashkarkueshëm;

d) dhënësit e informacionit mund të japin të dhëna dhe informacione vetëm brenda kufijve të kompetencave të tyre.

8. Informacioni i klasifikuar apo informacionet, të cilat nuk janë në dispozicion për subjekte të tjera, janë:

a) informacioni i cilësuar si i klasifikuar, mbështetur në legjislacionin në fuqi;

b) informacioni i dhënë nga kompanitë dhe individët, të cilët kanë kërkuar fshehtësinë apo kufizim në përdorim të njëjtë, për arsye të sekretit profesional dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Përditësimi i Kadastrës bëhet, si më poshtë vijon:

a) autoritetet përgjegjëse, për çdo modul të bazës së të dhënave, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, do të bëjnë rregullisht përditësimet e të dhënave çdo muaj;

b) të gjitha përditësimet, mbas hedhjes për herë të parë të të dhënave, duhet të kryhen të paktën katër muaj pas aplikimit të ndryshimit të grupeve të të dhënave burimore, pavarësisht se për përditësimet e të dhënave të menaxhimit të burimeve ujore specifike janë caktuar periudha të ndryshme në standardet përkatëse të temës.

IV. FONDET BUXHETORE DHE DISPOZITAT E FUNDIT

1. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit elektronik mbulohen nga fondet e miratuara në buxhetin për institucionin e ngarkuar me përgjegjësi për administrimin e këtij sistemi (AKSHI).

2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, institucionet publike që përcaktohen në këtë vendim dhe në shtojcat e tij, subjektet private dhe subjektet juridike me kapital shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
KËRKESAT PËR MODULIN PËR TRUPAT UJORË SIPËRFAQËSORË DHE UJËRAT DETARE

1. Moduli për trupat ujorë sipërfaqësorë dhe detarë përbëhet nga shtresa gjeohapësinore të lidhura me një tabelë përkatëse të atributeve. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unik, kodet kombëtare dhe të BE-së, emrat dhe përshkrimin e saktë të trupave ujorë sipërfaqësorë.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre specifike për ujërat sipërfaqësore janë të dhënat, si më poshtë:

a) baseni lumor;
b) basenet ujore;
c) nënbasenet;
d) nënpellgjet;
e) nyjat hidrografike;
f) liqenet dhe segmentet liqenore;
g) lumi, zona të lumit apo segmente të kanalit;
h) ujëmbledhësit.

3. Baseni lumor, nënpellgjet, ujëmbledhësit dhe basenet ujore dhe nënbasenet përshkruhen sipas tipit.

4. Baseni lumor, nënpellgjet, ujëmbledhësit dhe basenet ujore janë të dhëna të cilat përshkruhen sipas:

a) llojit;
b) pellgut natyror;
c) pellgut natyror të vërtetë/të supozuar;
d) sipërfaqes së pellgut;
e) sipërfaqes së pellgut të supozuar;
f) pellgut të njëtrajtshëm ose të papërcaktuar/supozuar të ujërave nëntokësore;
g) pellgut të njëtrajtshëm ose të papërcaktuar/supozuar të ujërave sipërfaqësore;
h) pellgut zonal të ujërave nëntokësore;
i) pellgut zonal të ujërave nëntokësore të papërcaktuar/supozuar;
j) origjinës;
k) rendit.

5. Liqeni dhe segmentet liqenore përshkruhen nga:

a) volumi ujëmbledhës;
b) vetëm gjatë dhe/ose menjëherë pas rritjes së konsiderueshme të volumit ujëmbledhës;
c) gjatë dhe menjëherë pas mbajtjes së volumit ujëmbledhës për një pjesë të vitit;

d) në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit;
e) i panjohur;
f) sipas zonës në km^2;
g) sipas llojit të ujit të ndenjur;
h) akumulimit dhe zonës së mbajtjes;
i) liqenet dhe ujërat e tjera të ndenjura;
j) rezervuar;
k) uji në strukturat artificiale;
l) sipas historisë.

6. Sipas klasës dhe sipërfaqes, liqenet ndahen në:
a) shumë të vegjël deri në 0,499 km^2;
b) të vegjël 0,5 në 0,999 km^2;
c) të mesëm 1 deri në 9,999 km^2;
d) të mëdhenj 10 deri 99,999 km^2;
e) shumë të mëdhenj më shumë se 100 km^2;
f) nga vëllimi në m^3.

7. Lumenjtë/kanalet janë të ndara në segmente, që shtrihen nga burimi deri në kontribues të parë, në mes të dy degëve fqinje, si dhe në mes të kontribuesit të fundit dhe grykëderdhjes.

8. Lumenjtë ndahen, gjithashtu, në vendet ku ekziston një ndryshim dëshmues për ndonjë nga karakteristikat përkatëse, të tilla si: ndryshime të rëndësishme hidrologjike dhe morfologjike, p.sh. lumë i lundrueshëm, gjendjes së ujit dhe cilësisë së ujit, sasisë së prurjeve, rrjedhjes vjetore, rrjedhës së kthyer etj.

9. Lumenjtë përshkruhen sipas nënpellgut ku janë vendosur.

10. Përcaktimi, nëse është lumë ose kanal, bëhet sipas kategorisë së madhësisë:
a) lumenj/kanale shumë të vogla më pak se 10 km^2; ose
b) lumenj/kanale të vogla ose zona ujëmbledhëse prej 10 km^2 deri në 500 km^2;
c) lumenj/kanale ose zona e mbulimit prej 500 km^2 deri në 1000 km^2;
d) lumenj/kanale të mëdhenj ose zona ujëmbledhëse prej 1000 km^2 deri në 4000 km^2;
e) lumenj/kanale kryesore ose zona të mbulimit më të mëdha se 4000 km^2.

11. Sipas kategorisë së shtrirjes lumi/kanali klasifikohet në:
a) lumë/kanal normal;
b) lumë/kanal më i madh në nivel rrethi të basenit të lumit;
c) lumë/kanal më i madh në nivel nënpellgu ose lumi i rëndësishëm në nivel rrethi të basenit të lumit;
d) lumë/kanal i zgjedhur në nivel nënpellgu;
e) lumë/kanal i panjohur.

12. Lumenjtë ose segmentet e kanaleve përshkruhen nga:
a) regjimi i rrjedhës:
i. vetëm gjatë reshjeve me intensitet të lartë (brenda 2 orësh sasia prej 50 mm);
ii. vetëm menjëherë pas reshjeve me intensitet të lartë;
iii. gjatë reshjeve;
iv. pas reshjeve;
v. për një pjesë të vitit, në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit, i panjohur; me drejtimin e rrjedhjes; me gjatësi; duke caktuar pikën e segmentit të lumit në km në fillim deri në fund pikën e segmentit të lumit në km;
b) tipi i lumit ose i kanalit:
i. lumë apo kanal kryesor;
ii. rrjedhë lumore sekondare;
iii. përrenj;
iv. përrenj sekondarë ose rrjedhje në lumë;
v. lumë në rrjedhjen e mesme ose lidhje me lumin;
vi. kanal kullimi dhe ujitje apo kanal tjetër;
vii. rrjedhjet e tjera;
viii. kanal furnizimi/kullimi në formë tuneli;
ix. rrjedhë kryesore përmes liqenit - lidhje kryq rrjedhjes;
x. lumë ose lidhje me lumin;
xi. kryq rrjedhjes;
c) vazhdimësia:
lidhje që ruajnë tipologjinë e rrjetit:
i. shtrirja e vërtetë e lumit;
ii. i panjohur;
ç) kufijtë:
i. shteti;
ii. nivelit të parë të subjekteve administrative në një shtet;
iii. nivelin e dytë të subjekteve administrative në një shtet;
iv. nivelin e tretë të subjekteve administrative;
v. nivelin e katërt të subjekteve administrative;
vi. segmenti i lumit nuk është pjesë e çfarëdo kufijve natyralë;
d) karakterizimi i shtrirjes së lumit;
i. nga historia;
ii. nga segmenti i lumit ku fillojnë nyja;

iii. segmente të lumit;
iv. nyja fundore;
dh) njësitë kalimtare të ujit:
i. sipërfaqja në km^2;
ii. lidhja e ujërave nëntokësore:
- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur;
e) lidhja e lumenjve me zonat e mbrojtura:
i. e vërtetë;
ii. e supozuar;
iii. e panjohur;
iv. nga në-pellgu ku është vendosur;
ë) njësitë bregdetare të ujit, si:
i. lagunat bregdetare;
ii. kënetat;
iii. moçalet;
iv. deltat e lumenjve;
v. rezervuarët artificialë bregdetarë;
vi. porte dhe limane të ndërtuara në tokë dhe që komunikojnë me detin.
f) njësitë bregdetare të ujit ndahen sipas:
i. sipërfaqja në km^2;
ii. lidhja me ujërat nëntokësore:
- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur.
iii. lidhja me zonat e mbrojtura:
- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur.
iv. nënpellgu ku është vendosur.
g) ujërat territoriale:
i. sipërfaqja në km^2;
ii. nga lidhja me zonat e mbrojtura:
- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur.

13. Nyjat hidrografike janë nyje brenda një rrjeti hidrografik, të cilat mund të përfaqësojnë një pikë fizike bashkimi/degëzimi/mbyllje etj. ose mund të lidhen me një pikë hidrografike interesi apo objekti. Nyjat hidrografike përshkruhen, sipas:
a) kategorisë;
b) emërtimit gjeografik;
c) hidroidentifikuesve;
i. skema e klasifikimit;
ii. ID-ja lokale;
iii. emri lokal.

SHTOJCA 2
KËRKESAT PËR MODULIN PËR UJËRAT NËNTOKËSORE

1. Moduli për ujërat nëntokësore përbëhet nga shtresa gjeohapësinore të lidhura me një tabelë përkatëse të atributeve. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unikë, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të ujërave nëntokësore. Tabelat e atributeve janë të lidhura me një dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre specifike janë të dhëna, të cilat përshkruhen, si:
a) pikat e burimeve natyrale; dhe
b) të dhënat e përgjithshme të burimeve natyrale.

3. Burimet ujore natyrale klasifikohen nga institucionet përgjegjëse (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar) dhe Instituti i Gjeoshkencave, si më poshtë:
3.1 Sipas fenomenit dhe tipit të burimit:
a) burime çarjesh hipës ose zbritës;
b) burime shtresore hipës ose zbritës;
c) burime karstike;
d) burime të prishjeve tektonike;
e) burime të kontaktit litologjik;
f) burime jokarstike;
g) burimit nëndetar.
3.2 Sipas vendndodhjes gjeografike (koordinatat);
a) me gjatësi;
b) me gjerësi;
c) me lartësi.
3.3 Sipas llojit të ujit:
a) ujë i ëmbël ose i freskët;
b) ujë i kripur;
c) ujë me kripshmëri detare;
d) ujë i shëllirtë;
e) ujë mineral;
f) ujë termal;
g) ujë radioaktiv;
h) ujë termomineral.
3.4 Sipas llojit të burimit:
a) zbritës;
b) ngjitës;
c) bregdetarë.
3.5 Sipas llojit të fenomeneve:
a) i infiltruar (dekantuar në nëntokë);

b) dalës i koncentruar;
c) dalës i shpërndarë;
d) gufim;
e) liqen;
f) shpellë;
g) sipas tipit të rrjedhjes;
h) kontakt;
i) depërtim;
j) dalës nga shtrati;
k) gjatësi e daljes;
l) zona e mbarimit të rrjedhjes;
m) nga thellësia e burimit nëndetar;
n) nga kapaciteti kryesor;
o) nga minimumi i kapaciteteve;
p) nga maksimumi i kapaciteteve.
3.6 Sipas regjimit të rrjedhjes së ujit:
a) i panjohur;
b) i përhershëm;
c) i përkohshëm.
3.7 Sipas strukturës së marrjes së ujit:
a) i kaptazhuar;
b) i pakaptazhuar ose i panjohur;
c) rezervuar për furnizimin me ujë.
3.8 Sipas llojit të strukturës së konsumit:
a) kaptazhimi i burimit;
b) galeria e ujit;
c) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.

4. Pikat e shpimeve, të dhënat e përgjithshme, të dhënat hidrogjeologjike, litologjike dhe dokumentet.

4.1 Pikat e shpimeve dhe të dhënat e përgjithshme janë përshkruar nga institucionet përgjegjëse (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar) si objekte të shpuara:
a) puset;
b) shpimet;
c) piezometrat.
4.2. Sipas llojit të objektit të shpuar:
a) puset e testimit dhe shfrytëzimit;
b) puset e furnizimit me ujë të pijshëm;
c) puset termomineral;
d) puset e gërmuara;
e) pus-shpimeve gjeologjike;
f) pus-shpimeve hidrogjeologjike;
g) pus-shpimeve gjeologo-inxhinierike;
h) pus-shpimeve gjeoteknike;
i) puset e kullimit;
j) puset e konsolidimit;
k) puse nafte;
l) puse gazi;
m) puse me qëllim të veçantë;
n) nga emri i objektit të shpimit;
o) nga gjatësia;
p) nga gjerësia;
q) nga lartësia;
r) nga thellësia e tubacionit;
s) nga saktësia e vendndodhjes;
t) nga thellësia e shpimit;
u) nga diametri i shpimit;
v) nga mënyra e shpimit;
w) nga interpretues të shpimit;
x) sipas vitit të shpimit;
y) nga viti i rikonstruksionit;
z) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.

5. Të dhënat e shpimeve hidrogjeologjike janë përshkruar:
5.1 Nga poroziteti i akuiferit:
a) ndërkokrrizor;
b) frakturor;
c) çarje-pore;
d) ndërkokrrizor dhe çarje;
e) çarje dhe çarje-pore.
5.2 Sipas llojit të akuiferit:
a) të hapur;
b) të mbyllur;
c) gjysmë të mbyllur.
5.3. Sipas llojit të ujit:
a) ujë i freskët;
b) ujë mineral;
c) ujë termal;
d) ujë nëntermal;
e) termominerale;
f) të njelmët;
g) të freskëta-njelmët;
h) i kripur.
5.4 Sipas karakteristikave të shpimit dhe akuiferit:
a) nga thellësia e tavanit të akuiferit;
b) nga thellësia e tabanit të akuiferit;
c) nga kapaciteti individual i shpimit/burimit;
d) nga të dhënat e veçanta;
e) nga ujë përshkueshmëria hidraulike;
f) nga ujëpërcjellshmëria;
g) nga ruajtja e veçantë;
h) nga filtrimi;
i) nga rrezja efektive e puseve;
j) nga metoda e përcaktuar për shpimin me rrotullim/goditje;

k) nga testi i pompimit;
l) nga analizat granulometrike;
m) nga mënyra e shpimit - karotash.
5.5 Sipas litologjisë së shpimeve:
a) intervali;
b) gjatësia e intervalit;
c) përshkrimi litologjik;
d) simboli litologjik.
5.6 Sipas të dhënave për shpimet e bëra:
a) thellësia e shpimit;
b) nga thellësia e fundit të shpimit;
c) nga diametri i tubove.
5.7 Sipas instalimeve në shpim:
a) tubat;
b) filtrat;
c) pjesa fundore e mbyllur e konstruksionit të pusit.
5.8 Sipas materialit ndërtimor:
a) çelik;
b) plastikë;
c) hekur;
d) hekur i galvanizuar;
e) azbest;
f) çimento;
g) inoks;
h) e kombinuar.
5.9 Sipas llojit të filtrit:
a) tub i hapur;
b) tub me vrima;
c) vrima me rrjetë;
d) çarje të hapura;
e) çarje me rrjetë;
f) spirale (të mbështjellë).
5.10 Sipas dokumenteve të shpimeve:
a) formati i dokumentit;
b) përshkrimi i dokumentit;
c) arkivi dhe nga numri arkivor.
6. Pikat e gërmuara, të dhënat e përgjithshme për gërmimet, të dhënat hidrogjeologjike dhe dokumentacioni.
6.1 Pikat e gërmuara dhe të dhënat e përgjithshme përshkruhen nga institucioni përgjegjës (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar), si:
a) objekte të gërmuara;
b) puse të gërmuara;
c) galeri të marrjes se ujit;
d) nga emri.
6.2 Sipas vendndodhjes:
a) gjerësia;
b) gjatësia;
c) lartësia;
d) vendndodhja e saktë - koordinatat;
e) thellësia;
f) diametri.
6.3 Sipas llojit të hyrjes:
a) pjerrësia;
b) pusi kryesor i minierës;
c) miniera;
d) prerje;
e) nga gjatësia e hyrjes;
f) tipi i nxjerrjes së ujit;
g) galeri;
h) galeri e pjerrët;
i) pusi kryesor i minierës;
j) pus i pjerrët;
k) pus horizontal;
l) pus vertikal;
m) nga gjatësia e marrjes së ujit (nënkupton tubacionin);
n) nga azimuti i marrjes së ujit;
o) nga numri i objekteve të marrjes së ujit të futura (stacionet e pompimit);
p) nga distanca midis objekteve të marrjes së ujit (të futura);
q) nga tipi i gërmimit;
r) nga viti i gërmimit;
s) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.
7. Të dhënat hidrogjeologjike të objekteve të gërmuara përshkruhen:
7.1 Nga poroziteti i akuiferit, si:
a) ndërkokrrizor;
b) frakturor;
c) çarje;
d) poro-çarje;
e) çarje-pore;
f) ndërkokrrizor dhe çarje.
7.2 Sipas llojit të akuiferit:
a) të hapur;
b) të mbyllur;
c) gjysmë të mbyllur.
7.3 Sipas llojit të ujit:
a) ujë i freskët;
b) ujë mineral;
c) ujë termal;
d) ujë nëntermik;
e) ujë termomineral;
f) ujë i njelmët;
g) ujë i freskët - i njelmët;
h) ujë i kripur.

7.4 Sipas të dhënave të tjera:
a) nga kapaciteti individual;
b) nga të dhënat e veçanta;
c) nga akumulimi i veçantë;
d) nga ujëpërshkueshmëria hidraulike;
e) nga ujëpërcjellshmëria;
f) nga filtrimi;
g) nga analiza granulometrike;
h) nga rrezja efektive e puseve;
i) nga testi i pompimit;
j) nga metoda e përcaktuar për tipin e shpimit me rrotullim/goditje;
k) nga metoda e shpimit-karotash.
7.5 Sipas dokumenteve të gërmimeve:
a) formati i dokumentit;
b) përshkrimi i dokumentit;
c) nga arkivi dhe nga numri arkivor.
8. Pikat gjeomorfologjike, të dhëna të përgjithshme dhe dokumentacioni përshkruhen nga institucionet sipas fushës së përgjegjësive.
8.1 Pikat gjeomorfologjike dhe të dhënat e përgjithshme janë përshkruar nga tipologjia:
a) emri;
b) vendndodhja;
c) koordinatat gjeografike; me gjatësi; me lartësi të hyrjes; me saktësi të vendndodhjes;
d) numri i hyrjes;
e) dimensioni i hyrjes kryesore;
f) gjatësia e gjurmës; nga thellësia;
g) ndryshimi i lartësisë;
h) azimuti i objektit;
i) thellësia në ujë.
8.2 Sipas llojit të regjimit:
a) të panjohur;
b) të përhershëm;
c) të përkohshëm;
d) të reja.
8.3 Sipas regjimit të uljes së nivelit të ujit:
a) të panjohur;
b) të përhershëm;
c) të përkohshëm;
d) të reja.
8.4 Sipas rrjedhës jashtë regjimit:
a) të panjohur;
b) të përhershëm;
c) të përkohshëm;
d) të reja.
8.5 Sipas llojit të ujit:
a) ujë i freskët;
b) ujë mineral;
c) ujë termal;
d) ujë nëntermike;
e) ujë termomineral;
f) ujë i njelmët;
g) ujë i freskët – i njelmët;
h) ujë i kripur;
i) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.
8.6 Sipas dokumenteve gjeomorfologjike:
a) formati i dokumentit;
b) nga përshkrimi i dokumentit;
c) nga arkivi dhe nga numri arkivor.
9. Njësitë e ujërave nëntokësore dhe njësitë e inerteve nëntokësore.
9.1 Ujërat nëntokësore përshkruhen sipas ekorajoneve, si:
a) ndërkufitar;
b) nga jashtë rrethit të basenit lumor;
c) nga jashtë rrethit të nënbasenit lumor;
d) nga emri;
e) nga gjerësia;
f) nga gjatësia;
g) sipas sipërfaqes;
h) nga horizonti i ujërave nëntokësore;
i) përcaktimi i formës finale;
j) nga kapaciteti.
9.2 Klasifikimi sasior i ujërave nëntokësore:
a) më pak se 1000 km^2;
b) midis 1000 km^2 dhe 4000 km^2;
c) më shumë se 4000 km^2;
d) nga lidhja me ujërat sipërfaqësore;
e) nga lidhja me zonat e mbrojtura.
9.3 Njësitë e inerteve nëntokësore janë përshkruar nga:
a) emri;
b) sipas fushave;
c) gjerësia;
d) gjatësia;
e) kapaciteti;
f) shtresat e trupave ujorë nëntokësorë;
g) klasa e madhësisë së shtresave nëntokësore:
h) më pak se 1000 km^2;
i) në mes të 1000 km^2 dhe 4000 km^2;
j) më shumë se 4000 km^2;
k) lidhja shoqëruese me ujërat sipërfaqësore;
l) lidhja shoqëruese me zonat e mbrojtura.

SHTOJCA 3
KËRKESAT PËR MODULIN PËR STRUKTURAT E UJIT

1. Moduli për strukturat e ujit përbëhet nga dy shtresa gjeohapësinore:

a) strukturat gjatësore të ujit/objekteve; dhe

b) strukturat tërthore të ujit/objekteve.

2. Tabela e atributeve të strukturave gjatësore të ujit përshkruan të dhënat e përgjithshme dhe specifike.

2.1 Tabela e atributeve të strukturave gjatësore të ujit përfshijnë:

a) kodet e lumenjve;

b) vendndodhjen;

c) anët e bankinave;

d) shënuesit kilometrikë;

e) gjatësinë;

f) vitin e ndërtimit;

g) lartësinë në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme;

h) peshën e kurorës;

i) shpatet e kanaleve ujore;

j) shpatet e ledheve;

k) qëllimi.

2.2 Tabela e atributeve të strukturave tërthore përfshin:

a) kodin;

b) vendndodhjen;

c) llojin e objektit;

d) vitin e ndërtimit;

e) pronarin etj.

2.3 Të dyja tabelat e atributeve janë të lidhura me tabelat që përshkruajnë dokumentacionin teknik.

3. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre specifike janë:

a) Strukturat gjatësore të ujit, të tilla si: ledhet, pritat për të shmangur përmbytjet, pritat për të shmangur intruzionin e ujit të detit janë përshkruar, sipas:

i. emrit;

ii. llojit të strukturës;

iii. emërtimit të ujërave sipërfaqësore;

iv. bankinave të lumit/bregdetit;

v. gjerësisë;

vi. gjatësisë;

vii. fillimit të shënuesit kilometrik;

viii. fundit të shënuesit kilometrik;

ix. materialit të objekt ujor;

x. lartësisë absolute në rrjedhën e sipërme të kurorës së objektit ujor;

xi. lartësisë në rrjedhën e poshtme të kurorës së objektit ujor;

xii. rëndësisë së kurorës së objektit lumor;

xiii. shpateve të rrjedhës së ujit;

xiv. pjesës së pasme të shpatit;

xv. vlerës përkatëse të ujit për vlera të mëdha të rrjedhës ujore;

xvi lartësisë së objektit hidroteknik mbi nivelin e ujit;

xvii. lartësisë relative mesatare, në lidhje me nivelin e tokës përreth;

xviii. gjerësisë mesatare të objektit ujor.

b) Strukturat gjatësore të ujit, të tilla si: ledhet, pritat për të shmangur përmbytjet, pritat për të shmangur intruzionin e ujit të detit janë përshkruar sipas kushteve:

i. vitit të ndërtimit;

ii. vitit të rikonstuksionit të fundit;

iii. qëllimit kryesor;

iv. burimit të të dhënave gjeometrike;

v. autoritetit mirëmbajtjes ID (numri i identifikimit).

c) Strukturat tërthore të ujit, të tilla si: diga, stacione pompimi, barriera, panelet mbrojtëse, kapërderdhësit, daljet nga shtrati për kanalet vaditëse janë përshkruar, sipas:

i. emrit;

ii. vendndodhjes;

iii. gjerësisë;

iv. gjatësisë;

v. lartësisë;

vi llojit të objektit ujor.

d) Strukturat tërthore të ujit, të tilla si: diga, stacione pompimi, barriera, panelet mbrojtëse, kapërderdhësit, daljet nga shtrati për kanalet vaditëse janë përshkruar, sipas kushteve:

i. vitit të ndërtimit;

ii. vitit të rikonstruksionit të fundit.

4. Përveç të dhënave të përgjithshme, daljet nga shtrati për kanalet vaditëse janë përshkruar nga:

a) kapaciteti dalës;

b) volumi.

5. Përveç të dhënave të përgjithshme, plotat janë përshkruar nga:

a) lartësia e tyre maksimale mbi kurorë;

b) dimensionit të përhapjes së ujërave;

c) kapaciteti i plotës;

d) mundësia e ndotjes nga plota.

6. Përveç të dhënave të përgjithshme, stacionet e pompimit janë përshkruar nga:

a) rrjedha e ujit në të cilën uji është lëvizur nëpërmjet stacionit të pompimit;

b) shënuesi kilometrikë në grykëderdhje;

c) mesatarja shumëvjeçare e ujit hyrës;

d) mesatarja vjetore maksimale e ujit hyrës;

e) mesatarja vjetore minimale e ujit hyrës;

f) numri i pompave;

g) fuqia totale e pompave;

h) kapaciteti total i përgjithshëm i pompave;

i) niveli maksimal i ujit;

j) lartësia maksimale e punës;

k) lartësia minimale e punës;

l) kapaciteti maksimal gravitacional i derdhjes;

m) orët e punës vjetore mesatare;

n) konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike;

o) konsumi mesatar vjetor i karburantit të lëngshëm;

p) fluksi minimal i hyrjes së ujit;

q) fluksi maksimal i hyrjes së ujit;

r) qëllimi kryesor i stacionit të pompimit.

7. Përveç të dhënave të përgjithshme, sifonet janë përshkruar nga:

a) gjatësia në plan në terren;

b) sipërfaqja mesatare e prerjes tërthore të sifonit;

c) forma e profilit kryq mesatar të sifonit;

d) vlera përkatëse e rrjedhjes;

e) lloji i objektit mbi sifon;

f) emri i objektit të sipër sifonit;

g) shënuesi i largësisë së sifonit pika e fillimit;

h) shënuesi i largësisë së objektit.

SHTOJCA 4
KËRKESAT PËR MODULIN PËR PËRDORIMIN E UJIT

1. Moduli për përdorimin e ujit përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me një tabelë respektive të atributeve. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unik, kodet kombëtare dhe të BE-së, emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave. Tabelat e atributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore të përdorimit të ujit dhe përshkrimet e tyre të veçanta janë:

a) pikat e nxjerrjes së ujit;

b) objektet dhe pikat hidroteknike;

c) koncesionet dhe tarifat e koncesionit.

2.1 Pikat e nxjerrjes së ujit përshkruhen nga:

a) të dhënat e përgjithshme;

b) sasia e nxjerrë;

c) emrit;

d) vendndodhjes;

e) gjerësisë;

f) gjatësisë;

g) lartësisë;

h) vitit të rindërtimit;

i) identifikimi i koncesionit (ID);

j) llojit të objektit të uji;

k) vitit të ndërtimit;

l) pellgut dhe nënpellgut ku ndodhet.

2.2 Sipas tipit nga ku nxirret uji:

a) ujërat sipërfaqësore;

b) ujërat nëntokësore;

c) ujërat detare;

d) të tjera.

2.3 Sipas llojit të marrjes:

a) marrje në burim;

b) puse;

c) lumë;

d) liqen apo grumbullime uji.

2.4 Sipas metodës së nxjerrjes së ujit;

a) me pompë;

b) rrjedhje e lirë;

c) artezian;

d) të tjera.

2.5 Sipas qëllimit të nxjerrjes së ujit:

a) furnizimi publik me ujë;

b) ujë për imbotilim;

c) ujë mineral;

d) ujë teknologjik;

e) ujë për terapi shëndetësore;

f) ujë rekreativ;

g) ujë për ujitje;

h) ujë për akuakulturë;

i) ujë për nevojat blegtorale;

j) ujë për hidroenergji;

k) ujë për hidrocentrale;

l) ujë për nevojat e zjarrfikësve;

m) ujë për përdorim familjar.

2.6 Nga kapaciteti i pompës:

a) kapaciteti i lejuar i nxjerrjes së ujit;

b) kapaciteti i lejuar i veprës ose i pompës;

c) nga kapaciteti i mundshëm shtesë për nxjerrjen e ujit.

2.7 Sipas thellësisë së zhytjes së pompës dhe viti i ndërtimit të pusit;
a) nga niveli i ujit;
b) nga viti i ndërtimit.
2.8 Sasia e nxjerrë është përcaktuar nga:
a) data e futjes së të dhënave;
b) viti dhe muaji i vënies në përdorim të pusit, kaptazhit;
c) shfrytëzimi i të gjithë muajve në total.
3. Objektet dhe pikat hidroteknike dhe të dhënat e tyre.
3.1 Objektet hidroteknike janë të përcaktuara sipas:
a) aktivitetit të objekteve hidroteknike;
b) identitetin (ID-në) e koncesionit;
c) emrit;
d) vendndodhjes;
e) gjerësisë;
f) gjatësisë;
g) lartësisë;
h) qëllimi i objektit hidroteknik;
i) sipas pellgut dhe nënpellgut ku është vendosur.
4. Koncesionet.
4.1 Koncesionet janë përshkruar sipas dokumentacionit fillestar:
a) identiteti i koncesionit;
b) ofruesi i koncesionit;
c) përdoruesi i koncesionit;
d) data e lëshimit.
4.2 Sipas qëllimit të koncesionit:
a) nxjerrjen e ujit për furnizimin të popullatës;
b) nxjerrjen e ujit - paketim me shishe;
c) nxjerrjen e ujit për nevoja teknologjike;
d) nxjerrjen e ujërave minerale dhe termale;
e) nxjerrjen e ujërave për terapi shëndetësore dhe rekreacion.
4.3 Sipas qëllimit të konsumit të ujit:
a) kullim;
b) ujitje;
c) përdorimi i fuqisë së ujit për impiante industriale;
d) përdorimi i ujit për të gjeneruar energji elektrike;
e) rrugëve ujore në brendësi dhe liqenet;
f) portet dhe kalatat;
g) akuakulturë.
4.4 Sipas përdorimit të ujit si pasuri publike:
a) sportive dhe rekreacioni;
b) sipas vendndodhjes së koncesionit;
c) sipas periudhës së koncesionit (vjet);
d) nga data e skadimit;
e) nga objekti i përdorimit;
f) dinamika e pagesës;
g) pagesa në kohë e tarifës;
h) përdorimi ekonomik dhe përdorime të tjera të ujit si pasuri publike.
5. Tarifat e koncesionit janë përshkruar në identitetin (ID-në) e koncesionit, sipas:
a) vitit të kontabilitetit;
b) sasisë;
c) tarifës së faturimit;
d) borxhit;
e) tarifës në ngarkim;
f) datës së pagesës.

SHTOJCA 5
KËRKESAT PËR MODULIN PËR MBROJTJEN E UJIT

1. Moduli për mbrojtjen e ujit përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të atributeve. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unikë, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave. Tabelat e atributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.
2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre të veçanta.
2.1 Pikat e ndotësve potencialë dhe të dhënat e përgjithshme. Ndotësit potencialë janë përshkruar nga agjencia përgjegjëse nga:
a) emri;
b) vendndodhja;
c) vendndodhja e detajuar në përmasa me të kufizuara;
d) gjerësia;
e) gjatësia;
f) lartësia;
g) sektorët e aktivitetit;
h) aktiviteti;
i) informacionet shtesë;
j) data e regjistrimit.
2.2 Sipas sasisë së ndotjes:
a) data e përcaktimit;
b) metoda e përcaktimit;
c) grupi i ndotësve;
d) njësia e matjes;
e) sasia e ndotësit;

f) përqendrimi i ndotësve;
g) rrjedha;
h) zonat e përhapjes.

SHTOJCA 6
KËRKESAT PËR MODULIN PËR ZONAT E MBROJTURA UJORE DHE HABITATET UJORE

1. Moduli për zonat e mbrojtura ujore përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të atributeve. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unikë, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave. Tabelat e atributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre të veçanta janë:
a) zonat e mbrojtura dhe habitatet ujore;
b) zonat e mbrojtura të zogjve;
c) zonat e mbrojtura sanitare të burimeve ujore;
d) zonat e mbrojtura atraktive dhe banjat;
e) zonat e mbrojtura të lëndëve ushqyese sensitive;
f) zonat e mbrojtura të specieve endemike të rëndësishme;
g) fusha të tjera të zonave të mbrojtura.

2.1 Zonat e mbrojtura dhe habitatet ujore janë përshkruar, sipas:
a) emrit;
b) llojit të zonave të mbrojtura;
c) gjerësisë;
d) gjatësisë;
e) zonës.

2.2 Zonat e mbrojtura të zogjve, janë përshkruar sipas:
a) emrit;
b) llojit të zonave të mbrojtura;
c) gjatësisë;
d) gjerësisë;
e) zonës.

2.3 Zonat e mbrojtjes sanitare të burimeve ujore janë përshkruar, sipas:
a) emrit;
b) llojit të zonës së mbrojtur:
i. zona e parë e mbrojtjes ose zona e rreptësisë;
ii. zona e mbrojtjes së afërt;
iii. zona e mbrojtjes së largët;
c) gjatësisë;
d) gjerësisë.

2.4 Zonat e mbrojtura atraktive dhe banjat janë përshkruar, sipas:
a) emrit;
b) llojit të zonave të mbrojtura;
c) gjatësisë;
d) gjerësisë;
e) zonës.

2.5 Zonat e mbrojtura të lëndëve ushqyese sensitive janë përshkruar, sipas:
a) emrit;
b) llojit të zonave të mbrojtura;
c) gjatësisë;
d) gjerësisë;
e) zonës.

2.6 Zonat e mbrojtura të specieve endemike të rëndësishme janë përshkruar, sipas:
a) llojit të zonave të mbrojtura;
b) gjatësisë;
c) gjerësisë;
d) zonës.

2.7 Fusha të tjera të zonave të mbrojtura janë përshkruar, sipas:
a) llojit të zonave të mbrojtura;
b) gjatësisë;
c) gjerësisë;
d) zonës;
e) hapësirës së vendndodhjes;
f) llojit të zonave të mbrojtura në Shqipëri;
g) kategorisë lokale;
h) lejeve të lëshuara nga organet ligjvënëse.

SHTOJCA 7
KËRKESAT PËR MODULIN PËR MONITORIMIN E UJIT

1. Moduli për monitorimin e ujit përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të atributeve.

2. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unik, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave, duke përfshirë seri kohore për ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore të të dhënave të monitorimit të ujit.

3. Tabelat e atributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

4. Shtresa gjeohapësinore dhe karakteristikat e tyre të veçanta janë:

a) stacionet matëse të cilësisë së ujit për ujërat sipërfaqësore;

b) stacionet matëse të cilësisë së ujit për ujërat nëntokësore;

c) karakteristikat e vlerësimit të cilësisë së ujit.

4.1 Monitorimi i ujërave nëntokësore është përshkruar:

a) me emër;

b) me gjerësi;

c) me gjatësi;

d) sipas ndarjes së kufirit të sipërm;

e) sipas ndarjes së kufirit më të ulët;

f) nga sasia;

g) sipas funksionit;

h) sipas mbikëqyrjes;

i) sipas nivelit të thellësisë;

j) sipas pusit apo burimit;

k) nga një monitorim i vetëm;

l) nxjerrja e ujit të pijshëm;

m) furnizimi industrial;

n) vaditja;

o) furnizime të tjera.

4.2 Stacionet matëse të cilësisë së ujit janë përshkruar, sipas:

a) etiketës origjinale;

b) monitorimit të llojit të objektit;

c) ujërave sipërfaqësore-lumenjve;

d) ujërave sipërfaqësore-liqeneve;

e) ujërat nëntokësore - burimet;

f) ujërat nëntokësore - pus-shpimet;

g) ujë nëntokësore - strukturat e gërmuara;

h) ujërat nëntokësore - strukturat gjeomorfologjike;

i) ujërat bregdetare;

j) ujërat e ndotura.

4.3 Monitorimi i cilësisë së ujit karakterizohet, si:

a) operacional;

b) mbikëqyrës;

c) referues;

d) kërkimor;

e) nga vetë pronari identifikues.

4.4 Karakteristikat e cilësisë së ujit përshkruhen, sipas:

a) intervaleve të rregullta;

b) të dhënave të rezultateve;

c) matjeve;

d) nxjerrjes;

e) intervalit matës;

f) datës së fillimit të matjes;

g) datës së përfundimit të matjes;

h) vazhdimësisë së matjes.

5. Matja e cilësisë së ujit përshkruhet nga metodologjia, si:

a) manuale;

b) automatike.

6. Karakteristikat e matjes së të dhënave të kampioneve janë përshkruar:

a) marrja në thellësi e kampioneve;

b) kushtet hidrologjike;

c) shkalla e rrjedhjes;

d) niveli i ujit.

7. Parametrat kimikë dhe fizikë janë përshkruar nga:

a) data e analizës;

b) temperatura e ujit;

c) temperatura e ajrit;

d) era;

e) shija;

f) ngjyra;

g) ndotja e ujit;

h) përçueshmëria elektrike;

i) mbetjet e thata;

j) oksigjeni i tretur në ujë;

k) ngopja me oksigjen.

7.1 Parametrat themelorë kimikë janë përshkruar nga:

a) data e analizës;

b) lënda pezull;

c) mbetja e thatë;

d) alkaliniteti total;

e) alkaliniteti karbonat;

f) alkaliniteti bikarbonat;

g) fortësia e përgjithshme;

h) fortësia e karbonatit;

i) fortësia e kalciumit;

j) fortësia magnezit;

k) karbonatet;

l) bikarbonatet.

7.2 Kationet dhe anionet bazë janë përshkruar nga:

a) data e analizës;

b) fluori;

c) kloruret;

d) sulfatet;

e) silikatet;

f) kaliumi;

g) natriumi;

h) kalciumi;
i) magnezi;
j) të tjera, sipas parametrave të bazuar në standardet e cilësisë së ujit të pijshëm në Shqipëri.

7.3 Parametrat mikrobiologjikë janë përshkruar nga:
a) data e analizës;
b) llogaritja e kolonisë në 37°C (N/100ml);
c) llogaritja e kolonisë në 22°C (N/100ml); bakteret Koliformeenterokoki (N/100ml);
d) Escherichia coli;
e) Clostridium Perfrigens(N/100ml).

7.4 Parametrat sanitarë dhe mikrobiologjikë janë përshkruar nga:
a) data e analizës;
b) organotropet aerobike;
c) bakteret fekale 37°C (N/100ml);
d) bakteret fekale 44°C (N/100ml);
e) streptokokët fekalë;
f) enterokoku i zorrëve; salmonela;
g) bakteret në 37°C (N/ml);
h) mikrobet;
i) Coli;
j) Escherichia coli;
k) sulfatet;
l) Clostridia e kuqe.

8. Stacionet e monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore janë përshkruar nga:
a) niveli i stacionit (ID-ja) të monitorimit;
b) stacionet (ID-ja) e monitorimit nëntokësor;
c) emërtimi origjinal;
d) identiteti (ID-ja) i pronarit.

9. Stacionet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe llojit të tyre, stacionet e matjes së cilësisë së ujit, dokumentacioni, stacioni i matjes së karakteristikave hidrologjike dhe pjesa kohore.

9.1 Stacionet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore janë përshkruar nga:
a) emri;
b) gjerësia;
c) gjatësia;
d) gjendja e punës;
e) vëzhgimet;
f) investigimet;
g) referencat;
h) ndërkalibrimet.

9.1.1 Sipas llojit të ujit sipërfaqësor, në:
a) ujë bregdetar;
b) ujë i ndryshueshëm;
c) i përkohshëm;
d) lumë;
e) liqen.

9.2 Stacionet matëse të cilësisë së ujit janë përshkruar nga:
a) emërtimi origjinal;
b) ID-ja e pronarit;
c) llojet e monitorimit të cilësisë së ujit;
d) objekti i monitorimit.

9.3 Të dhënat e stacioneve hidrologjike janë përshkruar nga:
a) emërtimi origjinal;
b) numri origjinal i stacionit;
c) ID-ja e pronarit;
d) lloji i stacionit hidrologjik;
e) lartësia;
f) numri i matjes në taban dhe tavan;
g) shënuesit e largësisë.

9.4 Dokumentacionet janë përshkruar nga:
a) përshkrimi i dokumentit;
b) arkivi;
c) numri arkivor;
d) forma e dokumentit.

9.5 Karakteristikat e stacionit matës hidrologjik janë përshkruar nga:
a) intervale të rregullta;
b) të dhënat e rezultateve;
c) matjet;
d) prurjet;
e) instrumentet matëse apo metodat;
f) zona e vogël e kufizuar;
g) zona më e madhe;
h) rrjedhja e lirë;
i) pajisjet ADCP;
j) pajisje elektromagnetike;
k) metoda mix;
l) metoda e matjes së objektit;
m) të tjera;
n) intervali i matjes;
o) data e fillimit të matjes;
p) data e përfundimit të matjes;
q) vazhdimësia e matjes.

9.6 Metodologjia e matjes, sipas ID-së së kërkuar të mbikëqyrësit është:
a) manuale;
b) automatike.

9.7 Seritë kohore tabelare të monitorimit janë përshkruar nga:
a) data dhe koha;

b) kapaciteti i rrjedhës;
c) lartësia e matjes në taban dhe tavan;
d) pasqyra e ujit;
e) zona e ndotur;
f) përqindja e rrjedhjes maksimale në profil;
g) paraqitja kryesore e normës së rrjedhjes.
10. Monitorimi i ujërave sipërfaqësore të rrjetit është përshkruar, me:
a) kodin e monitorimit të rrjetit: Eionet, Eurowaternet;
b) vendimi 86/574/EEC - cilësia e ujit të freskët sipërfaqësor;
c) direktivën 91/676/EEC - ndotja nga nitratet apo bujqësia;
d) matjen e programeve të OECD (EMEP);
e) një pjesë të raportit në nivel baseni ujor të qarkut, të cilat nuk janë pjesë e rrjetit të monitorimit ndërkombëtar ose të panjohura.

SHTOJCA 8
KËRKESAT PËR MODULIN PËR MONITORIMIN METEOROLOGJIK

1. Moduli për monitorimin meteorologjik përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të atributeve.
2. Tabelat e atributeve përmbajnë identifikues unik, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave, duke përfshirë seri kohore me të dhënat meteorologjike.
3. Tabelat e atributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.
4. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre të veçanta janë:
a) stacionet meteorologjike;
b) karakteristikat e matjes;
c) metodologjia e matjes;
d) të dhënat në seritë kohore meteorologjike;
e) dokumentacionet.
4.1 Stacionet meteorologjike janë përshkruar nga:
a) numri origjinal i stacionit;
b) emërtimi origjinal;
c) koordinatat gjeografike x, y, z;
d) vendndodhja;
e) lartësia;
f) gjerësia;
g) lloji i stacionit meteorologjik;
h) identiteti (ID-ja) i pronarit.
4.2 Karakteristikat matëse janë përshkruar nga:
a) data e fillimit të matjes;
b) data e përfundimit të matjes;
c) intervalet e rregullta;
d) të dhënat e rezultateve;
e) matja e realizuar;
f) prurja;
g) intervali i matjes;
h) vazhdimësia e matjes.
4.3 Metodologjia e matjes është:
a) manuale;
b) automatike.
4.4 Të dhënat në seritë kohore meteorologjike janë përshkruar nga:
a) data;
b) temperatura e ajrit;
c) reshjet.
4.5 Dokumentacionet janë përshkruar nga:
titulli i dokumentit;
arkivi;
numri arkivor;
formati i dokumentit.

SHTOJCA 9
PËR HEDHJEN E TË DHËNAVE NGA BURIMI I DISPONIMIT TË TYRE NË KADASTRËN KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

Kjo shtojcë ka për qëllim të japë përcaktimet kryesore për aktorët e përfshirë mbi mënyrën e hedhjes të të dhënave të disponuara për popullimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore bazuar në marrëveshjet midis Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe institucioneve respektive sipas fushave të Kadastrës.
I. TREGUESIT E KADASTRËS SIPAS FUSHAVE
Treguesit e Kadastrës janë elementet e cilësuara në sistemin e hedhjes së të dhënave të Kadastrës dhe që do të përdoren për popullimin e saj, sipas fushave të mëposhtme:
1. Treguesit e ujërave sipërfaqësore *(Surface Water)*
a) Basene lumore, nënbasenet, ujëmbledhësit *(River basins, sub-basins, catchments and watersheds)*;

b) Liqenet dhe segmentet liqenore *(Lake and lake segments)*;

c) Lumi, zona të lumit apo segmente të kanalit *(River, river or canal segment areas, river or canals segments)*;

d) Njësitë kalimtare të ujit *(Transitional Water units);*

e) Njësitë bregdetare të ujit *(Coastal water units)*;

f) Ujërat territoriale *(Territorial water)*.

2. Ujërat nëntokësorë *(Groundwater)*

a) Pikat e burimeve natyrale dhe të dhënat e përgjithshme të burimeve natyrale *(Spring points and spring general data)*;

b) Pikat e shpimeve, të dhënat e përgjithshme, të dhënat hidrogjeologjike, litologjike dhe dokumentet *(Borehole points, general data, hydrogeological data, lithology and documents)*;

c) Pikat e gërmuara, të dhënat e përgjithshme për gërmimet, të dhënat hidrogjeologjike dhe dokumentacioni *(Dug points, dug general data, hydrogeological data and documentation)*;

d) Pikat gjeomorfologjike, të dhënat e përgjithshme dhe dokumentacioni *(Geomorphological points, general data and documentation)*;

e) Njësitë e ujërave nëntokësore dhe njësitë e inerteve nëntokësore *(Groundwater units and aggregated groundwater unit)*.

3. Monitorimi *(Monitoring)*

a) Monitorimi i ujërave nëntokësore, stacionet matëse të cilësisë së ujit, karakteristikat matëse të cilësisë së ujit, karakteristikat e matjes së të dhënave të kampioneve *(Groundwater monitoring, water quality measuring stations, water quality measuring characteristics, measuring characteristics sample data)*;

b) Stacionet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore, stacionet matëse të cilësisë së ujit, dokumentacioni, karakteristikat e stacionit matës hidrologjik, seritë kohore tabelare të monitorimit *(Surface monitoring stations, ëater quality measuring stations, documentation, hydrology station measurement characteristics, time series)*;

c) Stacionet meteorologjike *(Meteorological stations)*;

d) Karakteristikat matëse meteorologjike *(Meteorological measurement characteristics)*.

4. Mbrojtja e ujit *(Water protection)*.

a) Pikat e ndotësve potencialë dhe të dhënat e përgjithshme *(Potential pollutants points and general data)*;

b) Sasia e ndotjes *(Amount of pollution)*;

c) Zonat e habitateve të mbrojtura *(Habitat protected area*);

d) Zonat e mbrojtura të zogjve *(Bird protected area)*;

e) Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve ujore *(Drinking water protected area)*

f) Zonat e mbrojtura atraktive dhe banjat *(Recreation and bathing protected area)*;

g) Zonat e mbrojtura të lëndëve ushqyese sensitive *(Nutrient sensitive protected areas);*

h) Zonat e mbrojtura të specieve endemike të rëndësishme *(Endemic significant species protected area)*;

i) Fusha të tjera të zonave të mbrojtura *(Other protected area areas)*.

5. Përdorimi i ujit *(Water usage)*.

a) Pikat e nxjerrjes së ujit - të dhënat e përgjithshme, sasia e nxjerrë (*water abstraction points - general data, abstraction quantity)*;

b) Objektet dhe pikat hidroteknike *(Hydrotechnical object points and data)*;

c) Koncensionet, tarifat e koncensioneve *(Concessions, concessions fee)*.

6. Struktura e ujit *(Water structure)*.

a) Strukturat gjatësore të ujit (shpatet e ledheve, anët e bankinave, rregulloret) *"Longitudinal water structures (levee, floodwall, regulation)"*.

b) Strukturat tërthore të ujit (prita/diga, stacione pompimi, barrierat, daljet nga shtrati, kapërderdhësit) *"Transversal Water structure (dam, pumping station, weir, overflow, outlet)*.

7. Topografia dhe toka *(Topographic & land)*.

a) Të dhëna për përdorimin e tokës, gjeologjike dhe hippsometrike *(Land-use, geological and hypsometric data)*;

b) Kufijtë administrativë *(Administrative boundaries)*;

c) Qytetet *(Cities);*

d) Kufijtë e shtetit *(State boundaries);*

e) Autoritetet kompetente *(Competent Authorities)*.

II. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR HEDHJEN E TË DHËNAVE SIPAS FUSHAVE TË TREGUESVE TË KADAS-TRËS

Për popullimin e sistemit të Kadastrës, me të dhënat e treguesve të cilësuar të sistemit të Kadastrës, do të aktivizohen institucionet

relevante të hedhjes dhe përditësimit të të dhënave që disponohen në arkivat respektivë të tyre, që kanë lidhje me treguesit specifikë dhe që janë përcaktuar në dispozitën përkatëse për të populluar Kadastrën me këto të dhëna. Institucionet referuese, sipas fushave, janë si më poshtë vijon:

1. Ujërat sipërfaqësore *(Surface water)*

Për treguesit e fushës së ujërave sipërfaqësore, sipas nëntreguesve të saj të shprehura në pikat 1.a, 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 1.f të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave respektive, duke u bazuar në përcaktimet e trupave ujorë të identifikuar dhe kufizuar në planet e menaxhimit të baseneve ujore.

2. Ujërat nëntokësore *(Groundwater)*

Për treguesit e fushës së ujërave nëntokësore, sipas nëntreguesve të saj të shprehura në pikat 2.a, 2.b, 2.c të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave respektive, duke u bazuar në përcaktimin e trupave ujorë nëntokësorë të identifikuar dhe kufizuar në planet e menaxhimit të baseneve ujore. Për treguesit e fushës së ujërave nëntokësore, sipas nëntreguesve të saj të shprehura në pikat 2.d dhe 2.e të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave respektive për gjeomorfologjinë dhe vendndodhjen e trupave ujorë nëntokësorë, bazuar në dokumentacionin e përzgjedhjes së këtyre trupave, sipas kërkesave të Direktivës së Ujërave Nëntokësore dhe legjislacionit kombëtar në lidhje me ujërat nëntokësore.

3. Monitorimi *(Monitoring)*

Për treguesit e fushës së monitorimit të nëntreguesve të trupave ujorë nëntokësorë, të shprehur në pikën 3.a të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet institucioni i SHGJSH-së ose/dhe institucioni që do të përcaktohet me marrëveshje nga AMBU-ja, për të zbatuar programin e monitorimit të ujërave nëntokësore (të përcaktuar me VKM-në respektive), të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e monitorimit të sasisë dhe cilësisë së ujërave nëntokësore.

Për treguesit e fushës së monitorimit të nëntreguesve të trupave ujorë sipërfaqësorë, të shprehur në pikën 3.b, të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Instituti i Shëndetit Publik, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit, Fakulteti i Shkencave Natyrore ose institucionet që do të përcaktohen me marrëveshje nga AMBU-ja, për të zbatuar programin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore (të përcaktuar me VKM-në respektive), të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e monitorimit të sasisë dhe të cilësisë së ujërave sipërfaqësore.

Për treguesit e fushës së monitorimit të nëntreguesve të stacioneve meteorologjike dhe karakteristikave të matjeve meteorologjike të shprehur në pikat 3.c dhe 3.d të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohet institucioni i IGJEUM-it, i SHMU-së, administratorët e HEC-ve ose/dhe institucioni që do të përcaktohet me marrëveshje nga AMBU-ja, për të zbatuar programin e monitorimit meteorologjik, në mbështetje të menaxhimit të burimeve ujore, të hedhin dhe përditësojnë të dhënat e monitorimit meteorologjik në Kadastër.

4. Mbrojtja e ujit *(Water protection)*

Për treguesit e fushës së mbrojtjes së burimeve ujore dhe të nëntreguesve respektivë, të shprehur në pikat 4.a, 4.b, 4.c, 4.d, 4.e, 4.f, 4.g, 4.h, 4.i të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohet AKZM-ja ose/dhe institucioni që do të përcaktohet me marrëveshje nga AMBU-ja, të hedhë dhe përditësojë të dhënat e burimeve ujore brenda zonave të mbrojtura natyrore, bazuar në identifikimin dhe kufizimin e tyre, sipas planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe në përputhje me planet e menaxhimit të baseneve ujore.

5. Përdorimi i ujit *(Water Usage)*

Për treguesit e fushës së përdorimit të burimeve ujore dhe të nëntreguesve të trupave ujorë, të shprehur në pikat 5.a, 5.b, 5.c të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e përdoruesve të burimeve ujore, sipas qëllimit të përdorimit dhe bazuar në planet e menaxhimit të baseneve ujore.

6. Struktura e ujit *(Water structure)*

Për treguesit e fushës së strukturës së burimeve ujore dhe të nëntreguesve të trupave ujorë, të shprehur në pikat 6.1 dhe 6.b të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (përfshirë institucionet e varësisë) dhe bashkitë, të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e strukturës së ujërave, sipas vendndodhjes së tyre dhe qëllimit të ndërtimit të këtyre strukturave në hapësirën gjeografike të baseneve ujore.

7. Topografia dhe toka *(Topographic & land)*

Për treguesit e fushës së topografisë dhe të kufizimit gjeohapësinor dhe të nëntreguesve respektivë të burimeve ujore, të shprehur në pikat 7.a, 7.b, 7.c, 7.d, 7.e të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja në bashkëpunim me ASIG-un, të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e topografisë dhe kufizimit gjeohapësinor të burimeve ujore.

III. STANDARDET E GJENERIMIT TË TË DHËNAVE SIPAS FUSHAVE TË KADASTRËS

Treguesit e sistemit të Kadastrës janë të dhëna që gjenerohen nga institucionet respektive, sipas fushave të përcaktuara në kadastër, si dhe në përputhje me standardet që janë përcaktuar në Programet Kombëtare të Monitorimit të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, të programit të monitorimit të elementeve hidrologjike dhe meteorologjike, si dhe në planet e menaxhimit të baseneve ujore dhe të zonave të mbrojtura brenda baseneve ujore.

IV. FREKUENCA E PËRDITËSIMIT TË TË DHËNAVE NË KADASTRËS

1. Frekuenca e përditësimit të të dhënave "statike", që lidhen me fushat: ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, koordinimi i stacioneve të monitorimit, mbrojtja e ujit, përdorimi i ujit, strukturat e ujit dhe topografia dhe toka *(surface water, groundwater, coordinations of monitorin stations, water protection, water usage, water strukture and topographic & land)*, është sipas periudhave kohore të përcaktuara në përputhje me kohën e rishikimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore, planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura, të periudhës së vlefshmërisë së të dhënave për përdoruesit e ujërave dhe strukturave të ndërtuara në burimet ujore, sipas planeve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

2. Frekuenca e përditësimit të të dhënave të monitorimit të sasisë dhe të cilësisë së trupave ujorë nëntokësorë dhe sipërfaqësorë e të treguesve meteorologjikë dhe hidrologjikë do të përcaktohen nga programet kombëtare të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe të elementeve meteorologjike dhe hidrologjike të miratuara për burimet ujore dhe që do të përcaktohen në marrëveshjet për popullimin me të dhëna të Kadastrës midis AMBU-së dhe institucioneve respektive të gjenerimit të këtyre të dhënave.

VENDIM
Nr. 1139, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË SIGURISË NË KOMUNITET 2021 – 2026 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021 – 2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimit 2021 – 2023, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E SIGURISË NË KOMUNITET 2021 – 2026

PËRMBAJTJA

PËRKUFIZIME
PJESA I - KONTEKSTI STRATEGJIK
1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

2. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike
3. Arritjet, Analiza dhe Sfidat
4. Vizioni dhe misioni
5. Metodologjia
PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË
POLITIKA 1 – RRITJA E PARAMETRAVE TË SIGURISË NË KOMUNITET
Objektivi specifik 1.1: Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin
Objektivi specifik 1.2: Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet
Objektivi specifik 1.3: Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit
POLITIKA 2 – ANGAZHIMI DHE NDËRVEPRIMI ME KOMUNITETIN
Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i komunikimit me publikun
Objektivi specifik 2.2: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve
Objektivi specifik 2.3: Rritja e mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për publike
POLITIKA 3 – REFORMIMI I SHËRBIMIT POLICOR DHE RRITJA E KAPACITETEVE PËR SIGURINË NË KOMUNITET
Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për Policimin në Komunitet
Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë
PJESA III – MASA PRIORITARE PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË
PJESA IV – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI
4.1 PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE
4.2 LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI
PJESA V – BUXHETI
ANEKSI 1. PLANI I VEPRIMIT 2021 – 2023
ANEKSI 2. PASAPORTA E INDIKATORËVE

SHKURTIMET

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
BE	Bashkimi Evropian
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPK	Departamenti i Policisë Kriminale
DKM	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
DSHM	Departamenti për Shërbimet Mbështetëse
DMN	Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DSP	Departamenti për Sigurinë Publike
DVP	Drejtoritë Vendore të Policisë
KVSP	Këshilli Vendor për Sigurinë Publike
MB	Ministria e Brendshme
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSPK/ SPZ	Ndihmës Specialist i Policimit në Komunitet
PK	Policimi në Komunitet
PSH	Policia e Shtetit
QEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
SCPA	Mbështetja e Qeverisë Suedeze për MB/DPPSH për forcimin e sigurisë në komunitet në Shqipëri
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ZP	Zona Policore
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

PËRKUFIZIME

Policim në Komunitet: Policimi në komunitet (PK) është një filozofi dhe strategji organizative e të vepruarit që fokusohet në krijimin e lidhjeve me komunitetin dhe i lejon policisë të punojë ngushtësisht me anëtarët e komunitetit, për të zgjidhur problemet e rendit dhe çështjet e sigurisë dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së gjithsecilit në komunitet;

Siguria e Komunitetit: Përdorimi i aftësive, njohurive dhe teknikave për të parandaluar dhe reduktuar kriminalitetin, për të fuqizuar sigurinë njerëzore dhe për zhvillimin e komuniteteve të sigurta në Shqipëri, përmes partneriteteve efikase dhe të qëndrueshme midis qytetarëve dhe institucioneve duke garantuar "lirinë nga frika" dhe "lirinë nga nevoja" të qytetarëve;

Komunitet/publik: Një term i gjerë që identifikon bashkësi njerëzish të cilët bashkëjetojnë në të njëjtën qendër banimi ose që kanë interesa të përbashkëta të të jetuarit, si: puna, shoqëria, bashkëjetesa e gjerë pa dallim etnie, race, feje, gjinie etj. Komuniteti/publiku përfshin gjithashtu bashkësi sociale si: grupet etnike, grupet e biznesit, organizatat kombëtare etj.;

Policia e Shtetit: Shërbim publik që përgjigjet për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës publike dhe private, parandalimin dhe zbulimin e krimit, zvogëlimin e frikës dhe dhënien e ndihmës për publikun;

Partneritet qeveri – publik: Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qeveritare, duke përfshirë edhe autoritetet e njësive të qeverisjes vendore, ndërmarrjet e shërbimit, bizneset e ndryshme, OJF etj., të cilët punojnë së bashku dhe shkëmbejnë burimet dhe ekspertizën e tyre me qëllim që të evidentojnë problemet, të vendosin prioritetet, dhe t'i zgjidhin këto probleme në mënyrë afatgjatë, duke luftuar shkaqet, si edhe pasojat;

Llogaridhënie e policisë: Proces pune, ku strukturat shtetërore dhe pushteti vendor raportojnë për zbatimin e detyrave të saj, para strukturave eprore, strukturave të institucioneve të tjera dhe para publikut. Llogaridhënia tregon se veprimtaria e policisë është e hapur për vëzhgim nga një sërë institucionesh mbikëqyrëse, përfshirë dhe publikun;

Parandalimi i krimit: Identifikimi i individëve ose komuniteteve në rrezik dhe ndërhyrja për të zvogëluar faktorët e rrezikut dhe/ose për të rritur faktorët mbrojtës;

Sjelljet antishoqërore: Janë veprime që dëmtojnë mirëqenien e të tjerëve ose çdo lloj sjellje që shkel të drejtat themelore të një personi tjetër dhe çdo sjellje që konsiderohet përçarëse ndaj të tjerëve në shoqëri.

PJESA I - KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 vjen si nevojë e rinovimit të Strategjisë së Rendit dhe Sigurisë Publike 2015 – 2020, dokumentit për Policimin në Komunitet 2018 – 2020, si dhe e një sërë strategjish dhe plan veprimesh të ndryshme të lidhura me çështje të sigurisë në komunitet, të cilat kanë përfunduar ose përfundojnë në vitin 2020.

Me fillimin dhe implementimin e procesit të decentralizimit, si dhe konceptit të sigurisë në komunitet, siguria publike tashmë ka pësuar një ridimensionim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit. Ky ridemensionim i ri i shërbimeve të të gjithë aktorëve në lidhje me sigurinë lidhet me zhvillimin e vendit në përgjithësi, si dhe me agjendës zhvillimore drejt anëtarësimit në BE. Kjo qasje e re do të materializohet në Strategjinë e re Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet, me anë të së cilës siguria në komunitet është përgjegjësi e të gjithë aktorëve përgjegjës në këtë fushë, që aplikohet në mënyrë demokratike dhe në përputhje me standardet dhe eksperiencat më të mira perëndimore.

Ky ridimensionim do të sjellë një gjithëpërfshirje të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, të cilat kanë detyrimin ligjor për garantimin e sigurisë në komunitet. Në këtë mënyrë, siguria publike nuk do të jetë më kompetencë vetëm e Policisë së Shtetit, duke shfrytëzuar qasjen e deritanishme vertikale në garantimin e rendit dhe sigurisë, por ky koncept tashmë do të jetë më demokratik dhe në rrafshin horizontal, duke bërë bashkë të gjithë aktorët institucionalë qendrorë dhe vendorë, institucionet ligjzbatuese, Policinë e Shtetit, qytetarët dhe komunitet, institucionet e tjera joqeveritare, forumet qytetare, bizneset, institucionet fetare, mediat etj., për të krijuar një kulturë të re të sigurisë publike.

Strategjia identifikon qartë përparësitë nëpërmjet politikave dhe objektivave strategjikë kombëtarë dhe përshkruan parimet udhëzuese që do të mbështesin përpjekjet ndërsektoriale për të siguruar sigurinë e publikut. Gjithashtu, kjo strategji, në planin e veprimit, siguron një organizim unifikues për të gjitha njësitë e qeverisjes dhe identifikon masa specifike për të drejtuar përparësitë tona kombëtare afatshkurtra për sigurinë e komunitetit dhe për të informuar procesin e alokimit të burimeve. Më e rëndësishmja, ajo krijon një themel për ndërtimin dhe nxitjen e mjedisit bashkëpunues në të cilin qeveria dhe qytetarët dhe komuniteti mund të kryejnë përgjegjësitë e tyre përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes në mënyrë më efektive.

Skema e mëposhtme paraqet vizionin e strategjisë, bazuar në objektivat e dokumenteve strategjikë, të përmendur në seksionin 2, të këtij dokumenti, si prioritetet e përcaktuara nga analiza e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe analiza të tjera në të cilat janë përcaktuar tri politikat për vitet 2021 – 2026.

2. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e sigurisë publike. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe prioritetet e Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, krijimi i kushteve për një jetë më të sigurt për qytetarët, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për fuqizimin e sigurisë publike, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me qytetarët në këtë drejtim.

Kuadri ligjor për sigurinë publike është i gjerë dhe përfshin një tërësi ligjesh, aktesh nënligjore, që përbëjnë bazën e nevojshme rregullatore për këtë fushë, të tilla si:

- ligji nr. 108/2014, datë 31.7.2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar;
- ligji nr. 103/2014, datë 31.7.2014, "Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë";
- ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- projektligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";
- ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar me ligjin nr. 47/2018 dhe nr. 125/2020;
- ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- ligji nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë" etj.

Ky dokument strategjik është i ndërlidhur, kontribuon dhe është bazuar në parimet që rrjedhin nga këto dokumente strategjikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si më poshtë:

- programi qeverisës për periudhën 2017 – 2021;

- lidhja me PKIE-n dhe legjislacionin e BE-së (kapitulli 24 – Drejtësia, liria dhe siguria, nënkapitulli: Bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar). Kjo strategji nuk përafron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përafrimin me *acquis communauitaire* të BE, për fushën e rendit dhe sigurisë publike;

- dokumenti për Policimin në Komunitet dhe Plani i Veprimit 2018 – 2020, miratuar me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 654, datë 10.12.2018;
- programi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 632, datë 27.1.2020, për zbatimin e dokumentit të Policimit në Komunitet;
- "Strategjia e Rendit Publik dhe Planit të Veprimit, 2015 – 2020";
- "Plani Kombëtar Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, 2018 – 2020", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 313, datë 31.5.2018;
- "Strategjia Ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013 – 2020" dhe plani i veprimit operacional;
- "Strategjia Ndërsektoriale për decentralizimin dhe vetëqeverisjen vendore, 2015 – 2020" (VKM-ja nr. 691, datë 29.7.2015);
- rekomandimet e KE-së;
- "Strategjia Kombëtare për Sigurinë Rrugore 2011 – 2020", miratuar me VKM-n nr. 125, datë 23.2.2011;
- "Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit", miratuar me VKM-n nr. 930, datë 18.11.2015;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
- Konventa për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve,
- Konventa e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Karta Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Karta Evropiane e Autonomisë Lokale etj.

Politikat dhe objektivat specifikë të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe Plani i Veprimit 2021 – 2023, janë gjithashtu në përputhje me disa prej **Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe Agjendës 2030, respektivisht:**

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe; 3.6 të përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe i plagosjeve nga aksidentet rrugore.

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave; 5.1 T'i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave; 5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe

shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit; 5.3 Të eliminohen të gjitha praktikat e dëmshme siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme dhe martesat e detyruara dhe gjymtimi gjenital femëror; 5.5 Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe dhënia e mundësive të barabarta për udhëheqjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.

Objektivi 11: Ndërtimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të parrezikshme, rezistente dhe të qëndrueshme; 11.2 Të sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve; 11.5 Të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe numri i njerëzve të prekur nga fatkeqësitë dhe të ulen ndjeshëm humbjet ekonomike të drejtpërdrejta, lidhur me prodhimin e brendshëm bruto në nivel global, të shkaktuara nga fatkeqësitë, përfshirë dhe fatkeqësitë që lidhen me ujin, me fokus mbrojtjen e shtresave të varfra dhe të njerëzve në gjendje të pambrojtur; 11.6 Të zvogëlohet ndikimi negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera.

Objektivi 16: Paqe, drejtësi, institucione të forta; 16.1 Kudo të zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës; 16.6 Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet; 16.10 Të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare; 16.a Të fuqizohen institucionet përkatëse kombëtare, përfshirë edhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

3. Arritjet, analiza dhe sfidat

Arritjet

Situata e sigurisë dhe e rendit publik në vend është përmirësuar rrënjësisht në katër vitet e fundit. Shqipëria është sot një vend më i sigurt për të gjithë ata që jetojnë në territorin e saj, për jetën, bizneset dhe pronat e tyre, për investimet e huaja dhe turistët që e vizitojnë atë.

Në fokus të Planit të Veprimit 2018 – 2020, të Strategjisë së Rendit dhe Sigurisë Publike, 2015 – 2020 ka qenë ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme, ndërveprimi dhe besimi ndërmjet komunitetit dhe policisë. Në këtë kuadër u finalizua një strategji gjithëpërfshirëse ndërsektoriale për sigurinë në komunitet, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Zbatimi i kësaj strategjie u konkretizua dhe me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë në Komunitetit.

Forcimit të policimit në komunitet po i shërbejnë edhe politikat gjithëpërfshirëse në këtë drejtim, të Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Brendshme, si dhe ndihma e donatorëve të ndryshëm nëpërmjet programeve mbështetëse. Programi Suedez "Forcimi i Policimit në Komunitet" (SCPA) ka qenë një partner kyç i cili ka nxitur këtë proces. Pas ndryshimeve strukturore të miratuara, janë krijuar dhe funksionojnë strukturat për policimin në komunitet në nivel qendror dhe vendor (sektorët dhe seksionet e policimit në komunitet).

Në këtë drejtim, me miratimin e akteve të ndryshme nënligjore, si urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, janë miratuar përmes asistencës së SCPA-së, përshkrimet e reja të punës së Ndihmës Specialistëve të Policimit në Komunitet (NSPK), është krijuar struktura e NSPK-së për edukimin në institucionet arsimore parauniversitare, të cilët janë trajnuar dhe asistuar në punën e tyre nga SCPA-ja. Gjithashtu asistenca e SCPA-së ka qenë e rëndësishme për rishikimin dhe përshkrimin e ri të punës, të miratuar për Patrullën e Përgjithshme.

Në këtë kuadër, Programi ka kontribuar gjithashtu për **fuqizimin e filozofisë së policimit në komunitet në Shqipëri** përmes një sërë nismave me të rinjtë.

Një prej prioriteteve, në drejtim të ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme, ndërveprimit dhe fuqizimit të besimit të komunitetit në Policinë e Shtetit, ka qenë vënia në eficiencë të plotë e zonave policore. Policia e Shtetit, me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë është angazhuar për vënien në eficiencë të plotë të Zonave Policore, për

t'i transformuar në mekanizmat kyç dhe efikas të filozofisë së policimit në komunitet. Për këtë, po punohet me asistencën e Programit Suedez të Policimit në Komunitet, në DVP pilot të Elbasanit, për zbatimin dhe implementimin e detyrave të reja të NSPK-ve dhe Patrullës së Policisë sipas zonave policore.

Në fokus të Planit të Veprimit 2018 – 2020 ka qenë dhe **rritja e ndërgjegjësimit të publikut për parandalimin e veprave penale të lehta dhe sjelljeve antishoqërore**. Kjo është realizuar nëpërmjet intensifikimit të programeve të edukimit publik në institucione arsimore parauniversitare përmes bashkëpunimit efektiv me institucionet e arsimit dhe organizatat e shoqërisë civile. Janë zhvilluar një sërë fushatash ndërgjegjësuese në lidhje me parandalimin e veprave penale dhe sjelljeve antishoqërore, veçanërisht radikalizmit dhe përfshirjes në krime të të miturve dhe të rinjve, si dhe takime në institucionet arsimore parauniversitare me nxënës e studentë për informimin lidhur me pasojat nga përfshirja në veprimtari kriminale, si dhe janë shpërndarë materiale ndërgjegjësuese të përshtatura sipas fokus grupeve të veçanta. Gjithashtu, me punonjësit e policisë, të caktuar për zbatimin e këtij programi, janë zhvilluar trajnime për programin sensibilizues dhe për sigurinë rrugore.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së procesit të organizimit, funksionimit dhe fushës së veprimit të policimit vullnetar. Për implementimin në praktikë të policimit vullnetar është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 641, datë 2.10.2019, **"Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar"**, si dhe urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1403, datë 19.11.2019, për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e këtyre akteve nënligjore, gjatë periudhës janar – mars 2020.

Reformimi i strukturave dhe funksionimit të Policisë së Shtetit me fokus në reformën e personelit, rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin në kohë të informacionit policor, mbështetjes logjistike dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit të publikut, si dhe përmirësimet në drejtim të transparencës, digjitalizimit të shërbimeve të policisë, shërbimit ndaj qytetarit, si dhe trajtimit financiar, ekonomik dhe logjistik konsiderohen arritje të dukshme dhe të prekshme.

Organizimi i ri i Policisë së Shtetit synoi ristrukturimin dhe **konsolidimin e vazhdueshëm të të gjithë sistemit duke thjeshtuar strukturat, ridimensionuar përgjegjësitë** për çdo funksion e pozicion pune, duke shtuar ngarkesën e punës dhe fuqizuar kompetencat, duke përmirësuar raportet dhe procedurat standarde të punës, duke rivlerësuar personelin sipas vlerave dhe meritokracisë së punonjësve, si dhe duke ngritur mekanizma që garantojnë komunikimin e bashkëpunimin ndërinstitucional efektiv me aktorët e tjerë të sigurisë.

Në këtë kuadër, ndryshimet organizative të realizuara janë fokusuar në:

- Modelimin dhe fuqizimin e njësive vendore (komisariateve/stacioneve të Policisë), duke u ngarkuar të gjithë përgjegjësinë për kontrollin e territorit, mbrojtjen e zbatimit të ligjit dhe luftën kundër krimit, si dhe duke kompletuar strukturat me kapacitet e nevojshme për kryerjen e detyrave;
- Riformatimin e strukturave dhe shërbimeve policore përgjegjëse që do të ndjekin drejtime e forma të veçanta të krimit, nga niveli i drejtorisë së policisë vendore deri te strukturat qendrore, të përgjegjësive, raporteve dhe procedurave të punës së tyre;
- Organizimin e strukturave të veçanta për të ndjekur disa forma të veçanta të krimit (vrasjet, veprat terroriste, trafiqet, drogat, pastrimi i parasë, krimi kompjuterik, korrupsioni nga funksionarët e lartë, etj.), të cilat kanë veçori e vështirësi për t'u zbuluar e dokumentuar, duke përdorur parimet profesionale dhe përvojën e vendeve perëndimore.

Në fokus ka qenë **formimi dhe kualifikimi i punonjësve të policisë**, ku një ndihmesë të veçantë ka dhënë vënia në funksionim të plotë e Akademisë së Sigurisë (AS) së Policisë së Shtetit. Në këtë kuadër janë realizuar një sërë masash, duke miratuar akte nënligjore si: vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 25.2.2015, "Për organizimin dhe funksionimin e AS"; Statuti i Akademisë së Sigurisë me urdhrin e përbashkët nr. 490, datë 21.9.2015, nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe ministri i Brendshëm etj.

Për zhvillimin e personelit akademik, të aftë për të gjeneruar dhe shpërndarë njohuri bashkëkohore të fushës së policimit dhe sigurisë publike, në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore, janë kryer si më poshtë:

- përcaktimi i procedurave të rekrutimit të personelit akademik në "Rregulloren e Akademisë së Sigurisë", në zbatim të LAL;

- përfundimi i aplikacionit për aplikimet për punësim në Akademinë e Sigurisë, që mundëson miradministrimin e procesit të punësimit të studentëve ekselentë;

- përmirësimi i sistemit të librarisë elektronike me funksionalitete shtesë.

Për zhvillimin profesional e akademik të personelit trajnues dhe mësimdhënës të Akademisë, janë zhvilluar një numër trajnimesh, si dhe janë ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi për shkëmbimin e përvojave mësimdhënëse me Universitetin e Tiranës (1 trajnim, 20 pjesëmarrës) dhe Aleancën Franceze (1 trajnim me 22 pjesëmarrës nga stafi akademik). Rekrutimi i personelit mësimdhënës bazohet në ligjin për Arsimin e Lartë, ligjin e Policisë së Shtetit dhe "Rregulloren e Akademisë".



Grafiku 1: Kurse për oficerët e trajnimit në terren

Gjithashtu, **arritje janë shënuar në drejtim edhe të rritjes së kapaciteteve operacionale dhe drejtuese** të Policisë së Shtetit, nëpërmjet specializimeve sipas fushave të veprimtarisë policore, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit efektiv me institucionet e tjera të arsimit të lartë publik dhe jopublik, me organizma ndërkombëtarë këshillues të PSH-së (ICITAP dhe PAMECA), janë ndërmarrë një sërë nismash si:

- nënshkrimi i marrëveshjes me Akademinë e Forcave të armatosura të RSH-së, për shkëmbim eksperiencash në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor (2017);

- nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit apo memorandumeve të mirëkuptimit të Akademisë së Sigurisë me Akademitë e Sigurisë së Austrisë, Hungarisë, CEPOL, Malit të Zi, FRONTEX, Kosovës, Estonisë etj.;

- anëtarësimi në shoqatën ndërkombëtare të drejtorëve të akademive "IADLEST" me qendër në SHBA, për standardet e trajnimit;

- anëtarësimi në Shoqatën e Kolegjeve të Policisë Evropiane (AEPC);

- fuqizimi i bashkëpunimit me akademitë e vendeve të rajonit në fushën e kërkimit shkencor me pjesëmarrje dhe referime të ndërsjella në konferencat shkencore për tematika të ndryshme policore;

- botimi periodik i revistës shkencore policore "Policimi dhe siguria".

Në kuadër të ofrimit të sigurisë publike, për implementimin e plotë të ligjit *"Për masat shtesë të sigurisë",* është ndjekur procesi për miratimin e akteve nënligjore, si më poshtë:

- VKM-ja "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit midis administratorëve të ndërtesave të banimit, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit";

- udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për ngritjen dhe funksionimin e një regjistri, si bazë të dhënash qendrore apo vendore, në të cilën regjistrohen subjektet që sipas ligjit, marrin masa shtesë të sigurisë publike".

Gjithashtu, janë bërë përpjekje për **përafrimin e legjislacionit dhe organizimit të policisë me atë të BE-së**, duke u fokusuar në ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në legjislacion, akte nënligjore, organizim dhe funksionim të policisë, për ta përshtatur atë më mirë me faktorët e mjedisit e nevojat e komunitetit dhe përafruar me standardet e shërbimit policor të BE-së.

Gjatë viteve 2018 – 2020, masat u fokusuan në **ndryshimin cilësor të sistemit të kontrollit të territorit dhe policimit në komunitet, në funksion të parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit,** i cili paraqitet si më poshtë:



Analiza në nivel vendor

Çështjet e sigurisë publike aktualisht trajtohen në rrafshin vertikal, ku aktori i vetëm "*de facto*" përgjegjës për garantimin e tij është Policia e Shtetit. Ky fakt ka sjellë një mbingarkesë në zbatimin e detyrimeve nga ana e Policisë së Shtetit, si dhe një problematikë tjetër që lidhet me mosfunksionimin adekuat të këshillave vendorë të sigurisë publike, të cilët shërbejnë si mekanizëm i mirëfilltë konsultimi dhe vendimmarrje për çështjet e sigurisë në nivel vendor. Fuqizimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë është një faktor kyç në rritjen e efikasitetit të institucioneve qendrore dhe vendore në parandalimin dhe trajtimin e kriminalitetit, dhunës, bulizmit, diskriminimit, ngacmimeve dhe fenomeneve të tjerë problematike për qytetarët.

Një prej risive më të mëdha në nivel vendor për fuqizimin e sigurisë publike kanë qenë Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP). Këto struktura janë ngritur bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Mbi vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Strategjinë Kombëtare të Rendit Publik (2015 – 2020), Strategjinë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, si dhe në aktet përkatëse nënligjore. Këshillat kanë filluar të krijohen në fund të vitit 2016, fillimisht në bashkitë e Elbasanit dhe Librazhdit.

Aktualisht, falë mbështetjes së vazhdueshme të OSBE-së, Komisionit Evropian, USAID-it, SIDA-s dhe Ambasadës Holandeze, KVSP-të janë ngritur në disa bashki të vendit, por jo të gjitha funksionojnë apo kryejnë veprimtari rregullisht. Procesi i ngritjes së KVSP-ve në Shqipëri nuk është shoqëruar me akte ligjore ose nënligjore dhe nuk ka zyra ose zyrtarë të ngarkuar me përgjegjësi, si në nivel shtetëror ashtu dhe në nivel vendor. Në mungesë të kuadrit rregullues, bashkitë kanë përshtatur rregulloret që u janë prezantuar nga organizatat e ndryshme mbështetëse (shiko më sipër). Në shumë bashki, rregulloret janë miratuar nga kryetarët e bashkive, në disa nga vetë KVSP-të dhe në disa raste janë miratuar nga këshilli bashkiak. Rregulloret marrin referenca nga ligji nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe ligji nr. 108/2015, "*Për Policinë e Shtetit*", sidoqoftë, asnjë nga këto ligje nuk ka parashikime të veçanta për ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve.

Forcimi i rendit dhe i sigurisë publike përbën një detyrim madhor të përhershëm. Puna për përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes dhe të treguesve në fushën e rendit publik krijon kushtet

për jetën normale të qytetarëve, rrit nivelin e sigurisë publike, forcon lidhjet me qytetarët dhe kontribuon ndjeshëm në krijimin e një mjedisi të vështirë për të gjitha llojet e veprimtarive kriminale. Tabela më poshtë pasqyron treguesit e punës për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, si dhe të dhëna deri për 9-mujorin e vitit 2020.

Tabela 1: Treguesit e punës së NSPK-ve

Nr.	Indikatorët e punës së NSPK-ve	Viti 2019	Viti 2018	Krahasimi 2019 – 2018	Viti 2020 9 mujori
1	Kapur autorë të veprave penale, në flagrancë	2576	2941	-365	2241
2	Kapur autorë të veprave penale, në kërkim	745	689	+56	436
3	Informacione SK2, të regjistruara	16938	15390	+1548	12269
4	Raporte të ngjarjes	8259	7703	+556	6265
5	Persona të shoqëruar në polici	17267	17382	-115	13078
6	Kontrolle të ushtruara	172477	148809	+23668	232868
7	Armë pa leje të kapura/bllokuara	146	316	-170	109
8	Mbështetje të institucioneve të tjera	20683	16647	+4036	9288
9	Konflikte të evidentuara/trajtuara	30835	35567	-4732	21888
10	Takime të zhvilluara	155175	141596	+13579	123817

Analiza e veprave penale të kryera gjatë vitit 2020

Veprat penale të kryera në lidhje me armëmbajtjen pa leje, ndërtime të paligjshme, dhunën në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe vepra penale në lidhje me rendin dhe sigurinë publike:

- evidentuar gjithsej **7628** vepra të tjera penale, nga të cilat janë zbuluar **7324**, ose **96%** tyre. Në krahasim me 10-mujorin e vitit 2019 janë evidentuar **186** më pak ose **6.40%** vepra penale më pak;

- evidentuar **3240** vepra penale për armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, vepra penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit janë zbuluar **3138** ose **96.85%** e tyre. Në krahasim me 10-mujorin e vitit 2019 ku janë evidentuar **3426** vepra penale për armëmbajtje pa leje, ndërtime të paligjshme, vepra penale kundër punonjësve të policisë dhe autoriteteve të shtetit, janë evidentuar **186** vepra më pak ose **5.4%** vepra penale më pak.

Vepra penale ndaj dhunës në familje

- Evidentuar gjithsej **1289** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **1289,** ose **100%** tyre. Në krahasim me 10-mujorin e vitit 2019 janë evidentuar **143** më shumë ose **12.48%** vepra penale më shumë.

Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor

- Evidentuar gjithsej **4433** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **4219,** ose **95.2%** e tyre. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rezultojnë **283** vepra penale më pak ose **6.0%** vepra penale më pak.

Rendi dhe siguria publike

- Telefonata nga publiku gjithsej **541276** ose **104%** më shumë se e njëjta periudhë krahasuar me vitin e kaluar. Indikatori për vitin: 7**%** realizuar në masën **97% ose 13.4 herë më shumë**;

- Në portalin "Komisariati Digjital", janë evidentuar **38852** njoftime nga publiku ose **3.9%** më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.[128] Indikatori për vitin: 7**%** realizuar në masën **60%;**

- Aksidente rrugore me pasoja të rënda **153** raste, ose **29** raste më pak ose **15.4%** më pak;

- Për menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme për sigurimin e rendit publik, janë kryer **6227** aktivitete/shërbime/mbështetje, ose rreth **29.5%** më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Parandalimi dhe zhvillimi alternativ

Në qasjen parandaluese të kriminalitetit (qasje e cila mbizotëron në të gjitha policitë demokratike të

[128] *Albania 2020 Report Communication on EU Enlargement Policy.*

botës perëndimore), koncepti i aksesit në siguri, nga të gjithë aktorët është jo vetëm i domosdoshëm por edhe i nevojshëm, duke marrë parasysh ndërlikimin e sfidave dhe ndarjen e përgjegjësive nga aktorë të ndryshëm. Në këtë kuadër, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me institucione të tjera, do të jetë në pararojë dhe do të luajë një rol të rëndësishëm në inicimin dhe ndërtimin e një sistemi funksional dhe efektiv, parandalimi e ndërgjegjësimi, me të gjitha kategoritë vulnerabël, si viktimat e dhunës në familje, në shkollë, të miturit, përdoruesit e drogës, apo edhe kategori të tjera, viktima dhe persona të varur nga fenomene kriminale. Krijimi i sistemit të referimit për kriminalitetin dhe prirjet ekstremiste sidomos për moshat e reja dhe puna e vazhdueshme me këto kontigjente, vlerësohet si mekanizmi i duhur parandalues.

Reformimi i Policisë Bashkiake

- Strukturat e Policisë Bashkiake, si një organ ekzekutiv në nivel lokal dhe me rol të rëndësishëm në garantimin e rendit dhe të qetësisë publike, duhet të rishikojnë mënyrën e organizimit të tyre, funksionimin dhe nivelin e ndërveprimit me struktura të tjera qendrore të sigurisë, si ato të Policisë së Shtetit, si dhe të përmirësojnë cilësinë e personelit të rekrutuar dhe menaxhimin e tij. Ndër masat kryesore në këtë drejtim është rishikimi i ligjit "Për Policinë Bashkiake", i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura. Po kështu, do të punohet për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe bashkëpunimin e ndërvarësisë me strukturat e Policisë së Shtetit.

Efektiviteti i qarkullimit rrugor dhe ulja e aksidenteve

- Ndryshimet e dëshiruara synojnë krijimin e një edukate dhe sjelljeje korrekte të qytetarëve në drejtimin dhe përdorimin e automjeteve, si dhe ndërgjegjësimin e publikut për sjelljen në rrugë. Angazhimi i strukturave përgjegjëse të transportit rrugor dhe ato të rrugëve në monitorimin dhe menaxhimin e trafikut, duhet të jetë pjesë e punës koordinuese të strukturave të policisë në interes të rritjes së sigurisë rrugore. Përveç punës për ndërtimin e rrugëve, këto struktura duhet të ndjekin problematikën që paraqet cilësia dhe siguria e tyre, ngarkesa e trafikut dhe aspekte të lirshmërisë së qarkullimit. Për këtë qëllim, duhet që sa më parë të krijohet Qendra Operacionale e Qarkullimit Rrugor, e cila të mbledhë dhe të përpunojë të gjithë informacionin për qarkullimin rrugor në vend dhe të bëjë optimizimin e tij në mënyrë të përhershme.

Kjo qendër do të konceptohet dhe ndërtohet si një përpjekje e përbashkët e strukturave të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të lartpërmendura, do të miratohet dhe do të fillojë zbatimi i "Planit të Veprimit Policia Rrugore 2030", i cili do të parashikojë masa të gjithanshme për përmirësimin e kuadrit ligjor e rregullator, përmirësime organike, rritjen e profesionalizmit në radhët e Policisë Rrugore, komunikimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, mbështetjen teknologjike në shërbim të sigurisë rrugore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Pritshmëritë në këtë drejtim do të jenë menaxhimi bashkëkohor i trafikut rrugor dhe garantimi maksimal i sigurisë rrugore krahasuar me standardet evropiane.

Kontrolli dhe administrimi i territorit

- Kontrolli i plotë i territorit, në funksionon të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera me përgjegjësi në këtë drejtim. Rezultatet e arritura dhe përvoja e fituar në menaxhimin e vijës bregdetare dhe të hapësirave të plazhit tregojnë për mundësitë dhe hapësirat e shumta që ekzistojnë për një administrim më të mirë të territorit.

- Bashkëpunimi ndërmjet strukturave dhe institucioneve të ndryshme, por edhe ndarja e qartë e përgjegjësive ndërmjet Policisë së Shtetit, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), prefektëve dhe organeve të qeverisjes vendore do të luajë rol të rëndësishëm në përmbushjen e kësaj përgjegjësie. Në këtë kuadër, me prioritet do të vlerësohet mënyra e organizimit dhe e integrimit të tyre në një strukturë funksionale dhe efikase, si dhe ndërtimi i një bashkëpunimi të frytshëm me Policinë e Shtetit. Hartimi dhe zbatimi i një kuadri të plotë nënligjor e procedural për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit do të jetë i një rëndësie të veçantë.

- Inspektoratet të organizojnë kontrollin e të gjithë territorit të vendit për ndërtime të paligjshme, por me fokus të veçantë në objekte me rëndësi kombëtare, të standardizojnë punën, bashkëpunimin dhe veprimtarinë e inspektorateve të mbrojtjes së territorit në njësitë e qeverisjes

vendore, si dhe të vlerësojnë performancën e tyre në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Reforma territoriale

- Objektivi i përgjithshëm i reformës dhe i ndryshimeve ligjore është krijimi i një sistemi efikas për dhënien e shërbimeve sa më efektive e cilësore për qytetarët dhe për mirëqenien e komuniteteve, nëpërmjet ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të bashkive. Ligji i ri u mundëson bashkive të përmbushin funksionet e mëposhtme:

• Infrastruktura dhe shërbimet publike;
• Shërbimet sociale;
• Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese;
• Mbrojtja e mjedisit;
• Bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat publike, natyra dhe biodiversiteti;
• Zhvillimi ekonomik vendor;
• Siguria publike.

Rendi dhe Siguria në nivel vendor

- Në hierarkinë e nevojave bazike që kanë qytetarët, ato për rendin dhe sigurinë publike vijnë menjëherë pas atyre fiziologjike (strehim, ushqim, ujë, veshmbathje). Rëndësia e këtyre nevojave kërkon rrjedhimisht vëmendjen e bashkive për t'u mundësuar qytetarëve siguri, si në përditshmëri, ashtu dhe në situata të jashtëzakonshme. Në qytetet ku mbizotëron rendi dhe qetësia publike edhe mundësitë e zhvillimit, modernizimit dhe përthithjes së investimeve janë shumë më të mëdha. Njësitë e vetëqeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin, përballimin dhe rimëkëmbjen nga situatat që krijohen nga fatkeqësi natyrore apo emergjenca civile të shkaktuara nga faktorë natyrorë, apo nga vetë njerëzit. Në përmbushjen e këtij roli bëjnë pjesë: krijimi i fondeve të mjaftueshme financiare për përballimin e situatave të tilla dhe për të ndihmuar banorët e dëmtuar, ngritja dhe funksionimi i strukturave për menaxhimin e këtyre situatave, mobilizimi i publikut dhe vullnetarëve për trajtimin dhe eliminimin e pasojave, si dhe funksionimi i sistemeve paralajmëruese në komunitet me qëllim shmangien apo minimizimin e rreziqeve.

- Bashkitë kanë kompetenca ligjore, që me anë të akteve të nxjerra, të parashikojnë veprimet që përbëjnë kundërvajtje administrative, si dhe të marrin masa parandaluese, detyruese e ndëshkuese për kundërvajtësit. Kuadri ligjor ekzistues u mundëson bashkive ngritjen dhe organizimin e shërbimeve të rendit dhe sigurisë publike, gjë që bën të mundur marrjen e masave administrative ndaj kundërvajtësve dhe parandalimin e veprimeve të tyre.

Sfidat

Problemet të cilat ndikojnë në sigurinë në komunitet, që nga aktet kriminale në fushën e sigurisë në komunitet e deri te problemet e funksionimit të mekanizmave relevantë në këtë fushë, janë një ndër sfidat kryesore për shtetin dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

Siguria dhe ruajtja e rendit publik mund të përmirësohen nëpërmjet ndërmarrjes së masave të mëposhtme:

- parandalimit të veprave penale dhe krimeve të tjera, duke u udhëhequr nga filozofia e "Policimit në komunitet", përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me komunitetin dhe organet e vetëqeverisjes vendore;

- sigurimit të ligjshmërisë në territor dhe një marrëdhënie të re me biznesin, komunitetin në tërësi dhe shoqërinë civile në funksion të garantimit të sigurisë së qytetarëve;

- përmirësimit të menaxhimit të qarkullimit rrugor, me synim minimizimin e aksidenteve; parandalimit dhe përballimit të situatave emergjente;

- marrjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse dhe koordinimit më të mirë të mekanizmave në nivel qendror dhe vendor si p.sh: krijimi, forcimi dhe institucionalizimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, ridimensionimi i rolit të prefektit për menaxhimin dhe koordinimin e kontrollit në territor dhe forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile në nivel kombëtar dhe vendor.

Në vitet e fundit, përmes një qasje më metodike ndaj policisë, policia po kërkon gjithnjë e më shumë një shpërndarje sa më racionale të përgjegjësive bazuar në një ekzaminim të hollësishëm të aspekteve të ndryshme të veprimtarisë së policisë. Me nisjen dhe implementimin e procesit të decentralizimit, si dhe konceptit të policimit në komunitet, siguria publike tashmë ka pësuar një ridimensionim në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, e cila tashmë do të synojë një përfshirje të institucioneve qendrore dhe vendore, të cilat kanë detyrime për çështjet e rendit publik.

Me gjithë parashikimet ligjore, bashkëpunimi ndërmjet strukturave vendore të policisë, pushtetit

vendor dhe degëve vendore të institucioneve publike, nuk ka qenë në nivelin e pritshmërive. Po ashtu me gjithë angazhimin e PSH-së, ka pasur një përgjigje të vakët të institucioneve të tjera për të thelluar bashkëpunimin. Strategjitë vendore të sigurisë në komunitet rrallë janë konsultuar me partnerët lokalë dhe edhe më rrallë partnerët lokalë kanë ndërmarrë hapa konkrete për rritjen e sigurisë publike, duke koordinuar veprimet me PSH-n.

Këshillat Vendorë për Sigurinë Publike, megjithëse janë krijuar formalisht në disa bashki, nuk kanë pasur asnjë efekt praktik dhe gjenden ende larg pritshmërisë për të funksionuar si forume të diskutimit për çështjet e sigurisë vendore dhe të planifikimit të përbashkët të burimeve në dispozicion. Po ashtu, nuk është realizuar përfshirja e komunitetit në kryerjen e shërbimeve policore të kontrollit të territorit, nëpërmjet aplikimit të praktikës së vullnetarizmit për problemet e sigurisë në komunitet.

Çështjet që lidhen me përgjegjësinë e ndarjes së informacionit dhe koordinimit me institucionet e tjera do të adresohen nëpërmjet forcimit të ligjit dhe përmirësimit të kapaciteteve institucionale, si dhe llogaridhënies.

Siguria është një e mirë publike aq e rëndësishme dhe e ndërlikuar, sa që ajo nuk mund të krijohet vetëm me kapacitetet e kufizuara të Policisë së Shtetit, kësisoj bashkëpunimi me qytetarët është parakusht i padiskutueshëm.

Legjislacioni i PSH-së do të vazhdojë të pasurohet për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të sigurisë dhe për t'u përafruar me atë të BE-së, duke konsideruar aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe veprimtarinë e Policisë.

Sfidë mbetet parandalimi i aksidenteve rrugore si një emergjencë kombëtare që përqendrohet te zbatimi i masave specifike me objektiv grupet, aktivitetet, sjelljet apo zonat me rrezikshmëri të lartë për aksidente, duke përsosur planifikimin dhe organizimin e shërbimeve në funksion të sigurisë në rrugë, efektshmërinë në shërbime, bashkëpunimin me aktorë të tjerë shtetërorë që kanë përgjegjësi kryesore dhe shoqërisë civile, si dhe rritja e fuqisë shtrënguese të ligjit ndaj shkelësve. Një punë specifike është bërë në kuadër të rritjes së parametrave të sigurisë rrugore, duke zbatuar masa konkrete për parandalimin e aksidenteve.

Gjatë viteve 2016 – 2018 policia rrugore u riorganizua, ku është implementuar sistemi i tabletave digjitale (250 njësi). Impakti i futjes së tyre në përdorim, përveç lehtësimit të punës në plotësim dhe verifikim në kohë reale të mjeteve, drejtuesve të mjeteve, alerteve të ndryshme ka qenë dhe identifikimi dhe kapja e shumë personave në kërkim në Tiranë, Durrës, Lezhë, Elbasan, Vlorë dhe në disa raste edhe të mjeteve të vjedhura, etj. Drejtoria e Policisë Rrugore ka draftuar projektin "*Detyra e projektimit për sistemin SENSOR*", një projekt i integruar për monitorimin e akseve rrugore me kamera, radarë dhe me ANPR dhe targa RFID, projekt i cili është në pritje të financimit.

Në shkallë vendi, për vitin 2020, nga 346 zyra policore të planifikuara për t'u hapur pranë njësive administrative, janë hapur 236 zyra, nga të cilat 180 janë funksionale dhe mbeten për t'u hapur 110 zyra. Këto zyra janë të pajisura me pajisjet bazë për punë, por sfidë ngelen pajisjet teknologjike të përparuara si: kompjuter, printer, etj.

Me qëllim arritjen e një standardi të policimit, si dhe krijimit të një baze të shëndoshë zhvillimi për të ardhmen është i nevojshëm vijimi i reformimit të Policisë së Shtetit, që mund të realizohet nëpërmjet:

- infrastrukturës ligjore e organizative dhe përafrimit me standardet e BE-së;
- standardeve profesionale dhe qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore të policisë;
- kushteve të punës dhe teknologjisë së shërbimit policor.

4. Vizioni dhe misioni i strategjisë

Vizioni

Për të mundësuar një komunitet sa më të sigurt, nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve institucionalë në nivel qendror dhe vendor, publik dhe privat, bazuar në partneritet, profesionalizëm, komunikim, transparencë dhe respekt të vlerave thelbësore.

Vizioni i dokumenti lidhet edhe me "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015 – 2020", kapitullin "Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës", e lidhur më konkretisht me këta tregues, si më poshtë:

- ulja e sjelljeve antisociale dhe krimit të rrugës deri në 2020, kryesisht e veprave penale kundër pronës;
- përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe rritja e besimit të publikut;

- përmirësimi i parametrave të sigurisë në rrugë deri në 2020, në përputhje me Vizionin Zero të BE-së;

- rritja e standardeve të menaxhimit të burimeve njerëzore, e trajnimit, mjeteve të policisë, shërbimeve logjistike dhe monitorimit të buxhetit.

Misioni

Krijimi i një mjedisi sa më të sigurt për komunitetin, për të mbrojtur jetën dhe pronën, duke ofruar shërbime, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët në fushën e sigurisë, agjencitë e sigurisë publike, komunitetin, si dhe subjekteve të tjera publike dhe private. Kjo strategji synon të mbrojë dhe t'i shërbejë kërkesave të qytetarëve për një jetesë më të qetë, të sigurt dhe me vlera demokratike për të gjithë komunitetin.

Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë sigurimin e rendit publik, duke i shërbyer interesit publik me paanësi dhe duke mundësuar krijimin e një komuniteti, ku të gjithë ndihen të sigurt në mjedisin ku jetojnë.

Kjo strategji ndërsektoriale ka si mision krijimin e një mjedisi sa më të sigurt për komunitetin, për të mbrojtur jetën dhe pronën, duke ofruar shërbime, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët në fushën e sigurisë, agjencitë e sigurisë publike, komunitetin, si dhe subjekteve të tjera publike dhe private. Strategjia synon të mbrojë dhe t'i shërbejë kërkesave të qytetarëve për një jetesë sa më të qetë, të sigurt dhe me vlera demokratike për të gjithë komunitetin.

Në funksion të këtij misioni janë hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë sigurimin e rendit publik, duke i shërbyer interesit publik me paanësi dhe duke mundësuar krijimin e një komuniteti, ku të gjithë ndihen të sigurt në mjedisin ku jetojnë.

Strategjia ka bazën e saj në këto parime kyçe të sigurisë në komunitet:

Parimet bazë të sigurisë në komunitet

- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit nënkupton që të gjithë aktorët e përfshirë në sigurinë në komunitet duhet të jenë përgjegjës dhe të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e kësaj strategjie;

- Parimi siguria dhe mirëqenia për të gjithë: një qasje gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë për të siguruar masa të rëndësishme dhe të përqendruara në grupet më vulnerabil;

- Mjedise të sigurta: të gjithë njerëzit kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të sigurt nga kërcënimet për sigurinë vetjake dhe mirëqenien e tyre personale.

- Policia e Shtetit: zhvillon veprimtarinë e udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, proporcionalitetit, pavarësisë operacionale, integritetit, profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies.

- Parandalimi: identifikimi i individëve ose i komuniteteve në rrezik dhe ndërhyrjet për të zvogëluar faktorët e rrezikut dhe/ose për të rritur faktorët e mbrojtjes.

- Përdorimi i të drejtës së informimit dhe pjesëmarrjes publike: kërkon përdorimin sa më të mirë të të gjitha të dhënave, informacionet dhe njohuritë e disponueshme, si dhe përdorimin e analizave, vlerësimit dhe shpërndarjes së informacionit për të siguruar që "Informacioni i duhur: të ndahet në mënyrë të përshtatshme për të ndërtuar "Pjesëmarrje publike" në iniciativat e sigurisë në komunitet".

- Pronësia e përbashkët: nëpërmjet bashkëpunimit efektiv dhe përmirësimit të funksionalitetit në nivel vendor, përdorimit të informacionit, njohurive dhe burimeve për të trajtuar problemet në arritjen e rezultateve të përbashkëta që plotësojnë nevojat e qytetarëve dhe komuniteteve.

- Llogaridhënia: nëpërmjet përmirësimeve në proceset e komunikimit dhe angazhimit, demonstrohet transparenca dhe llogaridhënia për aktivitetet dhe veprimet e ndërmarra dhe përgjegjësia ndaj komuniteteve dhe qytetarëve të Shqipërisë.

Kjo strategji është hartuar duke u bazuar në analizat dhe vlerësimet e gjendjes aktuale dhe nevojat për adresimin e problemeve përkatëse në këtë fushë, si dhe në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe institucioneve e aktorëve pjesëmarrës në procesin e hartimit të këtij dokumenti strategjik.

Pjesa e I e këtij dokumenti paraqet kuadrin metodologjik të hartimit të strategjisë së sigurisë në komunitet, mbështetur në analizën e situatës aktuale, ekspertët kanë përcaktuar vizionin, politikat dhe objektivat strategjikë të sigurisë në komunitet për 6 vitet e ardhshme. Kreu I prezanton kuadrin aktual ligjor dhe institucional ku bazohet kjo strategji, si dhe analizën e situatës së

përgjithshme të deritanishme të sigurisë, me qëllim identifikimin e fushave prioritare të ndërhyrjes.

Pjesa II paraqet në mënyrë të detajuar qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë të strategjisë, si më poshtë:

- Politika 1 rritja e parametrave të sigurisë në komunitet ka në fokus: 1.1 rritjen e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin; 1.2 evidentimin, parandalimin dhe trajtimin në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet; si dhe 1.3 rritjen e efikasitetit të kontrollit të territorit.

- Politika 2 angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin synon: 2.1 përmirësimin e komunikimit me publikun në lidhje me çështje të sigurisë në komunitet; 2.2. forcimin e bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë në Komunitet (KVSP-ve).

- Politika 3 fokusohet në reformimin e shërbimit policor dhe rritjen e kapaciteteve për sigurinë në komunitet nëpërmjet: 3.1. përmirësimit të strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimit të një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet; si dhe 3.2. përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë.

Pjesa e III përshkruan, nga pikëpamja organizative, planin e zbatimit të strategjisë, mënyrën e koordinimit dhe përgjegjësitë e institucioneve që marrin pjesë gjatë hartimit, zbatimit, raportimit dhe monitorimit të realizimit të treguesve të këtij dokumenti. Treguesit e monitorimit të rezultateve janë paraqitur në tabelën përkatëse (aneksi 1), si dhe në pasaportat e indikatorëve (aneksi 2) si element i rëndësishëm i procesit të monitorimit.

Pjesa e IV, "Burimet financiare", paraqet parashikimet e kostove dhe burimet e financimit për zbatimin e strategjisë, si dhe hendekun financiar. Kjo dokument strategjik shoqërohet nga "Plani i Veprimit 2021 – 2023", i cili është hartuar nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Brendshme me kontributin e institucioneve përgjegjëse dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Financimi i Planit të Veprimit do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve.

5. METODOLOGJIA

Siç është shpjeguar në nënkapitullin 2, kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjikë në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave duke bërë që vizioni, objektivat strategjikë dhe specifikë të parashikuar të përputhen plotësisht me këta dokumente strategjike.

Nisma për hartimin e kësaj strategjie është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë, të rregulluar me vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*".

Ministria e Brendshme, institucione të tjera si: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, etj, si dhe Programi Suedez për Policimin në Komunitet kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie.

Në hartimin e këtij dokumenti, krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioriteteve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e bëra në Studimin/anketën mbi Forcimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri (tetor – nëntor 2020), i mbështetur nga programi SCPA, me qëllim matjen e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve për punën e policisë së shtetit, impaktin e aktivitetit të policisë mbi jetën e përditshme të qytetarëve, si dhe krahasimin me valët pararendëse të studimit (2013, 2014 dhe 2018). Gjithashtu, ky dokument merr në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e bëra në rezultatet e sondazhit mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Shqipëri 2019 (OSBE),[129] si dhe ato të bëra në progresraportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020[130].

Gjithashtu, ky dokument është publikuar për konsultim publik në fillim të dhjetorit 2020 në

[129] https://www.osce.org/secretariat/445501.

[130] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf.

adresën: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/314 dhe nuk ka pasur komente apo sugjerime të tjera në lidhje me përmbajtjen.

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

Politika 1: Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet

Qëllimi i kësaj politike lidhet me parandalimin e kriminalitetit dhe rritjen e efikasitetit të shërbimit policor në kontrollin e territorit. Në këtë kuadër, siguria ka të bëjë me punën me njerëzit dhe komunitetet për të parandaluar krimin dhe sjelljet antishoqërore, për të zvogëluar dëmin dhe për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e jetës. Për ta arritur këtë, institucionet shtetërore do të fokusohen në masat parandaluese për të siguruar rritje efikase të parametrave të sigurisë nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse të të gjithë shoqërisë për sigurinë e komunitetit. Masat parandaluese do të lidhet me intensifikimin e përpjekjeve të të gjithë institucioneve, për të zbatuar konceptin e aksesit në siguri për të gjithë komunitetin dhe në zbatim të direktivave strategjike të vendit drejt integrimit në BE.

Në këtë kuadër, Ministria e Brendshme do të udhëheqë perfeksionimin e sistemit aktual të parandalimit në praktikë, në bashkëpunim me të gjitha kategoritë shoqërore në komunitet, përfshirë grupet vulnerabël si: viktimat e dhunës në familje, viktimat e mitura/të mitur dhe të rritura/të rritur të dhunës seksuale, viktimat e përndjekjes dhe të dhunës në internet, në shkollë, të miturit, përdoruesit e drogës, bulizmin, apo edhe kategori të tjera me sjellje antishoqërore.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë , në partneritet me institucione dhe organizata të tjera, do të fokusohen në këto objektiva specifikë:



Objektivi specifik 1.1: Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin

Strukturat e Policisë së Shtetit në veprimtarinë e tyre, krahas evidentimit të treguesve të punës, kryejnë analiza specifike bazuar në treguesit e performancës/punës, duke vlerësuar dhe klasifikuar nivelet e riskut për zonat e territorit (urbane dhe rurale) për rritje të tendencave të veprave penale apo të paligjshmërisë në territor.

Gjithashtu, Policia e Shtetit e ndërton punën e saj, krahas të tjerave edhe nëpërmjet grumbullimit të informacioneve të ndryshme policore që kanë të bëjnë me persona apo grupe të dyshuara kriminale që ushtrojnë veprimtari kriminale apo të paligjshme në territor, informacione të cilat pasi vlerësohen, shërbejnë për të ndërtuar punën policore në mënyrë proaktive, për parandalimin e kësaj veprimtarie kriminale apo të paligjshme.

Një element shumë i rëndësishëm është vlerësimi i risqeve, pasi nëpërmjet këtij vlerësimi, Policia e Shtetit dhe jo vetëm mund të përcaktojnë "zonat e nxehta" apo "njollat e zeza" në territorin/zonën policore, vlerësime këto të cilat orientojnë planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve policore në këto vende për parandalimin e ngjarjeve të ndryshme (kriminale, paligjshmëri, aksidente rrugore, etj.).

Treguesit kryesore të performancës

1.1.1 Rezultatet e treguesve të punës së strukturave të policisë së shtetit, krahasuar me

periudhat paraardhëse në lidhje me parametrat e sigurisë në komunitet.

Indikatorë të matshëm

1.1.1.1 Numri i informacioneve policore (SK2);

1.1.1.2 Numri i veprave penale që cenojnë sigurinë në komunitet (vrasjet, plagosjet, krimet seksuale, rrëmbimet, shtrëngim për dhënie pasurie, dhunim banese, përndjekja, dhuna në familje vjedhjet, mashtrimi, shkatërrimi i pronës, organizimi i lotarive të palejuara, ndërtimet e paligjshme, krimet kundër mjedisit, largim nga vendi i aksidentit, prishje e qetësisë publike, vetëgjyqësia, krime në fushën e narkotikëve, shkelje rregullave të qarkullimit rrugor).

Rezultate të pritshme

1.1.1.1 Rritja e numrit të informacioneve policore (SK2);

1.1.1.1 Rritja e forcës goditëse, numrit të personave të proceduar penalisht / arrestuarve / ndaluarve për veprimtari kriminale apo paligjshmëri në territor;

1.1.1.2 Ulja e numrit të veprave penale që cenojnë sigurinë në komunitet (vrasjet, plagosjet, krimet seksuale, rrëmbimet, shtrëngim për dhënie pasurie, dhunim banese, përndjekja, dhuna në familje, vjedhjet, mashtrimi, shkatërrimi i pronës, organizimi i lotarive të palejuara, ndërtimet e paligjshme, krimet kundër mjedisit, largim nga vendi i aksidentit, prishje e qetësisë publike, vetëgjyqësia, krime në fushën e narkotikëve, shkelje rregullave të qarkullimit rrugor).

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 1. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese

Kjo masë synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, si në nivel qendror me ministritë e linjës dhe në nivel vendor me agjencitë zbatuese nëpërmjet KVSP-ve, për vlerësimin e riskut dhe dëmit, si dhe marrjen e masave parandaluese në lidhje me çështje të rëndësishme për sigurinë si: dhuna, kriminaliteti në komunitet, shpërndarja dhe përdorimi i lëndëve narkotike në komunitet. Kjo do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të masave ligjore dhe mekanizmave në nivel vendor e qendror për adresimin e këtyre çështjeve nëpërmjet vlerësimit të riskut dhe përforcimit të masave aktuale nga të gjithë agjencitë ligjzbatuese, si dhe nëpërmjet koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve me mekanizmat ekzistues, si për shembull: Mekanizmat e Koordinuar të Referimit për rastet e dhunës në familje, në nivel vendor, Grupin Teknik ndërsektorial për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, tryezat antitrafik, për trajtimin e rasteve në rrezik trafikimi, etj.

KSVP-të, nëpërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe forumeve e mekanizmave të tjerë të bashkëpunimit, do të punojë për të siguruar ndërhyrje specifike për sigurinë në nivel vendor, duke siguruar kështu një kundërnarrativë për të sfiduar dhe parandaluar krimet në komunitet.

Masa 2. Realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike

Në lidhje me vlerësimin e riskut, masat do të fokusohen në kryerjen e vlerësimeve të riskut në komunitete mbi baza lokale, sipas modelit të analizave SMSK (*Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet*), i realizuar nga programi suedez "**Forcimi i sigurisë në komunitet në Shqipëri**" (**SCPA**), ose modele të tjera të përdorura nga Policia e Shtetit apo agjencitë e tjera në bashkëpunim me KSVP-të dhe partnerë të tjerë, po ashtu të dhënat do të krahasohen në nivel qarku dhe ato në nivel kombëtar.

Prioritet do t'i kushtohet modernizimit të sistemit, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të avancuara të teknologjisë së informacionit, për përpunimin e të dhënave, si dhe shfrytëzimin e databazave të të gjithë institucioneve përgjegjëse që kanë detyrime në këtë fushë.

Masa 3. Proaktiviteti i shërbimit policor në lidhje me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve

Një rol të rëndësishëm për arritjen e këtij objektivi do të vazhdojë të luajë dhe Policia e Shtetit, e cila do të përdorë analizën e performancës, për të kuptuar më mirë kërkesat operacionale me të cilat përballet çdo ditë, për të siguruar që plotëson sfidat e çështjeve rutinë, si dhe kërcënimet dhe sfidat e reja në baza lokale, rajonale dhe kombëtare.

PSH-ja do të përqendrohet në modernizimin e teknologjisë dhe sistemeve të TIK-ut për të përmirësuar mbledhjen, analizën dhe përdorimin e informacionit të Policisë që synon parandalimin dhe zgjidhjet e orientuara drejt problemit.

PSH-ja do të rishikojë vazhdimisht Sistemin e Menaxhimit Policor të Çështjes për të siguruar që mbetet i përshtatshëm, për qëllimin dhe se gatishmëria e Policisë për të reaguar ndaj emergjencave civile, incidenteve të vazhdueshme ose të drejtpërdrejta dhe patrullimi i policisë bazohet në informacionin dhe proceset më të mira në dispozicion.

Në fokus do të jetë dhe forcimi i bashkëpunimit të strukturave policore brenda Zonave Policore dhe bërja funksionale 100% e këtyre zonave nëpërmjet plotësimit të strukturave dhe mbështetjes logjistike.

Objektivi specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet

Qëllimi i këtij objektivi është që institucionet përgjegjëse dhe komuniteti të bashkëpunojnë ngushtësisht për të identifikuar problemet, për të vendosur përparësi dhe për të gjetur zgjidhje për problemet siç janë: krimi, abuzimi me drogat, frika nga krimi, çështjet sociale, sjelljet antishoqërore, problemet ekologjike dhe shqetësime të tjera në mjedisin jetësor dhe punës në komunitet.

Analiza e situatës dhe sfidat

Strukturat e Policisë së Shtetit kryejnë identifikimin e problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit nëpërmjet denoncimeve, ankesave të drejtpërdrejta në organet e policisë, kallëzimeve të qytetarëve, kontakteve të përditshme që kanë në zonën policore, takimeve të ndryshme me përfaqësues të pushtetit vendor, institucioneve vendore shtetërore, pjesëmarrjes në mbledhjet e Ekipit Teknik Ndërdisiplinar etj.

Megjithëse, ky evidentim aktualisht kryhet në këto forma, vlerësohet shumë i rëndësishëm aktivizimi në këtë proces i të gjithë aktorëve të tjerë si pushtetit vendor, institucione të tjera vendore shtetërore, subjekte të ndryshme private, organizata OJF, komunitetet fetare, etj., si pjesë integrale e jetës së komunitetit në një territor të caktuar, ku edhe këto problematika, shqetësime janë të pranishme çdo ditë.

Referuar kësaj situate dhe problematikave nevojitet:

- krijimi i mekanizmave specifikë, si dhe fuqizimi i mekanizmave ekzistues për adresimin e problematikave dhe shqetësimeve të evidentuara, të cilat duhen ndarë sipas prioriteteve për t'u trajtuar;
- krijimi i strukturave të specializuara (si KVSP, etj.) dhe koordinimi i veprimeve të tyre me mekanizmat/strukturat ekzistuese, për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit;
- krijimi i buxheteve të veçanta për zgjidhjen e problematikave dhe shqetësimeve të tilla që kërkojnë mbështetje financiare.

Treguesit kryesorë të performancës

1.2.1 Parandalimi i orientuar nga inteligjenca dhe informacioni nëpërmjet evidencave dhe raporteve të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe aktorët e tjerë që kontribuojnë në fushën e sigurisë në komunitet;

1.2.2 Bashkëpunimi me sistemin arsimor me qëllim parandalimin.

Indikatorë të matshëm

1.2.1.1 Numri i rasteve të evidentuara dhe të sjella nga institucionet përgjegjëse, përfshirë policinë në KVSP;

1.2.1.2 Numri i masave parandaluese të marra nga institucionet përgjegjëse bazuar në evidencat dhe raporte;

1.2.1.3 Numri i anketimeve dhe analizave, në nivel vendor dhe kombëtar, mbi perceptimin e publikut në lidhje me rendin dhe sigurinë;

1.2.2.1 Shtrirja e rolit të oficerëve të sigurisë në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare, të vendit (aktualisht kjo strukturë funksionon vetëm në 150 gjimnaze);

1.2.2.2 Fuqizimi i rrjetit të institucioneve arsimore parauniversitare – qendra komunitare.

Rezultate të pritshme

1.2.1.1.1 Rritja e evidencave dhe informacioneve zyrtare të institucioneve përgjegjëse që përmirësojnë cilësinë e jetës në komunitet dhe në territor;

1.2.1.1.2 Rritja e numrit të informacioneve cilësore policore;

1.2.1.1 & 1.2.1.3 Rritja e ndërveprimit për parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollat parauniversitare nëpërmjet mësuesit, drejtuesit të shkollës dhe Policisë (SPZ) dhe komuniteteve nëpërmjet mekanizmit: shkolla si qendër komunitare.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 4. Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit, i orientuar nga inteligjenca dhe informacioni

Qëllimi është reduktimi i aktiviteteve të kontrollit nëpërmjet masave që parandalojnë krimin, zvogëlojnë frikën e krimit dhe përmirësojnë cilësinë e jetës në komunitet dhe në territor. Parandalimi i orientuar nga inteligjenca (evidentimi dhe informacioni) do të sigurojë reduktimin e përsëritjes së çështjeve që cenojnë sigurinë në komunitet, analizën e pikave të nxehta, orientimin për plane specifike të parandalimit dhe të zvogëlimit të krimit, të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe një shërbim policor efikas.

Policimi që udhëhiqet nga informacioni është koncepti që sfidon modelin tradicional dhe reagues të policimit, ndërkohë që policimi në komunitet është një qasje vertikale, për të ndërtuar besimin e publikut te policia, policimi i udhëhequr nga inteligjenca (informacioni) është një model drejtimi dhe vendimmarrje nga lart – poshtë. Modeli i policimit që udhëhiqet nga inteligjenca fokusohet tek analiza dhe informacioni i përpunuar si elemente thelbësorë për vendimmarrjen objektive e që ka si prioritet zonat e nxehta të kriminalitetit, si dhe parandalimin e goditjen e aktiviteteve kriminale, nëpërmjet menaxhimit nga pikëpamja teknike e strategjike etj.

Ky policim i udhëhequr nga inteligjenca do të ndihmonte në zgjidhjen e shumë problemeve, pasi policia merr masa proaktive parandaluese në kohë, bazuar në informacionet e marra dhe kjo do të reduktonte kryerjen e kontrolleve në territor, si patrullime etj.

Institucionet përgjegjëse dhe aktorët e tjerë që kontribuojnë në fushën e sigurisë në komunitet, të bazuar në evidenca dhe informacion për çështje që shqetësojnë komunitetin, të koordinuar apo në bashkëveprim me KVSP-të, do të rishikojnë vazhdimisht rolin e tyre në përmirësimin e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe në ngritjen e fushatave ndërgjegjësuese për çështjet e krimit lokal dhe rendit dhe sjelljeve antishoqërore përmes ndërveprimit efektiv me komunitetin, si në institucione arsimore parauniversitare, biznese, apo dhe me OJF/OSHC, për t'u fokusuar në komunitete më pak të arritshme dhe më pak të dukshme.

Të gjithë aktorët përgjegjës, nëpërmjet KVSP-ve, do të mbledhin, analizojnë, vlerësojnë dhe shpërndajnë informacione në mënyrë proaktive, bazuar në informacionin më të plotë të mundshëm, në mënyrë që të informojnë KVSP-të, mekanizmat e tjerë ekzistues (ETN-të, GNT-të, tryezat antitrafik etj.) dhe komunitetet për problemet, trendet dhe çështjet në zhvillim.

PSH-ja do të sigurojë mbështetje për politikat, analizat dhe taktikat për KVSP-të duke u përqendruar në mbrojtjen e grupeve më vulnerabël në komunitet, PSH-ja do të sigurojë që sistemet, proceset dhe procedurat që kjo strukturë përdor janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të të drejtave të njeriut dhe do të përpiqet të arrijë rezultatet më të mira, duke marrë në konsideratë dhe duke respektuar nevojat e veçanta të këtyre grupeve.

Fushatat e ndërgjegjësimit do të jenë të bazuara në evidenca dhe inteligjencë të lidhura me shqetësimet specifike të sigurisë në komunitet. Aktivitetet ndërgjegjësuese do të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për çështje të ndryshme të sigurisë në komunitet dhe publikut, si rezultat i ndërveprimit gjatë këtyre veprimtarive dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet/problematikat e ngritura në lidhje me sigurinë.

Masa 5. Parandalimi nëpërmjet edukimit

Edukimi në sistemin arsimor synon edukimin nëpërmjet programeve shkollore me sjelljet që nxisin sigurinë vetjake dhe të të tjerëve në situata të ndryshme, si dhe ndryshimet ndërmjet sjelljeve të rrezikshme dhe të sigurta. Në fokus do të jetë dhe rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të sistemit arsimor në funksion të rritjes së parametrave të sigurisë publike.

Në fokus do të jetë zhvillimi i protokolleve gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe raportimin e dhunës, ngacmimit dhe sulmeve seksuale, bulizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në institucione arsimore parauniversitare. Përmes praktikave më të mira në rajon, në institucione arsimore parauniversitare do të krijohen ekipe të përbëra nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit që kanë për synim krijimin e mjediseve pa dhunë dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve mes nxënësve. Gjithashtu, do të investohet në ndërtimin e kapacitetit të ekipeve të tilla dhe në koordinimin e tyre nga ZVAP-të. Një rol të rëndësishëm këtu do të kenë bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve me bashkinë/koordinatorin vendor dhe ETN-të për

trajtimin e rasteve të dhunës në familje, apo dhe NJMF-të/PMF-të dhe GTN-të për rastet e abuzimit të fëmijëve.

Shtrirja e rolit të oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare, në të gjitha institucionet arsimore të vendit (aktualisht kjo strukturë funksionon vetëm në 150 gjimnaze), përfshirë këtu shkollat fillore. Kjo strukturë është e domosdoshme për sinjalizimin, parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollë nëpërmjet ndërveprimit me mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe Policisë (SPZ). Qëllimi i kësaj strukture nuk është ndëshkimi, por ndërgjegjësimi, edukimi dhe ofrimi i mbështetjes mbi problematikat e sigurisë që nxënësit mund të hasin në ambientet e shkollës.

Fuqizimi i rrjetit të institucione arsimore parauniversitare do të realizohet edhe nëpërmjet shtimit të numrit të oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare. MASR-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në zbatim të vendimit nr. 600, datë 9.10.2018, *"Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë"*, të ndryshuar, ka bërë të mundur punësimin e oficerëve të sigurisë në të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të lartë, si dhe në institucione arsimore parauniversitare të arsimit bazë që plotësojnë kritere të caktuara në kuptim të numrit të nxënësve, vendndodhjes, vlerësimit të sigurisë etj. Trajtimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet nga Akademia e Sigurisë.

Fuqizimi i rrjetit të institucioneve arsimore parauniversitare – qendrave komunitare do të vijojë, mbështetur në eksperiencat më të mira, përftuar gjatë zbatimit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014 – 2020, ndërsa fokusi në periudhën 2021 – 2026 do të jetë në fuqizimin e rrjetit të këtyre institucione arsimore parauniversitare në nivel të ZVAP-ve, DRAP-ve dhe në nivel vendi. Në këtë formë synohet që të shtohen mundësitë për shkëmbim të përvojave në mes të institucioneve arsimore parauniversitare – qendrave komunitare, duke i nxitur ato për përmirësim të vazhdueshëm të performancës së tyre. Bashkëpunimi në këtë qasje do të fuqizohet edhe me mjekët e shkollave ku ekzistojnë, si dhe me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social.

Me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së materialeve edukuese do të mundësohet që paketat edukuese për çështje të ndryshme të jenë të përgatitura nga ekspertë të fushës nëpërmjet qasjes shumëdisiplinare, të përputhura me moshën dhe nevojat e tyre, si dhe të publikuara në një faqe të caktuar të portalit policor dhe arsimor.

Objektivi specifik 1.3: Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit

Kontrolli i plotë i territorit, në funksion të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë, është një detyrë e rëndësishme e një sërë aktorëve që kanë detyrim ligjor në këtë drejtim. Ky kontroll përfshin një tërësi procesesh, duke filluar nga mbikëqyrja e zonave urbane dhe rurale, zonave turistike duke prekur të gjitha hapësirat e tjera (malore, fushore, pyjore, etj.) në të gjithë territorin e vendit për parandalimin e veprave penale dhe paligjshmërisë në territor. Përfundimi i reformës territoriale, së bashku me ndryshimet e fundit ligjore[131], ngarkon bashkitë me përgjegjësi në raport me kontrollin e territorit dhe garantimin e sigurisë publike.

Masat që do të merren në këtë drejtim do të fokusohen kryesisht në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe institucioneve të ndryshme të përfshira në kontrollin e territorit dhe zbatimin e kuadrit ligjor përkatës. Në fokus do të jenë edhe puna për krijimin e "qyteteve të sigurta për gratë dhe vajzat" (në përputhje me OZHQ-të 11.7), të cilat mund të lëvizin pa frikën e ngacmimit apo dhunës (verbale, fizike e seksuale) në hapësirat publike urbane dhe rurale.

Analiza e situatës dhe sfidat

Kontrolli i territorit vlerësohet shumë i rëndësishëm sa i përket konstatimit të paligjshmërisë dhe veprimtarisë kriminale në territor. Në aktet ligjore dhe nënligjore janë të mirëpërcaktuara kompetencat dhe përgjegjësitë që kanë aktorë të ndryshëm për kontrollin e territorit, por aktualisht perceptohet si një përgjegjësi dhe punë kryesisht e Policisë së Shtetit.

Strukturat vendore të Policisë së Shtetit janë të organizuara dhe të ndara në të gjithë territorin dhe ushtrojnë përgjegjësitë e tyre funksionale dhe realizojnë detyra në kontrollin e territorit për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe të paligjshmërisë në territor, por aktorët e tjerë vendorë që kanë detyrime për kontrollin e territorit, nuk ushtrojnë përgjegjësitë që i ngarkon ligji ose i

[131] Referencë ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

ushtrojnë ato në nivele minimale, për shumë arsye dhe faktorë objektiv e subjektiv.

Për një kontroll sa më të mirë dhe efektiv të territorit është e rëndësishme dhe e nevojshme marrja e përgjegjësive, si dhe forcimi i bashkëpunimit të të gjitha strukturave shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

Hartimi i një Procedure Standarde Pune/Veprimi (PSV)*"Mbi mënyrat e bashkëpunimit dhe kryerjes së veprimeve/kontrolleve të përbashkëta të territorit për evidentimin/konstatimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor",* konsiderohet i nevojshëm, ku të përfshihen të gjithë aktorët qendrorë e vendorë që kanë detyrime ligjore në këtë fushë.

Treguesit kryesorë të performancës

1.3.1 Kontroll cilësor dhe efektiv i territorit nëpërmjet zbatimit të përgjegjësive të strukturave të ndryshme, institucioneve dhe organeve të vetëqeverisjes vendore dhe qendrore për të përmirësuar kontrollin e territorit.

1.3.2 Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit në mënyrë sa më efektive, me qëllim evidentimin/konstatimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor.

Indikatorë të matshëm:

1.3.1.1 Hartimi i një kuadri të plotë nënligjor dhe procedural për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit të inspektorateve që kanë përgjegjësi të përfshihen në kontrollin e territorit;

1.3.1.2 Riorganizimi i strukturave që kanë përgjegjësi, duke i shtuar kompetenca të reja për kontrollin e territorit dhe inspektimin, përfshirë pushtetin vendor;

1.3.1.3 Krijimi dhe aktivizimi i grupeve vullnetare pranë njësive administrative për kontroll territori;

1.3.2.1 Mundësimi dhe përdorimi i mjeteve logjistike me teknologji inovative, për kryerjen e kontrolleve efektive dhe pajisja me automjete e strukturave vendore përgjegjëse, për kontrollin e territorit.

Rezultate të pritshme

1.3.1.1 Akte të hartuara që rregullojnë kuadrin nënligjor për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit të inspektorateve që kanë përgjegjësi të përfshihen në kontrollin e territorit;

1.3.1.2 Formulimi i akteve që rregullojnë kuadrin nënligjor për veprimtarinë e pushtetit vendor me përgjegjësi për kontrollin e territorit;

1.3.1.3 Rritja e numrit të njësive administrative që kanë grupet vullnetare të aktivizuara për kontrollin e territorit;

1.3.1.1.1 Rritja e numrit të automjeteve në dispozicion të strukturave përgjegjëse (inspektoratet) në nivel vendor për kontrollin cilësor të territorit;

1.3.1.1.2 Rritja e numrit të zonave policore të mbuluara me pajisje teknologjike (dronë, dylbi, GPS, tableta dhe pajisje të tjera.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 6. Zbatimi i përgjegjësive në nivel qendror dhe vendor për kontrollin e territorit

Ministria e Brendshme dhe institucionet shtetërore në nivel kombëtar do të identifikojnë ndarjen më të qartë të përgjegjësive ndërmjet strukturave të ndryshme, institucioneve dhe organeve të vetëqeverisjes vendore dhe qendrore për të përmirësuar kontrollin e territorit.

Në fokus do të jenë:

- ndërtimi i protokolleve dhe përmirësimi i legjislacionit për shkëmbimin e informacionit për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kryesore që kanë përgjegjësi të përfshihen në kontrollin e territorit;
- riorganizimi i strukturave që kanë përgjegjësi duke i shtuar kompetenca të reja për kontrollin e territorit dhe inspektimin;
- hartimi i një kuadri të plotë nënligjor dhe procedural për veprimtarinë dhe mënyrën e bashkëpunimit të këtyre inspektorateve.

Masa 7. Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit

Kjo masë synon pajisjen e strukturave vendore që kanë detyrime për kontrollin e territorit me automjete të kalueshmërisë së lartë dhe pajisje të tjera si: dronë, dylbi, veshje etj., për kryerjen e kontrolleve sa më efektive, me qëllim evidentimin/konstatimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor. Po ashtu do të ndërmerren hapa të mëtejshme, në zbatim të detyrime të përcaktuara në ligjin nr. 19, datë 22.9.2016, "*Për masat shtesë të sigurisë"*, si vendosja e kamerave nga subjektet e ndryshme private në ambientet e jashtme, si dhe ngritja dhe funksionimi

i një regjistri, si bazë të dhënash në nivel qendror apo vendor, në të cilin regjistrohen subjektet që sipas ligjit, marrin masa shtesë të sigurisë publike, etj.

Politika 2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin

Kjo politikë është në thelb të filozofisë së zbatimit të kësaj strategjie, duke synuar vendosjen dhe ruajtjen e besimit të ndërsjellë si qëllim kryesor të komponentit të parë thelbësor të sigurisë në komunitet, atë të partneritetit të komunitetit. Politika synon rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, ku siguria bëhet pjesë integrale e kulturës së komunitetit dhe ndërveprimi midis komunitetit dhe organeve të pushtetit vendor ndihmon në besimin e ndërsjellë, duke përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve dhe shpërndarjen e burimeve.

Suksesi afatgjatë i sigurisë në komunitet nuk varet vetëm nga transformimi i policisë nëpërmjet zbatimit të ligjit, por edhe nga transformimi dhe gatishmëria e pushteti vendor për të ndjekur një integrim efektiv të zbatimit të filozofisë në nivel vendor. Përfaqësuesit e zgjedhur dhe të emëruar në nivel vendor duhet të kuptojnë zbatimin e strategjisë së sigurisë në komunitet si pjesë e zbatimit të ligjit dhe të marrin pjesë aktive në zhvillimin e saj. Kryetarët e bashkive, njësive administrative nuk duhet të jenë partnerë pasivë në këtë proces, ata duhet të udhëzojnë zgjerimin e kësaj lëvizje drejt "qeverisë së orientuar nga komuniteti" në nivelin vendor. Koordinimi dhe bashkëpunimi me organizatat, forumet dhe institucionet joqeveritare konsiderohet si shumë i rëndësishëm, pasi përfshirja e tyre do të kontribuojë në sigurinë e komunitetit.

Gjithashtu, bashkëpunimi dhe angazhimi proaktiv i policisë së shtetit në mekanizmat ekzistues të trajtimit të problemeve të ndryshme shoqërore, si MKR-ja kundër dhunës në familje, GTN-ja kundër abuzimit të fëmijëve, tryezat antitrafikim etj. Përfshirja aktive e komunitetit çon në zgjidhje proaktive dhe të orientuara e të drejtuara, forcon besimin tek institucionet shtetërore dhe gjithashtu çon në përmirësimin e komunikimit, performancës dhe kënaqësisë më të mirë ndaj shërbimeve shtetërore për të përmbushur nevojat e komuniteteve.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë do të fokusohen në përmbushjen e objektivave specifikë të mëposhtëm:

Objektivi specifik 2.1
- Përmirësimi i komunikimit me publikun.

Objektivi specifik 2.1
- Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve.

Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i komunikimit me publikun

Komunikimi është një nga vlerat kryesore të sigurisë në komunitet, i cili duhet të jetë në kohë, gjithëpërfshirës dhe i drejtpërdrejtë. Komunikimi në mënyrë të vazhdueshme me publikun do të inkurajojë pjesëmarrjen aktive dhe uljen e rezistencës për bashkëpunim dhe ndërveprim dhe rritjen e besimit të publikut për përmirësimin e sigurisë.

Analiza e situatës dhe sfidat

Raportet e komunikimit të policisë me publikun mbeten në themel të përpjekjeve të forcimit të bashkëpunimit të policisë me komunitetin, duke forcuar besimin e publikut te policia dhe duke ndërvepruar përpjekjet për parandalimin e krimit dhe ofrimin e sigurisë. Ky raport ndërmjet tyre është i një rëndësie të veçantë, duke u lidhur drejtpërsëdrejti me përmirësimin e shërbimeve të sigurisë ndaj qytetarëve në bashkëpunim të ngushtë me ta. Bashkëpunimi i strukturave të policisë në nivel qendror dhe vendor me komunitetin, në interes të drejtpërdrejtë të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve nevojitet të fuqizohet, si dhe të jetë i drejtpërdrejtë e nga afër, në mënyrë që ndërveprimi të jetë më eficient. Po ashtu një rëndësi të veçantë merr përdorimi i mundësive më të mira teknologjike për të lehtësuar komunikimin, të cilat ofrojnë zgjedhje dhe më shumë facilitete për

njerëzit që zgjedhin të kontaktojnë, me opsione të zgjeruara digjitale dhe akses të përmirësuar.

Në kuadër të marrjes së përgjegjësive të të gjitha strukturave përgjegjëse për çështjet e sigurisë në komunitet, si dhe me ngritjen e KSVP-ve, zhvillimi i "Planeve specifike të komunikimit të sigurisë lokale" është me rëndësi për nxitjen e besimit të publikut, duke theksuar arritjet e sigurisë lokale dhe sigurisë në komunitet duke demonstruar përgjegjshmëri dhe rezultate, si dhe duke punuar në partneritet, dhe duke koordinuar me planet e tjera të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit që hartohen nga struktura ku edhe vetë PSH-ja është anëtare (MKR etj.);

Treguesit kryesorë të performancës

2.1.1 Zhvillimit i "Planeve specifike të komunikimit të sigurisë lokale";

2.1.2 Përmirësimi i komunikimit të NSPK-ve me qytetarët dhe bashkërendimi i punës së NSPK-ve me strukturat e tjera vendore, si dhe forcimi i rolit të oficerëve të sigurisë në shkolla;

2.1.3 Përmirësimi i komunikimit nëpërmjet kanaleve të ndryshme mediatike të komunikimit;

2.1.4 Rritja e transparencës në punën institucionale të DPPSH-së dhe bashkive në lidhje me çështje të sigurisë në komunitet, nën garancinë e Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Indikatorë të matshëm

2.1.1.1 Numri KVSP-ve me "Plane specifike të komunikimit të sigurisë lokale";

2.1.1.2 Numri i KVSP-ve që komunikojnë raporte specifike te publiku mbi çështjet e adresuara nga KVSP-të;

2.1.2.1 Numri i takimeve nga NSPK me oficerët e sigurisë në shkolla, me qytetarët në lagje, fshatra i evidentuar dhe komunikuar me komunitetin;

2.1.3.1 Numri i kanaleve të reja mediatike të komunikimit ose rubrikave të përmirësuara;

2.1.4.1 Programi i transparencës i përditësuar çdo vit nga DPPSH-ja dhe bashkitë.

Rezultate të pritshme:

2.1.1.1.1 Rritja e numrit të KVSP-ve me "Plane specifike të komunikimit të sigurisë lokale";

Rritja e numrit të raporteve të punës të KVSP-ve të komunikuara me publikun;

2.1.1.1.2 Rritja e numrit të takimeve nga NSPK me oficerët e sigurisë në shkolla, me qytetarët në lagje, fshatra;

2.1.1.1.3 Rritja e informacioneve të ndara nga grupet e ndryshme të komunitetit gjatë takimeve me NSPK-të;

2.1.3.1 Rritja e numrit të kanaleve të reja mediatike të komunikimit ose rubrikave të përmirësuara në lidhje me sigurinë në komunitet;

2.1.4.1.1 Rritja e numrit të publikimeve të raporteve vjetore të çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet (përfshirë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve);

2.1.4.1.2 Rritja e numrit të përdoruesve të programit "Komisariati digjital".

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 8. Hartimi dhe zbatimi i masave të reja për të përmirësuar kontaktet e drejtpërdrejta me publikun dhe komunitetet

Masat do të fokusohen në përmirësimin e komunikimit të NSPK-ve me qytetarët dhe bashkërendimin e punës së NSPK-ve me strukturat e tjera vendore. **Forcimi i rolit të oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare** konsiderohet një element tjetër i rëndësishëm sa i takon përmirësimit të komunikimit me publikun. Gjithashtu, me rëndësi është dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut nëpërmjet komunikimeve dhe këshillimeve për shërbimet e ofruara nga policia dhe hartimi e zbatimi i masave të reja për të përmirësuar kanalet e komunikimit dhe mjetet e kontaktit me publikun, si dhe metodat e komunikimit për të nxitur besimin e publikut ndaj shërbimeve policore, duke i afruar qytetarët më pranë me Policinë e Shtetit përmes kësaj forme partneriteti dhe pjesëmarrjeje. Koordinimi i veprimeve dhe pjesëmarrje në aktivitetet specifike ndërgjegjësuese, të cilat organizohen në kuadër të ditëve apo fushatave mbarëkombëtare (ose ndërkombëtare), lidhur me të drejtat e fëmijëve, fushatën antitrafikim, fushatën e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në familje, etj.

Masa 9. Përmirësimi i komunikimit dhe angazhimit efektiv me partnerët dhe komunitetet në nivel lokal dhe kombëtar

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

- zhvillimit të "Planeve specifike të komunikimit të sigurisë lokale" që nxisin besimin e publikut, duke theksuar arritjet e sigurisë lokale dhe sigurisë në komunitet duke demonstruar përgjegjshmëri dhe rezultate, si dhe duke punuar në partneritet,

dhe duke koordinuar me planet e tjera të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit që hartohen nga struktura ku edhe vetë PSH-ja është anëtare (MKR etj);

- krijimit të një strategjie specifike komunikimi të jashtëm, duke përdorur praktikën më të mirë ndërkombëtare, të përshtatur me kushtet dhe kulturën shqiptare;

- demonstrimit dhe promovimit për rolin e parandalimit përmes nxjerrjes në pah të veprimtarisë ekzistuese të institucioneve përgjegjëse dhe nga KVSP-të, si dhe qasjet inovative të komunikimit për parandalimin e krimit dhe prishjen e rendit publik;

- marrjes së masave proaktive në krijimin e kontakteve dhe komunikimin me grupet e pakicave dhe të disavantazhuara në komunitet për të luftuar pabarazinë, në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të që janë shpesh zëri i këtyre grupeve.

Masa 10. Hartimi dhe zbatimi i masave për të përmirësuar komunikimin nëpërmjet mediave teknologjike

Perceptimet e publikut ndaj çështjeve të rendit dhe sigurisë dhe policisë janë të një rëndësie të mashe, sepse në fund të fundit policia dhe organet e tjera përgjegjëse për zbatimin e ligjit nuk mund të jetë efektive pa mbështetjen e publikut. Mungesa e mbështetjes nga publiku do t'i bënte këto institucione dhe policinë të paaftë për të kapur shkelësit e rendit si dhe kriminelët. Në këtë kuadër komunikimi në kohë reale dhe i vazhdueshëm me publikun merr rëndësi të veçantë. Po ashtu rëndësi të veçantë merr dhe përdorimi sa më i gjerë i kanaleve të komunikimit nëpërmjet aksesit të teknologjive të reja të komunikimit.

Kjo masë synon të shqyrtohen mundësitë më të mira teknologjike për të lehtësuar komunikimin, të cilat ofrojnë zgjedhje dhe më shumë facilitete për njerëzit që zgjedhin të kontaktojnë, me opsione të zgjeruara digjitale dhe akses të përmirësuar. Kjo masë synon të realizohet nëpërmjet:

- përdorimit të kanaleve të reja të mediave sociale të komunikimit si *Facebook* dhe *Twitter* për të zhvilluar plane komunikimi dhe angazhimi që arrijnë të gjitha komunitetet, bizneset dhe palët e tjera të interesit në një mënyrë proaktive dhe inovative;

- përmirësimit të mbështetjes së mediave dhe mënyrës së shpërndarjes së mesazheve te mediat lokale;

- fuqizimit të mëtejshëm dhe rivendosjes në qendër të vëmendjes të Komisariatit Digjital si një platformë unike për adresimin e ankesave.

Masa 11. Zbatimi i masave të komunikimit në kuadër të programit të transparencës për të përmirësuar sistemin e raportimit dhe informimit të publikut

Komunikimi i strukturave përgjegjëse për sigurinë me publikun, është një element kyç, i cili synon të përmirësojë imazhin e strukturave të Policisë së Shtetit nëpërmjet rritjes së shkallës transparencës duke informuar publikun mbi aksione/operacione, reformat e policisë, situatën e kriminalitetit, realizime apo suksese të rëndësishme të policisë etj. Përgatitja e buletineve dhe publikimi i tyre për të prezantuar punën reale të kryer nga Policia e Shtetit është një nga masat e cila tregon transparencën e kësaj strukture dhe përmirëson imazhin e saj si dhe rrit besimin e qytetarëve te publiku. Gjithashtu, krahas publikimeve apo njoftimeve për shtyp për bërjen publike të ngjarjeve të veçanta, është i rëndësishëm edhe informimi periodik për bashkëpunimin me komunitetin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në lidhje me çështjet e sigurisë.

Objektivi specifik 2.2. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve

Pavarësisht përcaktimeve ligjore në fuqi, bashkëpunimi ndërmjet strukturave vendore të policisë, pushtetit vendor dhe degëve vendore të institucioneve publike, nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe të pritshmërive. Policia e Shtetit është struktura që ka qenë e angazhuar maksimalisht, por ka pasur një reagim të vakët të institucioneve të tjera për të thelluar bashkëpunimin ndërinstitucional. Strategjitë vendore të Sigurisë në Komunitet janë konsultuar rrallë me partnerët lokalë edhe në shumë pak raste partnerët lokalë kanë ndërmarrë hapa konkretë për rritjen e sigurisë publike, duke koordinuar veprimet me Policinë e Shtetit.

Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike, si një mekanizëm koordinues, identifikues dhe menaxhues në nivel vendor mbi problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit, janë të drejtuar nga Kryetari i Bashkisë. Ky mekanizëm përbën në vetvete një instrument të qëndrueshëm bashkëpunimi. Si një risi, e ndërmarrë që nga viti

2016[132], ky mekanizëm është konceptuar të trajtojë çështjet e sigurisë duke garantuar të drejtat e njeriut dhe forcuar shtetin e së drejtës.

Në sajë të fuqizimit të bashkëpunimit ndërsektorial për sigurinë publike në nivel vendor duhet të përfshihen një sërë veprimesh, që synojnë:

- zgjerimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar mbi përcaktimin e kompetencave funksionale dhe procedurale në ngarkim të KVSP-ve, si dhe anëtarëve të përhershëm dhe vëzhgues, të cilët, ngarkohen të parët me të drejta dhe detyrime në zbatim të detyrës funksionale, ndërsa të dytët ftohen të angazhohen në format këshillues për shkëmbim informacioni ndërinstitucional;

- nxitjen e bashkëpunimit të institucioneve qendrore e në nivel vendor për t'u angazhuar me komunitetin, përfaqësuesit fetarë, organizatat e shoqërisë civile, si dhe aktorë të tjerë, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e problematikave në kuadër të sigurisë publike;

- identifikimin dhe kuptimin e shqetësimeve socio-ekonomike, të komuniteteve lokale, në mënyrë që të bëhet i mundur trajtimi i shkaqeve rrënjësore mbi parandalimin, identifikimin, referimin dhe trajtimin e fenomeneve negative në dëm të qytetarëve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e çështjeve që lidhen me sigurinë lokale, si dhe në përballimin dhe rimëkëmbjen nga situatat që krijohen nga fatkeqësitë natyrore apo emergjenca civile të shkaktuara nga faktorë natyrorë, apo nga vetë njerëzit. Në përmbushjen e këtij objektivi nevojitet krijimi i burimeve të mjaftueshme financiare për përballimin e situatave, si dhe ngritja dhe funksionimi i strukturave për menaxhimin e këtyre situatave, mobilizimi i publikut dhe vullnetarëve për trajtimin dhe eliminimin e pasojave, si dhe funksionimi i sistemeve paralajmëruese në komunitet, me qëllim shmangien apo minimizimin e rreziqeve.

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht, nuk ka një akt ligjor ose nënligjor në fuqi, i cili të përcaktojë shprehimisht rolin e KVSP-ve, si dhe përfshirjen e komunitetit në fuqizimin e KVSP-ve. Në mënyrë që roli i KVSP-ve të jetë efektiv, kontributi i komunitetit në fuqizimin dhe bashkëveprimin me KVSP-të duhet të jetë i unifikuar në 61 bashkitë e vendit. Nuk kanë pasur asnjë efekt praktik dhe impakt në komunitetin e gjerë dhe gjenden ende larg pritshmërisë për të funksionuar si forume të diskutimit për çështjet e sigurisë vendore dhe të planifikimit të përbashkët të burimeve në dispozicion.

Sfida më e madhe në forcimin e këtij mekanizmi janë aktet ligjore rregulluese dhe mirëfunksionimi i rregullt dhe periodik.

Megjithëse roli i njësive të vetëqeverisjes vendore është fuqizuar, me hyrjen në fuqi të reformës territoriale, dhe këto struktura kanë një rol më aktiv gjatë viteve të fundit, do të ishte e nevojshme që roli i tyre të fuqizohej edhe më tej, duke krijuar struktura të posaçme për sigurinë në komunitet, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 (kompetencat e këshillit të bashkisë dhe kryetarit të bashkisë), si dhe të miratohet një buxhet i veçantë për funksionimin e këtyre strukturave në nivel bashkie dhe të njësive administrative.

Treguesit e performancës:

2.2.1 Krijimi i një modeli të unifikuar për funksionimin e KVSP-ve dhe zbatimi i KVSP-ve në të gjitha bashkitë e vendit;

2.2.2 Indeksi i funksionimit të KVSP-ve në 61 bashkitë e vendit;

2.2.3 Fuqizimi i strukturave të reja dhe i atyre ekzistuese, me qëllim fuqizimin e tyre për kompetencat dhe detyrat që duhen të ushtrojnë për sigurinë në komunitet;

2.2.4 Shtimi i investimeve për funksionimin e strukturave të vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e problematikave/situatave nëpërmjet burimeve të shtuara financiare.

Indikatorë të matshëm:

2.2.1.1 Dokumenti ligjor që përcakton në mënyrë të unifikuar funksionimin dhe mënyrën e zbatimit të KVSP-ve në të gjitha bashkitë e vendit;

2.2.2.1 Ngritja dhe bërja funksionale e KVSP-ve në çdo bashki të vendit deri në 2024;

2.2.3.1 Numri i udhëzimeve/urdhra që përcaktojnë dhe rishikojnë kompetencat dhe përgjegjësitë për secilin aktor;

2.2.4 Numri i investimeve të raportuara nga bashkia në përgjigje të çështjeve të sigurisë në komunitet të ngritura në KVSP.

[132] Bashkia Elbasan është e para bashki që ndërmori krijimin e këtij mekanizmi koordinues, ku aktualisht janë të ngritur dhe konstituar 57 KVSP.

Rezultate të pritshme:

2.2.1.1 Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore për ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve;

2.2.2.1.1 Numri i bashkive që raportojnë ngritjen dhe funksionimin e KVSP-ve;

2.2.2.1.2 Numri i Planveprimeve të KVSP-ve për fuqizimin e parametrave të sigurisë publike;

2.2.3.1.1 Numri i udhëzimeve/urdhra të dalë për përcaktimi i kompetencave dhe roleve të tjera të aktorëve përgjegjës, si: kryepleqtë/kryetarët e lagjeve; strukturat pranë njësive administrative/bashkive dhe për administratorët e pallateve që normojnë veprimtarinë e këtyre aktorëve në këto fusha lidhur me evidentimin, adresimin dhe trajtimin e problematikave në fushën e sigurisë në komunitet;

2.2.3.1.2 Hartimi i udhëzimit/ urdhrit për rishikimin i rolit dhe përgjegjësive të policisë bashkiake;

2.2.4.1 Rritja e numrit të investimeve të raportuara nga bashkitë në përgjigje të çështjeve të sigurisë në komunitet të ngritura në KVSP.

Masa 12. Funksionimi i plotë i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)

Hartimi i Plan Veprimeve të KVSP-ve për fuqizimin e parametrave të sigurisë publike në bashkëpunim me institucionet shtetërore në nivel vendor me Policinë e Shtetit. Funksionaliteti dhe performanca e KVSP-ve do të forcohet për të zyrtarizuar procesin, duke ndërtuar në uniformitet strukturën, procedurat, pikat e kontaktit dhe rezultatet. Kjo do të arrihet përmes krijimit të bazës ligjore dhe protokolleve të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit, si dhe një vizioni të qartë të kontributit të rëndësishëm që KSVP-të mund të japin në përmirësimin e sigurisë së të gjitha komuniteteve.

Institucionet përgjegjëse do të shkëmbejnë informacione në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe KVSP-të do të përdorin informacion për të siguruar inteligjencën më të mirë që do të mbështesë vendimet lokale dhe zgjidhjet e problemeve në partneritet, duke iu drejtuar për zbatim institucionit përgjegjës më të përshtatshëm për veprim.

Gjithashtu, do të synohet fuqizimi i rolit të aktorëve të tjerë vendorë për parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore, si dhe veprimeve të tjera të dhunshme, fuqizimi i këshillave të komuniteteve në lagje, vënia në funksion e vullnetarëve të policisë përmes përzgjedhjes, si dhe trajnimit dhe koordinimit të veprimtarisë në terren.

Masa 13. Fuqizimi i roleve të aktorëve të tjerë që kontribuojnë në sigurinë në komunitet

Gjithashtu, do të synohet fuqizimi i rolit të aktorëve të tjerë vendorë për parandalimin e konflikteve, sjelljeve antishoqërore dhe veprimeve të tjera të dhunshme, si dhe fuqizimi i këshillave të komuniteteve në lagje, vënia në funksion e vullnetarëve të policisë përmes përzgjedhjes, trajnimit dhe koordinimit të veprimtarisë në terren.

Analiza e situatës dhe sfidat

Gjatë viteve të fundit, angazhimi i aktorëve/strukturave të tjera shtetërore apo të pushtetit vendor, për zbatimin e detyrimeve ligjore që kanë në parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve ligjore në territor nuk ka qenë në nivelin e duhur, duke ngarkuar më shumë strukturat e Policisë së Shtetit në këtë drejtim.

Si rrjedhojë, konsiderohet i domosdoshëm krijimi i strukturave të reja dhe fuqizimi i atyre ekzistuese, me qëllim zbatimin e kompetencave që përcaktohen nga ligji organik përkatës sipas fushëveprimit që mbulojnë, si p.sh: për krimet mjedisore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komunitetit, (mbrojtja e tokës, ajrit, ujërave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja e pyjeve/pemëve frutore e dekorative, mbrojtja e faunës dhe florës, etj. të cilat parashikohen nga ligji si vepra penale dhe janë përcaktuar kompetencat e aktorëve/institucioneve përkatëse dhe sanksionet ligjore ndaj shkelësve në ligjet përkatëse.

Rishikimi i akteve ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e këtyre aktorëve në këto fusha veprimi, me qëllim fuqizimin e tyre për kompetencat dhe atributet që duhen të ushtrojnë punonjësit e këtyre strukturave.

Gjithashtu duhet një fokus i veçantë sa i takon aktivizimit të disa strukturave që kanë qenë ndër vite si ato të grupeve të vullnetarëve në terren, organizimi dhe motivimi për dhënien e kontributit të tyre në fushën e mbrojtjes, parandalimit dhe goditjes së veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor do të vlerësohej i rëndësishëm.

Rishikimi apo hartimi i akteve të reja përkatëse (marrëveshje, memorandume, procedura pune etj.) të këtyre aktorëve/strukturave me strukturat ligjzbatuese në vend (polici, prokurori, etj.), me

qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale dhe paligjshmërisë në territor.

Objektivi specifik 2.3. Rritja e mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike

Masa 14. Krijimi i një fondi të veçantë për sigurinë në komunitet

Vlerësohet si i nevojshëm planifikimi i buxhetit bashkiak për çështje që lidhen me sigurinë dhe rendin në komunitete, përfshirë çështje që lidhen me emergjencat civile, si dhe vendosja e pajisjeve monitoruese (teknologjike) nga institucionet vendore, për të ndihmuar në identifikimin dhe parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe qytetarëve me rrezikshmëri shoqërore (në bashkërendim me Policinë e Shtetit), nën konceptin e ***Smart Cities***.

Masa 15. Rishikimi i rolit dhe përgjegjësive të policisë bashkiake

Masat kyçe do të lidhen me rishikimin e ligjit për Policinë Bashkiake, i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura në funksion të sigurisë publike, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit.

Masa 16. Konsolidimi i strukturave të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike

Kjo masë synon unifikimin nëpërmjet hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore të strukturës së KVSP-ve. Me hartimin e këtyre akteve, do të mundësohet krijimi i një baze ligjore për organizimin dhe funksionimin e Këshillave të Sigurisë në mënyrë efektive, me qëllim konsolidimin e kësaj strukture në nivel vendor.

Në këtë kuadër do të realizohet:

- ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike;
- përmirësimi i kuadrit ligjor të funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja e të gjithë aktorëve institucionalë;
- përmirësimi i kuadrit rregullator të funksionimit të brendshëm të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike;
- themelimi i rrjetit kombëtar të KVSP-ve dhe i një strukture të përhershme koordinuese të tyre;
- trajnimi i pjesëmarrësve të KVSP-ve mbi çështje të sigurisë në komunitet, si dhuna në familje, kriminaliteti, siguria në institucione arsimore parauniversitare përdorimi i lëndëve narkotike;
- përmirësimi i koordinimit mes KVSP-ve dhe strukturave të tjera lokale, përgjegjëse për menaxhimin e krizave, përfshirë katastrofat natyrore dhe kërcënimet për shëndetin publik (pandemitë), nëpërmjet hartimit të planeve të përbashkëta lokale;
- rritja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar në KVSP, nëpërmjet ndërmarrjes së fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit nga KVSP-të, lidhur me rreziqet e sigurisë në komunitet dhe informimin e publikut mbi rolin e të gjithë aktorëve lokalë institucionalë.

Masa 17. Rishikim i akteve ligjore për përmirësimin e detyrave të administratorëve të njësive administrative, hapjen e zyrave dhe shërbim të përhershëm të policisë në çdo bashki dhe njësi administrative

Kjo masë synon përmirësimin e kuadrit ligjor, me qëllim përmirësimin e detyrave të administratorëve të njësive administrative, si dhe krijimin e kushteve më të mira duke përdorur fonde nga donatorë dhe partnerë të tjerë, me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe ofrimin e pajisjeve logjistike për përmbushjen e detyrave.

Politika 3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet

Zbatimi i Strategjisë së Sigurisë në Komunitet kërkon ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm në lidhje me reformimin e shërbimit policor, përmirësim organizativ dhe të kulturës së punës së vetë Policisë së Shtetit, në mënyrë që një grup vlerash thelbësore të udhëheqin mënyrën e ofrimit të shërbimit ndaj komunitetit dhe të bëhen promotor i rritjes së standardeve të punës.

Përmirësimi organizativ përfshin integrimin e filozofisë së sigurisë në komunitet në veprimtarinë e Policisë së Shtetit, në misionin, politikat, planifikimin dhe procedurat, vlerësimin e performancës, trajnimin, praktikat e rekrutimit dhe zhvillimit të karrierës, në sistemet dhe metodat e sigurisë që përcaktojnë kulturën organizative dhe veprimtarinë e saj.

Përmirësimi organizativ synohet të arrihet edhe nëpërmjet krijimit të strukturave të specializuara të implementimit dhe integrimit të kësaj strategjie në veprimtarinë e gjithë shërbimeve policore. Në fokus do të jetë rishikimi i funksioneve,

përmirësimi i strukturave dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe mirëqenies së punonjësve të policisë si në aspektin logjistik, infrastrukturës, po ashtu dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale. Kjo politikë ka në fokus dy objektiva specifikë kryesorë:



Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet

Përmirësimi i strukturave të policimit në komunitet veçanërisht, përmirësimi i funksionit të ndihmës specialistit të policimit në komunitet NSPK/SPZ të zonës policore (pasi policim në komunitet kryejnë të gjitha strukturat e PSH-së) ka të bëjë me faktin që ky funksion të jetë i veçantë vetëm për policimin në komunitet (për kryerjen e aktiviteteve me fokus komunitetin dhe forcimin e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në zonën policore), duke mos pasur më rol "represiv" siç funksionon aktualisht, ku ka edhe përgjegjësi të tjera si: kontrolle banesash, shoqërime/ndalime personash, ndërhyrje dhe pjesëmarrje në operacione policore, kapjen e personave në kërkim, kontrolle territori për kanabis etj.

Gjithashtu, bazuar në situatën aktuale të strukturës vendore organike të policimit në komunitet rezulton se në zonat rurale, numri i NSPK/SPZ-ve është i pamjaftueshëm për të mbuluar territorin dhe për të realizuar detyrat e përgjegjësitë funksionale, pra rrjedhimisht është e nevojshme të konsiderohet mundësia e rritjes së kapaciteteve të punonjësve të policimit në komunitet në zonat rurale, të paktën edhe me një punonjës shtesë brenda zonës policore (1 SPZ dhe një ndihmës i tij = patrullë policie), pasi në të gjitha zonat urbane funksionon patrulla e përgjithshme të policisë, ndërsa në zonat policore rurale nuk ka punonjës të patrullës së përgjithshme.

Si përfundim, përmirësimi i strukturave të policimit në komunitet synon:

- funksion/strukturë të veçantë vetëm për policimin në komunitet;
- rritjen e kapaciteteve të punonjësve të policimit në komunitet në zonat rurale.

Gjithashtu, do të nevojitet përcaktimi i objektivave afatshkurtër për njësitë e vetëqeverisjes vendore për miratimin e strukturës, përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive, si dhe përcaktimin e një buxheti për Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike.

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht në strukturat vendore të PK ushtrohen funksionet e NSPK/SPZ të zonës policore dhe NSPK/SPZ për edukimin dhe punën me të rinjtë.

Sa i përket funksionit organik të NSPK/SPZ për edukimin dhe punën me të rinjtë është e nevojshme të shtohet si funksion edhe në komisariatet e tjera të policisë, duke vlerësuar edukimin me të rinjtë si një element kyç për parandalimin, ndërsa për funksionin organik të NSPK/SPZ të zonës policore është e domosdoshme që funksioni të jetë i veçantë vetëm për policimin në komunitet (për kryerjen e aktiviteteve me fokus komunitetin dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët e tjerë në zonën policore) dhe jo siç funksionin aktualisht, ku ka edhe përgjegjësi të karakterit represiv si: kontrolle banesash, shoqërime/ndalime personash, ndërhyrje dhe pjesëmarrje në operacione policore, kapja e personave në kërkim, kontrolle për kanabis etj.

Krahas strukturave të Policisë së Shtetit për shërbimin ndaj komunitetit, në territor janë edhe shumë aktorë/struktura të tjera shtetërore dhe jo vetëm, të cilat kërkojnë përmirësim dhe fuqizim të tyre për realizimin sa më mirë të përgjegjësive dhe detyrimeve që kanë ndaj komunitetit, pa përjashtuar përfshirjen edhe të organizatave joqeveritare dhe komunitetet fetare që operojnë në territor.

Treguesit kryesorë të performancës:

3.1.1 Fuqizimi i kapaciteteve policore në shërbim të komunitetit;

3.1.2 Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të zonës policore në Akademinë e Sigurisë.

Indikatorë të matshëm:

3.1.1.1 Rritja e numrit të NSPK/SPZ me funksion në shërbim të komunitetit;

3.1.1.2 Numri i punonjësve të policisë në komunitet në raport me popullsinë;

3.1.1.3 Numri i punonjësve sipas strukturës dhe funksioneve të përcaktuara në sektorin e planifikimit, monitorimit dhe analizës strategjike në nivel vendor e qendror;

3.1.2.1 Numri i trajnimeve të kryera;

3.1.2.2 Numri i punonjësve të trajnuar.

Rezultate të pritshme:

3.1.1.1.1 Rritja e numrit të punonjësve në zonat rurale;

3.1.1.1.1 Ulja e numrit të ankesave, konflikteve dhe problematikave të çështjeve që shqetësojnë komunitetin, etj.;

3.1.2.1.1 Rritja e trajnimeve me tema që mbulojnë çështje policore në shërbim të komunitetit;

3.1.2.2.1 Rritja e numrit të punonjësve të trajnuar sipas çështjeve që mbulojnë në funksione;

3.1.2.2.2 Rritja e numrit të grave të punonjësve të PSH-s të trajnuara, sipas çështjeve që mbulojnë në funksione.

Masa 18. Fuqizimi i burimeve njerëzore

Masat do të lidhen me ofrimin e sigurisë në komunitet nëpërmjet fuqizimit të burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit në funksion të policimit në komunitet, nëpërmjet krijimit të një strukture të dedikuar për policimin në Komunitet, përmirësimit dhe shtrirjes së plotë të funksionimit të zonave policore, si dhe implementimi i ndryshimeve të funksioneve të reja të NSPK-ve dhe strukturave të tjera të ZP-ve.

Orientimi për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në komunitet kërkon një vëmendje të veçantë në aftësitë analitike dhe menaxhimin e sistemeve nga ekspertët për të marrë mbështetjen më të vlefshme të informacionit. Në fokus do të jetë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i strukturave të sektorit të planifikimit, monitorimit dhe analizës strategjike në çdo Drejtori Vendore të Policisë dhe në nivel qendror.

Roli i oficerëve të sigurisë në institucione arsimore parauniversitare do të rishikohet me rigorozitet për të siguruar uniformitetin e rolit dhe përgjegjësive në të gjithë Shqipërinë dhe për të siguruar arritjen e praktikave më të mira.

PSH-ja do të rekrutojë, trajnojë dhe caktojë oficerë të përkushtuar dhe me integritet të policimit në komunitet në zonat policore, si dhe do të ofrojë mbështetje për të siguruar forcimin e kapaciteteve të punonjësve, si dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Masa 19. Rritja e kapaciteteve

Kjo masë synohet të realizohet nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të punonjësve, duke ofruar trajnim dhe kualifikime, me fokus përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të zonës policore në Akademisë së Sigurisë. Gjithashtu, marrjen e masave të ndryshme të lidhura me trajnimin e punonjësve të policisë në funksione dhe detyra të ndryshme, si dhe përmirësimin e kurrikulave e ofrimin e trajnimeve periodike për NSPK-të, patrullën e përgjithshme dhe aktorëve relevantë në ruajtjen e rendit dhe sigurisë.

Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta midis punonjësve të policisë dhe aktorëve të tjerë shtetërorë e privatë që operojnë në "zonën policore", me fokus ndarjen/ marrjen e përgjegjësive/detyrimeve ligjore që ka secili në fushën e sigurisë publike, por edhe për rritjen e bashkëpunimit e ndërveprimit për parandalimin e veprimtarisë kriminale, paligjshmërisë dhe sjelljeve antishoqërore në territor, konstatimin, evidentimin dhe ndëshkimin e tyre konform akteve ligjore në fuqi.

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë

Në fokus do të jenë masat që do të përmirësojnë përgjegjshmërinë, kontrollin dhe performancën e punonjësve të Policisë së Shtetit në nivel qendror dhe vendor, të cilat do të përmirësojnë rekrutimin, zhvillimin dhe karrierën (përfshirë masat për angazhimin e grave apo grupeve minoritare), si dhe masat që garantojnë cilësinë e kushteve të punës dhe mirëqenien e punonjësve të lidhura me infrastrukturën, pajisjet, mjetet, uniformën, teknologjinë, etj. Ndërhyrjet gjithashtu do të sigurojnë prezantim dinjitoz para komunitetit i punonjësve të zonës policore për

policim në komunitet, si dhe dhënia e të drejtave të përcaktuara me ligj dhe nxitja për kryerjen sa më mirë të detyrave në fushën e policimit në komunitet

Analiza e situatës dhe sfidat

Aktualisht, strukturat vendore të PK-s janë të organizuara mbi bazën e "Zonës Policore", të ndara në zona policore urbane dhe zona policore rurale. Kryesisht, kushtet e punës në zonat urbane vlerësohen të mira, ndërsa në zonat rurale ka nevojë për krijimin e ambienteve të punës për punonjësit e policisë të "Zonës Policore", si dhe përmirësimin e kushteve në ato ambiente ekzistuese, duke marrë masa të plota për kompletimin e zyrave të punës me infrastrukturën e nevojshme për punë dhe për pritjen e qytetarëve si; tavolina, karrige, kompjuterë, printer, linjë interneti, pajisje për ngrohje/ftohje etj.

Përmirësimi i kushteve të punës dhe motivimi për punonjësit e policisë të "Zonës Policore", si dhe kompletimi i tyre me automjet për lëvizje dhe pajisje policie, vlerësohet i rëndësishëm, pasi do të bëjë të mundur shfrytëzimin në mënyrë eficiente të kohës së punës në zonën policore, ndjekjen më nga afër të problematikave dhe shqetësimeve të komunitetit, si dhe parandalimin në kohë të ngjarjeve të mundshme apo veprave penale.

Treguesit kryesorë të performancës

3.2.1 Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit e policisë të "Zonës Policore";

3.2.2 Përmirësimi i masave motivuese për kryerjen sa më të mirë të shërbimit të punonjësve të policisë të "Zonës Policore".

Indikatorë të matshëm:

3.2.1.1 Numri i hapjes së zyrave të reja në zonën policore;

3.2.1.2 Numri i zyrave policore të rikonstruktuara;

3.2.1.3 Numri i zyrave policore të pajisura me infrastrukturë për punë;

3.2.2.1 Numri i punonjësve të policisë të zonës policore pajisur me automjete shërbimi;

3.2.2.2 Numri i specialistëve të policimit në komunitet NSPK/SPZ, që marrin gradën "Inspektor i parë" për ndihmës bazuar në Ligjin për Policinë e Shtetit;

3.2.2.3 Numri i orëve suplementare të paguara për punonjësit e policimit në komunitet mbi kohën normale të punës;

3.2.2.4 Vendosja e një shenje të veçantë dalluese për punonjësit e policimit në komunitet NSPK/SPZ dhe numri i punonjësve të identifikuar me shenjën dalluese;

3.2.2.5 Numri i punonjësve të pajisur me uniforma të reja policore.

Rezultate të pritshme:

3.2.1.1 Rritja e numrit të zyrave policore me infrastrukturën e nevojshme për punë dhe për pritjen e qytetarëve;

3.2.2.1.1 Kompletimi i të gjithë punonjësve të policisë të zonës policore me automjete shërbimi (kryesisht në zonat rurale) për të motivuar dhe lehtësuar realizimin e detyrave funksionale;

3.2.2.1.2 Rritja e numrit të automjeteve të shërbimit në dispozicion të punonjësve të policisë të zonës policore;

3.2.2.2 Rritja e numrit të specialistëve të policimit në komunitet NSPK/SPZ, që marrin gradën "Inspektor i parë" për ndihmës, bazuar në Ligjin për Policinë e Shtetit;

3.2.2.3 Barazimi i numrit të orëve suplementare të paguara për punonjësit e policimit në komunitet me kohën suplementare të punës;

3.2.2.4 Rritja e numrit të punonjësve të policimit në komunitet NSPK/SPZ të identifikuar me shenjën dalluese;

3.2.2.5 Rritja e numrit të punonjësve të pajisur me uniforma të reja policore, duke i dhënë një paraqitje dinjitoze punonjësve përballë komunitetit/publikut.

Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet përmbushjes së masave të mëposhtme:

Masa 20. Krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe rurale

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me drejtuesit e pushtetit vendor dhe të institucioneve të tjera shtetërore, me qëllim gjetjen e ambienteve sa më të përshtatshme të cilat mund të përdoren nga punonjësit e "Zonës policore" kryesisht nga punonjësit e policimit në komunitet. Këto ambiente/zyra duhen të jenë sa më afër qendrave të njësive administrative që bëjnë të mundur ofrimin e lehtësirave për qytetarët dhe të qenurit më të aksesueshme për ta.

Masa 21. Rikonstruksioni i zyrave ekzistuese në zonat policore urbane dhe rurale

Drejtuesit e strukturave vendore të PSH duhet të kryejnë vlerësimin e ambienteve/zyrave aktuale të shërbimit policor pranë njësive administrative në

zonat urbane dhe rurale, me qëllim evidentimin e gjendjes së tyre aktuale, përcaktimin e zyrave që kanë nevojë për rikonstruksion dhe planifikimin/buthtimin e marrjen e masave për rikonstruksionin e tyre, duke shfrytëzuar burimet financiare e materiale që disponojnë, si dhe duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në juridiksionin territorial të njësisë policore.

Masa 22. Kompletimi me infrastrukturë për punë i zyrave në zonat policore urbane dhe rurale, me uniformë dinjitoze dhe mjete e pajisje policie

Drejtuesit e strukturave vendore të PSH-së duhet të kryejnë vlerësimin e ambienteve/zyrave aktuale të shërbimit policor pranë njësive administrative në zonat urbane dhe rurale dhe të atyre të hapura të reja, duke evidentuar nevojat që këto zyra kanë për t'u bërë funksionale dhe me parametra të pranueshëm pune.

Mbi bazën e nevojave do të merren edhe masat përkatëse për kompletimin dhe pajisjen e tyre me infrastrukturën e nevojshme për punë (tavolina, karrige, kompjuter, printer, internet, kasafortë, rafte, pajisje ngrohje/ftohje, etj.), për pritjen e qytetarëve dhe trajtimin e shqetësimeve e problematikave të tyre, si dhe shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës, duke shmangur sorollatjet e qytetarëve dhe lëvizjet boshe të NSPK/SPZ-ve nga zona në njësinë policore e anasjelltas. Për këtë qëllim, duhen shfrytëzuar burimet financiare e materiale që kanë strukturat vendore të policisë, por edhe duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në juridiksionin territorial të njësisë policore.

Masa 23. Motivimi i punonjësve të policisë të zonës policore

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet rishikimit të mundësive për rritjen e pagave për punonjësit e policisë, nëpërmjet propozimeve dhe diferencimeve të pagave mes strukturave e funksioneve të ndryshme që janë pjesë e "zonës policore".

Gjithashtu, vlerësohen shumë të rëndësishëm ndërmarrja e hapave të mëposhtëm, për motivimin e punonjësve të zonës policore, e në veçanti të punonjësve të policimit në komunitet:

- dhënia e gradës "Inspektor i parë" për ndihmës specialistët e policimit në komunitet NSPK/SPZ, bazuar në ligjin për Policinë e Shtetit;

- pagesa e orëve suplementare të kryera nga punonjësit e policimit në komunitet mbi kohën normale të punës;

- vendosja e një shenje të veçantë dalluese për punonjësit e policimit në komunitet NSPK/SPZ, dhe pajisja me uniforma të reja policore, duke i dhënë një paraqitje dinjitoze këtyre punonjësve përballë komunitetit/publikut;

- kompletimi i punonjësve të policisë të zonës policore me automjete shërbimi (kryesisht në zonat rurale) për të motivuar dhe lehtësuar realizimin e detyrave funksionale.

PJESA III – MASAT PRIORITARE PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË

Bazuar në objektivat specifikë të parashikuar në këtë dokument strategjik, me qëllim përmbushjen e tyre, ndër masat prioritare përmendim, si më poshtë:

- forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese;

- realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike

- parandalimi nëpërmjet edukimit;

- përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit;

- funksionimi i plotë i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP);

- krijimi i një fondi të veçantë për sigurinë në komunitet;

- fuqizimi i burimeve njerëzore;

- krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe rurale.

Disa prej këtyre masave synohen të realizohen nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit, por gjithashtu të mbështetura edhe në donatorë, të cilët kanë programuar disa zëra në buxhetet e tyre.

Programi "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" (*SCPA*), i cili financohet nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida), është një nga donatorët, i cili mbështet edhe disa masave specifike në këtë dokument. Sa i përket masës "Realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike" është parashikuar të mbështetet nga programi suedez SCPA për realizimin e SMSK-ve, anketimeve, intervistave, pyetësorëve mbi kënaqësinë publikut te Policia e Shtetit dhe institucionet, i cili ka parashikuar fonde për

kryerjen e anketës kombëtare për kënaqësinë e publikut me punën e Policisë për vitin 2022, anketës për Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet (Elbasan dhe Kukës).

Gjithashtu, në lidhje me masën "Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit", ky program ka parashikuar një fond të posaçëm për blerjen e pajisjeve për policinë rrugore (tableta, radarë). Kostot e parashikuara nga ky program për realizimin e këtyre masave, por edhe komponentëve të tjerë janë përfshirë në aneksin e Planit të Veprimit.

PJESA IV – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Përgjegjësia e institucioneve

Institucionet përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e Strategjisë në Komunitet dhe Planin e Veprimit janë:

- Ministria e Brendshme;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
- Ministritë e linjës ku përfshihen ministritë e ngarkuara me zbatimin e këtij dokumenti, që ngarkohen për masa/aktivitete specifike sipas fushave të tyre të përgjegjësisë;
- Institucionet shtetërore: institucione të varësisë së ministrive të linjës të ngarkuara në dokument.

Pushteti vendor

- Prefektët e qarqeve;
- Këshillat Vendorë të Sigurisë publike;
- Kryetarët e këshillave të qarqeve;
- Kryetarët e bashkive;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet arsimore parauniversitare;
- Institucionet e tjera të linjës - institucione të pushtetit vendor;
- Shoqata të ndryshme në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të njeriut, gruas, fëmijëve, minoriteteve dhe komuniteteve;
- OJF-të me aktivitet në këtë fushë në Shqipëri;
- Media kombëtare dhe lokale, si dhe çdo grup apo individ i interesuar etj.

Roli specifik i bashkive në kuadër të sigurisë në komunitet në nivel vendor

Siç është shprehur dhe në analizën e kësaj strategjie, angazhimi i aktorëve/strukturave të tjera shtetërore apo të pushtetit vendor, për zbatimin e detyrimeve ligjore që kanë në parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve ligjore në territor nuk ka qenë në nivelin e duhur, duke ngarkuar më shumë strukturat e Policisë së Shtetit në këtë drejtim. Po kështu, me hyrjen në fuqi të reformës territoriale, roli i njësive të vetëqeverisjes vendore është fuqizuar dhe këto struktura kanë pasur një rol më aktiv gjatë viteve të fundit, por do të synohet fuqizimi i rolit të tyre edhe më tej, duke krijuar struktura të posaçme për sigurinë në komunitet, në përputhje me ligjin nr. 139/2015 (kompetencat e këshillit të bashkisë dhe kryetarit të bashkisë), si dhe mundësimin e miratimit të një buxhet i të veçantë për funksionimin e këtyre strukturave në nivel bashkie dhe të njësive administrative.

4.2 Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Llogaridhënia

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS".

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese si më poshtë:

- Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);
- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për

përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë së Sigurisë në Komunitet do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit mbi Sigurinë në Komunitet do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë në komunitet (përfshirë MB/DPPSH, MASR, MSHMS, bashkitë – AMVV, KVSP-të), Donatorë dhe shoqërinë civile, (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së objektivave strategjikë të sigurisë në komunitet, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integrimit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve;
- monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura sigurinë në komunitet. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MB, DPPSH dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/ të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Të gjithë institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale së Sigurisë në Komunitet dhe Planin e Veprimit do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe një vjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6 mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatin Teknik Ndërinstitucional.

Komiteti Drejtues Sektorial "punët e brendshme", drejtuar nga ministri i Brendshëm, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të urdhrit të kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioriteteve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit.

Krahas monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet do të matet nëpërmjet vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të tre-vjeçarit, në fund të vitit 2023, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plani i Veprimit për vitet 2024 – 2026 për të arritur objektivat e vendosur në strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të sigurisë në komunitet. Po në këtë kuadër do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit, si dhe raporte e studime të kryera nga shoqëria civile dhe donatorët.

PJESA V - BUXHETI

Efektet financiare përllogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe Planit të Veprimit 2021 – 2023, në mënyrë të detajuar.

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë produktet e Strategjisë së Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026. Efektet financiare janë përllogaritur nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe Planit të Veprimit 2021 – 2023, në mënyrë të detajuar.

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Plani i Veprimit 2021 – 2023 është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë në përmbushje të objektivave specifikë.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e kësaj strategjie dhe Planit të Veprimit është 7,760,392,246 lek, ose 62, 083,138 euro. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 125 lek për 1 euro.

Qëllimet e politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kosto totale 2021 – 2026	Kosto e planifikuar në PBA 2021 – 2023 Buxheti dhe donatorët	Kosto për t'u planifikuar në PBA 2022 – 2024 Buxheti dhe donatorët	Hendeku financiar 2021 – 2026
QP1: Rritja e parametrave të sigurisë	Korente	2,528,523,430	1,666,502,610	862,020,820	**0**
	Kapitale	531,840,000	35,000,000	496,840,000	
QP2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin	Korente	774,098,816	613,508,816	160,590,000	**0**
	Kapitale	0	0	0	
QP3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet	Korente	3,819,680,000	1,622,140,000	1,816,900,000	**454,390,000**
	Kapitale	106,250,000	5,000,000	27,500,000	
TOTALI [lekë]		**7,760,392,246**	**3,942,151,426**	**3,363,850,820**	**454,390,000**
TOTALI [euro] *1 euro = 125 lekë*		**62,083,138**	**31,537,211**	**26,910,807**	**3,635,120**

Qëllimi i Politikës 3, pritet të ketë në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e planit, përafërsisht në masën 51 %. Ndërsa qëllimi i politikës 1 dhe qëllimi i politikës 2 zënë përafërsisht përkatësisht 39 % dhe 10% në totalin e buxhetit të Planit të Veprimit.

Financimi i planit të veprimit të strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve. Për periudhën 2021 – 2023, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit përafërsisht në masën 50 % të financimit të nevojshëm, ndërsa 1% pritet të financohet nga donatorë të tjerë. Hendeku financiar vlerësohet të jete në masën përafërsisht 6 % të totalit të kostos financiare të gjithë viteve të strategjisë, e cila është hartuar mbi bazë supozimi që kostoja financiare pas vitit 2023, pritet të financohet nga PBA 2022 – 2024 e në vazhdim dhe donatorët.

Natyrat ekonomike e kostove të Planit të Veprimit



Peshën më të madhe për zbatimin e masave të Planit të Veprimit e zënë kostot korente, përkatësisht në masën 92 %. Ndërsa kostot kapitale përllogariten në masën 8 % të kostos totale të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026.

Kostot korente dhe kapitale të lidhur sipas qëllimit të politikave janë si më poshtë:



Plani i Veprimit të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet do të rishikohet në periudhë 3-vjeçare për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform programeve buxhetore afatmesme, si dhe prioriteteve të çdo institucioni. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor.

PLANI I VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË SIGURISË NË KOMUNITET 2021 – 2023

I. Forcimi i rendit publik dhe përgatitjes për rastet e emergjencave civile

II. QËLLIMI I POLITIKËS 1: RRITJA E PARAMETRAVE TË SIGURISË NË KOMUNITET

Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140; Programi Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160; Programi buxhetor 09120 (MASR); Programi buxhetor 01110 (MSHMS)

Nr.	Titulli	Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	Programi buxhetor: Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse: Institucioni përgjegjës	Institucionet përgjegjëse: Institucioni kontribuues	Afati i zbatimit: Afati i fillimit	Afati i zbatimit: Afati i mbarimit	Kosto indikative 2021: Korente	Kosto indikative 2021: Kapitale	Kosto indikative 2021: Totali i kostos	Kosto indikativë 2022: Korente	Kosto indikativë 2022: Kapitale	Kosto indikativë 2022: Totali i kostos	Kosto indikative 2023: Korente	Kosto indikative 2023: Kapitale	Kosto indikative 2023: Totali i kostos	Kosto indikativë 2024: Korente	Kosto indikativë 2024: Kapitale	Kosto indikativë 2024: Totali i kostos	Kosto indikativë 2025: Korente	Kosto indikativë 2025: Kapitale	Kosto indikativë 2025: Totali i kostos	Kosto indikativë 2026: Korente	Kosto indikativë 2026: Kapitale	Kosto indikativë 2026: Totali i kostos	Kosto indikative totale: Korente	Kosto indikative totale: Kapitale	Kosto indikative totale: Totali i kostos	Burimi i Financimit 2021-2023: PBA Buxhet Shteti (në lekë): Korente	PBA: Kapitale	PBA: Total BSH	Financim i huaj (në lekë): Korente	Financim i huaj: Kapitale	Financim i huaj: Emri donatorit/ titullin e projektit	Financim i huaj: Total financim i huaj	Kosto indikative 2024–2026: Korente	Kosto indikative 2024–2026: Kapitale	Kosto indikative 2024–2026: Totali i kostos	Hendeku financiar
1.1	**I. OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin**																																									
	Masa. 1 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese																																									
1.1.1	1.1.1 Shkëmbimi i informacioneve dhe treguesve të punës që shërbejnë për vlerësimin e riskut; Përcaktimi i zonave me risk të lartë		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	Bashkitë KVSP; ministritë e linjës	2021	2023	33,000,000	0	33,000,000	33,000,000	0	33,000,000	33,000,000	0	33,000,000	33,000,000	0	33,000,000	33,000,000	0	33,000,000	33,000,000	0	33,000,000	198,000,000	0	198,000,000	99,000,000	0	99,000,000	0	0		0	99,000,000	0	99,000,000	0
1.1.2	1.1.2 Zhvillimi i takimeve të përbashkëta në nivel vendor me përfshirjen e komunitetit dhe shoqërisë civile për çështjet e sigurisë		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	KVSP; Institucioni i Prefektit Institucionet shtetërore; Shoqëria civile; Komuniteti etj.	2021	2023	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	5,000,000	7,500,000	15,000,000	5,000,000	20,000,000	7,500,000	0	7,500,000	0	0		0	7,500,000	5,000,000	12,500,000	0
1.1.3	1. 1.3 Hartimi i planeve të veprimit/ masave parandaluese në lidhje me çështje të rëndësishme për sigurinë		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	KVSP; Institucioni i Prefektit; institucionet shtetërore	2021	2023	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	0	0	0	0	0	0	3,200,000	0	3,200,000	2,400,000	0	2,400,000	0	0		0	800,000	0	800,000	0
	Masa 2. Realizimi i vlerësimeve të riskut mbi baza lokale nga Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike																																			0	0	0	0
2.1.1	2. 1.1 Vlerësimi i treguesve të punës së strukturave të policisë së shtetit, krahasuar me periudhat paraardhëse		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140 Kodi 91604AA	DPPSH		2021	2023	22,000,000	0	22,000,000	22,000,000	0	22,000,000	22,000,000	0	22,000,000	22,000,000	0	22,000,000	22,000,000	0	22,000,000	22,000,000	0	22,000,000	132,000,000	0	132,000,000	66,000,000	0	66,000,000	0	0		0	66,000,000	0	66,000,000	0
2.1.2	2.1.2 Vlerësimi i informacioneve policore		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140 Kodi 91604AA	DPPSH		2021	2023	21,000,000	0	21,000,000	21,000,000	0	21,000,000	21,000,000	0	21,000,000	21,000,000	0	21,000,000	21,000,000	0	21,000,000	21,000,000	0	21,000,000	126,000,000	0	126,000,000	63,000,000	0	63,000,000	0	0		0	63,000,000	0	63,000,000	0
2.1.3	2. 1.3. Zhvillimi i analizave periodike (javore, mujore, 3, 6, 9 mujore dhe vjetore)		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140 Kodi 91604AA	DPPSH		2021	2023	31,500,000	0	31,500,000	23,500,000	0	23,500,000	23,500,000	0	23,500,000	23,500,000	0	23,500,000	23,500,000	0	23,500,000	23,500,000	0	23,500,000	149,000,000	0	149,000,000	78,500,000	0	78,500,000	0	0		0	70,500,000	0	70,500,000	0
2.1.4	2.1. 4 Kryerja e SMSK, anketimeve, intervista, pyetësorë mbi kënaqësinë e publikut te Policia dhe institucionet.		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	Programi SCPA; Shoqëria civile; OJF-të	2021	2023	18,750,000	0	18,750,000	18,750,000	0	18,750,000	18,750,000	0	18,750,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	56,250,000	0	56,250,000	56,250,000	0	56,250,000	0	0		0	0	0	0	0
	Masa 3. Proaktiviteti i shërbimit policor në lidhje me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve																																			0	0	0	0
3.1.1	3.1. 1 Përmirësimi i sistemit MPÇ		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH-DTI	DPPSH/Donatore	2021	2023	0		0	0	70,000,000	70,000,000	0	70,000,000	70,000,000	0	0	0		0	0	0	0	0	0	140,000,000	140,000,000	0	0	0	0	0		0	0	140,000,000	140,000,000	0
3.1.2	3.1.2 Integrimi i MPÇ me sistemet e tjera TI		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH-DTI	DPPSH/Donatore	2021	2023	0		0	0	0	0	0	0	0	7,000,000	0	7,000,000	7,000,000	0	7,000,000	7,000,000	0	7,000,000	21,000,000	0	21,000,000	0	0	0	0	0		0	21,000,000	0	21,000,000	0
	Kostoja e objektivit specifik 1.1.							**129,550,000**	**0**	**129,550,000**	**121,550,000**	**70,000,000**	**191,550,000**	**121,550,000**	**70,000,000**	**191,550,000**	**109,800,000**	**0**	**109,800,000**	**109,000,000**	**0**	**109,000,000**	**109,000,000**	**5,000,000**	**114,000,000**	**700,450,000**	**145,000,000**	**845,450,000**	**372,650,000**	**0**	**372,650,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**327,800,000**	**145,000,000**	**472,800,000**	**0**
	Objektivi specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet																																									
	Masa 4. Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit i orientuar nga Inteligjenca dhe Informacioni																																									
4.1.1	4.1.1 Mbledhja, analizimi dhe vlerësimi i informacioneve për çështje që shqetësojnë komunitetin	Monitorime të kryera në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve	Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	KVSP; institucionet e tjera të linjës	2021	2023	158,000,000	0	158,000,000	158,000,000	0	158,000,000	158,000,000	0	158,000,000	158,000,000	0	158,000,000	158,000,000	0	158,000,000	158,000,000	0	158,000,000	948,000,000	0	948,000,000	474,000,000	0	474,000,000	0	0		0	474,000,000	0	474,000,000	0
4.1.2	4.1.2 Përcaktimi i zonave problematike "të nxehta"	Monitorime të kryera në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve	Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	KVSP; institucionet e tjera të linjës	2021	2023	10,550,000	0	10,550,000	2,550,000	0	2,550,000	2,550,000	0	2,550,000	10,550,000	0	10,550,000	10,550,000	0	10,550,000	10,550,000	0	10,550,000	47,300,000	0	47,300,000	15,650,000	0	15,650,000	0	0		0	31,650,000	0	31,650,000	0
4.1.3	4.1.3 Hartimi i planeve dhe zbatimi i masave konkrete në zonat e nxehta		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	KVSP; NJVV; Institucionet e tjera të linjës	2021	2023	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	36,000,000	0	36,000,000	18,000,000	0	18,000,000	0	0		0	18,000,000	0	18,000,000	0
	Masa 5. Parandalimi nëpërmjet edukimit																																			0	0	0	0
5.1.1	5.1. 1. Zhvillimi i Programit Sensibilizues "Jo drogës, alkolit, duhanit, etj.", në shkolla		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140; Programi buxhetor 09120 kodi 91103AE	DPPSH	ASCAP; Programi SCPA	2021	2023	10,625,000	0	10,625,000	10,775,000	0	10,775,000	10,775,000	0	10,775,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	32,175,000	0	32,175,000	30,300,000	0	30,300,000	1,875,000	0	SCPA	1,875,000	0	0	0	0
5.1.2	5.1. 2. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese me publikun dhe fokus grupe të veçanta, për çështjet e krimit, rendit dhe sjelljeve antishoqërore		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140;	DPPSH	MASR; SCPA; KVSP; NJVV	2021	2023	3,750,000	0	3,750,000	3,750,000	0	3,750,000	3,750,000		3,750,000	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	0	2,500,000	2,500,000	0	2,500,000	18,750,000	0	18,750,000	7,500,000	0	7,500,000	3,750,000	0	SCPA	3,750,000	7,500,000	0	7,500,000	0
5.1.3	5.1.3 Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë; Fuqizimi i rrjetit të shkollave-qendra komunitare si burim për të nxënit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve		Programi buxhetor 09120 kodi 91103AE	ASCAP	DPAP; MASR	2021	2023	200,000	0	200,000	200,000	0	200,000		0	0		0	0	0	0	0		0	0	400,000	0	400,000	400,000	0	400,000	0	0		0	0	0	0	0
5.1.4	5.1.4 Fuqizimi i rolit të punonjësve shërbimit psikosocial për të gjithë nxënësit, veçanërisht të shtresave vulnerabël (romë, egjiptianë) nxënësve me aftësi të kufizuara në funksion të rritjes së		Programi buxhetor 09120 kodi i produktit 91103AB	MASR		2021	2023	150,865,092	0	150,865,092	150,865,092	0	150,865,092	150,865,092	0	150,865,092		0	0	0	0	0		0	0	452,595,276	0	452,595,276	452,595,276	0	452,595,276	0	0		0	0	0	0	0

	sigurisë publike në komunitet																																						
5.1.5	5.1.5 Veprimtari mbi masat kundër bulizmit dhe ekstremizmit në shkolla		Programi buxhetor 09120, Kodi i produktit 91103AE	ASCAP	DPAP	2021	2023	300,000	0	300,000	300,000	0	300,000	300,000	0	300,000		0	0	0	0	0		0	0	900,000	0	900,000	900,000	0	900,000	0	0		0	0	0	0	0
5.1. 6	5.1.6 Aktivitete informuese mbi parandalimin e fenomeneve të dhunshme dhe rrezikshme për shëndetin publik dhe komunitetin, si: abuzimi me drogat dhe alkoolin, problemet e shëndetit mendor, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, sjelljet e shëndetshme, etj.		Planifikim Administrim Menaxhim (01110) Kodi	MSHMS	SHSSH; ASHMDF; ISHP; NJVKSH; DRSHSSH	2021	2023	956,940	0	956,940	1,156,940	0	1,156,940	956,940	0	956,940	956,940	0	956,940	1,156,940	0	1,156,940	956,940	0	956,940	6,141,640	0	6,141,640	3,070,820	0	3,070,820	0	0		0	3,070,820	0	3,070,820	0
	Kostoja e objektivit specifik 1.2							**341,247,032**	**0**	**341,247,032**	**333,597,032**	**0**	**333,597,032**	**333,197,032**	**0**	**333,197,032**	**178,006,940**	**0**	**178,006,940**	**178,206,940**	**0**	**178,206,940**	**178,006,940**	**0**	**178,006,940**	**1,542,261,916**	**0**	**1,542,261,916**	**1,002,416,096**	**0**	**1,002,416,096**	**5,625,000**	**0**	**0**	**5,625,000**	**534,220,820**	**0**	**534,220,820**	**0**
	Objektivi specifik 1.3 Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit					**2021**	**2023**																																
6.1.1	Masa 6. 1.1 Rishikimi dhe përmirësimi i përgjegjësive dhe PSV, për pushtetin vendor dhe strukturat e tjera shtetërore për kontrollin e territorit		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602 AC	AMVV	NJVV; IKMT; Institucionet e tjera të linjës	2021	2023	18,263,000	0	18,263,000	18,281,400	0	18,281,400	18,281,400	0	18,281,400	0	0	0	0	0	0	0	0	0	54,825,800	0	54,825,800	54,825,800	0	54,825,800	0	0		0	0	0	0	0
6.1. 2	6.1. 2 Kryerja e kontrolleve të territorit nga njësitë përgjegjëse si: pushteti vendor, IKMT, etj.		Buxheti i Bashkive	NJVV/ njësitë administrative	Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor; IKMT	2021	2023	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0			0		0	0	1,875,000	0	1,875,000	1,875,000	0	1,875,000	0	0		0	0	0	0	0
6.1.3	6.1.3 Kryerja e kontrolleve të përbashkëta me Plan, në zona problematike "të nxehta"		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor; DVP/NJVV	2021	2023	65,000,000	0	65,000,000	65,000,000	0	65,000,000	65,000,000	0	65,000,000	0	0	0			0		0	0	195,000,000	0	195,000,000	195,000,000	0	195,000,000	0	0		0	0	0	0	0
6.1.4	6.1. 4 Zhvillimi i takimeve dhe analizave të përbashkëta për kontrollin e territorit		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	Institucionet shtetërore në nivel vendor; DVP/ NJVV	2021	2023	10,500,000	0	10,500,000	10,500,000	0	10,500,000	10,500,000	0	10,500,000	0	0	0			0		0	0	31,500,000	0	31,500,000	31,500,000	0	31,500,000	0	0		0	0	0	0	0
6.1.5	6.1.5 Fuqizimi i kapaciteteve të grupeve vullnetare për kontrollin e territorit, mbi ngacmimin dhe dhunën seksuale, si dhe mbi kryerjen e auditit të sigurisë në për gratë dhe vajzat në hapësirat publike		Programi buxhetor 01110	MSHMS	NJVV; MKR OSHC e specializuara; Donatorët	2021	2023	261,444	0	261,444	1,195,872	0	1,195,872	1,153,398	0	1,153,398	0	0	0	0	0	0		0	0	2,610,714	0	2,610,714	455,914	0	455,914	2,154,800	0	Agjensite e KB	2,154,800	0	0	0	0
	Masa 7. Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit																																			0	0	0	0
7.1.1	7.1. 1. Blerja dhe kompletimi i strukturave vendore me automjete për kontrollin e territorit		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH /DVP	Institucionet shtetërore në nivel vendor;	2021	2023	0	0	0	0	121,000,000	121,000,000	0	181,500,000	181,500,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	302,500,000	302,500,000	0	0	0	0	0		0	0	302,500,000	302,500,000	0
7.1.2	7.1. 2. Blerja dhe përdorimi i pajisjeve për 121 zona policore rurale, si; Dronë, Dylbi, GPS, tableta si; Dronë, Dylbi, GPS, tableta dhe pajisje të tjera për strukturat vendore për kontrollin e territorit		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	Donatorë (SCPA); Institucionet shtetërore në nivel vendor; DPPSH-DVP	2021	2023	0	53,290,000	53,290,000	0	31,050,000	31,050,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	84,340,000	84,340,000	0	10,000,000	10,000,000	0	25,000,000	SCPA	25,000,000	0	49,340,000	49,340,000	0
	Kostoja e objektivit specifik 1.3							**94,649,444**	**53,290,000**	**147,939,444**	**95,602,272**	**152,050,000**	**247,652,272**	**95,559,798**	**181,500,000**	**277,059,798**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**285,811,514**	**386,840,000**	**672,651,514**	**283,656,714**	**10,000,000**	**293,656,714**	**2,154,800**	**25,000,000**	**0**	**27,154,800**	**0**	**351,840,000**	**351,840,000**	**0**
	Kosto totale qëllimi i politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3)							**565,446,476**	**53,290,000**	**618,736,476**	**550,749,304**	**222,050,000**	**772,799,304**	**550,306,830**	**251,500,000**	**801,806,830**	**287,806,940**	**0**	**287,806,940**	**287,206,940**	**0**	**287,206,940**	**287,006,940**	**5,000,000**	**292,006,940**	**2,528,523,430**	**531,840,000**	**3,060,363,430**	**1,658,722,810**	**10,000,000**	**1,668,722,810**	**7,779,800**	**25,000,000**	**0**	**32,779,800**	**862,020,820**	**496,840,000**	**1,358,860,820**	**0**
	POLITIKA II : ANGAZHIMI DHE NDËRVEPRIMI ME KOMUNITETIN																																						
				Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140; Programi Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160; Programi buxhetor 01110																																	
Nr.	**Titulli**	**Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor**	**Programi buxhetor**	**Institucionet përgjegjëse**		**Afati i zbatimit**		**Kosto indikative 2021**			**Kosto indikative 2022**			**Kosto indikative 2023**			**Kosto indikative 2024**			**Kosto indikative 2025**			**Kosto indikative 2026**			**Kosto indikativë 2026**			**Burimi i financimit**							**Kosto indikative 2026**			**Hendeku financiar**
																													Buxhet shteti (në mijë lekë)			**Financim i huaj (në mijë lekë)**							
			Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni kontribues**	**Afati i fillimit**	**Afati i mbarimit**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	**Korente**	**Kapitale**	**Total Kosto**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	**Korente**	**Kapitale**	**Total BSH**	**Korente**	**Kapitale**	**Emri i donatorit/ titullin e projektit**	**Total financim i huaj**	**Korente**	**Kapitale**	**Totali i kostos**	
	Objektivi specifik 2.1 Përmirësimi i komunikimit me publikun																																						
	Masa 8. Hartimi dhe zbatimi i masave të reja për të përmirësuar kontaktet e drejtpërdrejta me publikun dhe komunitetet																																						
8.1.1	8.1.1 Planifikimi dhe zhvillimi i takimeve nga NSPK me oficerët e sigurisë në shkolla, me qytetarët në lagje, fshatra		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH-DVP	ASCAP/MASR	2021	2023	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	6,000,000	0	6,000,000	36,000,000	0	36,000,000	18,000,000	0	18,000,000	0	0		0	18,000,000	0	18,000,000	0
8.1.2	8.1.2 Planifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e komunitetit		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH	Ministritë e linjës; NJVV; KVSP	2021	2023	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	3,500,000	0	3,500,000	21,000,000	0	21,000,000	10,500,000	0	10,500,000	0	0		0	10,500,000	0	10,500,000	0
8.1.3	8.1.3 Planifikimi dhe zhvillimi i veprimtarive publicitare në media të shkruara, vizive dhe ato sociale, në interes të përmirësimit të komunikimit		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03140	DPPSH /MB	Ministritë e linjës; NJVV; KVSP;	2021	2023	4,680,000	0	4,680,000	4,680,000	0	4,680,000	4,680,000	0	4,680,000	4,680,000	0	4,680,000	4,680,000	0	4,680,000	4,680,000	0	4,680,000	28,080,000	0	28,080,000	14,040,000	0	14,040,000	0	0		0	14,040,000	0	14,040,000	0
8.1.4	8.1.4 Fushatë ndërgjegjësimi në mediat sociale mbi forma të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e përshtatur për grupe të caktuara në komunitet		Programi buxhetor 01110	MSHMS	DPPSH/ NJVV/MKR OSHC e specializuara; Donatorët	2021	2023	345,743	0	345,743	200,000	0	200,000	200,000	0	200,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	745,743	0	745,743	145,743	0	145,743	600,000	0	Agjensite e KB	600,000	0	0	0	0
8.1.5	8.1.5 Përgatitja e broshurave për bashkëpunimin e grupeve të caktuara me policinë dhe denoncimin e rasteve të ndryshme që cenojnë sigurinë e jetës		Programi buxhetor 01110	MSHMS	OSHC e specializuara; Donatorët	2021	2023	893,113	0	893,113	500,000	0	500,000	500,000	0	500,000	0		0	0	0	0	0	0	0	1,893,113	0	1,893,113	1,683,113	0	1,683,113	210,000	0	Agjensite e KB	210,000	0	0	0	0
	Masa 9. Përmirësimi i komunikimit dhe angazhimit efektiv me partnerët dhe komunitetet në nivel lokal dhe kombëtar																																						

9.1..1	9.1.1 Zhvillimi i “Planeve specifike të Komunikimit të sigurisë vendore”		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH /DVP	Institucionet shtetërore NJVV	**2021**	**2023**	28,500,000	0	28,500,000	28,500,000	0	28,500,000	28,500,000	0	28,500,000	28,500,000	0	28,500,000	28,500,000	0	28,500,000	28,500,000	0	28,500,000	171,000,000	0	171,000,000	85,500,000	0	85,500,000	0	0		0	85,500,000	0	85,500,000	0
9.1. 2	9.1.2 Krijimi i një strategjie specifike komunikimi të jashtëm;		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH /DVP	Institucionet shtetërore/NJVV	**2021**	**2021**	85,500,000	0	85,500,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0		0	0	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	0	0		0	0	0	0	0
9.1.3	9.1.3 Fuqizimi i kapaciteteve të personelit të kujdesit shëndetësor për raportimin e rasteve të dhunës dhe përdorimin e PSV në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, edhe në situata të emergjencave civile		Programi buxhetor 01110	MSHMS	MB/PSH; Akademia e Sigurisë; OSHC e specializuara; Donatorët	2021	**2022**	1,716,132	0	1,716,132	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0	0		0	0	1,716,132	0	1,716,132	134,532	0	134,532	1,581,600	0	Agjensite e KB	1,581,600	0	0	0	0
	Masa 10. Hartimi dhe zbatimi i masave për të përmirësuar komunikimin me mediat																																			0	0	0	0
10.1.1	10.1.1 Përdorimi i kanaleve të reja të mediave sociale të komunikimit si *Facebook* dhe *Twitter*		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140;	NJVV	DPPSH-DVP; Institucionet shtetërore;	**2021**	**2023**	1,750,000	0	1,750,000	1,750,000	0	1,750,000	1,750,000	0	1,750,000	1,750,000	0	1,750,000	1,750,000	0	1,750,000	1,750,000	0	1,750,000	10,500,000	0	10,500,000	5,250,000	0	5,250,000	0	0		0	5,250,000	0	5,250,000	0
10.1.2	10.1.2 Fuqizimi i mëtejshëm i Komisariatit Digjital		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140;	DPPSH		**2021**	**2023**	3,600,000	0	3,600,000	3,600,000	0	3,600,000	3,600,000	0	3,600,000	3,600,000	0	3,600,000	3,600,000	0	3,600,000	3,600,000	0	3,600,000	21,600,000	0	21,600,000	10,800,000	0	10,800,000	0	0		0	10,800,000	0	10,800,000	0
	Masa 11: Zbatimi i masave të komunikimit në kuadër të programit të transparencës për të përmirësuar sistemin e raportimit dhe informimit të publikut																																			0	0	0	0
11.1.1	11.1.1 Përditësimi i Programit të transparencës dhe publikimi i raporteve vjetore të çështjeve që lidhen me sigurinë në komunitet (regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve)		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140;	DPPSH	NJVV	**2021**	**2023**	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	33,000,000	0	33,000,000	16,500,000	0	16,500,000	0	0		0	16,500,000	0	16,500,000	0
	Kostoja e objektivit specifik 2.1							**141,984,988**	**0**	**141,984,988**	**54,230,000**	**0**	**54,230,000**	**54,230,000**	**0**	**54,230,000**	**53,530,000**	**0**	**53,530,000**	**53,530,000**	**0**	**53,530,000**	**53,530,000**	**0**	**53,530,000**	**411,034,988**	**0**	**411,034,988**	**248,053,388**	**0**	**248,053,388**	**2,391,600**	**0**	**0**	**2,391,600**	**160,590,000**	**0**	**160,590,000**	**0**
	Objektivi specifik 2.2. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve																																						
	Masa 12. Funksionimi i plotë i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP)																																						
12.1.1	12.1.1 Krijimi i Grupit të Punës për përmirësimin e kuadrit ligjor për KVSP dhe realizimi i akteve ligjore dhe administrative sipas nevojave për përgjegjësitë dhe detyrat e KVSP		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	AMVV	NJVV	**2021**	**2021**	18,743,000	0	18,743,000	18,770,600	0	18,770,600	18,770,600	0	18,770,600	0	0	0						0	56,284,200	0	56,284,200	56,284,200	0	56,284,200	0	0		0	0	0	0	0
12.1.2	12.1.2 Hartimi i PSV-ve për mënyrën e evidentimit, transmetimit të informacioneve/rasteve, adresimit dhe trajtimit/veprimit të anëtarëve të KVSP (sipas rasteve që trajtohen)		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	AMVV	NJVV; Institucionet anëtare të KVSP; Donatorë	**2021**	**2021**	19,463,000	0	19,463,000	19,504,400	0	19,504,400	19,504,400	0	19,504,400	0	0	0						0	58,471,800	0	58,471,800	58,471,800	0	58,471,800	0	0		0	0	0	0	0
12.1.3	12.1.3 Hartimi i Plan-Veprimeve të KVSP-ve për fuqizimin e parametrave të sigurisë publike		Buxheti i Bashkive	NJVV	Institucionet anëtare të KVSP; AMVV	**2021**	**2023**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0						0	1,875,000	0	1,875,000	1,875,000	0	1,875,000	0	0		0	0	0	0	0
12.1.4	12.1.4 Organizimi i mbledhjeve të përbashkëta të ETN, GTN dhe KVSP, si dhe sesioneve trajnuese mbi qytetet e sigurta në të gjitha bashkitë ku KVSP janë ngritur		Planifikim Administrim Menaxhim (01110);	MSHMS ;	MKR/NJMF; OSHC e specializuara;Donatorët	**2021**	**2023**	306,288	0	306,288	1,405,144	0	1,405,144	1,355,196	0	1,355,196	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3,066,628	0	3,066,628	911,828	0	911,828	2,154,800	0	Agjensite e KB	2,154,800	0	0	0	0
	Masa 13. Fuqizimi i roleve të aktorëve të tjerë që kontribuojnë në sigurinë në komunitet																																						
13.1.1.	13.1.1 Përcaktimi i kompetencave dhe roleve të tjera si: kryepleqtë/kryetarët e lagjeve; strukturat pranë bashkive/njësive administrative; administratorët e pallateve; shkollat; komunitetet fetare; shoqëria civile OJF/OJQ; mediat; biznesi; grupet rinore, etj.		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	NJVV	AMVV; Ministritë e linjës; Komunitetet fetare; Shoqëria civile; Media; Biznesi	**2021**	**2022**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0						0	1,875,000	0	1,875,000	1,875,000	0	1,875,000	0	0		0	0	0	0	0
13.1.2	13.1.2 Rishikimi i akteve ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e këtyre aktorëve në këto fusha veprimi, me qëllim përcaktimin e kompetencave dhe atributet që duhen të ushtrojnë punonjësit e këtyre strukturave		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	MB/AMVV	NJVV, etj.	**2021**	**2022**	19,703,000	0	19,703,000	19,749,000		19,749,000	19,749,000		19,749,000	0	0	0						0	59,201,000	0	59,201,000	59,201,000	0	59,201,000	0	0		0	0	0	0	0
	Kostoja e objektivit specifik 2.2							**59,465,288**	**0**	**59,465,288**	**60,679,144**	**0**	**60,679,144**	**60,629,196**	**0**	**60,629,196**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**180,773,628**	**0**	**180,773,628**	**178,618,828**	**0**	**178,618,828**	**2,154,800**	**0**	**0**	**2,154,800**	**0**	**0**	**0**	**0**
	Objektivi specifik 2.3. Rritja e mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike																																						
	Masa 14. Krijimi i një fondi të veçantë për sigurinë në komunitet																																						
14.1.1	14.1.1 Ndriçimi i rrugëve, lagjeve, apo zonave të veçanta ku kryhet veprimtari kriminale apo e kundërligjshme		Buxheti i Bashkive	NJVV/ Njësitë administrative		**2021**	**2023**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0							1,875,000	0	1,875,000	1,875,000	0	1,875,000	0	0		0	0	0	0	0
14.1.2	14.1.2 Zhvillimi i fushatave/aktivitete ve ndërgjegjësuese për çështjet e sigurisë		Buxheti i Bashkive	NJVV - KVSP		**2021**	**2023**	1,250,000	0	1,250,000	1,250,000	0	1,250,000	1,250,000	0	1,250,000	0	0	0			0			0	3,750,000	0	3,750,000	3,750,000	0	3,750,000	0	0		0	0	0	0	0
14.1.3	14.1.3 Angazhimi i shoqërisë civile, OJF, komuniteteve fetare dhe grupet rinore, në diskutime dhe vendimmarrje		Buxheti i Bashkive	NJVV - KVSP		**2021**	**2023**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0			0			0	1,875,000	0	1,875,000	1,875,000	0	1,875,000	0	0		0	0	0	0	0
	Masa 15. Rishikimi i rolit dhe përgjegjësive të policisë bashkiake																																			0	0	0	0
15.1.1	15.1.1 Rishikimi i përgjegjësive dhe detyrave të policisë bashkiake, në funksion të sigurisë		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	AMVV	NJVV	**2021**	**2023**	20,903,000	0	20,903,000	20,972,000	0	20,972,000	20,972,000	0	20,972,000	0	0	0			0			0	62,847,000	0	62,847,000	62,847,000	0	62,847,000	0	0		0	0	0	0	0
15.1.2	15.1.2 Rishikimi dhe hartimi i PSV-ve të policisë bashkiake për parandalimin e sjelljeve antishoqërore		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	AMVV	NJVV	**2021**	**2023**	17,903,000	0	17,903,000	17,914,500	0	17,914,500	17,914,500	0	17,914,500	0	0	0			0			0	53,732,000	0	53,732,000	53,732,000	0	53,732,000	0	0		0	0	0	0	0

	Masa 16: Konsolidimi i strukturave *ad-hoc* të Komisioneve të sigurisë në nivel vendor																																						
16.1.1	16.1.1 Zhvillimi periodik i takimeve të KVSP-ve		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	NJVV	AMVV	**2021**	**2023**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0			0			0			0	1,250,000	0	1,250,000	1,250,000	0	1,250,000	0	0		0	0	0	0	0
16.1.2	16.1.2 Vlerësimi i ngjarjeve dhe situatave		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160	NJVV	AMVV	**2021**	**2023**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0			0			0			0	1,250,000	0	1,250,000	1,250,000	0	1,250,000	0	0		0	0	0	0	0
16.1.3	16.1.3 Raportime periodike të çështjeve të adresuara në KVSP		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160	NJVV - KVSP	AMVV	**2021**	**2023**	625,000	0	625,000	625,000	0	625,000	0	0	0			0			0			0	1,250,000	0	1,250,000	1,250,000	0	1,250,000	0	0		0	0	0	0	0
	Masa 17. Rishikim i akteve ligjore për përmirësimin e detyrave të administratorëve të njësive administrative, hapjen e zyrave dhe shërbim të																																			0	0	0	0
17.1.1	17.1.1 Hartimi i një akti nënligjor për përgjegjësitë, detyrat specifike dhe procedurat për administratorët e njësive administrative, lidhur me evidentimin, adresimin dhe trajtimin e problematikave në fushën e sigurisë në komunitet.		Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160 Kodi 91602AC	MB/AMVV	NJVV	**2021**	**2023**	18,143,000	0	18,143,000	18,159,100		18,159,100	18,159,100		18,159,100										54,461,200	0	54,461,200	54,461,200	0	54,461,200	0	0		0	0	0	0	0
	Kostoja e objektivit specifik 2.3							**61,324,000**	**0**	**61,324,000**	**61,420,600**	**0**	**61,420,600**	**59,545,600**	**0**	**59,545,600**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**182,290,200**	**0**	**182,290,200**	**182,290,200**	**0**	**182,290,200**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
	Kosto totale qëllimi i politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)							**262,774,276**	**0**	**262,774,276**	**176,329,744**	**0**	**176,329,744**	**174,404,796**	**0**	**174,404,796**	**53,530,000**	**0**	**53,530,000**	**53,530,000**	**0**	**53,530,000**	**53,530,000**	**0**	**53,530,000**	**774,098,816**	**0**	**774,098,816**	**608,962,416**	**0**	**608,962,416**	**4,546,400**	**0**	**0**	**4,546,400**	**160,590,000**	**0**	**160,590,000**	**0**
	POLITIKA III: REFORMI I SHËRBIMIT POLICOR DHE RRITJA E KAPACITETEVE TË SIGURISË NË KOMUNITET																																						
				Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140; Programi Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor 01160;																																			
	Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet																																						
	Masa 18. Fuqizimi i burimeve njerëzore																																						
18.1.1	18.1.1 Krijimi i një strukture të dedikuar për policimin në Komunitet dhe shtimi i limitit organik të NSPK/SPZ me ndihmës 121 funksioneve në zonat rurale, duke krijuar PP		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH		**2021**	**2022**	0	0	0	133,017,000		133,017,000	133,017,000		133,017,000	133,017,000		133,017,000	133,017,000		133,017,000	133,017,000		133,017,000	665,085,000	0	665,085,000	0	0	0	0	0		0	665,085,000	0	665,085,000	0
18.1.2	18.1.2 Caktimi i personelit me formimin e duhur profesional në strukturat e policimit në komunitet dhe shtrirja e plotë e funksionimit të strukturave që operojnë në Zonat Policore		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH		**2021**	**2023**	85,650,000	0	85,650,000	85,650,000		85,650,000	85,650,000		85,650,000	85,650,000		85,650,000	85,650,000		85,650,000	85,650,000		85,650,000	513,900,000	0	513,900,000	256,950,000	0	256,950,000	0	0		0	256,950,000	0	256,950,000	0
18.1.3	18.1.3 Përmirësimi i (PSV-rekrutimi, përzgjedhja e personelit) i strukturave të sektorit të planifikimit, monitorimit dhe analizës strategjike në nivel vendor e qendror		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH		**2021**	**2023**	53,000,000	0	53,000,000	28,700,000	0	28,700,000	53,000,000		53,000,000	53,000,000		53,000,000	53,000,000		53,000,000	53,000,000		53,000,000	293,700,000	0	293,700,000	134,700,000	0	134,700,000	0	0		0	159,000,000	0	159,000,000	0
18.1.4	18.1.4. Përzgjedhja e kandidatëve të SPZ-ve sipas kritereve të përcaktuara		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH	Akademia e Sigurisë	**2021**	**2023**	61,650,000	0	61,650,000	61,650,000		61,650,000	61,650,000		61,650,000	61,650,000		61,650,000	61,650,000		61,650,000	61,650,000		61,650,000	369,900,000	0	369,900,000	184,950,000	0	184,950,000	0	0		0	184,950,000	0	184,950,000	0
	Masa 19. Rritja e kapaciteteve								0																														
19.1.1	19.1.1 Kryerja e trajnimeve dhe kualifikimeve për policimin në komunitet dhe bashkëpunimin me aktorët e tjerë në zonën policore		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH	Akademia e Sigurisë	**2021**	**2023**	37,758,000	0	37,758,000	37,758,000		37,758,000	37,758,000		37,758,000	37,758,000		37,758,000	37,758,000		37,758,000	37,758,000		37,758,000	226,548,000	0	226,548,000	113,274,000	0	113,274,000	0	0		0	113,274,000	0	113,274,000	0
19.1.2	19.1.2 Vizita për shkëmbim eksperiencë në fushën e PK, në rajon e më gjerë		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	MB-DPPSH	Programi SCPA; MASR; NJVV - KVSP	**2021**	**2023**	6,250,000	0	6,250,000	6,250,000		6,250,000	6,250,000		6,250,000	6,250,000		6,250,000			0			0	25,000,000	0	25,000,000	18,750,000	0	18,750,000	0	0		0	6,250,000	0	6,250,000	0
	Kostoja e objektivit specifik 3.1							**244,308,000**	**0**	**244,308,000**	**353,025,000**	**0**	**353,025,000**	**377,325,000**	**0**	**377,325,000**	**377,325,000**	**0**	**377,325,000**	**371,075,000**	**0**	**371,075,000**	**371,075,000**	**0**	**371,075,000**	**2,094,133,000**	**0**	**2,094,133,000**	**708,624,000**	**0**	**708,624,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**1,385,509,000**	**0**	**1,385,509,000**	**0**
	Objektivi specifik 3.2. Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë																																						
	Masa 20. Krijimi i zyrave të reja në zonat policore urbane dhe ato rurale																																						
20.1.1	20.1.1 Evidentimi i zonave në territorin e Zonës Policore, ku ka nevojë për hapjen e zyrave të reja policore		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH - DVP		**2021**	**2023**	3,650,000	0	3,650,000	3,650,000		3,650,000	3,650,000		3,650,000	3,650,000		3,650,000	3,650,000		3,650,000	3,650,000		3,650,000	21,900,000	0	21,900,000	10,950,000	0	10,950,000	0	0		0	10,950,000	0	10,950,000	0
20.1.2	20.1.2 Bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe institucionet e tjera për hapjen e këtyre ambienteve të reja.		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH-DVP	NJVV/Njësitë Administrative Institucionet e tjera	**2021**	**2023**	4,300,000	0	4,300,000	4,300,000	0	4,300,000	4,300,000	0	4,300,000	4,300,000	0	4,300,000	4,300,000	0	4,300,000	4,300,000	0	4,300,000	25,800,000	0	25,800,000	12,900,000	0	12,900,000	0	0		0	12,900,000	0	12,900,000	0
20.1.3	20.1. 3 Marrja në dorëzim dhe përgatitja për punë e 110 zyrave të reja policore (Kompletimi me pajisje zyre i ambienteve të punës (zyrat) për organizimin sipas konceptit të zonave policore (tavolina, karrige, kompjuter, internet, pajisje komunikimi, etj.)		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH-DVP	NJVV/Njësitë Administrative Institucionet e tjera	**2021**	**2023**	0	0	0		27,500,000	27,500,000			0			0			0			0	0	27,500,000	27,500,000	0		0	0	0	Donatore	0	0	27,500,000	27,500,000	0
	Masa 21: Rikonstruksioni i zyrave ekzistuese në zonat policore urbane dhe ato rurale																																			0	0	0	0
21.1.1	21.1.1 Evidentimi i zyrave policore që kanë nevojë për rikonstruksion		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH	Donatorët	**2021**	**2023**	1,650,000	0	1,650,000	1,650,000		1,650,000	0		0			0			0			0	3,300,000	0	3,300,000	3,300,000	0	3,300,000	0	0		0	0	0	0	0
21.1.2	21.1.2 Planifikimi i fondeve dhe bashkëpunimi me donatorë të tjerë për sigurimin e fondeve për rikonstruksion		Programi Buxhetor “Policia e Shtetit” 03140	DPPSH	Donatorët	**2021**	**2023**	1,100,000	0	1,100,000	1,100,000	5,000,000	6,100,000	0		0			0			0			0	2,200,000	5,000,000	7,200,000	2,200,000		2,200,000	0	5,000,000	SCPA	5,000,000	0	0	0	0

21.1.3	21.1.3 Mbetja e masave dhe sikurimeve i 256 zyrave nga policore		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	DPPSH	Donatorë	**2021**	**2023**		0	0		11,000,000	11,800,000	0	17,700,000	17,700,000			0			0			0	0	29,500,000	29,500,000	0		0	0	0		0	0	0	0	-29,500,000
	Masa 21. Kompletime me infrastrukturë për punë i zyrave në zonat policore urbane dhe ato rurale, me sasitë më të mëdha të popullsisë dhe mjete e pajisje policie																																		0	0	0	0
21.1.1	21.1.1 Ferkesimi dhe prerjakrisi i mbrojtjes me sallonizimit për punë të zyrave policore		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	DPPSH	Donatorë	**2021**	**2023**	4,800,000	0	4,800,000	4,800,000		4,800,000	4,800,000		4,800,000				0			0			0	14,400,000	0	14,400,000	14,400,000	0	14,400,000	0	0		0	0	0	0	0
21.1.2	21.1.2 Pemtëlimi i mbrojtjes të punonjësve të "Grash Policor me" pikë mbrojtëse, bazë dhe pajisje policie		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340 Kodi: 51604AA	DPPSH		**2021**	**2023**	40,300,000	0	40,300,000	40,300,000	0	40,300,000	40,300,000	0	40,300,000	40,300,000			40,300,000	40,300,000		40,300,000	40,300,000		40,300,000	241,800,000	0	241,800,000	120,900,000	0	120,900,000	0	0		0	120,900,000	0	120,900,000	0
21.1.3	21.1.3 Mbetja e masave dhe kompletime me infrastrukturë për punë të zyrave policore		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	DPPSH	Donatorë	**2021**	**2023**		0	0		33,250,000	33,250,000			0				0			0			0	0	33,250,000	33,250,000	0	0	0	0	0	Donatorë	0	0	0	0	-33,250,000
21.1.4	21.1. 4. Mbetja e masave dhe kompletime me sallonizë me dezogë dallavre të PK, i mbrojtjes me NJPK/SPZ dhe automjete policie për 121 zyrave rurale		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340 Kodi: 51604AA	DPPSH		**2021**	**2023**	265,600,000	0	265,600,000	275,320,000	11,000,000	286,320,000	275,320,000	0	275,320,000	0			0			0			0	856,640,000	11,000,000	867,640,000	434,080,000	0	434,080,000	0	0	Donatorë	0	0	0	0	-301,640,000
	Masa 21 : Mobilimi i punonjësve të policisë të zonës rurale																																						
21.1.1	21.1.1 Hartimi i projektligjeve për shkrirje e grades policore "Inspektor i parë", sipas ligji 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	MB-DPPSH		**2021**	**2023**	300,000	0	300,000	300,000		300,000	300,000		300,000	300,000			300,000			0			0	1,200,000	0	1,200,000	900,000	0	900,000	0	0		0	300, 000	0	300,000	0
21.1.2	21.1.2 Pajisdhima e familjeve me strehim me qira e ndihmë të natës dhe implementimi të punonjësve të policisë në komunitet		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	DPPSH		**2021**	**2023**	41,500,000	0	41,500, 000	41,500, 000		41,500, 000	41,500, 000		41,500,000	41,500, 000		41,500, 000	41,500, 000	41,500, 000		41,500, 000	41,500, 000		41,500, 000	249,000,000	0	249,000,000	124,500,000	0	124,500,000	0	0		0	124, 500, 000	0	124,500,000	0
21.1.3	21.1.3 Promovimin i biznes prodaktiv, mjetesigjë ekonomi familjare dhe mundësi për punësimin e policisë në komunitet		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	MB-DPPSH	NJPV/ Aktualiz e sjell	**2021**	**2023**	53,947,000	0	53,947, 000	53,947, 000		53,947, 000	53,947, 000		53,947,000	53,947, 000		53,947, 000	53,947, 000	53,947, 000		53,947, 000	53,947, 000		53,947, 000	323,682,000	0	323,682,000	161,841,000	0	161,841,000	0	0		0	161, 841, 000	0	161,841,000	0
21.1.4	21.1.4 Zhvillimi i aplikimeve/ vlerësime ne pike të mesme punonjësimo e policisë në komunitet		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	Programi 36.3% (donator e)		**2022**	**2022**	0	0	0	2,500,000		2,500,000	0		0				0			0			0	2,500,000	0	2,500,000	0	0	0	2,500, 000	0	**SCPA**	2,500,000	0	0	0	0
21.1.5	21.1.5 Ashtu edhe formacione e publikut me punën e policisë		Programi Buxhetor "Policia e Shtetit" 03340	Programi 36.3% (donator e)		**2022**	**2022**	0	0	0	3,125,000		3,125,000	0		0				0			0			0	3,125,000	0	3,125,000	0	0	0	3,125, 000	0	**SCPA**	3,125,000	0	0	0	0
	Kostoja e objektivit specifik 2.1							**437,147,000**	**0**	**437,147, 000**	**432,652, 000**	**88,550, 000**	**521,202, 000**	**434,317, 000**	**17,700, 000**	**442,017,000**	**163,997, 000**	**0**	**163,997, 000**	**163,697, 000**	**0**	**163,697, 000**	**163,697, 000**	**0**	**163,697, 000**	**1,755,34 7,000**	**106,250, 000**	**1,861,797, 000**	**997,095, 000**	**0**	**907,095, 000**	**5,625, 000**	**5,000,0 00**	**0**	**10,625,000**	**441, 391, 000**	**27,500, 000**	**458,891,000**	**-454,390,000**
	Kosto totale sipërimi i politikës III (objektiva specifike 2.1+2.2)							**688,403,00 0**	**0**	**681,403 ,000**	**780,717 ,000**	**88,550, 000**	**874,267 ,000**	**808,442 ,000**	**17,700, 000**	**819,142,000**	**521,322 ,000**	**0**	**521,322 ,000**	**314,772 ,000**	**0**	**314,772 ,000**	**314,772 ,000**	**0**	**314,772 ,000**	**3,859,66 0,000**	**106,250 ,000**	**3,965,91 0,000**	**1,636,315 ,000**	**0**	**1,616,315 ,000**	**5,625, 000**	**5,000,0 00**	**0**	**10,625,000**	**1,061 ,391, 000**	**27,500, 000**	**1,044,480,000**	**-454,390,000**

Qëllimi i politikës I: Rritja e parametrave të sigurisë

Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024 – 2026			Hendeku financiar 2021 – 2026 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)
								PBA			Financimi i huaj			Buxheti total				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Objektiv specifik 1.1 Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin	DPPSH	KVSP; Bashkitë; Institucioni i Prefektit Institucionet shtetërore; Shoqëria civile; Komuniteti Programi SCPA; Shoqëria civile; OJF	2021	2023	700,450,000	145,000,000	845,450,000	372,650,000	0	372,650,000	0	0	0	327,800,000	145,000,000	472,800,000	0	6,763,600
Objektiv specifik 1.2 Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe cështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet	DPPSH; ASCAP	KVSP; NJVV; Institucionet e tjera të linjës; SCPA;DPAP; MASR; SHSSH; ASHMDF; ISHP; NJVKSH; DRSHSSH	2021	2023	1,542,261,916	0	1,542,261,916	1,002,416,096	0	1,002,416,096	5,625,000	0	5,625,000	534,220,820	0	534,220,820	0	12,338,095
Objektiv specifik 1.3 Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit	NJVV; AMVV; DPPSH/DVP;MSHMS	NJVV; MKR OSHC e specializuara; Donatorët(SCPA); Institucionet shtetërore në nivel vendor; DPPSH-DVP	2021	2023	285,811,514	386,840,000	672,651,514	283,656,714	10,000,000	293,656,714	2,154,800	25,000,000	27,154,800	0	351,840,000	351,840,000	0	5,381,212
Kosto totale qëllimi i politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+13)					2,528,523,430	531,840,000	3,060,363,430	1,658,722,810	10,000,000	1,668,722,810	7,779,800	25,000,000	32,779,800	862,020,820	496,840,000	1,358,860,820	0	24,482,907

Qëllimi i politikës II: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin

Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024 – 2026			Hendeku financiar 2021–2026 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)
								PBA			Financimi i huaj			Buxheti total				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Objektivi specifik 2.1 Përmirësimi i komunikimit me publikun	DPPSH-DVP; MSHMS; MB; NJVV	ASCAP/MASR; Ministritë e linjës; NJVV; KVSP; MKR OSHC e specializuara; Donatorët; MB/PSH; Akademia e Sigurisë;	2021	2026	411,034,988	0	411,034,988	248,053,388	0	248,053,388	2,391,600	0	2,391,600	160,590,000	0	160,590,000	0	3,288,280
Objektivi specifik 2.2 Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve	MSHMS; MB; AMVV; NJVV	Institucionet anëtare të KVSP;MKR/NJMF; OSHC e specializuara; Donatorët; Ministritë e linjës; Komunitetet fetare; Shoqëria civile; Media; Biznesi	2021	2026	180,773,628	0	180,773,628	178,618,828	0	178,618,828	2,154,800	0	2,154,800	0	0	0	0	1,446,189
Objektivi specifik 2.3 Rritja e mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore për sigurinë publike	NJVV - KVSP;AMVV: MB	NJVV/AMVV	2021	2026	182,290,200	0	182,290,200	182,290,200	0	182,290,200	0	0	0	0	0	0	0	1,458,322
Kosto totale qëllimi i politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)					774,098,816	0	774,098,816	608,962,416	0	608,962,416	4,546,400	0	4,546,400	160,590,000	0	160,590,000	0	6,192,791

Qëllimi i Politikës III: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet

Objektivi specifik	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kosto indikative			Burimi i mbulimit deri në 2023						Burimi i mbulimit 2024 – 2026			Hendeku financiar 2021 – 2026 (në lekë)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)
								PBA			Financimi i huaj			Buxheti total				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Totali i kostos	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Objektivi specifik 3.1 Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet	DPPSH; MB	Akademia e Sigurisë; Programi SCPA; MASR; NJVV - KVSP	2020	2030	2,094,133,000	0	2,094,133,000	708,624,000	0	708,624,000	0	0	0	1,385,509,000	0	1,385,509,000	0	16,753,064
Objektivi specifik 3.2 Përmirësimi i kushteve të punës, performancës dhe motivimit të punonjësve të policisë	DPPSH - DVP; MB; Programi SCPA (donatorë)	NJVV/Njësitë Administrative Institucionet e tjera; Donatorët	2020	2030	1,725,547,000	106,250,000	1,831,797,000	907,891,000	0	907,891,000	5,625,000	5,000,000	10,625,000	431,391,000	27,500,000	458,891,000	-454,390,000	14,654,376
Kosto totale qëllimi i politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2)					3,819,680,000	106,250,000	3,925,930,000	1,616,515,000	0	1,616,515,000	5,625,000	5,000,000	10,625,000	1,816,900,000	27,500,000	1,844,400,000	-454,390,000	31,407,440
Kosto totale e Planit të Veprimit					7,122,302,246	638,090,000	7,760,392,246	3,884,200,226	10,000,000	3,894,200,226	17,951,200	30,000,000	47,951,200	2,839,510,820	524,340,000	3,363,850,820	-454,390,000	62,083,138

Kosto totale e Planit të Veprimit	7,760,392,246
PBA 2021–2023	3,894,200,226
Financimi I huaj	47,951,200
Buxheti 2024–2026	3,363,850,820
Hendeku financiar 2021–2026	454,390,000

	Kosto Korente	Kosto kapitale	TOTALI
Qëllimi i politikës I	2,528,523,430	531,840,000	3,060,363,430
Qëllimi i politikës II	774,098,816	0	774,098,816
Qëllimi i politikës III	3,819,680,000	106,250,000	3,925,930,000

Kosto Korente	7,122,302,246
Kosto kapitale	638,090,000
Totali i kostos	7,760,392,246

Nevojat kapitale (në Lek)

Qëllimet e politikave	Natyra/tipologjia e kostove	Kosto totale 2021–2026	Kosto e planifikuar në PBA 2021–2023 Buxheti dhe donatorët	Kosto për t'u planifikuar në PBA 2022–2024 Buxheti dhe donatorët	Hendeku financiar 2021–2026
QP1: Rritja e parametrave të sigurisë	Korente	2,528,523,430	1,666,502,610	862,020,820	**0**
	Kapitale	531,840,000	35,000,000	496,840,000	
QP2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin	Korente	774,098,816	613,508,816	160,590,000	**0**
	Kapitale	0	0	0	
QP3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet	Korente	3,819,680,000	1,622,140,000	1,816,900,000	**454,390,000**
	Kapitale	106,250,000	5,000,000	27,500,000	
TOTALI [lekë]		**7,760,392,246**	**3,942,151,426**	**3,363,850,820**	**454,390,000**
TOTALI [euro] ***1 euro = 125 lekë***		**62,083,138**	**31,537,211**	**26,910,807**	**3,635,120**


Kosto e PV- NDARJA E SHPENZIMEVE
Hendeku financiar 2021-2026
6%
PBA 2021-2023
50%
Buxheti 2024-2026
43%
Financimi I huaj
1%
PBA 2021-2023
Financimi I huaj
Buxheti 2024-2026
Hendeku financiar 2021-2026


NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË PLANIT TE VEPRIMIT
Kosto kapitale
8%
Kosto Korente
92%


Kostot lidhur me Qëllimet e Politikave
100%
90%
80%
70%
60%
50%
40%
30%
20%
10%
0%
531,840,000
2,528,523,430
0
774,098,816
106,250,000
3,819,680,000
Series "Kosto Korente" Point "Qëllimi i Politikës II"
Value: 774,098,816
Kosto Kapitale
Kosto Korente
Qëllimi i Politikës I
Qëllimi i Politikës II
Qëllimi i Politikës III

VENDIM
Nr. 1140, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA, 2021–2025, DHE PLANIN E VEPRIMIT 2021–2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2021–2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj Strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA FINALE

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve
PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK
1.1 Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
1.2 Vizioni i Strategjisë
1.3 Metodologjia
1.4 Analiza e riskut, arritjet dhe mësimet
1.5 Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi, lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike
PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË DOKUMENTIT STRATEGJIK
2.1 Qëllimi i politikës I: Ulja e kërcënimit dhe e ndikimit të krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda.
Objektivi specifik 1.1 Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve
Objektivi specifik 1.2 Goditja e trafiqeve të paligjshme
Objektivi specifik 1.3 Goditja e krimit ekonomik të pastrimit të parave
Objektivi specifik 1.4 Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe i anëtarëve të strukturave kriminale
Objektivi specifik 1.5 Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar
Objektivi specifik 1.6 Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar
Objektivi specifik 1.7 Forcimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja
2.2 Qëllimi i politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë
Objektivi specifik 2.1 Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar
Objektivi specifik 2.2 Rritja e profesionalizmit
Objektivi specifik 2.3 Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krim të organizuar
2.3 Qëllimi i politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda
Objektivi specifik 3.1 Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medies dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar
Objektivi specifik 3.2 Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël
PJESA III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI
3.1 Përgjegjësia e institucioneve
3.2 Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi
PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE
4.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e Strategjisë

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AISM	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AS	Akademia e Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BSH	Banka e Shqipërisë
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë

DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DVP	Drejtoritë Vendore të Policisë
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EMCDDA	Qendra Evropiane e Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga
EMPACT	Platforma multidisiplinare evropiane kundër kërcënimeve kriminale
FAST	Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim
FATF	Task-Forca e Veprimit Financiar
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
GKO	Grupet e krimit të organizuar
IKRTK	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSPK/SPZ	Ndihmësspecialist i policimit në komunitet
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Policia e Shtetit
PU	Policia Ushtarake
QEDH	Qendra për Ekstremizmin e Dhunshëm
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SIENA	Aplikacioni i sigurt i rrjetit të shkëmbimit të informacionit
SKKOKR	Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit

PJESA I
KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda është hartuar në vijim të dy strategjive të mëparshme: Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2008–2013, dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020. Ndryshe nga dokumentet e mëparshme, kjo Strategji përqendrohet në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke u fokusuar në komponentët kryesorë të saj, si: trafikimi i drogave, njerëzve, armëve, veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore, pastrimi i parave dhe strukturat e organizuara kriminale.

Zhvillimi i Strategjisë i është nënshtruar një procesi konsultativ ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, të cilat do të japin kontributin kryesor në zbatimin e kësaj Strategjie dhe monitorimin e ecurisë së saj.

Strategjia bazohet mbi të dhëna dhe vlerësime të institucioneve dhe të agjencive të zbatimit të ligjit dhe të inteligjencës, si dhe raporte të jashtme vlerësimi të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar nëpër disa faza:

Faza e parë ka konsistuar në vlerësimin e kërcënimit nga krimi i organizuar, duke u mbështetur në matjen e rezultateve të arritura gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme, 2013–2020. Nëpërmjet këtij vlerësimi janë identifikuar mangësitë dhe nevojat në qasjen e deritanishme kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbi të cilat janë zhvilluar gjatë fazës së dytë qëllimet e politikave/politikat, objektivat specifikë të Strategjisë, si dhe treguesit e performancës për të matur arritjet. Pjesë përbërëse e këtij vlerësimi kanë qenë dhe gjetjet dhe rekomandimet e ofruara nga raportet e pavarura ndërkombëtare dhe ato vendore, të cilat kanë trajtuar vit pas viti çështje që lidhen me zbatimin e ligjit dhe luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri. Gjithashtu, një sërë dokumentesh Strategjike dhe praktikash të mira ndërkombëtare në këtë fushë janë konsultuar dhe kanë shërbyer për fazën tre dhe katër të këtij procesi. Gjatë fazës së tretë është kryer hartimi i dokumentit përfundimtar dhe hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për periudhën 2021–2022, ndërsa gjatë fazës së katërt është kryer procesi i konsultimit me publikun dhe palët e interesuara.

Kapitujt në vijim të këtij dokumenti Strategjik do të trajtojnë një sërë çështjesh që lidhen me hapat që janë ndjekur për të arritur këtë Strategji, synimet dhe pritshmëritë e saj, si dhe zbatimin dhe monitorimin e objektivave të përcaktuar.

Në pjesën e parë të këtij dokumenti do të pasqyrohet një vlerësim i përgjithshëm i

përpjekjeve, arritjeve dhe sfidave në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në vend, duke u mbështetur në analizat e brendshme të institucioneve shqiptare, si dhe duke u referuar në raportet kryesore të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtarë që mbulojnë këto çështje. Në këtë pjesë do të përcaktohet vizioni i Strategjisë, i cili do të jetë qëllimi kryesor i përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe do të evidentohet lidhja e kësaj Strategjie me kuadrin ligjor në fuqi dhe dokumentet e tjera strategjike në këtë fushë.

Pjesa e dytë fokusohet në qasjen strategjike që do të ndiqet në këtë dokument, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar tri politikat kryesore të kësaj Strategjie, si dhe objektivat specifikë për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në përballjen kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Pjesa e tretë përcakton masat prioritare që do të zbatohen nga institucionet për secilën prej tre politikave dhe së fundmi, pjesa e katërt pasqyron planin e veprimit 2021–2022, nëpërmjet të cilit do të synohet vënia në jetë e politikave dhe e objektivave specifikë, ndarja e përgjegjësive ndërmjet institucioneve, si përcaktimi i afateve për zbatimin e masave.

1.2 Vizioni i Strategjisë

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të koordinojë përpjekjet e institucioneve shqiptare ndaj një sërë problematikash dhe sfidash në fushën e sigurisë, të cilat janë evidentuar në vija të përgjithshme në analizën e riskut dhe do të kenë si busull orientuese vizionin e kësaj Strategjie:

"Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe e krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi."

Ky vizion është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, ku lufta kundër krimit të organizuar lidhet me shtyllën e "Mirëqeverisjes, demokracisë dhe shtetit të së drejtës" dhe mbështet vizionin e SKZHI-së: *"Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë",* në lidhje me objektivat e parashikuar për krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe të mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve, uljen e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri më 2020-ën, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Sfidat që parashikon të ndeshë kjo Strategji lidhen, gjithashtu, me sfidat e parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020: 1. Përpjekje më të mëdha në forcimin e bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit; 2. Krijimin e "të dhënave të gjurmueshme", të besueshme të hetimeve parandaluese, të proceseve dhe dënimeve të shoqëruara me përdorimin sistematik të hetimeve financiare; 3. Përshpejtimin dhe intensifikimin e luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të drogave për të pasur një efekt më afatgjatë; dhe për 4. Një luftë më të bashkërenduar dhe të fokusuar ndaj të gjitha formave të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe kundërmasa më të forta.

1.3 Metodologjia

Siç është shpjeguar më poshtë në nënkapitullin 5 - kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, duke bërë që vizioni, politikat dhe objektivat specifikë të përputhen plotësisht me këto dokumente strategjike.

Hartimi i kësaj Strategjie është planifikuar në kuadër të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian 2020–2022, duke i dhënë një rol koordinues Ministrisë së Brendshme, si institucioni me peshën më të madhe në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Ky dokument strategjik është konsultuar në të gjitha fazat e saj, duke nisur nga analiza e riskut deri në miratimin e tij, me institucione të tjera si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Prokuroria e Përgjithshme etj., të cilat kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj Strategjie.

Në hartimin e këtij dokumenti krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes

dhe planifikimin e prioriteteve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e bëra nga raportet ndërkombëtare, si rekomandimet e progresraporteve të Komisionit Evropian, Komitetit të Stabilizim-Asociimit, GRETA-s, DASH-it, ICRG/FATF-it etj.

Gjithashtu, ky dokument është publikuar për Konsultim publik në fillim të dhjetorit 2020, në adresën: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/313, dhe nuk ka pasur komente apo sugjerime të tjera në lidhje me përmbajtjen.

1.4. Analiza e riskut, arritjet dhe mësimet

Krahas vlerësimeve periodike të kryera nga institucionet shqiptare, organizma ndërkombëtarë, të pavarur dhe të paanshëm, raportojnë, se: "Shqipëria ka bërë përparim të mirë në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar ... dhe rezultate të prekshme janë arritur në këtë drejtim"[133]. Sipas Komisionit Evropian, përparimi i bërë në këtë drejtim nga vendi ynë dëshmohet përmes intensifikimit të mëtejshëm të operacioneve policore për shkatërrimin e grupeve kriminale ... dhe angazhimit të fortë për të shkatërruar trafikimin e drogës.[134]

Ndër faktorët kyç që kanë çuar në një numër të konsiderueshëm të operacioneve të suksesshme dhe në arrestimin e drejtuesve të grupeve të organizuara kriminale, përmenden bashkëpunimi me vendet anëtare të BE-së dhe Europoli, rritja e bashkëpunimit midis policisë dhe prokurorisë, zbatimi i *acuqis* të BE-së në këtë fushë, përmbushja e rekomandimeve të vazhdueshme, si dhe zbatimi i planit të veprimit për adresimin e kërkesave të FATF-së. Një vëmendje e posaçme i është kushtuar, gjithashtu, rëndësisë dhe rolit të institucioneve të reja të drejtësisë, konkretisht Prokuroria e Posaçme. Vijimi i zbatimit të reformës në drejtësi dhe punës për luftën kundër krimit të organizuar, vlerësohen të një rëndësie jetike nga Departamenti Amerikan i Shtetit.[135]

Për sa u përket rezultateve në luftën kundër narkotikëve, raportohet, se: "ashtu si vitet e kaluara, Shqipëria dëshmoi, gjithashtu, më 2019-ën, një përkushtim të fortë dhe të qëndrueshëm në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të kanabisit". Faktorë kyç në këtë drejtim përmenden lejimi i monitorimit ajror nga *Guardia di Finanza* italiane, bashkëfinancuar nga BE-ja, puna e ekipeve të përbashkëta të hetimit dhe operacionet në shkallë të gjerë në lidhje me kokainën dhe heroinën, në bashkëpunim me autoritetet policore të vendeve fqinje, veçanërisht me Italinë, të cilat kanë ndihmuar në identifikimin dhe ndjekjen penale të organizatave kriminale gjatë operacioneve të trafikimit të narkotikëve, përfshirë ato të kryera nga deti. Si rezultat i këtyre operacioneve, janë rritur, gjithashtu, sekuestrimet e sasive të hashashit. Komisioni Evropian, në raportin e tij të vitit 2020, mbi vendin tonë vlerësoi, gjithashtu, vazhdimin e bashkëpunimit me Qendrën Evropiane të Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA), mbështetur dhe në marrëveshjen e punës të nënshkruar në muajin mars 2019, mes Shqipërisë dhe EMCDDA-së. Faktorë të natyrës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë dhe përpjekjet e vendit për integrimin në Bashkimin Evropian janë vlerësuar me ndikim pozitiv në drejtim të rritjes së volumit të drogave të sekuestruara dhe numrit të arrestimeve lidhur me këto çështje gjatë vitit 2019, edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Ky i fundit, sjell në vëmendje se ndonëse roli i Shqipërisë si vend burimi dhe tregtimi i drogave kryesisht të forta mbetet i ulët, ka një rritje të sasive të sekuestruara të kokainës në Evropën Perëndimore me përfshirjen e grupeve kriminale shqiptare.

Krahas vazhdimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë adresimin e tendencave të reja në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, nevojitet që autoritetet shqiptare të marrin masa shtesë të karakterit politik, legjislativ dhe organizativ. Ndër nevojat e identifikuara, përfshihen miratimi i Strategjisë dhe i planit kombëtar për drogat, rishikimi i legjislacionit mbi barnat narkotike dhe substancat psikotrope, përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive dhe ngritja e

[133] EU Commission, Albania 2020 Report, Brussels, 6.10.2020 pg 6 https://ec.europa.eu/neighbourhoosites/near/files/albania_report_2020.pdf

[134] Po aty.

[135] United States Department of State, International Narcotics Control Strategy Report, Albania 2020, pg 93, https:// www.state.gov/wp-content/uploads/2020/06/Tab-1-INCSR-Vol.-I-Final-for-Printing-1-29-20-508-4.pdf

Observatorit Kombëtar të Drogave dhe e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për substancat e reja psikoaktive.

Referuar sfidave, rezultateve të arritura dhe rekomandimeve për forcimin e luftës kundër trafiqeve të paligjshme, vendi ynë vijon të raportohet si një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e qenieve njerëzore. Viktimat përfshijnë gra dhe fëmijë, të cilët i nënshtrohen trafikimit për shfrytëzim seksual dhe të punës, në vendet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së.

Shqipëria ka forcuar përpjekjet për parandalimin dhe për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe ka vijuar masat për zbatimin e ligjit.[136] Në dhjetor 2019, Shqipëria miratoi masa shtesë për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht duke rritur kontrollimin e detajuar nga ana e Policisë së Shtetit për të miturit që largohen nga vendi. Mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit vlerësohet plotësisht funksional. Megjithatë, autoritetet shqiptare duhet të rrisin përpjekjet për identifikimin e hershëm të viktimave dhe viktimave të mundshme, intensifikimin e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe në riintegrimin e suksesshëm të viktimave. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve viktima të trafikimit, duke u siguruar atyre, gjithashtu, mbrojtjen e duhur.

Referuar veprimtarisë së paligjshme të trafikimit të armëve, vendi ynë konsiderohet një vend tranzit dhe destinacion për armët e lehta. Shqipëria ka miratuar "Strategjinë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve, 2019–2024, dhe Planin e Veprimit 2019–2021, si dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në ciklin e politikave të BE-së – Planin e veprimit operativ EMPACT mbi armët e zjarrit.

Trafikimi i paligjshëm i pasurive kulturore është një çështje tjetër që sjell pasoja të shumta në shoqërinë tonë, duke shkaktuar dëm historik, pasi pengon studimet shkencore dhe kuptimin e së kaluarës, dëm kulturor, që çon në humbjen e identitetit të vendeve të origjinës, si dhe dëm shoqëror, duke qenë shpesh një burim i financimit të veprimtarisë kriminale dhe duke dëmtuar ekonominë e vendeve të origjinës.

Trafikimi i paligjshëm i pasurive kulturore si format e tjera të trafikimit të paligjshëm është një çështje komplekse, e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Mund të marrë forma të ndryshme, të përfshijë vende të shumta dhe të shërbejë për qëllime të ndryshme, varësisht nga konteksti gjeografik, socioekonomik dhe politik. Është një aktivitet kriminal shumë i madh dhe fitimprurës, përfshin rrjete dhe tregje ilegale transnacionale, gjeneron një humbje të trashëgimisë, financon krime të tjera.

Lufta kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore kërkon legjislacion të fortë, ndërgjegjësim, si dhe bashkëpunim ndërsektorial. Në Strategjinë Ndërsektoriale të saj "Për luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe terrorizmit, 2013–2020", Qeveria e Shqipërisë ka treguar, gjithashtu, përparësi dhe angazhim për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore të luajtshme.

Institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese shqiptare kanë kryer një sërë operacionesh, me qëllim zbulimin, identifikimin, gjetjen e objekteve dhe hetimin e dënimin e autorëve të përfshirë në këto forma të trafikimit. Për shkak të rëndësisë madhore që ka ruajtja e veprave të trashëgimisë kulturore, objektiva dhe masa të detajuar janë parashikuar për zbatim nga institucione dhe agjenci të ndryshme ligjzbatuese në një plan veprimi të posaçëm, i cili plotëson dhe shoqëron këtë Strategji.

Sipas vlerësimit të Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF), Shqipëria ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të efektivitetit të regjimit të saj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë miratimin e legjislacionit për zbatimin e regjistrit për pronarët përfitues, marrjen e masave për reduktimin e ekonomisë informale dhe përdorimin e *cash*-it dhe ngritjen e ekipeve të specializuara dhe zyrtarëve për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, në çdo qark.[137] Megjithëse Komisioni Evropian ka vlerësuar një lloj progresi lidhur me sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive kriminale, numri i çështjeve me dënime përfundimtare për pastrim

[136] United States Department of State, Trafficking in Persons Report, Albania 2020, https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/albania/

[137] Financial Action Task Force (FATF), Albania http://www.fatf-gafi.org/countries/di/iceland/documents/ increased-monitoring-october-2020.html

parash mbetet i ulët. Krahas vijimit të zbatimit të Planit të Veprimit të dakordësuar me Task-Forcën e Veprimit Financiar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nevojiten përpjekje për të forcuar hetimet financiare dhe luftën kundër pastrimit të parave. Një vëmendje e shtuar i duhet kushtuar identifikimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale të vendosura jashtë vendit ose të paarritshme, zbatimit të rregullave për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të pasurive, si dhe përdorimit sistematik të hetimeve paralele financiare për krimin e organizuar, të cilat duhet të shoqërojnë sistematikisht procedimet penale që nga fillimi.

Çdo vit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kryen një vlerësim kombëtar të kërcënimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke përfshirë vlerësimin e riskut të grupeve kriminale, në mënyrë që të ketë një panoramë të krimit dhe kërcënimeve me të cilat përballet dhe të vendosë për masat operacionale për adresimin e tyre. Institucione dhe agjenci të tjera ligjzbatuese mbledhin, hartojnë dhe shkëmbejnë të dhëna dhe informacione rreth veprimtarisë së paligjshme të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbështetur në fushën e veprimit dhe përgjegjësitë e tyre ligjore.

Bashkëpunimi policor me shtetet anëtare të BE-së dhe Europoli është intensifikuar, duke çuar në një numër të konsiderueshëm të operacioneve të suksesshme dhe arrestimin e drejtuesve të grupeve të strukturuara kriminale. Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit përdorin marrëveshjen operacionale me Europolin, përmes shkëmbimit proaktiv dhe në kohë të informacionit përmes SIENA, si dhe përdorin ekipe të përbashkëta hetimore për të kryer hetime me homologët e BE-së.

Shqipëria merr pjesë, gjithashtu, në projektet e analizave operacionale të Europolit, si dhe në projekte analizash lidhur me krimin kibernetik, krimin mjedisor, krimin e organizuar për pasuritë, terrorizmin, kontrabandën e migrantëve, trafikimin e qenieve njerëzore, armët dhe eksplozivët. Zyra Ndërlidhëse e Europolit në Shqipëri, e hapur zyrtarisht në muajin korrik 2019, ishte e para që operoi në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vendi ynë ka shkëmbyer gjithnjë e më shumë informacion me Europolin dhe u bashkua me Rrjetin Operacional Informal kundër Pastrimit të Parave në vitin 2019, si dhe u bë një partner strategjik në luftën kundër "krimit të organizuar të pronës", një nga fushat me përparësi të hetimit të krimit të Europol dhe një prioritet për sa i takon Platformës Evropiane Multidisiplinare kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT).

Komisioni Evropian ka vlerësuar në vitin 2020, se numri dhe cilësia e mesazheve të shkëmbyera përmes aplikacionit të sigurt të rrjetit të shkëmbimit të informacionit (SIENA) është përmirësuar ndjeshëm që nga fundi i vitit 2019 dhe se ka pasur zhvillime pozitive në bashkëpunimin me Interpolin. Hapja në muajin korrik 2019 dhe funksionimi i Zyrës Ndërlidhëse të Europolit në Shqipëri, e cila ishte e para zyrë që operoi në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe roli i Oficerit Ndërlidhës në Tiranë ndihmuan në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit policor me Europolin dhe vendet anëtare. Për më tepër, Shqipëria ka vijuar të bashkëpunojë mirë në çështjet penale, duke përfshirë këtu vendet anëtare të BE-së. Marrëveshja e saj e bashkëpunimit me *Eurojust*, e cila hyri në fuqi në 1 nëntor 2019, pritet të lehtësojë më tej bashkëpunimin gjyqësor ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe atyre të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Megjithatë, duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi juridiksional ndërkombëtar, zbatimi në kohë i instrumenteve shumëpalëshe dhe kapaciteti institucional. Këto përpjekje duhet të shoqërohen nga përpjekjet e mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* të BE-së dhe për të nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

Në nëntor të vitit 2017, qeveria shqiptare mori vendim për krijimin e operacionit "Forca e ligjit". "Forca e ligjit" u konceptua si një strukturë e veçantë brenda Policisë së Shtetit me oficerë të dedikuar për luftën ndaj krimit të organizuar. Një nga detyrat e para të "Forcës së ligjit" ishte krijimi i një harte të saktë mbi grupet e krimit të organizuar, fushën e tyre të veprimtarisë, ndikimin në territor, identifikimin e udhëheqësve, anëtarëve, financuesve, aseteve dhe aktiviteteve financiare të pastrimit të produkteve të krimit. Pas kësaj pune paraprake, në gati tri vite, operacioni "Forca e ligjit" ka arritur një sërë rezultatesh konkrete nëpërmjet operacioneve policore të kryera, të cilat kanë çuar në arrestimin e një numri të konsiderueshëm të

anëtarëve të grupeve kriminale dhe sekuestrimin e aseteve të tyre me vlerë rreth 120 milionë euro.

Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, në muajin korrik 2019 u krijua Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim *(Fugitive Active Searching Team) "Fast Albania"*. Në shkurt të vitit 2020 kjo njësi u bë pjesë e rrjetit evropian ENFAST, duke u bërë kështu vendi i parë në Ballkanin Perëndimor, joanëtar i BE-së, që ka krijuar një njësi të tillë të specializuar. Njësia është e fokusuar në kapjen e personave të rrezikshëm në kërkim dhe në bashkëpunim me njësitë simotra të BE-së dhe deri në muajin shtator 2020, ka kontribuuar në kapjen e 22 shumëtëkërkuarve, të huaj apo shqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sa i përket krijimit të institucioneve të reja, si rezultat i reformës së sistemit të drejtësisë u krijua një gjykatë e veçantë (GJKKO), një prokurori e veçantë (SPAK) dhe një njësi e hetimore e veçantë (BKH), sipas modelit amerikan të FBI-së. Të tria këto institucione kanë objektiv kryesor luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, kanë një legjislacion të veçantë për organizimin dhe funksionimin, janë totalisht të pavaruara nga organet e tjera të kontrollit të sistemit të drejtësisë dhe operojnë vetëm në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit të tyre të organizimit. Kjo formë e re organizimi dhe funksionimi ka eliminuar një problem serioz të hasur ndër vite, atë të varësisë funksionale dhe organizative nga hallkat qeverisëse të sistemit të drejtësisë. Të tria këto institucione përbëhen nga gjyqtarë, prokurorë dhe hetues që i janë nënshtruar paraprakisht një procesi rivlerësimi *(vetting)*, sa i përket figurës, pasurisë dhe profesionalizmit.

Duke qenë se krijimi i institucioneve të veçanta, sidomos i njësisë speciale të hetimit (BKH) kërkonte kohë për t'u realizuar, qeveria shqiptare ndërmori disa masa të menjëhershme për të asistuar institucionet e sistemit të drejtësisë në luftën ndaj krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua legjislacionit në dispozicion të institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese. Në luftën ndaj krimit të organizuar institucionet dhe agjencitë përdorin jo vetëm legjislacionin penal, por edhe forma të tjera edhe më proaktive, siç është legjislacioni parandalues.

Shqipëria ka një traditë në adaptimin e legjislacionit parandalues që në vitin 2004, me miratimin e ligjit të parë të ashtuquajtur antimafia, sipas modelit italian. Pavarësisht ndryshimeve të shpeshta në vite, thelbi i këtij legjislacioni nuk kishte ndryshuar, ai ka qenë i përqendruar vetëm mbi ato që quhen masa pasurore, pra sekuestrimi dhe konfiskimi i të mirave dhe aseteve i personave të përfshirë në aktivitete kriminale.

Më 31 janar 2020, me iniciativë të qeverisë, ky legjislacion u kompletua nëpërmjet adaptimit të aktit normativ nr. 1, "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike".

Legjislacioni i ri, akoma edhe më agresiv, parashikoi krahas masave pasurore ekzistuese të sekuestrimit dhe të konfiskimit, masa parandaluese personale, si: mbikëqyrja speciale e personave apo masa ekonomike si ndalimi i marrjes pjesë të ndërmarrjeve të caktuara private në tendera publikë apo koncesione.

Ky legjislacion ofroi një instrument akoma edhe më efikas në duart e institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese shqiptare, sepse mundësoi një aksion të koordinuar dhe kompleks ndaj krimit të organizuar, përmes zbatimit të masave parandaluese personale, masave parandaluese pasurore, si sekuestrimi apo konfiskimi i aseteve, mundësojnë kufizimin e fuqisë financiare të individëve apo të grupeve kriminale, si dhe të masave ekonomike, si heqja e licencave apo lejeve apo ndalimi i marrjes pjesë në tendera publikë të shoqërive tregtare, të cilat mundësojnë kufizimin e injektimit të parave kriminale në ekonomi.

1.5. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi, lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike, që adresojnë çështjet e krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe prioritetet e Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, duke parashikuar këtu luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, narkotikëve etj.

Kuadri ligjor për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është i gjerë dhe përfshin një tërësi ligjesh, aktesh nënligjore, që përbëjnë bazën e nevojshme rregullatore për këtë fushë, të tilla si:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- ligji nr. 108/2014, datë 31.7.2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar;

- ligji nr. 103/2014, datë 31.7.2014, "Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë";

- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ku përcaktohet kompetenca e hetimit të veprave penale, që lidhen me krimin e organizuar, si dhe ligji nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", në bazë të të cilit është krijuar Prokuroria e Posaçme, që ka në kompetencë hetimin e veprave të kryera nga krimi i organizuar;

- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale;

- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për eliminimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet masave ndaluese kundër pasurisë", zbatohen edhe për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, edhe për pjesëmarrje në organizata kriminale ose në banda të armatosura;

-Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 10.6.2009, "Për miratimin e rregullores "Për parandalimin e pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit";

-Me ligjin nr. 9110, datë 24.7.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda", u krijua Gjykata Për Krime të Rënda dhe Prokuroria për Krimet e Rënda, e cila ka në kompetencë edhe hetimin e veprave penale, në fushën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda;

- ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë";

- ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale";

- ligji nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale";

- akti normativi nr. 1, datë 31.1.2020, "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike";

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020;

- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020 dhe planit të veprimit 2013–2016;

- Për miratimin e planit të veprimit për vitet 2019–2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020;

- Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020;

- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019–2022;

- Prioritetet e Ministrit të Brendshëm;

- Marrëveshje me EUROPOL, INTERPOL;

- Task-Forca Antiskifter;

- Konventa kundër krimit të organizuar transnacional etj.

Ky dokument strategjik është e ndërlidhur dhe kontribuon në parimet që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, kapitulli Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shtetit i së Drejtës e lidhur me këto objektiva strategjikë:

Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve;

Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri në 2020;

Përmirësimi i eficiencës në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të parave, korrupsionit dhe të ardhurave nga krimi;

Rritja e efikasitetit të njësisë së krimeve kibernetike;

Krijimi i një shërbimi hetimor bashkëkohor;

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

PJESA II
QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË DOKUMENTIT STRATEGJIK

2.1 Qëllimi i politikës I: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Lufta ndaj krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme, si

dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit të vendit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtësisht me rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, përmirësimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e cilësisë hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Kjo Strategji dhe plani i veprimit që e shoqëron mbështetet në vizionin e qeverisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe përparimit të vendit nga kërcënimet dhe ndikimi i krimit të organizuar dhe krimet e rënda, përmes zvogëlimit të risqeve dhe rritjes së fuqisë parandaluese.

Ky dokument do të jetë një udhërrëfyes për zbatimin në praktikë të qasjes gjithëpërfshirëse kundër veprimtarive të paligjshme dhe strukturave të krimit të organizuar, e cila përfshin ndërveprimin midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve.

Prioritetet, objektivat dhe masat konkrete që parashikon kjo Strategji, organizohen dhe synojnë të adresojnë tri çështje kryesore në përballje me krimin e organizuar dhe krimet e rënda: 1. **Goditja** (*pursue*); 2. **Parandalimi** (*prevention*); 3. **Mbrojtja** (*protection*).

Me gjithë përparimin e bërë, sfida kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda mbetet e madhe dhe për këtë arsye kjo Strategji e rishikon qasjen në përballjen me të. Duke marrë në konsideratë natyrën komplekse dhe gjithmonë në zhvillim të strukturave, veprimtarive dhe formave të shfaqjes së krimit të organizuar, në themel të kësaj strategjie parashikohet një qasje gjithëpërfshirëse e gjithë shoqërisë shqiptare kundër këtij fenomeni, ku institucionet shtetërore, sektori privat, komunitetet dhe qytetarët të luajnë rolin e tyre në një përpjekje kolektive për të ulur kërcënimin dhe ndikimin e krimit të organizuar. Për të realizuar këtë qëllim, Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 parashikon tri politika:

Me qëllim të uljes së kërcënimit të krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda, nevojitet adresimi njëkohësisht i shqetësimeve kryesore që lidhen me veprimtaritë e paligjshme të krimit të organizuar, sidomos atyre në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, si dhe veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Sigurisht, goditja dhe ndjekja e strukturave të krimit të organizuar, të cilat veprojnë brenda apo jashtë vendit është me rëndësi kritike për zbatimin efektiv të kësaj politike.

Përmbushja me efektivitet e objektivave të mësipërm do të mbështetet përmes vënies në përdorim të kapaciteteve dhe aftësive të reja për dobësimin e përhapjes dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke përmirësuar sistemet, kuadrin ligjor, burimet njerëzore dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve dhe aktorëve vendës me përgjegjësi dhe rol në këtë fushë. Për më tepër, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nevojës për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, kapjes dhe vënies përpara drejtësisë të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar dhe zbatimit të regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për subjektet me rrezikshmëri të theksuar kriminale.

Objektivi specifik 1.1: Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve

Lufta kundër narkotikëve do të intensifikohet, duke bashkërenduar angazhimin e institucioneve ligjzbatuese me atë të vendeve partnere, si dhe do të ndërmerren procese të thella reformuese që do të prekin legjislacionin, logjistikën dhe personelin e institucioneve.

Në themel të kësaj qasjeje do të jenë mbledhja dhe analizimi i të dhënave të reja, rritja e aftësive informative dhe të vlerësimit, të cilat do t'u mundësojnë institucioneve të zbatimit të ligjit dhe qeverisë të kuptojë më mirë organizimin dhe veprimtarinë e rrjeteve të krimit të organizuar, avantazhet dhe dobësitë e tyre, me qëllim realizimin e goditjeve sa më efektive. Për shkak se grupet dhe rrjetet kriminale shqiptare tashmë operojnë në një kontekst pothuaj tërësisht transnacional, edhe qasja gjurmuese dhe goditëse do t'i përshtatet kësaj prirjeje, duke thelluar cilësisht bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese të vendeve evropiane, ku grupet shqiptare të krimit të organizuar operojnë.

Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të paligjshme në fushën e narkotikëve do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- rritja e veprimtarisë zbuluese të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat;

- përditësimi i bazës së të dhënave të posaçme për kultivimin e kanabisit me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendëse dhe të huaja;

- planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimit në këtë drejtim;
- ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm;
- ngritja dhe funksionimi i Observatorit Kombëtar të Drogave;
- magazinimi dhe asgjësimi i lëndëve narkotike dhe prekursorëve, dhe ruajtja e mostrave si provë materiale për procedurat gjyqësore sipas standardeve dhe praktikave më të mira;
- forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave;
- rritja e efikasitetit të bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe të goditjes së strukturave kriminale;
- përmirësimi i kuadrit legjislativ për substancat psikotrope dhe prekursorët dhe përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive;
- përmirësimi i kuadrit legjislativ mbi procedurën e asgjësimit të lëndëve narkotike dhe prekursorëve, dhe ruajtjes së mostrave.

Objektivi specifik 1.2: Goditja e trafiqeve të paligjshme

Një vëmendje e veçantë në këtë Strategji i kushtohet, gjithashtu, uljes së kërcënimit që vjen nga veprimtaritë e paligjshme në fushën e trafiqeve, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit apo e njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, trafikimi i veprave të artit dhe pasurive kulturore etj. Lidhur me këtë, masa dhe veprimtari shtesë do të parashikohen dhe ndiqen mbi bazë të planit shoqërues të veprimit.

Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të trafiqeve të paligjshme do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj trafiqeve të paligjshme të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat;
- planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta, me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit, sekuestrimeve dhe konfiskimeve në këtë drejtim;
- forcimi i bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme të trafiqeve dhe të goditjes së strukturave kriminale të përfshira në këto veprimtari;
- përmirësimi dhe miratimi i procedurave dhe i mekanizmave standardë kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta;
- hartimi dhe miratimi i planit kombëtar të veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme";
- forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të pasurive kulturore;
- ngritja dhe funksionimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale për ruajtjen dhe luftën kundër vjedhjes dhe trafikimit të Pasurive Kulturore;
- formalizimi i tregut dhe monitorimi i qarkullimit civil dhe fizik të pasurive kulturore;
- plotësimi i kuadrit ligjor vendës, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi i sistemeve dhe i bazave të të dhënave shtetërore, që administrohen nga Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Kulturës (Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore), me qëllim evidentimin, gjurmimin, parandalimin, monitorimin dhe ndalimin në kohë të rasteve dhe personave që lidhen me trafikimin e paligjshëm të pasurive kulturore;
- ratifikimi i konventave në fushën e trashëgimisë kulturore ende të paratifikuara nga shteti shqiptar, si Konventa UNIDROIT, Konventa e BE *"Council of Europe Convention on Offences relating to Cultural Property, Nicosia 2017"*;
- kryerja e trajnimeve të stafit në çdo pikë të kontrollit kufitar lidhur me përdorimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore".

Objektivi specifik 1.3: Goditja e krimit ekonomik të pastrimit të parave

Zbatimi i kësaj politike do të mbështetet, gjithashtu, përmes përmirësimit të proceseve të identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të financave dhe aseteve të grupeve kriminale. Kjo do të ngushtojë hapësirën e veprimit, fuqisë financiare, por dhe motiveve të përfshirjes në struktura të krimit të organizuar, si dhe pamundësimin e

riinvestimit të të ardhurave të përftuara nga veprimtari të paligjshme. Goditja e krimit ekonomik dhe e pastrimit të parave përbën një nga shtyllat kryesore në luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi i gjerë institucional dhe me vendet partnere do të jetë një domosdoshmëri për përmbushjen e këtij objektivi.

Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të krimit ekonomik dhe pastrimit të parave do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- forcimi i kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të përbashkëta;
- sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi *online* i bazave të të dhënave në funksion të mbikëqyrjes dhe të hetimit në fushën ekonomike-financiare;
- koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim rritjen e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes strukturave përgjegjëse dhe kryerjen e analizave të thelluara mbi risqet e pastrimit të parave dhe administrimin e të dhënave (*track record);*
- përmirësimi i zbatimit të sanksioneve financiare të targetuara dhe rritja e hetimeve financiare proaktive dhe paralele që nga fillimi i procedimeve penale;
- rritja e sekuestrimeve dhe e konfiskimeve mbështetur në inteligjencë dhe hetime cilësore të thelluara;
- rishikimi dhe miratimi i kuadrit legjislativ mbi gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar;
- menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duke ruajtur vlerën ekonomike të tyre.

Objektivi specifik 1.4: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe i anëtarëve të strukturave kriminale

Krijimi i strukturave të reja në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është tepër shpresëdhënës, për sa i përket goditjes së grupeve të krimit të organizuar dhe dënimit të drejtuesve dhe anëtarëve të tyre. Me qëllim arritjen e rezultateve pozitive në këtë front do t'i kushtohet një vëmendje e veçantë rritjes së efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike dhe investimeve në funksion të hetimeve të thelluara, cilësore dhe proaktive, si dhe pasurimit dhe përmirësimit të kuadrin ligjor, do të synohet rritja e eficiencës në luftën kundër strukturave të krimit të organizuar.

Në funksion të hetimit penal dhe të dënimit të drejtuesve dhe të anëtarëve të strukturave të organizuara kriminale do të ndiqen dhe do të zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale;
- zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimi i bazave të të dhënave publike/private të aksesueshme nga autoritetet përgjegjëse dhe zhvillimi dhe përdorimi i zgjeruar i kapaciteteve analitike (*software*);
- blerje pajisjesh për Policinë Shkencore;
- hartimi i projekteve, përthithja e financimeve dhe koordinimi i projekteve për mbështetjen e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike të agjencive të zbatimit të ligjit;
- blerje pajisjesh dhe asistencë teknike për strukturat e Policisë së Shtetit, në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar;
- zbatimi i regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë;
- rritja e hetimeve ndaj metodave dhe rasteve të infiltrimit (korrupsioni, kërcënimet etj.) nga strukturat e krimit të organizuar.

Objektivi specifik 1.5: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar

Krimi i organizuar është një sfidë që i kalon kufijtë e territorit shqiptar. Shumë grupe kriminale shqiptare e ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Për këtë arsye nevojitet një bashkëpunim i shkëlqyer ndërmjet institucioneve shqiptare me ato partnere. Nëpërmjet pjesëmarrjen aktive në Europol, në Interpol dhe në platformat rajonale të bashkëpunimit, do të rritet shkëmbimi i informacionit mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit, çka do të rezultojë në më shumë operacione të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale.

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar midis agjencive të zbatimit të ligjit, si një element kyç për luftën e suksesshme kundër veprimtarive dhe anëtarëve të

strukturave të organizuara kriminale do të ndiqen dhe zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit;
- pjesëmarrja aktive në Europol, në Interpol dhe në platformat rajonale të bashkëpunimit;
- nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve me vendet e tjera për shkëmbimin e të dhënave (gjurmë daktiloskopike, profile ADN, të dhëna automjetesh, rekorde kriminale, të dhëna financiare etj.);
- rritja e operacioneve të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale.

Objektivi specifik 1.6: Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar

Ky objektiv specifik lidhet drejtpërdrejt me konsolidimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve partnere. Që prej vitit të kaluar Shqipëria krijuar një njësi speciale, e cila do të merret me vetëm me ndalimin e personave të shpallur në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo njësi i është bashkuar rrjetit ENFAST, e cila është ombrellë e njësive speciale të disa vendeve evropiane. Nëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjes aktive në takimet e FAST-it, do të synohet rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtarë të lokalizuar dhe arrestuar.

Gjetja, gjurmimi, kapja dhe vënia përpara përgjegjësisë ligjore të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar, krahas zbatimit të ligjit, përbën një aspekt të rëndësishëm të uljes së ndikimit dhe të kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, për vendin tonë dhe më gjerë. Për vazhdimin dhe forcimin e rezultateve të arritura deri më tani në këtë drejtim do të ndiqen dhe do të zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- pjesëmarrja aktive në takimet dhe trajnimet e ENFAST-it;
- rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST-it, Europolit dhe Interpolit;
- rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar të lokalizuar dhe arrestuar;
- publikimi dhe përditësimi i të dhënave të identitetit të personave në kërkim ndërkombëtar.

Objektivi specifik 1.7: Forcimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal është një nga format më thelbësore të bashkëpunimit midis shteteve në sfidat që lidhen me aktivitetet kriminale dhe personave të përfshira në to. Globalizmi dhe lëvizja e lirë e njerëzve e shtetasve paraqet sfida të përbashkëta në fushën e sigurisë, të cilat nuk mund të zgjidhen brenda një territori juridiksional, por parashtron si kusht bashkëpunimin ndërkufitar. Kjo Strategji do të synojë rritjen e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja si kundërpërgjigje e atyre personave që tentojnë t'i shpëtojnë ndëshkimit të ligjit, si dhe si rrjedhojë rritjen e besimit të ndërsjellë me vendet e tjera.

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të rezultateve të drejtësisë penale ndaj autorëve dhe veprimtarive të paligjshme të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, nevojitet përdorimi sa më i plotë i instrumenteve dhe i mekanizmave ndërkombëtarë në nivel juridiksional. Për këtë qëllim do të ndiqen dhe zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor, në raport me minimizimin e kohës për ekzekutimin e kërkesave për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar nga Shqipëria apo nga shtetet e huaja;
- përditësimi dhe aksesi në regjistrin gjyqësor penal të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit;
- mbështetja dhe rritja e pjesëmarrjes në skuadrat e përbashkëta hetimore (JIT-s dypalëshe/Eurojust).

2.2. Qëllimi i politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

Si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, ndër vite, shumë qytetarë kanë vuajtur pasojat e kësaj veprimtarie në forma të ndryshme, si trafikimi për qëllime prostitucioni apo pune të detyruar, zhvatja e vlerave monetare apo materiale, dëmtimi i pronës dhe i pasurisë dhe deri në dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës. Anëtarët e strukturave të krimit të organizuar kanë shfaqur, gjithashtu, synimin dhe prirjen për veprime neutralizuese të punës së nëpunësve publikë, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit dhe të organeve të drejtësisë, përmes formave të ndryshme të intimidimit dhe të korrupsionit.

Për më tepër, krimi i organizuar ka ndikim negativ në ekonominë e ligjshme të një vendi. Nëpërmjet përfitimeve të mëdha monetare, grupet kriminale synojnë të kryejnë investime dhe depërtojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë nëpërmjet formave të ndryshme të pastrimit dhe të riciklimit të të ardhurave kriminale, prezantimin e praktikave gjysmë të ligjshme të biznesit dhe krijimin e aktiviteteve të ligjshme për të mbuluar veprimtaritë e fshehta kriminale dhe origjinën e të ardhurave të përftuara prej tyre, dëmtimin e konkurrencës etj. Për sa më sipër, ulja e kërcënimit dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar mbi qytetarët, institucionet dhe ekonominë e ligjshme të vendit, si dhe mbrojtja e tyre nga këto kërcënime vlerësohet si politikë e veçantë e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda.

Objektivi specifik 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'ju nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar

Në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, agjencitë ligjzbatuese duhet të jenë të afta të garantojnë shëndetin dhe jetën e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve, funksionarëve të drejtësisë, viktimave të trafikimit dhe grupe të tjera vulnerabël. Në këtë mënyrë do të rritet besimi i njerëzve në institucionet shtetërore dhe do të forcohet marrëdhënia shtet-qytetar.

Për një luftë më efikase kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është e nevojshme që të garantohet, së pari, siguria fizike dhe e jetës së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të drejtësisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit, si dhe viktimave të krimit, përfshirë ato të trafikimit. Për përmbushjen e këtij objektivi duhet të zbatohen masat e mëposhtme:

- garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit përmes programeve të posaçme;
- nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- ofrimi i asistencës ndaj viktimave të trafikimit.

Objektivi specifik 2.2: Rritja e profesionalizmit

Krahas garantimit të integritetit, rritja e profesionalitetit në agjencitë ligjzbatuese do të marrë rëndësi të veçantë në zbatimin e kësaj Strategjie. Do të kryhen trajnime të përbashkëta nga strukturat e hetimit të krimit në Policinë e Shtetit, punonjësve të agjencive ligjzbatuese, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, si dhe dënimit të autorëve. Kjo do të sjellë jo vetëm rritjen e ekspertizës, por edhe konsolidimin e frymës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shqiptare.

Përmirësimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm i kapaciteteve profesionale përbën kusht për një përgjigje sa më efektive ndaj formave të ndryshme të shfaqjes së krimit të organizuar, përfshirë ato më komplekse dhe zbulimin, hetimin dhe dënimin e autorëve të tyre, të cilët përdorin gjithnjë e më shumë metodat dhe taktika të zhvilluara për t'iu shmangur veprimtarisë zbuluese dhe hetimore të agjencive të zbatimit të ligjit, me synimin përfundimtar për t'iu shmangur përgjegjësisë penale. Për përmbushjen e këtij objektivi kërkohet zbatimi i masave të mëposhtme:

- kryerja e trajnimeve të strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit të strukturave dhe veprimtarive kriminale;
- kryerja e trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, dënimit të autorëve dhe sekuestrimit/konfiskimit të produkteve dhe aseteve kriminale;
- kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi rolin e viktimave në drejtësinë penale;
- pranimi në Akademinë e Sigurisë i të diplomuarve që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.

Objektivi specifik 2.3: Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krim të organizuar

Ky objektiv do të përqendrohet kryesisht në analizimin e legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve në funksion të masave me karakter ekonomik dhe pasuror. Nëpërmjet këtij aktiviteti synohet evidentimi i mangësive dhe i nevojave për t'u përmirësuar më pas në legjislacion. Në këtë kuadër do të ndërmerren ndryshime ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi.

Gjithashtu, kryerja e trajnimeve në këtë fushë do të mundësojë zbatimin më eficient të masave parandaluese pasurore.

Mbrojtja e ekonomisë së ligjshme nga mundësitë dhe hapësirat e shfrytëzueshme nga strukturat e krimit të organizuar, me qëllim riciklimin e të ardhurave me origjinë kriminale, përbën një aspekt të rëndësishëm të qasjes mbrojtëse kundër kërcënimeve dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar në shoqëri. Zbatimi në praktikë i qasjes administrative kundër krimit të organizuar ka rezultuar efikas për agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit. Ndjekja dhe forcimi i zbatimit të kësaj qasje në vendin tonë do të realizohet përmes masave të mëposhtme:

- analizë e legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit, në funksion të masave parandaluese me karakter ekonomik dhe pasuror;
- evidentimi i mangësive dhe i nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor parandalues;
- hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi;
- kryerja e trajnimeve, analizave dhe koordinimi ndërinstitucional në zbatim të masave parandaluese pasurore.

2.3. Qëllimi i politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Strukturat dhe rrjetet e krimit të organizuar synojnë dhe angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për të rekrutuar anëtarë të rinj për kryerjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarive kriminale.

Për shkak të vështirësive me karakter kryesisht social-ekonomik, aftësia e strukturave kriminale për të rekrutuar anëtarë të rinj ka qenë e lartë, siç dëshmojnë dhe të dhënat statistikore të shtrira në kohë, mbi profilin e autorëve të dënuar për veprimtari të tilla kriminale, si brenda dhe jashtë vendit.

Kjo politikë mbështetet mbi vizionin e qeverisë shqiptare për adresimin gjithëpërfshirës të fenomeneve të paligjshme, përfshirë kërcënimet dhe ndikimin negativ të krimit të organizuar, duke mos u kufizuar vetëm në qasjen goditës dhe mbrojtëse. Qasja parandaluese (*prevent*) kërkon kohën e nevojshme dhe angazhimin e të gjithë aktorëve në shoqëri, përtej institucioneve shtetërore, për të ofruar rezultate të qëndrueshme dhe efektive në uljen e kërcënimeve dhe ndikimit të krimit të organizuar. Kjo politikë mbështetet në nevojën për rritjen e vetëdijësimit, ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë në komunitet, besimit të qytetarëve dhe bashkëpunimit të tyre me institucionet në përgjigje të përpjekjeve dhe formave të shfaqjes së veprimtarive të paligjshme. Gjithashtu, ofrimi i alternativave zhvillimore për komunitetet dhe zonat më të ndikuara dhe ekspozuara ndaj veprimtarive të paligjshme dhe përpjekjeve rekrutuese të strukturave të krimit të organizuar përbën njëkohësisht një aspekt me rëndësi kritike për zbatimin me sukses të qasjes parandaluese. Konkretisht, kjo politikë do të përmbushet përmes realizimit të masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

Objektivi specifik 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medies dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar

Sfidat që lidhen me krimin e organizuar dhe aktivitetet kriminale në tërësi nuk mund të përballen vetëm me qasje konfrontative dhe robuste, por paralelisht duhet të punohet me ndërgjegjësimin e publikut, duke përfshirë këtu të gjithë aktorët relevantë që kanë një ndikim të gjerë si institucionet qendrore dhe vendore, shoqëria civile, biznesi, media etj.

Në këtë drejtim janë ndërmarrë disa hapa nga institucionet shqiptare. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si rezultat i një marrëveshjeje ndërinstitucionale me Ambasadën Britanike në Tiranë momentalisht po harton një paketë mësimore (modul) mbi krimin e organizuar dhe krimet e rënda. Kjo marrëveshje synon implementimin e një pakete mësimore/kurrikulare rreth parandalimit të krimit të organizuar dhe krimet e rënda në disa rajone dhe shkolla pilot në Republikën e Shqipërisë.

Mbi këtë modul fillimisht do të trajnohen nga MASR-ja dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) mësuesit që japin lëndën "Qytetari" në disa institucione arsimore parauniversitare të përzgjedhura për pilotim. Këta mësues do të mësojnë më pas nxënësit nën monitorimin e grupit trajnues. Ky projekt synon të zgjerohet më tej në të gjitha shkollat e vendit. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar edhe aktivitete

sensibilizuese me nxënës të grup-moshës nga 13–18 vjeç.

Në funksion të përmbushjes së objektivit të parë specifik të kësaj politike do të zbatohen masat e mëposhtme:

- organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në nivel qendror dhe vendor, me grupe të targetuara dhe tema të përshtatura me kontekstin vendor lidhur me risqet, pasojat dhe parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale;
- organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në institucione arsimore publike dhe private;
- realizimi i video-mesazheve ndërgjegjësuese mbi risqet dhe pasojat e krimit të organizuar, si dhe promovimi i modeleve pozitive ndërmjet të rinjve dhe transmetimi në mediet lokale, rrjete sociale etj.;
- organizimi i takimeve të këshillave vendorë për sigurinë publike me të ftuar nga shoqëria civile, të rinj, aktorë kyç në komunitete me fokus rritjen e vetëdijësimit ndaj krimit të organizuar.

Objektivi specifik 3.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

Një sfidë e veçantë, në kuadër të kësaj Strategjie do të jetë ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme dhe të huaj për zonat dhe komunitetet vulnerabël. Si hap të parë Strategjia parashikon evidentimin dhe analizimin e këtyre zonave dhe komuniteteve, për të koordinuar dhe nxitur më pas vënien në jetë të programeve dhe projekteve sociale, dhe financiare, me qëllim parandalimin e kriminalitetit. Më tej do të bëhen përpjekje serioze për nxitjen e programeve sociale me fokus shtresat në nevojë. Gjithashtu do të nxitet kalimi i objekteve të konfiskuara në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, me qëllim përdorimin si banesa sociale.

Në funksion të përmbushjes së objektivit të dytë specifik të kësaj politike do të zbatohen masat e mëposhtme:

- evidentimi dhe analizimi i zonave gjeografike, komuniteteve dhe grupeve shoqërore të afektuara dhe vulnerabël ndaj strukturave dhe veprimtarive të paligjshme;
- nxitja e programeve sociale me fokus shtresat në nevojë dhe viktimat e krimit përmes projekteve të financuara nga Fondi i Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;
- nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njësive të qeverisjes vendore me qëllim përdorimin si banesa sociale.

PJESA III
ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3.1 Përgjegjësia e institucioneve

Institucionet përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Planit të Veprimit janë:

1. Ministria e Brendshme;
2. Ministria e Drejtësisë;
3. Ministria e Mbrojtjes;
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
5. Ministria e Kulturës;
6. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
8. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
11. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
12. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
13. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
14. Prokuroria e Përgjithshme;
15. Shërbimi Informativ i Shtetit;
16. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare;
17. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
18. Banka e Shqipërisë.

3.2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Llogaridhënia

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit Strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS".

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese si më poshtë:

Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);

- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë

dhe do të miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

- Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë Strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe në planin e veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e Strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë (përfshirë MB/DPPSH, MD, MASR, MSHMS etj.), donatorë dhe shoqëria civile (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së politikave në luftën kundër krimit të organizuar, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;

- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progresraporteve të Bashkimit Evropian;

- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;

- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe të integrimit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura me përballjen e sfidave kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MB, DPPSH-ja dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Të gjitha institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe planit të veprimit do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6- mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatin Teknik Ndërinstitucional.

Komiteti Drejtues Sektorial "Punët e brendshme", drejtuar nga Ministri i Brendshëm, në zbatim të pikave 6 dhe 7, të urdhrit të kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe

prioriteteve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të matet nëpërmjet dy mënyrave të vlerësimit, atë të vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të dyvjeçarit, në fund të vitit 2022, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plani i Veprimit për vitet 2023–2025 për të arritur objektivat e vendosur në strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive në luftën kundër krimit të organizuar.

PJESA IV
ANALIZA BUXHETORE

4.1. Analiza e buxhetit për zbatimin e Strategjisë

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë produktet e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025. Efektet financiare janë përllogaritur nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025 dhe planit të veprimit 2021–2022, në mënyrë të detajuar.

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm, 2021–2023, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Plani i veprimit është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e kësaj Strategjie dhe e planit të veprimit është 19,947,019,300 lekë ose 159,576,154 euro. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 125 lekë për 1 euro.

Qëllimi i politikës I pritet të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e planit, përkatësisht 84%. Qëllimi i politikës II do të arrijë vlerën 13%, ndërsa qëllimi i politikës III do të arrijë vlerën 3%. Më poshtë, gjendet pasqyrimi i kostove financiare përgjatë 5 viteve të zbatimit të Strategjisë.

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2021-2025	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023 Buxheti dhe Donatoret	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024-2025	Hendeku Financiar 2021-2025
Qëllimi i politikës I	Korente	16,254,958,300	9,278,054,500	6,173,903,800	***803,000,000***
	Kapitale	577,211,000	577,211,000	0	
Qëllimi i politikës II	Korente	2,566,900,000	1,540,140,000	1,026,760,000	***0***
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i politikës III	Korente	547,950,000	329,250,000	218,700,000	***0***
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [lek]		**19,947,019,300**	**11,724,655,500**	**7,419,363,800**	***803,000,000***
TOTALI [euro] *1 euro 125 lek*		**159,576,154**	**93,797,244**	**59,354,910**	**6,424,000**

Financimi i planit të veprimit të Strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve. Për periudhën 2021–2025, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 93% të financimit të nevojshëm, 3% pritet të financohet nga donatorë, ndërsa 4% është hendek financiar.



Kostot korente zënë rreth 97%, ndërsa pjesa tjetër është e parashikuar për kosto kapitale. Të ndara sipas qëllimeve të politik, ato pasqyrohen si më poshtë:



Plani i Veprimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të rishikohet në periudhë 3-vjeçare për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform programeve buxhetore afatmesme, si dhe prioriteteve të çdo institucioni. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesem Buxhetor, dhe buxhetit vjetor.

PLANI I VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA 2021–2025

I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT

II. QËLLIMI I POLITIKËS 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE E NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

III. Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: Programi 01110 Ministria e Brendshme; Programi 03140, Policia e Shtetit; Programi 1012020, IKRKT; Programi 01110, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Programi 03440, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Programi 1014001, Ministria e Drejtësisë.

Nr.	Titulli	Programi buxhetor Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucionet përgjegjëse Institu-cioni përgjegjës	Institu-cioni kontribues	Afati i zbatimit Afati i filli-mit	Afati i mbari-mit	Kostoja indikative/2021 Korente	Kapitale	Total Kostoja	Kostoja indikative/2022 Korente	Kapitale	Total Kostoja	Kostoja indikative/2023 Korente	Kapi-tale	Total Kostoja	Kostoja indikative/2024 Korente	Kapi-tale	Total Kostoja	Kostoja indikative/2025 Korente	Kapit-ale	Total Kostoja	Kostoja indikative totale Korente	Kapitale	Total Kostoja	Burimi i financimit PBA 2021 – 2023 (në lek) Korente	Kapitale	Total BSH	Financim i huaj (në lek) Kore-nte	Kapitale	Emri donatorit/titu-llin e projektit	Total Finan-cim i huaj	Burimi i financimit Buxheti 2024–2026 (në lek) Korente	Kapi-tale	Total BSH	Hendeku financiar
1.1	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve**				2021	2022																													
	Masat																																		
1.1.1	Rritja e veprimtarisë zbuluese të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidenca	91604AA	Policia e Shtetit	PP PU AISM SHISH Doganat AISM	2021	2025	128,675,000	0	128,675,000	128,675,000	0	128,675,000	128,675,000	0	128,675,000	128,675,000	0	128,675,000	128,675,000	0	128,675,000	643,375,000	0	643,375,000	386,025,000	0	386,025,000	0	0		0	257,350,000	0	257,350,000	0
1.1.2	Përditësimi i bazës së të dhënave të posaçme për kultivimin e kanabisit me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendëse dhe të huaja	91604AA	Policia e Shtetit	PP GdF/Pro-jekti mbështetur nga BE PU AISM SHISH Doganat	2021	2025	25,735,000	0	25,735,000	25,735,000	0	25,735,000	25,735,000	0	25,735,000	25,735,000	0	25,735,000	25,735,000	0	25,735,000	128,675,000	0	128,675,000	77,205,000	0	77,205,000	0	0		0	51,470,000	0	51,470,000	0
1.1.3	Planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta, me qëllim të rritjes së zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimit në këtë drejtim	91604AB	Policia e Shtetit	PP GdF/Projekti mbështetur nga BE PU AISM SHISH Doganat	2021	2025	215,800,000	0	215,800,000	215,800,000	0	215,800,000	215,800,000	0	215,800,000	215,800,000	0	215,800,000	215,800,000	0	215,800,000	1,079,000,000	0	1,079,000,000	647,400,000	0	647,400,000	0	0		0	431,600,000	0	431,600,000	0
1.1.4	Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm	91604AA	Policia e Shtetit		2021	2025	86,540,000	0	86,540,000	86,540,000	0	86,540,000	86,540,000	0	86,540,000	86,540,000	0	86,540,000	86,540,000	0	86,540,000	432,700,000	0	432,700,000	259,620,000	0	259,620,000	0	0		0	173,080,000	0	173,080,000	0
1.1.5	Ngritja dhe funksionimi i Observatorit Kombëtar të Drogave	Akte ligjore e nënligjore të miratuara	MSHMS		2022	2025	210,000	0	210,000	210,000	0	210,000	4,660,600	0	4,660,600	1,338,000	0	1,338,000	1,338,000	0	1,338,000	7,756,600	0	7,756,600	5,080,600	0	5,080,600	0	0		0	2,676,000	0	2,676,000	0
1.1.6	Magazinimi dhe asgjësimi i lëndëve narkotike dhe prekursorëve dhe ruajtja e mostrave si provë materiale për procedurat gjyqësore, sipas standardeve dhe praktikave më të mira	91604AB	Policia e Shtetit		2021	2025	18,000,000	0	18,000,000	18,000,000	0	18,000,000	18,000,000	0	18,000,000	18,000,000	0	18,000,000	18,000,000	0	18,000,000	90,000,000	0	90,000,000	54,000,000	0	54,000,000	0	0		0	36,000,000	0	36,000,000	0
1.1.7	Forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave	91604AA	Policia e Shtetit	PP SHISH GdF/Projekti mbështetur nga BE PU AISM Doganat	2021	2025	135,650,000	0	135,650,000	135,650,000	0	135,650,000	135,650,000	0	135,650,000	135,650,000	0	135,650,000	135,650,000	0	135,650,000	678,250,000	0	678,250,000	406,950,000	0	406,950,000	0	0		0	271,300,000	0	271,300,000	0
1.1.8	Rritja e efikasitetit të bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale	91604AA	Policia e Shtetit	PP GdF/Projekti mbështetur nga BE PU AISM SHISH Doganat	2021	2022	77,250,000	0	77,250,000	77,250,000	0	77,250,000	77,250,000	0	77,250,000	77,250,000	0	77,250,000	77,250,000	0	77,250,000	386,250,000	0	386,250,000	231,750,000	0	231,750,000	0	0		0	154,500,000	0	154,500,000	0
1.1.9	Përmirësimi i kuadrit legjislativ për substancat psikotrope dhe prekursorët dhe përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive	Akte ligjore e nënligjore të miratuara	MSHMS	Policia e Shtetit	2021	2022	91,000	0	91,000	91,000	0	91,000	91,000	0	91,000	91,000	0	91,000	91,000	0	91,000	455,000	0	455,000	273,000	0	273,000	0	0		0	182,000	0	182,000	0
1.1.10	Përmirësimi i kuadrit legjislativ mbi procedurën e asgjësimit të lëndëve narkotike dhe prekursorëve dhe ruajtjes së mostrave	91604AB	Policia e Shtetit		2021	2021	105,700,000	0	105,700,000	105,700,000	0	105,700,000	105,700,000	0	105,700,000	105,700,000	0	105,700,000	105,700,000	0	105,700,000	528,500,000	0	528,500,000	317,100,000	0	317,100,000	0	0		0	211,400,000	0	211,400,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 1.1.						**793,651,000**	**0**	**793,651,000**	**793,651,000**	**0**	**793,651,000**	**798,101,600**	**0**	**798,101,600**	**794,779,000**	**0**	**794,779,000**	**794,779,000**	**0**	**794,779,000**	**3,974,961,600**	**0**	**3,974,961,600**	**2,385,403,600**	**0**	**2,385,403,600**	**0**	**0**	**0**	**0**	**1,589,558,000**	**0**	**1,589,558,000**	**0**
1.2	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Goditja e trafiqeve të paligjshme**		**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni kontribues**	**Afati fillimit**	**Afati i mbarimit**																													
	Masat																																		
1.2.1	Rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj trafiqeve të paligjshme të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat	91604AA	Policia e Shtetit	MK/IKRTK AISM PU SHISH Doganat	2021	2022	515,550,000	0	515,550,000	515,550,000	0	515,550,000	515,550,000	0	515,550,000	515,550,000	0	515,550,000	515,550,000	0	515,550,000	2,577,750,000	0	2,577,750,000	1,546,650,000	0	1,546,650,000	0	0		0	1,031,100,000	0	1,031,100,000	0
1.2.2	Planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta, me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimeve dhe konfiskimeve në këtë drejtim	91604AB	Policia e Shtetit	MK/IKRTK AISM PU SHISH Doganat	2021	2022	77,205,000	0	77,205,000	77,205,000	0	77,205,000	77,205,000	0	77,205,000	77,205,000	0	77,205,000	77,205,000	0	77,205,000	386,025,000	0	386,025,000	231,615,000	0	231,615,000	0	0		0	154,410,000	0	154,410,000	0
1.2.3	Forcimi i bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale	91604AA	Policia e Shtetit	MK/IKRTK AISM PU SHISH Doganat	2021	2022	55,500,000	0	55,500,000	55,500,000	0	55,500,000	55,500,000	0	55,500,000	55,500,000	0	55,500,000	55,500,000	0	55,500,000	277,500,000	0	277,500,000	166,500,000	0	166,500,000	0	0		0	111,000,000	0	111,000,000	0
1.2.4	Përmirësimi dhe miratimi i procedurave dhe i mekanizmave standarde kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta	91604AA	Policia e Shtetit	SHISH Doganat AISM PU	2021	2022	12,850,000	0	12,850,000	12,850,000	0	12,850,000	12,850,000	0	12,850,000	12,850,000	0	12,850,000	12,850,000	0	12,850,000	64,250,000	0	64,250,000	38,550,000	0	38,550,000	0	0		0	25,700,000	0	25,700,000	0
1.2.5	Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", për vitet 2021-2023 (Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Policia e Shtetit)	91202AB	MK/IKRTK	MB Policia e Shtetit	2021	2023	210,000	0	210,000	210,000	0	210,000	210,000	0	210,000	0	0	0	0	0	0	630,000	0	630,000	630,000	0	630,000	0	0		0	0	0	0	0
1.2.6	Forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të pasurive kulturore	91604AA	Policia e Shtetit	SHISH MK/IKRTK Doganat	2021	2022	25,850,000	0	25,850,000	25,850,000	0	25,850,000	25,850,000	0	25,850,000	25,850,000	0	25,850,000	25,850,000	0	25,850,000	129,250,000	0	129,250,000	77,550,000	0	77,550,000	0	0		0	51,700,000	0	51,700,000	0
1.2.7	Ngritja dhe funksionimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale për ruajtjen dhe luftën kundër vjedhjes dhe trafikimit të Pasurive Kulturore	Planifikim menaxhim Administrimi 01110	Ministria e Brendshme	Policia e Shtetit MK/IKRTK Doganat	2021	2021	6,540,000	0	6,540,000	0	0	0	0	0	0	6,540,000		6,540,000	6,540,000	0	6,540,000	19,620,000	0	19,620,000	6,540,000	0	6,540,000	0	0		0	13,080,000	0	13,080,000	0
1.2.8	Plotësimi i kuadrit ligjor vendës, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare	91202AB	MK/IKRTK		2021	2021	350,000	0	350,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	350,000	0	350,000	350,000	0	350,000	0	0		0	0	0	0	0
1.2.9	Formalizimi i tregut dhe monitorimi i qarkullimit civil dhe fizik i pasurive kulturore	91202AB	MK/IKRTK	Policia e Shtetit	2021	2022	210,000	0	210,000	210,000	0	210,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	420,000	0	420,000	420,000	0	420,000	0	0		0	0	0	0	0
1.2.10	Ratifikimi i Konventave në fushën e trashëgimisë kulturore ende të paratifikuara nga shteti shqiptar, si Konventa UNIDROIT, Konventa e BE "Council of Europe Convention on Offences relating to Cultural Property, Nicosia 2017"	91202AB	MK/IKRTK		2021	2022	400,000	0	400,000	400,000	0	400,000	400,000	0	400,000	400,000		400,000	400,000		400,000	2,000,000	0	2,000,000	1,200,000	0	1,200,000	0	0		0	800,000	0	800,000	0
1.2.11	Sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi i Sistemeve dhe Bazave të të dhënave Shtetërore që administrohen nga Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Kulturës (Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore), me qëllim evidentimin, gjurmimin, parandalimin, monitorimin dhe ndalimin në kohë të rasteve dhe personave që lidhen me trafikimin e paligjshëm të pasurive kulturore	Planifikim menaxhim Administrimi 01110	MB	MK/IKRTK Doganat AKSHI	2021	2021	450,000	0	450,000	450,000	0	450,000	450,000	0	450,000	450,000	0	450,000	450,000	0	450,000	2,250,000	0	2,250,000	1,350,000	0	1,350,000	0	0		0	900,000	0	900,000	0
1.2.12	Kryerja e trajnimeve të stafit në çdo pikë të kontrollit kufitar lidhur me përdorimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)"	91202AB	MK/IKRTK	MB AKSHI	2021	2022	350,000	0	350,000	350,000	0	350,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	700,000	0	700,000	700,000	0	700,000	0	0		0	0	0	0	0
	Kosto Objektivi specifik 1.2						**695,465,000**	**0**	**695,465,000**	**688,575,000**	**0**	**688,575,000**	**688,015,000**	**0**	**688,015,000**	**694,345,000**	**0**	**694,345,000**	**694,345,000**	**0**	**694,345,000**	**3,460,745,000**	**0**	**3,460,745,000**	**2,072,055,000**	**0**	**2,072,055,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**1,388,690,000**	**0**	**1,388,690,000**	**0**

1.3	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Goditja e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave**	**Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor**	**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni kontribues**	**Afati fillimit**	**Afati mbarimit**																													
	Masat																																		
1.3.1	Forcimi i kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të përbashkëta	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA PU	2021	2022	160,600,000	0	160,600,000	160,600,000	0	160,600,000	160,600,000	0	160,600,000	160,600,000	0	160,600,000	160,600,000	0	160,600,000	803,000,000	0	803,000,000	0	0	0	0	0		0	0	0	0	-803,000,000
1.3.3	Sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi *online* i bazave të të dhënave në funksion të mbikëqyrjes dhe hetimit në fushën ekonomike-financiare	91604AA	Policia e Shtetit	SHISH DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA PU	2021	2021	505,500,000	0	505,500,000	505,500,000	0	505,500,000	505,500,000	0	505,500,000	505,500,000	0	505,500,000	505,500,000	0	505,500,000	2,527,500,000	0	2,527,500,000	1,516,500,000	0	1,516,500,000	0	0		0	1,011,000,000	0	1,011,000,000	0
1.3.4	Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim rritjen e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes strukturave përgjegjëse dhe kryerjen e analizave të thelluara mbi risqet e pastrimit të parave dhe administrimin e të dhënave *(track record)*	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA PU	2021	2022	80,200,000	0	80,200,000	80,200,000	0	80,200,000	80,200,000	0	80,200,000	80,200,000	0	80,200,000	80,200,000	0	80,200,000	401,000,000	0	401,000,000	240,600,000	0	240,600,000	0	0		0	160,400,000	0	160,400,000	0
1.3.5	Përmirësimi i zbatimit të sanksioneve financiare të targetuara dhe hetimeve financiare proaktive dhe paralele që nga fillimi i procedimeve penale	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA PU	2021	2022	35,650,000	0	35,650,000	35,650,000	0	35,650,000	0	0	0		0	0	29,500,000	0	29,500,000	100,800,000	0	100,800,000	71,300,000	0	71,300,000	0	0		0	29,500,000	0	29,500,000	0
1.3.6	Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve mbështetur në hetime cilësore të thelluara	91604AA	Policia e Shtetit	PP	2021	2022	105,940,000	0	105,940,000	105,940,000	0	105,940,000	105,940,000	0	105,940,000	105,940,000	0	105,940,000	105,940,000	0	105,940,000	529,700,000	0	529,700,000	317,820,000	0	317,820,000	0	0		0	211,880,000	0	211,880,000	0
1.3.7	Rishikimi dhe miratimi i kuadrit legjislativ mbi gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar	91604AB	Policia e Shtetit		2021	2021	30,750,000	0	30,750,000	30,750,000	0	30,750,000	30,750,000	0	30,750,000	30,750,000	0	30,750,000	30,750,000	0	30,750,000	153,750,000	0	153,750,000	92,250,000	0	92,250,000	0	0		0	61,500,000	0	61,500,000	0
1.3.8	Menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara duke ruajtur vlerën ekonomike të tyre	Pasuri të sekuestruara 91601AG	AAPSK		2021	2022	10,400,000	0	10,400,000	10,400,000	0	0	10,400,000	0	10,400,000	10,400,000	0	10,400,000	10,400,000	0	10,400,000	52,000,000	0	52,000,000	31,200,000	0	31,200,000	0	0		0	20,800,000	0	20,800,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 1.3						**929,040,000**	**0**	**929,040,000**	**929,040,000**	**0**	**929,040,000**	**893,390,000**	**0**	**882,990,000**	**893,390,000**	**0**	**893,390,000**	**922,890,000**	**0**	**922,890,000**	**4,567,750,000**	**0**	**4,567,750,000**	**2,269,670,000**	**0**	**2,269,670,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**1,495,080,000**	**0**	**1,495,080,000**	**-803,000,000**
1.4.	**Objektivi specifik: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale**																																		
	Masat																																		
1.4.1	Rritja e efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale	91604AB	Policia e Shtetit	PP SHISH	2021	2022	110,950,000	0	110,950,000	110,950,000	0	110,950,000	110,950,000	0	110,950,000	110,950,000	0	110,950,000	110,950,000	0	110,950,000	554,750,000	0	554,750,000	332,850,000	0	332,850,000	0	0		0	221,900,000	0	221,900,000	0
1.4.2	Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimi i bazave të të dhënave publike/private të aksesueshme nga autoritetet përgjegjëse dhe zhvillimi dhe përdorimi i zgjeruar i kapaciteteve analitike	91604AB	Policia e Shtetit	MB	2021	2022	75,755,000	0	75,755,000	75,755,000	0	75,755,000	75,755,000	0	75,755,000	75,755,000	0	75,755,000	75,755,000	0	75,755,000	378,775,000	0	378,775,000	227,265,000	0	227,265,000	0	0		0	151,510,000	0	151,510,000	0
2.4.3	Blerje pajisje për Policinë Shkencore	M160510	Policia e Shtetit		2021	2022	0	12,210,000	12,210,000	0	65,000,000	65,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	77,210,000	77,210,000	0	77,210,000	77,210,000	0	0		0	0	0	0	0
2.4.4	Hartimi i projekteve, përthithja e financimeve dhe koordinimi i projekteve për mbështetjen e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike të agjencive të zbatimit të ligjit	91604AA	Ministria e Brendshme		2021	2022	16,950,000	0	16,950,000	16,950,000	0	16,950,000	16,950,000	0	16,950,000	16,950,000	0	16,950,000	16,950,000	0	16,950,000	84,750,000	0	84,750,000	50,850,000	0	50,850,000	0	0		0	33,900,000	0	33,900,000	0
2.4.5	Blerje pajisje dhe asistencë teknike për strukturat e Policisë së Shtetit në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar	18AT501	Policia e Shtetit		2021	2022	0	86,930,000	86,930,000	0	413,071,000	413,071,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	500,001,000	500,001,000	0	0	0	0	500,001,000		500,001,000	0	0	0	0
1.4.6	Zbatimi i regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë	03440 (sistemi i Burgjeve)	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	IEVP	2021	2022	105,500,000	0	105,500,000	105,500,000	0	105,500,000	105,468,900	0	105,468,900	105,468,900	0	105,468,900	105,468,900	0	105,468,900	527,406,700	0	527,406,700	316,468,900	0	316,468,900	0	0		0	210,937,800	0	210,937,800	0
1.4.7	Rritja e hetimeve ndaj metodave dhe rasteve të infiltrimit (korrupsioni, kërcënimet etj.) nga strukturat e krimit të organizuar	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	150,865,000	0	150,865,000	150,865,000	0	150,865,000	150,865,000	0	150,865,000	150,865,000	0	150,865,000	150,865,000	0	150,865,000	754,325,000	0	754,325,000	452,595,000	0	452,595,000	0	0		0	301,730,000	0	301,730,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 1.4						**460,020,000**	**99,140,000**	**559,160,000**	**460,020,000**	**478,071,000**	**938,091,000**	**459,988,900**	**0**	**459,988,900**	**459,988,900**	**0**	**459,988,900**	**459,988,900**	**0**	**459,988,900**	**2,300,006,700**	**577,211,000**	**2,877,217,700**	**1,380,028,900**	**77,210,000**	**1,457,238,900**	**0**	**500,001,000**	**0**	**500,001,000**	**919,977,800**	**0**	**919,977,800**	**0**
1.5	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar**																																		
	Masat																																		
1.5.1	Rritja e shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	25,000,000	0	25,000,000	25,000,000	0	25,000,000	25,000,000	0	25,000,000	25,000,000	0	25,000,000	25,000,000	0	25,000,000	125,000,000	0	125,000,000	75,000,000	0	75,000,000	0	0		0	50,000,000	0	50,000,000	0
1.5.2	Pjesëmarrja aktive në Europol, në Interpol dhe në platformat rajonale të bashkëpunimit	91604AD	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	8,500,000	0	8,500,000	8,500,000	0	8,500,000	8,500,000	0	8,500,000	8,500,000	0	8,500,000	8,500,000	0	8,500,000	42,500,000	0	42,500,000	25,500,000	0	25,500,000	0	0		0	17,000,000	0	17,000,000	0
1.5.3	Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve me vendet e tjera për shkëmbimin e të dhënave (gjurmë daktiloskopike, profile ADN, të dhëna automjetesh, rekorde kriminale, të dhëna financiare etj.)	91604AD	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	5,500,000	0	5,500,000	27,500,000	0	27,500,000	16,500,000	0	16,500,000	0	0		0	11,000,000	0	11,000,000	0
1.5.4	Rritja e operacioneve të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	185,600,000	0	185,600,000	185,600,000	0	185,600,000	185,600,000	0	185,600,000	185,600,000	0	185,600,000	185,600,000	0	185,600,000	928,000,000	0	928,000,000	556,800,000	0	556,800,000	0	0		0	371,200,000	0	371,200,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 1.5						**224,600,000**	**0**	**224,600,000**	**224,600,000**	**0**	**224,600,000**	**224,600,000**	**0**	**224,600,000**	**224,600,000**	**0**	**224,600,000**	**224,600,000**	**0**	**224,600,000**	**1,123,000,000**	**0**	**1,123,000,000**	**673,800,000**	**0**	**673,800,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**449,200,000**	**0**	**449,200,000**	**0**
1.6	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar**																																		
	Masat																																		
1.6.1	Pjesëmarrja aktive në takimet dhe trajnimet e ENFAST	91604AD	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	6,600,000	0	6,600,000	6,600,000	0	6,600,000	6,600,000	0	6,600,000	6,600,000	0	6,600,000	6,600,000	0	6,600,000	33,000,000	0	33,000,000	19,800,000	0	19,800,000	0	0		0	13,200,000	0	13,200,000	0
1.6.2	Rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST-it, Europolit dhe Interpolit	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	50,867,000	0	50,867,000	50,867,000	0	50,867,000	50,867,000	0	50,867,000	50,867,000	0	50,867,000	50,867,000	0	50,867,000	254,335,000	0	254,335,000	152,601,000	0	152,601,000	0	0		0	101,734,000	0	101,734,000	0
1.6.3	Rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar të lokalizuar dhe arrestuar	91604AB	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	77,868,000	0	77,868,000	77,868,000	0	77,868,000	77,868,000	0	77,868,000	77,868,000	0	77,868,000	77,868,000	0	77,868,000	389,340,000	0	389,340,000	233,604,000	0	233,604,000	0	0		0	155,736,000	0	155,736,000	0
1.6.4	Publikimi dhe përditësimi i të dhënave të identitetit të personave në kërkim ndërkombëtar	91604AD	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2022	13,350,000	0	13,350,000	13,350,000	0	13,350,000	13,350,000	0	13,350,000	13,350,000	0	13,350,000	13,350,000	0	13,350,000	66,750,000	0	66,750,000	40,050,000	0	40,050,000	0	0		0	26,700,000	0	26,700,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 1.6						**148,685,000**	**0**	**148,685,000**	**148,685,000**	**0**	**148,685,000**	**148,685,000**	**0**	**148,685,000**	**148,685,000**	**0**	**148,685,000**	**148,685,000**	**0**	**148,685,000**	**743,425,000**	**0**	**743,425,000**	**446,055,000**	**0**	**446,055,000**	**0**	**0**	**0**	**0**	**297,370,000**	**0**	**297,370,000**	**0**
1.7	**VII. OBJEKTIVI SPECIFIK: Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja**																																		
	Masat																																		
1.7.1	Rritja e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor në raport me minimizimin e kohës për ekzekutimin e kërkesave për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar nga Shqipëria apo nga shtetet e huaja	1014001 Projektakte të hartuara dhe të vleresuara	Ministria e Drejtësisë	MEPJ	2021	2022	15,355,000	0	15,355,000	15,355,000	0	15,355,000	15,355,000	0	15,355,000	15,355,000		15,355,000	15,355,000		15,355,000	76,775,000	0	76,775,000	46,065,000	0	46,065,000	0	0		0	30,710,000	0	30,710,000	0
1.7.2	Përditësimi dhe aksesi në regjistrin gjyqësor penal të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit	1014001 Projektakte të hartuara dhe të	Ministria e Drejtësisë	MEPJ	2021	2022	921,000	0	921,000	921,000	0	921,000	921,000	0	921,000	921,000		921,000	921,000		921,000	4,605,000	0	4,605,000	2,763,000	0	2,763,000	0	0		0	1,842,000	0	1,842,000	0

		vleresuara																																	
1.7.3	Mbështetja dhe rritja e pjesëmarrjes në skuadrat e përbashkëta hetimore (JIT-s dypalëshe/Eurojust)	1014001 Projektakte të hartuara dhe të vleresuara	Ministria e Drejtësisë	MEPJ	2021	2022	738,000	0	738,000	738,000	0	738,000	738,000	0	738,000	738,000		738,000	738,000		738,000	3,690,000	0	3,690,000	2,214,000	0	2,214,000	0	0		0	1,476,000	0	1,476,000	0
	Kosto: Objektivi specifik 1.7						17,014,000	0	17,014,000	17,014,000	0	17,014,000	17,014,000	0	17,014,000	17,014,000	0	17,014,000	17,014,000	0	17,014,000	85,070,000	0	85,070,000	51,042,000	0	51,042,000	0	0	0	0	34,028,000	0	34,028,000	0
	Kosto totale: Qëllimi i politikës I (objektiva specifikë 1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6+1.7)						3,268,475,000	99,140,000	3,367,615,000	3,261,585,000	478,071,000	3,739,656,000	3,229,794,500	0	3,219,394,500	3,232,801,900	0	3,232,801,900	3,262,301,900	0	3,262,301,900	16,254,958,300	577,211,000	16,832,169,300	9,278,054,500	77,210,000	9,355,264,500	0	500,001,000	0	500,001,000	6,173,903,800	0	6,173,903,800	-803,000,000

I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT

QËLLIMI I POLITIKËS II. MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË

III. Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: Programi 01110 Ministria e Brendshme; Programi 03140, Policia e Shtetit;

Nr.	Title	Programi buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative/2021			Kostoja indikative/2022			Kostoja indikative/2023			Kostoja indikative/2024			Kostoja indikative/2025			Kostoja indikative Totale			Burimi i Financimit							Burimi i Financimit			Hendeku financiar
																									Buxhet Shteti (në mijë lekë)			Financim i Huaj (në mijë lekë)				Buxheti 2024-2026 (në lekë)			
		Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati Fillimit	Afati Mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH	
2.1	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar**																																		
	Masat																																		
2.1.1	Garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit	91604AD	PSH	KLGJ PP	2021	2022	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	427,500,000	0	427,500,000	256,500,000	0	256,500,000	0	0		0	171,000,000	0	171,000,000	0
2.1.2	Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë	91604AD	PSH	KLGJ PP	2021	2022	15,850,000	0	15,850,000	15,850,000	0	15,850,000	15,850,000	0	15,850,000	15,850,000	0	15,850,000	15,850,000	0	15,850,000	79,250,000	0	79,250,000	47,550,000	0	47,550,000	0	0		0	31,700,000	0	31,700,000	0
2.1.3	Asistimi i viktimave të trafikimit	91604AD	PSH	KLGJ PP	2021	2022	45,850,000	0	45,850,000	45,850,000	0	45,850,000	45,850,000	0	45,850,000	45,850,000	0	45,850,000	45,850,000	0	45,850,000	229,250,000	0	229,250,000	137,550,000	0	137,550,000	0	0		0	91,700,000	0	91,700,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 2.1						147,200,000	0	147,200,000	147,200,000	0	147,200,000	147,200,000	0	147,200,000	147,200,000	0	147,200,000	147,200,000	0	147,200,000	736,000,000	0	736,000,000	441,600,000	0	441,600,000	0	0	0	0	294,400,000	0	294,400,000	0
2.2	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Rritja e profesionalizmit**																																		
	Masat																																		
2.2.1	Kryerja e trajnimeve të strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit të strukturave dhe veprimtarive kriminale	91604AA	Policia e Shtetit		2021	2022	226,800,000	0	226,800,000	226,800,000	0	226,800,000	226,800,000	0	226,800,000	226,800,000	0	226,800,000	226,800,000	0	226,800,000	1,134,000,000	0	1,134,000,000	680,400,000	0	680,400,000	0	0		0	453,600,000	0	453,600,000	0
2.2.2	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, dënimit të autorëve dhe sekuestrimit/konfiskimit të produkteve dhe aseteve kriminale	Rekrutë të trajnuar në auditore dhe në terren 91604AM	AS	PSH KLGJ Shkolla e Magjistraturës	2021	2022	12,000,000	0	12,000,000	12,000,000	0	12,000,000	12,000,000	0	12,000,000	12,000,000	0	12,000,000	12,000,000	0	12,000,000	60,000,000	0	60,000,000	36,000,000	0	36,000,000	0	0		0	24,000,000	0	24,000,000	0
2.2.3	Kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, funksionarët e drejtësisë dhe stafet administrative për çështje të bashkëpunimit policor/gjyqësor ndërkombëtar	Rekrutë të trajnuar në auditore dhe në terren 91604AM	AS	PSH KLGJ Shkolla e Magjistraturës	2021	2022	11,500,000	0	11,500,000	11,500,000	0	11,500,000	11,500,000	0	11,500,000	11,500,000	0	11,500,000	11,500,000	0	11,500,000	57,500,000	0	57,500,000	34,500,000	0	34,500,000	0	0		0	23,000,000	0	23,000,000	0
2.2.4	Pranimi në Akademinë e Sigurisë i të diplomuarve që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë	Rekrutë të trajnuar në auditore dhe në terren 91604AM	AS		2021	2021	29,500,000	0	29,500,000	29,500,000	0	29,500,000	29,500,000	0	29,500,000	29,500,000	0	29,500,000	29,500,000	0	29,500,000	147,500,000	0	147,500,000	88,500,000	0	88,500,000	0	0		0	59,000,000	0	59,000,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 2.2						279,800,000	0	279,800,000	279,800,000	0	279,800,000	279,800,000	0	279,800,000	279,800,000	0	279,800,000	279,800,000	0	279,800,000	1,399,000,000	0	1,399,000,000	839,400,000	0	839,400,000	0	0	0	0	559,600,000	0	559,600,000	0
2.3	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krimit të organizuar**																																		
	Masat																																		
2.3.1	Analizë e legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit në funksion të masave parandaluese me karakter ekonomik dhe pasuror	91603AB	MB	PSH MFE	2021	2021	7,500,000	0	7,500,000	7,500,000	0	7,500,000	7,500,000	0	7,500,000	7,500,000	0	7,500,000	7,500,000	0	7,500,000	37,500,000	0	37,500,000	22,500,000	0	22,500,000	0	0		0	15,000,000	0	15,000,000	0
2.3.2	Evidentimi i mangësive dhe i nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor parandalues	91603AB	MB	PSH	2021	2021	12,880,000	0	12,880,000	12,880,000	0	12,880,000	12,880,000	0	12,880,000	12,880,000	0	12,880,000	12,880,000	0	12,880,000	64,400,000	0	64,400,000	38,640,000	0	38,640,000	0	0		0	25,760,000	0	25,760,000	0
2.3.3	Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi	91603AB	MB	PSH	2021	2021	15,500,000	0	15,500,000	15,500,000	0	15,500,000	15,500,000	0	15,500,000	15,500,000	0	15,500,000	15,500,000	0	15,500,000	77,500,000	0	77,500,000	46,500,000	0	46,500,000	0	0		0	31,000,000	0	31,000,000	0
2.3.4	Kryerja e trajnimeve, analizave dhe koordinimi ndërinstitucional në zbatim të masave parandaluese pasurore	91604AD	PSH	MB	2021	2022	50,500,000	0	50,500,000	50,500,000	0	50,500,000	50,500,000	0	50,500,000	50,500,000	0	50,500,000	50,500,000	0	50,500,000	252,500,000	0	252,500,000	151,500,000	0	151,500,000	0	0		0	101,000,000	0	101,000,000	0
	Kostoja: Objektivi specifik 2.3						86,380,000	0	86,380,000	86,380,000	0	86,380,000	86,380,000	0	86,380,000	86,380,000	0	86,380,000	86,380,000	0	86,380,000	431,900,000	0	431,900,000	259,140,000	0	259,140,000	0	0	0	0	172,760,000	0	172,760,000	0
	Kostoja totale: Qëllimi i politikës II (objektiva specifikë 2.1+2.2+2.3)						513,380,000	0	513,380,000	513,380,000	0	513,380,000	513,380,000	0	513,380,000	513,380,000	0	513,380,000	513,380,000	0	513,380,000	2,566,900,000	0	2,566,900,000	1,540,140,000	0	1,540,140,000	0	0	0	0	1,026,760,000	0	1,026,760,000	0

I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT

QËLLIMI I POLITIKËS III: RRITJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

III. Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: Programi 01110 Ministria e Brendshme; Programi 03140, Policia e Shtetit;

Nr.	*Title*	Programi buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative/2021			Kostoja indikative/2022			Kostoja indikative/2023			Kostoja indikative/2024			Kostoja indikative/2025			Kostoja indikative/Totale			Burimi i Financimit							Burimi i financimit			Hendeku financiar
																									PBA 2021-2023 (në lekë)			Financim i huaj (në lek)				Buxheti 2024-2026 (në lek)			
		Referenca e rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucioni përgjegjës	Institu-cioni kontri-bues	Afati i filli-mit	Afati i mbari-mit	Korente	Kapi-tale	Total Kostoja	Korente	Kapitale	Total Kostoja	Korente	Kapi-tale	Total Kostoja	Korente	Kapi-tale	Total Kostoja	Korente	Kapi-tale	Total Kostoja	Korente	Kapitale	Total Kosto	Korente	Kapitale	Total BSH	Kore-nte	Kapitale	Emri donatorit/titullit të projektit	Total financim i huaj	Korente	Kapi-tale	Total BSH	
3.1	**OBJEKTIVI SPECIFIK: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medies dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar**																																		
	Masat																																		
3.1.1	Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në nivel qendror dhe vendor, me grupe të targetuara dhe tema të përshtatura me kontekstin vendor lidhur me risqet, pasojat dhe parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale	91604AB	Policia e Shtetit	MASR Prefekti i Qarkut	2021	2022	52,550,000	0	52,550,000	52,550,000	0	52,550,000	52,550,000	0	52,550,000	52,550,000	0	52,550,000	52,550,000	0	52,550,000	262,750,000	0	262,750,000	157,650,000	0	157,650,000	0	0		0	105,100,000	0	105,100,000	0
3.1.2	Organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në institucione arsimore publike dhe private	91604AA	Policia e Shtetit	MASR IAL	2021	2022	8,750,000	0	8,750,000	8,750,000	0	8,750,000	8,750,000	0	8,750,000	8,750,000	0	8,750,000	8,750,000	0	8,750,000	43,750,000	0	43,750,000	26,250,000	0	26,250,000	0	0		0	17,500,000	0	17,500,000	0
3.1.3	Realizimi i video-mesazheve ndërgjegjësuese mbi risqet dhe pasojat e krimit të organizuar si dhe promovimi i modeleve pozitive ndërmjet të rinjve dhe transmetimi në mediet lokale, rrjete sociale etj.	91604AA	Policia e Shtetit		2021	2022	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	800,000	0	800,000	4,000,000	0	4,000,000	2,400,000	0	2,400,000	0	0		0	1,600,000	0	1,600,000	0
3.1.4	Organizimi i takimeve të Këshillave Vendorë për Siguri Publike me të ftuar nga shoqëria civile, të rinj, aktorë kyç në komunitete me fokus rritjen e vetëdijësimit ndaj krimit të organizuar	91604AA	Policia e Shtetit	MASR Prefekti i Qarkut	2021	2022	25,750,000	0	25,750,000	25,750,000	0	25,750,000	25,750,000	0	25,750,000	25,750,000	0	25,750,000	25,750,000	0	25,750,000	128,750,000	0	128,750,000	77,250,000	0	77,250,000	0	0		0	51,500,000	0	51,500,000	0

	Kosto objektivi specifik 3.1						87,850,000	0	87,850,000	87,850,000	0	87,850,000	87,850,000	0	87,850,000	87,850,000	0	87,850,000	87,850,000	0	87,850,000	439,250,000	0	439,250,000	263,550,000	0	263,550,000	0	0	0	0	175,700,000	0	175,700,000	0
3.2	OBJEKTIVI SPECIFIK: Ofrimi dhe konsolidimi i infrastrukturës së komunikimit/ hapaj për zona dhe komunitete vulnerabël.																																		
	Masat																																		
3.2.1	Evidentimi dhe mbulimi i zonave gjeografike, komunitetve dhe grupeve vlnerabël të dëmtuar dhe vulnerabël nga zvarritjet dhe ripozicionimi i popullsisë	91040AA	Policia e Shtetit		MSHMS Kodi i Buxhetit Prefekt i Qarkut	2021	2021	18,500,000	0	18,500,000	18,500,000	0	18,500,000	18,500,000	0	18,500,000	18,500,000	0	18,500,000	18,500,000	0	18,500,000	92,500,000	0	92,500,000	55,500,000	0	55,500,000	0	0		0	37,000,000	0	37,000,000	0
3.2.2	Nxitja e programeve sociale me fokus shtesë në grupet e vulosura e lënë pranë prefekturës të financuara nga Fondi i Posaçëm për parandalimin e komunalizmit	Patrati të sekuestruara 91040AG	AAPSK		MSHTR Prefekt e Shtetit MTMT Kodi i Buxhetit Prefekt i Qarkut	2021	2022	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000	0	3,000,000	15,000,000	0	15,000,000	9,000,000	0	9,000,000	0	0		0	6,000,000	0	6,000,000	0
3.2.3	Nxitja e bilancit të ekuilibrave të konsiderueshëm në pasuritë të njëtrës të qeverisjes vendore, me qëllim përdorimin e burimit mobël	91040AB	MB			2021	2022	1,200,000	0	1,200,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,200,000	0	1,200,000	1,200,000	0	1,200,000	0	0	0	0	0	0	0
	Kosto objektivi specifik 3.2						22,700,000	0	22,700,000	21,500,000	0	21,500,000	21,500,000	0	21,500,000	21,500,000	0	21,500,000	21,500,000	0	21,500,000	108,700,000	0	108,700,000	65,700,000	0	65,700,000	0	0	0	0	43,000,000	0	43,000,000	0
	Kostoja totale Qëllimi i Politikës III (objektiva specifikë 3.1+3.2)						110,550,000	0	110,550,000	109,350,000	0	109,350,000	109,350,000	0	109,350,000	109,350,000	0	109,350,000	109,350,000	0	109,350,000	547,950,000	0	547,950,000	329,250,000	0	329,250,000	0	0	0	0	218,700,000	0	218,700,000	0
	Total Cost of the Action Plan = QPI + QP II + QP III						3,892,895,000	93,540,000	3,999,345,000	3,884,203,000	474,077,200	4,362,286,000	3,892,224,300	0	3,892,224,300	3,892,224,300	0	3,892,224,300	3,892,224,300	0	3,892,224,300	19,569,899,200	377,271,000	19,947,170,200	11,677,344,000	77,270,000	11,754,614,000	0	0	0	0	7,693,264,000	0	7,693,264,000	493,000,000

Qëllimi i Politikës I: ULJA E KËRCËNIMIT DHE E NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indiktive totale			Burimi i mbulimit deri më 2023-shin						Burimi i financimit			Hendeku financiar 2021–2025 (në lek)	Kostoja totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125ALL)
								PBA 2021–2023 (në lek)			Financim i huaj (në lek)			Buxheti 2024–2026 (në lek)				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kostoja	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		
Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve	Policia e Shtetit MSHMS	PP PU AISM SHISH Doganat AISM GdF / Projekti mbështetur nga BE	2021	2025	3,974,961,600	0	**3,974,961,600**	2,385,403,600	0	**2,385,403,600**	0	0	0	1,589,558,000	0	**1,589,558,000**	**0**	**31,799,693**
Goditja e trafiqeve të paligjshme	MB Policia e Shtetit MK/IKRKT	MK/IKRTK AISM PU SHISH Doganat	2021	2025	3,460,745,000	0	**3,460,745,000**	2,072,055,000	0	**2,072,055,000**	0	0	0	1,388,690,000	0	**1,388,690,000**	**0**	**27,685,960**
Goditja e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave	Policia e Shtetit AAPSK	SHISH DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA PU PP	2021	2025	4,567,750,000	0	**4,567,750,000**	2,269,670,000	0	**2,269,670,000**	0	0	0	1,495,080,000	0	**1,495,080,000**	**-803,000,000**	**36,542,000**
Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale	Policia e Shtetit; Ministria e Brendshme; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	IEVP PP SHISH	2021	2025	2,300,006,700	577,211,000	**2,877,217,700**	1,380,028,900	77,210,000	**1,457,238,900**	0	500,001,000	500,001,000	919,977,800	0	**919,977,800**	**0**	**23,017,742**
Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2025	1,123,000,000	0	**1,123,000,000**	673,800,000	0	**673,800,000**	0	0	0	449,200,000	0	**449,200,000**	**0**	**8,984,000**
Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar	Policia e Shtetit	SHISH	2021	2025	743,425,000	0	**743,425,000**	446,055,000	0	**446,055,000**	0	0	0	297,370,000	0	**297,370,000**	**0**	**5,947,400**
Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja	Ministria e Drejtësisë	MEPJ	2021	2025	85,070,000	0	**85,070,000**	51,042,000	0	**51,042,000**	0	0	0	34,028,000	0	**34,028,000**	**0**	**680,560**
Kostoja totale: Qëllimi i politikës I (objektiva specifikë 1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6+1.7)					**16,254,958,300**	**577,211,000**	**16,832,169,300**	**9,278,054,500**	**77,210,000**	**9,355,264,500**	**0**	**500,001,000**	**500,001,000**	**6,173,903,800**	**0**	**6,173,903,800**	**-803,000,000**	**134,657,354**

Qëllimi i politikës II: MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË

Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indiktive totale			Burimi i mbulimit deri më 2023-shin						Burimi i financimit			Hendeku financiar 2021–2025 (në lek)	Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125ALL)
								PBA 2021–2023 (në lek)			Financim i huaj (në lek)			Buxheti 2024–2026 (në lek)				
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Korente	Kapitale	Total Kostoja	Korente	Kapitale	Total BSH	Korente	Kapitale	Total FH	Korente	Kapitale	Total BSH		

Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar	PSH	KLGJ PP	**2021**	**2025**	736,000,000	0	**736,000,000**	441,600,000	0	**441,600,000**	0	0	**0**	294,400,000	0	**294,400,000**	**0**	**5,935,484**
Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë	PSH AS	PSH KLGJ Shkolla e Magjistraturës	**2021**	**2025**	1,399,000,000	0	**1,399,000,000**	839,400,000	0	**839,400,000**	0	0	**0**	559,600,000	0	**559,600,000**	**0**	**11,282,258**
Zbatimi i qasjes parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik ndaj subjekteve të lidhur me veprimtari të krimit të organizuar dhe krimet e rënda	MB	PSH MFE	**2021**	**2025**	431,900,000	0	**431,900,000**	259,140,000	0	**259,140,000**	0	0	**0**	172,760,000	0	**172,760,000**	**0**	**3,483,065**
Kostoja totale: Qëllimi i Politikës II (objektiva specifikë 2.1+2.2+2.3)					**2,566,900,000**	**0**	**2,566,900,000**	**1,540,140,000**	**0**	**1,540,140,000**	**0**	**0**	**0**	**1,026,760,000**	**0**	**1,026,760,000**	**0**	**3,483,065**

Qëllimi i Politikës III: RRITJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA

Objektivat specifikë	**Institucionet përgjegjëse**		**Afati i zbatimit**		**Kostoja indiktive totale**			**Burimi i mbulimit deri më 2023-shin**						**Burimi i financimit**			**Hendeku financiar 2021–2025 (në lek)**	**Kosto totale në EUR (kursi këmbimit: 1 EUR = 125 ALL)**
								PBA 2021–2023 (në lek)			**Financim i huaj (në lek)**			**Buxheti 2024-2026 (në lek)**				
	Institucioni përgjegjës	**Institucioni kontribues**	**Afati i fillimit**	**Afati i mbarimit**	**Korente**	**Kapitale**	**Total Kostoja**	**Korente**	**Kapitale**	**Total BSH**	**Korente**	**Kapitale**	**Total FH**	**Korente**	**Kapitale**	**Total BSH**		
Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medies dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar	Policia e Shtetit	MASR IAL Prefekti i Qarkut	**2021**	**2025**	439,250,000	0	**439,250,000**	263,550,000	0	**263,550,000**	0	0	**0**	175,700,000	0	**175,700,000**	**0**	**3,542,339**
Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël	Policia e Shtetit AAPSK MB	MBZHR Policia e Shtetit MTMT Bashkitë Prefekti I Qarkut MSHMS	**2021**	**2025**	108,700,000	0	**108,700,000**	65,700,000	0	**65,700,000**	0	0	**0**	43,000,000	0	**43,000,000**	**0**	**876,613**
Kostoja totale: Qëllimi i politikës III (objektiva specifikë 3.1+3.2)					**547,950,000**	**0**	**547,950,000**	**329,250,000**	**0**	**329,250,000**	**0**	**0**	**0**	**218,700,000**	**0**	**218,700,000**	**0**	**4,418,952**
Kostoja totale e PV-së					**19,369,808,300**	**577,211,000**	**19,947,019,300**	**11,147,444,500**	**77,210,000**	**11,224,654,500**	**0**	**500,001,000**	**500,001,000**	**7,419,363,800**	**0**	**7,419,363,800**	**-803,000,000**	**142,559,371**

Kostot Totale të PV	19,947,019,300	%
PBA 2021-2023	11,224,654,500	56
Financimi i huaj	500,001,000	3
Buxheti 2021 – 2025	7,419,363,800	37
Hendek financiar 2021–2025	803,000,000	4

Kostoja korente	19,369,808,300
Kostoja kapitale	577,211,000
Total, kostoja	19,947,019,300

	Kostoja korente	Kostoja kapitale	Totali
Qëllimi i politikës I	16,254,958,300	577,211,000	16,832,169,300
Qëllimi i politikës II	2,566,900,000	0	2,566,900,000
Qëllimi i politikës III	547,950,000	0	547,950,000

Nevojat Kapitale (në Lek)

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2020-2025	Kostot e Planifikuara PBA 2020-2023 Buxheti dhe Donatoret	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024-2025	Hendeku Financiar 2021-2025
Qëllimi i Politikës I	Korente	16,254,958,300	9,278,054,500	6,173,903,800	803,000,000
	Kapitale	577,211,000	577,211,000	0	
Qëllimi i Politikës II	Korente	2,566,900,000	1,540,140,000	1,026,760,000	0
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës III	Korente	547,950,000	329,250,000	218,700,000	0
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Leke]		**19,947,019,300**	**11,724,655,500**	**7,419,363,800**	**803,000,000**
TOTALI [Euro] *1 euro 125 Leke*		**159,576,154**	**93,797,244**	**59,354,910**	**6,424,000**


Kostot e PV- NDARJA E SHPENZIMEVE
Hendek financiar 2021-2025
4 %
Buxheti 2024-2025
37 %
PBA 2021-2023
56
%
FInancimi I Huaj
3%


Natyra Ekonomike e Kostove të Planit te Veprimit
Kosto kapitale
3%
Kosto Korente
97%


Kosto të lidhura me Qëllimin e Politikave
100%
90%
80%
70%
60%
50%
40%
30%
20%
10%
0%
1,292,406,000
24,930,273,602
1,149,158,000
1,793,500,000
0
7,200,000
Kosto Kapitale
Kosto Korente
Qëllimi i Politikës I
Qëllimi i Politikës II
Qëllimi i Politikës III

VENDIM
Nr. 1143, datë 9.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 750, DATË 16.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË POLICISË SË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 136, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores së Policisë së Shtetit, të miratuar me vendimin nr. 750, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 6 hiqen fjalët " ... realizimin e detyrave nga punonjës policie në një periudhë të caktuar ...".

2. Në pikën 16 hiqen fjalët "... ose në të gjithë territorin e vendit ..." dhe pas fjalëve "... në varësi të strukturës qendrore ..." hiqen fjalët "... apo vendore ...".

3. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1, me këtë përmbajtje:

"16/1. "Strukturat e veçanta" janë strukturat e policisë në varësi të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në nivel drejtorie, sektori, komisariati, seksioni, stacioni dhe poste policie që veprojnë në një territor të caktuar ose në të gjithë territorin e vendit.".

Neni 2

Pika 5, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Në strukturat policore, në mjediset e brendshme, në muze, kabinete, klasa etj., flamuri kombëtar mund të mbahet i hapur në mure ose tenda.".

Neni 3

Neni 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 8
Stema e Republikës së Shqipërisë dhe stema e Policisë së Shtetit

1. Stema e Republikës së Shqipërisë është simbol shtetëror, e cila mbahet dhe përdoret në Policinë e Shtetit, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

2. Stema e Republikës së Shqipërisë vendoset në hyrjen kryesore të strukturave policore, mbi emërtimin e tij, në vula, si element identifikues, dhe në aktet që nxjerrin strukturat policore.

3. Stema e Policisë së Shtetit është simbol i konfiguruar i identitetit të institucionit të policisë dhe përdoret vetëm nga strukturat përbërëse të saj.

4. Stema e Policisë së Shtetit, e stilizuar në medaljone, lejohet të përdoret në uniformat e punonjësve të policisë, në kostumet sportive, në materiale kancelarie, të cilat përdoren në Policinë e Shtetit (në stilografë, stilolapsa, dosje, kalendarë, në ftesa, në njoftime, në seminare) etj.

5. Stema e Policisë së Shtetit është sipas lidhjes nr. 18 të kësaj rregulloreje.".

Neni 4

Neni 10 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e dytë, të pikës 1, pas fjalëve "... të Policisë së Shtetit ..." hiqen fjalët "... në Akademinë e Sigurisë ...".

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Në përfundim të shkollimit/formimit përkatës policor, studenti/kursanti betohet përpara flamurit kombëtar dhe flamurit të Policisë së Shtetit. Data e betimit caktohet me urdhër të drejtorit të Akademisë së Sigurisë.".

3. Në pikën 4 hiqet fjalia "Ai mund të përcaktohet brenda institucionit të Akademisë ose jashtë tij.".

Neni 6

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 18 ndryshohet dhe bëhet "Procedurat e brendshme për organizimin ose ndryshimin e strukturës".

2. Në shkronjën "a", të pikës 1, hiqen fjalët "... i cili, ndër të tjera, duhet të përmbajë ..." dhe nënndarjet "i", "ii", "iii" e "iv".

Neni 8

Në shkronjën "c", të pikës 5, të nenit 21, fjalët "... hartimin e strategjive njëvjeçare ..." zëvendësohen me "... dhënien e kontributeve që u kërkohen në hartimin e strategjive, programeve apo planeve të veprimit ...".

Neni 9

Në nenin 23 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2, fjalët "... drejtorit ose zëvendësdrejtorit të policisë vendore për rendin dhe sigurinë publike ..." zëvendësohen me "... drejtorit të drejtorisë vendore të policisë ...".

2. Në pikën 3, fjalët "... shërbim policor ..." zëvendësohen me "... strukturë policore operacionale ...".

3. Në shkronjën "a", të pikës 4, pas fjalëve "... si dhe ofrimin e shërbimeve ..." hiqet fjala "... urgjente ..." dhe pas fjalëve "... institucionet apo organizatat ..." hiqen fjalët "... sa herë që u kërkohet ...".

4. Në shkronjën "ç", të pikës 4, pas fjalëve "... të shkollave dhe biznesit në ..." fjala "... territorin ..." zëvendësohet me fjalën "... juridiksionin ...".

Neni 10

Në nenin 24 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, para fjalëve "... drejtohet nga shefi i Stacionit të Policisë..." shtohen fjalët "Stacioni i Policisë ...".

2. Në shkronjën "a", të pikës 3, hiqet fjala "... urgjente ...".

Neni 11

Në pikën 2, të nenit 25, fjalët "... por në juridiksionin e tij të caktuar ..." zëvendësohen me "... brenda juridiksionit të saj ...".

Neni 12

Pikat 6, 7 e 8, të nenit 27, hiqen.

Neni 13

Neni 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 30
Elementet e aktit administrativ dhe njohja me aktet

Procedurat e njohjes me aktet administrative dhe elementet e aktit administrativ janë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.".

Neni 14

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4, fjala "... shifrës ..." zëvendësohet me fjalët "... Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ...".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Prodhimi, administrimi dhe qarkullimi i informacionit të klasifikuar në strukturat e policisë kryhet sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" dhe udhëzimeve të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.".

Neni 15

Nenet 31, 32, 36, 40, 41, 43, 44, 45, 47, 48 dhe 49 shfuqizohen.

Neni 16

Pas pikës 8, të nenit 35, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

"9. Për sigurinë e informacionit në rrjetet elektronike, nivelin e aksesit, nivelin e klasifikimit të tyre dhe mënyrën e ruajtjes së informacionit në to zbatohen aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe udhëzimet e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

Neni 17

Në nenin 42 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Të gjitha aktet, dokumentet zyrtare, regjistrimet audiovizuale, kompjuterike dhe çdo material tjetër që kategorizohet informacion i klasifikuar, klasifikohet, grumbullohet, trajtohet e administrohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.".

Neni 18

Neni 46 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 46
Hyrja dhe dalja e personave në mjediset e policisë

Rregullat dhe procedurat për hyrjen dhe daljen e personave, që nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, në ndërtesat/mjediset e Policisë së Shtetit, miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

Neni 19

Shkronja "b", e nenit 57, hiqet.

Neni 20

Pas pikës 9, të nenit 60, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1. Struktura përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e armatimit në Policinë e Shtetit mban një regjistër qendror për armët dhe municionet. Ky regjistër mbahet njëkohësisht në formë elektronike dhe në një libër të posaçëm.".

Neni 21

Në nenin 61 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Miratimi i lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj jepet nga drejtuesi i strukturës qendrore, vendore apo të veçantë.".

2. Pika 3 hiqet.

Neni 22

Pas nenit 61 shtohet neni 61/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 61/1
Transferimi i punonjësit të policisë në struktura të tjera shtetërore

1. Transferim në struktura të tjera shtetërore është emërimi i punonjësit të policisë në një institucion publik jashtë Policisë së Shtetit.

2. Institucioni në të cilin punonjësi i policisë transferohet është Ministria e Brendshme, institucionet në varësi të saj, si dhe organe apo institucione të tjera të administratës shtetërore, të cilat kanë në organikë funksione që mund të kryhen profesionalisht nga punonjës të Policisë së Shtetit.

3. Punonjësi i policisë mund të transferohet në funksione të ndryshme në struktura të tjera shtetërore, në rast se kjo kërkohet ose miratohet nga autoritetet zyrtare përgjegjëse, në përputhje me kriteret e parashikuara për çdo funksion.

4. Gjatë kohës që punonjësi i policisë shërben si i transferuar në pozicione të ndryshme jashtë strukturës së Policisë së Shtetit, ai nuk gëzon atributet që lidhen me statusin e policisë gjyqësore dhe as ato që lidhen me statusin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

5. Në rastet kur punonjësi i policisë transferohet në administratën publike, ai emërohet në funksione me nivel ekuivalent me gradën e tij policore. Për procesin e ekuivalentimit të gradave të Policisë së Shtetit dhe administratës publike, për qëllime të zbatimit të këtij procesi, merren në konsideratë parashikimet në aktin nënligjor përkatës, që miraton Këshilli i Ministrave për këtë qëllim.

6. Punonjësi i policisë, i transferuar sipas këtij neni, mund të rikthehet në detyrë brenda

strukturave të Policisë së Shtetit, sipas të njëjtave rregulla dhe procedura që ndiqen edhe në rastin e transferimit të tij jashtë strukturave të saj, në përputhje me kualifikimin profesional dhe gradën policore.

7. Transferimi i punonjësit të policisë në struktura të tjera shtetërore nuk konsiderohet dalje nga Policia e Shtetit në kuptim të nenit 43 të ligjit për Policinë e Shtetit.

8. Periudha e shërbimit të punonjësit të policisë së shtetit, të transferuar sipas këtij neni në funksione jashtë Policisë së Shtetit, konsiderohet si periudhë e vlefshme për efekte të vjetërsisë.

9. Punonjësi i Policisë së Shtetit ka të drejtën e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë në pozicionet e administratës publike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, pas ekuivalentimit të gradave policore me ato civile.

10. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që fiton të drejtën e studimeve në fushën e sigurisë në një prej universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose të Bashkimit Evropian, i ruhet e drejta e rikthimit në të njëjtin pozicion, me mbarimin e studimeve. Periudha e studimeve konsiderohet si periudhë e vlefshme për efekte të vjetërsisë së shërbimit.

11. Në rastet e transferimit të punonjësve të policisë në struktura të tjera zbatohen rregullat dhe procedurat e hollësishme të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave përkatës për këtë qëllim.

Neni 23

Pas pikës 2, të nenit 63, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

"3. Punonjëset e policisë shtatzëna dhe ato që kanë fëmijë deri në moshën 1 (një) vjeç nuk mund të urdhërohen të kryejnë shërbim natën.

4. Punonjësja e policisë nuk mban uniformë policore në muajt e dukshëm të shtatzënisë.".

Neni 24

Nenet 64, 66, 69, 71, 72, 73, 74, 75, 76 dhe 77 shfuqizohen.

Neni 25

Në nenin 67 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "ë", të pikës 1, hiqet fjala "etj." dhe pas kësaj shkronje shtohet shkronja "f", më këtë përmbajtje:

"f) planeve të veçanta.".

2. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"2. Monitorimi dhe analiza për realizimin e detyrimeve të përcaktuara në strategjitë, programet dhe planet e punës në Policinë e Shtetit realizohet nëpërmjet:

a) raporteve dhe analizës mujore;

b) raporteve dhe analizës tremujore;

c) raporteve dhe analizës gjashtëmujore;

ç) raporteve dhe analizës nëntëmujore;

d) raporteve dhe analizës vjetore (raporti vjetor i Policisë së Shtetit);

dh) raporteve dhe analizave të tjera.

3. Procedurat për hartimin, elementet përbërëse, afatet dhe strukturat përgjegjëse për hartimin e zbatimin e programeve, planeve, analizave dhe raporteve përcaktohen në urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

Neni 26

Pas nenit 67 shtohet neni 67/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 67/1
Raporti vjetor i Policisë së Shtetit

Raporti vjetor i Policisë së Shtetit përgatitet dhe dërgohet në formë shkresore dhe elektronike në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike brenda muajit shkurt të vitit pasardhës.".

Neni 27

Neni 68 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 68
Përgjegjësitë për hartimin e strategjive

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit harton strategji sektoriale e ndërsektoriale të Policisë së Shtetit për zhvillimin e institucionit dhe për drejtime të veçanta të përgjegjësive të saj, ndërsa drejtoria vendore e policisë harton strategji vjetore për territorin në juridiksionin e saj. Strategjitë, në bazë juridiksioni lëndor ose sipas

problematikës, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, hartohen e ndiqen nga strukturat qendrore respektive.

2. Strategjitë e Policisë së Shtetit, përfshirë këtu edhe Strategjinë e Policimit në Komunitet hartohen në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të këtij neni. Projektstrategjitë diskutohen paraprakisht në Këshillin e Politikave para miratimit të tyre. Projektstrategjia vjetore propozohet për miratim, brenda datës 15 dhjetor të vitit pararendës dhe miratohet brenda muajit janar të vitit zbatues të saj.".

Neni 28

Në nenin 70 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës "... strategjisë ..." shtohen fjalët "... përfshirë Strategjinë e Policimit në Komunitet ...".

2. Në shkronjën "d", pas fjalës "... vlerësimi ...", shtohen fjalët "... dhe zbatimi ...".

Neni 29

Në nenin 79 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve "... punonjësve të policisë" shtohen "... agjencive të zbatimit të ligjit ...".

2. Në pikën 4, pas fjalës "... civile ..." shtohen fjalët "... dhe agjencive të zbatimit të ligjit dhe organizmave brenda dhe jashtë vendit ...".

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Parimet dhe rregullat e komunikimit të strukturave të Policisë së Shtetit me medien dhe publikun përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.".

Neni 30

Në nenin 80 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës "... i brendshëm ..." shtohen fjalët "... dhe i jashtëm ...".

2. Pika 2 hiqet.

3. Në pikën 6, pas fjalës "... procedurat ...", shtohet "... standarde ... ".

Neni 31

Në nenin 82 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me shoqërinë civile dhe komunitetin realizohet me qëllim krijimin e partneritetit dhe për t'u informuar për çështje që lidhen me rendin dhe sigurinë, si dhe për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të njeriut.".

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6, me këtë përmbajtje:

"5. Komunikimi zyrtar për çështjet teknike dhe operacionale ndërmjet Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera kushtetuese brenda vendit dhe në marrëdhëniet dy- ose shumëpalëshe me jashtë, sipas marrëveshjeve të miratuara, mbahet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

6. Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me institucionet e administratës shtetërore, agjencitë ligjzbatuese, organet e qeverisjes vendore bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara në urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

Neni 32

Në nenin 83 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka të drejtë të caktojë apo të miratojë pika kontakti në strukturat policore për lehtësimin e bashkëpunimit me njësi të zbatimit të ligjit, projekte, organizata apo organizma ndërkombëtarë policorë, në përmbushje të detyrimeve të marrëveshjeve të nënshkruara.".

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6, më këtë përmbajtje:

"6. Mënyra e komunikimit të strukturave të policisë me partnerët ndërkombëtarë bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse dhe sipas kritereve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, për ato çështje që nuk zgjidhen nga marrëveshja respektive.".

Neni 33

Neni 84 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 84
Policimi në komunitet

1. Policimi në komunitet është mënyrë e policimit, që synon shndërrimin e policisë në polici

komunitare, pjesë integrale e komunitetit ku ajo shërben.

2. Policimi në komunitet kërkon që prioriteti kryesor i veprimtarisë së Policisë së Shtetit të jenë qytetarët dhe komuniteti.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë miraton dokumentin e policimit në komunitet, në të cilin, ndër të tjera, përcaktohen:

a) strategjitë vjetore dhe planet e veprimit;

b) sistemi i sigurisë në komunitet dhe monitorimi i tij;

c) bashkëpunimi me publikun;

ç) mënyra e monitorimit;

d) bashkëpunimi me grupet e tjera të interesit.".

Neni 34

Në pikën 1, të nenit 86, pas fjalëve "... Strategjinë e Sigurisë Kombëtare ..." shtohen "... prioritetet vjetore të ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ...".

Neni 35

Në pikën 1, të nenit 89, emërtesa "... Bordin Konsultativ të Qytetarëve (BKQ) ..." zëvendësohet me fjalët "... këshillat vendorë të sigurisë publike ..." dhe pas fjalëve "... komunitetin vendor ..." shtohen "... duke përfshirë organizatat civile dhe autoritetet vendore ...".

Neni 36

Në nenin 94 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, emërtesa "... Bordin Konsultativ të Qytetarëve (BKQ) ..." zëvendësohet me fjalët "... këshillat vendorë të sigurisë publike dhe struktura/grupe komunitare në bazë të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet drejtorit vendor të Policisë dhe drejtuesit/drejtuesve të strukturës/grupit komunitar ...".

2. Pika 2 hiqet.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Raportet e vlerësimit dhe rekomandimet nga këshillat vendorë të sigurisë publike dhe strukturat/grupet komunitare, të cilat i paraqiten Drejtorisë së Policisë të Shtetit bëhen publike nga Policia e Shtetit me mjete zyrtare të komunikimit.".

Neni 37

Pas nenit 96 shtohet neni 96/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 96/1

Vlerësimi i performancës së Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit, në vlerësimin e performancës, e cila kryhet nga struktura përgjegjëse, mban në konsideratë, në kriteret e procesit të vlerësimit, edhe konkluzionet, vlerësimet apo rekomandimet e dhëna nga faktorë të jashtëm, siç janë strukturat e specializuara në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe organizata partnere, kombëtare apo ndërkombëtare, me reputacion në fushën e rendit dhe sigurisë publike.".

Neni 38

Në pikën 1, të nenit 99, emërtesa "... Drejtoria e Standardeve Profesionale ..." zëvendësohet me fjalët "... drejtuesi/titullari i strukturës përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale ...".

Neni 39

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 100, fjalët "... Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ..." zëvendësohen me "... drejtuesit/titullarit të strukturës përgjegjëse për vlerësimin e performancës ...".

Neni 40

Në nenin 102 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, fjalët "... çdo rekomandim të Drejtorisë së Standardeve Profesionale ..." zëvendësohen me "... rekomandimet e raporteve të vlerësimit ...".

2. Në fjalinë e dytë, emërtesa "... Drejtoria e Standardeve Profesionale ..." zëvendësohet me fjalët "... struktura përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale në Policinë e Shtetit dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ...".

Neni 41

Nenet 103, 106, 107, 108, 109, 111, 122, 123 dhe 124 shfuqizohen.

Neni 42

Në nenin 114 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, fjalët "... kur ato përbëjnë "sekret shtetëror" ose kanë karakter personal" hiqen.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Punonjësi i Policisë së Shtetit, gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të tij, duhet:

a) të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e paautorizuar, te personat e tretë, të informacionit për të cilin ka marrë dijeni për shkak të detyrës, detyrim ky që vazhdon edhe pasi ai ndërpret marrëdhëniet e punës;

b) të mos e përdorë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj;

c) të sigurojë mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave personale të personave, të mbrojtura sipas ligjit, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës.".

Neni 43

Në pikën 3, të nenit 116, pas fjalës "... veprimtarinë ..." shtohet lidhëza "e" dhe hiqen fjalët "... sekrete të punës së ...".

Neni 44

Në nenin 127 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Bazuar në nevojat e identifikuara të Policisë së Shtetit, shpallen kuotat e aplikimit për pranim në Akademinë e Sigurisë edhe për shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 38, të ligjit për Policinë e Shtetit dhe kriteret e veçanta në bazë të nevojave të Policisë së Shtetit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.".

Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje.

"4. Vetëm personat që kanë mbushur moshën 19 vjeç dhe janë nën 30 vjeç kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në kurset e Akademisë së Sigurisë për t'u rekrutuar në Policinë e Shtetit.".

Neni 45

Në nenin 128 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Kuotat e pranimit përcaktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, sipas nevojave për personel që kanë strukturat e Policisë së Shtetit, bazuar në limitin e përcaktuar organik dhe tavaneve buxhetore të miratuara të periudhës.".

2. Në pikën 2, pas fjalëve "... më pak të përfaqësuar ..." shtohen "... fëmijët e punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës ...".

Neni 46

"Neni 130

Neni 130, ndryshohet, si më poshtë:

1. Shtetasi paraqet në drejtorinë vendore të policisë kërkesën e motivuar, ku shpreh arsyet për t'u pranuar në Policinë e Shtetit.

2. Dokumentet për aplikim janë, si më poshtë vijon:

a) formulari i aplikimit dhe autorizimi për sigurimin e dokumentacionit;

b) fotokopje e kartës së identitetit;

c) dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;

ç) fotokopje e dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B";

d) certifikatë e gjendjes gjyqësore;

dh) certifikatë familjare;

e) vërtetim nga gjykata;

ë) vërtetim nga prokuroria;

f) raport mjekoligjor;

g) fotokopje të librezës së punës ose vërtetim që ndjek arsimin e lartë (nëse i disponon);

gj) dokument të lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

3. Dokumentet e përcaktuara në shkronjat "b", "ç", "d", "dh", "e", "ë", të pikës 2, të këtij neni, sigurohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Policinë e Shtetit përmes komunikimit zyrtar me strukturat/agjencitë/institucionet përgjegjëse për lëshimin e tyre, aksesit në bazat e të dhënave të përbashkëta me këto struktura/ agjenci /institucione ose sistemeve të qarkullimit

ndërinstitucional të dokumenteve me nënshkrim elektronik.

4. Shtetasi që aplikon për pranimin në Akademinë e Sigurisë, i cili ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë, paraqet në drejtorinë vendore të policisë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, diplomën dhe listën e notave të ciklit të parë dhe të dytë të arsimit të lartë.".

Neni 47

Në pikën 1, të nenit 134, fjalët "... *website*-in e Policisë së Shtetit ..." ndryshohen me "... faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, Akademisë së Sigurisë ...".

Neni 48

Pas nenit 135 shtohet neni 135/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 135/1

Shpallja e thirrjes për konkurrim të fëmijëve të punonjësve të policisë, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës

1. Për aplikantët që hyjnë në kategorinë e fëmijëve të punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës përcaktohen procedura lehtësuese për pranimin e tyre në Akademinë e Sigurisë.

2. Kriteret dhe procedura e testimit të kësaj kategorie përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.".

Neni 49

Në nenin 136 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon, si më poshtë vijon:

"1. Struktura përgjegjëse në Drejtorinë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për koordinimin dhe monitorimin e procesit të pranimit në Akademinë e Sigurisë është struktura përgjegjëse për burimet njerëzore.".

2. Në shkronjën "b", të pikës 3, fjala "... drejtoria ..." ndryshohet me "... struktura ...".

Neni 50

Në nenin 140 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës "ë", të pikës 1, shtohen shkronjat "f" dhe "g", me këtë përmbajtje:

"f) nuk kalon kontrollin shëndetësor ose gjatë këtij kontrolli evidentohen tatuazhe në pjesët e dukshme të trupit;"

g) nuk gëzon besueshmëri për të qenë në radhët e Policisë së Shtetit";

2. Shkronja "dh" ndryshon me këtë përmbajtje:

"dh) pas procesit të verifikimit përfundimtar rezulton se ai është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje".

3. Në pikën 2, pas fjalës "... konkurrimit" shtohen fjalët "... dhe kontrollit ...".

Neni 51

Neni 142 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 142

Publikimi i rezultateve të kandidatëve

1. Në përfundim të procesit të konkurrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit publikon në *website*-in e Policisë, listën e rezultateve përfundimtare sipas rendit zbritës.

2. Pas çdo faze konkurrimi dhe kontrolli, Akademia e Sigurisë publikon në faqen zyrtare të saj listën e rezultateve sipas rendit zbritës.

3. Në përfundim të procesit të konkurrimit, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore publikon në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, listën e rezultateve përfundimtare sipas rendit zbritës".

Neni 52

Në nenin 143 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës "... konkurrimi" shtohet "... dhe kontrollit".

2. Në pikën 2, emërtesa "Drejtoria e Burimeve Njerëzore" zëvendësohet me emërtesën "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit".

3. Në pikën 4, fjalët "... shkollimi bazë ..." ndryshohen me "... shkollimin bazë dhe studimet/kualifikimet ...".

Neni 53

Neni 145 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 145
Pranimi në polici

Me përfundimin e shkollimit bazë dhe studimeve/kualifikimeve, studenti/kursanti pranohet si punonjës policie, i jepet grada policore përkatëse "inspektor" ose "nënkomisar" dhe emërohet në detyrë me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

Neni 54

Në nenin 148 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon, si më poshtë vijon:

"1. Punonjësi i Policisë, pas pranimit në Policinë e Shtetit, i nënshtrohet periudhës njëvjeçare të provës, periudhë e cila fillon në datën kur punonjësi i policisë emërohet në detyrë me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.".

2. Në pikën 3 fjalët "Drejtori i Policisë së Shtetit, në bazë të propozimit të strukturave të policisë vendore" ndryshohen me "titullari i strukturës në bazë të propozimit të eprorit të drejtpërdrejtë".

3. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Akti administrativ për shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 3, nxirret nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.".

Neni 55

Pas nenit 149 shtohet neni 149/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 149/1
Kriteret e pranimit për nevoja të veçanta

Për plotësimin e nevojave të veçanta pranohen në Policinë e Shtetit ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin për Policinë e Shtetit.".

Neni 56

Në nenin 150, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

"Funksionet e veçanta në strukturën organike të Policisë së Shtetit përcaktohen me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe miratim të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë.".

Neni 57

Pika 5, e nenit 156, ndryshohet me këtë përmbajtje:

"5. Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e trajnimeve funksionale-profesionale janë departamentet, strukturat e veçanta, strukturat vendore, sipas shërbimeve përkatëse në Policinë e Shtetit dhe Akademia e Sigurisë".

Neni 58

Në nenin 157 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Të gjithë punonjësit e policisë, pavarësisht nga grada dhe funksioni që mbajnë, çdo vit i nënshtrohen testimit fizik dhe profesional sipas normave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e testimit fizik.".

Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Testimi fizik i punonjësve të policisë zhvillohet në strukturat, ku ata janë efektivë. Rezultatet e testimit fizik janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm për përparimin e tyre në gradë dhe në karrierë. Normat dhe rregullorja e testimit fizik miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në përputhje me përcaktimet e ligjit për Policinë e Shtetit.".

Neni 59

Në nenet 158, 159 dhe 160, emërtesa "Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit" ndryshohet me fjalët "struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe struktura përgjegjëse për trajnimet.".

Neni 60

Në nenin 161 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi "... si më poshtë:" dhe shkronjat "a", "b", "c" me këtë përmbajtje:

"a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të ketë përfunduar arsimin dhe kualifikimin përkatës për gradën për të cilën konkurron sipas përcaktimeve të nenit 161/3 të kësaj rregulloreje;

c) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë sipas të afateve të përcaktuara në shkronjën "ë", të pikës 1, të nenit 55, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar dhe nenit 161/2, të kësaj rregulloreje.".

2. Pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 61

Pas nenit 161 shtohen nenet 161/1 deri në 161/7, me këtë përmbajtje:

"Neni 161/1
Kriteret për aplikim për gradimin e radhës

1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës) jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;

b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në ligjin "Për Policinë e Shtetit";

c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;

ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;

d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar.

2. Konkurrimi për fitimin e gradës bëhet vetëm për gradën pasardhëse.

Neni 161/2
Afatet e qëndrimit në gradë

1. Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

a) nga "Inspektor" deri në "Inspektor i dytë": 5 vjet;

b) nga "Inspektor i dytë" në "Inspektor i parë": 10 vjet;

b/1)Punonjësit të policisë në rolin zbatues, që ka vjetërsi shërbimi mbi 5 vjet, i lind e drejta për të konkurruar për fitimin e gradës "Nënkomisar";

c) nga "Nënkomisar" në "Komisar": 3 vjet;

ç) nga "Komisar" në "Kryekomisar": 3 vjet;

d) nga "Kryekomisar" në "Drejtues": 5 vjet;

dh) nga "Drejtues" në "Drejtues i parë": 3 vjet.

2. Në vjetërsinë për efekt gradimi nuk llogaritet koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të lejes së përfituar pa të drejtë page.

3. Në vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës llogaritet edhe koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të:

a) paaftësisë shëndetësore deri në 6 muaj, brenda afatit 12-mujor;

b) vjetërsisë së shërbimit të njohur me vendim gjyqësor;

c) lejes së lindjes.

Neni 161/3
Arsimimi dhe kualifikimet për fitimin e gradës

Kurset e detyrueshme për fitimin e gradës janë:

a) për gradën "Inspektor i dytë", të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Inspektor i dytë;

b) për gradën "Inspektor i parë", të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Inspektor i parë;

c) për gradën "Komisar" të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Komisar;

ç) për gradën "Kryekomisar" të ketë përfunduar kursin e trajnimit për Kryekomisar;

d) për gradën "Drejtues" të ketë përfunduar masterin profesional në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;

dh) për gradën "Drejtues i parë" të ketë përfunduar kursin për "Drejtues të parë".

Neni 161/4
Procedura e aplikimit dhe verifikimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave të Policisë së Shtetit, nxjerr urdhrin për kuotat për gradimet e radhës dhe afatet e këtij procesi në Policinë e Shtetit.

2. Fillimi i procesit të gradimeve shpallet në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit, si dhe dërgohet zyrtarisht në të gjitha strukturat e saj për mundësimin e konkurrimit të personelit të interesuar jo më vonë se 30 ditë nga data e konkurrimit. Për këtë qëllim, mund të përdoren edhe format e tjera të komunikimit publik.

3. Procesi i gradimeve zhvillohet vetëm një herë në vit për një gradë të caktuar policore.

4. Punonjësi që dëshiron të marrë pjesë në procesin e konkurrimit për fitimin e gradës, aplikon pranë strukturës ku është i emëruar, brenda afatit të përcaktuar.

5. Struktura vendore bën verifikimin e dokumentacionit për plotësimin e kritereve të çdo aplikanti. Për aplikantët që plotësojnë kriteret për konkurrim për fitim grade hartohet dhe dërgohet lista emërore me dokumentacionin përkatës të aplikimit në strukturën përgjegjëse për burimet njerëzore. Për ata që nuk plotësojnë këto kritere kthehet përgjigje për arsyet e mospranimit të aplikimit.

6. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe struktura përgjegjëse për trajnimet, pas riverifikimit të dokumentacionit të aplikantëve, hartojnë listën emërore përfundimtare të aplikantëve, që plotësojnë kriteret për konkurrim për fitim grade, duke i caktuar secilit aplikant një numër kodik identifikimi dhe ia dërgojnë atë strukturës përgjegjëse për menaxhimin e procesit të gradimeve.

7. Aplikanti që, pas riverifikimit, nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 161, të kësaj rregulloreje, skualifikohet. Ai njoftohet zyrtarisht për arsyet e mospranimit të aplikimit për konkurrim.

8. Aplikanti i skualifikuar ka të drejtën e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 161/7, të kësaj rregulloreje.

Neni 161/5
Zhvillimi i procedurës së konkurrimit për fitimin e gradës

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton me urdhër fillimin e procesit të konkurrimit për fitimin e gradës së radhës, fazat e konkurrimit, si dhe afatet për zhvillimin e tyre.

2. Procedura e konkurrimit dhe kriteret e vlerësimit për fitimin e gradës së radhës, duke filluar nga aplikimi deri në vlerësimin përfundimtar të aplikantëve, zhvillohen sipas standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 161/6
Shkollimi/trajnimi i aplikantëve fitues dhe dhënia e gradës

1. Konkurrentët e shpallur fitues në fazat e testimit/vlerësimit i nënshtrohen arsimimit/ trajnimit për gradën përkatëse në Akademinë e Sigurisë.

2. Numri i punonjësve të policisë që do të ndjekin programin e shkollimit/trajnimit nuk mund të jetë më shumë se 30% mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

3. Pas përfundimit të programit të arsimimit/ trajnimit, renditja e konkurrentëve bëhet sipas shumës së pikëve të arritura gjatë testimit/vlerësimit dhe arsimimit/kualifikimit për gradën përkatëse, duke filluar nga punonjësi, i cili ka vlerësimin më të lartë, duke bërë listim të ndarë ndërmjet fituesve dhe listës së pritjes.

4. Afati i qëndrimit në listë pritjeje për dhënien e gradës nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Nëse brenda këtij afati nuk bëhet e mundur dhënia e gradës, punonjësi i nënshtrohet konkurrimit të radhës.

5. Bazuar në aktin përfundimtar të vlerësimit, komisioni përkatës i gradimit i paraqet drejtorit të Përgjithshëm të Policisë listën emërore të aplikantëve fitues, sipas rendit zbritës dhe listën e pritjes.

Neni 161/7
Procesi i ankimit

1. Punonjësi i policisë ka të drejtën e ankimit për çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe i dërgohet komisionit të apelimit për fitimin e gradës, brenda 7 ditëve pune nga momenti i skualifikimit ose i shpalljes së rezultateve të testimit.

3. Komisioni i apelimit për fitimin e gradës ngrihet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në të njëjtën kohë me ngritjen e komisioneve të gradimit.

4. Komisioni i apelimit shqyrton ankesat dhe merr vendim brenda 30 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

5. Ankuesit i kthehet përgjigje zyrtare me shkrim brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit nga komisioni.

6. Formularët e vlerësimit, fletët e testimit të plotësuara në mënyrë fizike ose elektronike nuk i jepen aplikantit dhe nuk bëhen publike.

7. Ushtrimi i së drejtës së ankimit, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, pezullon nxjerrjen e urdhrit të drejtorit të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të komisionit të gradimit që është ankimuar.

8. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së aplikantit, nëse komisioni e vlerëson të drejtë, ai njoftohet jo më vonë së dy ditë para datës së fillimit të fazës pasardhëse të testimit.

9. Vendimi i komisionit të apelimit për fitimin e gradës është i zbatueshëm menjëherë.

10. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të policisë i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

11. Urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për dhënien e gradave miratohet pas përfundimit të afateve të procesit të apelimit.".

Neni 62

Në nenin 162 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Grada "Nënkomisar" fitohet pas shpalljes fitues në procesin e konkurrimit dhe përfundimit të ciklit të parë të studimeve të arsimit të lartë ose pas përfundimit të kursit përkatës në Akademinë e Sigurisë për konkurrentët që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.".

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Gradat "Inspektor i dytë", "Inspektor i parë", "Komisar", "Kryekomisar", "Drejtues" dhe "Drejtues i parë" fitohen nëpërmjet konkurrimit për gradim.".

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Gradat "Drejtues i lartë" dhe "Drejtues madhor" jepet në momentin e emërimit të punonjësit që i korrespondojnë këto grada.".

5. Pikat 5 dhe 6 hiqen.

Neni 63

Nenet 163, 164 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171 dhe 172 shfuqizohen.

Neni 64

Në pikën 1, të nenit 173, emërtesa "... Drejtoria e Standardeve Profesionale ..." ndryshohet me fjalët "... struktura përgjegjëse për vlerësimin e standardeve profesionale ..."

Neni 65

Në pikën 7, të nenit 177, fjala "tip" hiqet.

Neni 66

Në titullin e kreut VII, përpara fjalës "transferimi ..." shtohet "emërimi ...".

Neni 67

Pas nenit 179 shtohen nenet 179/1, 179/2, 179/3, 179/4, 179/5, 179/6 dhe 179/7 me këtë përmbajtje:

"Neni 179/1
Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim

1. Emërimi në detyrë i punonjësve të policisë bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore dhe me miratim të autoriteteve që përcakton ligji për Policinë e Shtetit.

2. Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim shqyrton dhe i propozon autoritetit që ka

në kompetencë emërimin e punonjësve të policisë, emërimin e kandidatëve, që:

a) përfundojnë studimet në Akademinë e Sigurisë;

b) përfundojnë kurset e specializimit dhe të kualifikimit në institucionet e lartpërmendura dhe/ose ato homologe jashtë vendit;

c) kanë fituar gradën e radhës dhe janë objekt i lëvizjes në detyrë;

ç) propozohen nga eprorët për t'u ngritur ose ulur në detyrë;

d) paraqesin vetë kërkesë për të lëvizur nga detyra;

dh) transferimi i tyre është i detyrueshëm;

e) janë ulur në detyrë si rezultat i masës disiplinore të dhënë ose i vlerësimit individual;

ë) rikthehen në strukturat e policisë.

Neni 179/2

Kriteret e emërimit në detyrë të punonjësve të policisë

Emërimi në detyrë i punonjësve të policisë bëhet në bazë të kritereve, si më poshtë vijon:

a) performanca në punë;

b) formimi dhe kualifikimi;

c) vjetërsia në shërbim;

ç) vjetërsia në gradë.

Neni 179/3

Organizimi i Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

Këshilli i vlerësimit të propozimeve për emërim është i përhershëm dhe funksionon në dy nivele, atë qendror dhe vendor. Në nivel qendror funksionon përmes Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim dhe në nivel vendor përmes Këshillit Vendor të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

Neni 179/4

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

1. Këshilli i Lartë i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim përbëhet nga:

a) zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;

b) drejtori i Departamentit të Varësisë Lëndore;

c) drejtori i strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore;

ç) rektori i Akademisë së Sigurisë;

d) drejtori Juridik i Policisë së Shtetit.

2. Këshilli i Lartë i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim ka të drejtë t'i propozojë drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për emërimin në detyrë të punonjësit të policisë me gradë "Komisar" deri "Drejtues i Parë".

Neni 179/5

Përbërja dhe funksionimi i Këshillit Vendor të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

1. Këshilli Vendor i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim përbëhet nga:

a) zëvendësdrejtori i Policisë së Qarkut/ zëvendëskomandanti i repartit/zëvendësshefi i institucionit;

b) shefi i sektorit ku punonjësi ka varësinë sektoriale;

c) shefi i sektorit ku punonjësi kalon në varësi të tij;

ç) shefi i sektorit/seksionit përgjegjës për burimet njerëzore;

d) juristi i drejtorisë vendore.

2. Kur punonjësi lëviz dhe emërohet në detyrë brenda të njëjtit sektor, merr pjesë vetëm shefi që e ka në varësi sektoriale.

3. Këshilli Vendor i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim ka të drejtë t'i propozojë titullarit të strukturës vendore/autonome për emërim në detyrë të punonjësit të policisë me gradë "Inspektor" deri në "Nënkomisar".

Neni 179/6

Vendimmarrja në Këshillin e Vlerësimit të Propozimeve për Emërim

1. Vendimet në Këshillin e Vlerësimit të Propozimeve për Emërim merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, ku duhet të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e tyre.

2. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, propozohet kandidati për të cilin ka votuar kryesuesi i Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

3. Nuk mund të marrin pjesë në Këshillin e Vlerësimit të Propozimeve për Emërim punonjësit

e policisë që diskutohen vetë për t'u emëruar në detyrë.

4. Këshilli i Vlerësimit të Propozimeve për emërime, si rregull, mblidhet sa herë që krijohen vende organike të lira dhe në çdo kohë për raste të jashtëzakonshme.

5. Dokumentet përkatëse, si dosje personale, vlerësimet e punës, propozimet e bëra, vendimet e komisioneve të gradimit e të dhëna të tjera, Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim i paraqiten nga drejtoria/sektori përkatës përgjegjës për burimet njerëzore, e/i cila/cili ruan edhe procesverbalet e takimeve dhe të vendimmarrjes së Këshillit të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

6. Këshilli i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim shqyrton dhe i propozon autoritetit që ka në kompetencë emërimin e punonjësve të policisë, të paktën, dy kandidatura, sa herë kjo është e mundur dhe, nëse janë më shumë se dy kandidatura apo alternativa, i propozon ato në bazë të një renditjeje.

Neni 179/7
Akti i emërimit në detyrë

1. Akti që përpilon Këshilli i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim emërtohet "Propozim".

2. Akti që përpilon struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe që miratohet nga titullari i organit/repartit emërtohet "urdhër".

3. Struktura që bën emërimin në detyrë të punonjësit në aktin e emërimit përshkruan bazën ligjore, propozimin e Këshillit i Vlerësimit të Propozimeve për Emërim në rastin e emërimeve, gradën, emër, atësi, mbiemër, funksionin (detyrën) që kryen ose që do të kryejë punonjësi, motivacionin, pagën, datën e ndryshimit të marrëdhënieve financiare, datën e hyrjes në fuqi të urdhrit, si dhe nënshkrimin e titullarit.

4. Akti i emërimit në detyrë i komunikohet punonjësit nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, jo më vonë se 48 orë nga koha e protokollimit në sekretari.

5. Punonjësi i policisë me marrjen e njoftimit bën dorëzimin e detyrës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 68

Pika 3, e nenit 186 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Stimujt mund të jepen edhe për punonjës të agjencive të zbatimit të ligjit të vendeve partnere, organizmave apo organizatave ndërkombëtare, kur ata japin kontribut të rëndësishëm në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.".

Neni 69

Pas pikës 3, të nenit 189, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

"4. Për stimujt që jepen për punonjës të agjencive të zbatimit të ligjit të vendeve partnere, organizmave apo organizatave ndërkombëtare, propozimi bëhet nga drejtuesit e strukturave të Policisë së Shtetit që kanë përfituar nga bashkëpunimi.".

Neni 70

Pas pikës 4.1, të nenit 193, shtohet pika 4.1.1, me këtë përmbajtje:

"4.1.1 Strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit depozitojnë në dosjen e personelit të punonjësve të policisë edhe certifikatën e sigurisë së personelit ose kopje të njësuar me origjinalin, për funksionet organike, që, për shkak të detyrës, njihen me informacionin e klasifikuar.".

Neni 71

Në pikën 3, të nenit 194, pas nënndarjes "Regjistri i punonjësve civilë në Policinë e Shtetit", shtohen nënndarjet, me këtë përmbajtje:

"- Regjistri i lejeve për punësimin në veprimtari të dyta;

- Regjistri i evidentimit të stimujve dhe shpërblimeve;

- Regjistri i evidentimit të punonjësve të policisë, subjekt të vlerësimit kalimtar.".

Neni 72

Në nenin 198 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Sillet dhe komunikon në mënyrë joetike, si gjatë kryerjes së detyrës, ashtu edhe jashtë saj.".

2. Pika 2 hiqet.

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

"5/1. Gjatë detyrës/shërbimit përdor telefonin dhe rrjetet sociale për arsye që nuk lidhen me objektin e punës.".

4. Pas pikës 12 shtohet pika 13, me këtë përmbajtje:

"13. Ndikon te perceptimi i publikut kur paraqet në rrjetet sociale, pa miratim, materiale të Policisë së Shtetit, të tilla si: dokumente, fotografi, regjistrime audio, video apo në çdolloj forme tjetër, të cilat i disponon/akseson, për shkak të detyrës ose materiale me përmbajtje denigruese, diskredituese, diskriminuese, fyese, politike ose fetare.".

Neni 73

Pas pikës 2 të nenit 199, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Nuk informon në kohë eprorin në lidhje me detyrën e dhënë dhe problematikat e ndodhura gjatë dinamikës në punë.".

Neni 74

Pas pikës 10 të nenit 200, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

"11. Nga pakujdesia, nuk përmbush apo nuk zbaton detyrat në përputhje me parimet, procedurat dhe rregullat mbi bazën e të cilave funksionon Policia e Shtetit, por që nuk kanë cenuar kryerjen e detyrave dhe nuk kanë sjellë pasoja të rënda.".

Neni 75

Pika 28, e nenit 205, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"28. Sillet dhe komunikon në mënyrë jo etike, duke përdorur fjalë apo shprehje të rënda fyese, përbuzëse apo kërcënuese, si gjatë kryerjes së detyrës edhe jashtë saj, ndaj kolegëve apo ndaj qytetarëve.".

Neni 76

Neni 213 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 213

Punonjësi është përgjegjës për përdorim të lëndëve narkotike, nëse:

1. Mban lëndë narkotike në mënyrë të jashtëligjshme;

2. Përdor lëndë narkotike;

3. Refuzon t'i nënshtrohet testit të përdorimit të lëndëve narkotike;

4. Nuk informon në kohë për kultivimin e lëndëve narkotike.".

Neni 77

Neni 215 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 215
Veprimet diskriminuese

Punonjësi i policisë është përgjegjës për veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, racës, kombësisë, gjuhës, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar fizike apo mendore, bindjes politike, përkatësisë etnike dhe fetare, ose sociale.".

Neni 78

Në nenin 240 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka të drejtë të japë masën disiplinore:

a) "Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet", për drejtorët e departamenteve, drejtorët qendrorë dhe drejtorët vendorë të policisë, shefat e komisariateve në drejtoritë vendore të policisë.

b) Procedura e ankimit kundër këtij vendimi bëhet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 95, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar.".

2. Në shkronjën "a", të pikës 2, fjalët "Ulje me një gradë për një periudhë deri në 6 muaj" hiqen.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Drejtuesit e departamenteve, drejtuesit e drejtorive qendrore në drejtoritë e përgjithshme të policisë së shtetit, në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtuesi i Akademisë së Sigurisë kanë të drejtë të propozojnë masat disiplinore "vërejtje" dhe "vërejtje me paralajmërim" tek eprori që ka të drejtën e dhënies së masës disiplinore për

punonjësit e policisë dhe punonjësit administrativë që kanë në varësi administrative dhe lëndore.".

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Drejtuesit e drejtorive vendore, drejtorive të kufirit dhe migracionit, shefat e komisariateve të policisë, titullarët e strukturave të forcave speciale e ndërhyrjes së shpejtë dhe strukturave të veçanta kanë të drejtë të japin masat disiplinore "vërejtje" dhe "vërejtje me paralajmërim" për punonjësit e policisë dhe punonjësit administrativë që kanë në varësi administrative dhe lëndore.".

Neni 79

Në nenin 241 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, në fund të fjalisë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Raporti përfundimtar i strukturës përgjegjëse për vlerësimin e performancës, për dhënien e masës disiplinore, dërgohet për zbatim në strukturat e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 240.".

2. Në pikën 3, të këtij neni, në fund të fjalisë shtohen fjalët "... për përfundimin e hetimit disiplinor".

Neni 80

Pas pikës 1, të nenit 242, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Kur punonjësi i policisë është me raport mjekësor, me pushime jashtë shtetit ose me pushime vjetore, komunikimi bëhet brenda 3 (tri) ditëve pune nga dita e paraqitjes në detyrë të punonjësit. Për oficerët e kontaktit dhe ata të dërguar me shërbim jashtë shtetit, komunikimi bëhet në rrugë elektronike *(email)*.".

Neni 81

Në nenin 246 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Në rastet kur zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep vetë masë disiplinore, Komisioni Qendror i Apelimit shqyrton ankesën pa prezencën e tij dhe e relaton pranë drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për vendim.

Në këtë rast, Komisioni Qendror i Apelimit drejtohet nga anëtari me gradë më të lartë e vjetërsi shërbimi më të gjatë.".

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"6/1. Komisioni i Apelimit, në përfundim të shqyrtimit të ankesës së punonjësit të policisë, vendos për lënien në fuqi të masës disiplinore të dhënë nga titullari ose ndryshimin e saj.".

Neni 82

Pas pikës 9, të nenit 247, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1. Kur punonjësi i policisë ndodhet me raport mjekësor, me pushime jashtë shtetit ose me pushime vjetore, komunikimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes në detyrë të punonjësit.".

Neni 83

Pika 3, e nenit 249, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Dokumentacioni që ka lidhje me ankimimet e masave të lehta, që shqyrtohen në Komisionet që ngrihen në përbërje të departamenteve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Komisionet Vendore të Apelimit, administrohen nga këto komisione dhe në përfundim të shqyrtimit, dërgohen në strukturën përgjegjëse për vlerësimin e performancës".

Neni 84

Pika 1, e nenit 253, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:

a) 6 muaj nga njoftimi i masës "vërejtje" dhe "vërejtje me paralajmërim;";

b) një vit nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa disiplinore "shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet" ose "Ulje në gradë për një periudhe deri në 6 muaj.".

Neni 85

Kudo në këtë rregullore:

a) emërtesa "Ministria e Punëve të Brendshme" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike";

b) emërtesa "Ministri i Punëve të Brendshme" zëvendësohet me fjalët "ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike";

c) emërtesa "Drejtor i Policisë së Shtetit" zëvendësohet me "Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit";

ç) emërtesa "Zëvendësdrejtor i Policisë së Shtetit" zëvendësohet me "Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit";

d) fjalët "Drejtori e Përgjithshme" zëvendësohen me fjalën "Departament";

dh) emërtesa "Drejtoria e Policisë së Shtetit" zëvendësohet me "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit";

e) emërtesa "drejtorët e përgjithshëm të policisë" zëvendësohen me "drejtorët e departamenteve të Policisë së Shtetit";

ë) emërtesa "Drejtoritë e Përgjithshme në Drejtorinë e Policisë së Shtetit" zëvendësohet me "Departamentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit";

f) emërtesa "Komision gradimi" zëvendësohet me "Komision vlerësimi";

g) emërtesa "shkolla bazë në Akademinë e Sigurisë" zëvendësohet me "Kolegji Profesional i Lartë "Kolegji i Policisë";

gj) emërtesa "Vendore/Rajonale" zëvendësohet me "Vendore";

h) emërtesa "specialistëve të policisë së zonave" zëvendësohet me "Ndihmësspecialistëve të Policimit në Komunitet/SPZ";

j) emërtesa "struktura për burimet njerëzore" zëvendësohet me "njësia e burimeve njerëzore".

Neni 86

Lidhjet në këtë rregullore ndryshohen, si më poshtë vijon:

1. Lidhja nr. 1 hiqet.

2. Në lidhjen nr. 2, fjalët "Modeli i regjistrit" hiqen.

3. Në lidhjen nr. 5, fjalët "... në "Akademinë e Sigurisë ..." hiqen.

II. Ngarkohet ministri i Brendshëm për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 18
Stema e Policisë së Shtetit

VENDIM
Nr. 1147, datë 9.12.2020

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE "PORTALI UNIK QEVERITAR *E-ALBANIA*" DHE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE "PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË PIKËS SË VETME TË KONTAKTIT"[138]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", dhe të neneve 10, pika 3, 11 e 12, të ligjit nr. 66/2016, "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim përcakton krijimin e bazës të të dhënave shtetërore "Portali unik qeveritar *e-Albania*" (në vijim "*e-Albania*") dhe miratimin e rregullave "Për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit".

Neni 2
Qëllimi

Në zbatim të ligjit nr. 66/2016, "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë", ky vendim ka për qëllim të përcaktojë:

a) portalin *e-Albania* si pikën e vetme të kontaktit, i cili mundëson aksesin për aplikim në shërbimet elektronike *online* të ofruara nga administrata publike, duke i grupuar sipas kategorive te ndryshme;

b) kërkesat e nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore të pikës së vetme të kontaktit për shërbime elektronike në Republikën e Shqipërisë (në vijim "PVK") si porta e vetme digjitale për t'u lehtësuar ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve aksesin në informacion, procedura elektronike dhe asistencë efektive në përfitimin e shërbimeve;

c) përgjegjësinë e organeve kompetente për PVK-në dhe të institucioneve ofruese të shërbimeve publike nëpërmjet PVK-së.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritetet përgjegjëse", autoritetet kombëtare me përgjegjësi të caktuara lidhur me informacionin, procedurat, asistencën që mbulon ky vendim;

2. "Kodi unik i përdoruesit", kodi i gjeneruar automatikisht nga *e-Albania*, pas regjistrimit të një përdoruesi;

3. "Kodi i shërbimit elektronik", numri unik identifikues i çdo shërbimi të implementuar në platformën qeveritare *e-Albania*;

4. "Përdorues", një shtetas shqiptar ose i huaj, një person fizik apo juridik që akseson informacionin, procedurat apo asistencën në dispozicion nëpërmjet portalit;

5. "Procedurë", një sërë veprimesh që duhen ndërmarrë nga përdoruesit për të përfituar shërbimet publike;

6. *"Single Sign-On"*, skema unike e identifikimit të përdoruesve, duke përdorur një ID dhe fjalëkalim të vetëm në platforma dhe sisteme të ndryshme të e-Qeverisjes, për garantimin e besueshmërisë dhe të sigurisë në ofrimin e shërbimeve elektronike;

7. Shërbimet elektronike kategorizohen sipas 4 niveleve të zhvillimit të tyre, si më poshtë vijon:

i. Niveli 1 nënkupton komunikimin e njëanshëm ndërmjet institucionit publik dhe përdoruesit, nëpërmjet ofrimit vetëm të informacionit për përfitimin e shërbimit publik;

ii. Niveli 2 nënkupton që, krahas informacionit për përfitimin e shërbimit publik, përdoruesit i shfaqet edhe mundësia e shkarkimit të formularit të aplikimit, të cilin e plotëson dhe e dorëzon fizikisht

[138] Ky projektvendim është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2018/1724 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 2.10.2018, "Mbi një portë të vetme digjitale për ofrimin e aksesit në informacion, procedura, asistencë dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave dhe që ndryshon Rregulloren (BE) 1024/2012", numri CELEX 32018R1724, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 295, datë 21.11.2018, faqe 1–38.

në institucionin përkatës. Komunikimi ndërmjet institucionit publik dhe përdoruesit është i njëanshëm;

iii. Niveli 3 nënkupton ndërveprimin e dyanshëm ndërmjet institucionit publik dhe përdoruesit, duke i mundësuar këtij të fundit plotësimin dhe dërgimin elektronikisht të aplikimit;

iv. Niveli 4 nënkupton ndërveprimin e dyanshëm të plotë ndërmjet institucionit publik e përdoruesit, duke i mundësuar këtij të fundit plotësimin dhe dërgimin elektronikisht të aplikimit, si dhe marrjen e përgjigjes elektronikisht nga institucioni. duke përfunduar të gjithë procedurën e shërbimit publik tërësisht *online*.

8. "Të dhëna shoqëruese", çdo dokument apo të dhënë që përfshin format tekst, zë, imazh apo regjistrim audiovizual, pavarësisht formatit të përdorur, që nevojiten nga autoritetet përgjegjëse për të vërtetuar faktet apo plotësimin e kritereve të përfitimit të shërbimeve publike, sipas përcaktimit të shkronjës "b", të pikës 7, të nenit 6, të këtij vendimi.

Neni 4
Të dhëna parësore

Të dhëna parësore janë të dhënat e mëposhtme:

a) kodi unik i përdoruesit;

b) kodi i shërbimit elektronik.

Neni 5
Të dhëna dytësore

Të dhëna dytësore janë të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore, dhe me të cilat ndërvepron e janë, si më poshtë vijon:

a) të dhënat e individit nga baza e të dhënave shtetërore "Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile", të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) të dhënat nga regjistri i personit fizik/tregtar apo juridik nga baza e të dhënave shtetërore "Regjistri Tregtar", të administruara nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

c) të dhënat nga baza e të dhënave shtetërore "Tatimi Elektronik", të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për subjektet e regjistruara pranë saj;

ç) çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me portalin *e-Albania* dhe të jetë e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Neni 6
Përcaktime të portalit *e-Albania* dhe të pikës së vetme të kontaktit

1. Pika e vetme e kontaktit (PVK) është portali *e-Albania*, që zhvillohet, administrohet e mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

2. Në portalin *e-Albania* regjistrohen shtetasit shqiptarë dhe të huaj, personat fizikë, juridikë, të cilët janë të pajisur me NID apo NUIS.

3. Procesi i regjistrimit dhe i identifikimit bazohet në strategjinë *Single-Sign-On*, për krijimin e një identiteti unik për çdo përdorues. Regjistrimi dhe identifikimi realizohet nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore dhe koordinohet, zhvillohet e administrohet nga Autoriteti Rregullator Koordinues (në vijim, ARK) i bazave të të dhënave shtetërore.

4. Të dhënat e plotësuara nga përdoruesit gjatë procesit të regjistrimit verifikohen elektronikisht me të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile për individët, të Regjistrit Tregtar dhe të Tatimit Elektronik.

5. PVK-ja integrohet në të gjitha web-faqet zyrtare të institucioneve të administratës publike dhe të atyre ofruese të shërbimeve në portal.

6. Dhënës të informacionit për PVK-në janë përdoruesit dhe ofruesit e shërbimeve, sipas përcaktimit të këtij vendimi.

7. PVK-ja jep akses për:

a) informacionin e nevojshëm mbi të drejtat, detyrimet dhe rregullat e përfitimit të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë;

b) informacionin lidhur me procedurat *online* dhe *off-line* për përfitimin e shërbimeve publike, për t'u mundësuar përdoruesve të ushtrojnë të drejtat, si dhe të përmbushin detyrimet e rregullat e përfitimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë;

c) informacionin dhe *link*-et përkatëse për asistencë në përfitimin e shërbimeve, ku qytetarët, shoqëritë tregtare dhe punonjësit e administratës mund të drejtohen në rast pyetjesh apo paqartësish për detyrimet, rregullat e procedurat e cilësuara në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike.

8. Ndërfaqja e saj ofrohet, të paktën, në gjuhën shqipe dhe në atë angleze, sipas shërbimeve specifike.

KREU II
PIKA E VETME E KONTAKTIT

Neni 7
Aksesi dhe përditësimi i informacionit

1. PVK-ja duhet t'u ofrojë përdoruesve akses sa më të lehtë *online* në informacionin e përcaktuar në pikën 7, të nenit 6, të këtij vendimi.

2. Të gjitha institucionet publike janë të detyruara që shërbimet e tyre *online* t'i ofrojnë përmes PVK-së, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 7, të nenit 3, të këtij vendimi.

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 6, të këtij vendimi, sigurohen që lidhja me PVK-në të vendoset në një vend të dukshëm në *web*-faqe dhe lehtësisht e aksesueshme nga vizitorët.

4. Institucionet ofruese të shërbimeve në PVK janë të detyruara që, sa herë të ketë ndryshime ligjore dhe procedurale, mbi bazën e të cilave ofrohet shërbimi publik i kërkuar, të dërgojnë ndryshimet e përditësimet përkatëse në informacionin dhe formularin elektronik të publikuar.

5. Për përditësimin e shërbimeve elektronike, institucioni ofrues i shërbimit i përcjell AKSHI-t kërkesën për ndryshimet përkatëse brenda 3 (tri) ditëve pune nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore apo procedurale.

Neni 8
Procedurat e ofruara tërësisht *online*

1. Institucionet përgjegjëse dhe AKSHI garantojnë që të aksesohen e të përfundohen tërësisht *online* sa më shumë shërbime publike.

2. AKSHI është përgjegjës që, brenda datës 31.12.2021, të implementojë postën elektronike unike për çdo shtetas të huaj ose shqiptar, nëpërmjet numrit personal (NID) dhe çdo person fizik e juridik nëpërmjet numrit unik të identifikimit të subjektit (NUIS).

3. Posta elektronike unike do të shërbejë si e vetmja mënyrë kontakti në llogarinë e çdo qytetari dhe shoqërie tregtare në *e-Albania*.

4. Procedurat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, do të konsiderohen tërësisht *online*, kur:

a) identifikimi i përdoruesve, dorëzimi i të dhënave shoqëruese, nënshkrimi dhe dorëzimi i aplikimit mund të kryhen elektronikisht nga distanca, përmes një kanali shërbimi, që u mundëson përdoruesve të përmbushin kërkesat e procedurës në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë në përdorim;

b) përdoruesve u jepet një konfirmim automatik (përmes një numri unik aplikimi), përveç rasteve kur shërbimi ofrohet në mënyrë të menjëhershme;

c) përgjigjja ose dokumenti përfundimtar i përfitimit të shërbimit dorëzohet elektronikisht ose, nëse aktet ligjore përkatëse e përcaktojnë ndryshe, përmes mjeteve fizike;

ç) përdoruesit njoftohen elektronikisht për përfundimin e procedurës.

5. Në rastet e veçanta, kur, për arsye të interesit publik në fushat e sigurisë publike, të shëndetit publik apo të luftës kundër mashtrimit, shërbimi nuk mund të kryhet tërësisht *online*, institucionet ofruese të shërbimit mund t'i kërkojnë aplikantit të paraqitet fizikisht, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Institucionet ofruese të shërbimeve duhet ta kufizojnë paraqitjen fizike të aplikantit vetëm, në rastet kur është rreptësisht e nevojshme dhe e justifikueshme, si dhe të sigurojnë që hapat e tjerë të procedurës të kryhen tërësisht *online*.

Neni 9
Lehtësimi i ofrimit të shërbimit nga administrata publike

1. AKSHI, me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimit elektronik nga administrata publike, është përgjegjës për ngritjen e sistemit "Moduli për administratën publike".

2. Moduli për administratën publike do të jetë pika e vetme nga e cila punonjësit e administratës publike gëzojnë të drejtën që, me pëlqimin e shtetasit, të përdorin shërbimet e ofruara në PVK.

Neni 10
Aksesi në asistencë dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave

AKSHI duhet të sigurohet që përdoruesit të aksesojnë lehtësisht *online* kanalet e ndryshme nga ku ofrohet asistencë dhe zgjidhje e problematikave

të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 7, të nenit 6, të këtij vendimi.

KREU III
KËRKESAT E CILËSISË

SEKSIONI 1
KËRKESAT E CILËSISË LIDHUR ME INFORMACIONIN PËR TË DREJTAT, DETYRIMET E RREGULLAT PËR PROCEDURAT, ASISTENCËN DHE SHËRBIMET E ZGJIDHJES SË PROBLEMATIKAVE

Neni 11
Cilësia e informacionit për të drejtat, detyrimet dhe rregullat

1. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve duhet të sigurojnë që, në përputhje me nenin 7, të këtij vendimi, informacioni i paraqitur në PVK, sipas shkronjës "a", të pikës 7, të nenit 6, të këtij vendimi, të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë lehtësisht i përdorshëm, t'u mundësojë përdoruesve ta gjejnë e ta kuptojnë lehtësisht informacionin, si dhe të identifikojnë lehtësisht se cilat pjesë të tij lidhen me situatën e tyre konkrete;

b) të jetë i saktë dhe mjaftueshëm i plotë për të përfshirë gjithë informacionin që përdoruesit duhet të dinë, në mënyrë që të ushtrojnë të drejtat e tyre, në përputhje të plotë me rregullat e detyrimet në fuqi;

c) të përfshijë referenca, lidhje me akte ligjore, specifikime teknike dhe udhëzime, kur është e nevojshme;

ç) të përfshijë emrin e autoritetit ose të entitetit përgjegjës për përmbajtjen e informacionit;

d) të përfshijë detajet e kontaktit për çdo asistencë ose shërbime të zgjidhjes së problematikave, të tilla si një adresë *email*-i, numër telefoni, një formular kërkese në internet ose ndonjë mjet tjetër komunikimi elektronik të përdorur zakonisht, që është më i përshtatshmi për llojin e shërbimit të ofruar dhe për audiencën e synuar të këtij shërbimi;

dh) të përfshijë datën e përditësimit të fundit të informacionit, nëse ka, ose, kur informacioni nuk është përditësuar, datën e publikimit të tij;

e) të jetë i strukturuar dhe i paraqitur mirë, në mënyrë që përdoruesit të gjejnë shpejt informacionin e nevojshëm;

ë) të mbahet i përditësuar; dhe

f) të jetë shkruar në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, të përshtatur me nevojat e përdoruesve të synuar.

2. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve ofrojnë informacionin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, në gjuhën shqipe dhe, të paktën, në atë angleze, për shërbimet specifike, në mënyrë që të kuptohet gjerësisht nga një numër sa më i madh përdoruesish të huaj, në përputhje me nenin 14, të këtij vendimi.

Neni 12
Cilësia e informacionit për procedurat

1. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve sigurohen që, në përputhje me nenin 7, të këtij vendimi, përpara se përdoruesit të identifikohen dhe të fillojnë procedurën e aplikimit apo të marrjes së shërbimit, të kenë akses në një informacion gjithëpërfshirës, të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm të elementeve të mëposhtme, kur është e aplikueshme, të procedurave të përmendura në shkronjën "b", të pikës 7, të nenit 6, të këtij vendimi:

a) hapat përkatës të procedurës që duhet të ndërmarrë përdoruesi, përfshirë çdo përjashtim sipas pikës 5, të nenit 8, të këtij vendimi, për përfitimin e shërbimit elektronik;

b) emrin e autoritetit përgjegjës për procedurën, përfshirë detajet e kontaktit të tij;

c) format e pranuara të identifikimit dhe të nënshkrimit për procedurën;

ç) llojin e formatin e të dhënave shoqëruese që duhet të dorëzohen;

d) mjetet e ankesës që janë të disponueshme në rast të mosmarrëveshjes me autoritetet kompetente;

dh) tarifat e aplikueshme dhe metodat e pagesës *online*;

e) afatet që duhet të respektohen nga përdoruesi ose nga autoriteti përgjegjës dhe kur nuk ekzistojnë afate, koha mesatare, e vlerësuar ose e dëshmuar nga praktika që i nevojitet autoritetit përgjegjës për të përfunduar procedurën;

ë) çdo rregull që ka të bëjë me mungesën e përgjigjes nga autoriteti përgjegjës dhe pasojat

ligjore të tyre për përdoruesit, përfshirë miratimin në heshtje ose marrëveshjet administrative në heshtje, nëse aplikohen sipas legjislacionit përkatës;

f) çdo gjuhë tjetër të nevojshme, në të cilën mund të kryhet procedura;

g) bazën ligjore për ofrimin e shërbimit.

2. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve ofrojnë informacionin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, në gjuhën shqipe dhe, të paktën, në atë angleze, sipas shërbimeve specifike, në mënyrë që të kuptohet gjerësisht nga një numër sa më i madh përdoruesish të huaj, në përputhje me nenin 14, të këtij vendimi.

Neni 13
Cilësia e informacionit për asistencën dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave

1. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve, në zbatim të nenit 7, të këtij vendimi, sigurohen që, përpara se të aplikojë për një shërbim të caktuar, sipas përcaktimit të shkronjës "c", të pikës 7, të nenit 6, të këtij vendimi, përdoruesi të ketë lehtësisht akses në një shpjegim të qartë, të sa më poshtë:

a) llojit, qëllimit dhe rezultateve të pritura të shërbimit të ofruar;

b) detajet e kontaktit të autoriteteve përgjegjëse për shërbimin, të tilla si: numër telefoni, adresë *email*-i, formular kërkese *online* ose ndonjë mjet tjetër të komunikimit elektronik të përdorur zakonisht, që është më i përshtatshmi për llojin e shërbimit të ofruar dhe për audiencën e synuar të këtij shërbimi;

c) tarifat përkatëse dhe mënyrat e pagesës *online*, nëse aplikohen;

ç) çdo afat të zbatueshëm që duhet të respektohet edhe kur nuk zbatohen afate, një kohë mesatare ose të vlerësuar që nevojitet për ofrimin e shërbimit;

d) çdo gjuhë tjetër të nevojshme, në të cilën mund të paraqitet aplikimi dhe që mund të përdoret gjatë kontaktit me autoritetin.

2. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve ofrojnë informacionin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, në gjuhën shqipe dhe, të paktën, në atë angleze, sipas shërbimeve specifike, në mënyrë që të kuptohet gjerësisht nga një numër sa më i madh përdoruesish të huaj, në përputhje me nenin 14, të këtij vendimi.

Neni 14
Përkthimi i informacionit

1. Institucionet ofruese të shërbimeve janë përgjegjëse për përkthimin e informacionit të përmendur në nenet 11, 12, 13 e 15, pika 2, shkronja "a", të këtij vendimi.

2. Institucionet ofruese të shërbimeve duhet të sigurohen që tekstet e përkthyera sipas pikës 1, të këtij neni, të mbulojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për përfitimin e shërbimit.

SEKSIONI 2
KËRKESAT LIDHUR ME PROCEDURAT *ONLINE*

Neni 15
Aksesi i të huajve në procedurat *online*

1. AKSHI duhet të sigurojë që, kur një shërbim publik, i përmendur në shkronjën "b", të pikës 7, të nenit 6, të këtij vendimi, mund të aksesohet dhe të kryhet *online* nga shtetasit shqiptarë dhe të ofrohet njëkohësisht edhe për shtetasin e huaj, ai mund të aksesohet e të kryhet po ashtu *online* nga përdoruesit e huaj në një mënyrë jodiskriminuese, me të njëjtën zgjidhje teknike ose me një zgjidhje alternative.

2. AKSHI siguron që, për procedurat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, të plotësohen të paktën kërkesat, si më poshtë vijon:

a) përdoruesit të jenë në gjendje të aksesojnë udhëzimet për përfundimin e procedurës në gjuhën shqipe dhe të paktën në atë angleze, në përputhje me nenin 14, të këtij vendimi;

b) përdoruesit e huaj të jenë në gjendje të identifikojnë vetveten, të nënshkruajnë dokumente elektronikisht, sipas ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 69, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara'", në të gjitha rastet kur kjo gjë është e mundur për ta;

c) Përdoruesit e huaj janë në gjendje të vërtetojnë se përmbushin kriteret e përfitimit të shërbimit dhe të marrin përgjigjen në format elektronik, në të gjitha rastet kur kjo është e mundur edhe për ta;

ç) Kur, për përfundimin e një procedure nevojitet kryerja e një pagese, përdoruesit duhet të

jenë në gjendje të paguajnë çdo tarifë *online*, përmes shërbimeve universale të pagesave *online*.

3. Kur procedura nuk kërkon identifikim ose autentifikim elektronik, siç përmendet në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, dhe kur autoriteteve përgjegjëse u lejohet, sipas ligjit kombëtar ose praktikave administrative, të pranojnë kopje të skanuara të dokumenteve joelektronike të identitetit, siç janë kartat e identitetit ose pasaportat, në lidhje me përdoruesit e huaj, këto autoritete duhet të pranojnë kopje të skanuara prej tyre.

SEKSIONI 3
KËRKESAT E CILËSISË LIDHUR ME NDIHMËN DHE SHËRBIMET E ZGJIDHJES SË PROBLEMATIKAVE

Neni 16
Kërkesat e cilësisë lidhur me ndihmën dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave

AKSHI dhe autoritetet përgjegjëse, brenda kompetencave të tyre përkatëse, sigurojnë që asistenca dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave, që ndeshen nga përdoruesit gjatë përdorimit të portalit, përputhen me kërkesat e mëposhtme të cilësisë:

a) ofrohen brenda një afati kohor të arsyeshëm, duke marrë parasysh kompleksitetin e kërkesës;

b) në rastet e zgjatjes së afateve, përdoruesit informohen paraprakisht për arsyet dhe për afatin e ri, brenda kuadrit ligjor rregullator përkatës të autoritetit përgjegjës;

c) kur ofrimi i një shërbimi përfshin pagesë, përdoruesit paguajnë tarifën përkatëse *online* pranë autoritetit përgjegjës që ofron shërbimin përmes shërbimeve universale të pagesave *online*.

KREU IV
ZGJIDHJET TEKNIKE

Neni 17
Ndërfaqja e përdoruesit

1. Ndërfaqja e përdoruesit siguron akses në informacionin, procedurat e shërbimeve dhe asistencën ose shërbimet e zgjidhjes së problematikave me anë të lidhjeve përkatëse.

2. AKSHI siguron që informacioni për rregullat dhe detyrimet, për procedurat, për asistencën dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave është i organizuar dhe i evidentuar në një mënyrë të tillë që e bën më të lehtë gjetjen e tij përmes ndërfaqes së përdoruesit.

3. AKSHI siguron që ndërfaqja plotëson kërkesat e mëposhtme të cilësisë:

a) përdoret lehtësisht;

b) aksesohet nëpërmjet pajisjeve të ndryshme elektronike;

c) është zhvilluar dhe optimizuar për shfletues të ndryshëm *web*-i;

ç) plotëson kërkesat e mëposhtme të aksesueshmërisë *web*: perceptueshmëria, operueshmëria, kuptueshmëria dhe qëndrueshmëria.

4. Institucionet sigurojnë që lidhja e *web*-faqeve zyrtare të institucionit me PVK-në është e saktë dhe funksionale.

Neni 18
Përgjegjësitë për aplikacionet TIK që mbështesin PVK-në

1. AKSHI është përgjegjës për zhvillimin, disponueshmërinë, monitorimin, përditësimin teknik, mirëmbajtjen, sigurinë dhe hostimin e:

a) ndërfaqes së PVK-së;

b) platformës qeveritare të ndërveprimit;

c) shërbimeve elektronike;

ç) shërbimeve të asistencës dhe të zgjidhjes së problematikave;

d) mjeteve në dispozicion të përdoruesve për dhënien e përshtypjeve të tyre për PVK-në;

e) postës elektronike unike të qytetarit dhe të shoqërisë tregtare.

2. AKSHI duhet të bashkëpunojë ngushtë me institucionet ofruese të shërbimeve publike për të përditësuar e zgjeruar përmbajtjen e PVK-së.

KREU V
PROMOVIMI

Neni 19
Emri dhe logoja

Emri me të cilin PVK-ja do t'i prezantohet publikut është "*e-Albania*". Logoja e saj përcaktohet nga AKSHI dhe vendoset në të gjitha *web*-faqet e institucioneve publike dhe të atyre ofruese të shërbimeve.

Neni 20
Promovimi

1. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve duhet të promovojnë PVK-në për të ndërgjegjësuar qytetarët dhe shoqëritë tregtare për informacionin, procedurat, asistencën dhe shërbimet e zgjidhjes së problematikave që ajo ofron. AKSHI sigurohet që elementet e mësipërme të gjenden lehtësisht nëpërmjet motorëve të kërkimit që aksesohen shpesh nga publiku.

2. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve koordinojnë aktivitete promovuese të përbashkëta që lidhen me PVK-në dhe përdorimin e saj.

3. Institucionet ofruese të shërbimeve duhet të sigurohen që *link*-u i PVK-së të gjendet lehtësisht në *web*-faqet e tyre.

KREU VI
MBLEDHJA E PËRSHTYPJEVE TË PËRDORUESVE DHE E STATISTIKAVE

Neni 21
Statistikat e përdoruesve

1. AKSHI mbledh dhe publikon të dhëna agregate të përdorimit të PVK-së në mënyrë periodike, duke siguruar anonimitetin e përdoruesve.

2. AKSHI dhe institucionet ofruese të shërbimeve shkëmbejnë ndërmjet tyre të dhëna statistikore për të analizuar performancën e shërbimeve dhe për të kryer përmirësimet e nevojshme.

Neni 22
Përshtypjet e përdoruesve

1. Me qëllim mbledhjen e informacionit për përshtypjet dhe nivelin e kënaqësisë drejtpërdrejt nga përdoruesit, AKSHI u vendos atyre në dispozicion mjete elektronike lehtësisht të përdorshme menjëherë pas përdorimit të një shërbimi elektronik.

2. Të dhënat e mbledhura për përshtypjet dhe nivelin e kënaqësisë së përdoruesve analizohen periodikisht nga AKSHI, në bashkëpunim me institucionet ofruese të shërbimeve elektronike, me qëllim përmirësimin e tyre.

KREU VII
ADMINISTRIMI I PVK-së

Neni 23
Koordinatorët institucionalë

1. Secili prej institucioneve ofruese të shërbimeve cakton një koordinator institucional përgjegjës për ofrimin e shërbimit, i cili koordinon me AKSHI-n dhe, krahas detyrimeve të përmendura në nenet 10, 17, 20 e 22, të këtij vendimi:

a) shërben si pikë kontakti lidhur me shërbimet e institucionit;

b) siguron zbatimin e neneve 11 deri 22, të këtij vendimi, me institucionin përgjegjës.

2. Institucionet i komunikojnë AKSHI-t, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e hyrjes në fuqi, të këtij vendimi, emrin dhe të dhënat e kontaktit të koordinatorit institucional, si dhe çdo ndryshim të të dhënave në vijim brenda 3 (tre) ditëve pune nga data e ndodhjes së ndryshimeve.

Neni 24
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Subjekti përgjegjës për administrimin e regjistrit, në cilësinë e "kontrolluesit", sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, dokumenton masat tekniko-organizative të përshtatura e të zbatuara për garantimin e mbrojtjes të të dhënave personale.

2. Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale kryhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Neni 25
Dispozita të fundit

1. Vendimi nr. 734, datë 28.8.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e sistemit unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike", shfuqizohet.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe institucionet ofruese të shërbimeve publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR
Nr. 527, datë 30.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 24, DATË 30.1.2013, "PËR UNIFIKIMIN E PROCEDURAVE, METODAVE DHE DOKUMENTACIONIT TË FUNKSIONIMIT TË LABORATORËVE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 42, pika 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar; të ligjit nr. 105/2016, datë 27.10.2016, "Për mbrojtjen e bimëve"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 14.7.2010, "Për miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar", të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të urdhrit të ministrit nr. 4635, datë 16.10.2006, "Për miratimin e manualit "Për inspektimin fitosanitar në pikat e kalimit kufitar", të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të udhëzimit 107, "Në zbatim të ligjit nr. 8732, datë 24.1.2001, "Për materialin mbjellës bimor", me propozim të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit,

URDHËROJ:

1. Zëvendësimin e shtojcave IV dhe VIII në urdhrin nr. 24, datë 30.1.2013, "Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve", sipas shtojcave bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

Shtojca IV

Shtojca I
Raport prove për laboratorin mikrobiologjik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT
SEKTORI I SHERBIMEVE LABORATORIKE _____

*Adresa*_____ _____ *më,* _____

RAPORTI I PROVËS NR.
Numri Identifikues i Mostrës: Data e pranimit:

Subjekti që ka Kërkuar Provën/Adresa:
Kampionimi i kryer nga: Metoda e kampionimit:
Fleta Shoqërimit: Motivi i kampionimit:
Emërtimi i Produktit: Kushtet e Ruajtjes: ± C°
Vendi i kampionimit: Data e kampionimit:
Data e skadencës: Origjina e mostrës:
Njësi mostre:
Laboratori i Kryerjes se Provës:
Provat e Kërkuara:
Përshkrime te tjera:
**Të dhënat për identifikimin e kampionit rezultojnë në dokumentat shoqeruese, etikete ose në deklaratën e lëshuar nga subjekti.*
Data e Fillimit të Provës: Data e Mbarimit të Provës:

REZULTATI I PROVAVE

Kampioni Nr.	Prova / Treguesi	Metoda/Referenca	Njesia e matjes	Rezultatet

Shënime të laboratorit:

Analisti Laboratorike

Përgjegjës Sektori i Shërbimeve

Drejtori i Vlerësimit të Riskut

Ky Raport Prove i përket vetëm mostrës së analizuar dhe është pronë e AKU.
Laboratori nuk mban përgjegjësi për kampionimin.
Riprodhimi i mundshëm i tij duhet të kryhet vetëm me autorizimin e Laboratorit.

Raport prove për laboratorin iziko-kimik

Shtojca IV

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT
SEKTORI I SHERBIMEVE LABORATORIKE _____

*Adresa*_____ _____ *më,* _____

RAPORTI I PROVËS NR.

Numri Identifikues i Mostrës: **Data e praninit:**

Subjekti që ka Kërkuar Provën/Adresa:

Kampionimi i kryer nga: **Metoda e kampionimit:**

Fleta Shoqërimit: **Motivi i kampionimit:**

Emërtimi i Produktit: **Kushtet e Ruajtjes: ± C°**

Vendi i kampionimit: **Data e kampionimit:**

Data e skadencës: **Origjina e mostrës:**

Njësi mostre:

Laboratori i Kryerjes se Provës:

Provat e Kërkuara:

Përshkrime te tjera:

**Të dhënat për identifikimin e kampionit rezultojnë në dokumentat shoqeruese, etikete ose në deklaratën e lëshuar nga subjekti.*

Data e Fillimit të Provës: **Data e Mbarimit të Provës:**

REZULTATI I PROVAVE

TREGUESIT ORGANO – SHQISORE
Pamja:
Ngjyra:
Aroma:
Shija:

Kampioni Nr.	Prova / Treguesi	Metoda/Referenca	Njesia e matjes	Rezultatet

Shënime të laboratorit:

Analisti Laboratorike

Përgjegjës Sektori i Shërbimeve

Drejtori i Vlerësimit të Riskut

Ky Raport Prove i përket vetëm mostrës së analizuar dhe është pronë e AKU.
Laboratori nuk mban përgjegjësi për kampionimin.
Riprodhimi i mundshëm i tij duhet të kryhet vetëm me autorizimin e Laboratorit.

Shtojca IV

Raport prova për laboratorin e Shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT
SEKTORI I SHERBIMEVE LABORATORIKE _____

*Adresa*_____ _____ *më,*
_____

RAPORTI I PROVËS NR.
DIAGNOZË SHËNDETI I KAFSHËVE
Numri Identifikues i Mostrës: **Data e pranimit:**

Informacion nga fleta shoqërimit të kampionit

Subjekti qe ka Kerkuar Proven:	Kampionimi i kryer nga:	Motivi i kampionimit:
Enti / Personi fizik:	Fllete shoqerimi Nr.:	Metoda:
Adresa:	Vaksinimi i fundit:	Mjekimi i fundit:
Lipi i mostres:	Njesi mostre:	Me nekropsi:
Mostra per prova laboratorike:	Provat e Kerkuara:	Hershkrimete tjera:
Nr.Matrikullimit		Kushtet e ruajtjes:

Informacion nga Laboratori:

Dokumenti financiar:

**Të dhënat për identifikimin e kampionit rezultojnë në dokumentat shoqeruese, etikete ose në deklaratën e lëshuar nga subjekti.* ☐

Laboratori i Kryerjes së Provës:

Data e Fillimit të Provës: **Data e Mbarimit të Provës:**

REZULTATI I PROVAVE

Kampioni nr	Analiti/ Treguesi	Metoda/Referenca	Rezultati

Shënime të laboratorit:

Analisti **Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Laboratorike**

Drejtori i Vlerësimit të Riskut

Ky Raport Prove i përket vetëm mostrës së analizuar dhe është pronë e AKU.
Laboratori nuk mban përgjegjësi për kampionimin.
Riprodhimi i mundshëm i tij duhet të kryhet vetëm me autorizimin e Laboratorit.

Raport Prove Seriologjia

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBETAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E VLERESIMIT TE RISKUT
SEKTORI I SHËRBIMEVE LABORATORIKE _____

*Adresa*_____ _____ *më,* _____

RAPORTI I PROVËS NR.
DIAGNOZË SHËNDETI I KAFSHËVE

Numri Identifikues i Mostrës: **Data e praninit:**

Informacion nga fleta shoqërimit të kampioni

Informacion nga Laboratori:

Dokumenti financiar:

Subjekti qe ka Kerkuar Proven:	Kampionimi i kryer nga:	Motivi i kampionimit:
Enti / Personi fizik:	Flete shoqerimi Nr.:	Metoda:
Adresa:	Nr. Matrikullimi:	Mjekimi i fundit:
Tipi i mostres:	Njesi mostre:	Me nekropsi:
Provat e Kerkuara:	Shenime te tjera:	

**Të dhënat për identifikimin e kampionit rezultojnë në dokumentat shoqeruese, etikete ose në deklaratën e lëshuar nga subjekti.*

Laboratori i Kryerjes së Provës:

Data e Fillimit të Provës: **Data e Mbarimit të Provës:**

REZULTATI I PROVAVE

Kampioni nr	Analiti/ Treguesi	Metoda/Referenca	Lloji i kafshës	Rezultati

Shënime të laboratorit:

Antibiograma:

Analisti **Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Laboratorike**

Drejtori i Vlerësimit të Riskut

Ky Raport Prove i përket vetëm mostrës së analizuar dhe është pronë e AKU.
Laboratori nuk mban përgjegjësi për kampionimin.
Riprodhimi i mundshëm i tij duhet të kryhet vetëm me autorizimin e Laboratorit.

Raport prova për laboratorin e Mbrojtjes së Bimëve

Shtojca VIII

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT
SEKTORI I SHERBIMEVE LABORATORIKE _____

*Adresa*_____ _____ *më,*
_____

RAPORTI I PROVËS NR.

Numri Identifikues i Mostrës: **Data e pranimit:**

Subjekti që ka Kërkuar Provën/Adresa:

Kampionimi i kryer nga: **Metoda e kampionimit:**

Fleta Shoqërimit: **Motivi i kampionimit:**

Emri i bimës / prodhimeve bimore: **Kushtet e Ruajtjes: ± C°**

Vendi i kampionimit: **Data e kampionimit:**

Nr. i etiketës së mostrës: **Origjina e mostrës:**

Njësi mostre:

Laboratori i Kryerjes se Provës:

Provat e Kërkuara:

Përshkrime te tjera:

Kampionet: _____ - (Var. _____- _____ rrenje)

U analizuan dhe rezultoi se: _____
_____
_____

Me këtë rast rekomandojmë këto masa:_____
_____
_____
_____
_____
_____

Analisti Fitosanitar **Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Laboratorike**

Drejtori i Vlerësimit të Riskut

Ky Raport Prove i përket vetëm mostrës së analizuar dhe është pronë e AKU.
Laboratori nuk mban përgjegjësi për kampionimin.
Riprodhimi i mundshëm i tij duhet të kryhet vetëm me autorizimin e Laboratorit.

Shtojca II

Fletë shoqërimi për konfirmim rezultati në ISUV

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË RISKUT
SEKTORI I SHERBIMEVE LABORATORIKE _____

Adresa_____

Nr. Serial _____ Datë _____

FLETË SHOQËRIMI MOSTRE PËR LABORATORIN

- Numri i kodit zyrtar të mostrës.....
- Data e pranimit të mostrës në LAB AKU.....Ora.....
- Lloji i analizës së kërkuar nga inspektori.....
- Kushtet e ruajtjes së mostrës .....
- Arsyeja që kërkohet konfirmimi i rezultatit .....
- Përshkrimi i mostrës.....
- Paketimi, sasia, lloji i paketimit.....
- Afati i skadencës, data, muaji, viti.....
- Mënyra e transportit të mostrës.....
- Mbërritja në laborator ISUV, data, ora.....
- Vërejtje të veçanta.....

PËRGJEGJËSI SEKTORIT TË SHËRBIMEVE LABORATORIKE AKU

PRANUESI I MOSTRËS ISUV

VENDIM
Nr. 5, datë 24.12.2020

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", KDZH-ja, e ngritur me urdhër nr. 389, datë 20.11.2017, të drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, u mblodh më datë 24.12.2020, dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror", si më poshtë:

- F. 811 (Mehmet Shehu)

Viti 1975, dosja 848. "Sekret"

Viti 1980, dosjet 853, 855, 857, 859, 860. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 863. Niveli i klasifikimit "T Sekret". Dosjet 867, 868, 869, 871, 872, 873, 876, 877, 878, 882. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 883. Niveli i klasifikimit "T Sekret". Dosjet 884, 885, 886, 887, 888. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 889. Niveli i klasifikimit "T Sekret". Dosjet 890, 891. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 892. Niveli i klasifikimit "T Sekret" 893, 894, 896, 897. 899, 903, 904, 905, 908, 910, 912, 913, 914, 916, 917, 918, 922, 923, 924, 925, 926, 927, 930, 933, 937, 943, 947, 948, 949, 950, 951, 952, 953. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dosja 958. Niveli i klasifikimit "T Sekret". Dosjet 957, 958, 959. Niveli i klasifikimit "Sekret".

2. Përjashtimin nga deklasifikimi të dosjes 894, viti 1980. Niveli i klasifikimit "Sekret".

Dosjet deklasifikohen plotësisht, sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika "b", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017.

3. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet DSIK-së, si dhe për botimin në Fletoren Zyrtare.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ardit Bido

URDHËR
Nr. 1, datë 5.1.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Endrit Musaj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2021.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Endrit Musaj, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

NJOFTIM
Nr. 195, datë 7.1.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

"Marrëveshje ndryshuese e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve", nënshkruar më 9.11.2020, ka hyrë në fuqi më 20 janar 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME
Armand Skapi

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 4
Datë: 2021/01/12 16:00:33
0dc240ca-fb65-4f39-8d9b-48d3dba5117c

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1120 lekë